RAPORTI PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

"AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE"

TIRANË, shtator 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**2-9**
1.	Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	2-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-7
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-9
II.	**HYRJA**	**9-12**
1	Objektivat dhe qëllimi	9
2	Identifikimi i çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9-10
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e vlerësimit	11
6	Standardet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	11-12
8	Dokumentimi i auditimit	12
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**12-344**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**12-344**
2.1	Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA-së dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.	12-71
2.2	Mbi zbatimin e legjislacionit për prokurimet e fondeve publike, zbatimi i kontratave si dhe shpenzimet e tjera të kryera.	71-161
2.3	Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, shpenzimet e pagave, si dhe menaxhimin i burimeve njerëzore në institucionet publike të arsimit parauniversitar.	161-253
2.4	Mbi veprimtarinë e monitorimit të kurrikulës dhe inspektimeve të kryera në institucionet publike të arsimit parauniversitar.	253-297
2.5	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar.	297-344
IV	**REKOMANDIME**	**345-376**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 10/1, datë 13.01.2026, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë (DRAP Tiranë), për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, ish Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës) për periudhën 01.01.2022-31.12.2024 si dhe 5 Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në varësi të DRAP Tiranës: ZVAP Tiranë; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë, për periudhën 01.01.2022-31.12.2025.

DRAP është përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e ZVAP dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, me qëllimin sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në nivel rajonal. Ndërsa ZVAP janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë është institucioni i ri, i krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*, sipas të cilit efektet e tij fillojnë pas datës 01.10.2024.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, sipas Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 ka në varësi 5 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar: Tiranë; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë.

Përpara datës 01.10.2024, 5 Zyrat Rajonale të Arsimit Parauniversitar, të përmendura më sipër, kanë qenë në varësi të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, pasi referuar Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*, DRAP Durrës, ka qenë përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e 12 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, konkretisht: Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë; Durrës; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë; Krujë; Bulqizë; Burrel; Mat; Klos, Dibër.

Pas riorganizimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës ka në varësi 7 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar: Durrës, Krujë, Bulqizë, Mat, Klos dhe Dibër.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij

Rëndësia e auditimit në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar qëndron në garantimin e ligjshmërisë, eficiencës, efektivitetit dhe transparencës së veprimtarisë së tyre. Auditimi siguron që procedurat administrative të zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Auditimi i këtyre institucioneve është fokusuar në çështje të posaçme që lidhen me emërimin e drejtuesve të institucioneve arsimore, kualifikimin e mësuesve, monitorimin dhe inspektimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, shpenzimet e realizuara, etj. Në këtë këndvështrim, auditimi përbën një mekanizëm për rritjen e llogaridhënies institucionale dhe garantimin e një administrimi më efektiv të politikave arsimore në nivel kombëtar dhe rajonal.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e kryerjes së veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ish Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës si dhe 7 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, për periudhën 01.01.2022-31.12.2025.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.
- Zbatimi i legjislacionit për prokurimet e fondeve publike, zbatimi i kontratave si dhe shpenzimet e tjera të kryera.
- Struktura organizative, administrimi i marrëdhënieve të punës, shpenzimet e pagave, si dhe menaxhimi i burimeve njerëzore në institucionet publike të arsimit parauniversitar.
- Veprimtaria e monitorimit të kurrikulës dhe inspektimeve të kryera në institucione publike të arsimit parauniversitar.
- Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave

Metodoogjia e auditimit është bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike, të zbatuara mbi bazën e vlerësimit të riskut, me qëllim sigurimin e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme për arritjen e objektivave të auditimit. Në këtë auditim janë përzgjedhur metoda, teknika dhe shtrirja e procedurave të auditimit, për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

-*Intervistimi* - duke komunikuar dhe marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

-*Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimet e auditimit;

-*Teknikat me ndihmën e kompjuterit* - për procedura të programuara, për të bërë testimet ose për nxjerrjen të dhënave për testim të mëtejshëm;

-*Verifikim transaksionesh* – me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

-*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 43 gjetje dhe ka dhënë 47 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

1. Dispozita e parashikuar në pikën 4, Kreu VII, të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 "*Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* bie në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr.

69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, duke sjellë shmangien e procedurave konkurruese dhe të parimit të barazisë në punësim.
2. Pas datës 21.07.2025, Kreu I, neni 2, pika "d" e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"* bie në kundërshtim me pikën 3 e nenit 3 të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, në lidhje me certifikimin e drejtuesve të institucionit arsimor.
3. Konstatohet se heqja e kriterit të realizimit të provimit për kategorinë e I "Mësues mjeshtër" në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 08.02.2023 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* për periudhën 11.03.2023 deri më 31.07.2024, dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 22.07.2024 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* bie në kundërshtim me pikën 2, neni 59 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Punonjësit e DRAP dhe ZVAP janë emëruar pa zhvilluar procedura konkurrimi, nëpërmjet kontratave të përkohshme me afat deri në përfundimin e procedurave konkurruese, ndërkohë që rezulton se emërime të tilla të përkohshme vijojnë prej vitit 2004.
5. 51 institucione arsimore nën juridiksionin e DRAP Tiranë nuk kanë hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të institucionit.
6**.** Deri në fund të vitit 2025, vijojnë të komanduar 90 nëndrejtorë shkollash, për të cilët nga drejtuesit e shkollave dhe drejtuesit e ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit
7. Rezulton se në institucionet arsimore nën juridiksionin e DRAP Tiranë janë punësuar 284 mësues të palicencuar, nga të cilët, 221 mësues në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Tiranë, 36 mësues në shkollat e ZVAP Kamëz, 12 mësues në shkollat e ZVAP Kavajë, 11 mësues në shkollat e ZVAP Vorë dhe 4 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë.
8. Në 53 raste në ZVAP Tiranë, në 3 raste në ZVAP Vorë dhe në 8 raste në ZVAP Rrogozhinë janë punësuar mësues jashtë profilit, pra profili për të cilin aplikanti ka lidhur kontratën provizore nuk përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar.
9. DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës nuk kanë realizuar procedurat e prokurimit për sigurimin e shërbimit të transportit për nxënësit dhe mësuesit, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar.
10. Në ZVAP Tiranë, Kavajë, Rrogozhinë, Vorë kanë përfituar shpenzime transporti gjithsej 207 punonjës të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytet ose fshat dhe me vendndodhje të IAP-ve publike brenda qendrave urbane dhe njësive administrative të Bashkisë Tiranë, në vlerë totale prej 1,747,276 lekë. Përfitimi i këtyre pagesave është bërë në kundërshtim me pikën 11, germa "a", të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar.
11. Nga ZVAP Tiranë janë likuiduar 8 vendime gjyqësore të formës së prerë, në vlerën totale 6,379,851 lekë. Për 4 raste, në shumën 415,513 lekë nuk është kryer ekzekutimi vullnetar i vendimeve gjyqësore, por është kontraktuar përmbarues privat. Nga ZVAP Kamëz është likuiduar 1 vendim gjyqësor i formës së prerë për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 842,226 lekë, prej të cilës 52,146 lekë është pagesë për shërbimin përmbarimor privat. Nga ZVAP Rrogozhinë është likuiduar 1 vendim gjyqësor i formës së prerë për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 1,671,754 lekë, prej të cilës 85,321 lekë është pagesë për shërbimin përmbarimor privat.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore

1. Ministria e Arsimit të marrë masa për rishikimin e Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"*, me qëllim shmangien e dispozitave që krijojnë përjashtime nga procedurat e konkurrimit nëpërmjet portalit *"Mësues për Shqipërinë"* si dhe vendosin kufizime në aplikimin e kandidatëve për një vend pune, në mënyrë që pranimi dhe emërimi i mësuesve të mbështetet në parimin e meritës, transparencës, barazisë së mundësive dhe respektimit të renditjes në portal.
2. Ministria e Arsimit të marrë masa për rishikimin e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"*, me qëllim rregullimin e procedurave të emërimit të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar dhe garantimin e transparencës, barazisë dhe vlerësimit të drejtë e proporcional të kandidatëve.
3. Ministria e Arsimit të marrë masa për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë së plotë të tyre duke përcaktuar qartë kriteret, procedurat dhe format e provimit përfundimtar për secilën kategori kualifikimi të mësuesve.
4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) të marrë masa të menjëhershme për përfundimin e procedurave të konkurrimit dhe emërimin e punonjësve të cilët rezultojnë me akte të përkohshme emërimi.
5. DRAP Tiranë të marrë masa të menjëhershme për identifikimin dhe shpalljen e të gjitha vendeve vakante për pozicionin e drejtorit të institucioneve arsimore publike me qëllim nisjen e procedurat e konkurrimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
6. ZVAP në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave të marrin masa të menjëhershme për hapjen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e nëndrejtorëve të komanduar dhe vendet vakante, duke siguruar zbatim të kërkesave ligjore për shpalljen publike, konkurrimin dhe verifikimin e kritereve të kualifikimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
7. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në bashkëpunimin me institucionet e arsimit parauniversitar të marrin masa për verifikimin e statusit të licencimit të të gjithë mësuesve në marrëdhënie pune dhe për rastet e konstatuara pa licencë të kërkojë pajisjen me licencë, në testimin e ardhshëm për licencim.
8. DRAP në bashkëpunim me ZVAP-të përkatëse të marrin masa të menjëhershme për garantimin e përputhshmërisë së profilit të diplomimit me lëndën e punësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të forcohen procedurat e verifikimit të dokumentacionit të kandidatëve para lidhjes së kontratës provizore, me qëllim parandalimin e rasteve të punësimit jashtë profili dhe sigurimin e respektimit të parimit të meritokracisë.
9. DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës t'i drejtohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me propozime dhe problematika konkrete lidhur me mosrealizimin e procedurave të prokurimit për shërbimin e transportit, për rastet e mungesës së ofertave ose interesit nga operatorët ekonomikë, me qëllim analizimin e shkaqeve, vlerësimin e efektivitetit të modelit aktual të prokurimit dhe identifikimin e mekanizmave alternativë që garantojnë realizimin e shërbimit dhe zbatimin efektiv të skemës së transportit për nxënësit dhe punonjësit arsimorë.
10. ZVAP-të nën juridiksion të DRAP Tiranë të marrin masa për forcimin e proceseve të verifikimit, administrimit dhe dokumentimit të përfitimit të shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë, duke siguruar evidentimin e saktë të vendndodhjes së IAP-ve, dokumentimin

e plotë të kritereve të përfitimit, standardizimin e dokumentacionit mbështetës dhe rritjen e kontrolleve administrative para kryerjes së pagesave, me qëllim garantimin e përdorimit të fondeve publike në përputhje me destinacionin e tyre, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të unifikuar për të gjithë punonjësit arsimorë.
11. DRAP Tiranë të analizojë rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që kanë sjellë efekte financiare negative në buxhetin e shtetit, me qëllim identifikimin e përgjegjësive administrative për vendimmarrjet dhe veprimet që kanë çuar në largime të padrejta nga puna dhe detyrime të tjera financiare ndaj institucionit. Gjithashtu, të marrë masat e nevojshme organizative dhe administrative për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afateve ligjore, duke shmangur përdorimin e shërbimit përmbarimor privat dhe kostot shtesë që rëndojnë buxhetin e shtetit.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

<u>Opinion për auditimin e përputhshmërisë i kualifikuar[1]:</u>
Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë (DRAP Tiranë), për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, ish Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës) për periudhën 01.01.2022-31.12.2024 si dhe 5 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në varësi të DRAP Tiranës: *ZVAP Tiranë; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë,* për periudhën 01.01.2022-31.12.2025, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve mbi të cilat këto struktura realizojnë misionin e tyre. Gjatë auditimit në terren janë marrë të dhëna, dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme, të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, në veprimtarinë e DRAP dhe ZVAP-ve janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin*", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.
Baza për opinionin mbi përputhshmërinë:
Nga evidencat e marra dhe të shqyrtuara për veprimtarinë e DRAP Tiranë, ish DRAP Durrës dhe 5 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar kanë rezultuar problematikat si në vijim:
- Udhëzimi i MAS nr. 8/2024 "*Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"* i jep kompetencë Drejtorit të DRAP të emërojnë mësues, punonjësit e prekur nga ristrukturimi i DRAP dhe ZVAP, pa procedura konkurrimi, duke shmangur portalin "Mësues për Shqipërinë" dhe duke krijuar mospërputhje me parimin e meritës të parashikuar në ligjin nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.
- Mospërputhje midis ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 22/2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"* për kriteret e emërimit të drejtorëve IPAP, përfshirë vendosjen e kushteve shtesë dhe skema vlerësimi që nuk reflektojnë diferencim real të dosjeve të kandidatëve.
- Mungesë harmonizimi ndërmjet ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në*

[1] Opinion i kualifikuar mbi auditimin e përputhshmërisë: *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, **janë materiale por jo të përhapura**.*

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10171/2009 *"Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë"* dhe akteve nënligjore lidhur me praktikën profesionale të mësuesve dhe rastet e përjashtimit prej saj, duke krijuar paqartësi në zbatim.
- Ndryshimet në udhëzimet për kualifikimin e mësuesve bien në kundërshtim me ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, pasi ndryshojnë formën e vlerësimit dhe heqin provimin për përfitimin e kategorive të kualifikimit.
- Mospërputhje ndërmjet kuadrit ligjor dhe nënligjor për afatet e furnizimit, faturimit dhe financimit të teksteve shkollore, duke krijuar risk për mosrespektim të afateve të pagesave dhe krijim detyrimesh të prapambetura.
- Nga ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz dhe ZVAP Rrogozhinë janë likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë në vlerën totale 8,893,831 lekë, kryesisht për largime të padrejta nga puna, ku vlera 415,513 lekë përbën kosto shtesë për përmbarues privat.
- Punonjësit e DRAP dhe ZVAP janë emëruar pa zhvilluar procedura konkurrimi, nëpërmjet kontratave të përkohshme me afat deri në përfundimin e procedurave konkurruese, ndërkohë që rezultoi se emërime të tilla të përkohshme vijojnë prej vitit 2004.
- Në 2 raste, DRAP Tirana ka emëruar mësues, punonjësit të ZVAP Tiranë të cilët janë prekur nga ristrukturimi, pa plotësuar kriteret e përcaktuar në Udhëzimin nr. 8/2024 "*Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë".*
- Për DRAP Tiranë dhe ZVAP Tiranë është caktuar i njëjti nëpunës zbatues, duke krijuar mbivendosje funksionesh dhe cenimin e parimit të ndarjes së detyrave.
- 51 institucione arsimore nën juridiksionin e DRAP Tiranë nuk kanë hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të institucionit.
- 90 nëndrejtorë shkollash janë të komanduar, për të cilët nga drejtuesit e shkollave dhe drejtuesit e ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit.
- Në institucionet arsimore nën juridiksionin e DRAP Tiranë janë punësuar 284 mësues të palicencuar, nga të cilët, 221 mësues në shkollat nën juridiksionin e ZVAP Tiranë, 36 mësues në shkollat e ZVAP Kamëz, 12 mësues në shkollat e ZVAP Kavajë, 11 mësues në shkollat e ZVAP Vorë dhe 4 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë.
- Në 53 raste në ZVAP Tiranë, në 3 raste në ZVAP Vorë dhe në 8 raste në ZVAP Rrogozhinë janë punësuar mësues jashtë profilit, pra profili për të cilin aplikanti ka lidhur kontratën provizore nuk përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar.
- Për punësimin e mësuesve ndihmës, në mungesë të profilit të arsimit special janë angazhuar mësues jashtë profilit, duke rritur riskun për cilësinë e shërbimit arsimor ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara.
-Janë identifikuar raste të mosplotësimit të kritereve për kredite, eksperiencë dhe kushte profesionale gjatë procesit të kualifikimit të mësuesve.
- Procesi i përzgjedhjes së mësuesve përmes portalit *"Mësues për Shqipërinë*" nuk dokumentohet në mënyrë të plotë dhe të gjurmueshme, duke mos garantuar transparencë dhe verifikueshmëri të plotë të vendimmarrjes.
- Monitorimet e kryera nga ZVAP-të paraqesin mangësi në dokumentim, analizë dhe ndjekje të rekomandimeve, me raporte përshkruese, rekomandime të përgjithshme dhe mungesë të afateve e evidencave mbështetëse.
- DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës nuk kanë realizuar procedurat e prokurimit për sigurimin e shërbimit të transportit për nxënësit dhe mësuesi.

- 207 mësues në ZVAP Tiranë, Kavajë, Rrogozhinë dhe Vorë, për muajin Dhjetor 2025, kanë përfituar shpenzime transporti në vlerën 1,747,276 lekë, pavarësisht se shkolla në të cilën janë punësuar ndodhet brenda qendrave urbane.
- Llogaritja e kompensimit të transportit nuk është kryer në mënyrë të diferencuar për distancën e udhëtimit të punonjësit arsimor, në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke rezultuar në zbatim jo uniform të procedurave të kompensimit.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 10/1, datë 13.01.2026, i ndryshuar, nga data 13.01.2026 deri më datë 11.05.2026, u krye auditimi me objekt përputhshmërinë e veprimtarisë në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, ish Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar për periudhën 01.01.2022-31.12.2024, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Kamëz, Kavajë, Vorë dhe Rrogozhinë, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2025, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. H.S, Përgjegjëse grupi
2. E.H, Anëtar
3. E.K, Anëtar
4. P.K, Anëtar
5. B.S, Anëtar.

1. Objektivat, fushëveprimi dhe metodologjia

Objektivat dhe qëllimi i auditimit është përputhshmëria e veprimtarisë së subjekteve, DRAP dhe ZVAP me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu veprimtarinë në lidhje me procedurat e emërimin të drejtuesve të institucioneve arsimore, kualifikimin e mësuesve, procedurat e prokurimit, shpenzimet e realizuara, monitorimin e kryera nga ZVAP dhe inspektimin e kryera nga DRAP në institucionet e arsimit parauniversitar.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

2. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Rajonale të Arsimit Parauniversitar, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi. Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së DRAP dhe ZVAP-ve, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të gabimit që do përdoren për procedura auditimi të cilat janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Strukturat drejtuese të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar , Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar kanë përgjegjësi për:

-Funksionimin e institucionit dhe institucioneve arsimore brenda juridiksioneve të tyre.

-Sigurimin dhe cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar.

-Sigurimin e zbatimit të kurrikulës, metodologjisë dhe standardeve që mbështetin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.

-Menaxhimin, mbikëqyrjen, vlerësimin dhe kontrollin e institucioneve të arsimit parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Monitorimin e kualifikimit të personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara.

- Mirëadministrimin e burimeve njerëzore në institucionet publike të arsimit parauniversitar si dhe shpërndarjen e tyre në varësi të aftësive, kontributit të gjithsecilit dhe parimeve të drejtësisë e meritokracisë.

-Rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar "Mësues për Shqipërinë", ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimin e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.

-Monitorimin, inspektimin, vlerësimin, rekomandimin dhe nxjerrjen e përfundimeve mbi zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitar publike dhe private, etj.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 *"Parimet themelore të auditimit të sektorit publik"*, paragrafi 44-51.

Përveç standardeve të ISSAI, ne aplikuam edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne: Identifikuam dhe përpunuam riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikuam, realizuam procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbulluam evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë.

Krijuam një konkluzion final nëse çështjet rutinë të raportimit të të dhënave janë kryer në mënyrën e duhur dhe u bazuam në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çonin në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit.

5. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*;
- Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";*
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar;
- Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar;
- VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *"Për krijimin, mënyrën e organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar";*
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar.
- VKM nr. 119, datë 01.03.2023 *"Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit"*, i ndryshuar, etj.

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë "Parimet INTOSAI-t" ku përfshihet: ISSAI-P-1 "Deklarata e Limës", ISSAI-P-10 "Deklarata e Meksikos"; Nivelin e dytë "Standardet e INTOSAI-t" ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 "Parimet bazë të auditimit financiar", ISSAI 400-499 "Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë".

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 "Sigurimin e cilësisë"
ISSAI 130 "Kodin Etik"
ISSAI 2315 "Risku"
ISSAI 2320-2450 "Materialiteti"
ISSAI 2500 "Dokumentimi"

7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

-*Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

-*Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël si mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

-*Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

-*Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit të subjektit që auditohet.

-*Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
-*Pyetësorët* - grupi i auditimit ka përdorur pyetësor për vlerësimin dhe testimin e drejtimeve të auditimit.
-*Të kombinuara,* sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit

Është mbështetur në kërkesat e Manualit të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.
Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve dhe në përgatitjen e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*, sipas të cilit efektet e tij fillojnë pas datës 01.10.2024.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, sipas Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 ka në varësi 5 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar: Tiranë; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë.
Përpara datës 01.10.2024, 5 Zyrat Rajonale të Arsimit Parauniversitar, të përmendura më sipër, kanë qenë në varësi të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, pasi referuar Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*, DRAP Durrës, ka qenë përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e 12 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, konkretisht: Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë; Durrës; Kamëz; Kavajë; Rrogozhinë; Vorë; Krujë; Bulqizë; Burrel; Mat; Klos, Dibër.
Pas riorganizimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës ka në varësi 7 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar: Durrës, Krujë, Bulqizë, Mat, Klos dhe Dibër.

2. Rezultatet e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i buxhetit. Programimi PBA-së dhe buxhetit vjetor, çelja e fondeve vjetore dhe ndryshimet sipas akteve normative, saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.1.1 Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë

DRAP Tiranë e ushtron aktivitetin financiar në grupin 11 në programin buxhetor *01110 "Planifikim, Menaxhim, Administrim", 09120 "Arsimi Bazë", 09320 "Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)",*

Programi Buxhetor Afatmesëm

Sipas pikës 7 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë është krijuar në fund të vitit 2024.

Duke qenë se DRAP Tirana është një institucion i krijuar rishtas, për buxhetin e vitit 2025, nga strukturat e këtij institucioni nuk është përgatitur dokumenti i PBA-së.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2025

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 8208/3, datë 24.01.2025 ka dërguar fondet e miratuara për shpenzimet korrente, të DRAP Tiranë në vlerën totale **63,077 mijë lekë**: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 36,881 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 15,121 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 11,075 mijë lekë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka dërguar shkresën nr. 3699/1, datë 24.06.2025 për transferimin e fondeve për shpenzimet kapitale nga DRAP Durrës në DRAP Tiranë për vlerën totale 7,135 mijë lekë nga të cilat 4,252 mijë lekë janë për programin e Arsimi Bazë (09120) dhe 2,883 mijë lekë janë për programin Arsimi i Mesëm (09230).

- **Rishpërndarja e fondeve**

Nga auditimi u konstatua se për periudhën gjatë vitit 2025, për DRAP Tiranë janë kryer 11 rishikimeve buxhetore.

Rezulton se Ministria e Arsimit nuk ka informuar DRAP, me shkresë zyrtare për ndryshimin buxhetor të ndodhur në muajin Nëntor, ku DRAP Tiranës i janë pakësuar fondet në vlerën 7,434 mijë lekë. Ndryshimi në buxhet është bërë me dije për institucionin në momentin e rakordimit me degën e thesarit.

Realizimi i planit të buxhetit

Niveli i realizimit të fondeve të DRAP Tiranë krahasuar me planifikimin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Buxheti sipas Programeve Buxhetore		Viti 2025			
		Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Realizimi Faktik	Mosrealizim i buxhetit të rishikuar
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	36,881	26,014	25,605	409
II	Arsimi Bazë	19,373	1,600	1,471	129
III	Arsimi i Mesëm	13,958	7,412	365	7,047
Total		**70,212**	**35,026**	**27,441**	**7,585**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 78% kundrejt planit te rishikuar dhe 39% kundrejt planit fillestar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **35,026 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **27,441 mijë lekë**.

Mosrealizimi i buxhetit në masën 61% kundrejt planifikimit fillestar të buxhetit tregon një planifikim jo realist fillestar. Edhe pse nuk është përgjegjësi direkte e subjektit DRAP Tiranë do të duhej të kishte një koordinim me të fortë me nivelin qendror për një planifikim me realist dhe

efektiv. Shkalla e mos realizimit mbi buxhetin e rishikuar është në vlerën 7,585 mijë leke ose 21.60% e buxhetit te rishikuar.
Konstatohet se buxheti është zbatuar brenda kufijve të planit të miratuar dhe nuk janë kryer shpenzime mbi fondet e miratuara.
Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

2025							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe Shërbime	231 Shpenzime Operative	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	20,612	3,442	1,960	0	**26,014**
		Realizuar	20,612	3,442	1,550	0	**25,604**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**79%**	**0%**	**98%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	0	0	1,600	0	**1,600**
		Realizuar	0	0	1,471	0	**1,471**
		Realizimi	**0%**	**0%**	**92%**	**0%**	**92%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	0	0	7,046	366	**7,412**
		Realizuar	0	0	0	366	**366**
		Realizimi	**0%**	**0%**	**0%**	**100%**	**5%**
TOTALI		Planifikuar	20,612	3,442	10,606	366	**35,026**
		Realizuar	20,612	3,442	3,021	366	**27,411**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**28%**	**100%**	**78%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2025, realizimi i shpenzimeve në programin 01110 **"*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*"** ka qenë 98%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 69.4% me planin fillestar.
Produkti 91101AA "*Punonjës dhe specialiste të trajnuar*" është planifikuar në vlerën 160 mijë lekë dhe është realizuar në masën 0%.
Produkti 91101AE "*Veprimtari e MAS sipas kërkesave ligjore*", për llogarinë 600, pagat e punonjësve është realizuar në masën 100%, 20,612 mijë nga 20,612 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 601, sigurime shoqërore është realizuar në masën 100%, 3,442 mijë lekë nga 3,442 mijë lekë të planifikuara. Për llogarinë 602, mallra dhe shërbime është realizuar në masën 79%, 1,550 mijë lekë nga 1,960 mijë lekë të planifikuara. Në këto shpenzime janë përfshirë shpenzime të kryera nga DRAP Tirane për kancelari, material për funksionimin e zyrës, material dhe shërbime speciale udhëtim i brendshëm, udhëtim i jashtëm.
Referuar buxhetit të DRAP Tiranë në vitin 2025, nën programin 01110 "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*" është përfshirë edhe produkti 91101AC "*Drejtuesve te institucioneve arsimore te trajnuar*", i cili rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë planifikuar fillimisht 1,500 mijë lekë.
Realizimi i shpenzimeve për programin 09120 *"Arsimi Bazë"*, deri në fund të vitit 2025 ka qenë 92%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 7.6% me planin fillestar. Më hollësisht, realizimi i fondeve sipas projekteve të përfshira në program paraqitet si më poshtë:
Produkti 91103AE "*Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re*" rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë buxhetuar fillimisht 7,377 mijë lekë.
Produkti 91103AB "*Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar"* është në masën 91.9%, 1,471 mijë lekë nga 1,600 mijë lekë të planifikuara. Buxheti i këtij produkti ka pësuar ndryshime dhe rezulton i realizuar në vlerën 1,471 mijë lekë deri në fund të periudhës objekt auditimi.
Projekti M112624 "*Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë*" rezulton i pa realizuar. Nën këtë projekt janë planifikuar fillimisht 4,252 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve për programin 09230 *"Arsimi i Mesëm"*, deri në fund të vitit 2025 ka qenë 5%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 2% me planin fillestar. Më hollësisht, realizimi i fondeve sipas projekteve të përfshira në program paraqitet si më poshtë:

Produkt 91104AA "*Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike*" rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë buxhetuar fillimisht 7,745 mijë lekë, të cilat janë rishikuar për tu shpërndarë në zyrat vendore arsimore duke konkluduar në buxhetin final prej 3,716 mijë lekë.

Produkti 91104AC "*Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12"* rezulton i pa realizuar. Nën këtë produkt janë buxhetuar fillimisht 3,330 mijë lekë, të cilat nuk kanë pësuar ndryshime në buxhet përgjatë periudhës se audituar dhe nuk është realizuar.

Projekti M112629 "*Krijim fond bibliotekash për shkollat e adresimit të mesëm"* është realizuar në masën 100%, 365 mijë lekë nga 365 mijë lekë të planifikuara. Buxheti i këtij projekti ka pësuar ndryshime deri në fund të periudhës objekt auditimi deri në përcaktimin e vlerës për realizim.

Tabela e mosrealizimit të programit *Në mijë lekë*

Programi	Llogaria	Projekti	Buxheti Fillestar 8208-3 dt24.01.2025	Ndryshim 3699-1 date 24.06.2025	Ndryshim 6955-1 dt 07.11.2025	Ndryshim 7052-1 dt 14.11.2025	Ndryshim 18059-41 dt 29.12.2025	Buxheti Përfundimtar i rishikuar
1110	602	Trajnime për Drejtuesit Arsimor	1,500			-1,500		-
9120	602	Mësues te arsimit baze te trajnuar për kurrikule e re	7,377		-182	-7,195		-
9230	231	Krijim fond bibliotekash për shkollat arsim baze	-	4,252			-4,252	-
Total			**8,877**	**4,252**	**-182**	**-8,695**	**-4,252**	**-**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Nga grupi i auditimit janë evidentuar projekte të planifikuara në buxhetin fillestar por që nuk janë realizuar, duke sjellë planifikim jo realist dhe mos realizim të objektivave të programit.

Mbi raportet e monitorimit

Në nenet 22 dhe 32 të Rregullores nr. 153, datë 17.04.2025 *"Për përcaktimin e metodave të brendshëm të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" përcaktohen kompetencat e DRAP-it dhe ZVAP-it në lidhje me hartimin dhe propozimin e projektbuxhetit, por nuk parashikohet asnjë detyrë specifike e DRAP-it për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të buxhetit të ZVAP-ve gjatë vitit buxhetor. Pra në rregullore përcaktohet se DRAP duhet të hartojë dhe raportojnë në Ministrinë e Arsimit projekt buxhetin e ZVAP, por nuk përcakton në mënyrë eksplicite që DRAP duhet të përfshijë në raportimin e monitorimit edhe zbatimin e buxhetin nga ana e ZVAP. Kjo krijon një mospërputhje me kërkesat e nenit 2, të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ku përcaktohet se: "*Ky ligj zbatohet nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në të gjitha fazat e procesit buxhetor, që do të thotë: a) përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit; b) zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit; c) të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë, si dhe format e tjera, të rrjedhura prej tyre; ç) kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin e buxhetit*."Për rrjedhojë, mungesa e një dispozite që të përcaktojë rolin e DRAP-it në monitorimin, analizën dhe raportimin e zbatimit të buxheteve të ZVAP-ve bën që rregullorja të mos pasqyrojë të plotë ciklin e menaxhimit buxhetor, sipas kërkesave të legjislacionit buxhetor në fuqi, duke kufizuar kompetencat e DRAP-it vetëm në fazën e planifikimit dhe miratimit të buxhetit.

Raporti i monitorimit 4 mujor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. 802, datë 18.06.2025 jashtë afatit ligjor në MAS në kundërshtim me pikën 33 të udhëzimit nr.14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit

në njësitë e qeverisjes qendror" ku citohet se: *" Raportet e katër mujorit dhe tetë mujorit duhet të dorëzohen tek njësia përgjegjëse për monitorimin në Ministrinë përgjegjëse për Financat deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit të parë dhe tetëmujorit, përkatësisht deri në 30 Maj; dhe deri në 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm*".

Raporti i monitorimit 8-mujor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë është përcjellë me shkresën nr. 1439 prot, datë 19.09.2025 brenda afatit ligjor.

Raporti i monitorimit 12-mujor Drejtorisë Rajonale Arsimore Tiranë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr.98 prot, datë 14.01.2026 brenda afatit ligjor.

Nga auditimi u konstatua se raportet e monitorimit shoqërohen me relacion shpjegues duke paraqitur vetëm qëllimin e raporteve të monitorimit. Në këto raporte nuk është kryer përshkrimi i institucionit si dhe nuk është hartuar një listë përmbledhëse së çfarë përmban relacioni. Mungon një analizë e plotë e realizimit të objektivave dhe përdorimit te fondeve. Analiza sipas zërave buxhetorë është kryer vetëm pas planit të rishikuar të buxhetit, e jo planit fillestar, duke sjellë mungesën e një analize të qartë në lidhje me ndryshimet dhe devijimet e planit të rishikuar në krahasim me planin fillestar. Konstatohet se nuk janë analizuar dhe argumentuar në mënyrë të detajuar shpenzimet operative, projektet dhe investimet e pa realizuara, si dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e punës në DRAP Tiranë. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin nr.14 datë 30.05.2023 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ",* shtojca nr. 3 dhe kapitulli 4, pika 49 dhe Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 *"Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit"*, kapitulli VI, pika 271.

Gjithashtu rezulton se raportet e monitorimit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në kundërshtim me pikën 51 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore",* ku citohet se: *"Ministritë dhe institucionet publikojnë raportet e monitorimit dhe tabletat e anekseve në faqen zyrtare të ministrisë/institucionit, brenda katër javëve nga mbarimi i periudhës së raportimit. Publikimi i raportit dhe anekseve bëhet në format të lexueshëm nga makinat (.doc, .xlx, etj.)"*

Për vitin 2025 DRAP Tiranë nuk ka gjeneruar të ardhur dytësore.

2.1.2 Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës (DRAP Durrës)

Programi Buxhetor Afatmesëm

Nga auditimi rezulton se DRAP Durrës ka hartuar PBA-në vetëm me një fazë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 07 datë 28.02.2008, pika 3 "Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" i cili përcakton se "*Programi buxhetor afatmesëm bëhet në dy faza"*.

PBA 2022-2024 është dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1566, prot, datë 09.08.2021, brenda afatit kohor, të përcaktuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*".

PBA 2023-2025 është dërguar në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1997, prot, datë 19.08.2022, brenda afatit kohor.

PBA 2024-2025 është dërguar në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 1430/3, prot, datë 18.08.2023, brenda afatit kohor.

Konstatohet se PBA-të e hartuar për periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në Kapitullin I, pika 8 e udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", pasi nuk janë përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat, treguesit e performancës për programin dhe aktivitetet e planifikuara për kërkesat buxhetore.

Nga auditimi rezulton se DRAP Durrës nuk ka paraqitur relacionin shpjegues dhe anekset e PBA-së për 12 ZVAP-të nën juridiksion e tij në kundërshtim me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 dhe rregulloren për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së përgjithshme të arsimit konkretisht neni 14 "Detyrat kryesore të burimeve njerëzore, shërbimeve dhe Statistikës", ku citohet se, DRAP harton projektbuxhetin e drejtorisë qendrore si dhe planifikon buxhetin në terma afatshkurtër e afatmesëm për ZVAP dhe institucionet publike të arsimit parauniversitar.
DRAP Durrës nuk ka hartuar për institucionin dhe për 12-ZVAP-të nën juridiksionin e tij, aneksein 1"Raporti i shpenzimeve" të raportimit për vitin 2023-2025, 2024-2026, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë ",* i ndryshuar, neni 23.
PBA 2024-2026, nuk paraqitet në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2024-2026". DRAP Durrës nuk ka hartuar deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit. Nuk ka paraqitur relacionin shpjegues dhe anekset e PBA-së vetëm për ZVAP nën juridiksion në kundërshtim me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 dhe rregulloren për organizimin dhe funksionimin e drejtorisë së përgjithshme të arsimit konkretisht, neni 14.
Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2022-2024, rezultoi se institucioni DRAP Durrës ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës nr. 1430/1 date 26.07.2021 për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm "pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.
Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2023-2025, 2024-2026 rezultoi se institucioni DRAP Durrës nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2, ku citohet se, se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.
Nga auditimi i PBA 2022-2024, 2023-2025, 2024-2026 u konstatua se në institucionin DRAP Durrës nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.*

Plani buxhetor afatmesëm 2023-2025 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj

Nga auditimi mbi procesin e hartimit dhe miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, u konstatua se relacioni i PBA-së është përcjellë pa firmën e Nëpunësit Zbatues, duke mos garantuar plotësisht gjurmën administrative në procesin e planifikimit buxhetor, në kundërshtim me nenin 12 dhe nenin 16 të ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku përcaktohen përgjegjësitë e nëpunësit zbatues për administrimin financiar, si dhe detyrimi për vendosjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm që sigurojnë gjurmë auditimi të plotë, dokumentim dhe ndarje të qartë përgjegjësish.

Plani buxhetor afatmesëm 2024-2026 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj. Dokumentacioni përbëhet nga anekset shoqëruese, por nuk janë përcaktuar qëllimin, objektivat, treguesit e performancës për programin aktivitetet e planifikuara sipas kërkesave buxhetore. Nuk rezulton të jetë hartuar deklarata e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit, si dhe nuk paraqitet në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit në dokumentin "Formati standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2024-2026".

Planifikimi për Shpenzimet Korrente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" për vitin 2022 nën artikullin 600 është bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve dhe kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucione në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*" dhe strukturën e miratuar për DRAP Durrës dhe ZVAP-et nën juridiksion. Ky zë është parashikuar në shumën totale 14,744 mijë lekë vetëm në programin "Planifikim, menaxhim, administrim",

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" për vitin 2022 nën artikullin 601 janë mbështetur në Ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Ky zë është parashikuar në shumën totale 2,345 mijë lekë, vetëm në programin "Planifikim, menaxhim, administrim",

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" për vitin 2022 nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, përcaktuar në bazën ligjore dhe rregullatore për funksionimin e DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et nën juridiksionin e saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 104,288 mijë lekë, nga të cilat 10,166 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 63,641 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 30,481 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*" për vitin 2022, nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". Ky zë është parashikuar në shumën totale 300 mijë lekë nga të cilat 300 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" për vitin 2023 nën artikullin 600 është parashikuar në shumën totale 10,876,204 mijë lekë nga të cilat 121,523 mijë lekë në programin

"Planifikim, menaxhim, administrim", 8,249,151 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 2,505,529 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".
Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" për vitin 2023 nën artikullin 601 është parashikuar në shumën totale 1,750,849 mijë lekë, nga të cilat nga të cilat 19,328 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 1,336,670 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 394,851 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" për vitin 2023 nën artikullin 602 është parashikuar në shumën totale 442,434 mijë lekë, nga të cilat 26,882 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 370,317 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 45,235 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".
Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*" për vitin 2023 është parashikuar në shumën totale 479,143 mijë lekë nga të cilat 1,742 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 433,707 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 43,694 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".
Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" për vitin 2024 nën artikullin 600 është parashikuar në shumën totale 13,141,895 mijë lekë nga të cilat 166,863 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 9,856,344 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 3,118,689 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".
Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" për vitin 2024 nën artikullin 601 është parashikuar në shumën totale 2,079,300 mijë lekë, nga të cilat nga të cilat 26,697 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 1,577,075 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 475,528 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" për vitin 2024 nën artikullin 602 është parashikuar në shumën totale 536,085 mijë lekë, nga të cilat 26,135 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 460,546 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 49,404 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".
Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*" për vitin 2024, nën artikullin 606 është parashikuar në shumën totale 238,700 mijë lekë nga të cilat 1,200 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim", 215,421 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 21,869 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Planifikimi për Shpenzimet Kapitale

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kapitale të Trupëzuara*" për vitin 2022 është kryer në bazë të nevojave të drejtorisë për vijimin e veprimtarisë së saj. Ky zë është parashikuar në shumën totale 53,238 mijë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim",63,641 mijë lekë. Për vitin 2023 është parashikuar në shumën totale 4,914,897 mijë lekë nga të cilat 169,480 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim",4,733,982 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 11,435 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm". Për vitin 2024 është parashikuar në shumën totale 32,339 mijë lekë nga të cilat 5,810 mijë lekë në programin "Planifikim, menaxhim, administrim",18,470 mijë lekë në programin "Arsimi Bazë" dhe 8,059 mijë lekë në programin "Arsimi i mesëm".

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

MAS me shkresën nr. 7403/3, prot, datë10.01.2022 ka dërguar pranë DRAP Durrës shpërndarja e shpenzimeve korrente për vitin 2022, duke bërë alokimin e fondeve të buxhetit për këtë institucion në një total prej 55,798 mijë lekë.

Nga vendosja në dispozicion e ndryshimeve që ka pësuar buxheti i vitit 2022 për DRAP Durrës rezulton se janë kryer ndryshimet si mëposhtëm:

Shkresa nr. 49341/141 prot, datë 11.04.2022 rezulton në pakësim të buxhetit të Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës në programin "Planifikim menaxhim administrimin" 01110 kodi i produktit 91101AE në vlerën 500,000 lekë. Shkresa nr. 6914/1 prot, datë20.04.2022 rezulton në shtim të buxhetit të DRAP Durrës në programin 01110, llogaria 600 në vlerën 238,404 lekë. Shkresa nr. 8489/1 datë 30.12.2022 rezulton në shtim të buxhetit të DRAP Durrës në programin 01110, llogaria 606 në vlerë 170,000 lekë.

Fondet, edhe pse janë transferuar në fillim të vitit për DRAP Durrës, përgjatë vitit ato rezultojnë të transferohen në ZVAP-et nën juridiksionin e DRAP Durrës.

Viti 2023

MAS me shkresën nr.8507/3, prot, datë 26.01.2023 ka dërguar në DRAP Durrës shpërndarja e shpenzimeve korrente për vitin 2023, në vlerën totale prej 36,592 mijë lekë

Nga vendosja në dispozicion e ndryshimeve që ka pësuar buxheti i vitit 2023 për DRAP Durrës rezulton se janë kryer ndryshimet si mëposhtëm:

Shkresa nr. 12821/1 prot, datë 12.07.2023 rezulton në shtim të buxhetit të DRAP Durrës në llogarinë 600, në vlerën 559 mijë lekë. Shkresa nr. 12821/1 prot, datë 12.07.2023 rezulton në pakësim të buxhetit të DRAP në llogarinë 600, në vlerën 335 mijë lekë. Shkresa nr. 12821/1 prot, datë 12.07.2023 rezulton në shtim të buxhetit të DRAP Durrës në llogarinë ekonomike 600, në vlerën 224 mijë lekë. Shkresa nr. 4356/5 prot, datë 04.08.2023 rezulton në pakësim të buxhetit të në llogarinë 602, në vlerën 1,254 mijë lekë. Shkresa nr. 4356/5 prot, datë 04.08.2023 rezulton në shtim të buxhetit në llogarinë 605 në vlerën 1,254 mijë lekë. Shkresa nr. 7456 prot, datë 01.12.2023 rezulton në shtim të buxhetit, në llogarinë ekonomike 600, në vlerën 250 mijë lekë. Shkresa nr. 7167/1 prot, datë 01.12.2023 rezulton në shtim të buxhetit, në llogarinë ekonomike 602, për programin arsim i mesëm në vlerën 279 mijë lekë.

Viti 2024

MAS me me shkresën nr.806/1 06.02.2024, prot, datë 06.02.2024 ka dërguar pranë DRAP Durrës shpërndarja e shpenzimeve korrente për vitin 2024, duke bërë alokimin e fondeve të buxhetit për këtë institucion në një total prej 46,327 mijë lekë

Nga vendosja në dispozicion e ndryshimeve që ka pësuar buxheti i vitit 2024 për DRAP Durrës rezulton se janë kryer ndryshimet si mëposhtëm:

Me shkresën nr. 816/2, prot, datë 23.02.2024 DRAP Durrës i janë shtuar 10,750 mijë lekë në programin 09120, projekti "Krijim fondi bibliotekash për shkollat e arsimit baze" dhe programin 09230 për projektin "Krijim fondi bibliotekash për shkollat e arsimit të mesëm". Me shkresën nr. 1689/1, datë 18.03.2024 i janë shtuar fondet në shumën 30,000 mijë lekë në programin 01110, produktin 91101AE. Me shkresën nr. 3078/1, datë 20.05.2024 i janë pakësuar fondet në shumën 1,000 mijë lekë në programin 09230, produktin 91104 AC. Me shkresën nr. 2720/1 prot, datë 20.05.2024 i janë pakësuar fondet në shumën 4,788 mijë lekë në programin 09120, produktin 91103 AB *"Nxënës përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar".* Me shkresën nr. 4442 prot, datë 11.07.2024 i janë pakësuar fondet në shumën 2,330 mijë lekë në programin 01110, produktin 991101AE, në vlerën 25 mijë lekë, në programin 09120, produktin 91103AB, në vlerën

2,121 mijë lekë, në programin 09230, produktin 91104AA, në vlerën 184 mijë lekë. Me shkresën nr. 10463/1 prot, datë 31.07.2024 i janë shtuar fondet në shumën 336 mijë lekë në programin 01110, produktin 91101AE, në vlerën 336 mijë lekë. Me shkresën nr. 5600/1, datë 14.11.2024 i janë shtuar fondet në shumën 1,020 mijë lekë në programin 01110, produktin 91101AE, në vlerën 1,020 mijë lekë.

Për periudhën objekt auditimi, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion të gjitha shkresat e ndryshimeve buxhetore, pasi Ministria nuk njofton DRAP për të gjitha ndryshimet që pëson buxheti, por njoftohet në momentin kur rakordojnë me thesarin.

Për periudhën objekt auditimi nga DRAP Durrës janë kryer rishikimet si vijon: në vitin 2022 janë kryer 3 rishikime buxhetore, për vitin 2023 janë kryer 4 rishikime buxhetore dhe për vitin 2024, janë kryer 7 rishikime buxhetore, të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së DRAP Durrës. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e Drap Durrës për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mos planifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 ku citohet … "*Çdo kërkesë për fonde shtesë ose rishpërndarje fondesh shoqërohet me analizë ku identifikohet arsyeja, rezultatet e pritshme, kontributi në arritjen e qëllimit dhe objektivave dhe risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat."* Dhe pika 75. "*Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit".*

Realizimi i planit të buxhetit

Viti 2022

Konstatohet se buxheti i alokuar në DRAP Durrës ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga faza e PBA-së, në buxhetin e miratuar vjetor. Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 92% kundrejt planit të rishikuar.

Fondet e alokuara në programin Planifikim Menaxhimi për vitin 2022		
Paga	**600**	10,201,502
Sigurime	**601**	1,637,206
Shpenz operative	**602**	415,136
Trans.Per Buxh.Fam.& Individ	**606**	460,758
TOTALI		**12,714,602**

Realizimi faktik në programin Planifikim Menaxhimi për vitin 2022

ARTIKULLI	**Përshkrimi**	**Fakti 12-mujori pare 2022**
600	Paga Personeli	9,108,627
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,569,396
602	Mallra dhe shërbime te tjera	436,045
602	Subvencione	13,882
606	Transferta për buxhet familjare dhe individët	537,382
Shpenzime korrente		**11,665,332**

Konstatohet se DRAP Durrës ka raportuar në raportin e monitorimit 12-mujor të vitit 2022 që llogaria 602 ka pasur plan buxhet në vlerën 415,136 lekë ndërsa realizimi faktik në vlerën 449,927 lekë, pra realizimi më të lartë se plani. Gjithashtu për llogarinë 606, në tabelën e raportimit për fondet e alokuara paraqiten në vlerën 460,758 lekë dhe fakti në vlerën 537,382 lekë, pra realizimi më i lartë së plani, duke sjellë një raportim jo të saktë.

DRAP Durrës rezulton se nuk ka përgatitur anekset e monitorimit mbi realizimin e shpenzimeve, në raport produkti, programi dhe llogarie duke mos mundësuar një pasqyrë të plotë të realizimit dhe mosrealizimit të secilit produkt për analizim të realizueshmërisë dhe evidentimit të produkteve që nuk janë realizuar për vitin 2022, në kundërshtim me udhëzimin nr. 14, "Për procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" pika 49.
Grupit të auditimit nuk iu vendos në dispozicion rakordimi me thesarin dhe shpenzimet analitike për vitin 2022 duke sjellë mungesë analizim të dhënash dhe pasiguri në raportim.
Viti 2023
Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 78% kundrejt planit të rishikuar.
Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

			Viti 2023						
Programi			600	601	602	605	606	231	Totali
			Paga	Sigurime Shoqërore	Mallra dhe shërbime	Transferta me Jasht ë	Transferta Buxhetore	Investime	
1110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[7]	14,604	2,565	1,600		20		**18,789**
		Realizuar	14,537	2,428	1,284		20		**18,269**
		Realizimi %	**99.5%**	**95%**	**80%**		**100%**		**97%**
9120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[8]			5,414	1,254		3,703	**10,371**
		Realizuar			279	1,244		3,685	**5,208**
		Realizimi %			**5%**	**99%**	**0%**	**99.5%**	**50%**
9230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[9]			2,854			0	**2,854**
		Realizuar			1,597			0	**1,597**
		Realizimi %			**56%**			**0%**	**56%**
TOTALI		Planifikuar	**14,604**	**2,565**	**9,868**	**1,254**	**20**	**3,703**	**32,014**
		Realizuar	**14,537**	**2,428**	**3,160**	**1,244**	**20**	**3,685**	**25,074**
		Realizimi %	**99.5%**	**95%**	**32%**	**99%**	**100%**	**99.5%**	**78%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2023, realizimi i shpenzimeve në programin 01110 ka qenë 97%.
Produkti 91101AE "*Veprimtari e MAS sipas kërkesave ligjore*", për llogarinë 600 është realizuar në masën 99.5%, për llogarinë 601 është realizuar në masën 95%, për llogarinë 602 është realizuar në masën 80%.
Realizimi i shpenzimeve për programin 09120 "Arsimi Bazë", për vitin 2023 ka qenë 50%, krahasuar me planin e rishikuar. Projekti "*Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë"* është realizuar në masën 99.5%, 3,703 mijë lekë nga 3,685 mijë lekë të planifikuara, *"Shpenzime Gjyqësore"* është realizuar në masën 5%, "*Shpenzime për transferta jashtë vendit"* është realizuar në masën 99%.
Realizimi i shpenzimeve për programin 09230 "*Arsimi i Mesëm*", për vitin 2023 ka qenë 56%, krahasuar me planin e rishikuar. *"Shpenzime për udhëtim i brendshëm"* është realizuar në masën 56%.
Nëse i referohemi realizimit të shpenzimeve 602 ato konstatohen si më poshtë:
Për programin "Planifikim, menaxhim, administrim", shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 1,284,061 lekë, të cilat janë përdorur si më poshtë: Shpenzime për kancelari në vlerë 165,600 lekë; Shpenzime për material për pastrim dezinfektim ngrohje dhe ndriçim në vlerë 150,000 lekë; Shpenzime për shërbime telefonike në vlerë 37,920 lekë.; Shpenzime për shërbime të tjera në vlerë 32,005 lekë; Shpenzime për karburant dhe vaj në vlerë 435,730 lekë; Shpenzime për udhëtim i brendshëm në vlerë 462,806 lekë.

Për programin "Arsimi bazë" (09120) shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 278,890 lekë, të cilat janë përdorur si më poshtë: Shpenzime për vendim e gjyqësore në shumën 278,890 lekë.
Në llogarinë 605 janë kryer shpenzime për Të tjera transferime korrente jashtë shtetit në shumën 1,243,813 lekë Në llogarinë 606 nuk janë kryer shpenzime
Në llogarinë 231 janë kryer shpenzime për krijim fondi bibliotekë në vlerën 3,685,232 lekë
Për programin "Arsimi i Mesëm" (09230)shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 1,596,600 lekë, të cilat janë përdorur si më poshtë: Shpenzime udhëtim i brendshëm në shumën 1,596,600 lekë
Në llogarinë 606 nuk janë kryer shpenzime.
Rezulton se DRAP Durrës ka akumuluar detyrime të prapambetura për vitin 2023 duke iu referuar kërkesës për transferim fondi nr. 12651/1 prot, datë 18.07.2023, me qëllim kryerjen e pagesës së tarifës regjistrimit të pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësuesve të shkollës Koreografike dhe korit të liceut Artistik Tiranë në festivalin ndërkombëtar të rinjve në Berceto Parma Itali nga data 10-20 Korrik 2023.
DRAP Durrës me urdhër shpenzimin nr. 111, datë 26.10.2023, ka paguar faturën e shoqërisë "O.", në vlerën 11,400 Euro, për tarifën e regjistrimit të pjesëmarrjes së 114 nxënësve dhe mësuesve të shkollës Koreografike dhe korit të Liceut Artistik Tiranë në Festivalin Ndërkombëtar të të Rinjve "Vivas Ẇorld", Itali. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se Shkolla Koreografike me shkresën nr. 494, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit mbulimin me fonde të tarifës së regjistrimit. Sekretari i MAS, me shkresën nr. 4356/2, datë 07.07.2023, i ka kërkuar DRAP Durrës të marrë masat e nevojshme për mbështetjen financiare të tarifës së regjistrimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 1265/1, datë 18.07.2023, ka miratuar transferimin e fondeve në vlerën 1,250,000, për DRAP Durrës. Konstatohet se ftesa zyrtare e organizimit të aktivitetit, e cila përcakton se zhvillimi i festivalit do të jetë në datat 08-22 Korrik 2023, është dërguar po më datë 08.07.2023, pra në të njëjtën datë me datën e fillimit të aktivitetit. Për rrjedhojë kërkesa për financim, përcaktimi i pjesëmarrësve dhe korrespodenca institucionale për mbulimin e shpenzimeve janë kryer përpara administrimit të ftesës zyrtare. Gjithashtu, në dokumentacion konstatohet mosrakordim lidhur me periudhën e zhvillimit të aktivitetit, pasi në shkresat e administruara referohen data të ndryshme *(08-22 korrik 2023, 08-20 korrik 2023 dhe 10-20 korrik 2023).*
Shoqëria "O." ka lëshuar faturën me datë 21.07.2023, në vlerën 11,400 Euro (114 persona* 100 Euro), me përshkrimin "Tarifa e regjistrimit të pjesëmarrësve në Festivalin Ndërkombëtar "Vivas Ẇorld", 08-20 korrik 2023". Po në datën 21.07.2023, Presidenti i Përkohshëm i Shoqatës, ka lëshuar deklaratë në të cilën konfirmon marrjen e shumës 11,400 Euro, si kontribut për pritjen e delegacionit të nxënësve dhe mësuesve të Liceut Artistik Tiranë. Ndërkohë, drejtori i DRAP Durrës ka nxjerrë urdhrin nr. 131, datë 24.10.2023, për pagesën e kësaj fature. Konfirmimi i marrjes së shumës nga organizatori i aktivitetit në datën 21.07.2023, pra rreth tre muaj përpara nxjerrjes së urdhrit të pagesës dhe kryerjes së likuidimit nga DRAP Durrës, krijon paqartësi mbi dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e transaksionit financiar.
Për sa më sipër , dokumentacioni i administruar nuk siguron një gjurmë auditimi të plotë, të qartë dhe të besueshme mbi ligjshmërinë e angazhimit dhe likuidimit të pagesës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar.

Viti 2024

Niveli i realizimit të buxhetit të vitit 2024 për tre programet paraqitet në masën 76% kundrejt planit të rishikuar. Nëse i referohemi planit fillestar, realizimi i shpenzimeve për DRAP Durrës rezulton rreth 62% kundrejt PBA 2024-2026 dhe planit të rishikuar.

Në mijë lekë

Viti 2024								
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	231 Investime	Totali
1110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[7]	18,870	3,165	2,875	60		**24,970**
		Realizuar	18,827	3,152	1,597	60		**23,636**
		Realizimi %	**99.80%**	**99.60%**	**55.54%**	**100%**		**95%**
9120	Arsimi Bazë	Planifikuar[8]			6,181		6,450	**12,631**
		Realizuar			2,508		6,450	**8,958**
		Realizimi %			**40.58%**		**100%**	**71%**
9230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[9]			8,474		4,300	**12,774**
		Realizuar			2,700		3,163	**5,863**
		Realizimi %			**32%**		**74%**	**46%**
TOTALI		Planifikuar	**18,870**	**3,165**	**17,530**	**60**	**10,750**	**50,375**
		Realizuar	**18,827**	**3,152**	**6,805**	**60**	**9,613**	**38,457**
		Realizimi %	**99.8%**	**99.6%**	**39%**	**100%**	**89%**	**76%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2024, realizimi i shpenzimeve në programin 01110 "*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*" ka qenë 95%, krahasuar me planin. Produkti 91101AE "*Veprimtari e MAS sipas kërkesave ligjore*", për llogarinë 600, pagat e punonjësve është realizuar në masën 99.8%, llogarinë 601, sigurime shoqërore është realizuar në masën 99.6%, për llogarinë 602, mallra dhe shërbime është realizuar në masën 55.54%,.

Realizimi i shpenzimeve për programin 09120 "Arsimi Bazë", ka qenë 71%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 65% me planin fillestar. Produkti 91103AB "*Nxënës Përfitues të shërbimit arsimor në sistemin 9 vjeçar*" rezulton i pa realizuar. Produkti 91103AE "*Mësues të arsimit bazë të trajnuar për kurrikulën e re*" është realizuar në masën 40.58%, 2,508 mijë lekë nga 6,181 mijë lekë të planifikuara. Buxheti i këtij produkti ka pësuar ndryshime gjatë vitit.

Projekti"*Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë"* është realizuar në masën 100%.

Realizimi i shpenzimeve për programin 09230 "Arsimi i Mesëm", për vitin 2024 ka qenë 46%, krahasuar me planin e rishikuar dhe 42% me planin fillestar. Produkti 91104AA "*Nxënës që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm e të lartë në institucionet arsimore publike*" rezulton i pa realizuar. Produkti 91104AC "*Mësues të AML të trajnuar kurrikulën kl 10, 11, 12"* është realizuar në masën 32%. Projekti "*Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit të mesëm"* është realizuar në masën 74%.

Nëse i referohemi realizimit të shpenzimeve 602 ato konstatohen si më poshtë:

- Për programin 01110 shpenzimet totale për mallra dhe shërbime paraqiten në vlerën 1,597,307 lekë, të cilat janë përdorur si më poshtë: Shpenzime për kancelari në vlerë 114,900 lekë; Shpenzime për shërbime telefonike në vlerë 20,855 lekë; Shpenzime për karburant dhe vaj në vlerë 443,562 lekë; Shpenzimet e siguracionit të mjeteve të transportit në vlerë 95,500 lekë; Shpenzime për udhëtim i brendshëm në vlerë 922,400 lekë.

Në llogarinë 606 janë kryer shpenzime për ndihmë për fatkeqësi në familje në vlerën 30,000 lekë, dhe shpenzime për shpërblim i menjëhershëm në vlerën 30,000 mijë lekë.

- Për programin 09120 shpenzimet totale për mallra dhe shërbime në llogarinë 602 paraqiten në vlerën 2,507,500 lekë, të cilat janë përdorur: Shpenzime për libra dhe publikime profesionale në

shumën 1,121,921 lekë; Shpenzime të tjera material dhe shërbime speciale në shumën 1,385,579 lekë.
Në llogarinë 606 nuk janë kryer shpenzime
Në llogarinë 231 janë kryer shpenzime për krijim fondi bibliotekë në vlerën 6,450,000 lekë
Për programin 09230shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 2,700,000 lekë, të cilat janë përdorur: Shpenzime udhëtim i brendshëm në shumën 2,598,000 lekë; Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrave në shumën 102,000 lekë.
Në llogarinë 606 nuk janë kryer shpenzime.
Në llogarinë 231 janë kryer shpenzime për krijim fondi bibliotekë në vlerën 3,163,487 lekë.
Nga sa më sipër mungesa e një strukture të unifikuar në listimin e produkteve sipas objektivave vështirëson krahasueshmërinë ndërmjet periudhave dhe njësive të ndryshme, duke ndikuar negativisht në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të performancës.
Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i ndryshuar dhe realizuar për vitin 2022,2023 dhe 2024 sipas 3 programeve për DRAP Durrës, paraqitet si më poshtë:

Buxheti i ndryshuar dhe i realizuar *Në mijë lekë*

Programi		Viti					
		2022		2023		2024	
		Planifikuar[4]	Realizuar	Planifikuar[5]	Realizuar[6]	Planifikuar[5]	Realizuar[6]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	0	0	18,789	18,269	24,970	23,636
II	Arsimi Bazë	0	0	10,370	5,208	12,631	8,958
III	Arsimi i Mesëm	0	0	2,854	1,597	12,774	5,863
Total		**0**	**0**	**32,012**	**25,073**	**50,375**	**38,457**

Burimi:DRAP Durrës, Punoi KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raporti i Monitorimit i 4 mujorit të parë i vitit 2022 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et është përcjellë me shkresë përcjellëse nr. 1399/1 datë 30.05.2022 në MAS brenda afatit ligjor në përputhje me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" dhe rezulton kryesisht në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit.
Raportet e konsoliduara të monitorimit të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-e, konkretisht i 8 mujorit të vitit 2022, 4 mujorit të viteve 2023, 2024, 8 mujorit të vitit 2023, 2024 dhe 12 mujorit 2023, 2024 nuk janë përcjellë me shkresë përcjellëse në MAS si dhe nuk janë hartuar pasqyrat e krahasimit të realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit në nivel të plotë bashkë me ZVAP në juridiksion
Raporti i Monitorimit i 12 mujorit të vitit 2022 i konsoliduar për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-e është përcjellë me shkresën nr. 224/3 prot, datë 23.02.2023 në MAS brenda afatit ligjor.
Raporti i monitorimit të 4 mujorit të parë të vitit 2022 për DRAP Durrës, është përcjellë me shkresë përcjellëse nr. 1399/1 datë 30.05.2022 në MAS brenda afatit ligjor duke qene në përputhje me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" dhe rezulton kryesisht në përputhje me formatin standard të monitorimit të buxhetit.
Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të parë i vitit 2022 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresë përcjellëse nr. 224/3 datë 20.09.2022 në MAS brenda afatit ligjor.
Raporti i Monitorimit i 12 mujorit të vitit 2022 për DRAP Durrës nuk është përcjellë me shkresë përcjellëse në MAS dhe nuk janë hartuar pasqyrat e krahasimit të realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit.

Raporti i monitorimit të 4 mujorit të parë të vitit 2023 për institucionin e DRAP Durrës, është përcjellë me shkresë përcjellëse nr. 1198/1 datë 30.05.2023 brenda afatit ligjor.
Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të vitit 2023 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresën nr.1944 prot, datë 29.09.2023 në MAS Brenda afatit ligjor me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore."* Nga auditimi rezulton se subjekti DRAP Durrës nuk ka hartuar relacionin shpjegues të raport monitorimit për monitorimin e katër mujorin e dytë te vitit 2023.
Raporti i Monitorimit i 12 mujorit të vitit 2023 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresën nr. 706/1 prot, datë 27.02.2024 brenda afatit ligjor në MAS.
Raporti i monitorimit të 4 mujorit vitit 2024 për institucionin e DRAP Durrës, është përcjellë me shkresën nr. 1377 prot, datë 10.06.2024 në MAS jashtë afatit ligjor duke qenë në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" konkretisht me pikë 33 "Procedura për përgatitjen e raporteve katër mujorë të monitorimit" e cila përcakton se *"Raportet e katër mujorit dhe tetë mujorit duhet të dorëzohen tek njësia përgjegjëse për monitorimin. në Ministrinë përgjegjëse për Financat deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit të parë dhe tetë mujorit, përkatësisht deri në 30 Maj; dhe deri në 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm*".
Raporti i Monitorimit i 8 mujorit të vitit 2024 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresën nr.2302 prot, datë 03.10.2024 në MAS jashtë afatit ligjor duke qene në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" konkretisht me pikë 33 "Procedura për përgatitjen e raporteve katërmujore të monitorimit" e cila përcakton se "Raportet e katër mujorit dhe tetë mujorit duhet të dorëzohen tek njësia përgjegjëse për monitorimin. në Ministrinë përgjegjëse për Financat deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katër mujorit të parë dhe tetë mujorit, përkatësisht deri në 30 Maj; dhe deri në 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm
Raporti i Monitorimit i 12 mujorit të vitit 2024 për DRAP Durrës është përcjellë me shkresën nr. 415/1 prot, datë 12.02.2025 brenda afatit ligjor në MAS.
Nga auditimi rezulton se raporti i monitorimit nuk është hartuar në përputhje me pikën 49 të udhëzimit nr. 14 të Ministrisë së Financave "*Për procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"*, ku përcakton se Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet qendrore duhet të përmbajë: a)Informacionin sipas formatit standard narrativ të raportit të monitorimit të buxhetit të përcaktuar në shtojcën 3, të këtij udhëzimi".
Relacioni shpjegues i raportit të monitorimit është i firmosur vetëm nga nëpunësi Autorizues pa u nënshkruar nga hartuesi dhe strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe verifikimin e tij, në kundërshtim me nenin 16 dhe nenin 19 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 i ndryshuar.
Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 "Raporti i monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni" Në faqen zyrtare të DRAP Durrës nuk janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024 dhe 2025.
Për vitin 2022,2023 dhe 2024 DRAP Durrës nuk ka gjeneruar të ardhura dytësore.

2.1.3 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë

Programi Buxhetor Afatmesëm

ZVAP Tiranë ka hartuar PBA-në vetëm në një fazë duke mos respektuar procedurat e hartimit ne dy faza, në kundërshtim me udhëzimin nr.7 datë 28.02.2008, pika 3 "Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" i cili përcakton se "*Programi buxhetor afatmesëm behet në dy faza*".

PBA 2022-2024 i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit vetëm në format elektronik, çka ka sjellë pamundësi për të verifikuar nëse është përcjellë, brenda afatit ligjor në MAS dhe DRAP Durrës. PBA nuk ka të bashkëlidhur përmbledhësen e kërkesave buxhetore sipas programeve dhe artikujve përbërës për planifikimin e vitit 2022.

PBA 2023-2025 është dërguar me shkresën nr. 2989, datë 28.08.2022 brenda afatit ligjor.

PBA 2024-2026 është dërguar me shkresën nr. 4401/1, datë 10.08.2023 brenda afatit ligjor.

PBA 2025-2027 është dërguar me shkresën nr. 5521/2, datë 09.08.2024 brenda afatit ligjor.

Nga auditimi konstatohet se PBA 2022-2024, 2023-2025, 2024- 2026, 2025-2027 paraqiten me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", Kapitullin I, pika 8 e tij, pasi nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat. Konstatohet se PBA kanë bashkëlidhur përmbledhësen e kërkesave buxhetore sipas programeve dhe artikujve përbërës.

Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA 2022-2024, PBA 2024-2026 dhe PBA 2025-2027 rezultoi se ZVAP Tiranë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë, në kundërshtim me udhëzimin nr.7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.

Nga auditimi i PBA 2022-2024, PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027, u konstatua se në institucionin ZVAP Tiranë nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj*.

Rezulton se institucioni ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MAS duke mos dokumentuar propozimin e tij fillimisht pranë DRAP; përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit apo komente të tjera; deri në përgatitjen finale të tij pranë MAS, jo në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika a e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe propozimin DPAP-së*", dhe neni 34, pika a "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", e cila përcakton se "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it".*

Planifikimi për shpenzimet Korrente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve, ku për vitin 2023 janë planifikuar në vlerë 4,733,165 mijë lekë, për 2024 në vlerë 5,616,522 mijë lekë, për vitin 2025

në vlerën 7,010,264 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 është mbështetur në ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ku për vitin 2023 në vlerë 762,635 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 918,834 mijë lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 1,094,198 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, ku për vitin 2023 në vlerën 36,702 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 441,337 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 84,602 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" për vitin 2023 në vlerë 209,227 mijë lekë, ku për vitin 2024 në vlerën 257,782 mijë lekë dhe për vitin 2025 në vlerën 268,070 mijë lekë.
Planifikimi i shpenzimeve për "*Subvencionet*" nën artikullin 603 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve te drejtorisë për subvencionimin e nxënësve te nivelit bazë ne vlerën 13,800 mijë lekë, për vitin 2025.
Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.
Viti 2023
Për ZVAP Tiranë janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 5,143,118 mijë lekë, si më poshtë:
Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 35,532 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 3,628,376 mijë lekë; dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 1,479,210 mijë lekë.
Buxheti fillestar ku përgjatë vitit *është shtuar me 417,383 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 5,560,500 mijë lekë.
Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:
Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 35,532 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim dhe pakësim të shpenzimeve për paga dhe sigurime. Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 941 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 36,473 mijë lekë.
Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 3,628,376 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 . Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 342,509 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 3,970,885 mijë lekë.
Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 1,479,210 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 në produktet 91104AE dhe 91104AG Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 73,9320 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,553,142 mijë lekë.

Viti 2024

Për ZVAP Tiranë janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 5,530,998 mijë lekë, si më poshtë: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 45,921 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 3,892,684 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 1,592,393 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 998,758 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 6,529,756 mijë lekë.

Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:

Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 45,921 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim dhe pakësim të shpenzimeve për paga dhe sigurime. Si rezultat plani i rishikuar është *pakësuar me 4,347 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 41,575 mijë lekë.

Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 3,892,684 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 . Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 967,124 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 4,859,808 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 1,592,393 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 në produktet 91104AE dhe 91104AG Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 35,981 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,628,373 mijë lekë.

Viti 2025

Për ZVAP Tiranë janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 7,125,876 mijë lekë, si më poshtë: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 35,803 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 5,022,244 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 2,067,829 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 197,012 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 7,322,888 mijë lekë.

Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:

Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 35,803 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim dhe pakësim të shpenzimeve për paga dhe sigurime. Si rezultat plani i rishikuar është *pakësuar me 4.906 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 30,898 mijë lekë.

Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 5,022,244 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 . Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 731,921 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 5,754,165 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 2,067,829 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtim të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesë fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 në produktet 91104AE dhe 91104AG Si rezultat plani i rishikuar është *shtuar me 530,004 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,537,825 mijë lekë.

Rishpërndarja e fondeve

Nga informacioni i marrë nga Thesari rezulton se për periudhën objekt auditimi nga ZVAP Tiranë janë kryer rishikimet si vijon: në vitin 2022 janë kryer 24 rishikime buxhetore, për vitin 2023 janë kryer 31 rishikime buxhetore, për vitin 2024, janë kryer 21 rishikime buxhetore, dhe për vitin 2025, janë kryer 18 rishikime buxhetore të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së ZVAP Tiranë. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e ZVAP Tiranë për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mos planifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 dhe 75.

Gjatë periudhës objekt auditimi rezulton se në disa raste Ministria e Arsimit nuk ka informuar me shkresë zyrtare ZVAP në lidhje me ndryshimet që ka pësuar buxheti, por ndryshimet janë bërë me dije për institucionin në momentin e rakordimit me degën e thesarit.

Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2022

Për vitin 2022 grupit të auditimit i është vendosur në dispozicion vetëm PBA-ja dhe asnjë dokumentacion tjetër. Në mungesë informacioni të vënë në dispozicion grupi i auditimit nuk mund të auditoj realizimin e buxhetit te institucionit ZVAP Tiranë për vitin 2022.

Viti 2023

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Tiranë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2023 sipas PBA 2023-2025	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	33.894	35,532	36,473	35,584
Arsimi Bazë	4,211,117	3,628,376	3,970,885	3,970,693
Arsimi i Mesëm	1,496,719	1,479,210	1,553,142	1,517,609
Total	**5,741,730**	**5,143,118**	**5,560,500**	**5,523,886**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.3 % kundrejt planit te rishikuar dhe 96.2% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **5,560,500 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **5,523,886 mijë lekë**.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2023							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	30,056	5,267	1,110	50	**36,473**
		Realizuar	30,056	4,498	980	50	**35,584**
		Realizimi %	**100%**	**85%**	**88%**	**100%**	**97.5%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	3,105,397	572,676	43,584	249,228	**3,970,885**
		Realizuar	3,105,397	572,676	43,579	249,041	**3,970,693**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99.9%**	**99.9%**	**99.9%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	1,323,350	217,469	6,866	5,457	**1,553,142**
		Realizuar	1,323,350	182,146	6,826	5,287	**1,517,609**
		Realizimi %	**100%**	**83.7%**	**99.4%**	**96.8%**	**97.7%**
TOTALI		Planifikuar	4,458,803	795,412	57,365	254,735	**5,560,500**
		Realizuar	4,458,803	589,320	51,385	254,378	**5,523,886**
		Realizimi	**100%**	**74%**	**89,5%**	**99.8%**	**99,3%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100 dhe 85%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 88% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100 dhe 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.9% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.9%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100 dhe 83.7%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.4% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 96.8%.

Nga konstatimi i grupit të auditimit rezulton se ZVAP Tiranë ka likuiduar sigurimet e prapambetura të vitit 2014 (për diferencën e pa likuiduar nga sistemimet).

Grupit të auditimit nuk i janë vendosur ne dispozicion shpenzimet analitike të faktit për vitin 2023.

Realizimi i planit të buxhetit, 2024

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Tiranë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2024 sipas PBA 2024-2026	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	45,810	45,921	41,575	39,133
Arsimi Bazë	4,938,288	3,892,684	4,859,808	4,848,624
Arsimi i Mesëm	1,850,377	1,592,393	1,628,373	1,589,455
Total	**6,834,474**	**5,530,998**	**6,529,756**	**6,477,212**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99 % kundrejt planit te rishikuar dhe 95% kundrejt planit fillestar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **6,529,756 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **6,477,212 mijë lekë**.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2024							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe Shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	34,553	5,557	1,400	65	**41,575**
		Realizuar	32,599	5,074	1,396	65	**39,133**
		Realizimi %	**94%**	**91%**	**99.7%**	**100%**	**94%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	3,897,262	649,588	50,247	262,711	**4,859,808**
		Realizuar	3,897,262	638,662	50,236	262,463	**4,848,624**
		Realizimi %	**100%**	**98%**	**99.9%**	**99.9%**	**99.7%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	1,350,601	258,424	6,858	12,490	**1,628,373**
		Realizuar	1,329,593	240,518	6,858	12,486	**1,589,455**
		Realizimi %	**98%**	**93%**	**100%**	**99.9%**	**98%**
TOTALI		Planifikuar	5,282,416	913,569	58,505	275,266	**6,529,756**
		Realizuar	5,259,454	884,254	58,490	275,014	**6,477,212**
		Realizimi	**99%**	**97%**	**99.9%**	**99.9%**	**99%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me programin 01110 "*Planifikim, Menaxhim, Administrim*": Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën 41,575 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 39,133 mijë lekë (94% realizimi)

Lidhur me programin 09120 "*Arsimi Bazë*": Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën 4,859,808 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 4,848,624 mijë lekë (99.7% realizimi).

Lidhur me programin 09230 "*Arsimi i Mesëm*": Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program është bërë për shumën 1,628,373 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 1,589,455 mijë lekë (98% realizimi). Për këtë program konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 98 dhe 93%.

Për programin "*Planifikim, menaxhim, administrim*"(01110), shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 1,396 mijë lekë, janë përdorur si më vijim: shpenzime për Dieta BKT në vlerë 528 mijë lekë; shpenzime për blerje vule në vlerë 2 mijë lekë; shpenzime për Energji Loro Borici në vlerë 119 mijë lekë; shpenzime për mirëmbajtje faqe interneti në vlerë 60 mijë lekë; shpenzime për kancelari në vlerë 456 mijë lekë; shpenzime për shërbim postar në vlerë 139 mijë lekë; shpenzime për taksa vjetore në vlerë 15 mijë lekë; shpenzime për ujësjellës Loro Borici në vlerë 76 mijë lekë.

Për programin *"Arsimi bazë"* (09120) shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 50,236 mijë lekë, të cilat janë përdorur: shpenzime transporti mësuesish dhe nxënësish në shumën 49,493 mijë lekë; shpenzime Gjyqësore në shumën 743 mijë lekë

Në llogarinë 606 janë kryer shpenzime për shpërblim dalje në pension dhe shpërblim individëve në shumën 6,865 mijë lekë, shpenzime për tatim në burim në vlerë 642 mijë lekë dhe shpenzime për subvencion libri në vlerë 254,956 mijë lekë.

Për programin *"Arsimi i Mesëm"* (09230) shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 6,858 mijë lekë, të cilat janë përdorur: Shpenzime transporti mësuesish dhe nxënësish në shumën 6,594 mijë lekë; Shpenzime për dieta në shumën 149 mijë lekë; Shpenzime për vendime Gjyqësore në shumën 115 mijë lekë.

Në llogarinë 606 janë kryer shpenzime për shpërblime fatkeqësie dhe dalje në pension në shumën 3,279 mijë lekë, subvencione libri në shumën 8,625 mijë lekë dhe shpenzime tatim në burim në shumën 582 mijë lekë.

ZVAP Tiranë me buxhetin e viti 2024 ka likuiduar detyrime të viteve të mëparshme konkretisht faturat e Energjisë dhe Ujësjellësit për shkollën "Loro Borici", në vlerën 119,370 lekë dhe 76,456 lekë.

Realizimi i planit të buxhetit, 2025

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Tiranë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2025 sipas PBA 2025-2027	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	48,528	35,803	30,898	30,826
Arsimi Bazë	6,259,524	5,022,244	5,754,165	5,751,188
Arsimi i Mesëm	2,163,383	2,067,829	1,537,825	1,537,031
Total	**8,471,434**	**7,125,876**	**7,322,888**	**7,319,045**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.9 % kundrejt planit te rishikuar dhe 86% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **7,322,888 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **7,319,045 mijë lekë**. Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit.

Në nivel programi, realizimi sipas programit fillestar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2025							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	25,419	4,201	950	328	**30,898**
		Realizuar	25,419	4,201	879	328	**30,826**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**93%**	**100%**	**99.7%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	4,668,202	780,732	65,029	340,201	**5,754,164**
		Realizuar	4,668,202	780,732	62,762	239,491	**5,751,188**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**97%**	**70%**	**99.9%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	1,299,667	218,680	6,982	12,495	**1,537,825**
		Realizuar	1,299,667	218,680	6,412	12,272	**1,537,031**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**92%**	**98%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	5,993,288	1,003,613	72,962	253,024	**7,322,888**
		Realizuar	5,993,288	1,003,613	70,053	252,091	**7,319,045**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**96%**	**99.6%**	**99.9%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Planifikimi i rishikuar i fondeve për programin 01110 është bërë për shumën 30,898 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 330,826 mijë lekë (99.7% realizimi)

Planifikimi i rishikuar i fondeve për programin 09120 është bërë për shumën 5,754,164 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 5,751,188 mijë lekë.

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë program 09230 është bërë për shumën 1,537,825 mijë lekë , nga të cilat janë realizuar 1,537,031 mijë lekë (99.9% realizimi).

Nëse i referohemi realizimit të shpenzimeve 602 sipas produkteve në të cilat ato janë përfshirë, konstatohet si më poshtë:

Për programin 01110, shpenzimet totale për mallra dhe shërbime paraqiten në vlerën 918 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë: Shpenzime kancelarie në vlerë 300 mijë

lekë; Shpenzime për mirëmbajtje interneti në vlerën 60 mijë lekë; Shpenzime për Postën Shqiptare në vlerën 103 mijë lekë; Shpenzime për kontratë qiraje TKOBAP vlerë në 90 mijë lekë; Shpenzime për taksë vjetore Bashkisë në vlerën 15 mijë lekë; Shpenzime për Ujësjellës kanalizimi shkolla "Loro Borici" në vlerën 154 mijë lekë; Shpenzime për FSHU shkolla "Loro Borici" në vlerën 196 mijë lekë

Për programin "Arsimi i Mesëm" (09230) shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 6,412 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë: Për produktin 91104AA janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 1,250 mijë lekë; Shpenzime për vendime gjyqësore M.Th në shumën 1,250 mijë lekë; Për produktin 91104 AB janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 4,766 mijë lekë që përfshijnë; Shpenzime për transportin e mësuesve dhe të nxënësve në vlerë 4,766 mijë lekë; Për produktin 91104 AH janë përfshirë shpenzime totale në vlerë 395 mijë lekë që përfshijnë; Shpenzime për projektin Arte dhe Zeje në vlerën 395 mijë lekë

Për programin "Arsimi bazë" (09120) shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 62,762 mijë lekë, të cilat në nivel produkti janë përdorur si më poshtë: Në produktin 91103AB janë kryer shpenzime totale në shumën 3,771 mijë lekë, që përfshijnë:; Shpenzime për vendim gjyqësor M. RR në shumën 1,541 mijë lekë; Shpenzime për detyrim shkolla Halit Coka në shumën 102 mijë lekë; Shpenzime për detyrim shkolla Ibrahim Braja në shumën 53 mijë lekë; Shpenzime detyrim për komisionerin në shumën 107 mijë lekë; Shpenzime detyrim komisioneri për në shumën 112 mijë lekë; Shpenzime për vendim gjyqësor D.S në shumën 1,856 mijë lekë Në produktin 91103AD janë kryer shpenzime totale në shumën 58,121 mijë lekë, që përfshijnë:Shpenzime për transport mësues nxënës në shumën 58,109 mijë lekë; Shpenzime për dieta në shumën 12 mijë lekë. Në produktin 91103AK janë kryer shpenzime totale në shumën 870 mijë lekë, që përfshijnë: Shpenzime për projektin Arte dhe Zeje në shumën 870 mijë

Nga sa më sipër rezulton se ZVAP Tiranë me buxhetin e viti 2025 ka likuiduar detyrime të viteve të mëparshme konkretisht faturat e Energjisë dhe Ujësjellësin për shkollën "Loro Borici" në vlerat 195,996 lekë dhe 154,258 lekë.

Mbi shpenzimet e kryera për librin shkollor

Nxënësit e arsimit bazë marrin dhe përdorin falas testet shkollore, të cilat bëjnë pjesë në katalogun e teksteve shkollore, sipas legjislacionit përkatës.

Në kreun II, pika 3 të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 21, datë 19.08.2020 *"Për përcaktimin e procedurave të administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas për arsimin parauniversitar",* përcaktohet se: "*Botuesit/distributorët bëjnë furnizimin drejtpërdrejtë në shkollë, sipas porosisë zyrtare të marrë. Furnizimi duhet të përfundojë detyrimisht* ***10 ditë kalendarike para datës së fillimit të vitit shkollor****".*

Sipas urdhrit të përbashkët nr. 156, datë 22.04.2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit "*Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar"*, në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë, mësimi fillon në datë 08.09.2025.

Referuar dispozitave të mësipërme furnizimi i shkollave me libra shkollor duhet të ketë përfunduar më datë 29.08.2025.

Sipas nenit 8, të ligjit nr. 87/2019 *"Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"* i, ndryshuar, fatura duhet të lëshohet në momentin e dorëzimit të mallit. Gjithashtu në pikën 1, neni 99 të ligjit 92/2014 *"Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, përcaktohet se fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit.

Neni 52, i Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e*

Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se nëpunësit zbatues të njësive shpenzues të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomik, **brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorëve ekonomik.**

Në Kreun III, pika 7 të udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 18, datë 01.07.2020 *“Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”,* përcaktohet se Zyra Arsimore e Arsimit Parauniversitar, brenda datës 10 tetor, dërgon në Ministrinë të Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë, kërkesën për fonde buxhetore të detajuar sipas niveleve arsimore/buxhetore, për arsimin bazë, për arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi konstatohet një mospërputhje ndërmjet afateve të përcaktuara për furnizimin, faturimin dhe financimin e teksteve shkollore. Konkretisht, furnizimi i librave dhe lëshimi i faturës, për vitin shkollor 2025-2026, duhet të kryhet deri më 29.08.2025, ndërsa pagesat duhet të realizohen brenda 30 ditëve nga data e faturës.

Në të njëjtën kohë, udhëzimi i përbashkët parashikon që kërkesat për fonde buxhetore të dërgohen nga ZVAP brenda datës 10 tetor, duke krijuar një mospërputhje kohore ndërmjet lindjes së detyrimit financiar dhe sigurimit të fondeve për shlyerjen e tij.

Në përfundim, kjo situatë paraqet risk për mosrespektimin e afateve ligjore të pagesave dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura ndaj operatorëve ekonomikë.

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për pagesat e librave shkollor rezulton se:

- Kontratat e lidhur nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë me botuesit dhe shpërndarësit nuk janë të protokolluara. Kontratat e lidhura me shpërndarës apo persona fizik nuk kanë të bashkëlidhur autorizimin e dhënë nga botuesit apo distributorët, të cilët janë përcaktuar në katalogun e teksteve, viti shkollor 2025-2026 të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me urdhrin nr. 128, datë 27.03.2025 *“Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1,2,3,5,10,11 dhe 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026”.*
- Për periudhën 2022-2025, në 24 raste, për vlerën totale 97,715,944 lekë faturat tatimore janë paguar jashtë afatit 30 ditor, në kundërshtim me nenin 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,* i ndryshuar, përcakton se: “*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzues të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomik, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorëve ekonomik*”.

Tabela: “Fatura tatimore të librit shkollor të paguara jashtë afatit”

Nr.	Subjekti-	Data e faturës	Numri dhe data e urdhër shpenzimeve	Shuma
1	A.SHPK	26.09.2025	313, datë 30.10.2025	2,244,790
2	S.K	29.09.2025	312, datë 07.11.2025	284,682
3	E.P	29.09.2025	309, datë 05.11.2025	2,049,458
4	A.C	27.09.2025	307, datë 29.10.2025	2,279,377
5	N.H	24.09.2025	305, datë 29.10.2025	6,145,566
		26.09.2025	305, datë 29.10.2025	
6	I.	17.09.2025	315, datë 30.10.2025	19,427
7	E.C	28.09.2023	444, datë 12.12.2023	217,397
8	F.C	19.09.2025	303, datë 29.10.2025	1,647,827
		25.09.2025	303, datë 29.10.2025	525,836
		25.09.2025	303, datë 29.10.2025	2,284,2003
9	O.K	21.09.2025 23.09.2025 24.09.2025 25.09.2025	291, datë 27.10.2025	10,779,597
10	N.H	24.09.2025 26.09.2025	305, datë 29.10.2025	6,145,566
11	S.G	27.08.2025 03.09.2025 15.09.2025	293, datë 03.11.2025	2,497,282

		16.09.2025 22.09.2025		
12	S.B	24.09.2025	300, datë 28.10.2025	9,740,075
13	N.B	18.09.2025 21.09.2025 24.09.2025 25.09.2025 26.29.2025	290, datë 27.10.2025	15,310,560
14	S.K	27.09.2024	391, datë 18.11.2024	273,314
15	F.B	27.09.2024	393, datë 13.11.2024	230,273
16	P.M	03.10.2024	392, datë 15.11.2024	1,359,681
17	C.L	28.09.2023	445, datë 12.12.2023	114,946
18	E.P	02.10.2024	397, datë 06.11.2024	2,998,842
19	E.S	20.09.2024	399, datë 12.11.2024	2,954,857
20	I.M	27.09.2024	387, datë 12.11.2024	2,875,174
21	J.Gj	10.10.2022	371, datë 15.11.2022	2,552,230
22	F.B	04.10.2022	374, datë 25.11.2022	183,218
23	D.G	06.10.2022	370, datë 16.11.2022	66,532
24	E.C	01.10.2022	333, datë 07.11.2022	1,377,434
TOTALI				**97,715,944**

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

-Të gjitha faturat tatimore të dorëzuara nga distributorët/shpërndarësit e librit shkollor rezultojnë të pa firmosura nga drejtorët e shkollave në kundërshtim me Kreun II, pika 5 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 21, datë 13.08.2020 "Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollor në përdorimin falas për arsimin parauniversitar", ku citohet se: "*Drejtori i shkollës nënshkruan faturën tatimore të çdo furnizimi të bërë nga botuesi/distributori, sipas sasisë së porositur. Origjinali i faturës, i nënshkruan nga drejtori i shkollës, dorëzohet në njësinë arsimore vendore për likuidim financiar të subjektit furnizues, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e lëshimit të faturës. Drejtori i shkollës ruan fotokopje të çdo fature tatimore".*

Nga sa më sipër, rezulton se shpenzimet në llogarinë **602**, **nuk** janë kryer sipas objektivave të produktin, ku vërehet si më sipër, se për të njëjtat zëra, janë kryer shpenzime në produkte të ndryshme. Kjo, pasi edhe çelja nga MAS është bërë jo gjithmonë për të njëjtat produkte, edhe pse nuk rezulton të ketë pasur ndryshim në objektivat institucional të ZVAP Tiranë për periudhën 2025

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i planifikuar dhe realizuar për ZVAP Tiranë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		Viti							
		2022		2023		2024		2025	
		Planifikuar[11]	Realizuar	Planifikuar[12]	Realizuar[13]	Planifikuar[12]	Realizuar[13]	Planifikuar[12]	Realizuar[13]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	34,093	29,388	36,473	35,585	41,575	39,133	30,898	30,826
II	Arsimi Bazë	3,684,231	3,679,058	3,970,888	3,970,697	4,859,808	4,848,624	5,754,165	5,751,188
III	Arsimi i Mesëm	1,359,583	1,357,192	1,553,141	1,517,648	1,628,373	1,589,455	1,537,825	1,537,031
Total		**5,077,907**	**5,065,639**	**5,560,502**	**5,523,930**	**6,529,756**	**6,477,212**	**7,322,888**	**7,319,045**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raportet e monitorimit të vitit 2022 nuk i janë vendosur në dispozicion grupit të auditimit nga institucioni ZVAP Tiranë.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i ZVAP për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. 2144 prot. datë 12.05.2023 në MAS dhe DRAP Durrës, brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i ZVAP Tiranë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr.4885

prot datë 08.09.2023 brenda afatit ligjor në MAS dhe në DRAP Durrës.
Raporti i Monitorimit vjetor i ZVAP Tiranë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr.595 prot datë 23.01.2024, brenda afatit ligjor, në MAS dhe DRAP Durrës.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i ZVAP për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr.2982 prot datë 20.05.2024 në MAS dhe DRAP Durrës, brenda afatit ligjor.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i ZVAP për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr.6653 prot datë 13.09.2024 brenda afatit ligjor në MAS dhe DRAP Durrës.
Raporti i Monitorimit vjetor i ZVAP për vitin 2024 është përcjellë me shkresën nr.778 prot datë 31.01.2025, brenda afatit ligjor, në MAS.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i ZVAP Tiranë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr.4303 prot datë 20.05.2025 në MAS dhe DRAP Tiranë, brenda afatit ligjor.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i ZVAP Tiranë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr.9125 prot datë 19.09.2025 brenda afatit ligjor në MAS dhe DRAP Tiranë.
Raporti i Monitorimit vjetor i ZVAP Tiranë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr.3356/1 prot datë 27.02.2026, brenda afatit ligjor, në MA dhe DRAP Tiranë.
ZVAP Tiranë nuk ka paraqitur në relacion arsyet dhe shkaqet e mosrealizimit të projekteve që janë planifikuar por nuk janë realizuar deri në fund të vitit. Gjithashtu nuk ka paraqitur në relacion përshkrimin e institucionit dhe plotësimin e një liste për përmbajtjen e raportit të monitorimit në kundërshtim me udhëzimin nr.14 datë 30.05.2023 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"* përkatësisht me shtojcën nr.3 të raport monitorimit pika 1dhe 2 e saj.
Raportet e monitorimit nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në kundërshtim me pikën 51 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore",* ku citohet se: *"Ministritë dhe institucionet publikojnë raportet e monitorimit dhe tabletat e anekseve në faqen zyrtare të ministrisë/institucionit, brenda katër javëve nga mbarimi i periudhës së raportimit. Publikimi i raportit dhe anekseve bëhet në format të lexueshëm nga makinat (.doc, .xlx, etj.)"*
Për vitin 2022,2023,2024 dhe 2025 ZVAP Tiranë nuk ka gjeneruar të ardhur dytësore.

Nga ZVAP Tiranë, konkretisht nga znj. E.M është dërguar observacion nr. 6054/1 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/11 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me vonesat në pagesën e librit shkollor, duam t'ju theksojmë se grupi i auditimit është marrë vetëm me anën e jashtme formale. Procesi i librit shkollor fillon që në muajin Prill-maj ne përzgjedhjen e teksteve nga ana e komisioneve lëndore, vazhdon me fletë-porositë e institucioneve arsimore vendore të cilat ju dërgohen botuesve ku përcaktohet librat që kanë përzgjedhur secila shkollë, dhe sasia përkatëse.
Periudha e furnizimit dhe e likuidimit është proces shumë voluminoz dhe kryerje e rakordimit dhe pagesës në një kohë shumë të shkurtër, pasi siç është konstatuar dhe nga ju, ZVAP Tiranë ka një kohë shumë të kufizuar (1-10 Tetor) për kuadrimin e tabelave të institucioneve arsimore për çdo institucion arsimor të përfituesve të teksteve që subvencionohen nga ana jonë. Vonesa në likuidime nga ana jonë nuk ka pasur asnjë rast pasi ne vonesë quajmë çdo tejkalim afati pas çeljes së buxhetit për subvencionimin e librit në thesar.
Nga ana e ZVAP Tiranë nuk ka asnjë vonesë të tillë, mbi 30 ditë nga data e çeljes së fondeve në thesar. Referuar dhe numrit shumë të madh të urdhër shpenzimeve (34 për vitin 2025), është e pamundur që këto urdhër shpenzime të realizohen brenda 1 dite dhe të bëhet likuidimi i tyre brenda 1 dite.
Referuar shpenzimeve të kryera për librin shkollor sipas kreut II, pika 3 e udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.21 datë 19.08.2020 "Për përcaktimin e procedurave administrative të teksteve shkollore në përdorim falas për arsimin parauniversitar" sqarojmë se botuesit kanë kryer furnizimin e drejtpërdrejtë në të gjitha shkollat sipas porosive të marra dhe kanë kryer rakordime me secilën shkollë nëpërmjet faturave dhe akt-rakordimeve.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë do të marrë masa për kontrolle më të rrepta në shkolla lidhur me respektimin e afateve ligjore dhe nënligjore të përcaktuara për furnizimin.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë me gjithë ngarkesën kolosale të punës kontrollon të gjitha dosjet (140

dosje) për tu siguruar që secila prej tyre (përveç të tjerave) të përfshijë faturat dhe akt-rakordimet me distributorët për sasitë dhe çmimet e artikujve.
Më pas zyrës së financës i duhet të përpilojë tabelën mbi: Numrin e nxënësve dhe shumën e fondeve buxhetore për mbulimin e shpenzimeve të blerjes së teksteve shkollore për klasat (1-9) për arsimin bazë dhe (10-13) për arsimin e mesëm dhe të rakordojë fondin e kërkuar për secilën shkollë më shumën e faturave për secilin distributor (duke njoftuar të paraqiten në ZVAP të gjithë distributorët së bashku me faturat dhe listat e shkollave që kanë mbuluar secili prej tyre).
Fondi i kërkuar çelet nga Ministria e Arsimit duke ardhur me shkresë në zyrën Vendore Arsimore Tiranë për të kryer pagesat dhe në rastin konkret fondi te arsimi bazë nuk ishte i mjaftueshëm. Duke shfrytëzuar të gjithë fondin që kishim në dispozicion, përgatiten urdhër-shpenzimet shoqëruar me dokumentacionin përkatës përfshirë edhe përmbledhësen e faturave të fiskalizuara dhe i nënshkruar nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.
Të gjitha faturat tatimore të dorëzuara nga distributorët nuk kryhen tashmë nëpërmjet blloqeve ku mund të nënshkruhen me dorë por janë elektronike dhe si rrjedhojë rezulton vetëm firma e distributorit, akt rakordimi përfshin firmat e të dy palëve.
Qëndrimi i grupit të auditimit:.Gjithashtu grupi i auditimit sqaron se ka audituar pagesat e kryera nga ZVAP në lidhje subvencionin e librit shkollor. Si fillim grupi i auditimit ka analizuar në mënyrë të detajuar bazën ligjore për kryerjen e pagesave në lidhje me librin shkollor ku ka konstatuar problematika në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 01.07.2020 "Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar", të cilat ndër të tjera sjellin dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Por pavarësisht problematikat të trajtuar në lidhje më bazën ligjore, rezulton se ZVAP nuk ka kryer menjëherë pagesat pas çeljes së fondeve. Në lidhje me faturat e pa firmosura, sqarojmë se firmosja e tyre është kërkesë e udhëzimit në fuqi, konkretisht e Kreut 2, pika 5 të Udhëzimit të cituar më sipër.

2.1.4 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz

Programi Buxhetor Afatmesëm

ZVAP Kamëz ka hartuar PBA-në vetëm me një fazë, në kundërshtim me udhëzimin nr.07 datë 28.02.2008, pika 3 "Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" i cili përcakton se *Programi buxhetor afatmesëm behet në dy faza*.
PBA 2022-2024 është dërguar në DRAP Durrës me shkresën nr. 686, prot datë 10.08.2021, brenda afatit ligjor.
PBA 2023-2025 është dërguar në DRAP Durrës me shkresën nr. 1256, prot datë 15.08.2022, brenda afatit ligjor.
PBA 2024-2026 është dërguar në DRAP Durrës me shkresën nr. 1453, datë 19.08.2023, brenda afatit ligjor.
PBA 2025-2027 është dërguar në DRAP Durrës me shkresën nr. 1666/1, datë 20.08.2024, brenda afatit ligjor.
Vërehet mungesë e argumentimit të kërkesave buxhetore dhe të numrit të punonjësve duke paraqitur ne PBA vetëm të dhëna numerike lidhur me numrin e punonjësve dhe fondet përkatëse pa asnjë analizë apo argumentim shpjegues mbi ndryshimet apo nevojat reale, në kundërshtim me nenin 7 dhe 24 të ligjit nr. 9936/2008 dhe pikën "g" të udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" e cila përcakton se planifikimi buxhetor duhet të bazohet në analiza dhe argumentime të qarta për nevojat financiare dhe burimet njerëzore.
Nga auditimi konstatohet se PBA-t e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitin me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në Kreun I, pika 8 e udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", pasi janë përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat.
Rezulton se institucioni ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MAS duke mos dokumentuar propozimin e tij fillimisht pranë DRAP; përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit apo komente të tjera; deri në përgatitjen finale të tij pranë MAS,

jo në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, pikë "a" të nenin 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, dhe pikë "a" neni 34, "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", ku citohet se: "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it.*

Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2022-2024, PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027 rezultoi se institucioni ZVAP Kamëz ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit , por në urdhër nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit anëtar të grupit të ngritur, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qëndore".

Nga auditimi i PBA 2022-2024, PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027, u konstatua se në institucionin ZVAP Kamëz nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.*

Planifikimi për shpenzimet

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 912,453 mijë lekë, për 2023 në vlerë 982,673 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 1,047,487 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 1,397,317 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 145,025 mijë lekë, për 2023 në vlerë 156,292 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 166,599 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 220,606 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 19,033 mijë lekë, për 2023 në vlerë 20,433 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 55,794 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 60,694 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" , ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 61,923 mijë lekë, për 2023 në vlerë 64,557 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 58,844 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 65,657 mijë lekë.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

ZVAP Kamëz i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **930,589 mijë lekë**, konkretisht:

Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 12,303 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 717,012 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 201,274 mijë lekë.

Gjatë vitit 2022 janë kryer ndryshime në shpërndarjen e fondeve, të cilat rezultojnë se **nuk** janë shoqëruar me shkresat respektive për informimin e institucionin lidhur me vendimmarrjen e MAS

për buxhetin e tij. Nga stafi i ZVAP Kamëz bëhet me dije se ndryshimet në buxhet bëhen me dije për institucionin dhe në momentin e rakordimit me degën e thesarit. Buxheti fillestar *është shtuar me 127,886 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **1,058,475 mijë lekë.**
Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë:
Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 12,303 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Plani është *pakësuar me 1,233 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 11,070 mijë lekë.
Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 717,012 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Plani është *shtuar me 111,524 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 828,536 mijë lekë.
Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 201,274 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit ky program ka pësuar ndryshime që kanë konsistuar në shtime të shpenzimeve për paga dhe sigurime, si dhe shtesa fondesh për mallra (602) dhe shpenzime në llogarinë 606 në produktet 91104AE dhe 91104AG. Si rezultat plani është *shtuar me 17,595 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 218,869 mijë lekë.

Viti 2023

ZVAP Kamëz i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 971,149 mijë lekë: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 12,863 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 743,694 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 214,592 mijë lekë.
Buxheti fillestar *është shtuar me 171,610 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **1,142,759 mijë lekë.**
Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten: Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 12,863 mijë lekë, në nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Përgjatë vitit është *shtuar me 972 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 13,835 mijë lekë. Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 743,694 mijë lekë, në nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Përgjatë vitit është *pakësuar me 157,507 mijë lekë,* dhe rezulton në shumën 901,201 mijë lekë.
Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 214,592 mijë lekë në nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Përgjatë vitit plani është *shtuar me 13,131 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 227,723 mijë lekë.

Viti 2024

ZVAP Kamëz i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 1,259,447 mijë lekë: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 15,087 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 833,703 mijë lekë. Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 237,212 mijë lekë.
Buxheti fillestar *është shtuar me 173,445 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 1,259,447 mijë lekë.
Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë: Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 15,087 mijë lekë, ndërsa gjatë vitit është *shtuar me 1,328 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 16,415 mijë lekë.
Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 833,703 mijë lekë, ndërsa gjatë vitit është *shtuar me 154,917 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 998,620 mijë lekë.
Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 237,212 mijë lekë, ndërsa gjatë vitit është *shtuar me 7,200 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 244,412 mijë lekë.

Viti 2025

ZVAP Kamëz i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 1,401,974 mijë lekë.

Më hollësisht ndryshimet sipas programeve dhe produkteve paraqiten si më poshtë: Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është përcaktuar fillimisht në vlerën 16,742 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91101AE dhe 91101AA. Plani është *pakësuar me 1,338 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 15,404 mijë lekë.

Programi "Arsimi Bazë" është përcaktuar fillimisht në vlerën 1,054,697 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91103AB, 91103AC dhe 91103AD. Plani është *shtuar me 90,732 mijë lekë*, dhe rezulton në shumën 1,145,429 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm" është përcaktuar fillimisht në vlerën 330,535 mijë lekë ku janë përfshirë shpenzime për paga, sigurime dhe mallra, nën produktet 91104AA dhe 91104AB. Plani është *pak*ësuar *me 59,208 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 271,327 mijë lekë.

Rishpërndarja e fondeve

ZVAP Kamëz ka kryer rishikimet si vijon: në vitin 2022 janë kryer 11 rishikime buxhetore, për vitin 2023 janë kryer 15 rishikime buxhetore, për vitin 2024, janë kryer 15 rishikime buxhetore, dhe për vitin 2025, janë kryer 11 rishikime buxhetore të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së ZVAP Kamëz. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e ZVAP Kamëz për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumente si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 dhe 75.

Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se në disa raste ndryshimet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Arsimit nuk i janë komunikuar ZVAP-së nëpërmjet shkresave zyrtare, por institucioni është vënë në dijeni të tyre vetëm gjatë procesit të rakordimit me Degën e Thesarit. Kjo praktikë nuk garanton informimin në kohë të njësisë shpenzuese, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e buxhetit dhe procedurat e thesarit."

Realizimi i planit të buxhetit

2022

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kamëz krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë. *Në mijë lekë*

Programi	Planifikim 2022 sipas PBA 2022-2024	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	13,799	12,303	11,070	10,452
Arsimi Bazë	886,749	717,012	828,536	827,675
Arsimi i Mesëm	237,886	201,274	218,869	218,841
Total	**1,138,434**	**930,589**	**1,058,475**	**1,056,968**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 99.8% kundrejt planit te rishikuar dhe 93% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën 1,058,475 mijë lekë, dhe janë realizuar në shumën 1,056,968 mijë lekë.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2022							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	8,600	1,580	700	190	**11,070**
		Realizuar	8,157	1,405	700	190	**10,452**
		Realizimi %	**95%**	**89%**	**100%**	**100%**	**94%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	624,856	106,929	32,918	63,833	**828,536**
		Realizuar	624,856	106,927	32,059	63,833	**827,675**
		Realizimi %	**100%**	**99.9%**	**97%**	**100%**	**99.8%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	177,650	29,690	6,045	5,484	**218,869**
		Realizuar	177,650	29,662	6,045	5,484	**218,841**
		Realizimi %	**100%**	**99.9%**	**100%**	**100%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	811,106	138,199	39,663	69,507	**1,058,457**
		Realizuar	810,663	137,994	38,804	69,507	**1,056,968**
		Realizimi	**99.9%**	**99.8%**	**98%**	**100%**	**99.8%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë programin 01110 është bërë për shumën 11,070 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 10,452 mijë lekë (94% realizimi)

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë programin 09120 është bërë për shumën 828,536 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 827,675 mijë lekë (99.8% realizimi).

Planifikimi i rishikuar i fondeve për këtë programin 09230 është bërë për shumën 218,869 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 218,841 mijë lekë (99.9% realizimi).

Nëse i referohemi realizimit të shpenzimeve 602 sipas produkteve në të cilat ato janë përfshirë, konstatohet si më poshtë: Për programin 01110 shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 700,000 lekë, të cilat janë përdorur: Shpenzime për qera në vlerë 588,590 lekë; Shpenzime për tatim në burim në vlerë 111,410 lekë. Për programin 09120 paraqiten në vlerën 32,058,505 lekë:shpenzime për drita në shumën 202,927 lekë; shpenzime për ujë në shumën 10,716 lekë; shpenzime për shërbime postare në shumën 28,640 lekë; shpenzime për internet në shumën 43,200 lekë; shpenzime për programin art dhe zeje në shumën 3,479,577 lekë; shpenzime për vendime gjyqësore në shumën 2,009,967 lekë; shpenzime për transport të nxënësve në shumën 26,236,718 lekë; shpenzime për dieta në shumën 46,760 lekë Për programin 09130 shpenzimet totale për mallra dhe shërbime (602) paraqiten në vlerën 6,045,195 lekë, të cilat janë përdorur për s penzime transporti nxënësish në shumën 6,045,195 lekë

2023

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kamëz krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	lanifikimi 2023 sipas PBA 2023-2025	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	14,075	12,863	13,835	12,726
Arsimi Bazë	952,946	743,694	901,201	892,090
Arsimi i Mesëm	256,933	214,592	227,723	225,650
Total	**1,223,954**	**971,149**	**1,142,759**	**1,130,466**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99% kundrejt planit te rishikuar dhe 92% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **1,142,759 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **1,130,466 mijë lekë**.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2023							
Programi			**600**	**601**	**602**	**606**	**Totali**
			Paga	**Sigurime Shoqërore**	**Mallra dhe shërbime**	**Transferta Buxhetore**	
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	10,147	2,029	1,482	177	**13,835**
		Realizuar	9,449	1,618	1,482	177	**12,726**
		Realizimi %	**93%**	**80%**	**100%**	**100%**	**92%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	667,295	112,030	62,073	59,803	**901,201**
		Realizuar	667,295	111,666	53,362	59,767	**892,090**
		Realizimi %	**100%**	**99.6%**	**86%**	**99.9%**	**99%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	187,588	32,404	4,500	3,231	**227,723**
		Realizuar	187,588	31,831	3,000	3,231	**225,650**
		Realizimi %	**100%**	**98%**	**67%**	**100%**	**99%**
TOTALI		Planifikuar	865,030	146,463	68,055	63,211	**1,142,759**
		Realizuar	864,332	145,115	57,844	63,175	**1,130,466**
		Realizimi	**99.9%**	**99%**	**85%**	**99.9%**	**99%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 93%, për shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%, për shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 86% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.9%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 67% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

2024

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kamëz krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	**Planifikimi 2024 sipas PBA 2024-2026**	**Buxheti fillestar**	**Buxheti i rishikuar**	**Realizimi**
Planifikim, Menaxhim, Administrim	16,498	15,087	16,415	13,892
Arsimi Bazë	1,035,784	833,703	998,620	996,666
Arsimi i Mesëm	276,432	237,212	244,412	244,412
Total	**1,328,715**	**1,086,002**	**1,259,447**	**1,254,970**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **1,259,447 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **1,254,970 mijë lekë**.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2024							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	12,921	2,011	1,367	116	**16,415**
		Realizuar	11,220	1,189	1,367	116	**13,892**
		Realizimi %	**87%**	**59%**	**100%**	**100%**	**85%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	771,760	128,742	34,376	63,742	**998,620**
		Realizuar	771,760	128742	32,422	63,742	**996,666**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**94%**	**100%**	**99.8%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	207,220	34,570	69	2,553	**244,412**
		Realizuar	207,220	34570	69	2,553	**244,412**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**100%**	**100%**	**100%**
TOTALI		Planifikuar	991,901	165,323	35,812	66,411	**1,259,448**
		Realizuar	990,200	164,501	33,858	66,411	**1,254,970**
		Realizimi	**99.8%**	**99.5%**	**95%**	**100%**	**99.6%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 0110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 87%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.
Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 94% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.
Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 93% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

2025

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kamëz krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2025 sipas PBA 2025-2027	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	22,929	16,742	15,404	15,299
Arsimi Bazë	1,372,351	1,054,697	1,145,429	1,144,500
Arsimi i Mesëm	348,995	330,535	271,327	270,596
Total	**1,744,275**	**1,401,974**	**1,432,160**	**1,430,395**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.8% kundrejt planit te rishikuar dhe 82% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **1,432,160 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **1,430,395 mijë lekë**.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2025							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	12,059	2,045	1,300	0	**15,404**
		Realizuar	12,059	2,045	1,195	0	**15,299**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**92%**	**0%**	**99%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	916,476	153,557	12,535	62,861	**1,145,429**
		Realizuar	916,476	153,557	11,610	62,857	**1,144,500**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**93%**	**99.9%**	**99.9%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	227,981	38,129	2,264	2,953	**271,327**
		Realizuar	227,981	38,129	1,539	2,947	**270,596**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**68%**	**99.7%**	**99.7%**
TOTALI		Planifikuar	1,156,516	193,731	16,099	65,814	**1,432,161**
		Realizuar	1,156,516	193,731	14,344	65,804	**1,430,395**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**89%**	**99.9%**	**99.8%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Lidhur me programin 01110 "***Planifikim, Menaxhim, Administrim***"**:**

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 92% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) nuk ka pas realizim sepse nuk kanë qenë të planifikuara për këtë program.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 93% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.9%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 68% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.7%.

Nga auditimi rezulton se kontrata e qirasë është hartuar në mënyrë të paplotë dhe jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit civil, pasi nuk përcakton qartë objektin e kontratës (mungon sipërfaqja në m² dhe përshkrimi i detajuar i ambientit), nuk parashikon afatet dhe mënyrën e pagesës, nuk rregullon në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe nuk përcakton detyrimet e tjera ekonomike që i lindin qiramarrësit me lidhjen e kësaj kontratës përveç tarifës mujore të qerasë. Këto mangësi janë në kundërshtim me nenet 659, 663, 698 dhe 801–802 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, mungesa e elementëve të kontrollit dhe analizës ekonomike për përzgjedhjen e ambientit është në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" për përdorimin me eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Nga analiza e të dhënave për periudhën 2022–2025 rezulton se realizimi i shpenzimeve nga subjekti nuk është kryer gjithmonë në përputhje me objektivat dhe produktet e miratuara në buxhet. Fondet e alokuara nuk janë përdorur sipas qëllimit për të cilin janë planifikuar, duke evidentuar mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe zbatimit të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i rishikuar dhe realizuar për ZVAP Kamëz, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		Viti 2022-2025							
		2022		2023		2024		2025	
		Planifikuar[1] [1]	Realizuar	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	11,070	10,452	13,835	12,726	16,415	13,892	15,404	15,299
II	Arsimi Bazë	828,536	827,675	901,201	892,090	998,620	996,666	1,145,429	1,144,500
III	Arsimi i Mesëm	218,869	218,841	227,723	225,650	244,412	244,412	271,327	270,596
Total		**1,058,475**	**1,056,968**	**1,142,759**	**1,130,466**	**1,259,447**	**1,254,970**	**1,432,160**	**1,430,395**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raporti i Monitorimit 4 mujor i ZVAP Kamëz për vitin 2022, është përcjellë në DRAP Durrës dhe MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. prot 1530 datë 14.09.2022 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 1531 datë 14.09.2022 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. prot 229 datë 27.01.2023 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 228 datë 27.01.2023 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. prot 941/1 datë 17.05.2023 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 941 datë 17.05.2023 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8_mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. prot 1666 datë 07.09.2023 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 1667 datë 07.09.2023 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. prot 259/1 datë 25.01.2024 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 259 datë 25.01.2024 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. prot 1016 datë 15.05.2024 ne DRAP Durrës dhe me shkresën nr. prot 1015 datë 15.05.2024 në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. prot 2042 datë 19.09.2024 në të njëjtën shkresë dhe në DRAP Durrës dhe në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. prot 349 datë 07.02.2025 në të njëjtën shkresë dhe në DRAP Durrës dhe në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. prot 1124 datë 22.05.2025 në të njëjtën shkresë dhe në DRAP Tiranës dhe në MAS brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. prot 2296 datë 14.10.2026 në të njëjtën shkresë dhe në DRAP Tiranës dhe në MAS jashtë afatit ligjor duke qenë në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë

30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore” konkretisht me pikë 33 “Procedura për përgatitjen e raporteve katërmujore të monitorimit”.
Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. prot 82 datë 19.01.2026 në të njëjtën shkresë dhe në DRAP Tiranës dhe në MA brenda afatit ligjor.
Nga auditimi u konstatua se raportet e monitorimit për vitet 2022,2023,2024 dhe 2025 nuk shoqërohen me relacion shpjegues duke mos mundësuar analizën e plotë të realizimit të objektivave dhe përdorimit te fundeve duke rëne në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “i cili kërkon qe njësitë publike të sigurojnë raportin e plotë të saktë dhe të besueshëm mbi performancën dhe përdorimin e fondeve dhe me udhëzimin e ministrisë së financave nr. 16. date 17.11.2016 “Për monitorimin e performancës së njësive te qeverisjes së përgjithshme “i cili përcakton detyrimin e raportimit periodik te shoqëruar me analizë dhe shpjegime shpjeguese mbi realizimin e treguesve dhe arsyet e mosrealizimit të projekteve deri ne fund te vitit.
Anekset e raporteve të monitorimit rezultojnë të pa firmosura nga nëpunësi zbatues gjithashtu dhe te pa firmosura dhe vulosura nga nëpunësi autorizuar duke qenë në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 “ Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore “konkretisht në pika 19.2 dhe me nënpikën IX të tij.
Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 “Raporti i monitorimit”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ku shprehimisht përcaktohet që: “Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni” Në faqen zyrtare të ZVAP Kamëz nuk janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2022,2023,2024 dhe 2025.
Për vitin 2022,2023,2024 dhe 2025 ZVAP Kamëz nuk ka gjeneruar të ardhura dytësore.

2.1.5 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë

Programi Buxhetor Afatmesëm

ZVAP Vorë ka hartuar PBA-në vetëm në një fazë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2008 Pika 3 “Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm” i cili përcakton se *Programi buxhetor afatmesëm behet në dy faza*.
Me shkresën nr. 521/1, datë 09.08.2021 është përcjellë shkresa për programin buxhetor afatmesëm në MAS për periudhën 2022-2024 brenda afatit ligjor. Me shkresën nr. 524/1 datë 09.08.2021, është përcjellë relacioni për programin buxhetor Në këtë relacion është pasqyruar baza ligjore e përdorur dhe mënyrën e përllogaritjes së fondit të pagave dhe shpenzimeve në llogarinë 602. Gjithashtu relacioni përmban parregullsi në mënyrën e hartimit te tij sepse është jo funksional sepse në brendësi i referohet viteve 2019,2020 dhe 2021 dhe jo vitit objekt auditimi të PBA-së.
Me shkresën nr. 623/1, është përcjellë shkresa dhe relacioni për programin buxhetor afatmesëm në MAS për periudhën 2023-2025, në vijim të shkresës nr. 4692, datë 13.07.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025” si dhe Udhëzuesit të MAS “Për hartimin e buxhetit në institucionet e arsimit për periudhën afatmesme 2023-2025”. Me shkresën nr. 623/2, është përcjellë relacioni për programin buxhetor Në këtë relacion është pasqyruar baza ligjore e përdorur, dhe mënyrën e përllogaritjes së fondit të pagave dhe shpenzimeve në llogarinë 602,gjithashtu relacioni përmban parregullsi në mënyrën e hartimit te tij sepse është jo funksional sepse në brendësi i referohet vitit 2021 dhe parashikimit për vitin 2021-2023.
Me shkresën nr. 861/1, prot datë 17.08.2023 është përcjellë brenda afatit ligjor shkresa dhe

relacioni për programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2024-2026, në vijim të shkresës nr. 4501/1, datë 18.07.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026" si dhe Udhëzuesit të MAS "Për hartimin e buxhetit në institucionet e arsimit për periudhën afatmesme 2024-2026".
Me shkresën nr. 493/2, prot datë 09.08.2024 është përcjellë brenda fatit ligjor shkresa dhe relacioni për programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2025-2027, në vijim të shkresës nr. 493/1, datë 09.08.204 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027" si dhe Udhëzuesit të MAS "Për hartimin e buxhetit në institucionet e arsimit për periudhën afatmesme 2025-2027".
Rezulton se ZVAP Vorë, ka dërguar shkresën e përgatitjes se projekt buxhetit për periudhën 2022-2024,2023-2025,2024-2026,2025-2027 vetëm në MAS dhe nuk e kanë dërguar në Drap Durrës dhe më pas në MAS duke qene në kundërshtim me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 " Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm "i cili përcakton që subjektet duhet të dërgojnë shkresën në DRAP dhe më pas ne MAS.
Nga auditimi konstatohet se plani buxhetor afatmesëm 2022-2024 për ZVAP Vorë nuk ka të bashkëlidhur përmbledhësen e kërkesave buxhetore sipas programeve.
Vërehet mungesë e argumentimit te kërkesave buxhetore duke paraqitur ne PBA vetëm të dhëna numerike lidhur me numrin e punonjësve dhe fondet përkatëse pa analizë apo argumentim shpjegues mbi ndryshimet apo nevojat reale.
Nga auditimi konstatohet se PBA-ja e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitet me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", ku më hollësisht në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të tij, pasi nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat.
Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika a e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe propozimin DPAP-së*", dhe neni 32, pika a "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", e cila përcakton se "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it",* në vijim të verifikimi të kryer në ZVAP Vorë, rezulton se ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MAS duke mos dokumentuar propozimin e dokumentit në DRAP për vitet 2024-2026 dhe 2025-2027.
Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2022-2024, rezultoi se institucioni ZVAP Vorë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formatizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm "pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.
Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2023-2025, 2024-2026 dhe 2025-2027 rezultoi se institucioni ZVAP Vorë ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit nr.497, datë 01.08.2022, nr. 37, datë 03.08.2023, nr. 583/1 datë 05.08.2024 por në urdhër nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit anëtar të grupit të ngritur, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm "pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet

të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.

Nga auditimi i PBA 2022-2024,2025-2027 u konstatua se në institucionin ZVAP Vorë nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.*

Nga auditimi i PBA 2023-2025, 2024-2026 u konstatua se në institucionin ZVAP Vorë ka ngritur urdhrin për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit, por në urdhër nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit anëtar të grupit të ngritur në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazat të hartimit të kërkesave buxhetore etj.*

Planifikimi për shpenzimet

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 296,830 mijë lekë, për 2023 në vlerë 252,101 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 274,789 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 380,947 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 47,225 mijë lekë, për 2023 në vlerë 43,312 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 47,208 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 63,562 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 29,776 mijë lekë, për 2023 në vlerë 12,114 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 13,2023 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 23,865 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" , ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 7,306 mijë lekë.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

ZVAP Vorë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **307,531 mijë lekë**: në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110) në shumën totale 5,691 mijë lekë; në programin Arsimi Bazë në shumën totale 253,561 mijë lekë dhë në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 68,232 mijë lekë.

Buxheti fillestar përgjatë vitit *është shtuar me 1,252 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **260,276 mijë lekë.**

Vitin 2023

ZVAP Vorë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **319,087 mijë lekë**: Shpenzime në

programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 5,825 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 246,273 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 66,989 mijë lekë.
Buxheti fillestar *është shtuar me 35,727 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **354,814 mijë lekë.**

Viti 2024

ZVAP Vorë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **340,200 mijë lekë:** Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,584 mijë lekë; Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 259,751mijë lekë. Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 71,865 mijë lekë.
Buxheti fillestar *është shtuar me 59,490 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **399,690 mijë lekë.**

Viti 2025

ZVAP Vorë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **444,223 mijë lekë**: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,721 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 337,398 mijë lekë. Shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 98,101 mijë lekë.
Buxheti fillestar *është shtuar me 17,183 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **461,406 mijë lekë.**

Rishpërndarja e fondeve

Buxheti i ZVAP Vorë rezulton se janë kryer rishikimet si vijon: në vitin 2022 janë kryer 2 shkresa rishikimi buxhetor, për vitin 2023 janë kryer 6 shkresa rishikimi buxhetor, për vitin 2024, janë kryer 2 shkresa rishikimi buxhetor, dhe për vitin 2025, janë kryer 6 shkresa rishikimi buxhetor të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së ZVAP Vorë. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e ZVAP Vorë për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 dhe 75
U konstatua se në disa raste ndryshimet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Arsimit nuk i janë komunikuar ZVAP-së nëpërmjet shkresave zyrtare, por institucioni është vënë në dijeni të tyre vetëm gjatë procesit të rakordimit me Degën e Thesarit.

Realizimi i planit të buxhetit.

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Vorë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2022 sipas PBA 2022-2024	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	5,155	5,691	6,520	6,475
Arsimi Bazë	227,356	253,561	265,485	262,384
Arsimi i Mesëm	6,987	68,232	68,010	64,451
Total	**239,4698**	**327,484**	**340,010**	**333,311**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën

340,010 mijë lekë, dhe janë realizuar në shumën **333,311 mijë lekë**.
Rezulton se ZVAP Vorë paraqet mospërputhje të vlerave midis raport monitorimit nr. 81 prot datë 31.01.2023 , PBA-së nr. 524/1 prot, datë 09.08.2021 dhe akt rakordimit me thesarin: konkretisht Aneks nr.1 Raporti i shpenzimeve sipas programeve tek raporti i monitorimit nuk rakordon me planin e rishikuar dhe faktin e vitit 2022 të firmosur ndërmjet ZVAP Vorë dhe thesarit. Plani i rishikuar sipas Thesarit rezulton 340,010 mijë lekë ndërsa ne raport monitorimi rezulton 260,276 mijë lekë e njëjta situatë rezulton dhe për faktin e vitit në rakordimin me thesarin rezulton 333,311 mijë lekë ndërsa në raport monitorimi rezulton në vlerë 257,401 mijë lekë. Gjithashtu nuk rakordon me aneksin nr. 7.A përmbledhëse e kërkesa buxhetore. Në aneksin e PBA rezulton totali i planifikuar 239,498 mijë lekë ndërsa në raport monitorimi paraqitet 296,930 mijë lekë mos dokumentimi dhe raportimi i saktë i te dhënave financiare sjellë vështirësi në analizim e saktë dhe faktik të grupit të auditimit.
Nga auditimi konstatohet një diference e konsiderueshme midis planifikimit dhe realizimit faktik te buxhetit përsa me sipër kjo tregon një parashikim jo real te paargumentuar dhe të pambështetur në nevojat reale të ZVAP Vorë.
Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2022							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	4,772	848	800	100	**6,520**
		Realizuar	4,772	831	772	100	**6,475**
		Realizimi %	**100%**	**98%**	**97%**	**100%**	**99%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	200,062	33,600	19,088	12,735	**265,485**
		Realizuar	200,062	33,600	16,050	12,673	**262,384**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**84%**	**99.5%**	**99%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	55,474	9,299	2,183	465	**68,005**
		Realizuar	52,598	8,621	2,183	465	**64,451**
		Realizimi %	**95%**	**93%**	**100%**	**100%**	**95%**
TOTALI		Planifikuar	260,308	43,474	22,071	13,300	**340,010**
		Realizuar	257,432	43,052	19,005	13,238	**333,311**
		Realizimi	**99%**	**99%**	**86%**	**99.5%**	**98%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH
Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Realizimi i shpenzimeve për mallra dhe shpenzime është realizuar në masën 97% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.
Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 84% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.5%.
Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 95%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

2023

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Vorë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2023 sipas PBA 2023-2025	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	5,591	5,825	8,145	7,771
Arsimi Bazë	236,396	246,273	280,975	280,861
Arsimi i Mesëm	65,540	66,989	65,694	64,365
Total	**307,527**	**319,087**	**354,814**	**352,997**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99% kundrejt planit te rishikuar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **354,814 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **352,997 mijë lekë**.

Nga institucioni nuk janë vendosur ne dispozicion te gjitha shkresat e ndryshimit te buxhetit për periudhën objekt auditimit 2023-2025.

Nga dokumentacioni i dorëzuar grupit të auditimit në lidhje me rishikimet buxhetore rezulton se për vitin 2023 ZVAP Vorë ka dokumentuar 6 ndryshime në total.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2023							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe Shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	6,021	1,224	900	0	**8,145**
		Realizuar	6,019	955	797	0	**7,771**
		Realizimi %	**99.9%**	**78%**	**86%**	**0%**	**95%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	213,975	36,015	17,518	13,467	**280,975**
		Realizuar	213,975	36,015	17,440	13,431	**280,861**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99.5%**	**99.7%**	**99.9%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	54,340	9,924	816	614	**65,694**
		Realizuar	54,270	8,985	508	602	**64,365**
		Realizimi %	**99.8%**	**90%**	**62%**	**98%**	**98%**
TOTALI		Planifikuar	274,336	47,163	19,234	14,081	**354,814**
		Realizuar	274,264	45,955	18,745	14,033	**352,997**
		Realizimi	**99.9%**	**97%**	**97%**	**99.6%**	**99%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99.9%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 86% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) nuk janë planifikuar dhe nuk janë realizuar për këtë program.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.5% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.7%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99.8%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 62% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 98%.

Viti 2024

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Vorë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2024 PBA 2024-2024	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	6,093	8,584	8,736	7,832
Arsimi Bazë	257,670	259,751	318,277	317,943

Arsimi i Mesëm	71,437	71,865	72,677	72,664
Total	**335,200**	**340,200**	**399,690**	**398,439**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.6% kundrejt planit te rishikuar. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **399,690 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **398,439 mijë lekë**.

Nga institucioni nuk janë vendosur ne dispozicion te gjitha shkresat e ndryshimit te buxhetit për periudhën objekt auditimi 2024-2026.

Nga dokumentacioni i dorëzuar grupit të auditimit në lidhje me rishikimet buxhetore rezulton se për vitin 2024 ZVAP Vorë ka dokumentuar 2 ndryshime në total.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2024							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	6,713	1,108	800	115	**8,736**
		Realizuar	5,936	998	783	115	**7,832**
		Realizimi %	**88%**	**90%**	**98%**	**100%**	**90%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	245,736	40,629	17,262	14,650	**318,277**
		Realizuar	245,736	40,629	16,946	14,632	**317,943**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**98%**	**99.8%**	**99.8%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	60,809	10,068	1,256	544	**72,677**
		Realizuar	60,809	10,068	1,256	531	**72,664**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**100%**	**98%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	313,258	51,805	19,318	15,309	**399,690**
		Realizuar	312,481	51,695	12,985	15,278	**398,439**
		Realizimi	**99.7%**	**99.7%**	**98%**	**99.7%**	**99.6%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 90%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 98% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.8% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.8%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.5% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 98%.

2025

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Vorë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	**Planifikimi 2025 PBA 2025-2027**	**Buxheti fillestar**	**Buxheti i rishikuar**	**Realizimi**
Planifikim, Menaxhim, Administrim	12,697	8,721	8,159	8,036
Arsimi Bazë	365,894	337,401	363,965	362,680
Arsimi i Mesëm	89,753	98,101	89,282	489,270
Total	**468,344**	**444,223**	**461,406**	**459,986**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.6% kundrejt planit te rishikuar dhe 98.2% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **461,406 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **459,986 mijë lekë**.

Nga dokumentacioni i dorëzuar grupit të auditmit në lidhje me rishikimet buxhetore rezulton se për vitin 2025 ZVAP Vorë ka dokumentuar 6 ndryshime në total.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2025							
Programi			**600** **Paga**	**601** **Sigurime Shoqërore**	**602** **Mallra dhe shërbime**	**606** **Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim,Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	6,326	1,033	800	0	**8,159**
		Realizuar	6,239	1,033	764	0	**8,036**
		Realizimi %	**98.6%**	**100%**	**95.5%**	**0%**	**98%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	287,095	48,279	15,769	12,822	**363,965**
		Realizuar	287,095	47,642	15,121	12,822	**362,680**
		Realizimi %	**100%**	**99%**	**96%**	**100%**	**99.6%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	74,164	12,215	2,418	485	**89,282**
		Realizuar	74,164	12,215	2,406	485	**89,270**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99.5%**	**100%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	367,585	61,527	19,472	12,822	**461,406**
		Realizuar	367,498	60,890	18,776	12,822	**459,986**
		Realizimi	**99.9%**	**99%**	**99%**	**100%**	**99.6%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 95.5% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) nuk janë planifikuar dhe nuk janë realizuar.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 96% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimet për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.5% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Nga auditimi i kontratës së qirasë rezulton se ajo është hartuar në mënyrë të paplotë dhe jo në përputhje me kërkesat e legjislacionit civil, pasi nuk përcakton qartë objektin e kontratës (mungon sipërfaqja në m² dhe përshkrimi i detajuar i ambientit), nuk parashikon afatet dhe mënyrën e pagesës, nuk rregullon në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe nuk përcakton detyrimet e tjera ekonomike që i lindin qiramarrësit me lidhjen e kësaj kontratës përveç tarifës mujore të qirasë. Këto mangësi janë në kundërshtim me nenet 659, 663, 698 dhe 801–802 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, mungesa e elementëve të kontrollit dhe analizës ekonomike për përzgjedhjen e ambientit është në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" për përdorimin me eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i rishikuar dhe realizuar për ZVAP Vorë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		Viti 2022-2025							
		2022		2023		2024		2025	
		Planifikuar[1] [1]	Realizuar	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]	Planifikuar[1] [2]	Realizuar[1] [3]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	6,520	6,475	8,145	7,773	8,737	7,834	8,159	8,037
II	Arsimi Bazë	265,485	262,384	280,977	280,857	318,279	317,945	363,968	362,683
III	Arsimi i Mesëm	68,005	64,451	65,694	64,367	72,674	72,661	89,279	89,267
Total		**340,010**	**333,311**	**354,817**	**352,998**	**399,691**	**398,440**	**461,406**	**459,987**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. 442, datë 20.05.2022 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. 637, datë 19.09.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. 81, datë 31.01.2023 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 22023, është përcjellë me shkresën nr. 328, datë 17.05.2023 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. 701, datë 22.09.2023 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. 80, datë 25.02.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. 341, datë 16.05.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. 599, datë 18.09.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. 85 , datë 12.02.2025 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës dhe në MAS.
Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. 282/1, datë 16.05.2025 brenda afatit ligjor ne DRAP Tiranë.
Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. 588, datë 09.1`0.2025 jashtë afatit ligjor ne DRAP Tiranë në kundërshtim me udhëzimin nr.14 datë 30.05.2023"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" pika 33 "Procedurat për përgatitjen e raporteve katër mujore të monitorimit".
Raporti i Monitorimit vjetor i Zyrës vendore Arsimore Vorë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. 38, datë 13.01.2026 në MAS, brenda afatit ligjor
Nga auditimi u konstatua se subjekti ka hartuar raportin e monitorimit periodik , por ky raport nuk shoqërohet me relacion shpjegues duke mos mundësuar analizën e plotë të realizimit të objektivave dhe përdorimit te fundeve duke rëne në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i cili kërkon qe njësitë publike të sigurojnë raportin e plotë të saktë dhe të besueshëm mbi performancën dhe përdorimin e fondeve dhe me udhëzimin e ministrisë së financave nr. 16 date 17.11.2016 "Për monitorimin e performancës së njësive te qeverisjes së përgjithshme" i cili përcakton detyrimin e raportimit periodik te shoqëruar me analizë dhe shpjegime shpjeguese mbi realizimin e treguesve dhe arsyet e mosrealizimit të projekteve të

planifikuara.
Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 "Raporti i monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni" Në faqen zyrtare të ZVAP Vorë nuk janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2022,2023,2024 dhe 2025.
Për vitin 2022,2023,2024 dhe 2025 ZVAP Vorë nuk ka gjeneruar të ardhura dytësore.

2.1.6 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë

Programi Buxhetor Afatmesëm

Nga konstatimi i grupit të auditimit rezulton se ZVAP Kavajë ka hartuar PBA-në vetëm në një fazë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2008 pika 3 për "Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" i cili përcakton se *Programi buxhetor afatmesëm behet në dy faza*.
PBA 2022-2024 është përcjellë me shkresën nr. 818/1, datë 12.08.2021 brenda afatit ligjor.
PBA 2023-2025 është përcjellë me shkresën nr. 957/1, datë 17.08.2022 brenda afatit ligjor.
PBA 2023-2025 është përcjellë me shkresën nr. 887/1, datë 16.08.2023 brenda afatit ligjor.
PBA 2024-2026 është përcjellë me shkresën nr. 1090/1, datë 08.08.2024 brenda afatit ligjor. Nga auditimi konstatohet se plani buxhetor afatmesëm 2022-2024 për ZVAP Kavajë nuk ka të bashkëlidhur përmbledhësen e kërkesave buxhetore sipas programeve dhe artikujve përbërës për planifikimin e vitit 2022 në kundërshtim me pikën "c" të udhëzimit nr.7,datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*" i cili citon se njësite shpenzuese duhet të përmbajnë paraqitjen e qëllimit dhe objektivave të politikës së programeve të shoqëruar me treguesit përkatës të performancës.
Rezulton se subjekti ZVAP Kavajë ka dorëzuar PBA-në 2022-2024 vetëm në forme tabelare (anekse) të shoqëruar me shkresë përcjellëse pa relacion shpjegues në kundërshtim me pikën "g" të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*" i cili citon se njësite shpenzuese janë të detyruara të paraqesin PBA të shoqëruar me relacion shpjegues dhe dokumentacionin mbështetës, ku argumentohet planifikimi buxhetor.
Për vitet 2022-2024, 2023-2025, 2024-2026, 2025-2027 vërehet mungesë e argumentimit te kërkesave buxhetore dhe të numrit te punonjësve duke paraqitur ne PBA vetëm te dhëna numerike lidhur me numrin e punonjësve dhe fondet përkatëse pa asnjë analizë apo argumentim shpjegues mbi ndryshimet apo nevojat reale në kundërshtim me nenin 7 dhe 24 të ligjit nr. 9936/2008 planifikimi buxhetor duhet te bazohet ne analiza dhe argumentime të qarta për nevojat financiare dhe burimet njerëzore.
Nga auditimi konstatohet se PBA-ja e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitet me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", ku më hollësisht në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të tij, pasi nuk është përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat.
Rezulton se institucioni ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MAS duke mos dokumentuar propozimin e tij fillimisht pranë DRAP; përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit apo komente të tjera; deri në përgatitjen finale të tij pranë MAS, jo në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të

Arsimit Parauniversitar, neni 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, pika "a" e saj, përcakton "*Hartimin e projektbuxhetit të DRAP-së dhe ZVAP-ve dhe propozimin DPAP-së*", dhe neni 34, pika a "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", e cila përcakton se "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it".*

Rezultoi se ZVAP Kavajë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.

Nga auditimi i procedurave për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA 2023-2025,2024-2026,2025-2027 rezultoi se institucioni ZVAP Kavajë ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit me urdhër nr. 60 prot, datë 05.08.2022, por në urdhër nuk janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit anëtar të grupit të ngritur, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktoje qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.

Nga auditimi i PBA 2022-2024, PBA 2023-2025, PBA 2024-2026, PBA 2025-2027, u konstatua se në institucionin ZVAP Kavajë nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5.

Planifikimi për shpenzimet Korrente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 458,419 mijë lekë, për vitin 2023 janë planifikuar në vlerë 416,600 mijë lekë, për 2024 në vlerë 492,900 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 573,077 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 60,362 mijë lekë, për vitin 2023 janë planifikuar në vlerë 69,572 mijë lekë, për 2024 në vlerë 82,314 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 91,008 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 31,300 mijë lekë, për vitin 2023 janë planifikuar në vlerë 37,069 mijë lekë, për 2024 në vlerë 45,411 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 36,040 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 22,370 mijë lekë, për vitin 2023 janë planifikuar në vlerë 20,069 mijë lekë, për 2024 në vlerë 27,790 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 42,375 mijë lekë.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

ZVAP Kavajë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 427,292 mijë lekë: shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,602 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 342,570 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 76,120 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 23,027 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 450,319 mijë lekë.

Viti 2023

ZVAP Kavajë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 429,235 mijë lekë: shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 9,087 mijë lekë: Shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 343,595 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 76,553 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 30,282 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 459,517mijë lekë.

Viti 2024

ZVAP Kavajë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 454,948 mijë lekë: shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 11,145 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 361,873 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 81,930 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 59,682 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 514,630 mijë lekë.

Viti 2025

ZVAP Kavajë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale 577,119 mijë lekë, ku sipas programit si më poshtë: Shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 10,306 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 468,796 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 98,017 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është shtuar me 5,698 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën 582,817 mijë lekë.

Rishpërndarja e fondeve

ZVAP Kavajë ka kryer rishikimet buxhetore si vijon: në vitin 2022 janë kryer 10 shkresa rishikimi buxhetor, për vitin 2023 janë kryer 12 shkresa rishikimi buxhetor, për vitin 2024, janë kryer 13shkresa rishikimi buxhetor, dhe për vitin 2025, janë kryer 10 shkresa rishikimi buxhetor të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së ZVAP Kavajë. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e ZVAP Kavajë për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 dhe 75.

Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se në disa raste ndryshimet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Arsimit nuk i janë komunikuar ZVAP-së nëpërmjet shkresave zyrtare, por institucioni është vënë në dijeni të tyre vetëm gjatë procesit të rakordimit me Degën e Thesarit. Kjo praktikë nuk garanton informimin në kohë të njësisë shpenzuese, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.

9936, datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore për zbatimin e buxhetit dhe procedurat e thesarit."

Realizimi i planit të buxhetit.

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kavajë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2022 sipas PBA 2022-2024	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	14,077	8,602	8,622	8,542
Arsimi Bazë	481,547	342,570	364,279	361,446
Arsimi i Mesëm	107,827	76,120	77,418	77,385
Total	**603,451**	**427,292**	**450,319**	**447,373**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 99.3 % kundrejt planit te rishikuar dhe 74% kundrejt planit fillestar PBA.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2022							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	6,600	1,102	800	120	**8,622**
		Realizuar	6,551	1,071	800	120	**8,542**
		Realizimi %	**99%**	**97%**	**100%**	**100%**	**99%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	283,837	48,787	17,750	13,905	**364,279**
		Realizuar	283,837	48,786	15,018	13,806	**361,447**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**85%**	**99%**	**99%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	64,922	10,665	163	1,668	**77,418**
		Realizuar	64,922	10,646	163	1,653	**77,384**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**100%**	**99%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	355,359	60,554	18,713	15,693	**450,319**
		Realizuar	355,310	60,503	15,981	15,579	**447,373**
		Realizimi	**99.9%**	**99.9%**	**85%**	**99%**	**99%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 85% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Realizimi i planit të buxhetit

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kavajë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2022 sipas PBA 2023-2025	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	24,197	9,087	10,371	9,896
Arsimi Bazë	450,412	343,595	370,221	369,395
Arsimi i Mesëm	86,198	76,553	78,925	78,017
Total	**560,807**	**429,235**	**459,517**	**457,308**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 99.5% kundrejt planit te rishikuar dhe 81.5% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën 459,517 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 457,308 mijë lekë.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë: *Në mijë lekë*

Viti 2023							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	7,984	1,387	1,000	0	**10,371**
		Realizuar	7,918	1,352	626	0	**9,896**
		Realizimi %	**99%**	**97%**	**63%**	**0%**	**95%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	294,803	49,505	12,237	13,676	**370,221**
		Realizuar	294,804	49,251	11,856	13,484	**369,395**
		Realizimi %	**100%**	**99%**	**97%**	**99%**	**99.7%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	65,747	11,628	422	1,128	**78,925**
		Realizuar	65,738	10,907	274	1,098	**78,017**
		Realizimi %	**99.9%**	**94%**	**65%**	**97%**	**99%**
TOTALI		Planifikuar	368,534	62,521	13,658	14,804	**459,517**
		Realizuar	368,460	61,510	12,756	14,582	**457,308**
		Realizimi	**99.9%**	**98%**	**93%**	**99%**	**99.5%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 63% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) nuk kanë qenë të planifikuara në këtë dhe nuk ka realizueshmëri.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 97% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99.9%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 93% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99%.

Realizimi i planit të buxhetit.

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kavajë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2024 sipas PBA 2024-2026	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	13,948	11,145	11,563	11,393
Arsimi Bazë	554,730	361,873	412,711	412,447
Arsimi i Mesëm	94,387	81,930	84,688	84,429

Total	**663,064**	**454,948**	**508,962**	**508,269**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.8% kundrejt planit te rishikuar dhe 77% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën 508,962 **mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **508,269 mijë lekë**. Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2024							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	9,249	1,584	630	100	**11,563**
		Realizuar	9,169	1,532	592	100	**11,393**
		Realizimi %	**99%**	**97%**	**94%**	**100%**	**99%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	332,193	55,075	11,386	14,057	**412,711**
		Realizuar	332,193	55,073	11,123	14,057	**412,447**
		Realizimi %	**100%**	**99.9%**	**98%**	**100%**	**99.9%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	71,471	11,875	415	927	**84,688**
		Realizuar	71,471	11,875	156	927	**84,429**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**38%**	**100%**	**99.6%**
TOTALI		Planifikuar	412,913	68,534	12,431	15,084	**508,962**
		Realizuar	412,834	68,480	11,871	15,084	**508,269**
		Realizimi	**99.9%**	**99.9%**	**95%**	**100%**	**99.8%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 94% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 98% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 38% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) fondet janë realizuar në masën

Realizimi i planit të buxhetit.

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Kavajë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2022 sipas PBA 2025-2027	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	17,562	10,306	10,057	9,841
Arsimi Bazë	616,143	468,796	474,753	473,745
Arsimi i Mesëm	125,013	98,017	98,007	97,984
Total	**758,718**	**454,948**	**582,817**	**581,570**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total për tre programet paraqitet në masën 99.7% kundrejt planit te rishikuar

dhe 77% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën 582,817 mijë lekë, dhe janë realizuar në shumën 581,570 mijë lekë.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2025							
Programi			600 Paga	601 Sigurime Shoqërore	602 Mallra dhe shërbime	606 Transferta Buxhetore	Totali
01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	Planifikuar[14]	7,925	1,332	800	0	**10,057**
		Realizuar	7,925	1,332	584	0	**9,841**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**73%**	**0%**	**98%**
09120	Arsimi Bazë	Planifikuar[15]	383,924	63,741	13,791	13,277	**474,753**
		Realizuar	383,925	63,741	12,802	13,277	**473,745**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**93%**	**100%**	**99.7%**
09230	Arsimi i Mesëm	Planifikuar[16]	83,004	13,828	230	925	**98,007**
		Realizuar	83,004	13,828	227	925	**97,984**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99%**	**100%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	474,853	78,901	14,821	14,242	**582,817**
		Realizuar	474,854	78,901	13,613	14,202	**581,570**
		Realizimi	**100%**	**100%**	**92%**	**99.7%**	**99.7%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 73% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) nuk janë planifikuar dhe realizuar.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 93% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime, fondet janë realizuar në masën 99% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) fondet janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar.

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i rishikuar dhe realizuar për ZVAP Kavajë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		Viti							
		2022		2023		2024		2025	
		Planifikuar[11]	Realizuar	Planifikuar[12]	Realizuar[13]	Planifikuar[12]	Realizuar[13]	Planifikuar[12]	Realizuar[13]
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	8,622	8,542	10,371	9,896,	11,563	11,393	10,057	9,841
II	Arsimi Bazë	364,279	361,446	370,221	369,395	412,711	412,447	474,753	473,745
III	Arsimi i Mesëm	77,418	77,385	78,925	78,017	84,688	84,429	98,007	97,984
Total		**450,319**	**447,373**	**459,5147**	**457,308**	**508,962**	**508,269**	**582,817**	**581,570**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raporti i Monitorimit 4 mujor i ZVAP Kavajë për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr. prot 448 datë 27.05.2025 në DRAP Durrës, brenda afatit ligjor në DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2022, është përcjellë me shkresën nr.1153 prot datë 14.09.2022 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2022, përcjellë me shkresën nr. prot 99, datë 23.01.2023 në DRAP Durrës, brenda afatit ligjor në DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. 530, datë 18.05.2023 në DRAP Durrës, brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr.989 prot, datë 08.09.2023 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr.93 prot datë 16.01.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. prot 746, datë 15.05.2024 në DRAP Durrës, brenda afatit ligjor në DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2024 është përcjellë me shkresën nr.1219 prot datë 09.09.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës

Raporti i Monitorimit vjetor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë për vitin 2024 është përcjellë me shkresën nr.168 prot datë 05.02.2025 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës.

Nga auditimi u konstatua se subjekti ka dorëzuar raportet e monitorimit periodik për periudhën objekt auditimi me anekset bashkangjitur të firmosura si nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi autorizues , por ky raport nuk shoqërohet me relacion shpjegues duke mos mundësuar analizën e plotë të realizimit të objektivave dhe përdorimit te fundeve duke rëne në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i cili kërkon qe njësite publike të sigurojnë raportin e plotë të saktë dhe të besueshëm mbi performancën dhe përdorimin e fondeve dhe me udhëzimin e ministrisë së financave nr. 14 date 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit te buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" i cili përcakton detyrimin e raportimit periodik te shoqëruar me analizë dhe shpjegime shpjeguese mbi realizimin e treguesve.

Nga konstatimi i grupit të auditimit rezulton se ZVAP Kavajë ka dërguar raportet e monitorimit vetëm në DRAP Durrës për vitet 2022, 2023 dhe 2024 dhe në DRAP Tiranë për vitin 2025 në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore" i cili citon se *raportet e monitorimit dërgohen fillimisht në njësinë përgjegjëse për monitorimin dhe më pas në ministrinë përgjegjëse*.

Nga auditimi rezulton se ZVAP Kavajë nuk ka paraqitur në relacion arsyet dhe shkaqet e mosrealizimit të projekteve që janë planifikuar por nuk janë realizuar deri në fund të vitit.

Nga auditimi rezulton se ZVAP Kavajë nuk ka paraqitur në relacion përshkrimin e institucionit dhe plotësimin e një liste për përmbajtjen e raportit të monitorimit në kundërshtim me udhëzimin nr.14 datë 30.05.2023 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"* përkatësisht me shtojcën nr.3 të raport monitorimit pika 1dhe 2 e saj.

Nga konstatimi i grupit të auditimit rezulton se subjekti ZVAP Kavajë ka publikuar në faqen e ŵebit raportet e monitorimit për vitet 2023 dhe 2025 gjithashtu rezulton se për vitin 2024 nuk është dorëzuar raporti i monitorimit 12 mujor, ndërsa për vitin 2022 rezulton se nuk është publikuar në ŵeb raporti 4-mujor dhe 8-mujor në kundërshtim me kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 "Raporti i monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë

30.05.2023, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni
Për vitin 2022,2023,2024 dhe 2025 ZVAP Kavajë nuk ka gjeneruar të ardhura dytësore.

2.1.7 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë

Programi Buxhetor Afatmesëm

Rrogozhinë ka hartuar PBA-në vetëm në një fazë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2008, pika 3 "Hapat ndërinstitucional për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm" i cili përcakton se *Programi buxhetor afatmesëm bëhet në dy faza*.
PBA 2022-2024 është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 260/1, datë 11.08.2021, brenda afatit ligjor.
PBA 2023-2025 është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 639, datë 10.08.2022, brenda afatit ligjor.
PBA 2024-2026 është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 376, datë 15.08.2023, brenda afatit ligjor.
PBA 2025-2027 është dërguar me shkresën përcjellëse nr. 515/1, datë 12.08.2024, brenda afatit ligjor.
Vërehet mungesë e argumentimit të kërkesave buxhetore dhe të numrit të punonjësve duke paraqitur ne PBA vetëm të dhëna numerike lidhur me numrin e punonjësve dhe fondet përkatëse pa asnjë analizë apo argumentim shpjegues mbi ndryshimet apo nevojat reale, në kundërshtim me nenin 7 dhe 24 të ligjit nr. 9936/2008 dhe pikën "g" të udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" e cila përcakton se planifikimi buxhetor duhet të bazohet në analiza dhe argumentime të qarta për nevojat financiare dhe burimet njerëzore.
Nga auditimi konstatohet se PBA-t e hartuar për periudhën objekt auditimi paraqitin me mangësi referuar kërkesave të parashikuara në Kreun I, pika 8 e udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA*", pasi janë përshkruar misioni i njësisë, përshkrimi i programit së bashku me qëllimin dhe objektivat.
Rezulton se institucioni ka përcjellë në të njëjtën kohë dokumentacionet pranë DRAP Durrës, dhe MAS duke mos dokumentuar propozimin e tij fillimisht pranë DRAP; përcjelljen e komenteve nga DRAP për rishikim të materialit apo komente të tjera; deri në përgatitjen finale të tij pranë MAS, jo në përputhje me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, pikë "a" të nenin 24 "Detyrat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës" pranë DRAP-së, dhe pikë "a" neni 34, "Detyrat e Sektorit të Shërbimeve", ku citohet se: "*Harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it.*
Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA 2022-2024, 2023-2025, 2024-2026, 2025-2027 rezultoi se institucioni ZVAP Rrogozhinë nuk ka nxjerrë urdhër për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt buxhetit. Procesi i përgatitjes së PBA është kryer pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit të përfshirë. Kjo praktikë bie ndesh me kërkesat e ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrisë së Financave për "Procedurat standarde te përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm "pika 2.4 "Përgjegjësitë e nëpunësit autorizues së qeverisjes qendrore" pika 2 e tij përcakton se nëpunësi autorizues duhet të ngrejë grupin e punës për hartimin e PBA-së dhe të përcaktojë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit.
Nga auditimi i PBA 2022-2024, 2023-2025, 2024-2026, 2025-2027 u konstatua se në institucionin ZVAP Rrogozhinë nuk ka funksionuar Ekipi i Menaxhimit të Programit, veprim në kundërshtim

me udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", paragrafi 2.5, pika 5, citohet se "*Drejtuesi i programit dërgon tek të gjithë anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programit (a) Udhëzimin e Përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, (b) përshkrimin e Misionit (c) propozimin e anëtarëve të Ekipit të Menaxhimit të Programit dhe (d) kalendarin për fazën e parë të hartimit të kërkesave buxhetore etj.*

Planifikimi për Shpenzimet Korrente

Planifikimi i shpenzimeve për "*Pagat e punonjësve*" nën artikullin 600 është bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 237,507 mijë lekë, për 2023 në vlerë 39,664 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 26,798 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 14,095 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore*" nën artikullin 601 janë mbështetur në ligjin për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 243,157 mijë lekë, për 2023 në vlerë 39,528 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 13,303 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 9,964 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Mallra dhe Shërbime*" nën artikullin 602 është mbështetur në fondet e alokuara sipas programeve dhe kërkesave të sektorëve të drejtorisë për përmbushjen e detyrave funksionale të punonjësve, ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 263,735 mijë lekë, për 2023 në vlerë 42,376 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 15,743 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 1,855 mijë lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për "*Transferta në Buxhetet Familjare dhe Individët për secilin Program të Ministrive të Linjës*", nën artikullin 606 është kryer në bazë të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" , ku për vitin 2022 janë planifikuar në vlerë 33,968 mijë lekë, për 2023 në vlerë 53,005 mijë lekë, për vitin 2024 në vlerën 13,301 mijë lekë, për vitin 2025 në vlerën 824 mijë lekë.

Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2022

ZVAP Rrogozhinë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **267,002 mijë lekë:** shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 5,591 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 226,563 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 34,848 mijë lekë. Buxheti fillestar *është pakësuar me 1,868 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **265,134 mijë lekë.**

Programi 01110 është *pakësuar me 600 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 4,991mijë lekë.

Programi 09120 është *pakësuar me 3,685 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 222,878 mijë lekë.

Programi 09230 është *shtuar me 2,417 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 37,265 mijë lekë.

Viti 2023

ZVAP Rrogozhinë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **269,296 mijë lekë**:shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,526 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 227,719 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 35,751 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është pakësuar me 2,797 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **266,499 mijë lekë.**

Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është *pakësuar me 5,805 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 221,914 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm"është *shtuar me 2,152 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 37,903 mijë

lekë.

Viti 2024

ZVAP Rrogozhinë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **287,694 mijë lekë:** shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,584 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 240,375 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 38,735 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është pakësuar me 2,541mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **285,153 mijë lekë.**

Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është *pakësuar me 652 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 7,932 mijë lekë.

Programi "Arsimi Bazë" është *pakësuar me 5,736 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 234,639 mijë lekë. Programi "Arsimi i Mesëm" është *shtuar me 3,848 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 42,583 mijë lekë.

Viti 2025

ZVAP Rrogozhinë i janë çelur fillimisht fondet me vlerën totale **357,505 mijë lekë**: shpenzime në programin Planifikim, Menaxhim, Administrim (01110), në shumën totale 8,721 mijë lekë; shpenzime në programin Arsimi Bazë (09120), në shumën totale 288,200 mijë lekë dhe shpenzime në programin Arsimi i Mesëm (09230), në shumën totale 60,584 mijë lekë.

Buxheti fillestar *është pakësuar me 41,690 mijë lekë* dhe plani final i rishikuar rezulton në shumën **315,815 mijë lekë.**

Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim" është *pakësuar me 729 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 7,992 mijë lekë.

Programi "Arsimi Bazë" është *pakësuar me 30.014 mijë lekë* dhe rezulton në shumën 259,186 mijë lekë.

Programi "Arsimi i Mesëm" është *pak*ësuar *me 11,947mijë lekë* dhe rezulton në shumën 48,637 mijë lekë.

Rishpërndarja e fondeve

Nga ZVAP Rrogozhinë janë kryer rishikimet si vijon: në vitin 2022 janë kryer 8 shkresa rishikim buxhetor, për vitin 2023 janë kryer 9 shkresa rishikimi buxhetor, për vitin 2024, janë kryer 6 shkresa rishikimi buxhetor, dhe për vitin 2025, janë kryer 10 shkresa rishikim buxhetor të cilat kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes së ZVAP Rrogozhinë. Nga auditimi i rishikimeve të kërkuara nga ana e ZVAP Rrogozhinë për shtesa dhe pakësime fondesh u konstatua se nuk janë të shoqëruara me argumentet si: a) arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit; b) produktet, që përfitohen nga veprimtaritë, që do të financohen nga kërkesat shtesë; c) kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave; ç) zërat e tjerë të fondeve buxhetore të miratuara, që mund të reduktohen për të siguruar fondin e nevojshëm, si dhe pasojat që një reduktim i tillë do të kishte mbi arritjen e objektivave të tjerë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 71 dhe 75. *mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit".*

Gjatë periudhës objekt auditimi u konstatua se në disa raste ndryshimet e buxhetit të miratuara nga Ministria e Arsimit nuk i janë komunikuar ZVAP-së nëpërmjet shkresave zyrtare, por institucioni është vënë në dijeni të tyre vetëm gjatë procesit të rakordimit me Degën e Thesarit.

Realizimi i planit të buxhetit.

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Rrogozhinë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2022 sipas PBA 2022-2024	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	66,375	5,591	4,991	4,860
Arsimi Bazë	267,088	226,563	222,878	222,825
Arsimi i Mesëm	44,131	34,848	37,265	37,256
Total	**377,594**	**267,002**	**265,134**	**264,941**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.9% kundrejt planit te rishikuar dhe 70% kundrejt planit fillestar PBA. Sipas planit të rishikuar, fondet për shpenzimet nën 3 programe janë planifikuar në shumën **265,134 mijë lekë**, dhe janë realizuar në shumën **264,941 mijë lekë**. Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2022							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	4,020	671	200	100	**4,991**
		Realizuar	3,917	671	172	100	**4,860**
		Realizimi %	**97%**	**100%**	**86%**	**100%**	**97%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	173,367	28,909	11,681	8,888	**222,878**
		Realizuar	173,367	28,909	11,660	8,888	**222,825**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99.8%**	**100%**	**99.9%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	30,805	5,094	316	1,050	**37,265**
		Realizuar	30,805	5,094	310	1,047	**37,256**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**98%**	**99.7%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	206,192	34,674	12,197	10,071	**265,134**
		Realizuar	206,090	34,674	12,142	10,031	**264,941**
		Realizimi	**99.9%**	**100%**	**99.5%**	**99.6%**	**99.9%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 86% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.8% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 98% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.7%.

2023

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Rrogozhinë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	Planifikimi 2023 sipas PBA 2023-2025	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Realizimi
Planifikim, Menaxhim, Administrim	8,534	5,826	6,683	5,972
Arsimi Bazë	259,529	227,719	221,914	221,152

Arsimi i Mesëm	40,749	35,751	37,903	37,723
Total	**308,811**	**269,296**	**266,499**	**264,847**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99% kundrejt planit te rishikuar dhe 86% kundrejt planit fillestar Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit. Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2023							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**Planifikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	4,975	808	900	0	**6,683**
		Realizuar	4,626	808	538	0	**5,972**
		Realizimi %	**93%**	**100%**	**60%**	**0%**	**89%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	174,964	29,619	11,094	6,237	**221,914**
		Realizuar	174,964	28,864	11,094	6,231	**221,152**
		Realizimi %	**100%**	**97%**	**100%**	**99.9%**	**99.6%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	31,331	5,426	446	699	**37,903**
		Realizuar	31,291	5,287	446	699	**37,723**
		Realizimi %	**99.8%**	**97%**	**100%**	**100%**	**99.5%**
TOTALI		Planifikuar	211,269	35,853	12,440	6,936	**266,499**
		Realizuar	210,880	34,959	12,078	6,930	**264,847**
		Realizimi	**99.8%**	**97.5%**	**97%**	**99.9%**	**99%**

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 60% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606)nuk janë realizuar kjo llogari e këtij programi është planifikuar në PBA dhe nuk është çelur fond dhe nuk është realizuar.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.9%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99.8%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 100% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

2024

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Rrogozhinë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi	**24 sipas PBA 2024-2026**	**Buxheti fillestar**	**Buxheti i rishikuar**	**Realizimi**
Planifikim, Menaxhim, Administrim	11,704	8,584	7,932	7,303
Arsimi Bazë	275.733	240,375	234,639	234,633
Arsimi i Mesëm	38,393	38,735	42,583	42,547
Total	**325,380**	**287,694**	**285,153**	**284,483**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.7% kundrejt planit të rishikuar dhe 87% kundrejt planit fillestar PBA. Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2024							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**fikim, Menaxhim, Administrim**	Planifikuar[14]	6,494	1,023	400	15	**7,932**
		Realizuar	5,898	1,022.63	367,33	15	**7,303**
		Realizimi %	**90%**	**99.9%**	**92%**	**100%**	**92%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	186,562	30,773	10,993	6,311	**234,639**
		Realizuar	186,562	30,773	10,987	6,311	**234,633**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**99.9%**	**100%**	**99.9%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	35,207	5,924	499	953	**42,583**
		Realizuar	35,207	5,924	463.92	953	**42,547**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**93%**	**100%**	**99.9%**
TOTALI		Planifikuar	228,263	37,719	11,892	7,279	**285,153**
		Realizuar	227,667	37,719	11,818	7,279	**284,483**
		Realizimi	**99.7%**	**100%**	**99%**	**100%**	**99.7%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 99.9%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 92% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 99.9% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 93% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

2025

Niveli i realizimit të fondeve të ZVAP Rrogozhinë krahasuar me planifikimin fillestar sipas PBA, buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar, paraqitet si më poshtë.

Në mijë lekë

Programi	**i 2025 sipas PBA 2025-2027**	**Buxheti fillestar**	**Buxheti i rishikuar**	**Realizimi**
Planifikim, Menaxhim, Administrim	11,851	8,721	7,992	7,804
Arsimi Bazë	333,836	288,200	259,186	258,877
Arsimi i Mesëm	55,411	60,584	48,637	48,410
Total	**401,097**	**357,505**	**315,815**	**315,091**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Niveli i realizimit në total **për tre programet** paraqitet në masën 99.7% kundrejt planit te rishikuar dhe 78.5% kundrejt planit fillestar. Niveli i lartë i realizimit vjen për shkak të alokimit të fondeve sipas nevojave të institucionit, duke kryer shtesa/pakësime të shumta përgjatë vitit.

Në nivel programi, realizimi sipas programit të rishikuar të alokuar sipas secilës llogari paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Viti 2025							
Programi			**600 Paga**	**601 Sigurime Shoqërore**	**602 Mallra dhe shërbime**	**606 Transferta Buxhetore**	**Totali**
01110	**fikim, Menaxhim,**	Planifikuar[14]	6,312	1,095	535	50	**7,992**
		Realizuar	6,221	1,074	460	50	**7,804**

	Administrim	**Realizimi %**	**98.5%**	**98%**	**86%**	**100%**	**97.6%**
09120	**Arsimi Bazë**	Planifikuar[15]	207,567	34,345	10,929	6,346	**259,186**
		Realizuar	207,567	34,345	10,624	6,341	**258,877**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**97%**	**99.9%**	**99.8%**
09230	**Arsimi i Mesëm**	Planifikuar[16]	40,547	6,753	822	516	**48,637**
		Realizuar	40,547	6,753	595	516	**48,410**
		Realizimi %	**100%**	**100%**	**72%**	**100%**	**99.5%**
TOTALI		Planifikuar	254,425	42,192	12,286	6,907	**315,815**
		Realizuar	254,334	42,171	11,680	6.907	**315,091**
		Realizimi	**99.9%**	**99.9%**	**95%**	**100%**	**99.7%**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Për programin 01110 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 98%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 86% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Për programin 09120 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 97% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 99.9%.

Për programin 09230 konstatohet se realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore është kryer në masën 100%. Shpenzimeve për mallra dhe shpenzime janë realizuar në masën 72% kundrejt planit të rishikuar. Transfertat buxhetore (606) janë realizuar në masën 100%.

Në mënyrë të përmbledhur, buxheti i rishikuar dhe realizuar për ZVAP Rrogozhinë, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Programi		**Viti 2022-2025**							
		2022		**2023**		**2024**		**2025**	
		Planifikuar[1] 1	**Realizuar**	**Planifikuar[1] 2**	**Realizuar[1] 3**	**Planifikuar[1] 2**	**Realizuar[1] 3**	**Planifikuar[1] 2**	**Realizuar[1] 3**
I	Planifikim, Menaxhim, Administrim	4,991	4,860	6,683	5,972	7,932	7,303	7,992	7,804
II	Arsimi Bazë	222,878	222,825	221,914	221,152	234,639	234,633	259,186	258,877
III	Arsimi i Mesëm	37,265	37,256	37,903	37,723	42,583	42,547	48,637	48,410
Total		**265,134**	**264,941**	**266,499**	**264,847**	**285,153**	**284,483**	**315,815**	**315,091**

Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Mbi raportet e monitorimit

Raportet e Monitorimit 4 mujor, 8 mujor dhe 12 mujor të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2022, 2023 nuk janë përcjellë me shkresë zyrtare fillimisht në Drap Durrës dhe më pas në MAS, në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore". Raporti i monitorimit është dërguar me email vetëm tek Drap Durrës në formë aneksi (tabelore).

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2023, është përcjellë me shkresën nr. 63, datë 30.01.2024 në MAS, brenda afatit ligjor.

Raporti i Monitorimit 4 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. 226, datë 17.05.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës.

Raporti i Monitorimit 8 mujor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2024, është përcjellë me shkresën nr. 637/1, datë 19.09.2024 brenda afatit ligjor ne DRAP Durrës

Raporti i Monitorimit 12 mujor i Zyrës Vendore Arsimorë Rrogozhinë për vitin 2024, është

përcjellë me shkresën datë 13.01.2025 në MAS, brenda afatit ligjor në MAS.
Nga auditimi u konstatua se subjekti ka dorëzuar raportin e monitorimit periodik, por ky raport rezulton i pa protokolluar.
Raportet e Monitorimit 4 mujor dhe 8 mujor të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2025, nuk janë përcjellë me shkresë zyrtare fillimisht në Drap Durrës dhe më pas në MAS duke qenë në kundërshtim me udhëzimin nr. 14 datë 30.05.2023 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore".
Raporti i Monitorimit vjetor i Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë për vitin 2025, është përcjellë me shkresën nr. 14, datë 13.01.2026 në MA, brenda afatit ligjor në MAS.
Nga auditimi u konstatua se subjekti ka hartuar raportin e monitorimit periodik , por ky raport nuk shoqërohet me relacion shpjegues duke mos mundësuar analizën e plotë të realizimit të objektivave dhe përdorimit të fondeve duke rënë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin "i cili kërkon që njësitë publike të sigurojnë raportin e plotë të saktë dhe të besueshëm mbi performancën dhe përdorimin e fondeve dhe me udhëzimin e ministrisë së financave nr. 16 date 17.11.216 "Për monitorimin e performancës së njësive te qeverisjes së përgjithshme "i cili përcakton detyrimin e raportimit periodik te shoqëruar me analizë dhe shpjegime shpjeguese mbi realizimin e treguesve.
Rezulton se ZVAP Rrogozhinë nuk ka paraqitur në relacion arsyet dhe shkaqet e mosrealizimit të projekteve që janë planifikuar por nuk janë realizuar deri në fund të vitit. Gjithashtu nuk ka paraqitur në relacion përshkrimin e institucionit dhe plotësimin e një liste për përmbajtjen e raportit të monitorimit në kundërshtim me udhëzimin nr.14 datë 30.05.2023 *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"* përkatësisht me shtojcën nr.3 të raport monitorimit pika 1dhe 2 e saj.
Grupi i auditimit konstaton se nga ana e institucionit, nuk janë zbatuar kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 51 "Raporti i monitorimit", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 14, datë 30.05.2023, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ku shprehimisht përcaktohet që: "Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe institucionet konsiston në publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të çdo ministrie/institucioni" Në faqen zyrtare të ZVAP Rrogozhinë nuk janë publikuar raportet e monitorimit të buxhetit për vitet 2022,2023,2024 dhe 2025.
Për vitin 2022,2023,2024 dhe 2025 ZVAP Rrogozhinë nuk ka gjeneruar të ardhura dytësore.

2.2 Mbi zbatimin e legjislacionit për prokurimin e fondeve publike, zbatimi i kontratave si dhe shpenzimet e tjera të kryera.

2.2.1 Mbi zbatimin e legjislacionit për prokurimin e fondeve publike, zbatimi i kontratave.

DRAP Tiranë Viti 2025

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 15/2024 "për buxhetin e vitit 2025", të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimet publike", i ndryshuar, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 571, datë 18.11.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit para universitar", DRAP Tiranë me shkresë nr. 156 Prot, datë 10.02.2025 ka dërguar në MAS dhe Degën e Thesarit Tiranë, regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2025.
Regjistri i parashikimeve ka pësuar ndryshime me shkresat nr. 615/1 Prot, datë 12.05.2025 me te cilën është kërkuar shtim i elementit "Blerje bileta për jashtë", shtesa 1,000,000 lekë, me shkresë nr. 1444 Prot, datë 19.09.2025 për "*Trajnim mësuesish për kurrikulën e re*" me pakësim 1,773,390 lekë (pa tvsh) si ndryshim (shtesë) për "Printimi materialeve te mësuesve" shtese 1,773,390 lekë

(pa tvsh), “Pasurimi Bibliotekave me te drejtë autori” shtesë 6,319,244 lekë (pa tvsh) dhe “Pasurimi Bibliotekave me libra me domen publik” shtesë 360,320 lekë (pa tvsh)

Për periudhën objekt auditimi DRAP Tiranë ka programuar sipas nevojave të njësisë, Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, duke parashikuar përkatësisht:

Për vitin 2025 sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, parashikuar për t’u kryer prokurime për 14 procedura prokurimi me fond limit **30,451,387** lekë (pa tvsh);

-Regjistri parashikimit 2025 *(në lekë)*

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit i Elementit te Regjistrit
1	Me negocim pa shpallje paraprake	1	6,319,244
2	Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar	1	12,907,995
3	Procedure e hapur - e thjeshtuar	3	7,397,161
4	Sistem dinamik	1	1,000,000
5	Blerje vogël	5	2,526,987
6	Blerje nën vlerën 100,000 leke	3	300,000
		14	**30,451,387**

Burimi: Regjistri Parashikimit te Prokurimeve; Punoi KLSH

Shumica e procedurave të tjera lidhet me prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, përmes procedurave si më poshtë:

Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit te kontratës me vlerë 6,319,244 lekë (pa tvsh) për pasurimin e bibliotekave me libra me te drejtë autori.

Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar në vlerë 12,907,995 lekë (pa tvsh) për mjete mësimore didaktike.

Prokurime me procedurë e hapur e thjeshtuar për shërbime për trajnim për drejtues te institucioneve arsimore para universitarë publik, trajnim për mësuesit për kurrikulën KL.1; KL.10; KL.11 për periudhën 2025-2025 dhe printimi manualeve te mësuesve për lëndën TIK, për Kl.1; Kl.2. Kl.3 në vlerë 7,397,161 lekë (pa tvsh); prokurim për blerje biletash për udhëtim jashtë vendit në vlerë 1,000,000 lekë (pa tvsh), blerje e vogël për letër dhe kancelari, blerje karburanti për automjet, blerje toner, trajnim për punonjësit specialiste te DRAP Tirane dhe blerje libra për pasurimin Bibliotekave të ZVA me domen publik, në vlerë 2,526,987 lekë (pa tvsh) dhe blerje nën 100,000 lekë për shërbime për Mirëmbajtje dhe riparim kompjuter, Materiale pastrimi dhe shërbim mirëmbajtje dyer, dritare, etj., në total 300,000 lekë (pa tvsh).

2.2.2 Realizimi i prokurimeve.

Për vitin 2025:

Realizimet e prokurimeve viti 2025 *(në lekë)*

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Nr. Prok.	Fondi Limit (pa tvsh)	Vlera Fituese (pa tvsh)
1	Procedure e hapur - e thjeshtuar	1	1,773,390	1,225,770
2	Sistem dinamik	1	1,000,000	790,000
3	Blerje vogël	2	854,239	591,958
		5	**3,627,629**	**2,607,728**

Burimi: Regjistri Realizimit te Prokurimeve 2023; Punoi KLSH

Sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve, janë zhvilluar gjithsej **5 procedura prokurimi**, me një fond limit total prej **3,627,629** lekë (pa tvsh) dhe një vlerë kontratash të lidhura prej **2,607,728** lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 72 % të fondit limit të llogaritur

Prokurimet e realizuara të tipit “Procedure e hapur e thjeshtuar” për printimin e manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK për DRAP Tiranë, procedurë e kryer nga Organi Qendror Blerës me procedurën e prokurimit REF-64566-10-13-2025, zhvilluar në datë 24,10,2024, me fond limit 1,773,390 lekë, me vlere fituese 1,225,770 lekë (pa tvsh) ose 69% e fondit limit të llogaritur.

Procedura “Blerje me vlerë të vogël”, u realizuan 2 (dy) procedura prokurimi, përkatësisht prokurimi për pasurimin e bibliotekave me libra me domen publikë për DRAP Tiranë me vlerë fituese 344,988 lekë (pa tvsh) dhe prokurimi për Blerje Letër dhe Kancelari me vlerë fituese 246,970 leke (pa tvsh).
Prokurime për blerje biletash për transporti ajror ndërkombëtar ne vlere 790,000 lekë.
Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar në vlerë 12,907,995 lekë (pa tvsh) për mjete mësimore didaktike, procedurë e anuluar nga OBP ne vitin 2025.
prokurime me procedurë e hapur e thjeshtuar për shërbime për trajnim për drejtues te institucioneve arsimore para universitarë publik , procedurë e pa realizuar në vitin 2025.
Nga auditimi u konstatua se për vitin 2025 DRAP Tiranë në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar të realizohen 14 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar 30,451,387 lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor njësia e prokurimit realizoi 5 procedura me fond limit 3,627,629 lekë ose 12 % të fondit të parashikuar.
Mos realizimi i procedurave të prokurimit sipas parashikimit bie ndesh me kërkesat e nenit 3 pika 1, 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik i cili duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.
Realizimi i regjistrit të prokurimeve

DRAP Tiranë	Regjistri i parashikimit të PP		Regjistri i realizimit të PP		Mosrealizim	Realizuar (%)
	nr.	Fondi Limit sipas regjistrit te parashikimit (pa tvsh)	nr.	Fondi Limit sipas regjistrit te parashikimit (pa tvsh)		
2025	14	30,451,387	5	3,627,629	-26,823,758	12%

(Burimi: DRAP Tiranë, Punoi KLSH)

Viti 2024 DRAP Durrës

2.2.1 Parashikimi i prokurimeve.

Për periudhën objekt auditimi DRAP Durrës ka programuar sipas nevojave të njësisë në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit, duke parashikuar përkatësisht:

-Regjistri parashikimit 2024 *(në lekë)*

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit i Elementit te Regjistrit
1	Me negocim pa shpallje paraprake	1	10,141,509
2	Procedure e hapur - e thjeshtuar	3	8,268,398
3	Blerje vogël	9	5,700,552
4	Blerje nën vlerën 100,000 leke	9	683,241
		22	**24,793,701**

(Burimi: Regjistri Parashikimit te Prokurimeve; Punoi KLSH)

Me shkresë nr. 250 Prot, datë 22.01.2024 DRAP Durrës ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimit publik për vitin 2024 në MAS dhe Degën e Thesarit Durrës në total parashikuar prokurime në vlerë 25,648,000 lekë pa tvsh.
Me shkresë nr. 1608 Prot, datë 15.07.2024 ka njoftuar ndryshimet në regjistrin e parashikimeve, duke ndryshuar (shtuar), sipas fondeve të alokuara nga MAS me shkresë nr. 4442 Prot, datë 11.07.2024.
Sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, i ndryshuar parashikuar për t’u kryer prokurime për 22 procedura prokurimi me fond limit 24,793,701 lekë (pa tvsh);
Shumica e procedurave të tjera lidhet me prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, përmes procedurave si më poshtë:
Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit te kontratës 1 procedure me vlerë 10,141,509 lekë (pa tvsh) për pasurimin e bibliotekave me libra me te drejtë autori.

Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar 3 procedura në vlerë 8,268,398 lekë (pa tvsh) përkatësisht: 1 procedurë për mjete mësimore didaktike deleguar te OBP përllogaritur ne vlere 2,426,732 lekë, 1 procedure për trajnim për mësues te arsimit baze dhe arsimit te mesëm te larte me fond limit te parashikuar 4,591,667 Lekë, dhe 1 procedurë për trajnim për punonjësit e stafit te DRAP Durrës me fond limit 1,250,000 lekë.

Procedure blerje e vogël, gjithsej 9 procedura me fond limit të llogaritur 683,241 lekë për blerje karburant ne vlere 5,700,552 lekë, për shpenzime për karburant në vlera 375,000 lekë; Shpenzime Udhëtimi dhe fjetje për nxënës dhe stafin shoqërues për Aktivitete Sportive te shkollës "Benardina Qerraxhia". Për periudhën Janar Qershor 2024 përllogaritur 850,000 lekë, stërvitje dimërore shkolla Sportive "Benardina Qerraxhia" përllogaritur 950,000 lekë, shpenzime udhëtimi dhe fjetje për nxënës dhe stafin shoqërues për aktivitete sportive te shkollës "Benardina Qerraxhia". Për Periudhën Shtator Dhjetor 2024 përllogaritur 755,167 lekë, programi jomësimor ART dhe Zeje, "Teatër Grim" përllogaritur 395,010 lekë, programi jomësimor ART dhe Zeje, "Libra" përllogaritur 373,585 lekë, programi jomësimor ART dhe Zeje, "Pikturë" përllogaritur 930,067 lekë, programi jomësimor ART dhe Zeje, "Vegla muzikore "përllogaritur 984,224 lekë, etj.

2.2.2 Realizimi i prokurimeve.

Realizimet e prokurimeve viti 2024 *(në lekë)*

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri Prok.	Fondi Limit sipas regjsitrit te parashikimit (pa tvsh)	Fondi Limit i prokurimit (pa tvsh)	Vlera fituese (pa tvsh)
1	Negocim pa shpallje	1	10,141,509	9,105,955	9,101,520
2	Blerje vogël	10	7,152,922	6,797,272	4,646,013
	Total	**11**	**17,294,431**	**15,903,227**	**13,747,533**

(Burimi: Regjistri Realizimit te Prokurimeve 2024- DRAP Durrës; Punoi KLSH)

Sipas Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve për vitin 2024, janë zhvilluar gjithsej **11 procedura prokurimi**, parashikuar në regjistrin e prokurimeve me një fond limit total prej **17,294,431** lekë (pa tvsh), për të cilin u llogarit fond limit (pa tvsh) **15,903,227 lekë** dhe realizuar në vlerë kontratash të lidhura prej **13,747,533** lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 79% të fondit limit të parashikuar ose 86% te fondit limit të parashikuar sipas procedurës së prokurimit.

Prokurimet e realizuara të tipit "*Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës*" për prokurim libri artistik për pasurim fondi biblioteka te arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar, parashikuar në regjistrin e prokurimeve me një fond limit total prej 10,141,509 lekë (pa tvsh), për të cilin u llogarit fond limit (pa tvsh) 9,105,955 lekë dhe realizuar në vlerë kontratash të lidhura prej 9,101,520 lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 90% të fondit limit të parashikuar ose 100 % te fondit limit të parashikuar sipas procedurës së prokurimit

Procedura "*Blerje me vlerë të vogël*", u realizuan 10 (dhjetë) procedura prokurimi, përkatësisht prokurimi për pasurimin e bibliotekave me libra me domen publikë për DRAP Durrës parashikuar në regjistrin e prokurimeve me një fond limit total prej 7,152,922 lekë (pa tvsh), për të cilin u llogarit fond limit (pa tvsh) 6,797,272 lekë dhe realizuar në vlerë kontratash të lidhura prej 4,646,013 lekë (pa tvsh), që përfaqëson rreth 92% të fondit limit të parashikuar ose 86% te fondit limit të parashikuar sipas procedurës së prokurimit.

Këto prokurime kane patur objekt prokurimi mbulimin e shpenzimeve për blerjen e Manualeve TIK për nxënës të klasave te dyta, materiale për program pikture, vegla muzikore , për personat e teatrit grup mosha te ndryshme, në vartësi të DRAP Durrës. Shpenzime transporti dhe akomodim shkolla "Bernardina Qeraxhiu" si dhe për shpenzime për blerje gazoil për nevoja të institucionit.

Auditimi u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion dosjet me procedure e hapur e thjeshtuar mbi kufirin e larte monetar dhe procedure e hapur e thjeshtuar.

Viti 2023 DRAP Durrës

Regjistri parashikimit 2023

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit i Elementit te Regjistrit (pa tvsh)
1	Me negocim pa shpallje paraprake	1	10,750,000
2	Procedure e hapur - e thjeshtuar	7	14,379,227
3	Blerje vogël	6	2,446,212
4	Blerje nën vlerën 100,000 leke	8	704,889
		22	**28,280,328**

(Burimi: Regjistri Parashikimit te Prokurimeve; Punoi KLSH)

Me shkresë nr. 214 Prot, datë 20.01.2024 DRAP Durrës ka dërguar regjistrin e parashikimit të prokurimit publik për vitin 2023 në MAS dhe Degën e Thesarit Durrës në total parashikuar prokurime në vlerë 14 procedura prokurimi në vlerë 21,197,570 lekë pa tvsh.

Sipas regjistrit të parashikimit të prokurimeve, i ndryshuar parashikuar për t'u kryer prokurime për 22 procedura prokurimi me fond limit 28,280,328 lekë (pa tvsh);

Shumica e procedurave të tjera lidhet me prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, përmes procedurave si më poshtë:

Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit te kontratës 1 procedure me vlerë 10,750,000 lekë (pa tvsh) për pasurimin e bibliotekave me libra me te drejtë autori.

Procedure e hapur e thjeshtuar 7 procedura në vlerë 14,379,227 lekë (pa tvsh) përkatësisht: 1 procedurë për mjete mësimore didaktike deleguar te OBP përllogaritur ne vlere 2,912,078 lekë, 1 procedure për trajnim për mësues te arsimit baze dhe arsimit te mesëm te larte me fond limit te parashikuar 4,591,667 lekë, dhe 1 procedurë për trajnim për punonjësit e stafit te DRAP Durrës me fond limit 1,250,000 lekë.

Procedure blerje e vogël, gjithsej 9 procedurë me fond limit te llogaritur 683,241 lekë për blerje karburant ne vlere 450,000 lekë, shpenzimet jane parashikuar per shpenzime udhëtimi dhe fjetje për nxënës dhe stafin shoqërues për aktivitete sportive te shkollës "Benardina Qerraxhia" për periudhën shtator dhjetor 2024 në vlerë 906,200 lekë;; gazoil 10 PPM për nevoja te institucionit (karburant) ne vlere 450,000 lekë; mallra kancelari për nevoja te institucionit. ne vlere 115,000 lekë; toner për printer, fotokopje. . ne vlere 105,000 lekë; shpenzime udhëtimi dhe fjetje për nxënës dhe stafin shoqërues për aktivitete sportive te shkollës "Benardina Qerraxhia" për periudhën shtator dhjetor 2024 ne vlerë 906,200 lekë; programi jomësimor art dhe zeje, teatër grim ne vlere 474,012 lekë; programi jomësimor art dhe zeje, teatër libra ne vlere 396,000 lekë; shpenzime te tjera 4 procedura për taksa automjeti, internet e te tjera ne vlere 125,572 lekë

Procedura për blerje nën 100 mijë lekë 4 procedura përkatësisht shpenzime mirëmbajtje automjeti në vlere 97,000 lekë, siguracion automjeti në vlere 22,800 leke, shpenzime për mirëmbajtje padisje kompjuterike në vlerë 46,800 lekë, shpenzime për materiale pastrimi, higjenosanitare në vlerë 36,000 lekë

Regjistri realizimit 2023

Nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri Prok.	Fondi limit sipas regjisitrit të parashikimit (pa tvsh)	Fondi limit i prokurimit (pa tvsh)	Vlera fituese (pa tvsh)
1	Negocim pa shpallje	1	10,750,000	3,508,358	3,498,629
2	Blerje vogël	8	2,622,808	1,495,085	1,412,048
3	Nen 100 mjie	3	-	-	141,666
	Total	12	13,372,808	5,003,443	5,052,343

(Burimi: Regjistri Realizimit te Prokurimeve; Punoi KLSH)

Nga auditimi rezulton se realizimi i prokurimeve publike për vitin 2023 nga fondi i parashikuar 28,280,328 lekë (pa tvsh) për 22 procedura prokurimi u realizua për 12 procedura në vlerë 13,372,808 lekë ose realizuar 47%.
Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit te kontratës për pasurimin e bibliotekave me libra me te drejtë autori me fond të parashikuar me vlerë 10,750,000 lekë (pa tvsh), e ndare në 6 Lote, **u realizua me fond limit 3,508,358 lekë** ose 33% e fondit te parashikuar dhe vlerë kontrate 3,498,629 lekë.
Procedure e hapur - e thjeshtuar nuk është realizuar asnjë procedure prokurimi.
Procedurë blerje e vogël: Nga AK procedura e prokurimit për shpenzime transporti dhe akomodimi për Shkolla Bernardina Qeraxhia, është planifikuar si procedure e hapur e thjeshtuar, por është realizuar si procedure prokurimi blerje e vogël, sipas kalendarit sportiv të dërguar nga shkolla sportive për t'u realizuar gjate vitit buxhetor.
AK ka realizuar procedure prokurimi blerje e vogël, fondin limit 922,975 lekë, duke prokuruar 6 procedura prokurimi stërvitja dimërore me REF-61418-03-06-2023 me fond limit 414,100 lekë; shpenzime transporti për kampionat kombëtar me REF-61501-03-06-2023 me fond limit 55,833 lekë; shërbim transport dhe akomodim për shkollën sportive me REF-62702-03-16-2023 me fond limit 48,750 lekë; shërbim transporti për shkollën sportive me REF-63658-03-27-2023 me fond limit 160,666 lekë; shërbim transporti për nxënës, mësues dhe trajner te shkollës sportive me REF-67087-04-25-2023 me fond limit 146,000 lekë; shpenzime transporti mësues dhe nxënës stërvitja verore shkolla sportive me REF-78338-08-25-2023 me fond limit 110,000 leke
Si procedure blerje e vogël, janë realizuar edhe 2 blerje mallra kancelari me fond limit 184,833 leke dhe karburant për nevoja të institucionit me fond limit 375,000 lekë.
Procedurat e tjera nuk janë realizuar.

Viti 2022 DRAP Durrës

Regjstri i parashikimeve të prokurimeve për vitin 2022

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri prok.	Fondi Limit i Elementit te Regjistrit
1	Me negocim pa shpallje paraprake	N/A	N/A
2	Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar	N/A	N/A
3	Procedure e hapur - e thjeshtuar	N/A	N/A
4	Sistem dinamik	N/A	N/A
5	Blerje vogël	N/A	N/A
6	Blerje nën vlerën 100,000 leke	N/A	N/A
		N/A	N/A

DRAP Durres nuk paraqiti të dhëna dhe dokumntencaion për regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike 2022.

nr.	Lloji i procedurës së prokurimit	Numri Prok.	Fondi Limit sipas regjsitrit te parashikimit (pa tvsh)	Fondi Limit i prokurimit (pa tvsh)	Vlera fituese (pa tvsh)
1	Negocim pa shpallje	1	8,113,123	6,610,302	6,603,209
2	Blerje vogël	1	1,000,000	1,175,079	998,700
	Total	**2**	**9,113,123**	**7,785,381**	**7,601,909**

(Burimi: faqja zyrtare APP)
Nga auditimi u konstatua se DRAP Durrës për vitin 2024 në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar të realizohen 22 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar 24,793,701lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor ka realizuar 11 procedura me fond limit 17,294,431 lekë ose realizuar 70 % të fondit të parashikuar.
Për vitin 2023 në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar të realizohen 22

procedura prokurimi me fond limit të parashikuar 28,280,328 lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor ka realizuar 12 procedura me fond limit 13,372,808 lekë ose realizuar 47 % të fondit të parashikuar. Për vitin 2022 autoriteti kontraktor nuk paraqiti të dhëna për regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike. Për këtë vit buxhetor AK ka realizuar 2 procedura me fond limit 9,113,123 lekë.

Mos realizimi i procedurave të prokurimit sipas parashikimit bie ndesh me kërkesat e nenit 3 pika 1, 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*", sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik i cili duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.

Realizimi i regjistrit të prokurimeve

DRAP Durrës	Regjistri i parashikimit të PP		Regjistri i realizimit të PP		Mosrealizim	Realizuar (%)
	nr.	Fondi Limit sipas regjistrit te parashikimit (pa tvsh)	nr.	Fondi Limit sipas regjistrit te parashikimit (pa tvsh)		
2024	22	24,793,701	11	17,294,431	-7,499,270	70%
2023	22	28,280,328	12	13,372,808	-14,907,520	47%
2022	N/A	N/A	2	9,113,123	N/A	N/A

(Burimi: DRAP Durrës, punoi KLSH)

<u>Viti 2025</u> (DRAP Tiranë)

Prokurimi me objekt me objekt "*Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*".

a. *Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*"		
1. Urdhër Prokurimi Nr.3278 Prot, datë 13.10.2025 (lëshuar nga OBP)		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Procedure e hapur e thjeshtuar për mallra;	3. Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit: (OBP)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave**: (OBP)**
5. Fondi Limit: 1,773,390 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "I": 1,225,770 lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 547,620 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së Prokurimit: (OBP)	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b)S'kualifikuar: 0
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e kontratës: Kontratë nr. 1848 Prot, datë 19.11.2025	15. Vlera e kontratës 1,470,924 lekë (me TVSH)	16. Likuiduar në shumën 1,470,924 Lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (zero) Lekë.
17- Situacioni përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar=10 ditë kalendarike; Zbatuar = 10 ditë kalendarike	19. Zgjatja e kontratës (jo)
Sigurim kontrate: Sigurim Kontrate lëshuar nga ALBSIG sha, datë 18.11.2025, në vlerë 147,092 lekë	23.Akt i marrjes në dorëzim Akt Marrje në dorëzim nr.1904/1 Prot, datë 02.12.2025	24. Fletë Hyrja Fletë Hyrje nr. 03 datë 02.12.2025.

Ngritja e Komisioneve

Komisioni të Testimit të Tregut dhe **Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe Llogaritjen e Fondit Limit,** i ngritur me Urdhër nr. 59 Prot, datë 27.08.2025 , me Protokoll nr. 1195 Prot, datë 27.08.2025, **i përbërë nga:**

- E.F, specialiste për buxhetin dhe investimet;
- G.K, specialist për burimet njerëzore,
- E.E, specialiste kurrikule.

Njësia e Prokurimit ngritur me Urdhër Prokurimi nr. 3278 Prot, datë 13.10.2025, lëshuar nga **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara** me përbërje si më poshtë:

- K.T, (**OBP**), person përgjegjës për prokurimin
- A.M, (**OBP**), anëtar i njësisë së prokurimit

- M.D, (**OBP**), anëtar i njësisë së prokurimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, (OBP)

Grupi i punës për verifikim dhe marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 112 Prot, datë 02.12.2025, me Protokoll nr. 1904 Prot, datë 02.12.2025, i përbërë nga:

- E.F, specialiste,
- E.F, specialiste
- E.E, specialiste.

➢ **Planifikimi i nevojave**

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKPA), **me shkresën nr. 2111 Prot., datë 25.08.2025**, i ka dërguar një shkresë DRAP Tiranë dhe DRAP-ve të tjera, marrjen e masave lidhur me pajisjen e mësuesve dhe nxënësve me manualet e lëndës TIK për klasat e para, të dyta dhe të treta, për vitin shkollor 2025–2026, në kuadër të zbatimit të projekteve "Element IT" dhe "SmartLabs".

Në shkresë përcaktohet se, në zbatim të nenit 6, pika gj), h) dhe i) të Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 13.08.2025, "Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar", mbi zbatimin e programit mësimor të lëndës së TIK në të gjitha shkollat e pajisura me SmartLab, për klasat I, II dhe III, si dhe të programit mësimor për klasën IV në shkollat e mbështetura nga projekti "Element IT", miratuar me Urdhrin e Ministrit të MAS nr. 344 Prot., datë 21.07.2025, si dhe në shkolla të tjera ku janë ndërtuar laboratorë SMART, në kuadër të financimeve të ndryshme dhe me partnerë zhvillimorë të MAS, në zbatim të shkresës nr. 24/050 Prot., datë 09.04.2024, të Albania-American Development Foundation (AADF), drejtuar MAS, **mbi autorizimin për shumëfishimin dhe shpërndarjen e materialeve të kurrikulës TIK** për klasat I, II dhe III gjatë kohëzgjatjes së projektit, janë përcjellë të dhënat e dërguara nga secili DRAP mbi numrin e mësuesve dhe nxënësve që duhet të pajisen me manualet e lëndës TIK.

Autorizim është konsideruar shkresa nr. 24/050 datë 09.04.2024 e Albanian American Development Foundation (AADF) bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit (MoU), në të cilin në pikës 4.1 për të drejtën e pronësisë intelektuale jep të drejtën jo ekskluzive dhe pa kundërshpërblim MAS për të përdorur këto materiale gjatë kohëzgjatjes së MoU-së, për qëllim të zbatimit të projektit. Për këtë arsye ne përgjigje të shkresës së MAS nr. 2284 Prot, datë 03.04.2024, **miratojnë kërkesën e saj për shumëfishim dhe shpërndarje** përgjatë kohëzgjatjes së Projektit, të materialeve të Kurrikulës TIK për klasën I, II dhe III , nga MAS **sipas formatit origjinal nga AADF**.

AKAP me email datë 25,08,2025 ka dërguar në DRAP Tiranë marrjen e masave për pajisje me manualet e TIK , sipas të dhënave të pasqyruara për secilin DRAP.

Në vijim, janë dërguar të dhënat për secilin DRAP mbi numrin e mësuesve dhe nxënësve që do të pajisen me manualet e lëndës TIK për klasat I, II dhe III, për vitin shkollor 2025–2026, në kuadër të projekteve "Element IT" dhe "SmartLabs".

DRAP Tiranë **me shkresë nr. 1444/1 Prot, datë 19.09.2025** ka njoftuar Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, dhe Degën e Thesarit Tiranë, për ndryshim (shtesë) në regjistrin e parashikime të prokurimit publik për vitin 2025, duke shtuar objektin "*Printimi i manualeve të nxënësve dhe mësuesve për klasën parë , të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*", me fond limit 1,773,390 lekë (pa tvsh)për DRAP Tiranë

DRAP Tiranë, ne regjistrin e parashikimeve të prokurimeve për vitin 2025, dërguar në MA dhe Degën në Thesarit Tiranë me shkresë nr. 156 Prot, datë 10.02.2025 nuk ka parashikuar procedurën e prokurimit me objektin "*Printimi i manualeve të nxënësve dhe mësuesve për klasën parë , të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*".

Ky objekt prokurimi është shtuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të DRAP Tiranë për t'u realizuar në muajin dhjetor 2025**.** Me shkresën nr. 1444/1 Prot., datë 19.09.2025, është njoftuar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, si dhe Dega e Thesarit Tiranë, **për shtesën** në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2025, duke përfshirë objektin "Printimi i manualeve të nxënësve dhe mësuesve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK", me fond limit 1,773,390 lekë (pa TVSH).
Kjo shtesë procedure prokurimit e ka burimin te shkresa nr. 2111 Prot., datë 25.08.2025 e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), dërguar për 5 (pesë) Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar për marrjen e masave lidhur me pajisjen e mësuesve dhe nxënësve me manualet e lëndës TIK për klasat e para, të dyta dhe të treta, për vitin shkollor 2025–2026, bazuar në nenin 6 germa gj) h) i) në Udhëzimin e Përbashkët nr. 20, datë 13.08.2025 "*Për vitin shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar*".
Nga auditimi u konstatua se DRAP Tiranë ka ndryshuar regjistrin e parashikimit të prokurimeve për t'u realizuar në muajin dhjetor 2025 sipas shkresës nr. 2111 Prot., datë 25.08.2025 e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar.
Me shkresë nr. 1444/1 Prot., datë 19.09.2025, AK ka njoftuar Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, si dhe Dega e Thesarit Tiranë, për shtesën në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2025, duke përfshirë objektin "*Printimi i manualeve të nxënësve dhe mësuesve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*", me fond limit 1,773,390 lekë (pa TVSH), veprim në kundërshtim me nenin 3, pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, sipas të cilit regjistri i parashikimeve duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.
Vonesat në printimin e Manualeve nuk lidhen me mosparashikimin e saktë nga autoriteti kontraktor, por me procedurën e ndjekur nga Ministria e Arsimit për pajisjen me Manuale të lëndës TIK vetëm për klasat e para dhe të dyta, të cilat duhet të ishin në dispozicion të përdoruesve me fillimin e vitit shkollor 2025-2026, njësoj si tekstet shkollore.
Printimi i manualeve në muajin dhjetor 2025, për t'u përdorur nga mësuesit dhe nxënësit në zhvillimin e lëndës "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)" është jashtë çdo afati të arsyeshëm dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 7.1.a të Udhëzimit të Përbashkët nr.20, datë 13.01.2025 "*Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar*", sipas të cilit institucionet e arsimit bazë, të pajisura me Laboratorë Smart, kanë detyrimin të sigurojnë përdorimin e tyre në funksion të përmirësimit të procesit mësimor për të gjithë nxënësit, në zhvillimin e orës mësimore të lëndës TIK për klasat nga e para deri në të nëntën.
Llogaritja e fondit limit:
Komisioni të Testimit të Tregut dhe **Komisionit për Hartimin e Specifikimeve Teknike dhe Llogaritjen e Fondit Limit,** i ngritur me Urdhër nr. 59 Prot, datë 27.08.2025 , me Protokoll nr. 1195 Prot, datë 27.08.2025, ka nënshkruar Deklaratën e Konfliktit të Interesit datë 27.08.2025.
Komisioni për studimin e tregut për llogaritjen e fondit limit dërgon "Ftesë për Ofertë", për çmimit e tregut për shtypshkrim "Manual pune për nxënësit dhe mësuesit për lëndën TIK për klasat I, II dhe III", sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, me afat paraqitje deri 17.09.2025. Ftesat për ofertë i janë drejtuar 3OE si më poshtë vijon:

1- P.shpk, me shkresë nr. 1326 Prot, datë 08.09.2025;
2- I. shpk, me shkresë nr. 1327 Prot, datë 08.09.2025;
3- A. Shpk, me shkresë nr. 1328 Prot, datë 08.09.2025

Me Proces Verbal, datë 16.09.2025 Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe Llogaritjes së Fondit Limit, **evidenton tërheqjen nga ftesa për ofertë** të OE "I" me NIPT K..G. Në kushtet kur DRAP për studimin e tregut ka vetëm dy oferta të paraqitura, përkatësisht nga "P" dhe "A", ridërgon ftesë për një tjetër OE. Proces verbali është nënshkruar nga anëtarët e komisionit.

Në mungesë të disponimit të tre ofertave, Komisioni me shkresë nr. 195/3 Prot, datë 16.09,2025 dhe me email datë 19.09.2025 dërgon "Ftesë për Ofertë" operatori **E.**, duke kërkuar ofrimin e çmimit të tregut për njësi, për shtypshkrim Manual pune për lëndën TIK për klasat I, II dhe III për nxënësit dhe mësuesit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë. OE kanë paraqitur çmimet e tregut, me date 09.09.2025 nga "P" shpk, në datën 15.09.2025 nga "A" shpk dhe në datën 18.09.2025 nga shtëpia botuese "E" shpk, dërguar me email dhe Protokolluar në institucion,

Me **Proces Verbal nr. 1443/1 Prot, datë 19.09.2025,** Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe Llogaritjes së Fondit Limit ka llogaritur fondin limit me **vlerë 1,773,390 lekë** (pa tvsh). mbështetur në 3 (tre) ofertat e ardhura nga 3 OE.

Komisioni me shkresë nr. 1443 Prot, datë 19.09.2025 drejtuar Titullarit, bazuar në studimin e tregut , ka llogaritur çmimin mesatar për 3 ofertat e paraqitura, bazuar dhe në shkresën e MAS nr. 2111 Prot, datë 25.08.2025, ka argumentuar nevojat dhe specifikimet teknike për printimin e manualeve për lëndën TIK dhe **kërkon miratim** të procedurës së prokurimit me fondin limit me **vlerë 1,773,390 lekë** (pa tvsh) mbështetur në 3 (tre) ofertat e ardhura nga 3 OE.

M**e shkresë nr. 1443/2** Prot, datë 26.09.2025, Komisioni kërkon miratim të procedurës së prokurimit, mbi **Relacionin** e paraqitur për Titullarin, në të cilin ka evidentuar nevojat për shumëfishim dhe shpërndarje të materialeve të kurikulës TIK për klasën e I-rë, II-të dhe III-të, gjatë kohëzgjatjes së projektit për vitin shkollor 2025-2026, në DRAP Tiranë, bazuar në numrin e nxënësve dhe mësuesve në kuadër të zbatimit të projekteve "Element IT" dhe "SmartLabs", për klasat e I-III-ta. Komisioni si specifikim teknik ka përcaktuar manual me 17 faqe, me 2 (dy) kapak, me ngjyra sipas Manualit të AADF, lloji i lidhjes me ngjitje. Dizajni dhe printimi duhet të jetë i njëjtë si formati origjinal nga AADF.

Me Proces Verbal nr. 1443/3 Prot, datë 26.09.2025 për caktimin e fondit limit, për "printimin e materialeve të mesunëve dhe nxënësve për lëndën TIK për klasën e I, II, III-të", komisioni ka **llogaritur fondin limit 1,773,390 lekë pa tvsh**, dhe shtesën e procedurë së prokurimit në regjistrin e parashikimeve të vitit 2025.

Proces Verbali/et janë nënshkruar nga gjithë anëtaret e komisionit.

Komisioni i Testimit të Tregut njëkohësisht dhe Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike dhe Llogaritjes së Fondit Limit, **ka llogaritur Fondin limit në vlerë 1,773,390 lekë (pa tvsh).**

Llogaritja e Fondit Limit për manualet për lëndën TIK për vitin shkollor 2025-2026 **për DRAP Tiranë**

Llogaritja e fondit limit

Manual për lëndën TIK	Njësia	Sasia	P.	A.	E.	Çmim Mestar	Fondi Limit (pa tvsh)
Klasa e parë- Nxënës	Copë	6,352	36	95	9	76	482,882
Klasa e parë- Mësues	Copë	123	618	336	34	432	53,090
Klasa e dytë- Nxënës	Copë	6,441	61	92	9	83	534,636
Klasa e dytë- Mësues	Copë	123	618	339	98	352	43,250
Klasa e tretë- Nxënës	Copë	6,878	63	97	10	87	597,281
Klasa e tretë- Mësues	Copë	123	772	359	36	498	61,310
		20,040					**1,773,390**

(Burimi: DRAP Tiranë, Punoi KLSH)

Me shkresë nr. 1456 Prot, datë 22.09.2025, saktësuar më shkresë **nr. 1456/1 Prot, datë 30.09.2025**, **DRAP Tiranë** i është drejtuar me kërkesë Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara **(OBP)** për kryerjen e procedurës së prokurimit me objekt "*Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të trete për lëndën TIK në DRAP Tiranë*" për vlerën e përllogaritur të kontratës **1,773,390 lekë (pa tvsh), ma afat lëvrimi malli 10 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.**

Bazuar në VKM nr. 245, datë 17.04.2025 "Për përcaktimin dhe përllogaritje e tarifës për kryerjen e veprimtarive ndihmëse, për prokurimin publik nga shoqëria aksionare shtetërore OBP sha", AK për shërbimin e kërkuar ka paguar tarifën e kryerjes së shërbimit në vlerë 53,201 lekë (me tvsh) me USH nr. 49, datë 06.10.2025, për faturën tatimore nr. 400/2025, date 03.10.2025 lëshuar nga OBP, konform Aneksit nr. 1 të VKM nr. 245, datë 17.04.2024 përcaktohet 2.5% e vlerës

OBP, me shkresë nr. **3278/6**, datë **13.11.2025**, me objekt *"Formulari i njoftimit të fituesit, në përfundim të afateve të ankimit"*, në procedurën e prokurimit, bazuar në çmimin e paraqitur, ka njoftuar fituesin **"I" shpk.**, me NIPT **L.L**, se oferta ekonomike në vlerë **1,225,770 lekë (pa TVSH)** ose 1,470,924 lekë (me tvsh), është kualifikuar si **oferta fituese**. Me njoftimin e fituesit, operatori është i detyruar të paraqesë pranë **DRAP Tiranë** sigurimin e kontratës brenda afatit që do t'i përcaktohet nga AK.

OE për procedurën e prokurimit REF-64566-10-13-2025 ka dorëzuar Sigurim Kontrate lëshuar nga A.sha, datë 18.11.2025, në vlerë 147,092 lekë, para nënshkrimit të kontratës.

OBP me shkresën **nr. 3278/7 Prot, datë 14.11.2025** ka dërguar **dokumentacionin për lidhjen e kontratës** për procedurën e prokurimit "Prokurimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK", për DRAP, me afat lëvrimi 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me fond limit 1,773,390 lekë (pa tvsh). Me këtë shkresë informohet se OBP ka zhvilluar procedurën e prokurimit me REF-64566-10-13-2025 me objekt "Prokurimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK", për DRAP, me afat lëvrimi 10 ditë nga nënshkrimi i kontratës, me fond limit 1,773,390 lekë (pa tvsh). Bashkëlidhur dërgon:

1. *Urdhrin e prokurimit nr. 3278 Prot, datë 13.10.2025.*
2. *Formularin e njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit nr. 3278/6 Prot, datë 13.11.2025.*
3. *Formularin e Ofertës Ekonomike (Shtoja 1:Formulari Ofertës Ekonomike. datë 24.10.2025; Shtojca 2:.Lista e çmimeve te artikujve datë 24.10.2025).*
4. *Formularin e sigurimit të ofertë datë 24.10.2025.*
5. *Deklaratë për transportin dhe lëvrimin e mallrave.*
6. *Formularin përmbledhës i vetëdeklarimit.*
7. *Dokumentacioni teknik*

a. *Katalog pajisjes së printimit;*
b. *Certifikate ISO 9001:2015 për I. shpk, lëshuar nga AQS Cert, me status " I Akredituar" nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.*

Lidhja e kontratës

AK –Drap Tiranë, ka nënshkruar me fituesin "I" shpk, me NIPT L.L, ka nënshkruar Kontratë nr. 1848 Prot, datë 19.11.2025 "*Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të trete për lëndën TIK në DRAP Tiranë*, me çmim kontrate 1,225,770 lekë (pa tvsh) ose 1,470,924 lekë (me tvsh), me afat lëvrimi 10 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës, me transport me mjetet dhe shpenzimet e kontraktuesit.

Dorëzimi i mallit do të bëhet pranë DRAP Tiranë. Malli duhet të jetë i ri, i pa përdorur, dhe në

gjendje të mirë fizike, në përputhje të plotë me specifikimet teknike, pjesë e dokumentacionit të Prokurimit.
AK me shkrese nr. 1863/1 Prot, datë 20.11.2025 AK ka miratuar "Formulari i Njoftimit të Kontratës së nënshkruar".
AK me shkrese nr. 1863/2 Prot, 20.11.2025 ka njoftuar OBP për kontratën e nënshkruar ne forme shkresore.
Zbatimi i kontratës
Titullari me Urdhër i Brendshëm Nr. 112/2025, Prot. 1904, datë 02.12.2025 ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për verifikim dhe marrjen në dorëzim të mallit, në zbatim të Kontratës nr. 1848 Prot, datë 19.11.2025. .
Komisioni ka detyrë të bëjë marrjen në dorëzim në varësi të verifikimit të kryer.
Komisioni ka detyrë të hartojë aktin e marrjes në dorëzim sipas faturës tatimore shoqëruese.
Në zbatim të Urdhërit të Titullarit, Komisioni i marrjes në dorëzim në datën 15.10.2025 ka mbajtur "Aktin e Marrjes në dorëzim" Protokolluar me nr. 1904/1 Prot, datë 02.12.2025.
Në aktin e marrjes në dorëzim Komisioni ka përcaktuar Manualin TIK për mësues dhe nxënës për klasën e pare, të dytë dhe të tretë, specifikimet për çdo manual .
Komisioni i marrjes në dorëzim pasi verifikoi sasinë e ardhur në magazinë për çdo artikull konstatoi se sasia, specifikimet dhe cilësia ishin konform kontratës nr. 1848 Prot, datë 19.11.2025
Komisioni vendosi pranim e mallrave dhe hyrjen në magazinë.
Akti i marrjes në dorëzim është firmosur nga anëtarët e Komisionit.
Titullari, ka urdhëruar kryerjen e pagesës për stampimin e Manualeve TIK për mësues dhe nxënës për klasën e parë, të dytë dhe të tretë me Urdhër shpenzim nr. 60, datë 11.12.2025 në shumën 1,470,924 lekë (me tvsh).
Likuidimi është shoqëruar në dokumentacion vërtetues:

- Urdhër prokurimi nr. 3278 date 13.10.2025 (OBP);
- Shkresa e OBP Protokolluar në DRAP Tirane më nr. 1826 Prot, dt. 17.11.2025 "*Njoftim për lidhje kontrate*."
- Kontratë nr. 1848 Prot., dt. 19.11.2025.
- Urdhër për zbatimin e kontratës nr. 1904 dt. 02.12.2025
- Akti i marrjes në dorëzim nr. 1904/1 Prot, dt.02.12.2024
- Faturë tatimore nr., 146/2025, datë 02.12.2025;
- Fletë Hyrje nr. 03, date 02.12.2025

Nga auditimit rezulton se Aktin e Marrjes në dorëzim, nr. 1904/1 Prot, dt.02.12.2024 është i njëanshëm, pasi nuk është nënshkruar nga operatori ekonomik I. shpk për të provuar dorëzimin e tij pranë AK, veprim në kundërshtim me nenin 9 të Kontratës nr. 1848 Prot., dt. 19.11.2025 sipas të cilës Kontraktuesi është i detyruar të dorëzojë mallin pranë AK, në kundërshtim me pikën 36 dhe 54 të Udhëzimit nr. 30/2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", sipas të cilave procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit duhet të përfshijë të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruara, dokumentacionin shoqërues përkatës, si dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme që i jep këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës.*
Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka hartuar Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës në kundërshtim me nenin 2 pika 2 gërma ll) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" sipas të cilit për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP.
Komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka përgatitur formularin e raportimit për zbatimin e kontratës,

i cili, pasi miratohet nga titullari, i përcillet APP-së veprim në kundërshtim me nenin 107 pika 6 germa f) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" sipas të cilit AK përgatit formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, i cili, pasi miratohet nga titullari, i përcillet APP-së.

Prokurimi me objekt me objekt "*Pasurimi i bibliotekave me libra me domain publik* për DRAP Tiranë, REF-62494-09-24-2025.

a. *Pasurimi i bibliotekave me libra artistik me domen publik për DRAP Tiranë*		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.82 Prot, datë 24.09.2025**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: **Blerje e Vogël**	3. **Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit:** Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël", ngritur me Urdhër nr.20 datë 12.03.2025, Protokolluar nr. 357 Prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar, si më poshtë: - A.K, përgjegjës SBNJSHS - Xh.B, specialist kurikule - A.S, specialist SBNJSHS	4. **Komisioni i Vlerësimit Ofertave**: Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël", ngritur me Urdhër nr.20 datë 12.03.2025, Protokolluar nr. 357 Prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar, si më poshtë: - A.K, përgjegjës SBNJSHS - Xh.B, specialist kurikule - A.S, specialist SBNJSHS
5. Fondi Limit: 383,320 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "P.R": 360,321 lekë (pa TVSH)	7. Diferenca me fondin limit 22,999 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së Prokurimit: 24-09-2025	9. Burimi Financimit - Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 8 (një) OE b)Skualifikuar: (2)
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** nr. 1475 dt. 24.09.2025	15. Vlera e kontratës **383,320** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: Faturë tatimore nr.19/2025, datë 15.10.2025 në shumën **383,320** Lekë (me Tvsh). Pa likuiduar (**zero**) Lekë.
17- Situacioni Përfundimtar(-)	18. Afati i kontratës në dite Zbatuar = 15 ditë kalendarike	19. Zgjatja e kontratës (-)
Sigurim kontrate:	23.**Akt i marrjes në dorëzim** nr. 1589/1 Prot, date 15.10.2025	**24. Fletë Hyrja** Flete Hyrje në magazinë nr. 03, date 15.10.2025

Ngritja e Komisioneve.

Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike, llogaritje fondi limit dhe studim tregu.

Titullari me Urdhër nr. 77 Prot, datë 12.09.2025, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për vlerësimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "*Pasurimin e bibliotekës se IAP-ve publike, nën juridiksionin e DRAP Tiranë*" me përbërje: Dh.M, përgjegjës kurrikule; E.F, specialiste për buxhetin dhe investimet; G.K, specialist për burimet njerëzore.

Anëtaret e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 19.09.2025

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 20 datë 12.03.2025, Protokolluar nr. 357 Prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 58, datë 27.08.2024, Protokolluar me nr. 194 Prot, datë 27.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë: A.K, përgjegjës SBNJSHS; Xh.H zëvendësohet me A.S, specialist SBNJSHS

Anëtaret e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 24.09.2025

Urdhër Prokurimi

Titullari DRAP Tiranë me Urdhër nr. 82 Prot, datë 23.10.2024 , Protokolluar me nr. 1465 Prot, datë 24.09.2025 ka urdhëruar kryerjen e prokurimit "Blerje e Vogël" me objekt "Pasurimi i bibliotekave me libra me domen publik për DRAP Tiranë".

- **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave**

Për shkak të procedurës së prokurimit "**Blerje e Vogël**", vlerësimi i ofertave kryhet nga **Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël**" ngritur me Urdhër nr. 20 datë 12.03.2025, Protokolluar nr. 357

Prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 58, datë 27.08.2024, Protokolluar me nr. 194 Prot, datë 27.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni.

- **Komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave**

Titullari DRAP Tiranë me Urdhër nr. 92 Prot, datë 14.10.2025, Protokolluar me nr. 1589 Prot, datë 14.10.2025 ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave procedura e prokurimit e llojit "Blerje e Vogël" me objekt "Pasurimi i bibliotekave me libra me domen publik për DRAP Tiranë " urdhëron:

Ngritjen e Komisionit për verifikim dhe marrje në dorëzim të mallit objekt prokurimi sipas Ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025 me përbërje si më poshtë: Znj. E.F specialiste per buxhetin dhe investimet; Znj. Xh.B , specialiste Inspektimi, Znj. Xh.B, specialiste statistike

Komisioni ka detyrë të bëjë marrjen në dorëzim në varësi të verifikimit të kryer.

Komisioni ka detyrë marrjen në dorëzim të mallit, sipas ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025 dhe të hartojë aktin e marrjes në dorëzim.

Parashikimi dhe çelja e fondeve të prokurimit publik.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, të ligjit nr. 97/2003 "për buxhetin e vitit 2024", të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Finance nr. 2, datë 24..01.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", Ministria e Financave me shkrese nr. 8888/1 Prot, datë 12.06.2025 ka miratuar transferimin e fondeve për shpenzime kapitale sipas tabelës bashkëlidhur sipas të cilës DRAP Tiranë i janë transferuar shpenzime kapitale si më poshtë vijon:

Me Kod M112624 ne vlere 4,252,000 lekë (për shkollat e arsimit bazë)
me Kod M112629 ne vlere 2,883,000 lekë (për shkollat e arsimit të mesëm)
Total **7,135,000 lekë**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. 3699/1 Prot, datë 24.06.2025, Protokolluar me nr. 897 Prot, datë 25.06.2025 ka dërguar në DRAP Tiranë shkresën e MF nr. 8888/2025 me objekt transferim fondi për shpenzime kapitale për librin artistik me te drejte autori dhe domen publik, në total 7,135,000 lekë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit në mbështetje të pikës 3.1 Urdhrit nr. 200, datë 07.05.2024 "Për miratimin e rregullores për pasurimin e bibliotekës se institucionit arsimor parauniversitar publik" me shkresë nr. 3682/4 Prot, datë 22.07.2025 ka dërguar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) **listën e titujve** rekomandues për pasurimin e bibliotekave të shkollave, me 888 tituj rekomandues te cilësuar në certifikatë me të drejte autori ose domen publik për vitin shkollor 2025-2026.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "*Për arsimin parauniversitar në RSH'*, i ndryshuar dhe VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, DRAP Tirane ka vijuar me kryerjen e procedurave të prokurimit për librin me domen publik.

Drap Tiranë në bazë të fondit të akorduar ka dërguar zyrtarisht fondin e llogaritur për librin artistik me domen publik sipas ZVAP-ve, sipas numrit të nxënësve në arsimin baze dhe të mesëm, me shkresat nr. shkresë nr. 131 dt. 11.08.2025; shkresë nr. 130 dt. 11.08.2025; shkresë nr. 129 dt. 11.08.2025; shkresë nr. 128 dt. 11.08.2025; shkresë nr. 127 dt. 11.08.2025.

Ndarja e buxhetit sipas ZVAP-ve për vitin shkollor 2025-2026

ZVAP	AMU	AML	Fondi AMU	Fondi AML	Total
	nxënës	nxënës	M112624	M112629	
ZVAP-Kamëz	12,392	2,759	598,236	344,171	**942,407**
ZVAP-Kavajë	2,796	635	135,023	79,232	**214,255**
ZVAP-Rrogozhine	1,155	297	55,759	37,049	**92,808**
ZVAP-Vore	2,812	693	135,752	86,698	**222,450**
ZVAP-Tiranë	68,921	18,725	3,327,230	2,335,850	**5,663,080**
	88,076	23,109	4,252,000	2,883,000	**7,135,000**

(Burimi : DRAP Tiranë)

Hartimi i dokumenteve të Prokurimit/kriteret e veçanta për kualifikim dhe llogaritja e Fondit Limit

Komisioni për Hartimin e Specifikimeve Teknike ka llogaritur fondin limit për sipas të dhënave të gjeneruara nga SMIP sipas kërkesës së ZVAP-ve dhe IAP-ve në juridiksion të Drap Tiranë sipas buxhetit të përcaktuar.

Mënyra e llogaritjes se fondit limit është bazuar ne çmimet e përcaktuara në listën e titujve te rekomanduar nga MAS me **shkresë nr. 3688/4 Prot, datë 22.07.2025.**

Komisioni i specifikimeve teknike ka hartuar Relacion për Titullarin me nr. 1442 Prot, datë 19.09.2025, i miratuar prej tij.

Nëpërmjet këtij Relacioni Komisioni evidenton nevojat e zyrave vendore për tu pajisur me libra artistik me të drejtë auditori dhe domen publik, duke llogaritur fond limit (pa tvsh) për:

1. Libra me te drejte autori për 437 tituj librash me fond limit 6,722,600 lekë (pa tvsh) dhe
2. Libra me domen publik, 81 tituj librash, për 371 artikuj me fond limit 383,320 lekë (pa tvsh**).**

Nga auditimi u konstatua se relacioni për titullarin nr. 1442 Prot, datë 19.09.2025, nuk përmban listën përfundimtare të gjeneruar nga SMIP për titujt e përzgjedhur nga IAP-et dhe ZVAP-et, në kundërshtim me pikën 11 të Udhezimit të MAS nr. 200, datë 07.05.2024 "Për miratimin e rreguores për pasurimin e bibliotekës së institucionit arsimor parauniversitar publik" sipas të cilit DRAP harton listën përfundimatre të titujve të përzgjedhur me numrin e kopjeve mbi bazën e kërkesës të gjeneruar nga SMIP, hartuar sipas kërkesës së IAP-ve e cila njëkohësisht duhet të dërgohet edhe zyrtarisht në DRAP/ZVAP (pika 10) si dhe në kundërshtim me nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Gjithashtu fondi limit i llogaritur për blerjen e librit artistik për 5 ZVAP-të nën juridiksion të DRAP Tiranë është llogaritur 7,135,000 lekë (pa tvsh) nga i cili 6,722,600 lekë (pa tvsh) për librin artistik dhe 383,320 lekë (pa tvsh) për librin me domen publik.

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr. 3699/1 Prot., datë 24.06.2025, Protokolluar në DRAP Tiranë me nr. 897 Prot., datë 25.06.2025, ka përcjellë shkresën e MF nr. 8888/2025 me objekt transferimin e fondit për shpenzime kapitale për librin artistik me të drejtë autori dhe domen publik, në vlerën totale 7,135,000 lekë. Procedura e prokurimit për librin artistik, me fond limit 6,722,600 lekë (pa TVSH), është zhvilluar nga OBP, ndërsa procedura për librin me domen publik, me fond limit 383,320 lekë (pa TVSH), është zhvilluar nga DRAP Tiranë nëpërmjet procedurës së prokurimit "Blerje e Vogël".

Duke qenë se këto procedura përbëjnë grup mallrash/shërbimesh të ngjashme, ato duhej të konsideroheshin në mënyrë të përbashkët për efekt të përllogaritjes së kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Vlera e përbashkët prej 7,135,000 lekësh (pa TVSH) tejkalon kufirin prej 1,000,000 lekësh në vit, për rrjedhojë përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" për prokurimin e librave me domen publik, me fond limit 383,320 lekë (pa TVSH), rezulton në

kundërshtim me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar,, sipas së cilës grupet e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, që zakonisht prokurohen njëherësh, nuk duhet të ndahen me qëllim përdorimin e kësaj procedure.
Gjithashtu, kjo praktikë bie në kundërshtim edhe me pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 5 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", datë 25.06.2021, sipas së cilës përdorimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të shërbejë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në të njëjtin grup, për shkak të ngjashmërisë ose funksionit të tyre kryesor."

Urdhër prokurimi

Përgjegjësi i sektorit te financës, me shkresë nr. 1460 Prot, datë 23.09.2025 ka kërkuar nga Titullari miratimin e procedurës së prokurimit për librin me domen publik për DRAP Tiranë, për vitin 2025, referuar specifikimeve teknike miratuar Relacion për Titullarin me nr. 1442 Prot, datë 19.09.2025.
Me Urdhër Prokurimi nr. 82 Prot, datë 24.09.2025, Protokolluar me nr. 1465, datë 24.09.2025 Titullari ka miratuar "**Prokurim Blerje e Vogël**", për procedurën e prokurimit "Pasurimi i bibliotekave me libra me domen publik për DRAP Tiranë".
Urdhër Prokurimi përmban objektin e prokurimi, llojin e prokurimit dhe sasinë për tu prokuruar **(371) artikuj për te cilët është përcaktuar titulli, autori, shtëpia botuese, sasia e kërkuar.**
DRAP Tirane me shkresë nr. 1475 Prot, datë 24.09.2025 ka ngarkuar ne SPE "Ftesë për Ofertë" për OE, të cilët duhet të paraqesin ofertën e tyre.
Data e zhvillimit të prokurimit do të jete 24.09.2025 ora 14:00 në SPE.
Në "**Ftese për oferte**" nr. 1475 dt 24.09.2025 janë përcaktuar titulli, autori, shtëpia botuese, sasia e kërkuar, specifikimet teknike.
Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet te paraqitet pranë AK brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në SPE, dhe duhet të dorëzojë :

1. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;
2. Ekstrat te regjistrit tregtar;
3. Vërtetim bankar për IBAN-in
4. Mostrat për secilin mall të kërkuar.
5. Afati i lëvrimit do të jetë 5 ditë pune.

Vlerësimi i Ofertave

Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël" ka kryer edhe vlerësimin e ofertave në SPE
Data e hapjes për pranimin e ofertave të ofertave 24-09-2025 ora 14:00
Data e mbylljes se pranimit të ofertave 25-09-2025, ora 14:00
Kriteri i vlerësimit është çmimi më i ulet.
Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël ka zhvilluar procedurën e prokurimit datë 25-09-2025, ora 14:00 dhe pas hapjes se procedurave ka konstatuar se pjesëmarrës në procedurë janë 8 OE nga të cilët **6 OE janë kualifikuar** fitues dhe **2 OE janë s'kualifikuar**, përkatësisht H..dhe N.H, pasi oferta e tyre është më e lartë se fondi limit.
Operatori ekonomik i klasifikuar i pari është E.K, me oferte 306.656 lekë, ka njoftuar ne SPE për tërheqje nga procedura e prokurimit dt 25.09.2025 ora 02:43:PM, mbajtur proces verbal date 25.09.2025.
Operatori i renditur i dyti, F, me ofertë 308,000 lekë, ka njoftuar ne SPE për tërheqje nga procedura e prokurimit dt 29.09.2025 ora 11:17:AM, mbajtur proces verbal date 29.09.2025
Operatori i renditur i treti, A., me ofertë 325,822 lekë, ka njoftuar ne SPE për tërheqje nga procedura e prokurimit dt 29.09.2025 ora 02:46:PM, mbajtur proces verbal date 01.10.2025

Operatori ekonomik i renditur i katërti, P.R, me ofertë në vlerën 344,988 lekë, është njoftuar nga Autoriteti Kontraktor më datë 01.10.2025, ora 12:07:57. Ky operator është paraqitur pranë DRAP Tiranë për dorëzimin e dokumentacionit më datë 06.10.2025, pra 6 ditë kalendarike pas tërheqjes nga gara të operatorit ekonomik të renditur i treti, A.., ose më shumë se një ditë pune pas njoftimit. Operatori ekonomik P.R është paraqitur për dorëzim dokumentesh në DRAP Tiranë date 06.10.2025 duke dorëzuar :

a. Listë çmimesh dt. 06.10.2025
b. Ekstrat QKB dt. 01.10.2025
c. Deklarate për përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe grafikun e realizmit te objektit te kontratës, dt. 06.10.2025;

Nga auditimi u konstatua se ftesa për ofertë mban datën 01.10.2025, ndërsa në SPE rezulton se dokumentacioni përkatës lidhur me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël është ngarkuar më datë 02.10.2025. Në këto kushte, afati minimal prej 24 orësh përfundonte më datë 03.10.2025 dhe jo në datën 06.10.2025. Veprimet e kryera rezultojnë në kundërshtim me parashikimet e ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025, sipas së cilës operatori ekonomik i radhës i renditur i pari duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në SPE, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*" sipas të cilës afati i përcaktuar nga AK në ftesën për ofertë për paraqitjen e dokumentacionit nga ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit dhe nuk duhet të përkojë në ditë pushimi (e shtunë, e diele, festa zyrtare)

- Nuk ka gjurmë të dorëzimit të mostrave të mallit të kërkuar për gjithë artikujt e përcaktuar, për listën e titujve te librave me Domen publik, veprim në kundërshtim me ftesën për ofertë nr. 1475 dt 24.09.2025 sipas të cilës operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se te shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë AK mostrat për secilin artikull si dhe në kunërshtim me pikën 10 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*" sipas të cilit kur AK ka nevojë për mostra për objektin që do të prokurohet duhet të ketë kujdes që mostra do t'i kërkohet vetëm OE të renditur në vend të parë përpara se të shpallet fitues dhe kështu me radhe ofertuesve të tjerë.
- Dokumentacioni i dorëzuar nga fituesi P.R nuk përmban numër dhe datë Protokolli të DRAP Tirane në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*" sipas të cilit dokumentacioni i kërkuar nga AK në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë duhet të dorëzohen nga OE fitues në zyrën e Protokollit të AK.

Kontrata

AK ka njoftuar "Ftese për Oferte" nr. 1475, datë 24.09.2025 janë përcaktuar titulli, autori, shtëpia botuese, sasia e kërkuar, specifikimet teknike, etj.

Zbatimi i kontratës

Titullari DRAP Tiranë me Urdhër nr. 92 Prot, datë 14.10.2025, Protokolluar me nr. 1589 Prot, datë 14.10.2025 ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave procedura e prokurimit e llojit "Blerje e Vogël" me objekt "Pasurimi i bibliotekave me libra me domen publik për DRAP Tiranë " urdhëron:

Komisioni ka detyrë të bëjë marrjen në dorëzim në varësi të verifikimit të kryer.

Komisioni ka detyrë marrjen në dorëzim të mallit, sipas ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025 dhe të hartojë aktin e marrjes në dorëzim.

Në zbatim të Urdhërit të Titullarit, Komisioni i marrjes në dorëzim në datën 15.10.2025 ka mbajtur "**Aktin e Marrjes në dorëzim**" Protokolluar me nr. 1589/1 Prot, datë 15.10.2025.
Në aktin e marrjes në dorëzim Komisioni ka përcaktuar listën e titujve të librave, autorin, shtëpinë botuese të librit, dhe sasinë në copë.
Lista e librave përfundon me 81 tituj librash.
Akti i marrjes në dorëzim është firmosur nga anëtarët e Komisionit.
Nga auditimit rezulton se Aktin e Marrjes në dorëzim, nr. 1589/1 Prot, datë 15.10.2025 **është i njëanshëm**, pasi **nuk është nënshkruar** nga operatori ekonomik P.R. për të provuar dorëzimin e tij pranë AK, veprim në kundërshtim me pikën 36 dhe 54 të Udhëzimit nr. 30/2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", sipas të cilave procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit duhet të përfshijë të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruara, dokumentacionin shoqërues përkatës, si dhe çdo të dhënë tjetër të nevojshme që i jep këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës.*
Titullari, ka urdhëruar kryerjen e pagesës për librin artistik me domen publik me Urdhër shpenzim nr. 50, datë 31.10.2025 më shumën 365,687 lekë (me tvsh 6%).
Urdhër shpenzimi mbështet në dokumentacion vërtetues:
- Urdhër prokurimi nr. 82 date 24.09.2025;
- Ftese për oferte nr. 1475 dt. 24.09.2025;
- Klasifikimi përfundimtar ne SPE dt. 25.09.2025;
- Akti i marrjes në dorëzim nr. 1589/1 Prot, date 15.10.2025;
- Faturë tatimore nr., 19/2025, datë 15.10.2025;
- Fletë Hyrje nr. 03, date 15.10.2025.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi personat përgjegjës si më poshtë:

1. *Titullari i AK znj. B.S, në cilësinë e mbikëqyrësit të gjithë procedurave të prokurimit të realizuara AK sipas konstatimeve të grupit te auditimit, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe neni 73 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Anëtarët e Komisionit par marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 112 Prot, datë 02.12.2025, me Protokoll nr. 1904 Prot, datë 02.12.2025, për mos nënshkrimin e Akt marrje në dorëzim nga dorëzuesi i mallit I. shpk, mos hartim formular raportimi për zbatimin e kontratës dhe mos hartim raport përmbledhës për zbatimin e kontratës i përbërë nga:

2. *E.F, specialiste.*
3. *E.F, specialiste.*
4. *E.E, specialiste.*

Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt "Pasurimin e bibliotekës se IAP-ve publike, nën juridiksionin e DRAP Tiranë", për mos përfshirje në Relacion për Titullarin me nr. 1442 Prot, datë 19.09.2025 të listës se titujve të gjenruar nga SMIP për të evidentuar përputhshmërinë e titujve të përcaktuar me kërkesën e IAP-ve , me përbërje:

5. *Dh.M, përgjegjës kurikule.*
6. *E.F, specialiste për buxhetin dhe investimet.*
7. *G.K, specialist për burimet njerëzore.*

Anëtarët e Komisioni të Prokurimit "Blerje e Vogël" ngritur me Urdhër nr. 20 datë 12.03.2025, Protokolluar nr. 357 Prot, datë 12.03.2025, i ndryshuar, pasi procedura e prokurimit të librit artitstik me certifikate autori dhe libri artistik me domen publik përbëjnë grup mallrash/shërbimesh të ngjashme, ato duhej të konsideroheshin në mënyrë të përbashkët për efekt

të përllogaritjes së kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Vlera e përbashkët prej 7,135,000 lekësh (pa TVSH) tejkalon kufirin prej 1,000,000 lekësh në vit, për rrjedhojë përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" për prokurimin e librave me domen publik, me fond limit 383,320 lekë (pa TVSH), rezulton në kundërshtim me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas së cilës grupet e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, që zakonisht prokurohen njëherësh, nuk duhet të ndahen me qëllim përdorimin e kësaj procedure, si dhe në kundërshtim edhe me pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 5 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", datë 25.06.2021, sipas së cilës përdorimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të shërbejë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në të njëjtin grup, për shkak të ngjashmërisë ose funksionit të tyre kryesor" me përbërje si më poshtë:

8. *A.K, përgjegjës SBNJSHS*
9. *Xh.B, specialist kurikule*
10. *A.S, specialist SBNJSHS*

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit u paraqitur observacion nga DRAP Tirane me shkresën nr. 1222/1 prot, datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/12 prot, datë 20.07.2026 lidhur me Projekt Raport Auditimin.

Pretendimi i subjektit: Lidhur mbi gjetjen nr. 16 të PRA, subjektit i audituar arsyeton se me mosrealizimin e një pjesë të procedurave të prokurimit të parashikuara në Regjistrin e Prokurimeve për vitin 2025, sqarojmë se ky konstatim duhet të vlerësohet në raportin me rrethanat faktike dhe administrative në të cilat ka ushtruar veprimtarinë e saj DRAP Tiranë, gjatë viti të parë të funksionimit të saj.

DRAP Tiranë ka filluar funksionimin efektiv të saj në datën 01.01.205, Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar". Për rrjedhojë PBA 2025 nuk është hartuar nga DRAP Tiranë, pasi në periudhën e planifikimit buxhetor institucioni ynë nuk kishte filluar veprimtarinë ë tij. Fondet buxhetore dhe zërat e shpenzimeve janë përcjellë në MA me shkresë nr. 8208/3 prot, datë 24.01.2025, në të cilën janë përcaktuar fonde dhe zëra buxhetore që do të administrohen nga institucioni gjatë vitit ushtrimor.

Gjatë vitit 2025 institucioni ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, duke patur mungesa në disa pozicione organike, përfshirë specialistë të fushës juridike dhe personel mbështetës, të cilët kanë rol të rëndësishëm në administrimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit.

Gjithashtu për një pjesë e zërave të planifikuar në buxhet, nuk janë administruar kërkesat nga strukturat përgjegjëse për inicimin e procedurave të prokurimit. Në mungesë të nevojës së dokumentuar dhe kërkesës përkatëse ,nuk janë krijuar kushtet administrative për zhvillimin e procedurave të planifikuara.

Theksojmë regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike është një instrument planifikimi , i cili hartohet mbi bazën e nevojave të parashikuara dhe në përputhje me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", mund të pësojë ndryshime gjatë vitit buxhetor, në varësi të nevojave reale të institucionit, fondeve të disponueshme dhe kërkesave të strukturave përfituese.

Në këto kushte, mosrealizimi i një pjesë të procedurave të prokurimit të parashikuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të vitit 2025, nuk lidhen me mosveprim apo neglizhencë, por me rrethana objektive që lidhen me fazën e krijimit dhe konsolidimit të institucionit, mënyrën e planifikimit dhe administrimit të fondeve në vitin e parë të funksionimit, si dhe mungesën e kërkesave konkrete për zhvillimin e disa procedurave të planifikuara.

Qëndrimi i grupit të auditimit. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit

Parauniversitar", DRAP Tirane ka filluar funksionimin efektiv në datën 01.01.2025 që përkon me vitin buxhetor 2025.
Në bazë të nevojave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti/enti kontraktor institucioni juaj është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së sipas nenit 3 pika 1, 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, i cili duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik. Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike është një instrument planifikimi, i cili hartohet mbi bazën e nevojave të parashikuara dhe në përputhje me ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ai mund të pësojë ndryshime gjatë vitit buxhetor, por në funksion të nevojave reale të institucionit, fondeve të disponueshme dhe kërkesave të strukturave përfituese. Çelja e fondeve për vitin 2025 nuk rezulton e krijuar apriori, por mbi bazën e kërkesës në PBA, miratuar me çelje fonde nga buxheti i shtetit nga MA.
Argumenti se mosrealizimi i një pjesë të procedurave nuk ka ardhur si pasoje e mosveprimit të institucionit, por si rezultat i fazës së konsolidimit institucional, mungesës së plotësimit të strukturës dhe mungesës së kërkesave konkrete për zbatimin e procedurave të prokurimit, nuk është i mbështetur në ligj, dhe si i tillë nuk pranohet nga grupi i auditimit dhe do të trajtohet në Raport Përfundimtar Auditimi.

Pretendimi i subjektit: Lidhur mbi gjetjen nr. 17 të PRA për mosparashikimin në fazën të procedurës së prokurimit me objekt "Printimi i manualeve të mësuesve të klasës së parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK", sqarojmë se ky vlerësim duhet të vlerësohet në raport me kompetencat e DRAP Tiranë dhe mënyrën e krijimit të nevojës për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi. Planifikimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve nuk përbën një nevojë qe planifikohet apo përcaktohet në mënyrë të pavarur nga DRAP Tiranë, por krijohet vetëm mbi bazën e kërkesës zyrtare të Ministrisë ë Arsimit dhe AKAP, të shoqëruar me fondin buxhetor përkatës. Për rrjedhojë DRAP Tiranë, nuk kishte kompetencë ligjore për ta planifikuar paraprakisht këtë procedurë. Në rastin konkret jemi vënë në dijeni me shkresë nr. 2111 prot, datë 25.08.2025 të AKAP.
Me marrjen e shkresës institucioni ka ndërmarrë pa vonesë të gjitha veprimet administrative të nevojshme, duke proceduar me ndryshimin e regjistrit te parashikimit, drejtuar MA dhe Degës ë Thesarit me shkresë nr. 1444/1 prot, datë 19.09.2025. Ndryshmi i regjistrit , nuk ka ardhur si pasojë e mungesës ë planifikimit , por si rezultat i krijimit të një nevojë të re administrative dhe buxhetore, e cila nuk ekzistonte të momentin e hartimit te regjistrit fillestar. Ky veprim është në përputhje me ligjin nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021 të cilat lejojnë përditësimin e regjistrit në rast të krijimit të nevojave te reja përgjatë vitit buxhetor.
Nga administrimi i dokumentacionit , rezulton se sapo janë krijuar kushtet ligjore dhe financiarë për zhvillimin e procedurës, institucioni ka vepruar me prioritet maksimal, dhe ka ndërmarrë të gjitha verimet procedurale të nevojshme me qëllim garantimin e furnizimeve të institucioneve arsimore me manualet e mësuesve dhe nxënësve për fillimin e vitit shkollor 2025-2026.
Pra sa më sipër ndryshimi i regjistrit te prokurimeve për vitin 2025 dhe zhvillimi i procedurës , kanë ardhur si rezultat i administrimit të një kërkesë dhe fondit të akorduar gjatë vitit buxhetor, rrethana që nuk varen nga planifikimi apo vullneti i DRAP Tiranë, por nga vendimmarrja e MA dhe AKAP, për të cilën kërkomë rishqyrtimin në raport me kompetencat e AK dhe rrethanat konkrete në të cilat është zhvilluar procedura e prokurimit.
Qëndrimi i grupit të auditimit. Procedura e prokurimit për printim e Manualeve të lëndës TIK e ka burimin te shkresa nr. 2111 Prot., datë 25.08.2025 e Agjencisë Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), për marrjen e masave lidhur me pajisjen e mësuesve dhe nxënësve me manualet e lëndës TIK për klasat e para, të dyta dhe të treta, për vitin shkollor 2025–2026, bazuar në nenin 6 germa gj) h) i) në Udhëzimin e Përbashkët nr. 20, datë 13.08.2025 "Për vitin shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar".
AK ka shtuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të DRAP Tiranë për t'u realizuar në muajin dhjetor 2025. Me shkresën nr. 1444/1 Prot., datë 19.09.2025, është njoftuar Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Arsimit, si dhe Dega e Thesarit Tiranë, për shtesën në regjistrin e parashikimeve

të prokurimit publik për vitin 2025, duke përfshirë objektin "Printimi i manualeve të nxënësve dhe mësuesve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK", me fond limit 1,773,390 lekë (pa TVSH).Printimi i manualeve në muajin dhjetor 2025, për t'u përdorur nga mësuesit dhe nxënësit në zhvillimin e lëndës "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)", është jashtë çdo afati të arsyeshëm dhe në kundërshtim me kërkesat e nenit 7.1.a të Udhëzimit të Përbashkët nr.20, datë 13.01.2025 "Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar". Ky udhëzim përcakton se institucionet e arsimit bazë, të pajisura me Laboratorë Smart, kanë detyrimin të sigurojnë përdorimin e tyre në funksion të përmirësimit të procesit mësimor për të gjithë nxënësit, në zhvillimin e orës mësimore të lëndës TIK për klasat nga e para deri në të nëntën.
Vonesat në printimin e Manualeve nuk lidhen me mosparashikimin në regjistrin e prokurimeve publike nga autoriteti kontraktor, por me procedurën e ndjekur nga Ministria e Arsimit për pajisjen me Manuale të lëndës TIK vetëm për klasat e para dhe të dyta, të cilat duhet të ishin në dispozicion të përdoruesve me fillimin e vitit shkollor 2025-2026, njësoj si tekstet shkollore.
Për sa më sipër observacioni nuk pranohet nga grupi i auditimit dhe do të trajtohet në Raport Përfundimtar Auditimi.
Pretendimi i subjektit: Lidhur mbi gjetjen nr. 18 të PRA se Komisioni i ngritur për zbatimin e kontratës nuk ka krijuar një raport përmbledhës për realizimin e saj, sqarojmë se zbatim te ligjit të PP dhe aktit nënligjor në zbatim të tij, komisioni ka ndjekur zbatimin e kontratës, dhe ka përmbushur detyrimin për publikimin pranë APP të njoftimit të zbatimit të kontratës.
Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Kontrata është zbatuar sipas kushteve të saj, është marrë në dorëzim nga AK, dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të kërkuara gjatë fazës ë administrimit dhe përfundimit të kontratës, në përputhje me ligjin nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021.
Qëndrimi i grupit të auditimit. Në pikën 54 të Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përcaktohet se për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.
Sa më sipër procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit duhet të përshkruajë me saktësi dhe vërtetësi të gjithë mallrat e furnizuara me treguesit e tyre sasiorë, cilësorë dhe të vlerës, të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar, dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe çdo e dhënë e nevojshme që i japin këtij dokumenti forcën e një prove ligjore ose administrative, në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
Procesverbali i marrjes në dorëzim nga vetë titulli i tij përcakton dorëzuesin dhe pranuesin e mallit, të cilët nënshkruajnë dokumentin, duke i dhënë atij forcën e një dokumenti ligjor, për të legjitimuar të gjitha veprimet e kryera për verifikimin e mallrave të lëvruar.
Në observacionin bashkëlidhur mungon Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës dhe formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, mbi të cilat ju argumentoni perëndimin tuaj.
Sa më sipër observacioni nuk pranohet.
Pretendimi i subjektit: Lidhur mbi gjetjen nr. 19 të PRA se relacioni për titullarin nr. 1442 prot, datë 19.09.2025, nuk përmban listën përfundimtare të gjeneruar nga SMIP për titujt e përzgjedhur nga IAP-et dhe ZVAP-et, dhe përpara nxjerrjes së urdhër prokurimit nuk është dokumentuar fondi limit dhe vlera e kontratës, sqarojmë se ky dokumentacion nuk pasqyron në mënyrë të plotë dokumentacionin administrativ të administruar nga AK.
Relacioni për titullarin nr. 1442 prot, datë 19.09.2025 është hartuar nga grupi i punës me qëllim dokumentimin e nevojës për prokurim, argumentimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike, dhe përcaktimin e vlerës së kontratës.
Tabela e përfshirë në këtë dokumentacion, përbën tabelën përmbledhëse të hartuar nga gru[pi i punës, mbi bazën ë përzgjedhjes nga IAP-et në SMIP dhe përcjellja nga ZVAP si nëpërmjet sistemit edhe me shkresa (citohen shkresat).Sqarojmë se sistemi SMIP nuk gjeneron një listë përfundimtare të unifikuar, për të gjitha ZVAP-të, por lista gjenerohet veçmas për secilës prej tyre. Për këtë arsye grupi i punës ka

administruar listat e gjeneruara nga SMIP, i ka verifikuar ato me dokumentacion përcjellës zyrtar, dhe ka hartuar tabelën përmbledhëse, e cila është bëre pjesë e relacionit nr. 1442 prto, datë 19.09.2025. Mbi bazën e tabelës përmbledhëse është llogaritur fondi limit dhe janë hartuar specifikimet teknike. Vetëm pas miratimit të këtij relacioni është proceduar me nxjerrjen e urdhrit për fillimin e procedurës së prokurimit.

Lidhur mbi gjetjen nr. 20 të PRA për procedurën e blerjes së librave për pasurimin e bibliotekave të IAP-ve, sqarojmë se trajtimi i librave me të drejtë autori dhe librave me domen publik është kryer nëpërmjet dy procedurave të veçanta të prokurimit, të ndryshme me njëra tjetrën përsa i përket natyrës juridike te objektit, vlerës së përllogaritur, procedurës së zbatueshme dhe AK për zhvillimin e tyre.

Në zbatim të shkresës së MA nr. 3699/1 prot, datë 24.06.2025 , AK ka administruar fondin e akorduar për pasurimin e bibliotekave, fond i cili është ndarë sipas ZVAP-ve, sipas formulës së shpërndarjes së përcaktuar. Mbi bazën e nurit të nxënësve duke ja përcjellë secilës prej tyre me shkresa zyrtare.

DRAP Tiranë nuk ka ndikuar në përzgjedhjen e titujve të librave, por ka administruar kërkesat e ardhura nga ZVAP-të.

Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, ZVAP-te kanë përcjellë pranë DRAP Tiranë shkresat me nr. 689 prot, datë 25.08.2025, protokolluar me nr.1202, datë 25.08.2025; nr. 442/1 prot, datë 18.08.2025, protokolluar me nr. 1153 prot, datë 21.08.2025; shkresa nr. 1600 prot, datë 18.08.2025, protokolluar me nr. 1154, datë 21.08.2025, shkresa nr. 617, datë 13.08.2025, protokolluar me nr. 1140 prot, datë 14.08.2025 dhe shkresa nr. 1562 prot, datë 18.08.2025, protokolluar me nr. 1149 prot, datë 19.08.2025.

- 6,722,600 lekë pa tvsh për librat me të drejtë autorit;
- 383,320 lekë pa tvsh për librat me domen publik;

Për librat me të drejtë autori, procedura është trajtuar "me negocim pa shpallje", është përcaktuar mbi bazën e ekzistencës ë të drejtave ekskluzive dhe jo vetëm mbi bazën e vlerës së kontratës. Kjo procedurë zhvillohet me subjektin qe provon se disponon të drejtën ekskluzive të botimit ose shpërndarjes së titullit përkatës. Duke qenë se vlera e librave me të drejtë autorit është 6,722,600 lekë pa tvsh dokumentacioni i përcjellë për procedurë OBP.

Për librat me domen publik, procedura ka qene e veçante dhe juridikisht e ndryshme nga procedura e librave me të drejtë autori. Për këtë kategori nuk ekziston një e drejtë ekskluzive që e kufizon furnizimin vetëm në një shtëpi botuese apo në një OE të caktuar. Për rrjedhojë këta libra mund të ofrohen nga çdo OE që plotëson kërkesat e përcaktuara nga AK.

Vlera 383,320 lekë pa tvsh e prokurimit për librat me domen publik përcakton aplikimin e procedurës së thjeshtuar për prokurimin me vlerë nën kufirin e ulët monetar, përdorur nga DRAP Tiranë.

Kjo procedurë ka karakter konkurrues, pasi mundëson pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomike që janë në gjendje të ofrojnë objektin e kërkuar dhe që plotësojnë kushtet ligjore dhe teknike te procedurës.

Përfundimisht, procedura për libra më të drejtë autori dhe domen publik nuk përbëjnë një procedurë të vetme të ndarë artificialisht, por dy procedura të dallueshme te diktuara nga natyra t ndryshme juridike.

Grupi i auditimit arsyeton se AK duhet të dokumentojë përllogaritjen e fondit limit, në bazë te nenit 34 të Ligjit të PP dhe nenit 76 të VKM nr. 285/2021 duke pasqyruar informacion konkret se si është arritur në vlerën e përllogartur të fondit limit.

Në rastin konkret llogaritja e fondit limit nuk përmban listën përfundimtare të titujve të përzgjedhur me numrin e kopjeve mbi bazën e kërkesës të gjeneruar nga SMIP dhe të dhenave të dërguara nga ZVAP-të në shkresat e cituara nga ju.

Arsyetojmë se një kopje e këtij dokumetacioni duhet t'i bashkëlidhet proces verbalit të mbajtur për këtë qëllim si dokumentacion vërtetues për të pasqyruar informacionin e plotë mbi të cilin është përllogaritur vlera e fondit limit. Dokumteacioni i paraqiturnga ju duhet te rferohet ne proces verbale dhe relacionet e procedurs se prokurimit dhe duhet të përfshihen ne dosjen e auditimit si "Gjurma e Auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to sipas ligjit të MFK.

Argumentet tuaja lidhur me procedurën e prokurimit janë në përputhje me përdorimin e procedurës me vlerë të vogël nisur nga fondi limit i llogaritur për libra me Domen Publik, 81 tituj librash, për 371 artikuj me fond limit 383,320 lekë (pa tvsh).

Në këndvështirm të procedurës së përzgjedhur ky prokurim nuk duhet të procedohej si blerje e vogël pasi kjo procedurë prokurimi bie në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", sipas së cilës përdorimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të shërbejë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në të njëjtin grup, për shkak të ngjashmërisë ose funksionit të tyre kryesor" (trajtuar me sipër).
Në këndveshtrim të tratimit si blerje e vogël sipas Udhëzimit të APP nr. 5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pretendimi juaj qëndron pasi kuadri ligjor dhe Udhëzimet e APP-së që rregullojnë procedurat me vlerë të vogël nuk parashikojnë detyrimin për kërkimin e dokumentacionit të plotë provues mbi gjendjen juridike dhe observacioni pranohet dhe trajtohet në Projekt Raport Auditim.
Për sa më sipër observacioni nuk pranohet.
Lidhur mbi gjetjen nr. 21 të PRA Në lidhje me OE "P.R" sqarojmë se nga verifikimi i të dhënave të administruara në SPE rezulton se me datë 02.10.2025 OE ka dorëzuar në SPE dokumentacionin përkatës lidhur me procedurën e prokurimit blerje e vogël. Afati minimal prej 24 orë ka përfunduar në datën 04.10.2025, ndërkohë që datat 04.10.2025 dhe 05.10.2025 kanë qenë ditë pushimi zyrtarë (e shtune dhe e diel). Në këto kushte paraqitja e OE në datën 06.10.2025 është kryer brenda afateve ligjore dhe në përputhje me pikën 12 të udhëzimit nr. 5/2021 ku përcaktohet se OE duhet tu garantohet të paktën një ditë pune efektive për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit. Gjithashtu OE ka dorëzuar edhe mostrat përkatëse dhe dokumentacionin e kërkuar nga AK, duke garantuat vijimin e rregullt të procedurë së prokurimit. Për sa më sipër, vlerësojmë se AK ka zbatuar drejt dispozitat ligjore pa sjellë pasoja financiare apo cenim të vlefshmërisë së procedurës së prokurimit.
Qëndrimi i grupit të auditimit Veprimet e kryera rezultojnë në kundërshtim me parashikimet e ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025, sipas së cilës operatori ekonomik i radhës i renditur i pari duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor brenda ditës së nesërme të punës nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në SPE, pas përfundimit të afatit të ankimit dhe në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" sipas të cilës afati i përcaktuar nga AK në ftesën për ofertë për paraqitjen e dokumentacionit nga ofertuesi i renditur në vend të parë duhet të jetë minimalisht dita e nesërme e punës nga publikimi i njoftimit të fituesit dhe nuk duhet të përkojë në ditë pushimi (e shtunë, e diele, festa zyrtare)
- Nuk ka gjurmë të dorëzimit të mostrave të mallit të kërkuar për gjithë artikujt e përcaktuar, për listën e titujve te librave me Domen publik, veprim në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"
- Dokumentacioni i dorëzuar nga fituesi P.R nuk përmban numër dhe datë protokolli të DRAP Tirane në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".
Për sa më sipër observacioni nuk pranohet.

<u>Viti 2024</u> Drap Durrës:

"*Biblioteka 2024-2025 për librin artistik për pasurim fondi biblioteka te arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar*", me procedurë "Procedurë me negocim pa shpallje paraprake" .

a. *Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK*" 1. **Urdhër Prokurimi Nr.21 Prot, datë 01.11.2024** 2. **Urdhër Prokurimi nr. 22 Prot, datë 04.12.2024 (rishpallje procedure)**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "**Negocim pa shpallje paraprake**"	3. Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit: **Urdhër nr. 84 Prot, datë 30.10.2024** **Komision me përbërje:** 1. R.B, specialist Sektori i BNJSH; 2. Xh.T, specialist Sektori i BNJSH; 3. O.T, specialist Sektori i BNJSH.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: **Urdhër Prokurimi nr. 83 Prot, datë 30.10.2024.** **Komision me përbërje:** 1.M.M, specialist SIVC; 2.V.D, specialiste finance ZVAP Kamëz; 3.E.M, përgjegjëse SIVC.

5. Fondi Limit: Me Kod M112624= **6,084,905 lekë** me Kod M112624= **4,056,603 lekë** **Total =10,141,509** lekë (pa TVSH)	**5. Ofertat fituese:** Loti 1:"A"= 961,037 lekë; Loti2: "M"= 2,425,188 lekë; Loti 3: "I"=997,735 lekë; Loti 5: "O"=184,339 lekë; Loti 6: "D"=1,161,561 lekë; Loti 8: "F"= 102,830 lekë; Loti 9: "N"=157,700 lekë; Loti 10: "P"=92,500 lekë; Loti 11: "N"=208,500 lekë; Loti12: "P"=259,622 lekë; Loti14: "A"=2,444,943 lekë; Loti 16: "P.=110,000 lekë; **Total 9,105,955**	7.Diferenca me fondin limit **1,035,554** lekë (pa TVSH) ose 10.21%
8. Data e hapjes së Prokurimit: Dt 20,11,2024; Ora 13:00 Dt.06.12.2024; ora 13:00 (rishpallje)	9. Burimi Financimit Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 16 OE b) Fitues 12 OE b)Skualifikuar: 4OE
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** nr. 1847/87 Prot, datë 10.12.2024 nr. 1847/85 Prot, datë 10.12.2024 nr. 1847/83 Prot, datë 06.12.2024 nr. 1847/86 Prot, datë 10.12.2024 nr. 1847/81 Prot, datë 06.12.2024 nr. 1847/102 Prot, datë17.12.2024 nr. 1847/93 Prot, datë 13.12.2024 nr. 1847/84 Prot, datë 10.12.2024 nr. 1847/80 Prot, datë 06.12.2024 nr. 1847/78 Prot, datë 06.12.2024 nr. 1847/79 Prot, datë 06.12.2024 nr. 1847/82 Prot, datë 06.12.2024	15. Vlera e kontratës **9,613,487** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumën **9,613,487** lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (**zero**) lekë.
17- Situacioni Përfundimtar…	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar=.30 ditë kalendarike; Zbatuar = 18 ditë kalendarike (max)	19. Zgjatja e kontratës (jo)
Sigurim kontrate: Po	23.**Akt i marrjes në dorëzim** Po	**24. Fletë Hyrje** Po.

Urdhërat e prokurimit

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër nr. 82 Prot, datë 23.10.2024** , Protokolluar me nr. 1847/1 Prot, datë 23.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e **Komisionit për përcaktimin** e titujve të librit të bibliotekës sipas cikleve bazë dhe të mesëm më përbërje:

1. E. B, kryetar.
2. E.V, anëtar.
3. F.K, anëtar.

Komisioni I mësipërm do të verifikojë pajisjen me certifikatën e të drejtës së autorit **për listën përfundimtare të literaturës rekomanduese** për pasurimin e bibliotekave të institucioneve arsimore parauniversitar publike, të dërguara nga MAS, e cila është shkarkuar nga SMIP sipas përzgjedhjes nga ZVA dhe dërguar në DRDRAP Durrës me shkresë zyrtare.

Anëtarët e grupit të punës për studimin paraprak të tregut kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024.

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër i Brendshëm nr. 84 Prot, datë 30.10.2024** , Protokolluar me nr. 1847/49 Prot, datë 30.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e **Njësisë së Prokurimit** me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" për IAP-et në vartësi të DRAP Durrës me Komision me përbërje:

1. R.B, specialist Sektori i BNJSH.
2. Xh.T, specialist Sektori i BNJSH.
3. O.T, specialist Sektori i BNJSH.

Komisioni ka për detyrë përllogaritjen e fondit limit dhe përgatitjen e dokumenteve stadnard të Prokurimit në SPE për procedurën "*Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar*".

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 83 Prot, datë 30.10.2024** , Protokolluar me nr. 1847/47 Prot, datë 30.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave** me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" për IAP-et në vartësi të DRAP Durrës me Komision me përbërje**:**

1. M. M, specialist SIVC;
2. V. D, specialiste finance (*ZVAP Kamëz*);
3. E.M, përgjegjëse SIVC.

Komisioni ka për detyrë vlerësimin e ofertave të paraqitura në SPE për procedurën e prokurimit "Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar".

Anëtarët e KVO kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 21 Prot, datë 01.11.2024** , Protokolluar me nr. 1847/71 Prot, datë 11.11.2024 ka urdhëruar te realizohet procedura e prokurimit e llojit "Negocim pa shpallje paraprake" me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioetak arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" mre fond limit 10,750,000 lekë (pa TVSH) , e ndarë në **16 lote** Ngarkohet **Njësia e Prokurimit** për zbatimin e këtij urdhri me përbërje si më poshtë:

1. R.B, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.
2. Xh.T, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.
3. O.T, specialit, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.

Anëtarët e KVO kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 22 Prot, datë 04.12.2024 (rishpallje procedure)**, Protokolluar me nr. 1847/76 Prot, datë 04.12.2024 ka urdhëruar **te rishpallet** procedura e prokurimit e llojit "Negocim pa shpallje paraprake" me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioetak arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" mre fond limit 10,750,000 lekë (pa TVSH), e ndarë në **6 lote**. Ngarkohet **Njësia e Prokurimit** për zbatimin e këtij urdhri me përbërje si më poshtë:

1. R.B, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.
2. Xh.T, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.
3. O.T, specialit, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve.

Anëtarët e KVO kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024

➢ Titullari DRAP Durrës me **Urdhër nr. 93 Prot, datë 06.12.2024**, Protokolluar me nr. 1847/77 Prot, datë 06.12.2024 ka urdhëruar **ngritjen e Komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave** procedura e prokurimit e llojit "Negocim pa shpallje paraprake" me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioetak arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" mre fond limit 10,750,000 lekë (pa TVSH), e ndarë në 6 lote, me përbërje si më poshtë:

1. Xh.V.
2. A. V.
3. E. B.

Anëtarët e KVO nuk kanë nënshkruar deklartat e konflktit të interesit datë 30.10.2024.

Parashikimi dhe çelja e fondeve të prokurimit publik.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar, të ligjit nr. 97/2003 "për buxhetin e vitit 2024", të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "për procedurtat standarde të zbatimit të b uxhetit", i ndryshuar, të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Fianace nr. 836/1, datë 19.02.2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. 816/2 Prot, datë 23.02.2024, Protokolluar me nr. 650 Prot, datë 26.02.2024 ka dërgaur f në DRAP Durrës fondet e miratuara për shpenzime kapitale për DRAP DUrrës sipas Tabelës nr. 1 "Detajimi i investimeve për projekte me fiancim të brendshëm 2024-2026".

Sipas buxhetit te mirastuar per vitin 2024 MAS ka miratuar investimin per krijimin e fondit të bibiliotekave për shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesëm ne nivel artikulli dhe produkti si më poshtë:

- Me Kod M112634 ne vlere **6,084,905 lekë** (për shkollat e arsimit bazë).
- me Kod M112629 ne vlere **4,056,603 lekë** (për shkollat e arsimit të mesëm).

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 "Për arsimin parauniversitar në RSH', i ndyrshuar dhe VKM nr. 99, datë 27.02.2019 "Për krujimin , mënyrën e organizimit dhe funksionimt të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, DRAP Durres ka vijuar me kryerjen e procedurave të prokurimit per librin artistik.

Agjencia Kombetare e Arsimit Parauniversitar me shkresë nr. 2453/1 Prot, datë 23.10.2024, ka dërguar në listën e titujve rekamandues për pasurimin e bibliotekat e shkollave, sipas shkresës së MAS nr. 4721/1 Prot, datë 24. 07.2024 bashkelidhur të cilës eshtë lista me **764 tituj rekoamndues** për bibliotekat e shkollave, për vitin shkollor 2024-2025, për pasurimin e bibliotekave të shkollave.

AKAP me shkresë nr. 1847/1 Prot, datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 3195/1 Prot, datë 02.10.2024, i ka kthyer përgjigje shkresës së DRAP Durrës me nr. 2269 Prot, datë 01.10.2024 me lënë "Për Kompetencë" me të cilën **aprovon** vijimin e procedurave te prokurimit deri në momentin e konfigurimit të plote të DRAP Tiranë dhe daljen e Urdhrit të Ministrit të MAS për miratimin e strukturës dhe organikës së ZVAP.

Për studimin paraprak të tregut

Titullari DRAP Durrës me **Urdhër nr. 82 Prot, datë 23.10.2024** , Protokolluar me nr. 1847/1 Prot, datë 23.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e **Komisionit për përcaktimin e titujve të librit të bibliotekës.**

Komisionit për përcaktimin e titujve të librit i mësipërm do të verifikojë pajisjen me certifikatën e të drejtës së autorit për listën përfundimtare të literaturës rekomanduese për pasurimin e bibliotekave të institucioneve arsimore parauniversitar publike, të dërguara nga MAS, e cila është shkarkuar nga SMIP sipas përzgjedhjes nga ZVA dhe dërguar në DRAP Durrës me shkresë zyrtare.

Anëtarët e grupit të punës për studimin paraprak të tregut kanë nënshkruar deklartat e konflktiti të interesit datë 30.10.2024.

Zyra e Financës DRAP Durrës, ka llogaritur shpërndarjen e fondit te miratuar nga MAS për 12 ZVAP nën juridiksionin e saj, sipas numrit te nxënësve dhe fondit të miratuar sipas kodit të projektit, si më poshtë vijon:

Shpërndarja e fondit te prokurimit për librin artistik sipas 12 ZVAP-ve (në lekë)

Nr.	ZVAP	**AMU** nxënës sipas ZVAP	**AMU** % e nxënësve te ZVAP ndaj totalit te Drap	**AMU** **Fondi limit për çdo ZVAP (me tvsh 6%)**	AML numri I nxënësve total ne DRAP Durrës	AML % e nxënësve te ZVAP ndaj totalit te Drap	AML **Fondi limit për çdo ZVAP (me tvsh 6%)**	**AMU +AML**	**%**
1	Dibër	5,480	5.0%	**320,456**	1,501	4.9%	**211,035**	**531,491**	4.94%
2	Mat	1,863	1.7%	**108,943**	645	2.1%	**90,685**	**199,628**	1.86%

3	Klos	1,217	1.1%	**71,167**	288	0.9%	**40,492**	**111,659**	1.04%
4	Bulqize	2,569	2.3%	**150,228**	524	1.7%	**73,673**	**223,901**	2.08%
5	Kruje	6,011	5.4%	**351,508**	1,652	5.4%	**232,265**	**583,773**	5.43%
6	**Tirane**	54,346	49.3%	**3,178,013**	14,834	48.5%	**2,085,607**	**5,263,620**	48.96%
7	Vore	2,866	2.6%	**167,596**	707	2.3%	**99,402**	**266,998**	2.48%
8	**Kamëz**	12,503	11.3%	**731,143**	2,978	9.7%	**418,696**	**1,149,839**	10.70%
9	**Durrës**	17,079	15.5%	**998,736**	6,031	19.7%	**847,937**	**1,846,673**	17.18%
10	Shijak	2,063	1.9%	**120,639**	352	1.2%	**49,490**	**170,129**	1.58%
11	Kavaje	3,007	2.7%	**175,842**	724	2.4%	**101,792**	**277,633**	2.58%
12	Rrogozhine	1,295	1.2%	**75,728**	348	1.1%	**48,928**	**124,656**	1.16%
		110,299	100.0%	**6,450,000**	**30,584**	**100.0%**	**4,300,000**	**10,750,000**	

(Burimi: DRAP Durrës; Punoi KLSH)

Nga të dhënat e fondeve te llogaritua, rezulton se ZVAP Tirane ka **5,263,620 ose** 48.96 % të fondit të alokuar, ZVAP Durrës **1,846,673 lekë ose** 17.18% , ZVAP Kamëz **1,149,839 lekë ose** 10.70% dhe 9 ZVAP-te e tjera 2,489,868 lekë ose 23.16% te fondit buxhetor.

Pas llogaritjes se fondit, me email datë 24.09.2024 Zyra e Financës dërgon shpërndarjen e fondit "Libri artistik 2024" për 12 ZVAP-të, duke kërkuar prej tyre përzgjedhjen e titujve te librave artistik. Në përgjgije të kërkesës ZVAP-et nën juridiksion të DRAP Durrës, **kanë dërguar informacion për titujt e librave të përzgjedhur prej tyre, me shkresat si më poshtë vijon:**

1. ZVAP Rrogozhine me shkresë nr. 776 Prot, datë 23.10.2024, Prot. me nr. 1847/38 Prot, datë 25.10.2024;
2. ZVAP Vorë me shkresë nr. 719 Prot, datë 24.10.2024, Prot.me nr. 1847/42 Prot, datë 28.10.2024;
3. ZVAP Kamëz me shkresë nr. 2432 Prot, datë 23.10.2024, Prot.me nr. 1847/40 Prot, datë 28.10.2024;
4. ZVAP Tiranë me shkresë nr. 8201 Prot, datë 23.10.2024, Prot. me nr. 1847/39 Prot, datë 25.10.2024;
5. ZVAP Kavajë me shkresë nr. 1423 Prot, datë 11.10.2024, Prot. me nr. (nuk ka) Prot, datë (nuk ka);
6. ZVAP Dibër me shkresë nr. 2829 Prot, datë 23.10.2024, Prot. me nr. 1847/53 Prot, datë 01.11.2024;
7. ZVAP Shijak me shkresë nr. 1221 Prot, datë 24.10.2024, Prot. me nr. 1847/43 Prot, datë 24.10.2024;
8. ZVAP Durrës me shkresë nr. 2362 Prot, datë 08.11.2024, Prot. me nr. (nuk ka) Prot, datë (nuk ka);
9. ZVAP Bulqizë me shkresë nr. 207 Prot, datë 24.10.2024, Prot. me nr. 1847/41 Prot, datë 28.10.2024;
10. ZVAP Krujë me shkresë nr. 1571 Prot, datë 23.10.2024, Prot.me nr. 1847/36 Prot, datë 24.10.2024;

Nga dokumentacioni administruar ne dosjen e prokurimit rezultojnë se 2 ZVAP, përkatësisht ZVAP MAT, ZVAP Klos nuk kanë kthyer përgjigje për përzgjedhjen e librit artistik për pasurimin e bibliotekave të tyre.

Në përgjigjen nga ZVA Kavajë dhe ZVA Durrës mungon numri dhe data e Protokollit hyrës.

Titullari me me **Urdhër nr. 82 Prot, datë 23.10.2024** ka urdheruar ngritjen e **Komisionit për përcaktimin e titujve të librit** sipas cikleve të arsimit bazë dhe të mesëm që do të prokurohen nga DRAP Durrës. Ky Komision **do të verifikojë pajisjen me "Certifikatën ë së drejtës së autorit"** për listen e titujve të librave të ardhura nga MAS nëpërmjet sistemit eletronik SMIP, sipas përzgjedhjes nga ZVAP-të.Kjo procedurë do të realizohet **brenda një afti 3 (tre**) ditor nga dalja e ketij urdhëri.

Pas daljes së **Urdhër nr. 82 Prot, datë 23.10.2024, Komisionit për përcaktimin e titujve të**

librit DRAP Durrës, i eshte drejtuar me mail nga shtëpitve botuese për disponimin prej tyre të **certifikatës** së të drejtës së autorit dhe **ekstrat te regjistrit** tregtar te subjektit, për titujt e listuar prej DRAP, me afat përgjigje deri në datën 28.10.2024 si me poshtë:

1. Mail datë 24.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/37 Prot, datë 24.10.2024;
2. Mail datë 24.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/36 Prot, datë 24.10.2024;
3. Mail datë 24.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/35 Prot, datë 24.10.2024;
4. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/34 Prot, datë 23.10.2024;
5. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/33 Prot, datë 23.10.2024;
6. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/32 Prot, datë 23.10.2024;
7. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/31 Prot, datë 23.10.2024;
8. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/30 Prot, datë 23.10.2024;
9. Mail datë 23.10.2024, Protokolluar me nr. 1847/29 Prot, datë 23.10.2024;

AK ka zgjedhur **procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, sipas nenit 47.1.b germa iii) të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pasi** për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale, librat artistike me të drejtë autorit mund të ofrohen vetëm nga një operator ekonomik (shtëpi botuese).

Nga auditimi u konstatua se AK për përzgjedhjen e OE të ftuar nuk ka mbajtur Proces verbal, në kundërshtim me pikën 6 paragrafi dytë të Udhëzimit nr. 6 datë 16.07.2021 "Mbi përdorimin e procedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", sipas të cilës AK për përzgjedhjen e OE të ftuar, ka detyrimin ti pasqyrojë në një proces verbal të mbajtur për këtë qëllim.

Me kthimin e përgjigjeve të ardhura nga shtëpitë botuese për përcaktimin titujve të librave që do të prokurohen nga DRAP Durrës, **u** mbajt **proces verbal nr. 1847/44, datë 28.10.2024** mbajtur **nga Sekretaria** ku kërkohej lista e çmimeve dhe Certifikuara e Regjistrimit të të drejtave për titujt e secilës shtëpi botuese kanë kthyer përgjigjen Shtëpitë botuese: 1. F; 2. M. P; 3. P; 4. D; 5. O; 6. N; 7. P; 8. B; 9. U; 10. I; 11. T; 12. A; 13. A; 14. N; 15. D.; 16. U; 17. F

Me anë të këtij procesverbali **Komisionit për përcaktimin e titujve të librit** në DRAP Durrës dorëzon pranë Njësisë së prokurimit **listën e titujve të librave me te drejtë autori**, pas verifikimit të përgjigjeve të ardhura nga shtëpive botuese, të cilat janë përgjigjur si më poshtë vijon:

1. A (me të drejtë autori)	38 tituj
2. M.P (me të drejtë autori)	35 tituj
3. I (me të drejtë autori)	17 tituj
4. B.T (me të drejtë autori)	11 tituj
5. O (me të drejtë autori)	16 tituj
6. D (me të drejtë autori)	40 tituj
7. B (me të drejtë autori)	13 tituj
8. F (me të drejtë autori)	6 tituj
9. N (me të drejtë autori)	3 tituj
10. P (me të drejtë autori)	8 tituj
11. N (me të drejtë autori)	15 tituj
12. P (me të drejtë autori)	11 tituj
13. A (me të drejtë autori)	5 tituj
14. A (me të drejtë autori)	54 tituj
15. P (me të drejtë autori)	13 tituj verifikuar nga procedura 2023
16. P (me të drejtë autori)	3 tituj verifikuar nga procedura 2023

Sipas **Komisionit për përcaktimin e titujve të librit nuk i janë përgjigjur kërkesës (11 shtepi botuese)**: U; E.; B.D; B.Sh; Onufri; SH; P; Z; B; A.SH; D (nuk është regjsitruar në APP) si dhe n**uk potesonin** kushtet e të drejtës së autorit (**3 shtepi botuese**): D; F.N; U.P.

Nga auditimi u konstatua se DRAP Durrës, në procesverbalin nr. 1847/45, datë 28.10.2024, për përcaktimin e titujve të librave, pasi ka administruar listat e titujve të përzgjedhur, të gjeneruara nga SMIP dhe të përcjella nga ZVAP-të përkatëse, ka hartuar vetëm një listë të shtëpive botuese me numrin e titujve të librave të pajisur me certifikatë të së drejtës së autorit. Në këtë dokumentacion nuk janë evidentuar titujt konkretë të librave dhe as certifikatat përkatëse të vlefshme të së drejtës së autorit për secilin titull sipas shtëpive botuese. Ky veprim është në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit të MAS nr. 200, datë 07.05.2024, "Për miratimin e rregullores për pasurimin e bibliotekës së institucionit arsimor parauniversitar publik", sipas së cilës DRAP harton listën përfundimtare të titujve të përzgjedhur dhe numrin e kopjeve mbi bazën e kërkesës së gjeneruar nga SMIP, të hartuar sipas kërkesave të IAP-ve, e cila, në zbatim të pikës 10 të këtij udhëzimi, duhet të dërgohet edhe zyrtarisht në DRAP/ZVAP. Gjithashtu, ky veprim bie në kundërshtim me nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se procesverbali nr. 1847/44, datë 28.10.2024, i mbajtur nga Sekretaria, nuk përmban nënshkrimet përkatëse, ndërsa grupi i punës nuk rezulton të jetë ngritur me urdhër të Titullarit për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi. Kjo situatë është në kundërshtim me pikën 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", sipas së cilës autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit, që nga faza e planifikimit deri në zbatimin e kontratës, si dhe të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për të gjitha veprimet e kryera në kuadër të procedurës.

Hartimi i dokumenteve të Prokurimit/kriteret e veçanta për kualifikim dhe llogaritja e Fondit Limit:

Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 21 Prot, datë 01.11.2024** , Protokolluar me nr. 1847/71 Prot, datë 11.11.2024 ka urdhëruar te realizohet procedura e prokurimit e llojit "Negocim pa shpallje paraprake" me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioetak arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" me fond limit 10,750,000 lekë (pa TVSH), e ndarë në **16 lote**.

Ngarkohet **Njësia e Prokurimit** për zbatimin e këtij urdhri me përbërje si më poshtë:

1. R.B, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve;
2. Xh.T, specialist, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve;
3. O.T, specialit, Sektori Burimeve Njerëzore Shërbimeve;

Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 22 Prot, datë 04.12.2024 (rishpallje procedure)**, Protokolluar me nr. 1847/76 Prot, datë 04.12.2024 ka urdhëruar **te rishpallet** procedura e prokurimit e llojit "Negocim pa shpallje paraprake" me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioetak arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" mre fond limit 10,750,000 lekë (pa TVSH), e ndarë në **6 lote**. Ngarkohet **Njësia e Prokurimit** për zbatimin e këtij urdhri me përbërje si më poshtë:

Komisioni llogartijes së fondit limit dhe DST ka mbajtur **proces verbal nr. 1847/50, datë 31.10.2024** pasi ka marrë në dorëzim listën finale të librave të kërkuara nga ZVAP-et me proces verbalin nr. 1847/45, datë 28.10.2024 dokumenton se **është konsumuar vetëm gjysma e fondit limit me vlerë 5,082,432 leke (pa tvsh), dhe vendos t'i propozojë Titullarit** të AK "*Plotesimin e shumës totale të fondit të vënë në dispozicion dhe të parashikuar në regjistrin e parashikimeve*

2024 në DRAP – Durrës, sipas procedurës së përzgjedhur "me negocim pa njoftim paraprak", të ndarë në Lote në mënyrë që të realizohet procedura , konform nenit 47, pika 1 germa iiii) Ligjit PP dhe nenit 52, pika 1, gërma iii) të VKM nr. 285/2021 si dhe pikës 10, germa b) pika iiii), si dhe Udhëzimit nr. 6, datë 16.07.2021 **"***Mbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete eletronike"* për të mbrojtur të drejtat ekskluzive, dukë përfshirë të drejta e pronësisë intelektuale.

Për këtë arsye Komisioni llogaritjes së fondit limit dhe DST propozon marrjen e titujve nga listat e vitit 2023 për librat me te drejtë autori, vetëm për titujt e miratuar nga lista e propozuar nga MAS për vitin 2024, e cila në procedurën e vitit 2023 mbeti e pa realizuar për arsye skualifikimi në dokumentacion, pas procedurës së kryer në sistemin e prokurimit publik. Pjesa e shumës e cila mbetet për t'u plotesuar në mënyrë që fondi të ezaurohet 100%, u shpërnda në mënyrë të barabartë midis Loteve të përcaktuara.

Komisioni llogartijes së fondit limit dhe DST bazuar titujt e shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 816/2 Prot, datë 23.02.2024, në kërkesat e ardhura nga ZVAP-të në vartësi të DRAP Durrës në vitin 2024 përzgjedhur nga IAP-et, të konfirmuara me Certifikatë Regjistrimi Kalim të Drejtash Autori referuar vlerësimit të Komisionit të Specifikimeve Teknike, perllogariti fond limit 10,141,509 lekë (pa tvsh), si më poshtë vijon:

Fondi limit për librin artitik viti 2024

Ndarja ne Lote	**Shtëpia Botuese**	**Perllogaritja e Fondit Limit (pa tvsh) 2024**	**Titujt e librave me te drejte autori 2024**	**Perllogaritja e Fondit Limit (pa tvsh) 2023**	**Titujt e librave me te drejte autori - 2023**	**Perllogaritja e Fondit Limit (pa tvsh) 2024**
Loti 1	"A"	905,094	38			961,037
Loti 2	"M.P"	1,097,028	35	1,340,943	26	2,425,188
Loti 3	"I"	201,698	17	740,094	8	997,735
Loti 4	"B.T"	116,038	11			171,981
Loti 5	"O"	128,396	16			184,339
Loti 6	"D"	563,915	40	477,736	28	1,161,561
Loti 7	"B"	99,433	13			155,283
Loti 8	"F"	47,170	6			102,830
Loti 9	"N"	101,700	3			157,700
Loti 10	"P"	36,500	8			92,500
Loti 11	"N"	152,500	15			208,500
Loti 12	"P"	203,774	11			259,622
Loti 13	"A"	49,100	5			104,800
Loti 14	"A"	1,283,028	54	1,151,094	33	2,444,943
Loti 15	"P"	89,057	13	608,585	12	603,490
Loti 16	"P	8,000	3	40,377	3	110,000
		5,082,431	**288**	**4,358,829**	**110**	**10,141,509**

(Burimi : DRAP Durres: Punoi KLSH)

Sa më sipër Komisioni llogartijes së fondit limit (pa tvsh) dhe DST në procedurën e prokurimit **me objekt "Furnizim Shkollash me libra artistike"** ka mbajtur:

- proces verbal nr. 1847/50 Prot, datë 31.10.2024 duke përllogartiur fondin limit për blerjen e librit artistik në vlerë **10,141,509 lekë (pa TVSH)**
- në SPE proces verbal nr. 1847/54, datë 04.11.2024 "*Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim*", me fond limit (pa tvsh)10,141,509 lekë.
- hartimin e DST dhe shtojcat përkatëse duke klasifikuar blerjen e librit artistik si investim:

- Me Kod M112624 ne vlere **6,084,905 lekë**
- Me Kod M112624 ne vlere **4,056,603 lekë**

DST nënshkruar në cdo faqe nga NjP.

Për argumetimin dhe miratimin e specifikimeve teknike Komisioni llogaritjes së fondit limit dhe

DST ka përcaktuar:

a. **Kriteret e vecanta** të kualifikimit sipas të cilave Ofertuesi duhet të dorëzoje: "Formularin përmledhes së vetëdeklarimit" sipas Shtojcës 9; Sigurim oferte sipas Shtojca 4; Përshtatshmerine për të kryer veprimtarinë profesionale sipas Shtojces 8 është përcaktuar sasia e mallit që kërkohet, e gjithë sasia e mallit duhet të dorëzohet brenda 10 ditëve nga lidhja e kontratës, Kapaciteti ekonomik dhe financair.

b. **Ka argumetuar specifikimeve teknike: Në** shtojcën *7 "**Formulari i specifikimeve teknike***" janë përckatuar specifikimet teknike të materialeve të librave si më poshtë:

- Librat të jenë në përputhje me kërkesat , sipas tabelës, listës bashkëngjitur, **e cila përbën kusht kryesor** për marrjen në dorrëzim të librave: **Titulli i kërkuar, Autori përkatës, Sasia e kërkuar;**
- Libri duhet të jetë i ambalazhuar, për tu ruajtur nga dëmtimet e mundhshme;
- Libri duhet të jëtë i rregullt, i ri, i papërdorur dhe në gjendje të mirë fizike.

Nga auditimi u konstatua se Njësia e Prokurimit në DRAP Durrës nuk ka dokumentuar nëpërmjet një relacioni, përzgjedhjen e procedurës "negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", si dhe Titullari ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 21, datë 11.11.2024 në mungesë të miratimit të relacionit argumentues mbi përzgjedhjen e kësaj procedure, në kundërshtim me kërkesat e pikës 10.a të Udhëzimit të APP nr. 06, datë 16.07.2021 "*Mbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", sipas të cilës në çdo rast AK duhet të analizojë faktet, kushtet dhe rrethanat që çojnë në përzgjedhjen e kësaj procedure si faktit se Titullari para nxjerrës së Urdhërit të prokurimit duhet të miratojë relacion shpjegues për përdorimin e kësaj procedure.

DRAP Durrës me shkresë nr. 1847 Prot., datë 22.08.2024, ka përcjellë listën e titujve artistikë rekomandues për pasurimin e bibliotekave të shkollave, bazuar në shkresën e MAS nr. 4721/1 Prot., datë 24.07.2024, bashkëlidhur me listën prej 764 titujsh për vitin shkollor 2024–2025.

Megjithatë, përfshirja në prokurim e listave të titujve të vitit 2023, të ndara në 6 lote me vlerë 4,358,829 lekë (pa TVSH), të mbetura të parealizuara për mungesë dokumentacioni, si dhe rishpërndarja e fondeve prej 700,249 lekë për ezaurimin e fondit limit 10,141,509 lekë (pa TVSH), nuk gjen mbështetje ligjore dhe bie në kundërshtim me shkresën e MAS nr. 4721/1 Prot., datë 24.07.2024, e cila përcakton listën e 764 titujve rekomandues për bibliotekat e shkollave për vitin shkollor 2024–2025.

Vlerësimi i Ofertave

Titullari DRAP Durrës me **Urdhër Prokurimi nr. 83 Prot, datë 30.10.2024** , Protokolluar me nr.1847/47 Prot, datë 30.10.2024 ka urdhëruar ngritjen e **Komisionit të Vlerësimit të Ofertave** me objekt "Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar" për IAP-et në vartësi të DRAP Durrës.

Komisioni ka për detyrë vlerësimin e ofertave të paraqitura në SPE për procedurën e prokurimit "Libra artistik për pasurim fondi biblioteka arsimi i mesëm dhe 9-vjeçar".

Anëtarët e KVO kanë nënshkruar deklaratat e konflktit të interesit datë 30.10.2024.

KVO pas hapjes se ofertave datë 20.11.2024, ora 13:00 ka proceduar me vlesimin e ofertave sipas nenit 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratiin e rregullave të prokurimit publik" Pas hapjes se procedurave ka kostatuar se pjesëmarres në procedurë janë 16 OE dhe **ka vendosur:**

✓ **të klasifikojë si fitues** 10 OE përkatësisht:

1. **Loti 2-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "M.P" Fondi limit 2,425,188 lekë (pa tvsh);
2. **Loti 5-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar

Shtëpia Botuese "O" Fondi limit 184,339 lekë (pa tvsh);
3. **Loti 6-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "D." Fondi limit 1,161,561 lekë (pa tvsh);
4. **Loti 8-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "F." Fondi limit 102,830 lekë (pa tvsh);
5. **Loti 9-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "N." Fondi limit 157,700 lekë (pa tvsh);
6. **Loti 10-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "P" Fondi limit 92,500 lekë (pa tvsh);
7. **Loti 11-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "N." Fondi limit 208,500 lekë (pa tvsh);
8. **Loti 12-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "P" Fondi limit 259,622 lekë (pa tvsh);
9. **Loti 14-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "A" Fondi limit 2,444,943 lekë (pa tvsh);
10. **Loti 16-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "P" Fondi limit 110,000 lekë (pa tvsh);

✓ të **skualifikojë 6 OE** si me poshtë:

1. **Loti 1-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "A." Fondi limit 961,037 lekë (pa tvsh);
2. **Loti 3-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "I" Fondi limit 997,735 lekë (pa tvsh);
3. **Loti 4-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "B.T" Fondi limit 171,981 lekë (pa tvsh);
4. **Loti 7-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "B." Fondi limit 155,283 lekë (pa tvsh);
5. **Loti 13-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "A" Fondi limit 104,800 lekë (pa tvsh);
6. **Loti 15-** Blerje libri artistik për pasurim fondi bibliotekës së arsimit të mesëm dhe 9-vjecar Shtëpia Botuese "P" Fondi limit 603,490 lekë (pa tvsh);

Komisioni i Vlesimit të Ofertave i ngritur me Urdhër nr. 83 Prot, datë 30.10.2024, Protokollaur me nr.1847/47 Prot, datë 30.10.2024 **ka hartuar Raport Përmbledhës me nr. 1847/73 Prot, datë 26.11.2024** "*Mbi shqyrtimin dhe Vlesesimin e Ofertave",* mbi realizimin e procedurës së prokurimit me fond limit 10,141,509 lekë (pa tvsh), ne "Procedure më negocim pa shpllaje paraprake të njoftimit të kontratës"e ndarë në 16 Lote. KVO ka vlersuar të sukseshme 10 oferta ekonomike në vlerë 7,147,183 lekë, të cilat plotësojnë kriterët për kualifikim sipas dokumentacionit në SPE.

Titullari i AK-së ka miratuar "Raportin Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave" me shkresën nr.1847/74 Prot., datë 26.11.2024, të paraqitur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sipas raporti përmbledhës nr.1847/73, datë 26.11.2024, "P*ër shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertavne nga KVO i ngritur me urdhër nr. 83/2024*", me objekt prokurimi "Furnizim shkollash me libra artistikë", me fond limit te prokuruar (pa TVSH) 10,141,509 lekë dhe klasifikuar të sukseshme 10 OE me vlere 7,147,183 lekë.

Komisioni i Vlersimit të Ofertave per realizimin e pjesës së mbetur të fondit limit**, rishpallur** me Urdher nr. 22 Prot, datë 04.12.2024, ka hartuar Raport Përmbledhës "Mbi shqyrtimin dhe Vlesesimin e Ofertave" me nr. 1847/89 Prot, datë 11.12.2024 mbi realizimin e procedurës së

prokurimit me fond limit 2,994,326 lekë (pa tvsh), në "*Procedure më negocim pa shpllaje paraprake të njoftimit ttë kontratës*"e ndarë në 6 lote si më poshtë:
Data e zhvillimit: 06.12.2024 ora 13:00 (rishpallje)
KVO pas mbylljes së dorëzimit të ofertave, ka hapur ofertat e paraqitura dhe ka vlersuar dokumentacionin e paraqitur nga OE pjesmarres.
KVO para vlersimit te ofertave ka verifikuar në Buletitin e PP nr. 94, datë 16.11.2023 (fq 5 dhe 6) nga i cili ka rezultuar se OE pjesëmarrrs nuk janë të përjashtuar nga e drejta për të marrë kontratata publike.
KVO ka zhvilluar procedurën e prokurimit datë 06.12.2024, ora 13:00 dhe pas hapjes se procedurave ka kostatuar se pjesëmarres në procedurë janë 6 OE dhe ka vendosur:

- ✓ të klasifikojë si fitues 2 OE përkatësisht:

Loti 1: me REF-31845-12-04-2024 nga shtëpia botuese "**A.**" me fond limit 961,037 lekë (pa tvsh) dhe vlere te ofertuar 961,037 lekë, me arsyetimin se OE ka paraqitur dokumnetacion të saktë konform DST. Pas kësaj KVO në zbatim të nenit 82 pka 3 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave"VKM nr. 285, datë 19.05.2021 procedoi me korigimine gabimeve aritmetike. Nga korrigjimi i OE ezultoi se kjo oeferte nuk përmban gabime artimetike. Më pas KVO procedoi me vlersimin nëse oferta është anomalisht e ulet, nga ku rezulton se nuk kemi ofertë anomalisht të ulët pasi oferta është e barabartë me fondin limit. KVO vendosi të pranojë ofertën e OE.
Loti 2: me REF-31848-12-04-2024 nga shtëpia botuese "**I"** me fond limit 997,735 lekë (pa tvsh) dhe dhe vlere te ofertuar 997,735 lekë.

- ✓ **të skualifikojë 4 OE si më poshtë**:

Loti 3: me REF-31851-12-04-2024 nga shtëpia botuese "B.T" me fond limit 171,981 lekë (pa tvsh). KVO ka paraqitur formualrin e pandrsyhaur të vetëdekalrimit. Konkretisht OE, sipas nenit 26 të VKM nr. 285/2021, i ndryshuar, OE skualifikohet për mosplotësim të "kritereve të vecanta", pika 1.
Loti 4: me REF-31845-12-04-2024 nga shtëpia botuese "B" me fond limit 155,283 lekë (pa tvsh) nga vlersimi i dokumnetacionit ligjor dhe teknik KVO ka vlersuar se OE ka dorëzuar dokuemnte te rregullta sic përcaktohet në DST; Në këtë raport mungon arsyeja e skualifikimit.
Loti 5: me REF-31845-12-04-2024 nga shtëpia botuese "A" me fond limit 104,800 lekë (pa tvsh) nga vlersimi i dokumnetacionit ligjor dhe teknik KVO ka vlersuar se OE ka dorëzuar dokuemnte te rregullta sic përcaktohet në DST; Në këtë raport mungon arsyeja e skualifikimit.
Loti 6: me REF-31848-12-04-2024 nga shtëpia botuese "P." me fond limit 603,490 lekë (pa tvsh). nga vlersimi i dokumnetacionit ligjor dhe teknik KVO ka vlersuar se OE ka dorëzuar dokuemnte te rregullta sic përcaktohet në DST; Në këtë raport mungon arsyeja e skualifikimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në procedurën e prokurimit "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", **ka hartuar Raport Përmbledhës nr. 1847/89 Prot, datë 11.12.2024 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave**, në të cilën për procedurën e prokurimit me fond limit 2,994,326 lekë (pa tvsh) të ndare në 6 Lote, kanë paraqitur oferte 6 OE, shpallur fitues 2(dy) OE ne vlere 1,958,772 lekë dhe skualifikuar 4 (katër) OE në vlere 1,035,554 lekë. Për sa më sipër KVO kërkon miratimin e Raportit përmbledhes së procedurës së prokurimit.
Kryetari i AK me shkresë nr. 1847/90 Prot, datë 11.12.2024 ka miratuar Raportin Përmbledhës të procedurës së prokurimit., kërkuar per miratim nga KVO me shkrese nr. 1847/89 prto, datë 11.12.2024.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ngritur me urdhër nr. 83/2024 mbi realizimin e procedurës së prokurimit me fond limit 10,141,509 lekë (pa tvsh), në procedurën me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" e ndarë në 16 Lote ka hartuar:

Raport Përmbledhës me nr. 1847/73 Prot, datë 26.11.2024 “Mbi shqyrtimin dhe Vlerësimin e Ofertave”, duke vlerësuar të suksesshme 10 oferta ekonomike në vlerë 7,147,183 lekë, të cilat plotësojnë kriteret për kualifikim sipas dokumentacionit në SPE. Dhe skualifikuar 6 (gjashtë) OE me vlere 2,994,326 lekë (pa tvsh), miratuar nga Titullari i AK.
Raport Përmbledhës nr. 1847/89 Prot, datë 11.12.2024 për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, në të cilën për procedurën e prokurimit me fond limit 2,994,326 lekë (pa tvsh) të ndare në 6 Lote, kanë paraqitur oferte 6 OE, shpallur fitues 2(dy) OE ne vlere 1,958,772 lekë dhe skualifikuar 4 (katër) OE në vlere 1,035,554 lekë. miratuar nga Titullari i AK.
Nga auditimi u konstatua se
-KVO nuk ka mbajtur proces verbal për të vlerësuar ofertat e paraqitura në SPE nga OE, veprim në kundërshtim me nenin 2 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera;
-KVO në Raport Përmbledhës nr. 1847/73 Prot, datë 26.11.2024 nuk është shprehur mbi arsyet e skualifikimit ne total 6 OE me vlere te skualifikuar 2,994,326 lekë, përkatësisht shtëpitë botuese “I” me oferte 997,735 lekë (pa tvsh); Shtëpia Botuese “B.T” me oferte 171,981 lekë (pa tvsh); Shtëpia Botuese “B” me oferte 155,283 lekë (pa tvsh); Shtëpia Botuese “A.” me oferte 104,800 lekë (pa tvsh); Shtëpia Botuese “P” me oferte 603,490 lekë (pa tvsh) në kundërshtim me nenin 2 pika ë) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik sipas të cilit për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën arsyet e kualifikimit dhe të skualifikimit të ofertuesve ose të kandidatëve;
-KVO (rishpallje procedure) nuk eshte shprehur mbi arsyet e skualifikimit ne total 6 OE me vlere te skualifikuar 863,573 lekë, përkatësisht “Loti 4: shtëpia botuese “B” me oferte 155,283 lekë (pa tvsh); Loti 5: shtëpia botuese “A” me oferte 104,800 lekë (pa tvsh); Loti 6: shtëpia botuese “P” me oferte 603,490 lekë (pa tvsh);në kundërshtim me nenin 2 pika ë). të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik sipas të cilit për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën arsyet e kualifikimit dhe të skualifikimit të ofertuesve ose të kandidatëve.

Kontrata e nënshkruara nga AK

1. **Loti 1:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/102 Prot, datë 17.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “Shtëpia Botuese A”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 1,014,227 lekë (me tvsh);
2. **Loti 2:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/85 Prot, datë 10.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “Shtëpia Botuese M.P”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 2,570,544 lekë (me tvsh);
3. **Loti 2:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/93 Prot, datë 13.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “I”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 1,057,399 lekë (me tvsh);
4. **Loti 5:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/84 Prot, datë 10.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “O”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 195,387 lekë (me tvsh);
5. **Loti 6:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/81 Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “Shtëpia Botuese D.”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 1,231,250 lekë (me tvsh);
6. **Loti 8:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/82Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese “F”, në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 108,999 lekë (me

tvsh);

7. **Loti 9:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/78Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "N", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 157,700 lekë (subjekti nuk është tatimpagues i tvsh-së);
8. **Loti 10:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/79Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "P", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 92,500 lekë (subjekti nuk është tatimpagues i tvsh-së);
9. **Loti 11:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/87 Prot, datë 10.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "Shtëpia Botuese N", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 208,500 lekë (subjekti nuk është tatimpagues i tvsh-së);
10. **Loti 12:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/80Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "P", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 275,198 lekë (me tvsh);
11. **Loti 14:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/86 Prot, datë 10.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "Shtëpia Botuese A", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 2,591,639 lekë (me tvsh);
12. **Loti 16:** Kontrate furnizimi me libra artistike nr. 1847/83 Prot, datë 06.12.2024 lidhur me shtëpinë botuese "Shtëpia Botuese P", në të cilën është përcaktuar vlera totale e kontratës 110,000 lekë (subjekti nuk është tatimpagues i tvsh-së);

Zbatimi i Kontratës

Titullari Urdhër Nr. 93/2024, Prot. 1847/77, datë 06,12,2024, ka urdhëruar ngritjen e Komisionit për Zbatimin e Kontratës, i përbërë nga z. Xh.V, znj. A.V, dhe z. E.B.

Komisioni ka mbajtur proces verbal dhe ka verifikuar sasinë e librave të furnizuar në përputhje me sasinë numerike të librave sipas faturës tatimore si me poshtë vijon:

1. proces verbal nr. 1847/96 Prot, datë 13.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese N.Z, sipas faturës tatimore nr.31/2024, dt. 1312.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
2. proces verbal nr. 1847/91 Prot, datë 11.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese M.P, sipas faturës tatimore nr.388/2024, dt. 11.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
3. proces verbal nr. 1847/95 Prot, datë 13.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese P, sipas faturës tatimore nr.10/2024, dt. 13.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
4. proces verbal nr. 1847/94 Prot, datë 13.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese A, sipas faturës tatimore nr.60532024, dt. 13.12.2024. Proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
5. proces verbal nr. 1847/92 Prot, datë 12.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese "D", sipas faturës tatimore nr.513 dt. 12.12.2024. Proces

verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.

6. proces verbal nr. 1847/103 Prot, datë 17.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese A., sipas faturës tatimore nr.152 dt. 17.12.2024. Proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
7. proces verbal nr. 1847/98 Prot, datë 16,12,2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese I, sipas faturës tatimore nr. 539/2024, dt. 16.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
8. proces verbal nr. 1847/104 Prot, datë 17,12,2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese O., sipas faturës tatimore nr. 388/2024, dt. 17.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
9. proces verbal nr. 1847/97 Prot, datë 13.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese P., sipas faturës tatimore nr. 56/2024, dt. 13.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
10. proces verbal nr. 1847/101 Prot, datë 1612.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese N sipas faturës tatimore nr. 77/2024, dt. 16.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
11. proces verbal nr. 1847/99 Prot, datë 16.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese P. sipas faturës tatimore nr. 28/2024, dt. 16.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.
12. proces verbal nr. 1847/100 Prot, datë 16.12.2024, për marrjen në dorëzim të librit artistik me të drejtë autori, nga shtëpia botuese F. sipas faturës tatimore nr. 27/2024, dt. 16.12.2024. proces verbali është firmosur nga anëtarët e Komisionit dhe personi i autorizuar nga furnizuesi. Proces verbali i marrjes në dorëzim nuk përmban listën e mallrave të lëvruara në sasi, çmim dhe vlere në kundërshtim me pikën 6.2 të kontratës së nënshkruar.

Pagesa e faturës është mbështetur në Urdhër Shpenzim, kaluar në Degën e Thesarit Durrës, shoqëruar me dokumentacion vërtetues: kontrate e nënshkruar, njoftim fituesi; grafik kontrate; fature tatimore; proces verbal marrje ne dorëzim; flete hyrje ne DRAP (sipas faturës tatimore); vërtetim llogari bankare.

Pagesa është kryer brenda aftit 30 ditor ne përcaktuar në kontrate.

Grupi i punës për zbatimin e kontratës nr. 1847/87 Prot, datë 10.12.2024; nr. 1847/85 Prot, datë 10.12.2024; nr. 1847/83 Prot, datë 06.12.2024; nr. 1847/86 Prot, datë 10.12.2024 ; nr. 1847/81 Prot, datë 06.12.2024; nr. 1847/102 Prot, datë 17.12.2024 ; nr. 1847/93 Prot, datë 13.12.2024; nr.

1847/84 Prot, datë 10.12.2024; nr. 1847/80 Prot, datë 06.12.2024; nr. 1847/78Prot, datë 06.12.2024; nr. 1847/79 Prot, datë 06.12.2024;nr. 1847/82 Prot, datë 06.12.2024 si më poshtë vijon:

Zbatimi Kontratës /ve të Mallit "Libri artistik" 2024

Faza Pare	Faza Dyte		**Përfituesi**	**Ur.Shp.**	**Date**	**Shuma**	**Kodi Projektit M112624**	**Kodi Projektit M112629**
Loti 11		1	Shtëpia Botuese N	122	18.12.2024	**208,500**	0	208,500
Loti 2		2	M.P	123	18.12.2024	**2,570,544**	2,570,544	0
Loti 16		3	P	124	18.12.2024	**110,000**	110,000	0
Loti 14		4	AShpk	125	18.12.2024	**2,591,583**	2,591,583	0
Loti 6		5	D	126	18.12.2024	**1,231,250**	1,177,873	53,377
	Loti 1	6	A.L	127	20.12.2024	**1,014,227**	0	1,014,227
	Loti 2	7	I	128	20.12.2024	**1,057,599**	0	1,057,599
Loti 5		8	O.G	129	24.12.2024	**195,387**	0	195,387
Loti 12		9	Shtëpia Botuese P	130	24.12.2024	**275,198**	0	275,198
Loti 9		10	Shtëpia Botuese N	131	24.12.2024	**157,700**	157,700	0
Loti 10		11	Shtëpia Botuese P	132	24.12.2024	**92,500**	92,500	0
Loti 8		12	F	133	24.12.2024	**108,999**		108,999
						9,613,487	**6,700,200**	**2,913,287**

Nga auditimi i konstatua se Komisioni i marrjes në dorëzim te librave artistike të prokuruar, në procesverbalet e marrjes në dorëzim të librave artistike (12 proces verbale) **nuk kanë evidentuar të dhënat kryesore** mbi titullin e librit, autorin e librit, sasinë e dorëzuar, nuk kanë shënuar të dhëna mbi gjendjen fizike të librit veprim në kundërshtim ne DST, Shtojca *7 "**Formulari i specifikimeve teknike***" dhe pikën 54 të Udhëzimit nr. 30/2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", në të cilin përcaktohet se për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbal i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.

Komisioni i marrjes në dorëzim **nuk ka hartuar Raport Permbledhës** mbi zbatimin e kontratës, në kundershtim me nenin 2, pika 2, gërma ll) te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilës AK duhet të hartojë Raportin për zbatimin e kontratës, sipas parashikimeve në LPP.

Anëtarët e KVO nuk kanë nënshkruar deklatën e konflktit të interesit datë 30.10.2024, **veprim në kundërshtim** me kërkesat e nenit 73 pika 4) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratiin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilës Titullari i autoritetit/entit kontraktor duhet të marrë masa për shmangien e çdo konflikti interesi në marrëdhëniet e tij, punonjësve të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sikurse përcaktohet në nenin 19, të LPP-së, për çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

Viti 2024

Prokurimi me objekt me objekt "*Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së parë*", Manuale TIK për nxënësit e klasave të para për DRAP Durrës, REF-17845-09-03-2024.

a. *Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës e parë*		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.16 Prot, datë 03.09.2024**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: **Blerje e Vogël**	3. **Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit:** Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "*Komisioni i Prokurimit- Blerje Vogë*l", i ndryshuar. - R.B, specialist SBNJSHS -P.N, specialist SKZHP -Xh.T, specialiste SBNJSHS	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "Komisioni i Prokurimit- Blerje Vogël", i ndryshuar. -R.B, specialist SBNJSHS -P.N, specialist SKZHP -XH.T, specialiste SBNJSHS

5. Fondi Limit: 653,438 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "F": **326,719** lekë (pa TVSH)	7. Diferenca me fondin limit: 326,719 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së Prokurimit: 02/09/2024	9. Burimi Financimit - Buxheti Shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a)Pjesëmarrës në tender: 14 (një) OE b)Skualifikuar: 6
11. Ankimime (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** **N/A**	15. Vlera e kontratës **392,063** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumën **392,063** Lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (**zero**) Lekë.
17- Situacioni Përfundimtar…	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar=30 dite kalendarike; Zbatuar = 15 ditë kalendarike	19. Zgjatja e kontratës (-)
Sigurim kontrate:	23.**Akt i marrjes në dorëzim**	**24. Fletë Hyrja** nr.11/2024, dt. 16.09.2024.

Ngritja e Komisioneve

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024, Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë:

- R.B, specialist SBNJSHS.
- V.K, specialist SKZHP (leje lidhje) zëvendësuar me P. N.
- XH.T, specialist SBNJSHS.

Anëtaret e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 03.09.2024

Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 73 Prot, datë 16.09.2024, me Protokoll nr. 1884/3 Prot, datë 16.09.2024, i përbërë nga:

- Xh. T, specialiste,
- A.V, specialiste .

Planifikimi i nevojave

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) me shkresë nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024 i është drejtuar Ministria e Arsimit dhe Sportit se në vijimësi të zbatimin të programit mësimor në shkollat e mbështetura nga projekti "Element IT", dhe "Smart Lab", numri i manualeve të mësuesve për lëndën TIK në 306 shkollat publike që zhvillojnë programin mësimor, sipas parashikimit të regjistrimeve për vitin shkollor 2024-2024 është si më poshtë vijon

Numri i manualeve të **mësuesve t**ë lëndës TIK për vitin shkollor 2024-2025 është si më poshtë vijon:

DRAP	**Publik**			**Privat**	
	Klasa e Parë	**Klasa e Dytë**	**Klasa e Tretë**	**Klasa e parë**	**Klasa e dytë**
Durrës	175	175	65	30	30
Fier	55	55	20	6	6
Korçë	65	65	30	10	10
Lezhe	55	55	15	4	4
Total	**350**	**350**	**130**	**50**	**50**

(Burimi: shkresa e AKAP nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024)

Numri i manualeve të **nxënësve t**ë lëndës TIK për vitin shkollor 2024-2025 është si më poshtë vijon:

DRAP	**Publik**			**Privat**	
	Klasa e Parë	**Klasa e Dytë**	**Klasa e Tretë**	**Klasa e parë**	**Klasa e dytë**
Durrës	9,750	9,270	3,910	1,250	1,200
Fier	2,000	2,000	1,100	170	150
Korçë	2,250	2,250	1,360	260	245
Lezhe	2,000	1,980	730	120	105
Total	**16,000**	**15,500**	**7,100**	**1,800**	**1,700**

(Burimi: shkresa e AKAP nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024)

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 4159/3 Prot., datë 31.07.2024, i ka dërguar një shkresë Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), marrjen e masave lidhur me pajisjen e mësuesve dhe nxënësve me manualet e lëndës TIK për klasat e para, të dyta, për vitin shkollor 2024-2025, në kuadër të zbatimit të projekteve "Element IT" dhe "SmartLabs". Bashkëlidhur shkresës MAS dërgon formatin fizik dhe elektronin (CD) manualet e mësuesve dhe librat e punës për lëndën TIK për klasën e parë dhe të dytë.

Në këtë shkresë përcaktohet se në zbatim të Urdhërit nr. 328 Prot, datë 01.07.2024 me lëndë "Për miratimin e manualeve të mësuesve dhe librave të punës për nxënësit për lëndën e teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), të klasës së parë dhe klasës së dytë", po ju dërgojmë bashkëlidhur dokumentacion:

- Manualin e mësuesit dhe librave të punës së nxënësit për lëndën TIK , për klasën e parë dhe klasën e dytë;
- Numrin e manualeve të mësuesve dhe nxënësve;
- Urdhëri 328, datë 01.07.2024.

Nga auditimi u konstatua se sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve për vitin 2024, DRAP Durrës ka zhvilluar 2 (dy) procedura prokurimi të tipit "Blerje e Vogël", konkretisht stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të para me REF-17845-09-03-2024 dhe fond limit 653,437 lekë (pa TVSH) dhe stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të dyta me REF-17854-09-03-2024 dhe fond limit 886,432 lekë (pa TVSH).Vlera totale e këtyre dy procedurave është 1,539,869 lekë (pa TVSH).

Stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të para dhe për nxënësit e klasave të dyta përbën grup mallrash ose shërbimesh të ngjashme. Për rrjedhojë, këto procedura duhej të ishin konsideruar në mënyrë të përbashkët për efekt të përllogaritjes së kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Duke qenë se vlera e tyre e përbashkët arrin në 1,539,869 lekë (pa TVSH), pra tejkalon kufirin prej 1,000,000 (një milion) lekë në vit, përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" rezulton në kundërshtim me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas të cilës për përcaktimin e kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, duhet të merren në konsideratë grupet e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe që, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen me qëllim përdorimin e kësaj procedure

Llogaritja e fondit limit:

Komisioni i Prokurimit "*Blerje e Vogël"* ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024 , Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, ka përllogaritu fondin limit për manuale TIK për klasën e parë dhe të dytë si më poshtë:

Llogaritja e fondit limit për manuale TIK për klasën e parë dhe të dytë.

Manual Për Lenden TIK	Njësia	Sasia (publik)	Sasia (privat)	Sasia (TOTAL	Çmimi			Fondi Limit	Fondi Limit
					A R	M E D	**M es**	(pa tvsh)	(me tvsh)
Klasa e parë- Nxënës	cope	9,750	1,250	11,000	82	48	**65**	633,750	760,500
Klasa e parë- Mësues	cope	175	30	205	140	85	**112.5**	19,688	23,625
Klasa e dytë- Nxënës	cope	9,270	30	9,300	107	80	**93.5**	866,745	1,040,094
Klasa e dytë- Mësues	cope	175	1,200	1,375	140	85	**112.5**	19,688	23,625
Klasa e tretë- Nxënës	cope	3,910	0	3,910	0	0	**0**	0	0
Klasa e tretë- Mësues	cope	65	0	65	0	0	**0**	0	0
	Totali	**23,345**	**2,510**	**25,855**				**1,539,870**	**1,847,844**

(Burimi: DRAP Durrës; Punoi KLSH)

Hartimi i kritereve specifike dhe DST
Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël" ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024, Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, ka përllogaritur fondin limit për manuale TIK për klasën e parë ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim me objekt procedure "Manuale TIK klasat e para" në vlerë 653,438 lekë (pa tvsh).
Vlerësimet e ofertave
Titullari me Urdhër prokurimi nr. 16, datë 03.09.2024, Protokolluar me nr. 1883, datë 03.09.2024 ka urdhëruar zhvillimin e procedurës së prokurimit të llojit "Blerje e Vogël" për manuale TIK për mësuesit dhe nxënësit për klasat e para, me fond limit 653,438 lekë (pa tvsh) ose 784,125 lekë (me tvsh).
Në urdhër prokurim është përcaktuar sasia e manuale që do të prokurohen , përkatësisht 175 manuale klasa e parë për mësues dhe 9,270 Manuale klasa e parë nxënës.
Komisioni i Blerjeve te vogla i është drejtuar OE me "Ftesë për Ofertë" në SPE , Protokolluar me nr. 1883/1 Prot, datë 03.09.2024, ku është përcaktuar sasia dhe specifikimet teknike për stampimin e Manualeve TIK klasa e parë.
Data e publikimit te njoftimit: Ftesë për Ofertë" në SPE dt. 06.09.2024

Klasa	Njësia	Sasia	Specifikimet teknike ---Manual TIK
Klasa e parë- Nxënës	cope	9750	Klasa e parë, nxënës, 19 faqe, formati A4, letra 80 gr offset, shtypi me ngjyra, kopertina 300 gr -matt,
Klasa e parë- Mësues	cope	175	Klasa e parë, nxënës, 48 faqe, formati A4, letra 80 gr offset, shtypi me ngjyra, kopertina 300 gr -matt,
TOTAL		**9,435**	

Në specifikimet teknike është përcaktuar destinacioni i dorëzimit të mallrave do të jetë në DRAP Durrës.
OE duhet të vërtetojë se ka në veprimtarinë e tij shërbimin e stampimit për kategorinë e përcaktuar në objektin e prokurimit.
OE *i renditur i pari*, përpara shpalljes fitues, duhet të dorëzojë pranë AK dokumentacionin si më poshtë:
- Ekstrat QKB-je;
- Të vërtetojë se ka kryer më parë shërbimin e kërkuar.
- Deklaratë me shkrim se i plotëson specifikimet teknike te përcaktuara më sipër;
- Afati i lëvrimit të mallit do të jetë brenda 2 (dy) ditë pune duke filluar nga data e dorëzimit në AK të kërkuar në këtë ftesë ofertë;
- Në ofertën e tij ofertuesi duhet të paraqesë të dhëna të plota të personit të kontaktit.

Komisioni i Blerjeve te vogla ka zhvilluar procedurën e prokurimit në SPE me REF-17845-09-03-2024,
Data e hapjes se procedurës se prokurimit 02/09/2024 ora 03:22 PM.
Data e zhvillimit te procedurës se prokurimit **do te jetë** 04/09/2024 03:00 PM.
Pas hapjes se procedurës së prokurimit në SPE u konstatuan se janë paraqitur 16 OE, të cilët nga KVO (Blerje Vogël) në SPE u paraqitën 14 OE nga të cilat u klasifikuan të suksesshme ofertat e paraqitura nga 8 OE dhe u **s'kualifikuan si të pasuksesshme ofertat e paraqitura nga 6** OE përkatësisht M.M, C, J., J.P.P, O.G pasi nuk kanë paraqitur ofertë mbi fondin limit.
Nga hapja e ofertave rezulton se **ofertuesi i renditur në vend të parë është** F. shpk me ofertë 326,719 lekë (pa tvsh)
Data e publikimit te njoftimit: të fituesit dt. 06.09.2024
Nga auditimi u konstatua se në dokumentacionin e dosjes së prokurimit mungon **Njoftimi i Fituesit** për operatorin ekonomik **F. shpk**, me ofertë në vlerën **326,719 lekë (pa TVSH)**, i

gjeneruar nga Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE). Ky veprim është në kundërshtim me nenin 83, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe me pikën 22 të Udhëzimi nr. 6, datë 25.06.2021 i APP-së "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", sipas të cilave njoftimi i fituesit, i krijuar automatikisht në SPE për operatorin ekonomik të shpallur fitues, i dërgohet automatikisht fituesit të parë dhe duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit të dosjes së prokurimit, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, transparencës dhe plotësisë së dokumentacionit procedural

OE F shpallur fitues ka paraqitur pranë AK dokumentacion provues me shkrese "Inventar dokumentacioni" në procedurën e prokurimit "Manuale TIK për klasat e para për IAP-et DRAP Durrës" me nr. (N/A), datë 06.09.2025, Protokolluar me nr. (N/A) . datë (N/A), duke dorëzuar materiale (origjinale) si më poshtë vijon:

- Oferta ekonomike e detajuar.
- Ekstrat QKB
- Deklarate e specifikimeve teknike, ku OE merr përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.
- IBAN

Kontrata

Komisioni i Blerjeve të vogla , në mungesë të kontratës së nënshkruar, për shkas të procedurës së prokurimit, ka mbajtur një "Proces verbal – Tipi i kontratës "Mall", për procedurën "Manuale TIK klasa e parë" për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Oferta ekonomike e paraqitur nga OE luan rolin e kontratës e shoqëruar me fature tatimore

Marrja në Dorëzim

Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 73 Prot, datë 16.09.2024, me Protokoll nr. 1883/2 Prot, datë 16.09.2024, ka mbajtur Proces verbal marrje ne dorëzim nr. 1883/3 Prot, datë 16.09.2024, nënshkruar nga anëtaret e komisionit.

Komisioni realizoi kontrollin sasior dhe marrjen në dorëzim të Manuale TIK për nxënës dhe mësues për klasën e parë. Sasia numerike është në përputhje me sasinë e faturës tatimore nr. 146/2024, dt. 16.09.2026.

Proces verbali është firmosur nga Komisioni i marrjes në dorëzim dhe personi i autorizuar nga F. shpk (firmë dhe vulë)

Nga auditimi u konstatua se komisioni i marrjes në dorëzim në proces verbal marrje ne dorëzim nr. 1883/3 Prot, datë 16.09.2024 nuk është shprehur mbi specifikimet teknike të Manualeve TIK të marra në dorëzim , konkretisht për formatin e letrës, ngjyrat e stampuara, kopertina, etj. në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara nga Komisioni i Blerjeve të Vogla.

Pagesa

Urdhër shpenzim nr. 102, dt. 01.10.2024, për pagesën e F në shumën 392,062 lekë (me tvsh).

Fature tatimore nr. 146/2024, datë 16.09.2024;

Flete Hyrje në magazinë nr. 11/2024, dt. 16.09.2024

Urdhër prokurim nr. 17, datë 03.09.2024 , nënshkruar nga Titullari

Ftesë për oferte nr. 1883/1 Prot, datë 03.09.2024

Nga auditimi rezulton se AK ka likuiduar 100% shërbimin e kryer nga F. shpk, sipas faturës tatimore nr. 147/2024, datë 16.09.2024 në vlere 531,860 (lekë me tvsh).

<u>Viti 2024</u>

Prokurimi me objekt me objekt "*Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së dytë*", Manuale TIK për nxënësit e klasave të dyta për DRAP Durrës, REF-17845-09-03-2024.

a. *Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës e dytë*		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.17 Prot, datë 03.09.2024**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: Blerje e Vogel	3. **Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit:** Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "*Komisioni i Prokurimit-BlerjeVogë*l". -R.B specialist SBNJSHS -P.N specialst SKZHP -Xh.T, specialiste SBNJSHS	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "*Komisioni i Prokurimit-Blerje Vogël*". -R.B specialist SBNJSHS - P.N specialst SKZHP -Xh.T, specialiste SBNJSHS
5. Fondi Limit: 886,732 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "F": **443,217** lekë (pa TVSH)	7.Diferenca me fondin limit 443,216 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së Prokurimit: 03.09.2024	9. Burimi Financimit - Buxheti Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: 15 (një) OE b)Skualifikuar: 4
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** **N/A**	15. Vlera e kontratës **531,860** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumën **531,860** Lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (**zero**) Lekë.
17-Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar=30 ditë kalendarike; Zbatuar = 15 ditë kalendarike	19. Zgjatja e kontratës (-)
Sigurim kontrate:	23.**Akt i marrjes në dorëzim**	**24. Fletë Hyrja** Flete Hyrje në magazinë nr.147/2024,dt. 16.09.2024.

Ngritja e Komisioneve.

Komisioni i Prokurimit "Blerje e Vogël" ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024 , Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë:

- R.B, specialist SBNJSHS.
- V.K, specialist SKZHP (leje lidhje) zëvendësuar me P. N.
- Xh.T, specialist SBNJSHS.

Anëtarët e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 03.09.2024

Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 74 Prot, datë 16.09.2024, me Protokoll nr. 1884/3 Prot, datë 16.09.2024, i përbërë nga:

- Xh.T, specialiste,
- A.V, specialiste,
- Z. B, specialiste.

Planifikimi i nevojave.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) me shkresë nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024 i është drejtuar Ministria e Arsimit dhe Sportit se në vijimësi të zbatimin të programit mësimor në shkollat e mbështetura nga projekti "Element IT", dhe "Smart Lab", numri i manualeve të mësuesve për lëndën TIK në 306 shkollat publike që zhvillojnë programin mësimor, sipas parashikimit të regjistrimeve për vitin shkollor 2024-2024 është si më poshtë vijon:

Numri i manualeve të mësuesve të lëndës TIK për vitin shkollor 2024-2025 është si më poshtë vijon:

DRAP	**Publik**			**Privat**	
	Klasa e Parë	**Klasa e Dytë**	**Klasa e Tretë**	**Klasa e parë**	**Klasa e dytë**
Durrës	175	175	65	30	30
Fier	55	55	20	6	6
Korcë	65	65	30	10	10
Lezhe	55	55	15	4	4

Total	**350**	**350**	**130**	**50**	**50**

(Burimi: shkresa e AKAP nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024)

Numri i manualeve të **nxënësve t**ë lëndës TIK për vitin shkollor 2024-2025 është si më poshtë vijon:

DRAP	**Publik**			**Privat**	
	Klasa e Parë	**Klasa e Dytë**	**Klasa e Tretë**	**Klasa e parë**	**Klasa e dytë**
Durrës	9,750	9,270	3,910	1,250	1,200
Fier	2,000	2,000	1,100	170	150
Korcë	2,250	2,250	1,360	260	245
Lezhe	2,000	1,980	730	120	105
Total	**16,000**	**15,500**	**7,100**	**1,800**	**1,700**

(Burimi: shkresa e AKAP nr. 2231 Prot, datë 02.07.2024)

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 4159/3 Prot., datë 31.07.2024, i ka dërguar një shkresë Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), marrjen e masave lidhur me pajisjen e mësuesve dhe nxënësve me manualet e lëndës TIK për klasat e para, të dyta, për vitin shkollor 2024-2025, në kuadër të zbatimit të projekteve "Element IT" dhe "Smart Labs". Bashkëlidhur shkresës MAS dërgon formatin fizik dhe elektronin (CD) manualet e mësuesve dhe librat e punës për lëndën TIK për klasën e parë dhe të dytë.

Në këtë shkresë përcaktohet se në zbatim të Urdhërit nr. 328 Prot, datë 01.07.2024 me lëndë "*Për miratimin e manualeve të mësuesve dhe librave të punës për nxënësit për lëndën e teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), të klasës së parë dhe klasës së dytë*", po ju dërgojmë bashkëlidhur dokumentacion:

- Manualin e mësuesit dhe librave të punës së nxënësit për lëndën TIK , për klasën e parë dhe klasën e dytë;
- Numrin e manualeve të mësuesve dhe nxënësve;
- Urdhëri 328, datë 01.07.2024.

Nga auditimi u konstatua se sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve për vitin 2024, DRAP Durrës ka zhvilluar 2 (dy) procedura prokurimi të tipit "Blerje e Vogël", konkretisht stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të para me REF-17845-09-03-2024 dhe fond limit 653,437 lekë (pa TVSH) dhe stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të dyta me REF-17854-09-03-2024 dhe fond limit 886,432 lekë (pa TVSH).Vlera totale e këtyre dy procedurave është **1,539,869 lekë (pa TVSH).**

Stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të para dhe për nxënësit e klasave të dyta përbën grup mallrash ose shërbimesh të ngjashme.

Për rrjedhojë, këto procedura duhej të ishin konsideruar në mënyrë të përbashkët për efekt të përllogaritjes së kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël. Duke qenë se vlera e tyre e përbashkët arrin në 1,539,869 lekë (pa TVSH), pra tejkalon kufirin prej 1,000,000 (një milion) lekësh në vit, përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" **rezulton në kundërshtim** me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas të cilës për përcaktimin e kufirit monetar të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, duhet të merren në konsideratë grupet e mallrave apo shërbimeve të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe që, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen me qëllim përdorimin e kësaj procedure

Llogaritja e fondit limit:

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdher të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024 , Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, ka përllogaritu fondin limit për manuale TIK për klasën e dytë si më poshtë:

Llogaritja e fondit limit për manuale TIK për klasën e dytë:

Manual Për Lenden TIK	Njësia	Sasia (publik)	Sasia (privat)	Sasia (TOTAL	Çmimi			Fondi Limit (pa tvsh)	Fondi Limit (me tvsh)
					A R	M E DI	Mesata		
Klasa e parë- Nxënës	cope	9,750	1,250	11,000	82	48	**65**	633,750	760,500
Klasa e parë- Mësues	cope	175	30	205	140	85	**112.5**	19,688	23,625
Klasa e dytë- Nxënës	cope	9,270	30	9,300	107	80	**93.5**	866,745	1,040,094
Klasa e dytë- Mësues	cope	175	1,200	1,375	140	85	**112.5**	19,688	23,625
Klasa e tretë- Nxënës	cope	3,910	0	3,910	0	0	**0**	0	0
Klasa e tretë- Mësues	cope	65	0	65	0	0	**0**	0	0
	Totali	**23,345**	**2,510**	**25,855**				**1,539,870**	**1,847,844**

Hartimi i kritereve specifike dhe DST

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdher të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024 , Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, ka përllogaritu fondin limit për manuale TIK për klasën e dytë ka argumetuar dhe miratuar specifikiket teknike dhe kriteret per kualifikim me objekt procedure "Manuale TIK klasast e dyta" në vlerë **886,433 lekë (pa tvsh**).

Vleresimit të ofertave

Titullari me Urdher prokurimi nr. 17, datë 03.09.2024, Protokolluar me nr. 1884, datë 03.09.2024 ka urdheruar zhvillimin e procedurës së prokurimit të llojit "Blerje e Vogël" për manuale TIK për mësuesit dhe nxënësit për klasat e dyta, me fond limit 886,432 lekë (pa tvsh) ose 1,063,719 lekë (me tvsh).

Në urdhër prokurim është përsaktuar sasisa e manuale që do të prokurohen , përkatësisht 175 manuale klasa e dyte për mësues dhe 9270 Manuale klasa e dytë nxënës.

Komisioni i Blerjeve te vogla i eshte drejtuar OE me "**Ftesë për Ofert**" në SPE , Protokolluar me nr. 18884/1 Prot, datë 03.09.2024, ku eshte përcaktuar sasia dhe specifikimet teknike pet stampimin e Manualeve TIK klasa e dyte.

Klasa	Njësia	Sasia	Specifikimet teknike ---Manual TIK
Klasa e dytë- Nxënës	cope	9,270	Klasa e dytë, nxënes, 39 faqe, formati A4, letra 80 gr offset, shtypi me ngjyra, kopertina 300 gr - matt,
Klasa e dytë- Mësues	cope	175	Klasa e dytë, nxënes, 49 faqe, formati A4, letra 80 gr offset, shtypi me ngjyra, kopertina 300 gr - matt,
TOTAL		**9,435**	

Ne specifikimet teknike është përcaktuar destinacioni i dorëzimit të mallrave do të jetë në DRAP Durrës.

OE duhet të vërtetojë se ka në veprimtarinë e tij shërbimin e stampimit për kategorinë e përcaktuar në objektin e prokurimit.

OE i renditur i pari, përpara shpalljes fitues, duhet të dorëzojë pranë AK dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrat QKB-je;
- Të vërtetojë se ka kryer më parë shërbimin e kërkuar;
- Deklaratë me shkrim se i plotëson specifikimet teknike te përcaktuara më sipër;
- Afati i lëvrimit të mallit do të jetë brenda 2 (dy) ditë pune duke filluar nga data e dorëzimit në AK të kërkuar në këtë ftesë ofertë;
- Në ofertën e tij ofertuesi duhet të paraqesë të dhëna të plota të personit të kontaktit.

Komisioni i Blerjeve te vogla ka zhvilluar procedurën e prokurimit në SPE me REF-17845-09-03-2024,

Data e hapjes se procedurës se prokurimit 02/09/2024 ora 03:22 PM

Data e zhvillimit te procedurës se prokurimit do te jetë 04/09/2024 ora 15:30 .

Data e mbylljes te procedurës se prokurimit 04/09/2024 ora 03:00 PM

Pas hapjes se procedurës së prokurimit në SPE u konstatuan se janë paraqitur 16 OE, të cilët nga KVO (Blerje Vogël) janë klasifikuar si më poshtë;

-Manuale TIK për nxënës të klasave te dyta në SPE u paraqitën 15 OE nga të cilët u klasifikuan të suksesshme ofertat e paraqitura nga 11 OE dhe u s'kualifikuan si të pasuksesshme ofertat e paraqitura nga 4 OE përkatësisht J..; C; O shpk; Z pasi nuk e kanë objekt te fushës se veprimtarisë. Nga hapja e ofertave rezultuan se 2 (dy) oferta janë kualifikuar të suksesshme dhe më vlerë të barabartë, përkatësisht F. me ofertë 443,217 lekë (pa tvsh) dhe R.G me ofertë 443,217 lekë (pa tvsh).
Në këto rrethana AK ka aplikuar procedurën e hedhjes së shortit duke njoftuar të dy OE të cilët u renditën të parët në procedurën e prokurimit REF-17854-09-03-2024. Ne short morën pjesë

- OE F, me përfaqësues z. E.P, pajisur me Autorizim date 06.09.2024 nga z. F.Xh, administrator i shoqërisë F.
- R G (N/A)

Për këtë qëllim nga Komisioni i blerjeve të vogla ka mbajtur proces verbal nr. 1884/2 Prot, datë 06.09.2024, firmosur nga gjithë anëtarë e komisionit dhe nga përfaqësuesit e OE vetëm nga përfaqësuesi i F.
Sipas shortit të hedhur fitues rezultoi fitues OE Fdhe operator i dytë renditen R-G.
Data e shpërndarjes se njoftimit: dt 06.09.2024
Nga auditimi u konstatua se proces verbal nr. 1884/2 Prot, datë 06.09.2024, i mbajtur nga Komisioni i Blerjeve të Vogla nuk mban informacion mbi njoftim dhe mosprezencën e përfaqësuesit të operatorit ekonomik R G, në kundërshtim me nenin 82 pika 6. VKM nr. 285/2021 sipas të cilës nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së shortit u njoftohet ofertuesve nëpërmjet SPE. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për s'kualifikim.
Në dokumentacion e dosjes mungon formulari i shpalljes së fituesit F me ofertë fituese 443,217 lekë (pa tvsh), ne kundërshtim me nenin 83 pika 1 të VKM nr. 285/2021 sipas të cilës pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit.
OE Fshpallur fitues ka paraqitur pranë AK dokumentacion provues me shkrese "*Inventar dokumentacioni*" nr. (N/A), datë 06.09.2025, Protokolluar me nr. (N/A) . datë (N/A), duke dorëzuar materiale (origjinale) si më poshtë vijon:

- Oferta ekonomike
- Ekstrat QKB
- Deklarate e specifikimeve teknike
- IBAN

Kontrata
Komisioni i Blerjeve të vogla , në mungesë të kontratës së nënshkruar, për shkas të procedurës së prokurimit, ka mbajtur një "Proces verbal – Tipi i kontratës "Mall", për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Oferta ekonomike e paraqitur nga OE luan rolin e kontratës e shoqëruar me fature tatimore
Marrja në dorëzim
Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 74 Prot, datë 16.09.2024, me Protokoll nr. 1884/3 Prot, datë 16.09.2024, ka mbajtur Proces verbal marrje ne dorëzim nr.1884/4 Prot, datë 16.09.2024, nënshkruar nga anëtaret e komisionit; ku ka përcaktuar se Komisioni realizoi kontrollin sasior dhe marrjen në dorëzim të Manuale TIK për nxënës dhe mësues për klasën e Dytë. Sasia numerike është në përputhje me sasinë e faturës tatimorë nr. 147/2024, dt. 16.09.2026.

Proces verbali është firmosur nga Komisioni i marrjes në dorëzim dhe personi i autorizuar nga F. shpk (firme dhe vule).
Nga auditimi u konstatua se Komisioni i Marrjes në Dorëzim, në procesverbalin nr. 1883/3 Prot., datë 16.09.2024, nuk është shprehur mbi përputhshmërinë e manualeve TIK të marra në dorëzim me specifikimet teknike të përcaktuara, konkretisht për formatin e letrës, ngjyrat e stampimit, kopertinën dhe elementë të tjerë teknikë, duke mos garantuar verifikimin e plotë të mallrave të furnizuara në raport me kërkesat e përcaktuara nga Komisioni i Blerjeve të Vogla.

Pagesa

Urdhër shpenzim nr. 103, dt. 01.10.2024, për pagesën e F. në shumën 531,860 lekë (me tvsh).
Faturë tatimore nr. 147/2024, datë 16.09.2024.
Flete Hyrje në magazinë nr. 147/2024, dt 16.09.2024.
Urdhër prokurim nr. 17, datë 03.09.2024 , nënshkruar nga Titullari.
Ftesë për oferte nr. 1884/1 prot., datë 03.09.2024.
Procesverbal i hedhjes se shortit nënshkruar nga Komisioni BV.
Nga auditimi rezulton se AK ka likuiduar 100% shërbimin e kryer nga F. shpk, sipas faturës tatimore nr. 147/2024, datë 16.09.2024 në vlere 531,860 (lekë me tvsh).

Viti 2024

Prokurimi me objekt me objekt "*Vegla Muzikore*", për IAP-et në DRAP Durrës, REF-11859-07-02-2024

a. **"*Vegla Muzikore*", për IAP-et në DRAP Durrës**		
1. **Urdhër Prokurimi Nr.12 Prot, datë 02.07.2024**		
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: **Blerje e Vogël**	3. **Hartuesit e Dokumenteve Prokurimit:** Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "*Komisioni i Prokurimit- Blerje Vogë*l": - R B specialist SBNJSHS - V K specialist SKZHP -Xh T, specialiste SBNJSHS	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave: Urdhër Brendshëm Nr.09 Prot, datë 30.01.2024 "*Komisioni i Prokurimit- Blerje Vogë*l". -R B specialist SBNJSHS -V K specialist SKZHP -Xh T, specialiste SBNJSHS
5. Fondi Limit: 984,224 lekë (pa TVSH)	6. Oferta fituese "EL": 492,112 lekë (pa TVSH)	7. Diferenca me fondin limit 590,534 lekë (pa TVSH)
8. Data e hapjes së Prokurimit: 03/09/2024	9. Burimi Financimit - Buxheti Shtetit	10.Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender: (16) OE b)S kualifikuar: (11)
11. Ankimime AK (s'ka) APP (s'ka) KPP (s'ka)	12. Përgjigje Ankesës: nga AK : (s'ka)	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: (s'ka)
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14. Lidhja e **kontratës:** **N/A**	15. Vlera e kontratës **590,534** lekë (me TVSH)	16. Likuiduar: në shumën **590,534** lekë (me Tvsh) Pa likuiduar (**zero**) lekë.
17- Situacioni Përfundimtar…	18. Afati i kontratës në dite Parashikuar=30 dite kalendarike; Zbatuar = 10 ditë kalendarike	19. Zgjatja e kontratës (-)
Sigurim kontrate:	23.**Akt i marrjes në dorëzim**	**24. Fletë Hyrja** Flete Hyrje në magazinë nr. 6/2024, dt. 08.07.2024.

Ngritja e Komisioneve.

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024, Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë:

- R B, specialist SBNJSHS.
- V K, specialist SKZHP.
- Xh T, specialist SBNJSHS.

Anëtaret e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 31.07.2024
Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 61 Prot, datë 02.07.2024,

me Protokoll nr. 1527 Prot, datë 02.07.2024, i përbërë nga:
- Xh V, specialiste,
- A V, specialiste
- E B, specialiste.

Planifikimi i nevojave

Ministria e Arsimit dhe Sportit me email datë 3 Prill 2024, i ka dërguar Drap Durrës dhe gjithë DRAP-ve te tjera, marrjen e masave lidhur programin "Art dhe Zeje", sipas listës së shkollave dhe zërat e artikujve që janë përcjellë me email date 19 Mars 2024.

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur ne Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, e cili për programin "Vegla Muzikore" ka përcaktuar artikujt: kitare klasike, metronom digjital, sintonizues elektronik, daulle (perkusion), tela për klasike me voltazh te larte, set çelësash për kitarë.

Llogaritja e fondit limit:

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, ka përllogaritu fondin limit për vegla muzikore si më poshtë:

Manual për Lenden TIK	Njësi	Sasia	Çmimi pa tvsh	Fondi Limit (pa tvsh)	Fondi Limit (me tvsh)
Kitare klasike	copë	51	12,500	637,500	765,000
Metronom digital	copë	6	3,388	20,328	24,394
Sintonizues elektronik	copë	50	1,875	93,750	112,500
Daulle (perkusion)	copë	8	11,083	88,664	106,397
Tela për klasike me voltazh te larte	copë	38	1,011	38,418	46,102
Set çelësash për kitare		38	2,778	105,564	126,677
	totali	**191**		**984,224**	**1,181,069**

Hartimi i kritereve specifike

Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, ka miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim me objekt procedure "Vegla Muzikore" në vlerë **984,224 lekë (pa tvsh**).

Për këtë ka mbajtur proces verbal nr. 1524/2 Prot, datë 02.07.2024.

Nga auditimi u konstatua se në proces verbal nr. 1524/2 Prot, datë 02.07.2024, nuk është shënuar vlera e fondit limit, **në kundërshtim me** nenin 56 pika 4 të VKM nr. 285/2021 sipas të cilës komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, **duhet të përllogarisë fondin për sasinë e mallrave**, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme.

Vlerësimet e ofertave

Titullari me Urdhër prokurimi nr. 12, datë 02.07.2024, Protokolluar me nr. 1524, datë 02.07.2024 ka urdhëruar zhvillimin e procedurës së prokurimit të llojit "Blerje e Vogël" për manuale TIK për mësuesit dhe nxënësit për klasat e para, me fond limit **984,224 lekë** (pa tvsh) ose **1,181,069 lekë** (me tvsh).

Në urdhër prokurim është përcaktuar sasia artikujve që do të prokurohen sipas programit Art dhe Zeje "Vegla Muzikore", përkatësisht kitare klasike (51) copë, metronom digjital (6) copë, sintonizues elektronik (50) copë, daulle (perkusion) (8) copë, tela për klasike me voltazh te larte (38) copë, set çelësash për kitare (38) copë.

Komisioni i Blerjeve te vogla i është drejtuar OE me "**Ftesë për Ofertë**" nr. 3 në SPE , Protokolluar me nr. N/A Prot, datë N/A, ku është përcaktuar sasia dhe specifikimet teknike për stampimin e Manualeve TIK klasa e parë.

Data e publikimit te njoftimit: "**Ftesë për Ofertë**" në SPE dt. 02/09/2024 03:22 PM

Specifikimet teknike janë detajuar për çdo artikull.

OE duhet të vërtetojë se ka në veprimtarinë e tij shërbimin e stampimit për kategorinë e përcaktuar në objektin e prokurimit.
OE i **renditur i pari**, përpara shpalljes fitues, duhet të dorëzojë pranë AK dokumentacionin si më poshtë:
- Ekstrat QKB-je;
- Të vërtetojë se ka kryer më parë shërbimin e kërkuar'
- Deklaratë me shkrim se i plotëson specifikimet teknike te përcaktuara më sipër;
- Afati i lëvrimit të mallit do të jetë brenda 2 (dy) ditë pune duke filluar nga data e dorëzimit në AK të kërkuar në këtë ftesë ofertë;
- Në ofertën e tij ofertuesi duhet të paraqesë të dhëna të plota të personit të kontaktit.

Komisioni i Blerjeve te vogla ka zhvilluar procedurën e prokurimit në SPE me REF-11859-07-02-2024
Data e hapjes **te procedurës se prokurimit** në SPE dt. 03/09/2024 14:30 AM
Data e mbylljes **te procedurës se prokurimit** në SPE dt. 04/09/2024 03:00 PM.
Pas hapjes se procedurës së prokurimit në SPE u konstatuan se janë paraqitur 16 OE, të cilët nga KVO (Blerje Vogël) në SPE u paraqitën 16 OE nga të cilat u klasifikuan të suksesshme ofertat e paraqitura nga 8 OE dhe u **s'kualifikuan si të pasuksesshme ofertat e paraqitura nga 11** OE përkatësisht F; M- M; A; B; J O T; A K; S; J P &P; O G; E..&E; E.Z pasi nuk e ka në fushën e veprimtarisë.
Nga hapja e ofertave rezulton se **ofertuesi i renditur në vend të parë është E. L** me ofertë 492,112 lekë (pa tvsh)
Data e publikimit te njoftimit: të fituesit dt. 03/07/2024 02:30 PM
Nga auditimit u konstatua se në dokumentacion mungon formulari i shpalljes së fituesit E.Lme ofertë 492,112 lekë (pa tvsh), **ne kundërshtim me** nenin 83 pika 1 të VKM nr. 285/2021, sipas të cilës pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave, autoriteti/enti kontraktor bën klasifikimin përfundimtar dhe harton njoftimin e fituesit.

OE E L (person fizik) shpallur fitues ka paraqitur pranë AK dokumentacion provues si më poshtë vijon:
- Oferta ekonomike e detajuar.
- Autorizim përfaqësimi.
- Certifikate Regjistrimi në AKSH---Bnt E. me NIPT J.D.
- Kontrate shërbimi E. L me B. E..
- Ekstrat QKB.
- Deklarate e specifikimeve teknike, ku OE merr përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.
- IBAN.

Kontrata
Komisioni i Blerjeve të vogla , në mungesë të kontratës së nënshkruar, për shkas të procedurës së prokurimit, ka mbajtur një Proces verbal nr. 1524/2 Prot, datë 02.07.2024 për procedurën e prokurimit sipas programit Art dhe Zeje "Vegla Muzikore" për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.
Oferta ekonomike e paraqitur nga OE luan rolin e kontratës e shoqëruar me fature tatimore
Marrja në Dorëzim
Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit, i ngritur me Urdhër nr. 61 Prot, datë 02.07.2024, me Protokoll nr. 1527 Prot, datë 02.07.2024, ka mbajtur Proces verbal marrje ne dorëzim nr. 1524/3 Prot, datë 08.07. 2024, nënshkruar nga anëtaret e komisionit.

Komisioni realizoi kontrollin sasior dhe marrjen në dorëzim të veglave muzikore. Sasia numerike është në përputhje me sasinë e faturës tatimore nr. 198/2024, dt. 08.07.2026.
Proces verbali është firmosur nga Komisioni i marrjes në dorëzim dhe personi i autorizuar nga E.L (firmë dhe vulë).
Nga auditimi u konstatua se komisioni i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike për "Kitarë Klasike" si pjesa e sipërme, ura, gjerësi, thellësi, ngjyra; për Metronom digjital specifikime si variacione rrahjesh për praktikim, butoni "tempo" për të rregulluar ritmin, ekran i madh LCD , funksion i zërit, etj,sipas termave teknike të përcaktuar në specifikimet teknike, etj. në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara nga Komisioni i Blerjeve të Vogla.

Pagesa

Urdhër shpenzim nr. 77, dt. 17.07.2024, për pagesën e E L në shumën 590,534 lekë (me tvsh).
Faturë tatimore nr. 198/2024, datë 08.07.2024;
Fletë Hyrje në magazinë nr. 11/2024, dt. 16.09.2024
Urdhër prokurim nr. 17, datë 03.09.2024 , nënshkruar nga Titullari
Ftesë për ofertë nr. 3
Proces verbal për argumentimin e specifikimeve teknike nr. 1524/2 Prot, datë 02.07.2024
Proces verbal marrje në dorëzim nr. 1524/3 Prot, datë 08.07. 2024.
Fletë Hyrje nr. 6, datë 08.07.2024.
Nga auditimi rezulton se AK ka likuiduar 100% shërbimin e kryer nga E.L, sipas faturës tatimore nr. 198/2024, datë 08.07.2024 në vlere 590,534 (lekë me tvsh).

Për sa më sipër ngarkohen me personat përgjegjës si më poshtë:

*-Titullari i AK **z. H.L**, në cilësinë e mbikëqyrësit të gjithë procedurave të prokurimit të realizuara AK sipas konstatimeve të grupit te auditimit, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së dhe nenin 73 të VKM nr. 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si më poshtë vijon:*

- Në procedurën e prokurimit "Negocim pa shpallje paraprake" për librat artsitike me të drejtë autori me objekt "Biblioteka 2024-2025 për librin artistik për pasurim fondi biblioteka te arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar".

Komisioni i Vlesimit të Ofertave i ngritur me urdhër nr. 83/2024 mbi realizimin e procedurës së prokurimit me fond limit 10,141,509 lekë (pa tvsh), ne "procedure më negocim pa shpllaje paraprake të njoftimit ttë kontratës"e ndarë në 16 Lote me përbërje:

- *M .M, specialist SIVC;*
- *V. D, specialiste finance (ZVAP Kamëz);*
- *E. M., përgjegjëse SIVC.*

Komisioni Zbatimit e Kontratës, ngritur me Urdhër Nr. 93/2024, Prot. 1847/77, datë 06,12,2024 i përbërë nga:

- *z. Xh. V;*
- *znj. A. V;*
- *z. E. B*

Në procedurën e prokurimit "Negocim pa shpallje paraprake" me objket "Biblioteka 2024-2025 për librin artistik për pasurim fondi biblioteka te arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar",

Komisioni i Vlesimit të Ofertave i ngritur me urdhër nr. 83/2024 mbi realizimin e procedurës së prokurimit me fond limit 10,141,509 lekë (pa tvsh), ne "procedure më negocim pa shpllaje paraprake të njoftimit ttë kontratës"e ndarë në 16 Lote me përbërje:

- *M.M, specialist SIVC;*
- *V.D, specialiste finance (**ZVAP Kamëz);***

- *E.M.,përgjegjëse SIVC.*

Komisioni Zbatimit e Kontratës, ngritur me Urdhër Nr. 93/2024, Prot. 1847/77, datë 06,12,2024 i përbërë nga:

- *z. Xh.V;*
- *znj. A.V*
- *z. E.B*

Prokurimi me objekt me objekt "Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së parë", Manuale TIK për nxënësit e klasave të para për DRAP Durrës, REF-17845-09-03-2024.

dhe Prokurimi me objekt me objekt "Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së dytë", Manuale TIK për nxënësit e klasave të dyta për DRAP Durrës, REF-17845-09-03-2024.

*Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024, Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë:*

- *R.B , specialist SBNJSHS*
- *V.K , specialist SKZHP (leje lidhje) zëvendësuar me P N*
- *Xh.T, specialist SBNJSHS*

Anëtaret e komisionit kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 03.09.2024

***Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit**, i ngritur me Urdhër nr. 73 Prot, datë 16.09.2024, me Protokoll nr. 1884/3 Prot, datë 16.09.2024, i përbërë nga:*

- *Xh.T, specialiste,*
- *A.V, specialiste*
- *Z.B , specialiste.*

Prokurimi me objekt me objekt "Vegla Muzikore", për IAP-et në DRAP Durrës, REF-11859-07-02-2024

*Komisioni i Prokurimit "**Blerje e Vogël"** ngritur me Urdhër nr. 9 datë 30.01.2024, nr. 388 Prot, datë 30.01.2024, i ndryshuar me Urdhër të brendshëm nr. 68, datë 13.08.2024, Protokolluar me nr. 1792 Prot, datë 13.08.2024, për ndryshim anëtar komisioni, si më poshtë:*

- *R.B., specialist SBNJSHS*
- *V.K, specialist SKZHP*
- *Xh.T, specialist SBNJSHS*

***Komisioni për marrjen në dorëzim të mallit**, i ngritur me Urdhër nr. 61 Prot, datë 02.07.2024, me Protokoll nr. 1527 Prot, datë 02.07.2024, i përbërë nga:*

- *Xh.V, specialiste,*
- *A.V, specialiste*
- *E.B , specialiste.*

2.2.2 Mbi zbatimin e legjislacionit për shpenzimet e tjera të kryera.

Procedurat e prokurimit të shpenzimeve të transportit për ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Kamëz, ZVAP Rrogozhinë dhe ZVAP Vorë.

Me shkresë nr. 448 Prot, datë 07.04.2025, DRAP Tiranë ka informuar se nuk ka lidhur kontratë për shërbimin e transportit të punonjësve dhe nxënësve, duke kërkuar marrjen e masave për pagesat sipas VKM nr.119, datë 01.03.2023 "Për pagesën e shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë dhe nxënësit përfitues", deri në mars 2025; me shkresë nr. 930 Prot, datë 02.07.2025, për periudhën deri në qershor 2025; dhe me shkresë nr. 1872 Prot, datë 25.11.2025, për periudhën deri në dhjetor 2025.

Po ashtu, DRAP Durrës ka njoftuar me shkresë nr. 1558 Prot, datë 08.07.2024, se nuk ka lidhur kontratë për transportin deri në qershor 2024; me shkresë nr. 2866 Prot, datë 14.11.2024, për

periudhën shtator–tetor 2024; dhe me shkresë nr. 3155 Prot, datë 13.12.2024, për nëntor–dhjetor 2024, gjithashtu duke u mbështetur në VKM nr.119/2023. Më herët, me shkresë nr. 2573 Prot, datë 14.12.2023, dhe nr. 2916 Prot, datë 30.11.2022, DRAP Durrës ka informuar se nuk është lidhur kontratë për transportin për shkak të mungesës së interesit nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit, duke u mbështetur në VKM nr.119/2023. Ndërsa me shkresë nr. 1492 Prot, datë 13.06.2022, është raportuar e njëjta situatë për 12 ZVAP nën juridiksionin e DRAP Durrës, sipas VKM nr.682, datë 07.07.2015 "Për pagesën e shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë dhe nxënësit përfitues", e ndryshuar, pas procedurës së prokurimit të datës 10.05.2022 ku nuk pati interes nga operatorët ekonomikë.

Nga auditimi u konstatua se: DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës **nuk kanë realizuar me sukses procedurat e prokurimit për prokurimin publik dhe tarifat e miratuara për transportin rrethqytetës**, të cilat subvencionohen, bazuar në shkronjën "b", të nenit 10, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, veprim në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2025, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", e ndryshuar, sipas së cilës DRAP-et dhe ofruesit e arsimit profesional publik duhet të prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe tarifat e miratuara për transportin rrethqytetës.

Në rrethanat e mos realizimit te procedurave te prokurimit DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës kanë njoftuar ZVAP se nuk është lidhur asnjë kontratë për shërbimin e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë, duke urdhëruar kryerjen e pagesave të transportit të punonjësve

❖ **Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë**

- Auditimi u fokusua në zbatimin e legjislacionit lidhur me shpenzimet e transportit për mësues dhe nxënës.

Nga verifikimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje shpenzimet për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre, për periudhën 2022-2025 rezultoi se Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar **Tiranë** ka planifikuar dhe realizuar shpenzime transporti si më poshtë vijon:

Shpenzimet e transportit për nxënës dhe punonjës arsimore (në lekë)

ZVAP Tiranë	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Plan	51,147,145	49,783,606	56,247,507	65,430,399
Fakt	50,651,640	49,779,423	56,236,321	62,887,160
Realizuar (%)	**99.03%**	**99.99%**	**99.98%**	**96.11%**

(Burimi: ZVAP; Punoi KLSH)

Për vitin 2022 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 51,147,145 lekë dhe realizuar 50,651,640 lekë ose realizuar **99.03%.**

Për vitin 2023 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 49,783,606 leke dhe realizuar 49,779,423 lekë ose realizuar **99.99%.**

Për vitin 2024 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 56,247,507 leke dhe realizuar 56,236,321ose realizuar **99.98%.**

Për vitin 2025 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 65,430,399 leke dhe realizuar 62,887,1608 lekë ose realizuar **96.11%.**

Plani dhe realizmi i shpenzimeve te transportit (në lekë)

ZVAP	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
TIRANE	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës
Plan	17,865,837	33,281,308	20,835,444	28,948,162	23,858,037	32,389,470	27,672,645	37,757,754
Fakt	17,529,386	32,923,566	21,105,452	28,872,065	22,818,306	33,179,429	26,597,026	36,290,134
Nxënës Mësues	35%	65%	42%	58%	41%	59%	42%	58%

(Burimi: ZVAP; Punoi KLSH)

Raporti shpenzimeve të transportit **për nxënës** varjon nga 65% ne vitin 2022 me tendencë ulje deri ne 58% në vitin 2025. Ndërsa shpenzimet e transportit për mësues variojnë nga 35% në vitin 2022 deri 42% në vitin 2025 me tendencë në rritje.

Në zbatim të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar, ZVAP Tiranë i është drejtuar Bashkisë Tiranë me shkresat si më poshtë vijon:

- **Për vitin buxhetor 2025**

ZVAP Tiranë i është drejtuar Bashkisë Tiranë me **kërkesë** nr. 2959 Prot, datë 05.03.2025, për miratimin e linjave të urbane transportit punonjësve arsimore dhe të nxënësve (gjithsej 312 destinacione) duke kërkuar dërgimin e linjave urbane të miratuara nga Bashkia Tiranë dhe përcaktimin e distancës në kilometra nga qendra e banimit ku nisen nxënësit dhe mësuesit deri në shkollat e arsimit 9- vjeçar dhe të mesëm.

Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 10123/1 Prot, datë 27.10.2025, Protokolluar me nr. 3643 Prot, datë 08.04.2025 **ka miratuar** distancat në kilometra (**për 312 linjave**) të transportit mësues-nxënës viti shkollor 2025-2026.

- **Për vitin buxhetor 2024**

ZVAP Tiranë i është drejtuar Bashkisë Tiranë për përcaktimin e distancës në km midis qendrës se banuar ku nisen nxënës, mësuesit dhe shkollës ku zhvillohet mësimi me shkresat nr. 4406/2 Prot, datë 19.12.2023, nr. 634 Prot, datë 24.01.2024.

Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje duke përcaktuar distancën sipas kërkesës së ZVAP Tiranë:

- me shkresë nr. 928, datë 09.01.2024 ka përcaktuar distancën në km nga qendra e banimit të mësuesit/ nxënësit deri në destinacion shkolla ku zhvillohet mësimi **(237 destinacione)**
- me shkresë nr.4409/1 Prot, datë 05.02.2025, ka informuar mbi linjat e transportit publik qytetës dhe rrethqytetës që funksionojnë brenda kësaj njësie vendore, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve për 16 linja transport publik, miratuara më VKB Tiranë nr. 39, datë 23.05.2016 "*Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në bashkinë e Tiranës* , mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja", i ndryshuar, ka miratuar 15 linja qytetëse.

Bashkia Tiranë me **VKB Tiranë nr.66, datë 30.12.2015** "*Indeksimin e tarifave të transportit qytetës në Bashkinë Tiranë*", i ndryshuar, ka miratuar tarifat e transportit qytetës janë përkatësisht:

-**Për një udhëtim vajtje/ardhje 40 lekë (me tvsh);** për biletë pajtimit mujor, për 1(një) linjë 1,200 lekë (me tvsh); për biletë pajtimi mujor të përgjithshëm për të gjitha linjat 1,600 lekë (me tvsh);dhe për biletë pajtimi mujor, të përgjithshëm, për studentët, për të gjitha linjat, 600 lekë (me tvsh).

- **Për vitin buxhetor 2023**

ZVAP Tiranë i është drejtuar Bashkisë Tiranë për përcaktimin e distancës në km midis qendrës se banuar ku nisen nxënësit/ mësuesit dhe shkollës ku zhvillohet mësimi me shkresat nr. 2786 Prot, datë 20.01.2023, nr. 1525 Prot, datë 21.03.2023 për informacion për linjat e transportit publik.

Bashkia Tiranë ka kthyer përgjigje duke përcaktuar distancën sipas kërkesës së ZVAP Tiranë:

-me shkresë nr. 2786/1, datë 07.02.2023 ka përcaktuar distancën në km nga qendra e banimit të mësuesit/ nxënësit deri në destinacion shkolla ku zhvillohet mësimi (117 destinacione).

- me shkrese nr.2561/1, dt. 12.04..2023 ku pasqyruar gjithë linjat e transportit publik qytetës dhe tarifat e udhëtimit të miratuara me VKB Tirane.

❖ **Për vitin buxhetor 2022**

Nga ZVAP Tirane grupit te auditimit nuk ju vunë ne dispozicion kërkesat drejtuar bashkisë Tirane dhe përgjigjet përkatëse për miratimin e distancave të udhëtimit për nxënës dhe mësues dhe linjat e transportit publik që funksionojnë brenda juridiksionit të Bashkisë Tiranë

Bashkia Tiranë me VKB nr. 39, datë 23.05.2016 "Për përcaktimin e linjave të trasnportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobuzëvë të shërbimit në këto linja", i ndryshuar, ka të miratuara linjat e transportit qytetës dhe rrethqytetës.

ZVAP Tiranë ka kërkuar miratimin e linjave për trasnportin e mesuesve dhe nxënësve sipas distacës së udhëtimit.

❖ **Tarifa e transportit të aplikuara për mësues dhe punonjës arsimore**

Në mbështetje të pikës **1 germa a)** VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "P*ër përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit",* i ndryshuar, përcaktohet nga buxheti i shtetit përballohen fondet publike të shpenzimeve **për transportin se punonjësve arsimorë** të institucioneve arsimore parauniversitar publike, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), **që punojnë larg vendbanimit** të përhershëm të tyre, **jashtë qendrave urbane** dhe **kthehen brenda ditë**s në vendbanim, **në distancën mbi 5 km deri në 50 km**;

Tarifat e transportit është llogaritur mbi tarifën fillestare duke filluar nga distanca më e vogël deri 10 km me tarifë 50 lekë për vajte ose 100 lekë (vajtje –ardhje), *bazuar në Shtojcën 1 në* VKM nr. 92/2024*'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*.

Pas indeksimit sipas normës së inflacionit tarifat e aplikuara për transportin e nxënësve janë si më poshtë:

1. Për vitin 2022, në vlerë 145 ,[40] leke (e indeksuar)
2. Për vitin 2023, në vlerë 145,[40] leke (e indeksuar), ndryshuar në prill 151,[80] (e indeksuar)
3. Për vitin 2024, në vlerë 151 leke (e indeksuar)
4. Për vitin 2025, në vlerë 148.[95] leke (e indeksuar)

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. **1746 Prot., datë 06.03.2024**, me lëndë "*Për zbatimin e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*, protokolluar në ZVAP Kamëz me nr. 612, datë 06.03.2024, **ka udhëzuar** të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore se, nga data e hyrjes në fuqi të VKM nr. 92, datë 21.02.2024, në përllogaritjen e fondeve të procedurave të prokurimit apo mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe mësuesit, referuar **VKM nr. 119, datë 01.03.2023** "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, duhet të zbatohen tarifat e përcaktuara në VKM nr. 92/2024, duke qenë se shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit subvencionohet në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Përgjigja e **Bashkisë Tiranë** ne shkresë nr. 4409//1Prot, dt. 05.02.2024, Protokolluar në institucion me nr. 878 Prot, dt. 07.02.2024 tregojë se Këshilli Bashkiak[2] ka miratuar 15 linjat e transportit publik qytetës, dhe tarifën e biletës së udhëtimit për këto linja.

Tarifat e krahasuara të biletës së udhëtimit

Tarifat e udhëtimit	Lloji i	Çmimi i biletës vajtje ose	Çmimi i biletës	Çmimi i biletës vajtje

[2] *VKB Tiranë nr. 39, datë 23.05.2016 "Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja", i ndryshuar.*

VKB Tirane nr. 66 ,datë 30.12.2015 "Për indeksimin e tarifave të transportit qytetës në bashkinë e Tiranës".

	transportit	ardhje (lek)	vajtje + ardhje (lek)	+ ardhje (lek) +50%
		punonjës	**punonjës**	**nxënës**
VKB Tiranë nr. 39, datë 23.05.2016	qytetes	40	80	120
	rrethqytetës	40	80	120
VKB Tirane nr. 66 ,datë 30.12.2015	*Ndërqytetës*	50	100	150

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 913/2 Prot, datë 19.02.2025, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 406/1 Prot, datë 10.02.2025, ka dërguar indeksin e çmimeve të konsumit për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2024 i cili është (-0.07%).

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 971/2 Prot, datë 22.02.2024, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 225/1 Prot, datë 13.02.2024, ka dërguar indeksin e çmimeve të konsumit për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2023 i cili është (4.78%).

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 1490 Prot, datë 02.03.2023, në zbatim të VKM nr.682/2015, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 126/1 Prot, datë 31.01.2023, ka dërguar indeksin e çmimeve të konsumit për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2022 i cili është (4.46%).

Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025 për periudhën maj deri dhjetor të 2025, ZVAP Tiranë ka **aplikuar tarifën e indeksuar** për punonjës arsimore dhe për nxënësit që udhëtojnë mbi 2 km, **në kundërshtim** me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, sipas të cilit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 24.04.2025, është ndryshuar pika 3 duke eliminuar (hequr) mekanizmin e indeksimit. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, me datë publikimi 24.04.2025.

Ndikimi i indeksimit të tarifës me (-0.7%) konsiderohet i papërfillshëm me efekt financiar për periudhën maj-dhjetor 2025.

Nga auditimi përcaktimit të tarifave të punonjësve arsimore dhe nxënësve **u konstatua se** nga ZVAP Tiranë, **tarifat e udhëtimit janë llogaritur sipas distancave dhe tarifave ndërqytetëse** të miratuara me VKM nr. 92/2024*"Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"* ***duke filluar me tarifë minimale 100 lekë/ditë*** *(e paindeksuar)në ditë miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe* ***jo tarifë*** **80 lek**ë/ditë miratuar nga Këshilli Bashkisë Tiranë, **në kundërshtim** më kërkesat e paragrafit 1 dhe **3 të VKM nr. 119**, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar*, sipas të cilës buxheti i shtetit përballon shpenzimet e transportit sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar i cili në nenin 10, germa "c" dhe "ç" e ligjit nr. 8308/1998 "Për transportet rrugore" përcakton se tarifat e biletave të **transportit qytetas dhe rrethqytetas** të udhëtarëve me autobus **miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore**, sipas nenit 14 të këtij ligji, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.

Tarifat e aplikuara janë në kundërshtim edhe me VKB Tirane nr. 66 ,datë 30.12.2015 "Për indeksimin e tarifave të transportit qytetës në bashkinë e Tiranës", i ndryshuar sipas të cilit tarifat e udhëtimit qytetëse dhe rrethqytetëse janë për një udhëtim 40 lek/ ditë ose 80 leke/ ditë vajtje-ardhje.

Nga auditimi përcaktimit të tarifave të nxënësve **u konstatua se** për shpenzimet e **transportit të nxënësve** që udhëtojnë mbi 2 km nga Bashkia Tiranë **mungon informacioni nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës**, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*",

sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar. Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km duhet të plotësohet edhe kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës.

Shkresa e MAS nr. 1746 Prot., datë 06.03.2024 për transportin qytetas dhe rrethqytetas, me referencë aplikimin e tarifave ndërqytetëse për tarifat qytetëse dhe rrethqytetëse, përcaktuar në VKM nr. 92/2024, nuk përputhet me dispozitat e nenit 10, germat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 8308/1998, pasi këto tarifa miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe jo nga Këshilli i Ministrave**.**

Procedurat e realizimit të shpenzimeve të transportit:

- **Pagesat transportit të punonjësve arsimore (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social)** kryhen sipas:

ZVAP përpilon **listë pagesë** mujore firmosur nga hartuesi i dokumentit (specialisti) përgjegjësi i sektorit të financës dhe Titullari i ZVAP-se;

Listëpagesat mujore ZVAP-se mbështet në listëprezencën e dërguar nga IAP-të, firmosura nga Drejtori i IAP-it, duke shënuar ditët mësimore të punonjësve arsimore për pagesë shpenzime transporti dhe distancën distanca sipas linjave nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollën ku ata janë punonjës arsimorë, firmosur nga Titullari IAP-it.

Ato përgjithësisht përmbajnë numër dhe datë Protokolli sipas shkollës përkatëse.

Pagesat e punonjësve arsimore kryhen **100% në bankë**

Pagesat e nxënësve kryhet **100% në Postën Shqiptare.**

Për auditim u përzgjodhën listëpagesat e në muajin dhjetor 2025 sipas të cilave rezulton se:

Për muajin dhjetor 2025 ka llogaritur shpenzime transporti për muajin nëntor për 18 dite mësimore faktike dhe dhjetor 2025 për 13 ditë mësimore faktike si për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare, në total **11,078,190** lekë nga të cilat **4,729,890** lekë për transport mësuesish dhe **6,348,300 lekë** për transport nxënësish.

Listat e pagesave për shpenzimet e transportit janë analizuar të grupuara sipas shkollave që përfshin secila listë, pasi specialistët e financës nuk kishin ndjekur një standard të caktuar në hartimin e dokumentit.

Për auditim u përzgjodhën listëpagesave të transportit për muajin **dhjetor 2025** rezulton si më poshtë vijon:

I. Listëpagesa e shpenzimeve te transportit nëntor dhe dhjetor 2025, për pagën e mësuesve për shkollat 9-vjecare: "4 Dëshmoret"; "Dëshmorët e Lirisë"; "Dora D'istria"; "Gjergj Fishta"; "Gjon Buzuku"; "Isa Boletini"; "Konferenca e Pezës"; "Kol Jakova"; "Kosova"; "M.Grebllleshi"; "M.Q.Ataturku"; "Misto Mame"; "O. Myderizi"; "S. Luarasi"; "Servete Maçi"; "Sh. Peza".

Sipas listë pagesës rezulton se:

- **(39)** punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkollat publike 4 Dëshmoret"; "Dëshmorët e Lirisë"; "Dora D'istria"; "Gjergj Fishta"; "Gjon Buzuku"; "Isa Boletini"; "Konferenca e Pezës"; "Kol Jakova"; "Kosova"; "Mustafa Grebllleshi"; "Mustafa Qemal Ataturku"; "Misto Mame"; "Osman Myderizi"; "Selman Luarasi"; "Servete Maçi"; "Sh. Peza" me vëndodhje në **qytetin e Tiranë**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **333,280** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti zero lekë.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.1 bashkëngjitur materialit.

- **(11)** punonjës arsimore të arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike **Asim Vokshi; Arben Broci; Kostandin Kristoforidhi; Petro Nini Luarasi; Sander Prosi, Sinan Tafaj**, me vendodhje në **qytetin e Tiranës** janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **115,770** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti zero lekë.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.2 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë, kanë përfituar shpenzime transporti **(50) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje **qyteti Tiranë** janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në total në shumën **449,050 lekë,** Punonjësit arsimorë të përfshirë në këtë listëpagesë kanë përfituar shpenzime transporti, **në kundërshtim me pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë duhet të përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike **me vendndodhje jashtë qendrave urbane**.

- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Në listëpagesë nuk përfshihet kompensimi i diferencuar sipas distancës së transportit, por klasifikohet në listëpagesën e pagës si element page i pataksuar.

II. **Listëpagesa e shpenzimeve te transportit nëntor dhe dhjetor 2025, për pagën e mësuesve të shkollave 9-vjecare:**

17 Shkurti; Emin Duraku; Lasgush Poradeci; Qazim Turdiu; Bashkim Fino; Lidhja e Prizrenit; Marie Logoreci; 1 Maji; 1 Qershori; E Kuqe; Nene Tereza; Betim Muço.

- **(26)** punonjës arsimore të arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat punojnë në shkollat publike 17 Shkurti; Emin Duraku; Lasgush Poradeci; Qazim Turdiu; Bashkim Fino; Lidhja e Prizrenit; Marie Logoreci; 1 Maji; 1 Qershori; E Kuqe; Nene Tereza; Betim Muço, me vendodhje brenda qytetit Tiranë, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën 220,120 lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti zero lekë.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.3 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë, kanë përfituar shpenzime transporti (26) punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje brenda 11 Njësive Administrative të Bashkisë Tirane, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën 220,120 lekë.

Punonjësit arsimorë të përfshirë në këtë listëpagesë kanë përfituar shpenzime transporti, **në kundërshtim me pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë duhet të përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike me vendndodhje jashtë qendrave urbane.

- Në listëpagesë nuk shënohet qendra administrative e shkollës;
- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Dokumentacioni konfirmimit të distancës nuk disponohet në ZVAP, por pretendohet i disponuar nga drejtoret e IAP-ve, të cilët miratojnë listë prezencën për ditët mësimore në shkollë për të cilat paguhen shpenzime transporti;
- Listë prezencat mbajnë numër Protokolli të e IAP-ve, por nuk kanë numër Protokolli të ZVAP.
- Listë prezencat e IAP-it, jo në të gjitha rastet e përcaktojnë distancën e transportit;

- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Modeli i elementeve të listëpagesës është i ndryshëm ndërmjet specialistëve të të njëjtit sektor.
- **(81)** punonjës arsimore të arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat punojnë në shkolla publike **jashtë 11 Njësive të Bashkisë Tirane**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **283,630** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti **221,400** lekë me tarife 2,700 lek/muaj.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.4 bashkengjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë, kanë përfituar shpenzime transporti **(81) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje **jashtë qendrës urbane** të Bashkisë Tirane, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 kompensim i transporti në shumën 221,400 lekë, më tarifë fikse 2700 lekë/ muaj, **në kundërshtim** me kompensimin e transportit me tarifë të diferencuar 1000; 1500 dhe 2700 lekë sipas pikës 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit" , i ndryshuar;

-në listëpagesë shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
-në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
-në listëpagesën e pagave kompensimi i diferencuar nuk llogaritet sipas distancës së transportit;
-modeli i elementeve të listëpagesës është i ndryshëm ndërmjet specialistëve të të njëjtit sektor.

III. Listëpagesa e shpenzimeve te transportit nëntor dhe dhjetor 2025, për pagesën e shpenzimeve të transportit të mësuesve të shkollave:

Shkolla e mesme: Shkolla e Mesme e Bashkuar Peze e Madhe; Shkolla e Mesme Sadi Nuri, Shkolla e Mesme e Bashkuar Ymer Lala; Shkolla e Mesme e Bashkuar Kasallë; Shkolla e Mesme e bashkuar Zall Herr.

Shkolla 9-vjecare: Shkolla 9-vjecare Ejona Dinga, shkolla 9-Vjecare Qinam; 9-Vjecare Dritas; 9-vjeçare Çerkez, 9-vjecare e Bashkuar Berisha; 9-vjecare Seit Brahja.

- **(204)** punonjës arsimore të arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat punojnë në shkolla publike Shkolla **e** Mesme e Bashkuar Peze E Madhe; 9-Vjecare e Bashkuar Berisha; 9-Vjecare Seit Brahja; Shkolla e Mesme Sadi Nuri, Shkolla e Mesme e Bashkuar Ymer Lala; Shkolla 9-Vjec Ejona Dinga, shkolla 9-Vjecare Qinam; 9-Vjecare Dritas; Shkolla e Mesme e Bashkuar Kasalle; shkolla e Mesme e bashkuar Zall Herr; 9 Vjeçare Çerkez, **jashtë qendrës urbane të Bashkisë Tirane**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **843,670** lekë, **në përputhje** me **pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë duhet të përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike ë punojnë **jashtë qendrës urbane** Tirane, **jashtë qendrave urbane** dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km.
- shpenzime për kompensimin e transporti **469,800** lekë me tarife 2,700 lek/muaj.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.5 bashkengjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVA Tiranë, në zbatim pikës 11 germa a) të **VKM nr. 425/2024** "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*", i ndryshuar, ka llogaritur dhe paguar **kompensim mujor për largësi nga vendbanimi** për çdo punonjës mësimor që punon mbi 5 km deri në 50 km, larg vendbanimit dhe kthehet brenda ditës.

Kompensim për largësi është llogaritur dhe paguar në masën 2,700 lekë në muaj, përcaktuar në

kolonë të veçantë në listëpagesën e pagave, si shume neto, që i shtohet të ardhurave nga paga pas zbritjes së sigurimeve dhe tatimeve të llogaritura.
Totali i pagesave për punonjësit e kësaj listëpagesë **në shumën 469,800 lekë** është **në kundërshtim** me *pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit, i ndryshuar, e cila* **parashikon kompensim të diferencuar për distanca**t: mbi 5 km deri në 10 km në vlerën 1,000 lekë/muaj; mbi 10 km deri në 20 km 1 në vlerën 1,500 lekë/muaj dhe mbi 20 km deri në 50 km në vlerën 2,700 lekë/muaj
- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Në listëpagesën e pagave nuk llogaritet kompensimi i diferencuar sipas distancës së transportit.
- Modeli i elementeve të listëpagesës së transportit është i ndryshëm ndërmjet specialistëve të të njëjtit sektor.
Sa më sipër nga auditimi u konstatua se në procesin e zbatimit, kuadri aktual nënligjor ka krijuar **mbivendosje dhe paqartësi ligjore**, duke sjellë një praktikë jo të unifikuar nga ZVA-të, Konkretisht:

- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024**, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, në pikën 11, germa "a", përcakton një normë të unifikuar për kompensimin e transportit, **në masën fikse prej 2,700 lekë/muaj**.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 01.03.2023**, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, në pikën 6, **parashikon një kompensim mujor të diferencuar**, i cili lidhet me dispozitat e shkronjës "a" të pikës 11 të vendimit nr. 425/2024.

Ky kuadër aktual nënligjor ka sjellë pasiguri në interpretim dhe zbatim, duke krijuar mospërputhje në praktikën administrative në institucioneve arsimore dhe ZVA-ve.

IV. Listëpagesa e shpenzimeve te transportit nëntor dhe dhjetor 2025, për pagesën e mësuesve te shkollave:

Shkolla 9-vjecare: Vilezez Kocaj; Mushqeta; Bastar; Berzhite; H.M, Zall Dajt; Vahid Haka; Fushas; Mustafa Lleshi; Ibrahim Hima; Kus; Lalm, Mangull, Mihal Duri, Picalle, Sami Kalasa, Nexhmi Tafaj, Farke e Vogël, Lundër,

Shkollat e mesme: Mesme e Bashkuar Krrabë; M.B.Farkë; MB.N.Z-Bastar; Mesme e Bashkuar Vaqar, Mesme Ibrahim Hasmema, Mesme Bashkuar Kllojkë, Mesme Bashkuar Feti Vogli, Mesme Bashkuar 100 Vjetori, Mesme Bashkuar Mersin Duqi, Mesme e Bashkuar Shëngjergj.

- **(547)** punonjës arsimore të arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat punojnë në shkolla publike **jashtë qendrës urbane të Bashkisë Tirane**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **2,538,170** lekë, **në përputhje** me **pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike , punojnë **jashtë qendrave urbane** dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km.
- shpenzime për kompensimin e transporti **1,069,200** lekë me tarife 2,700 lek/muaj.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.6 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVA Tiranë, në zbatim pikës 11 germa a) të **VKM nr. 425/2024** "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në*

institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, ka llogaritur dhe paguar **kompensim mujor për largësi nga vendbanimi, jashtë qendrave urbane,** për çdo punonjës mësimor që punon mbi 5 km deri në 50 km, larg vendbanimit dhe kthehet brenda ditës.

ZVAP ka paguar kompensim për largësi **me vlere 2,700 lekë në muaj**, përcaktuar në kolonë të veçantë në listëpagesën e pagave, si shume neto, që i shtohet të ardhurave nga paga pas zbritjes së sigurimeve dhe tatimeve të llogaritura. Totali i pagesave për punonjësit arsimore të kësaj listëpagesë **në shumën 1,069,200 lekë** është **në kundërshtim** me *pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit, i ndryshuar, e cila* **parashikon kompensim të diferencuar për distanca**t: mbi 5 km deri në 10 km në vlerën 1,000 lekë/muaj; mbi 10 km deri në 20 km 1 në vlerën 1,500 lekë/muaj dhe mbi 20 km deri në 50 km në vlerën 2,700 lekë/muaj

- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Në listëpagesën e pagave **nuk llogaritet kompensimi i diferencuar** sipas distancës së transportit.
- Modeli i elementeve të listëpagesës është i ndryshëm ndërmjet specialistëve të të njëjtit sektor.

Në procesin e zbatimit, kuadri aktual nënligjor ka krijuar **mbivendosje dhe paqartësi ligjore**, duke sjellë një praktikë jo të unifikuar nga ZVA-të, Konkretisht:

- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024**, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, në pikën 11, germa "a", përcakton një normë të unifikuar për kompensimin e transportit, **në masën fikse prej 2,700 lekë/muaj**.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 01.03.2023**, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, në pikën 6, **parashikon një kompensim mujor të diferencuar**, i cili lidhet me dispozitat e shkronjës "a" të pikës 11 të vendimit nr. 425/2024.

Ky kuadër aktual nënligjor ka sjellë pasiguri në interpretim dhe zbatim, duke krijuar mospërputhje në praktikën administrative ndërmjet institucioneve arsimore dhe ZVA-ve.

- në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë, kanë përfituar shpenzime transporti **(46) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike **me vendndodhje brenda** 11 Njësive Administrative të Bashkisë Tirane, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **363,940 l**ekë,
- shpenzime per kompesim **transporti zero lekë.**
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.7 bashkengjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë, kanë përfituar shpenzime transporti **(46) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje **brenda** qytetit Tirane, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **363,940 l**ekë.

Punonjësit arsimorë të përfshirë në këtë listëpagesë kanë përfituar shpenzime transporti, **në kundërshtim me pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë duhet të përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike **me vendndodhje jashtë qendrave urbane**.

- Në liste pagesë nuk shënohet qendra administrative e shkollës;
- Në listëpagesë nuk shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- Dokumentacioni konfirmimit të distancës nuk disponohet në ZVAP, por pretendohet i

disponuar nga drejtoret e IAP-ve, të cilët miratojnë listë prezencën për ditët mësimore në shkollë për të cilat paguhen shpenzime transporti;

- Listë prezencat mbajnë numër Protokolli të e IAP-ve, por nuk kanë numër Protokolli të ZVAP.
- Listë prezencat e IAP-it, jo në të gjitha rastet e përcaktojnë distancën e transportit;
- Në listëpagesën e pagave nuk përfshihet kompensimi i diferencuar sipas distancës së transportit.
- Modeli i elementeve të listëpagesës është i ndryshëm ndërmjet specialistëve të të njëjtit sektor.

❖ **Listëpagesat e transportit të nxënësve**

Pagesat transportit të punonjësve nxënësve kryhen sipas listë pagesave të dërguara nga IAP-et, ne te cilat shënohet:

- emri dhe mbiemri i nxënësit përfitues,
- ID e nxënësit përfitues
- klasën ku mëson nxënësi;
- Linjën e transporti për distanca në kilometra mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm i nxënësit deri në shkollë
- adresën e shkollës, njësinë administrative ku ndodhet shkolla;
- ditë mësimore prezent në mësim sipas list prezencës nga Drejtori IAP-it;
- çmimi i transportit vajtje ardhje 150 lekë/ditë
- vlera neto për tu paguar
- nënshkrimi nga personi që tërheq shumën në postë.

Listë pagesat janë nënshkruar nga NZ dhe NA.

❖ **Pagesat e shpenzimeve të transportit.**

Pagesat e shpenzimeve të transportit për **punonjës** arsimorë vitin 2025 janë paguar në total ne vlere 62,887,160 lekë dhe për **nxënës** ne vlere 28,195,914 lekë dhe për mësues 34,691,246 lekë

Pagesat e Punonjësve arsimore **kryer nëpërmjet llogarive bankare.**

Pagesat e **nxënësve** kryhen nëpërmjet 100% me **shërbimi postar**, në emër të prindërve të nxënësve, të kujdestareve ligjore apo përfituesve me prokurë të posaçme.

Të dhënat analitike sipas urdhër shpenzimeve janë pasqyruar sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Shpenzimet transport 2025 (në lekë)

Nr.	Programi	Urdhër Shpenzimi	Data Urdhër Shpenzim	Shuma	Nxënës/ Mësues	Posta	Banka
1	9120	Nr. 66	11.03.2025	600,600	Nxënës	Posta Qendrore	
2	9230	Nr. 66	11.03.2025	107,100	Nxënës	Posta Qendrore	
3	9120	Nr. 72	13.03.2025	185,180	Mësues		BKT
4	9230	Nr. 72	13.03.2025	1,152,031	Mësues		BKT
5	9120	Nr. 73	13.03.2025	411,470	Mësues		RZB
6	9120	Nr. 74	13.03.2025	4,170	Mësues		OTP
7	9120	Nr. 75	13.03.2025	125,280	Mësues		Credins
8	9120	Nr. 103	16.04.2025	8,094,220	Mësues		BKT
9	9120	Nr. 123	06.05.2025	4,015,390	Mësues		BKT
10	9120	Nr. 124	06.05.2025	1,239,100	Mësues		RZB
11	9120	Nr. 125	06.05.2025	8,850	Mësues		OTP
12	9120	Nr. 128	06.05.2025	12,960	Mësues		INTESA
13	9120	Nr. 127	07.05.2025	3,900	Mësues		TIRANA
14	9230	Nr. 126	06.05.2025	416,380	Mësues		Credins
15	9120	Nr. 189	10.07.2025	12,871,464	Nxënës	Posta Qendrore	
16	9120	Nr. 198	17.07.2025	3,546,660	Mësues		BKT
17	9120	Nr. 199	17.07.2025	1,127,630	Mësues		RZB
18	9230	Nr. 200	17.07.2025	327,980	Mësues		Credins
19	9120	Nr. 201	17.07.2025	1,800	Mësues		TIRANA
20	9120	Nr. 202	17.07.2025	9,360	Mësues		INTESA
21	9120	Nr. 203	17.07.2025	2,819,050	Mësues		BKT
22	9120	Nr. 206	17.07.2025	6,720	Mësues		INTESA
23	9230	Nr. 205	17.07.2025	279,470	Mësues		Credins

24	9230	Nr. 225	01.08.2025	902,955	Mësues		RZB
25	9120	Nr. 337	18.11.2025	8,280,450	Nxënës	Posta Qendrore	
26	9120	Nr. 366	05.12.2025	3,707,310	Mësues		BKT
27	9230	Nr. 367	05.12.2025	1,194,850	Mësues		RZB
28	9230	Nr. 368	05.12.2025	332,850	Mësues		Credins
29	9230	Nr. 369	05.12.2025	12,500	Mësues		INTESA
30	9230	Nr. 370	05.12.2025	5,440	Mësues		TIRANA
31	9230	Nr. 371	11.12.2025	5,850	Mësues		OTP
32	9120	Nr. 392	31.12.2025	6,336,300	Nxënës	Posta Qendrore	
33	9230	Nr. 386	31.12.2025	13,450	Mësues		INTESA
34	9230	Nr. 387	31.12.2025	10,540	Mësues		TIRANA
35	9230	Nr. 388	31.12.2025	4,650	Mësues		OTP
36	9120	Nr. 385	31.12.2025	310,070	Mësues		Credins
37	9120	Nr. 384	31.12.2025	1,143,410	Mësues		RZB
38	9120	Nr. 383	31.12.2025	3,247,770	Mësues		BKT
39	9120	Nr. 389	31.12.2025	6,500	Mësues		BKT
40	9120	Nr. 390	31.12.2025	5,500	Mësues		RZB
			Totali	**62,887,160**			

(Burimi: ZVAP Tiranë; Punoi KLSH)

ZVAP Tiranë me urdhër shpenzim Nr. 66, Nr. 72, Nr. 73, Nr. 74, Nr. 75 datë 13.03.2025 ka paguar shpenzimet e transportit për mësues dhe nxënës në vlerë me tre muaj vonese.

- Me urdhër shpenzim Nr.103 dt. 16.04.2025 ka paguar shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve me tre muaj vonese.
- Nr.123 dt.06.05.2025;Nr.124, dt.06.05.2025; Nr.125 dt.06.05.2025; Nr. 128 dt. 06.05.2025; Nr. 127 dt. 07.05.2025; Nr. 126 dt. 06.05.2025 ka paguar shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve me tre muaj vonesë.
- Me urdhër shpenzim nr. Nr. 189 dt.10.07.2025 ka paguar shpenzimet e transportit për nxënës për periudhën mars- qershor 2025 me tre muaj vonesë.
- Me urdhër shpenzim Nr. 198 dt17.07.2025; Nr. 199 dt. 17.07.2025; Nr.200 dt. 17.07.2025; Nr. 201 dt. 17.07.2025; Nr. 202 dt. 17.07.2025, ka paguar shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve me tre muaj vonesë.
- Me urdhër shpenzim Nr. 203, dt. 17.07.2025; Nr. 206, dt17.07.2025; Nr. 205, dt. 17.07.2025, Nr. 225, dt. 01.08.2025 shpenzimet e transportit të muajit maj janë paguar me dy muaj vonesë.
- Me urdhër shpenzim Nr. 225, dt. 01.08.2025; Nr. 337, dt.18.11.2025; Nr. 366 dt.05.12.2025, Nr. 367, dt.05.12.2025, Nr. 368, dt.05.12.2025; Nr. 369, dt.05.12.2025; Nr. 370, dt.05.12.2025; Nr. 371, dt.11.12.2025 shpenzimet e muajve shtator dhe tetor janë paguar me dy muaj vonesë.
- Me urdhër shpenzim Nr. 392, dt. 31.12.2025; Nr. 386, dt. 31.12.2025; Nr. 387, dt. 31.12.2025; Nr. 388, dt. 31.12.2025; Nr. 385, dt.31.12.2025; Nr. 384, dt. 31.12.2025; Nr. 383, dt. 31.12.2025 shpenzimet janë në afat.

Nga auditimi u konstatua se Titullari **nuk ka lëshuar urdhër për** kryerjen e pagesës së transportit të punonjësve mësimorë që punojnë brenda dhe jashtë territorit të bashkisë së tyre dhe nxënësve të mbështetur në VKM nr. 119, datë 01.03.2025 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, ne kundërshtim me nenin 12.3.a të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*".

ZVAP Tiranë **ka kryer pagesat e shërbimit të transportit 100% nëpërmjet shërbimit postar**. Në listat e pagesave nuk **është shënuar prindi kujdestar** që ka të drejtë të tërheqë shumën e transferuar ne postë, ne emër të nxënësit të identifikuar me ID, në kundërshtim me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 **"***Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*" sipas të cilit ZVAP-të, bazuar në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, duhet të kryejnë pagesat

çdo muaj përmes llogarive bankare të prindërve, kujdestarëve ligjorë, përfituesve me prokurë të posaçme. Përdorimi i shërbimit postar lejohet vetëm në zonat ku shërbimi bankar mungon ose është i paaksesueshëm, sipas pikës 2 të vendimit, deri në nënshkrimin e kontratës nga DRAP me operatorët ekonomikë për realizimin e transportit.

ZVAP Tiranë nuk ka kryer rakordime mujore me Postën Shqiptare për fondet tërhequra nga prindi kujdestar, sipas listëpagesës së depozituar në postë.

ZVAP Tiranë nuk ka kryer llogaritur dhe paguar shpenzimet e transportit për çdo muaj, veprim në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119/2023, sipas të cilës ZVAP-të, paguajnë çdo muaj shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, mbështetur në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar.

Liste prezencat e IAP-ve, nuk mbajnë numër dhe datë Protokoll hyrës në ZVAP Tiranë, veprim në **kundërshtim me** nenin 24 te Rregullores se Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP-Tirane *sipas të cilit përcaktohet se dokumentet hyrëse regjistrohen ne regjistrin e Protokollit nga punonjësi i arkiv Protokollit i cili bën shënimin në to të numrit të Protokollit dhe datës së marrjes së shkresës.*

Gjithashtu, ZVAP Tiranë **nuk disponon rregullore të miratuar nga DRAP Tiranë**, i cili të përcaktojë **dokumentin vërtetues për përcaktimin distancës nga adresa e vendbanimit të përhershëm**, institucionin që duhet të disponojë dokumentin e vërtetimit të distancës, të dhënat që duhet të përmbajë një listë pagesë për shpenzimet e transportit, veprim që bie ndesh me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas së cilës *pagesat duhet të kryhen çdo muaj mbi bazën e të dhënave të dërguara nga institucionet arsimore*.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjesi personat si më poshtë:

- z. K.F në cilësinë e NZ të ZVAP Tiranë.
- znj. E.M në cilësinë NA në ZVAP Tiranë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit u paraqitur observacion nga ZVAP Tirane me shkresën nr. 6054/1 prot, datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/11 prot, datë 20.07.2026, lidhur me gjetjen nr. 26 në të cilën evidenohet së një numër punonjësish arsimore kanë përfituar shpenzime transporti në kundërshtim me pikën 1 dhe pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, me argumentin se institucionet arsimore nuk ndodhen brenda qendrave urbane të qytetit Tiranës.

Lidhur me këtë konstatim sqarojmë se: Pagesat janë kryer mbi bazën e dokumentacionit të administruar nga institucionet arsimore përkatëse dhe listë prezencave të miratuara nga drejtuesit e IAP-ve. Përfituesit shpenzimeve të transportit janë trajtuar për distanca reale dhe kosto transporti të konsiderueshme, referuar përcaktimeve të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, kunnë pikën 1, germa a) është përcaktuar tekstualisht: "1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e: a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;" .

Në këtë vendim evidentohet lehtësisht se ndërmjet fjalës "larg vendbanimit të tyre të përhershëm" dhe fjalës "jashtë qendrave urbane", nuk ka një lidhës "dhe", që do ta bënte automatikisht të

lidhur dhe të ndërvarur plotësimin e këtyre dy kushteve në mënyrë kumulative dhe të pandashme. Pra mjafton plotësimi i vetëm i një kushti që mund të jetë ose punonjësi të punojë larg vendbanimit të tij të përhershëm, ose të kushtit të punojë jashtë qendrave urbane që të përfitojë fonde për përballimin e shpenzimeve të transportit sipas tarifave në varësi të kilometrave, të dokumentuara me dokumentacionin përkatës.
Nuk përcakton në mënyrë të detajuar metodologjinë e matjes së distancës apo kriteret e qarta për ndarjen mes "qendrës urbane" dhe "zonave periferike", duke lënë hapësirë interpretimi në zbatim. ZVAP Tiranë ka vepruar në funksion të garantit të vijimësisë së procesit mësimor, duke shmangur penalizmin e punonjësve që realisht përballojnë shpenzime transporti për paraqitjen në vendin e punës si dhe në hapësirën ligjore të krijuar nga VKM e sipërcituar. Vlerësojmë së nuk kemi të bëjmë me pagesa fiktive, por me interpretim të administrativ të dispozitave ligjore në kushtet e mungesës së një udhëzimi të detajuar unifikues.
Evidentohet se në listë pagesa nuk është shënuar distanca për përfitimin e shpenzimeve të transportit. Ne lidhje më këtë evidentim, sqarojmë se dokumentacioni mbështetës për vendbanimin dhe vendin e ushtrimit të detyrës është administruar në dosjet përkatëse të punonjësve dhe në institucionet arsimore.
Listë pagesat financiare janë hartuar kryesisht për efekt likuidimi, dhe përmbajmë element financiarë të nevojshëm për kryerjen e pagesës. Mungesa e pasqyrimit të distancës përbën mangësi formale dokumentare dhe jo shkelje me efekt financiar. Nuk rezulton të jetë krye pagesa për punonjës jashtë marrëdhënieve të punës apo pa dokument justifikues. Konstatimi se specialistët e financës nuk kanë ndjekur një model unik listë pagesë lidhet me organizimin e brendshëm administrativ të dokumentacionit ndër vite. Diferencat në format nuk kanë sjelle pasoja financiare dhe nuk kanë ndikuar në llogaritjen e shumave të përfituara. Mungesa enjë modeli unik , nuk përbën por nevojë për përmirësim procedural.
ZVAP Tiranë, do të marrë masa për unifikimin e formatit të listë pagesave dhe pasqyrimin më të plotë të elementëve administrativë.
Edhe në rekomandimin 26.2 nga grupi audites është evidentuar që ka paqartësi dhe përplasje ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjorë që rregullojnë transportin e mësuesve dhe nxënësve.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi i listëpagesave të transportit për muajin dhjetor 2025 në ZVAP Tiranë u konstatua se kanë përfituar shpenzime transporti gjithsej punonjës arsimorë të arsimit 9-vjeçar dhe të arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytet ose fshat dhe me vendndodhje të IAP-ve publike brenda qendrave urbane dhe njësive administrative të Bashkisë Tiranë, Përfitimi i këtyre pagesave rezulton në kundërshtim me pikën 11, germa "a", të VKM nr. 119, datë 01.03.2023, i ndryshuar, sipas së cilës përfitimi i shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë kushtëzohet me ushtrimin e detyrës në IAP publike me vendndodhje jashtë qendrave urbane.
Interpretimi sipas të cilit mjafton plotësimi i vetëm njërit prej kushteve ligjore për përfitimin e shpenzimeve të transportit nuk mbështetet në formulimin e dispozitës, pasi kushtet e përcaktuara në VKM nr. 119/2023 janë kumulative dhe kërkojnë plotësimin njëkohësisht të kritereve që lidhen me vendndodhjen e IAP-së jashtë qendrave urbane, largësinë nga vendbanimi i përhershëm, kthimin brenda ditës dhe distancën e përcaktuar ligjërisht. Argumenti juaj në observacion nuk përputhet me kriterin ligjor , arsye për të cilin nuk pranohet.
Në lidhje me konstatimin se në listëpagesë nuk është shënuar distanca për përfitimin e shpenzimeve të transportit, sqarojmë se pavarësisht se dokumentacioni mbështetës për vendbanimin dhe vendin e ushtrimit të detyrës është administruar në dosjet përkatëse të punonjësve dhe në institucionet arsimore dhe nga verifikimi i tyre nga grupi i auditimit nuk u konstatuan

mospërputhje, distanca është element mbi te cilin aplikohet tarifa dhe llogariten shpenzimet e transportit. Ai duhet të jetë element i veçantë ne liste pagesë dhe jo vetëm në formulën mbi të cilat llogariten shpenzimet.
Në lidhje me konstatimin se specialistët e financës nuk kanë ndjekur një model unik të listëpagesës lidhet me organizimin administrativ të brendshëm dhe mënyrën e organizimit ndër vite dhe reflektimi juaj se në vijim do të ndërmerren masa për unifikimin e formatit të listëpagesave dhe pasqyrimin më të plotë të elementeve administrativë, vlerësohet nga grupi i auditimit si shprehje e interesit për rritjen e performancës në punë.
Në lidhje me konstatimin se DRAP/ZVAP kanë vijuar pagesat në kushtet kur nuk janë lidhur kontrata shërbim transporti, sqarojmë se kjo problematikë është evidentuar në ZVAP për shpenzimet e transportit, por jo si përgjegjësi e saj por si përgjegjësi e DRAP Tiranë ose DRAP Durrës, të cilat gjithsesi kanë operuar me shkresa urdhëruese për kryerjen e shpenzimeve të transportit sipas kritereve ligjore në fuqi.
Në lidhje me konstatimin për pajisjen me autorizim të prindit kujdestar, argumentoni se Posta Shqiptare zbaton rregullat e saj dhe pagesat kryhen me kartë identiteti të fëmijës dhe prindit, kështu që nuk është kompetencë e ZVAP Tiranë për autorizim prindi kujdestar
Pretendimi juaj nuk përputhet plotësisht me dispozitën ligjore të cituar, sepse argumenti i ZVAP Tiranë fokusohet te mënyra operative e tërheqjes së pagesës nga operatori postar, ndërsa dispozita ligjore përcakton qartë subjektin përfitues dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.

❖ **Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë**

Nga verifikimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje shpenzimet për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre, për periudhën 2022-2025 rezultoi se në Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar ka planifikuar dhe realizuar shpenzime transporti sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Zvap	2022	2023	2024	2025
Plan	17,912,960	12,658,380	11,801,200	14,020,550
Fakt	15,180,123	12,130,141	11,536,917	12,954,815
	85%	96%	98%	92%

(Burimi ZVAP; Punoi KLSH)

Për vitin 2022 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 17,912,960 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 15,180,123 lekë ose 85%;
Për vitin 2023 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 12,658,380 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 12,130,141lekë ose 96%;
Për vitin 2024 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 11,801,200 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 11,536,917 lekë ose 98%;
Për vitin 2025 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 14,020,550 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 12,954,815 lekë ose 92%.

Shpenzimet e transportit për nxënës dhe punonjës arsimore (në lekë)

ZVA	**01.01.2022 - 31.12.2022**	**01.01.2022 - 31.12.2022**	**01.01.2023 - 31.12.2023**	**01.01.2023 - 31.12.2023**	**01.01.2024 - 31.12.2024**	**01.01.2024 - 31.12.2024**	**01.01.2025 - 31.12.2025**	**01.01.2025 - 31.12.2025**
	mësues	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**
Pan	2,163,492	15,749,468	2,589,322	10,069,058	2,390,691	9,410,509	3,670,571	10,349,979
Fakt	2,981,842	12,198,328	2,603,852	9,526,288	2,968,463	8,619,437	2,929,098	10,100,992
	20%	**80%**	**21%**	**79%**	**26%**	**74%**	**22%**	**78%**

(Burimi: ZVAP; Punoi KLSH)

Nga auditimi rezulton se në ZVAP Kavajë pashëm specifike me të madhe e zënë shpenzimet e

transportit e zëne shpenzimet e transportit për nënës të cilat përbëjnë 74% deri 80% të shpenzimeve vjetore kundrejt shpenzimeve të transportit për mësues më peshë specifike 20% deri në 22% të shpenzimeve vjetore.
Në zbatim të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit* , i ndryshuar, ZVAP Kavaje
Për vitin buxhetor 2025
- me shkresë nr. 1418 Prot, datë 10.10.2024, i është drejtuar Bashkisë Kavajë me kërkesë për miratimin e linjave të transportit dhe konfirmimin e listave të punonjësve arsimorë sipas listave të nxënësve dhe punonjësve arsimorë për vitin 2024-2025 ne total 339 punonjës arsimore dhe nxënës.
- me shkresë nr. 1419 Prot, datë 10.10.2024, i është drejtuar Bashkisë Kavajë se në zbatim të VKM nr. 119/2023, i ndryshuar, DRAP Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për transportin e punonjësve arsimore dhe nxënësve dhe arsye për të cilën na nevojitet informacion mbi linjat e licencuara dhe tarifat e transportit në Bashkinë Kavajë.
- ZVAP Kavaje me shkresë nr. 1100 Prot, datë 10.10.2025, i është drejtuar Bashkisë Kavajë me kërkesë për miratimin e linjave të transportit dhe konfirmimin e listave të punonjësve arsimorë sipas listave të nxënësve dhe punonjësve arsimorë për vitin 2025-2025.
- me shkresë nr. 1100/1 Prot, datë 29.10.2025, i është drejtuar Bashkisë Kavajë se në bazë të pikës 4 të VKM nr. 119/2023 , i ndryshuar, ZVAP duhet të bazohet tek çmimi i biletës i miratuar me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, i cili indeksohet me normën e inflacionit. Për këto arsye kërkohet dërgimi i tarifave/ çmimeve të biletave të transportit rrethqytetës dhe ndërqytetës, sipas tabelave bashkëlidhur.
- Me shkresë nr. 1100/2 Prot, datë 29.10.2025, i është drejtuar Bashkisë Kavajë se në zbatim të VKM nr. 119/2023 , i ndryshuar, **DRAP Tiranë do të zhvilloj procedurën e prokurimit** par transportin e punonjësve arsimore dhe nxënësve dhe arsye par të cilën **kërkohet informacion mbi linjat e licencuara të transportit në bashkinë Kavajë.**
Bashkia Kavajë me shkresë nr. 1335 Prot, datë 13.03.2026 më lëndë "**Kthim përgjigje**", informon se në përgjigje të tajës nr. 1100, datë 10.10.2025 **ju njoftojmë** se të dhënat e kërkuara për distancat në kilometra të linjave të transportit mësues- nxënës viti shkollor 2025-2026, **janë të njëjta, të pandryshuara, sipas miratimit të bërë me VKB nr. 219, datë 26.04.2024**, të cilin e kemi dërguar me shkresë nr. 59/3 Prot, datë 10.05.2024 (e pandryshuar).
ZVAP Kavajë me shkresë përcjellëse nr. 303 Prot, data 19.03.2026 ka dërguar në DRAP Tiranë listat e punonjësve arsimore dhe nxënësve përfitues të shërbimeve të transportit për vitin shkollor 2025-2026.
Nga auditimi u konstatua se Bashkia Kavajë, **me** *VKB Kavajë nr. 219, datë 26.04.2024 "Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve brenda territorit të Bashkisë Kavajë* ka të miratuara **linjat e transportit** qytetës dhe rrethqytetës .

- **Tarifa e transportit të aplikuara për mësues dhe punonjës arsimore**

Në mbështetje të pikës **1 germa a)** VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "P*ër përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit",* i ndryshuar, përcaktohet nga buxheti i shtetit përballohen fondet publike të shpenzimeve **për transportin se punonjësve arsimorë** të institucioneve arsimore parauniversitar publike, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), **që punojnë larg vendbanimit** të përhershëm të tyre, **jashtë qendrave urbane** dhe **kthehen brenda ditë**s në vendbanim, **në distancën mbi 5 km deri në 50 km**;

Tarifat e transportit është llogaritur mbi tarifën fillestare duke filluar nga distanca më e vogël deri 10 km me tarifë 50 lekë për vajte **ose 100 lekë (vajtje –ardhje),** *bazuar në Shtojcën 1 në* VKM nr. 92/2024*'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*.

*Pas indeksimit sipas normës së inflacionit tarifat e aplikuara për transportin e **nxënësve j**anë si më poshtë:*

- Për vitin 2022, në vlerë 145.[40] leke (e indeksuar)
- Për vitin 2023, në vlerë 145.[40] leke (e indeksuar), ndryshuar në prill 151,[80] (e indeksuar)
- Për vitin 2024, në vlerë 151.[80] leke (e indeksuar)
- Për vitin 2025, në vlerë 148.[95] leke (e indeksuar)

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. **1746 Prot., datë 06.03.2024**, me lëndë "*Për zbatimin e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'"*, Protokolluar në ZVAP Kamëz me nr. 612, datë 06.03.2024, ka udhëzuar të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore se, nga data e hyrjes në fuqi të VKM nr. 92, datë 21.02.2024, në përllogaritjen e fondeve të procedurave të prokurimit apo mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe mësuesit, referuar VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, duhet të zbatohen tarifat e përcaktuara në VKM nr. 92/2024, duke qenë se shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit subvencionohet në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Përgjigja e **Bashkisë Kavajë** ne shkresë nr. 4409//1Prot, dt. 05.02.2024, Protokolluar në institucion me nr. 878 Prot, dt. 07.02.2024 tregojë se Këshilli Bashkiak[3] ka miratuar 13 linjat e transportit **publik rrethqytetës**, dhe tarifën e biletës duke filluar 1-10 km ne vlere 100 lekë/ ditë ne vajtje plus kthim, duke vijuar me distancat e tjera.

Tarifat e krahasuara të biletës së udhëtimit

Tarifat e udhëtimit	Lloji i transportit	Çmimi i biletës vajtje ose ardhje (lek)	Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek)	Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek) +50%
		punonjës	**punonjës**	**nxënës**
VKB Kavajë nr. 219, datë 26.04.2024	Qytetës/ rrethqytetës	50	100	150
VKM nr. 92/2024	*Ndërqytetës*	50	100	150

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 913/2 Prot, datë 19.02.2025, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 406/1 Prot, datë 10.02.2025, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2024 i **cili është (-0.07%).**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 971/2 Prot, datë 22.02.2024, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 225/1 Prot, datë 13.02.2024, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2023 i **cili është (4.78%).**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 1490 Prot, datë 02.03.2023, në zbatim të VKM nr.682/2015, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 126/1 Prot, datë 31.01.2023, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2022 i **cili është (4.46%).**

Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVAP Kavajë ka **aplikuar tarifën e indeksuar** për punonjës arsimore dhe për nxënësit që udhëtojnë mbi 2 km, **në kundërshtim** me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për*

[3] *VKB Kavajë nr. 219, datë 26.04.2024 "Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve brenda territorit të Bashkisë Kavajë"*

transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, sipas të cilit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 24.04.2025, është ndryshuar pika 3 duke eliminuar (hequr) mekanizmin e indeksimit. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, me datë publikimi 24.04.2025. Ndikimi i indeksimit të tarifës me (-0.7%) konsiderohet i papërfillshëm me efekt financiar për periudhën maj-dhjetor 2025.

ZVAP Kavajë, tarifat e udhëtimit janë llogaritur sipas distancave dhe tarifave ndërqytetëse të miratuara me VKM nr. 92/2024"Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus" duke filluar me tarifë minimale 100 lekë/ditë (e paindeksuar) miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe me VKB Kavajë nr. 219, datë 26.04.2024 "Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve brenda territorit të Bashkisë Kavajë", në përputhje më kërkesat e paragrafit 1 dhe 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, rrethqytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.

Sa më sipër u konstatua se ZVAP Kavajë ka llogaritur tarifat e udhëtimit sipas distancave dhe tarifave ndërqytetëse të miratuara me VKM nr. 92/2024 *"Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*, duke aplikuar tarifë minimale prej 100 lekë/ditë (e paindeksuar), të miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe jo tarifën 80 lekë/ditë të miratuar me *VKB Kavajë nr. 219, datë 26.04.2024 "Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve brenda territorit të Bashkisë Kavajë"* veprim në kundërshtim me pikat 1 dhe 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 *"Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, sipas së cilës përballimi i shpenzimeve të transportit kryhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar.

Nga auditimi përcaktimit të tarifave të nxënësve u konstatua se për shpenzimet e transportit për shpenzimet e transportit të nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km nga Bashkia Kavajë mungon informacion nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar. Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km duhet të plotësohet edhe kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës**.**

- **Procedurat e realizimit të shpenzimeve të transportit:**

ZVAP përpilon **listë pagesë** mujore firmosur nga hartuesi i dokumentit (specialisti) përgjegjësi i sektorit të financës dhe Titullari i ZVAP-se;

Listëpagesat mujore ZVAP-se mbështet në listëprezencën e dërguar nga IAP-të, firmosura nga Drejtori i IAP-it, duke shënuar ditët mësimore të punonjësve arsimore për pagesë shpenzime transporti dhe distancën distanca sipas linjave nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollën ku ata ka llogaritur shpenzime transporti për muajin nëntor për 18 dite mësimore faktike dhe dhjetor 2025 për 13 ditë mësimore faktike si për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare, në total 766,105 lekë nga të cilat 210,230 lekë për transport mësuesish dhe 555,875 lekë për transport nxënësish.

Pagesat janë kryer 100% me bankë.
janë punonjës arsimorë, firmosur nga Titullari IAP-it.
Ato përgjithësisht përmbajnë numër dhe datë protokolli sipas shkollës përkatëse.
Pagesat e punonjësve arsimore kryhen **100% në bankë**
Pagesat e nxënësve kryhet **100% në Banke, me përjashtim transportit të nxënësve të** shkollës 9 vjeçare Bago (**2%** deri ne fillim mars 2025 në vlere total 246,824 lekë) e cila ka qenë në rikonstruksion, për të cilën ZVAP Kavajë ka paraqitur këtë korrespodencë shkresore:
- shkresë nr. 167, datë 05.02.2025 drejtuar Bashkisë Kavajë, (*për dijeni edhe MAS*) kërkesë për informacion lidhur me rikonstruksionin e **shkollës 9-vjecare Bago, Kavajë.** Në këtë kërkesë kërkohet informacion se kur parashikohet të përfundojë rikonstruksioni i shkollës, pasi sipas kontratës së lidhur ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe Kontraktuesit, rikonstruksioni duhet të kishte përfunduar brenda datës 20.10.2023. Në përgjigjën me shkresë nr. 45438/1 Prot, datë 24.09.2024 keni konfirmuar se data përfundimtare për përfundimin e punimeve do të jetë data 26.11.2024.
Drejtori i shkollës na konfirmon se shkolla nuk është dorëzuar nga Bashkia që procesi mësimor të vazhdojë në shkollën e rikonstruktuar.
Bashkia Kavajë me shkresë nr. 995 Prot, datë 27.02.2025, Protokolluar me nr. 204 , dt. 28.02.2025, njofton hapjen e ambienteve të shkollës 9-vjecare Bago, mjedisi i të cilës behët i përdorshëm duke filluar nga data 03.03.2025.
Për këtë shpenzim nga ZVAP janë paguar shpenzimet e transportit nëpërmjet Postës Kavajë për vitin 2025 **në total 246,824 lekë** , si më poshtë vijon:
- urdhër shpenzim nr. 93, dt. 04.05.2025 në vlere 187,874 lekë, për periudhën shkurt 2025
- urdhër shpenzim nr. 56 dt.05.02.2025 në vlerë 58,950 lekë, për periudhën nëntor- dhjetor 2024

Për auditim u përzgjodhën listëpagesat e në muajin dhjetor 2025 sipas të cilave rezulton se:
Për muajin dhjetor 2025
Listat e pagesave për shpenzimet e transportit janë analizuar të grupuara sipas shkollave .
Sipas listëpagesës janë llogaritur shpenzime transportit për **muajin nëntor 2025, paguar në dhjetor 2025**
Shkollat 9-Vjecare: Razi Leka V e Bagos; 28-Nëntori Vorrozen; 3/Dëshmorët; Bago; Blerimaj V 28-Nëntori; Cetë; Fiqiri Kurti; Golem; Helmas V Memzotaj; Herbert; Kanaparaj; Karpen; Kryezi V Memzotaj; Memzotaj; Qamil Xhani; Shkolla e Mesme e Bashkuar 11-Shkurti; Shtodher;
Sipas listë pagesës rezulton se:
- **(5)** punonjës arsimore të **arsimit 9-vjecar**, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet dhe punojnë në shkolla publike **brenda** qytetit Kavaje, përkatësisht në shkollën 9-vjecare "3 Dëshmoret" dhe në shkollën 9-vjecare "Fiqiri Kurti"'janë paguar për muajin nëntor 2025 në shumën **15,637 l**ekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti me tarifë 2700 leke/ muaj.
-Në listëpagesën e transportit **përfshihet kompensimi** transportit me tarifë 2700 leke/ muaj, pavarësisht se është element page sipas shkronjës "a", të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*".
- në listëpagesë transporti shënohet distanca e udhëtimit.
- në listëpagesë transporti shënohet linja e udhëtimit.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.8 bashkëngjitur materialit.

Shkollat e Mesme: Aleksandër Moisiu; Gjimnazi Luz i Vogël; Shkolla Mesme Bashkuar 11-Shkurti
Sipas listë pagesës rezulton se:

- **(2)** punonjës arsimore të **arsimit të mesëm**, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet dhe punojnë në shkolla publike **brenda** qytetit Kavaje, përkatësisht në Aleksandër Moisiu, janë paguar për muajin nëntor 2025 në shumën **2,719 l**ekë.
- Në listëpagesën e transportit **përfshihet kompensimi** transportit me **tarifë 2700 leke**/ muaj, pavarësisht se është element page sipas shkronjës "a", të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*".
-në listëpagesë transporti shënohet distanca e udhëtimit.
-në listëpagesë transporti shënohet linja e udhëtimit,
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.9 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e transportit të muajit dhjetor 2025 në ZVAP Kavajë kanë përfituar shpenzime transporti **(7) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat **dhe punojnë** në shkolla publike me vendndodhje **qyteti Kavajë**, janë paguar për muajin nëntor në shumën **15,637 lekë**, **në kundërshtim me pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë duhet të përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike **me vendndodhje jashtë qendrave urbane**.

Nga auditimi u konstatua se ë listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVA Kavajë, në zbatim pikës 11 germa a) të **VKM nr. 425/2024** "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*", i ndryshuar, ka llogaritur dhe paguar **kompensim mujor për largësi nga vendbanimi** për çdo punonjës mësimor që punon mbi 5 km deri në 50 km, larg vendbanimit dhe kthehet brenda ditës. Kompensim për largësi është llogaritur dhe paguar **në masën 2,700 lekë në muaj**, përcaktuar në kolonë të veçantë në listëpagesën e pagave, si shume neto, që i shtohet të ardhurave nga paga pas zbritjes së sigurimeve dhe tatimeve të llogaritura.

Totali i pagesave për **(143) punonjësit** e kësaj listëpagesë **në shumën 193,729 lekë** është **në kundërshtim** me *pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit, i ndryshuar, e cila* **parashikon kompensim të diferencuar për distanca**t: <u>mbi 5 km deri në 10 km në vlerën 1,000 lekë/muaj; mbi 10 km deri në 20 km 1 në vlerën 1,500 lekë/muaj dhe mbi 20 km deri në 50 km në vlerën 2,700 lekë/muaj</u>

Në procesin e llogaritjes së shpenzimeve të transportit, kuadri aktual nënligjor ka krijuar **mbivendosje dhe paqartësi ligjore**, duke sjellë një praktikë jo të unifikuar nga ZVA-të, Konkretisht:

- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024**, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, në pikën 11, germa "a", përcakton një normë të unifikuar për kompensimin e transportit, **në masën fikse prej 2,700 lekë/muaj**.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 01.03.2023**, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, në pikën 6, **parashikon një kompensim mujor të diferencuar**, i cili lidhet me dispozitat e shkronjës "a" të pikës 11 të vendimit nr. 425/2024.

Ky kuadër aktual nënligjor ka sjellë pasiguri në interpretim dhe zbatim, duke krijuar mospërputhje në praktikën administrative në institucioneve arsimore dhe ZVA-ve.

❖ **Pagesat e shpenzimeve të transportit.**

Titullari me **Urdhër te brendshëm** urdhëron kryerjen e pagesës së transportit të punonjësve mësimorë dhe mësuesve që punojnë brenda dhe jashtë territorit të bashkisë së tyre dhe nxënësve të mbështetur në VKM nr. 119, datë 01.03.2025 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit" , i ndryshuar.

Pagesat transportit të punonjësve arsimore kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et e ZVAP Kavaje, ne te cilat shënohet distanca sipas linjave nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollës ku ata janë punonjës arsimorë.

- Listë prezenca e mësuesve që përfitojnë shpenzime transporti janë të firmosura nga Drejtori i IAP-se dhe dërguar me shkresë përcjellëse në ZVAP, për çdo pagesë të kryer.
- Për çdo liste prezencë shkresat mbaje numër dhe datë Protokolli sipas institucioneve përkatëse.
- Listë pagesat janë nënshkruar nga NZ dhe NA.

Pagesat transportit të nxënësve kryhen sipas:

- ditëve mësimore të dërguara nga liste prezenca IAP-et ZVAP Kavaje, ne te cilat shënohet distanca në kilometra mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollë, duke evidentuar emër, atësi , mbiemër, klasën e nxënësit përfitues, ditë mësimore prezentë në mësim, emri i prindit/ kujdestarit të fëmijës, llogari mbajtësit për të cilin është hapur llogaria bankare dhe numri i llogarisë bankare.
- Listë prezenca e mësuesve që përfitojnë shpenzime transporti janë të firmosura nga Drejtori i IAP-se dhe dërguar me shkresë përcjellëse në ZVAP –për çdo pagesë të kryer.
- Për çdo liste prezencë shkresat mbaje numër dhe datë Protokolli sipas institucioneve përkatëse, dhe firmosen nga mësuesit kujdestar që shënojnë ditët mësimorë të nxënësve prezentë në shkollë dhe drejtori i IAP-it.
- çmimi i transportit vajtje ardhje 148.95 lekë/ditë
- pagesa behet me liste pagesë në banke në të cilën shënohen emër atësi mbiemër nxënësit, klasa, shkolla ku ndjek mësim (IAP), distanca, dite mësimore prezent, tarifa e udhëtimit, vlere e përfituar, dhe të dhëna t të prindit, kujdestarit, llogarisë bankare në të cilën kalon shuma e përfituar nga nxënësi për shpenzim transporti.
- Listë pagesat janë nënshkruar nga NZ dhe NA.

ZVAP Kavajë, për periudhën nëntor 2025 paguar në dhjetor 2025 ka llogaritur 13 ditë pune faktike për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare.

Pas verifikimit të listës së pagesave të muajit dhjetor 2025, në llogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve të transportit nuk u konstatuan mospërputhje midis ditëve të punës të realizuara realisht nga punonjësit arsimorë, ditëve që nxënësit kanë ndjekur procesin mësimor

Mbështetur në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, përgjithësisht **ka paguar çdo muaj** shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, **nëpërmjet llogarive bankare** në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të institucioneve publike, sipas kërkesave të pikës 4 të VKM nr. 119, datë 01.03.2025 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar.

ZVAP Kavajë në vitin 2025 ka kryer vetëm 2 pagesa nëpërmjet shërbimit postar, përkatësisht për shkollën 9 vjeçare Bago-rikonstruksion:

-Pagesa me urdhër shpenzim nr. 93, datë 04.05.2025 në vlerë 187,874 lekë

-Pagesa me urdhër shpenzim nr. 56, datë 05.02.2025 në vlerë 58,950 lekë
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi personat përkatës si më poshtë:
-znj. B.M në cilësinë e NZ të ZVAP Kavajë
-z. E.B në cilësinë NA në ZVAP Tiranë

❖ **Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz**

Nga verifikimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje shpenzimet për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre, për periudhën 2022-2025 rezultoi se në Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar **Kamëz** ka planifikuar dhe realizuar shpenzime transporti:
Në vitin 2022 janë planifikuar 33,122,755 lekë dhe realizuar 32,281,913 lekë ose realizuar 97%
Në vitin 2023 në vitin 2022 janë planifikuar 61,954,460 lekë dhe realizuar 54,907,145 lekë ose realizuar 97%,
Në vitin 2024 janë planifikuar 33,456,521 lekë dhe realizuar 31,367,399 lekë ose realizuar 97.
Në vitin 2025 janë planifikuar 8,744,997 lekë dhe realizuar 8,115,970 lekë ose realizuar 97%.

Shpenzimet e transportit për nxënës dhe punonjës arsimore (në lekë)

ZVAP	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
KAMËZ	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës
Plan	-	33,122,755	-	61,954,460	-	33,456,521	-	8,744,997
Fakt	-	32,281,913	-	54,907,145	-	31,367,399	-	8,115,970
Realizimi	-	97%	-	97%	-	97%	-	97%

Nga auditimi rezulton se ZVAK për periudhën objekt auditimi ka paguar shpenzimi transporti për shërbimin e transportit të nxënësve të arsimit bazë për Shkollat 9 – vjeçare :
1. “Hillary Clinton” në Kamëz e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në “Frutikultura” në Kamëz;
2. “Demokracia” në Valias, në Kamëz e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në “Niko Hoxha” në Laknas;
3. “Ibrahim Basha”, në Bulcesh, në Kamëz e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në “Niko Hoxha” në Laknas; e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në “Halit Coka” në Kamëz;
4. “Lidhja e Prizrenit” në Paskuqan e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në “Isa Boletini” në Paskuqan;
5. “Azem Hajdari” në Paskuqan e cila për arsye rindërtimit mësimi do të zhvillohet në 50% e nxënësve në shkollën e mesme “Isa Boletini” në Paskuqan dhe 50% në shkollën “Vëllazërimi” në Paskuqan;
Bashkia Kamëz, me shkrese nr. 3764, datë 15.12.2022, për vitin mësimor 2022-2023 ka miratuar listën emërore të nxënësve të klasës 4- 9 të shkollës “Azem Hajdari” deri tek gjimnazi “Isa Boletini” me vëndodhje “Babru Qendër”.
Bashkia Kamëz, me shkrese nr. 8760/2 Prot, datë 31.10.2022, në përgjigje të shkresës nr. 1728 Prot, datë 28.09.2022 për vitin mësimor 2022-2023 ka pacaktuar hartën e linjave me distancat përkatëse për transportin e nxënësve :
a. të shkollës 9-vjecare “Demokracia”
b. të shkollës 9-vjecare “Hillary Clinton”
c. të shkollës 9-vjecare “Ibrahim Basha”
d. të shkollës 9-vjecare “Lidha e Prizrenit”
e. të shkollës 9-vjecare “Azem Hajdari”.
Ne shkresat e mësipërme Bashkia Kamëz dhe bashkia Paskuqan konfirmojnë se distanca e nxënëseve është mbi 2 km,

Tarifat e aplikuara

Në mbështetje të pikës 1 germa b) të VKM nr. 119, datë 03.03.2026 VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "P*ër përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit",* i ndryshuar, përcaktohet se nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të **arsimit bazë ose kopshtet publike**, që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm **mbi 2 km larg IAP-ve publike** më të afërta (shkollë/kopsht) dhe **në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës**, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

Tarifat e transportit është llogaritur mbi tarifën fillestare

duke filluar nga distanca më e vogël deri 10 km me tarifë 50 lekë për vajte ose 100 lekë (vajtje – ardhje), duke shtuar *50 (pesëdhjetë) për qind mbi çmimin e biletës, duke llogaritur një tarifë bazë 150 lekë në ditë , bazuar në Shtojcën 1 në* VKM nr. 92/2024*'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*.

Pas indeksimit sipas normës së inflacionit tarifat e aplikuara për transportin e nxënësve janë si më poshtë:

- Për vitin 2022, në vlerë 145 leke (e indeksuar)
- Për vitin 2023, në vlerë 151 leke (e indeksuar)
- Për vitin 2024, në vlerë 151 leke (e indeksuar)
- Për vitin 2025, në vlerë 148.[95] leke (e indeksuar)

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. **1746 Prot., datë 06.03.2024**, me lëndë "*Për zbatimin e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'"*, Protokolluar në ZVAP Kamëz me nr. 612, datë 06.03.2024, **ka udhëzuar** të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore se, nga data e hyrjes në fuqi të VKM nr. 92, datë 21.02.2024, në përllogaritjen e fondeve të procedurave të prokurimit apo mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe mësuesit, referuar **VKM nr. 119, datë 01.03.2023** "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, **duhet të zbatohen tarifat** e përcaktuara në **VKM nr. 92/2024**, duke qenë se shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit subvencionohet në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Në pikën 3 të me pikën **3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2025**, *"Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, **DRAP-et** dhe ofruesit e arsimit profesional publik p*ërllogaritja e fondeve që prokurohen kryhet:*

*Mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të punonjësve arsimorë, që përfitojnë shërbim transporti, v**etëm për ata punonjës arsimorë** që udhëtojnë brenda linjave të transportit rrethqytetës; n**umrit të nxënësve** që përfitojnë shërbimin e transportit dhe të tarifës/çmimit të biletës për linjat rrethqytetëse të transportit, të cilat subvencionohen **bazuar në shkronjën "b", të nenit 10, të ligjit nr. 8308**, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, dhe*

***sipas distancave dhe tarifave të miratuara me vendimin nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave**, "Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus",*

Bazuar në shkronjën **"b" të nenit 10** të ligjit **nr. 8308, datë 18.03.1998** "*Për transportet rrugore*", të ndryshuar, tarifat e transportit të udhëtarëve **zbatohen** mbi bazën e dispozitave të **Ligjit nr.7581, datë 7.7.1992** "Për çmimet dhe tarifat", i ndryshuar.

VKM nr. 92, datë 21.02.2024, dalë në zbatim të mbështetje të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, "Për çmimet dhe tarifat", i ndryshuar, dhe të **shkronjës "b", të nenit 10**, të ligjit nr. 8308, datë

18.3.1998, "Për transportet rrugore", ka përcaktuar tarifat e transportit **rrugor ndërqytetës** të udhëtarëve me autobus në shtojcën nr. 1.
Ndërkohë, neni 10, germa "c" dhe "ç" e ligjit nr. 8308/1998 "*Për transportet rrugore*" **përcakton se tarifat e biletave të transportit qytetas dhe rrethqytetas** të udhëtarëve me autobus miratohen me **vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore**, sipas nenit 14 të këtij ligji, sipas të cilit *tarifa e llojit të biletës në transportin qytetas të udhëtarëve me autobus miratohet **nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore**, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim*
Bashkia Kamëz, me **VKB Kamëz nr. 66 Prot, datë 26.09.2025** "*Mbi miratimin e çmimit të biletave dhe aboneve të linjave të transportit urban në Bashkinë Kamëz*", ka mbajtur të pandryshuar çmimin e biletave dhe aboneve për linjat e transportit publik **nën 8 km për (8 linja autobusi publik) 40 (dyzet) lekë** për vajtje/ardhje, duke **shfuqizuar** VKB Kamëz nr. 151, datë 05.12.2016 "*Mbi studimin për riorganizimin e transportit publik urban, miratimin e linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve qytetës dhe rrethqytetas dhe e tarifës së biletës dhe aboneve për çdo linjë në Bashkinë Kamëz", **VKB nr. 53, datë 24.04.2017** "Për miratimin e ndryshimit të tarifës së biletës dhe aboneve për çdo linjë të rregullt të transportit të udhëtarëve qytetas dhe rrethqytetas që operojnë në Bashkinë Kamëz si dhe miratimin e ngjyrës së biletës për çdo linjë*."
VKB Kamëz pasqyron se Bashkia Kamëz ka të miratuara linjat e transportit publik qytetës dhe rrethqytetës, dhe për distanca më pak se 8 km, përgjatë vitit 2025 dhe më parë, ka mbajtur të pandryshuar tarifën e biletës së udhëtimit **në vlerë 40 lekë** ne vajtje /ardhje, ose 80 leke vajtje ardhje, ose 120 lekë (e pa indeksuar), ose **119.16 lekë (e indeksuar),**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 913/2 Prot, datë 19.02.2025, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 406/1 Prot, datë 10.02.2025, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2024 i **cili është (0.07%).**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 971/2 Prot, datë 22.02.2024, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 225/1 Prot, datë 13.02.2024, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2023 i **cili është (4.78%).**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 1490 Prot, datë 02.03.2023, në zbatim të VKM nr.682/2015, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 126/1 Prot, datë 31.01.2023, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2022 i **cili është (4.46%).**
Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVAP Kamëz ka **aplikuar tarifën e indeksuar** për punonjës arsimore dhe për nxënësit që udhëtojnë mbi 2 km, **në kundërshtim** me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, sipas të cilit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 24.04.2025, është ndryshuar pika 3 duke eliminuar (hequr) mekanizmin e indeksimit. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, me datë publikimi 24.04.2025. Ndikimi i indeksimit të tarifës me (-0.7%) konsiderohet i papërfillshëm me efekt financiar për periudhën maj-dhjetor 2025.
Për vitin 2025 përzgjedhur për auditim u konstatua se për shpenzimet e transportit për transportin e nxënësve të shkollës 9-vjecare "Hillary Clinton", gjatë kohës së rikonstruksionit të saj, për shpenzimet e transportit të nxënësve deri në shkollën "Frutikultura", **mungon informacion nga Bashkia Kamëz nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës**, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë*

dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve **që** udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) **dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës**, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar. **Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km duhet të plotësohet edhe kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës.**

ZVAP Kamëz, për transportin e nxënësve të shkollës 9-vjecare "Hillary Clinton", gjatë kohës së rikonstruksionit të saj, për shpenzimet e transportit të nxënësve deri në shkollën "Frutikultura", për distancën 2,100 m ose **2.1 km**, ka aplikuar tarifën **148.95 lekë (e indeksuar), bazuar në** VKM nr. 92, datë 21.02.2024 "*Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus*", dhe udhëzimeve **të MAS** me shkresë nr. 1746 Prot., datë 06.03.2024, **në kundërshtim** pikën 1 germa b) të VKM nr. 92/2024*'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*, s***ipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998****, "Për transportet rrugore", të ndryshuar; numrit të nxënësve që përfitojnë shërbimin e transportit dhe të tarifës/çmimit të biletës për linjat* ***rrethqytetëse të transportit, dhe jo ndërqytetës.***

Tarifa e transportit për nxënësit janë paguar **29.79 lekë/ditë më shumë** se tarifat e miratuara nga **Bashkia Kamëz për transport publik qytetës dhe rrethqytetës** për distancë më pak se 8 km, veprim në kundërshtim me VKB Kamëz nr. 66, datë 26.09.2025, nr. 151, datë 05.12.2016 "*Mbi studimin për riorganizimin e transportit publik urban, miratimin e linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve qytetës dhe rrethqytetas dhe e tarifës së biletës dhe aboneve për çdo linjë në Bashkinë Kamëz", **VKB nr. 53, datë 24.04.2017*** "*Për miratimin e ndryshimit të tarifës së biletës dhe aboneve për çdo linjë të rregullt të transportit të udhëtarëve qytetas dhe rrethqytetas që operojnë në Bashkinë Kamëz si dhe miratimin e ngjyrës së biletës për çdo linjë*". **Shkresa e MAS** nr. 1746 Prot., datë 06.03.2024 **për transportin qytetas dhe rrethqytetas,** me referencë aplikimin e tarifave ndërqytetëse për tarifat qytetëse dhe rrethqytetëse, përcaktuar në VKM nr. 92/2024, **nuk përputhet me dispozitat e nenit 10, germat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 8308/1998, pasi këto tarifa miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe jo nga Këshilli i Ministrave.**

KONKLUZION

Zbatimi i kriterit ligjor për bazën e tarifave për punonjësit arsimorë dhe nxënësit, sipas VKM nr. 92, datë 21.02.2024, paraqet paqartësi në zbatim lidhur me përcaktimin e tarifës.

Konkretisht, mbetet e paqartë nëse tarifa duhet të mbështetet në vendimin e këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 10, germa "b", apo Vendimin e Këshillit të Ministrave me kriteret e përcaktuara në nenin 10, germat "c" dhe "ç", të Ligji nr. 8308/1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, të cilat kanë mospërputhje në tarife dhe në distancë.

Kjo është akoma më e ndjeshme në aplikimin e tarifës së transportit të nxënësve e cila llogaritet mbi 2 km dhe tarifa e aplikuar është deri 10 km në vlerë 150 lekë/ditë.

Shkresa e MAS nr. 1746 Prot., datë 06.03.2024 për transportin qytetas dhe rrethqytetas, me referencë aplikimin e tarifave ndërqytetëse përcaktuar në VKM nr. 92/2024, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 10, germat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 8308/1998, sipas të cilit tarifat e biletave të transportit qytetas/rrethqytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.

Pagesa e shpenzimeve të transportit të nxënësve

Për auditim u përzgjodhën procedurat e shpenzimeve të transportit për vitin 2025.

Për vitin 2025, Titullari ka urdhëruar kryerjen e pagesës së transportit të nxënësve me Urdhër te brendshëm nr. 20, dt. 19.02.2025 për muajin janar 2025, nr. 36, dt. 18.03.2025për muajin shkurt 2025, nr. 57, dt. 07.05.2025 për muajt mars- prill 2025 dhe nr. 67, dt. 19.06.2025 për muajt maj -

qershor 2025.
Pagesat transportit të punonjësve arsimore nga IAP-et e ZVAP Kamëz, janë zero lekë pasi Bashkia Kamëz dhe dy njësitë administrative konsiderohen zonë urbane.
Pagesat e transportit për nxënësit, për vitin 2025 (janar- qershor), bazohen në listat mujore të prezencës së transportit të dërguara nga shkolla 9-vjeçare "Hillary Clinton". Në këto lista pasqyrohen: ditët mësimore kur nxënësi ka qenë i pranishëm në mësim; distanca mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollë; të dhënat personale të nxënësit (emër, atësi, mbiemër); klasa ku ndjek mësimin nxënësi përfitues; shkolla përkatëse dhe njësia administrative ku ajo bën pjesë.
Shkolla 9- vjeçare "Azem Hajdari" Paskuqan me shkresë nr. 2-66 Prot, datë 27.09.2022, Protokolluar me nr. 1640 Prot, datë 27.09.2022 **ka dërguar në ZVAP Kamëz listën** e nxënësve përfitues të shpenzimeve të transportit për vinin shkollor 2022-2023
ZVAP Kamëz me shkrese nr. 1728 Prot, datë 29.09.2022, ka dërguar për miratim në Bashkinë Kamëz **listat e** nxënësve përfitues të shpenzimeve të transportit **përcaktimin e distancat përkatëse** për transportin e nxënësve për shkollat 9 – vjeçare "Demokracia"; "Hillary Clinton"; "Ibrahim Basha"; "Lidhja e Prizrenit"; "Azem Hajdari" në Njësinë Administrative Paskuqan.
Bashkia Kamëz me shkresë nr. 8760/2 Prot, datë 03.10.2022 ka **konfirmuar listat** e nxënësve përfitues të shpenzimeve të transportit **dhe hartën e linjave me distancat përkatëse** për transportin e nxënësve për shkollat 9 – vjeçare "Demokracia"; "Hillary Clinton"; "Ibrahim Basha"; "Lidhja e Prizrenit"; "Azem Hajdari" në Njësinë administrative Paskuqan.
(Bashkia Kamëz ka përcaktuar d*istancën në kilometra për çdo nxënës, me pikë nisje Qendra e Qyteti Kamëz dhe si pikë mbërritje vendodhjen e IAP-it).*
Listat emërore të nxënësve përfitues të shërbimit të transportit për vitin shkollor 2024-2025 (periudha e pagesës deri në qershor 2025) janë hartuar sipas listë prezencës së dërguar nga Drejtori IAP-it.
Lista prezenca mban **numër dhe datë Protokolli të IAP-it** si dhe **numër dhe datë Protokolli hyrës të ZVAP-Kamëz**.
Pas verifikimit të listës së pagesave të muajit dhjetor 2025, në llogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve të transportit nuk u konstatuan mospërputhje të ditëve që nxënësit kanë ndjekur procesin mësimor.
Nga auditimi u konstatua se:
Për përcaktimin e distancës së transportit janë përdorur të dhënat e miratuara nga Bashkia Kamëz me shkresë nr. .2760/2 Prot, datë 31.10.2022. Protokolluar në ZVAP me nr. 2760/2 Prot, datë 03.10.2022, **sipas të cilës distanca në kilometra nga qendra e qytetit Kamëz deri në shkollën 9-vjecare "Hillary Clinton" me vëndodhje te "Frutikultura" është 2100 m ose 2.1 km.**
Për vitin 2025 ZVAP Kamëz **nuk ka kërkuar** informacion nga Bashkinë Kamëz mbi shërbimin e transportit qytetës, në kundërshtim me pikën 2 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilit *(ZVAP, bazuar në informacionin që marrin nga drejtuesit e IAP-ve publike, dërgojnë, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, të dhëna për numrin e fëmijëve/nxënësve dhe të punonjësve arsimorë të tyre, që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, sipas kritereve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.*
ZVAP – Kamëz ne vitin 2025 ka paguar shpenzimet e transportit për nxënës në vlerë në total **8,115,970 lekë, deri në qershor 2025.**
Për periudhën korrik deri dhjetor 2025, ZVAP Kamëz nuk ka kryer shpenzime transporti për nxënës.

Për pagesën e shpenzimeve të transportit për nxënës **ka aplikuar tarifat e transportit ndërqytetës,** miratuar me **VKM nr. 92, datë 21.2.2024**, "Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus", sipas të cilës tarifa e përllogaritur rezulton **148.95 lekë (vajtje dhe kthim)**.

Pagesat transportit të punonjësve nxënësve për vitin 2025 janë kryer **deri në 09 qershor 2025**, më përfundimin e vitit shkollor 2024-2025, për shkak të rindërtimit të shkollës 9 –vjeçare "Hillary Clinton", Kamëz për një numër rreth 520 nxënës përfitues, punimet e te cilës janë marre në dorëzim me "Certifikate e marrjes në dorëzim të përkohshëm" datë 13.06.2025 dërguar në Bashkinë Kamëz nga FSHZH me shkresë nr. 1375/5 Prot, datë 16.06.2025, Protokollua me nr. 5117 Prot, datë 16.06.2025. Shkolla e re e ndërtuar, me kapacitet mbi 1000 nxënës, emërtohet shkolla 9-vjecare "*Angela Merkel"*, me Vendim të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 47 datë 17.07.2025.

Pagesat e nxënësve janë kryhet nëpërmjet **postës shqiptare**, sipas listë pagesës së shpenzimeve të transportit të nxënësve, në të cilën shënohen emër, atësi, mbiemër, dite mësimore, **distanca mbi 2 km**, **çmimi i biletës** 148.95 lekë, vlera e përfituar, numri ID së nxënësit përfitues dhe kolona e fundit (nënshkrimi) e pa përcaktuar.

Lista e shpenzimeve të transportit të nxënësve dorëzohet në postë, me një dokument përmbledhës të nënshkruar nga Titullari i ZVAP-së, përgjegjësi i sektorit të shërbimeve, dhe punonjësi i postës shqiptare.

Të dhënat analitike të urdhër shpenzimeve të transportit të nxënësve të kaluara në Degën e Thesarit Kamëz për vitin 2025, janë si më poshtë vijon:

Shpenzime transport nxënës ZVAP Kamëz / 2025 (në lekë)

Urdhër Shpenzim nr.	Periudha mësimore	Data USH	Nxënës	Punonjës arsimorë	Transfertë me Banka/Posta
23	Janar 2025	19.02.2025	1,562,331	-	Posta Qendrore Kamëz
41	Shkurt 2025	19.03.2025	1,554,132	-	Posta Qendrore Kamëz
72	Mars-Prill 2025	07.05.2025	2,680,951	-	Posta Qendrore Kamëz
87	Maj –Qershor 2025	23.06.2025	2.318.556	-	Posta Qendrore Kamëz
		TOTAL	**8,115,970**	**0**	

(Burimi: ZVAP Kamëz; Punoi KLSH)

Nga auditimi u konstatua se ZVAP Kamëz **ka kryer pagesat e shërbimit të transportit 100% nëpërmjet shërbimit postar**. Në listat e pagesave nuk **është shënuar prindi kujdestar** që ka të drejtë të tërheqë shumën e transferuar ne postë, ne emër të nxënësit të identifikuar me ID, në kundërshtim me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 **"***Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*" sipas të cilit ZVAP-të, bazuar në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, duhet të kryejnë pagesat çdo muaj përmes llogarive bankare të prindërve, kujdestarëve ligjorë, përfituesve me prokurë të posaçme. Përdorimi i shërbimit postar lejohet vetëm në zonat ku shërbimi bankar mungon ose është i paaksesueshëm, sipas pikës 2 të vendimit, deri në nënshkrimin e kontratës nga DRAP me operatorët ekonomikë për realizimin e transportit.

ZVAP Kamëz nuk ka kryer rakordime mujore me postën shqiptare fondet tërhequra nga prindi kujdestar, sipas listëpagesës së depozituar në postë.

Shpenzimet e nxesnesve të muajit mars-prill 2025, janë paguar me USH nr. 72, dt.07.05.2025 në vlere 2,680,951 leke me dy muaj vonese;

Gjithashtu, ZVAP Kamëz **nuk disponon rregullore të miratuar nga DRAP Tiranë**, i cili të përcaktojë **dokumentin vërtetues për përcaktimin distancës mbi 2 km larg IAP- publik nga adresa e vendbanimit të përhershëm**, institucionin që duhet të disponoje dokumentin e vërtetimit të distancës, të dhënat që duhet të përmbajë një listë pagesash për shpenzimet e transportit, veprim që bie ndesh me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për*

transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", sipas së cilës *pagesat duhet të kryhen çdo muaj mbi bazën e të dhënave të dërguara nga institucionet arsimore.*

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi personat si më poshtë:

-Znj. A S., në cilësinë e Drejtor në ZVA Kamëz.

-Znj. V D, në cilësinë e përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve në ZVA Kamëz.

❖ **Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë**

Nga verifikimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje shpenzimet për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre, për periudhën 2022-2025 rezultoi se në Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar **Rrogozhinë** ka planifikuar dhe realizuar shpenzime transporti si më poshtë vijon:

ZVAP RROGOZHINE	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Plan	11,997,560	11,540,300	11,492,330	11,751,000
Fakt	11,970,090	11,539,460	11,450,780	11,219,360
	99.77%	99.99%	99.64%	95.48%

Për vitin 2022 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 11,997,560 leke dhe realizuar 11,970,090 lekë ose realizuar **99.77%**;

Për vitin 2023 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 11,540,300 leke dhe realizuar 11,539,460 lekë ose realizuar **99.99%.**

Për vitin 2024 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 11,492,330 leke dhe realizuar 11,450,780 lekë ose realizuar **99.64%.**

Për vitin 2025 për nxënës dhe mësues buxheti i miratuar për shpenzime transporti 11,751,000 leke dhe realizuar 11,219,360 lekë ose realizuar **95.48%.**

Shpenzimet e transportit për nxënës dhe punonjës arsimore (në lekë)

ZVAP	Viti 2022		Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
RROGOZHINE	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës	mësues	nxënës
Plan	4,238,378	7,759,182	3,686,435	7,853,865	4,719,502	6,772,828	4,941,406	6,809,594
Fakt	3,216,125	8,753,965	3,981,506	7,557,954	4,454,816	6,995,964	4,805,461	6,413,899
Nxënës VS Mësues	27%	73%	35%	65%	39%	61%	43%	57%

(Burimi: ZVAP; Punoi KLSH)

Nga auditimi rezulton se në ZVAP Rrogozhinë peshën specifike me të madhe e zënë shpenzimet e transportit për nxënës të cilat përbëjnë 57% deri 73% të shpenzimeve vjetore kundrejt shpenzimeve të transportit për mësues më peshë specifike 27% deri në 43% të shpenzimeve vjetore.

Në zbatim të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar, ZVAP i është drejtuar Bashkisë Rrogozhinë me shkresat si më poshtë vijon:

❖ **Për vitin buxhetor 2025**

Për vitin 2024-2025, në zbatim të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar, ZVAP Rrogozhinë i është drejtuar Bashkisë Rrogozhinë me shkresat si më poshtë vijon:

- me shkresë nr. 761 Prot, datë 17.10.2024, me kërkesë për konfirmimin e linjave të transportit rrethqytetës për Bashkinë Rrogozhinë, të shoqëruar me Vendim të Këshillit Bashkiak, për subvencionimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve dhe mësuesve punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre;

- me shkresë nr. 784/1 Prot, datë _/_/.2024, me kërkesë për miratimin e linjave të transportit 20 Linja, që kryejnë transportimin e nxënësve dhe mësuesve jashtë vendbanimit të tyre, duke përcaktuar dhe distancën në km;
- me shkresë nr. 862 Prot, datë 10.12.2024, me kërkesë për miratimin e linjave të transportit që kryejnë transportin e mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre 6 (gjashtë) linja dhe rikonfirmim për 2 (dy) linja ;
- me shkresë nr. 862 Prot, datë 10.12.2024, me kërkesë për miratimin e linjave të transportit që kryejnë transportin e mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre 6 (gjashtë) linja dhe rikonfirmim për 2 (dy) linja;
- me shkresë nr. 832 Prot, datë 24.12.2024, me kërkesë për miratimin e linjave të transportit që kryejnë transportin e mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre për 3 (tre) linja dhe konfirmim e distancave përkatëse.
- me shkresë nr. 842 Prot, datë 16.10.2025, **kërkesë për konfirmim in e linjave të transportit dhe distancat e tyre për transportin e mësuesve dhe nxënësve** për vitin 2025-2025;
- me shkrese nr. 907 Prot, datë 13.11.2025 kërkohet dërgimi i linjave të miratuara të transportit rrethqytetës për bashkinë Rrogozhinë të shoqëruar me Vendim të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë.

Bashkia Rrogozhinë kthyer përgjigje kërkesës se ZVAP-it për linjat e transportit dhe tarifat e linjave rrethqytetës që funksionojnë në këtë njësi vendore.

- me shkresë nr. 4694 Prot, datë 06.11.2024, konfirmim për 59 distancave në kilometër sipas listës se linjave të përcaktuara nga ZVAP për itinerarin që do të përshkruajnë mësuesit dhe nxënësit, në përgjigje të shkresës nr. 862 Prot, datë 10.12.2024;
- me shkresë nr. 42 Prot, datë 07.01.2025, konfirmimin për linjat e transportit të nxënësve dhe mësuesve punojnë dhe mësojnë jashtë vendbanimit të tyre, në përgjigje të shkresës nr. 784/2 Prot, datë _/10/2024;
- me shkresë nr. 41 Prot, datë 07.01.2025, konfirmimin për linjat e transportit të mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre, në përgjigje të shkresës nr. 832 Prot, datë 24.12.2024;
- me shkresë nr. 412/1 Prot, datë 27.01.2025, konfirmimin për linjat e transportit të mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre, në përgjigje të shkresës nr. 70 Prot, datë 27.01.205;
- me shkresë nr. 411/1 Prot, datë 27.01.2025, konfirmimin/ saktësimin e distancave për linjat e transportit të mësuesve që punojnë jashtë vendbanimit të tyre sipas itinerarit të përcaktuar nga ZVAP, në përgjigje të shkresës nr. 69 Prot, datë 27.01.205;
- me shkresë nr. 4487/1 Prot, datë 27.10.2025 "Kthim përgjigje" shkresës nr. 840, datë 16.10.2025, ka njoftuar të dhënat e kërkuara për distancat në kilometra të linjave të transportit mësues- nxënës viti shkollor 2025-2026, pa referuar në VKB Rrogozhinë;
- me shkresë nr. 4487/2 Prot, datë 27.10.2025 "Kthim përgjigje" shkresës nr. 841, datë 16.10.2025 10.2025, ka njoftuar miratimin e linjave të transportit dhe distancat në kilometra të linjave të transportit mësues- nxënës viti shkollor 2025-2026, pa referuar VKB Rrogozhinë;
- me shkresë nr. 4990/1Prot, dt. 19.11.2025, Protokolluar nr. 925 Prot, dt. 20.11.2025 ka dërguar linjat e miratuara të transportit qytetës në Bashkinë Rrogozhinë[4], me të cilin kjo bashki ka miratuar 4 linjat e transportit publik qytetës, ka përcaktuar tarifën ë udhëtimit për 1(një) udhëtim me një stacion 30 lekë vajtje ose kthim dhe 50 leke në ditë (vajtje ose kthim) për më shumë se një stacion.

Bashkia Rrogozhinë, **me** Vendim të Këshilli Bashkiak Rrogozhinë nr. 68, datë 20.11.2018 "Për caktimin e linjave, tarifave dhe orareve të transportit qytetës në Bashkinë e Rrogozhinës" ka të

[4] Vendim të Këshilli Bashkiak Rrogozhinë nr. 68, datë 20.11.2018 "Për caktimin e linjave, tarifave dhe orareve të transportit qytetës në Bashkinë e Rrogozhinës "

miratuara **për linjat e transportit** qytetës dhe rrethqytetës .

❖ **Tarifa e transportit të aplikuara për mësues dhe punonjës arsimore**

Në mbështetje të pikës **1 germa a)** VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "P*ër përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit",* i ndryshuar, përcaktohet nga buxheti i shtetit përballohen fondet publike të shpenzimeve për transportin se punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitar publike, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;

Tarifat e transportit **për mësuesit** është llogaritur mbi tarifën fillestare duke filluar nga distanca më e vogël deri 10 km me tarifë 50 lekë për vajte ose 100 lekë vajtje –ardhje, e pa indeksuar, *bazuar në Shtojcën 1 në* VKM nr. 92/2024*'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*.

*Pas indeksimit sipas normës së inflacionit tarifat e aplikuara për transportin **e nxënësve** janë si më poshtë:*

- Për vitin 2022, në vlerë 145.[40] leke (e indeksuar)
- Për vitin 2023, në vlerë 145.[40] leke (e indeksuar), ndryshuar në prill 151,[80] (e indeksuar)
- Për vitin 2024, në vlerë 151 leke (e indeksuar)
- Për vitin 2025, në vlerë 148.[95] leke (e indeksuar)

Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. **1746 Prot., datë 06.03.2024**, me lëndë "*Për zbatimin e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'"*, Protokolluar në ZVAP Kamëz me nr. 612, datë 06.03.2024, **ka udhëzuar** të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore se, nga data e hyrjes në fuqi të VKM nr. 92, datë 21.02.2024, në përllogaritjen e fondeve të procedurave të prokurimit apo mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe mësuesit, referuar **VKM nr. 119, datë 01.03.2023** "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, **duhet të zbatohen tarifat** e përcaktuara në **VKM nr. 92/2024**, duke qenë se shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit subvencionohet në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Përgjigja e Bashkisë Rrogozhinë ne shkresë nr. 4990/1Prot, dt. 19.11.2025, Protokolluar në institucion me nr. 925 Prot, dt. 20.11.2025 tregojë se Këshilli Bashkiak **ka miratuar 4 linjat e transportit publik qytetës**, ka informacion për tarifën e biletës së udhëtimit **për këto linja, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:**

Tarifat e krahasuara të biletës së udhëtimit

Tarifat e udhëtimit	Lloji i transportit	Çmimi i biletës vajtje ose ardhje (lek)	Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek)	Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek) +50%
		punonjës	**punonjës**	**nxënës**
VKB Rrogozhinë	1 (një) stacion	30	60	90
	Më shume se 1(një stacion)	50	100	150
VKM nr. 92/2024	*Ndërqytetës*	50	100	150

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 913/2 Prot, datë 19.02.2025, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 406/1 Prot, datë 10.02.2025, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2024 i **cili është (-**

0.07%).

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 971/2 Prot, datë 22.02.2024, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 225/1 Prot, datë 13.02.2024, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2023 i **cili është (4.78%).**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 1490 Prot, datë 02.03.2023, në zbatim të VKM nr.682/2015, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 126/1 Prot, datë 31.01.2023, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2022 i **cili është (4.46%).**

Nga auditimi u konstatua se në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, ZVAP Rrogozhinë ka **aplikuar tarifën e indeksuar** për punonjës arsimore dhe për nxënësit që udhëtojnë mbi 2 km, **në kundërshtim** me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, sipas të cilit me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 24.04.2025, është ndryshuar pika 3 duke eliminuar (hequr) mekanizmin e indeksimit.

Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, me datë publikimi 24.04.2025.

Ndikimi i indeksimit të tarifës me (-0.7%) konsiderohet i papërfillshëm me efekt financiar për periudhën maj-dhjetor 2025.

Tarifat e udhëtimit janë llogaritur sipas distancave dhe tarifave ndërqytetëse të miratuara me VKM nr. 92/2024*"Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus" duke filluar me tarifë minimale 100 lekë/ditë në ditë(e paindeksuar) e njëvlershme me tarifën e përcaktuar me* Vendim të Këshillit Bashkiak Rrogozhinë nr. 68, datë 20.11.2018 "Për caktimin e linjave, tarifave dhe orareve të transportit qytetës në Bashkinë e Rrogozhinës ", për distancat më shumë se 1 (një) stacion.

Nga auditimi përcaktimit të tarifave të nxënësve **u konstatua se p**ër shpenzimet e transportit për shpenzimet e **transportit të nxënësve** që udhëtojnë mbi 2 km **nga Bashkia Rrogozhinë mungon informacioni nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës**, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) **dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës**, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km nuk plotësohet kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës**.**

Procedurat e realizimit të shpenzimeve të transportit:

- **Pagesat transportit të punonjësve arsimore (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social)**

ZVAP përpilon **listë pagesë** mujore firmosur nga hartuesi i dokumentit (specialisti) përgjegjësi i sektorit të financës dhe Titullari i ZVAP-se;

Listëpagesat mujore ZVAP-se mbështet në listëprezencën e dërguar nga IAP-të, firmosura nga Drejtori i IAP-it, duke shënuar ditët mësimore të punonjësve prezent, distancën **sipas linjave nga vendbanimi** i përhershëm deri në IAP ku ata janë punonjës arsimorë, firmosur nga Titullari IAP.

Ato përgjithësisht përmbajnë numër dhe datë Protokolli sipas shkollës përkatëse.

Pagesat e punonjësve arsimore kryhen **100% në bankë.**

Pagesat e nxënësve kryhet **100% në Postën Shqiptare.**

Për auditim u përzgjodhën listëpagesat e në muajin dhjetor 2025 sipas të cilave rezulton se:

Për muajin dhjetor 2025 ka llogaritur shpenzime transporti për muajin nëntor për 18 dite mësimore faktike dhe dhjetor 2025 për 13 ditë mësimore faktike si për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare, në total **714,295** lekë nga të cilat **311,531 lekë** për transport mësuesish dhe **402,764 lekë** për transport nxënësish.

Listat e pagesave për shpenzimet e transportit janë analizuar të grupuara sipas shkollave.

Nga shqyrtimi te dhënave dhe dokumentacionit vërtetues të listëpagesave të transportit për muajin dhjetor 2025 rezulton si më poshtë vijon:

Sipas listëpagesës janë llogaritur shpenzime transportit të muajit nëntor paguar dhjetor 2025, për shkollat 9-vjecare:

"Spille" Qendër; "Haki Skuqi "Gërmenj; "Kryevidh" vartëse e "Sterbeg"; "Lekaj"; "Luz i Madh"; "Qamil Gjuzi" Qendër Rrogozhine, "Vile Bashtovë "Vartëse e Zhabjak"; "Hekuran Balliu " vartëse e " Kalush"; SHMB- Qendër ,Gose; Xhorxh Soros.

Sipas listë pagesës rezulton se:

- **(20)** punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkollën publike **"Qamil Gjuzi" dhe "Xhorxh Soros"** me vëndodhje në **qytetin e Rrogozhinës**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **18,927** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti me tarifë të diferencuar 1000; 1500 dhe 2700 lekë sipas pikës 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar";
- në listëpagesë shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- përfitojnë kompensim mujor të diferencuar llogaritet dhe paguhet me listëpagesën e pagave si shumë neto.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.10 bashkëngjitur materialit.

Për shkollat arsimit të mesëm: "Haxhi Qehaj" qyteti Rrogozhinë; "Shkolla e Mesme e Bashkuar "Gose".

Sipas listë pagesës rezulton se:

- **(7)** punonjës arsimore të arsimit mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkollën **e mesme "HAXHI QEHAJ"** me vendodhje në **qytetin e Rrogozhinës**, janë paguar për muajin nëntor në dhjetor 2025 në shumën **30,723** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti me tarifë të diferencuar 1000; 1500 dhe 2700 lekë sipas pikës 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar";
- në listëpagesë shënohet distanca për përfitimin e shpenzimit të transportit;
- përfitojnë kompensim mujor të diferencuar llogaritet dhe paguhet me listëpagesën e pagave si shumë neto.
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.11 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Rrogozhinë, kanë përfituar shpenzime transporti (27) punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje brenda qytetit Rrogozhinë, janë paguar në shumën 449,050 lekë, në kundërshtim me pikën 11 germa a) të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", sipas të cilës punonjësit arsimorë përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike me vendndodhje jashtë qendrave urbane.

- Në listëpagesë e transportit nuk përfshihet kompensimi i diferencuar sipas distancës së transportit.
- Llogaritja dhe pagesa e kompensim mujor të diferencuar me tarifë 1000; 1500 dhe 2700 lekë) e vlerësuar si shumë neto në liste pagesën e pagave, nuk jep siguri të arsyeshme mbi saktësinë e vlerës së paguar, pasi në këtë listëpagesë mungon distanca në referencë të së cilës duhet të vlerësohet edhe kompensimi mujor për transport punonjësish arsimorë.

❖ **Pagesat e shpenzimeve të transportit.**

Pagesat transportit të punonjësve arsimore kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et e ZVAP Rrogozhinë. Listë prezenca e mësuesve që përfitojnë shpenzime transporti janë të firmosura nga Drejtori i IAP-se dhe dërguar me shkresë përcjellëse në ZVAP – Rrogozhinë.

Pagesat transportit të punonjësve nxënësve kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et ZVAP Rrogozhinë, ne te cilat shënohet emri dhe mbiemri i nxënësit përfitues distanca në kilometra mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollë, duke evidentuar emër- mbiemër ditë mësimore prezentë në mësim.

Për muajin dhjetor 2025 **ka llogaritur 13 ditë pune faktike** për muajin nëntor, për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare.

Pas verifikimit të listës së pagesave të muajit dhjetor 2025, në llogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve të transportit nuk u konstatuan mospërputhje midis ditëve të punës të realizuara realisht nga punonjësit arsimorë, ditëve që nxënësit kanë ndjekur procesin mësimor

Pagesat e shpenzimeve të transportit për **punonjës** arsimorë muajin vitin 2025 janë paguar në total ne vlere **11,219,360 lekë** nga të cilat për **nxënës** ne vlere 6,661,032 lekë dhe për mësues 4,558,328 lekë.

Pagesat e Punonjësve arsimore kryer nëpërmjet llogarive bankare**.**

Pagesat e **nxënësve** kryhen nëpërmjet 100% me **shërbimi postar**, në emër të prindërve të nxënësve, të kujdestareve ligjore apo përfituesve me prokurë të posaçme.

Nga urdhër shpenzimet e përzgjedhura në mënyrë rastësore u konstatua se ZVAP **ka paguar me vonese shpenzimet e transportit,** në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119/2023, sipas të cilës ZVAP-të, paguajnë çdo muaj shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, mbështetur në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, për urdhër pagesat si më poshtë vijon:

Shpenzimet e nxënësve të muajit tetor 2025, janë paguar me USH nr. 286, dt. 12.12.2025 në vlere 716,749 leke me tre muaj vonesë;

Shpenzimet e nxënësve të muajit shtator 2025, janë paguar me USH nr. 266, dt. 04.12.2025 në vlere 515,814 leke me tre muaj vonesë;

Shpenzimet e nxënësve të muajit prill 2025, janë paguar me USH nr. 133, dt. 17.06.2025 në vlere 577,182 leke me tre muaj vonesë;

Shpenzimet e nxënësve të muajit mars 2025, janë paguar me USH nr. 102, dt.08.05.2025 në vlere 616,653 leke me dy muaj vonesë;

Shpenzimet e nxënësve të muajit shkurt 2025, janë paguar me USH nr. 79, dt. 16.04.2025 në vlere 677,126 leke me dy muaj vonesë;

Shpenzimet e nxënësve të muajit janar 2025, janë paguar me nr. 70, dt.11.04.2025 në vlere 687,404 leke me tre muaj vonesë;

Shpenzimet e punonjësve të muajit janar 2025 me urdhër shpenzim nr. 71, dt. 11.04.2025, në vlere 125,475 leke me tre muaj vonesë;

Shpenzimet e punonjësve të muajit shkurt 2025 me urdhër shpenzim nr. 80, dt.22.04.2025, në vlerë 123,112 leke me dy muaj vonesë;

Shpenzimet e punonjësve të muajit mars 2025 me urdhër shpenzim nr. 110, dt. 08.05.2025, në vlerë 13,680 leke me dy muaj vonesë;
Shpenzimet e punonjësve të muajit prill 2025 me urdhër shpenzim nr. 144, dt.26.06.2025 në vlere 43,910 leke me dy muaj vonesë;
Shpenzimet e punonjësve të muajit maj 2025 me urdhër shpenzim nr. 159, dt. 07.07.2025, në vlerë128,256 leke me dy muaj vonesë;
Shpenzimet e punonjësve të muajit shtator 2025 me urdhër shpenzim nr. 168, dt. 10.12.2025, në vlerë 120,074 leke me tre muaj vonesë;
Shpenzimet e punonjësve të muajit qershor 2025 me urdhër shpenzim nr. 195, dt. 20.08.2025, në vlerë 114,294 leke me dy muaj vonesë;
Nga auditimi u konstatua se ZVAP Rrogozhinë ka administruar procesin e pagesës së shpenzimeve të transportit me mangësi në dokumentim, gjurmueshmëri dhe kontroll administrativ. Pagesat janë kryer 100% nëpërmjet shërbimit postar, pa evidentuar në listëpagesa prindin/kuzjdestarin ligjor përfitues dhe pa rakordime mujore me Postën Shqiptare, në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023. Gjithashtu, pagesat nuk janë kryer çdo muaj sipas kërkesave të këtij vendimi, ndërsa listëprezencat e IAP-ve nuk mbajnë numër dhe datë Protokolli hyrës në ZVAP, në kundërshtim me nenin 24 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP-ve. U konstatua gjithashtu mungesa e procedurave/rregulloreve të miratuara për dokumentimin e distancës, administrimin e dokumentacionit mbështetës dhe standardizimin e listëpagesave të transportit, duke dobësuar kontrollin dhe gjurmueshmërinë e procesit.
Nga auditimi u konstatua se ZVAP Rrogozhinë **ka kryer pagesat e shërbimit të transportit 100% nëpërmjet shërbimit postar**. Në listat e pagesave **nuk është shënuar prindi kujdestar** që ka të drejtë të tërheqë shumën e transferuar ne postë, ne emër të nxënësit të identifikuar me ID, në kundërshtim me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 **"***Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*" sipas të cilit ZVAP-të, bazuar në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, duhet të kryejnë pagesat çdo muaj përmes llogarive bankare të prindërve, kujdestarëve ligjorë, përfituesve me prokurë të posaçme. Përdorimi i shërbimit postar lejohet vetëm në zonat ku shërbimi bankar mungon ose është i paaksesueshëm, sipas pikës 2 të vendimit, deri në nënshkrimin e kontratës nga DRAP me operatorët ekonomikë për realizimin e transportit.
ZVAP Rrogozhinë **nuk ka kryer rakordime mujore me Postën Shqiptare për fondet tërhequra nga prindi kujdestar, sipas listëpagesës së depozituar në postë.**
ZVAP Rrogozhinë nuk ka paguar shpenzimet e transportit për çdo muaj, veprim në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119/2023, sipas të cilës ZVAP-të, paguajnë çdo muaj shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, mbështetur në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar,
Liste prezencat e IAP-ve, nuk mbajnë numër dhe datë Protokoll hyrës në ZVAP Rrogozhinë, veprim në **kundërshtim me** nenin 24 te Rregullores se Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP-ve *sipas të cilit përcaktohet se dokumentet hyrëse regjistrohen ne regjistrin e Protokollit nga punonjësi i arkiv Protokollit i cili bën shënimin në to të numrit të Protokollit dhe datës së marrjes së shkresës.*
Gjithashtu, ZVAP Tiranë **nuk disponon rregullore të miratuar**, i cili të përcaktojë **dokumentin vërtetues për përcaktimin distancës nga adresa e vendbanimit të përhershëm**, institucionin që duhet të disponojë dokumentin e vërtetimit të distancës, të dhënat që duhet të përmbajë një listë pagesë për shpenzimet e transportit, veprim që bie ndesh me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe

të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", sipas së cilës pagesat duhet të kryhen çdo muaj mbi bazën e të dhënave të dërguara nga institucionet arsimore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi personat përkatës si më poshtë:

- *z. A S. në cilësinë e NZ të ZVAP Rrogozhinë.*
- *znj. A. H. në cilësinë NA në ZVAP Rrogozhinë.*

❖ **Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë**

Nga verifikimi i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi në lidhje shpenzimet për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit të përhershëm të tyre, për periudhën 2022-2025 rezultoi se në Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar **Vorë** ka planifikuar dhe realizuar shpenzime transporti sipas të dhënave si më poshtë vijon:

	Viti 2022	**Viti 2023**	**Viti 2024**	**Viti 2025**
Plan	19,226,340	18,335,400	18,519,695	17,468,250
Fakt	16,263,878	17,949,660	18,203,700	17,385,570
Realizimi	**85%**	**98%**	**98%**	**99.5%**

Për vitin 2022 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 19,226,340 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 16,263,878 lekë ose 85%;

Për vitin 2023 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 18,335,400 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 17,949,660 lekë ose 98%;

Për vitin 2024 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 18,519,695 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 18,203,700lekë ose 98%;

Për vitin 2025 për nxënës dhe mësues ka planifikuar 17,468,250 leke shpenzime transporti dhe i ka realizuar 17,385,570 lekë ose 100%%;

Shpenzimet e transportit te detajuara (në lekë)

ZVAP	**Viti 2022**		**Viti 2023**		**Viti 2024**		**Viti 2025**	
VORË	**mësues**	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**	**mësues**	**nxënës**
Plan	2,182,743	17,043,597	816,600	17,518,800	1,256,830	17,262,865	2,418,380	15,049,870
Fakt	2,182,743	14,081,135	508,736	17,440,924	1,256,830	16,946,870	2,406,350	14,979,220
Realizimi	**13%**	**87%**	**3%**	**97%**	**7%**	**93%**	**14%**	**86%**

(Burimi: ZVAP; Punoi KLSH)

Nga auditimi rezulton se në ZVAP Vorë peshën specifike me të madhe e zënë shpenzimet e transportit e zëne shpenzimet e transportit për nxënës të cilat përbëjnë 86% deri 97% të shpenzimeve vjetore kundrejt shpenzimeve të transportit për mësues më peshë specifike 3% deri në 14% të shpenzimeve vjetore.

❖ **Për vitin buxhetor 2025**

Në zbatim të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit* ", i ndryshuar, ZVAP Vorë i është drejtuar Bashkisë Vorë me shkresat si më poshtë vijon::

- me shkresë nr. 32 Prot, datë 23.01.2026, kërkesë për informacion dhe miratim te linjave te transportit për nxënës dhe mësues që mësojnë dhe punojnë jashtë vendbanimit të tyre, për vitin shkollor 2024-2025, duke përcaktuar linjat e **transportit të mësuesve për vitin shkollor 2025-2026.**

Bashkia Vorë i ka kthyer përgjigje kërkesës se ZVAP-it për distancat për linjat e transportit publik që funksionojnë në këtë bashki përkatësisht **linjat: Vorë-Tiranë; Vorë-Marikaj; Vorë-Prezë dhe Vorë-Gërdec**.

- me shkresë nr. 5036/1 Prot, datë 04.10.2024, Protokolluar me nr. 683, dt. 11.10.2024, për vitin shkollor 2024-2025.
- me shkresë nr. 603/1 Prot., datë 15.04.2026, Protokolluar me nr. 190 Prot, datë 15.04.2026, për vitin shkollor 2025-2026.

❖ **Për vitin buxhetor 2024**

- me shkresë nr. 611 Prot, datë 19.09.2024, kërkesë për informacion dhe miratim te linjave te transportit për nxënës dhe mësues që mësojnë dhe punojnë jashtë vendbanimit të tyre, për vitin shkollor 2024-2025, duke përcaktuar (10) linjat e **transportit të mësuesve dhe distancat për linjat e udhëtimit të nxënësve** sipas (7) shkollave 9-vjecare "Prezë"; "Fushe Prezë"; "Ahmetaq";"Marqinet"; "Picar" "Bërxullë"; dhe "Marikaj"
- me shkresë nr. 5036/1 Prot, datë 04.10.2024 Bashkia Vorë konfirmon se **ka miratuar (4) linjat** transportit publik qytetës dhe rrethqytetës që operojnë në përkatësisht:Vore-Tiranë-Vore; Vorë-Prezë-Vore; Vorë-Marikaj-Vorë; Vorë-Gërdec-Vorë. Me këtë shkresë miraton distancat e udhëtimit të nxënësve që mësojnë larg vendbanimit të tyre shkollave e mesme e bashkuar "Prezë"; dhe shkolla 9 vjeçare "Fushë Prezë"; "Ahmetaq";"Marqinet"; "Picar" "Bërxullë"; dhe "Marikaj"

❖ **Për vitin buxhetor 2023**

-me shkresë nr. 47Prot, datë 12.12.2023, kërkesë për informacion dhe miratim te linjave te transportit për shkollën 9 vjeçare "Ahmetaq" me listë emërore për 14 nxënës me distancë mbi 2 km. Bashkia Vorë me shkresë nr. 196 Prot, datë 12.12.2023, ka miratuar linjat e transportit për shkollës 9 vjeçare "Ahmetaq".

❖ **Për vitin buxhetor 2022**

-me shkresë nr. 861 Prot, datë 14.09.2024, kërkesë për informacion dhe miratim te linjave te transportit për nxënës dhe mësues që mësojnë dhe punojnë jashtë vendbanimit të tyre, për vitin shkollor 2022-2023, duke përcaktuar (10) linjat e **transportit të mësuesve dhe nxënësve** Linjat e transportit të nxënësve që udhëtojnë për sipas shkollave 9-vjecare "Bërxullë"; "Marqinet"; "Picar" dhe"Ahmetaq" dhe Shkollën e Mesme të Bashkuar Prezë.

- me shkresë nr. 1045 Prot, datë 14.09.2024, kërkesë për informacion dhe miratim te linjave te transportit për nxënës dhe mësues që mësojnë dhe punojnë jashtë vendbanimit të tyre, për vitin shkollor 2022-2023, duke përcaktuar (10) linjat e transportit të mësuesve dhe nxënësve Linjat e transportit të nxënësve që udhëtojnë për sipas shkollave 9-vjecare "Bërxullë"; "Marqinet"; "Picar" dhe"Ahmetaq" dhe Shkollën e Mesme të Bashkuar Prezë.

Bashkia Vorë ka kthyer përgjigje:

- me shkresë nr. 5189/1 Prot, datë14.09.2022 për distancat për linjat e transportit të mësuesve dhe distancën ne km dhe linjat e transportit të nxënësve.
- me shkresë nr. 639 Prot, datë 29.01.2022 konfirmon se ka miratuar (5) linjat transportit qytetës dhe rrethqytetës që operojnë në Bashkia Vorë përkatësisht:

Vore-Tiranë-Vore; Vorë-Prezë-Vore; Vorë-Marikaj-Vorë; Vorë-Gërdec-Vorë; Vorë-Durrës-Vorë **Nga auditimi u konstatua se:** Bashkia Vorë, ka të miratuara linjat e transportit qytetës dhe rrethqytetës por pa përcaktuar Vendim të Këshilli Bashkiak për caktimin e linjave, tarifave dhe orareve të transportit qytetës nën juridiksion e saj.

❖ **Tarifa e transportit të aplikuara për mësues dhe punonjës arsimore**

Në mbështetje të pikës 1 germa a) VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "P*ër përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit",* i ndryshuar, përcaktohet nga buxheti i shtetit përballohen fondet publike të shpenzimeve për transportin se punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitar publike, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;

Tarifat e transportit **për mësuesit** është llogaritur mbi tarifën fillestare duke filluar nga distanca

më e vogël deri 10 km me tarifë 50 lekë për vajte ose 100 lekë vajtje –ardhje, e pa indeksuar**,** bazuar në Shtojcën 1 në VKM nr. 92/2024'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor *ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"*.
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 913/2 Prot, datë 19.02.2025, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 406/1 Prot, datë 10.02.2025, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2024 i **cili është (-0.07%).**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 971/2 Prot, datë 22.02.2024, në zbatim të VKM nr.119/2023, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 225/1 Prot, datë 13.02.2024, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2023 i **cili është (4.78%).**
Ministria e Arsimit dhe Sportit, më shkresë nr. 1490 Prot, datë 02.03.2023, në zbatim të VKM nr.682/2015, dhe në vijim të shkresës së INSTAT nr. 126/1 Prot, datë 31.01.2023, ka dërguar **indeksin e çmimeve të konsumit** për grupin "Shpenzime transporti " për vitin 2022 i **cili është (4.46%).**
Nga auditimi u konstatua se: Shpenzimet e transportit të mësuesve nga ZVAP Vorë për periudhën objekt auditimi janë aplikuar mbi tarifat e çmimit të biletës (pa indeksuar) sipas përcaktimeve në VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'".
Shpenzimet e transportit të nxënësve nga ZVAP Vorë për periudhën objekt auditimi janë aplikuar mbi tarifat e çmimit të biletës (pa indeksuar) sipas përcaktimeve në VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'".
Për periudhën maj deri dhjetor të 2025, aplikimi tarifën e pa indeksuar për punonjës arsimore dhe për nxënësit përputhet me tarifat e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus", pasi pika 3) VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", ka ndryshuar, me VKM nr. 239, datë 24.04.2025, duke eliminuar (hequr) mekanizmin e indeksimit. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 73, me datë publikimi 24.04.2025.
Përgjigja e Bashkisë Vorë tregojnë se ka miratuar linjat e transportit publik qytetës dhe rrethqytetës, por nuk ka informacion për distancat dhe tarifën e biletës së udhëtimit për këto linja, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tarifat e krahasuara të biletës së udhëtimit

	Lloji i transportit	**Çmimi i biletës vajtje ose ardhje (lek)**	**Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek)**	**Çmimi i biletës vajtje + ardhje (lek) +50%**
		punonjës	**punonjës**	**nxënës**
VKB Vorë	Qytetës/ Rrethqytetëse	**N/A**	**N/A**	**N/A**
VKM nr. 92/2024	***Ndërqytetës***	50	**100**	**150**

Nga ZVAP Vorë tarifat e udhëtimit **janë llogaritur sipas distancave dhe tarifave ndërqytetëse** të miratuara me VKM nr. 92/2024*"Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus"* ***duke filluar me tarifë minimale 100 lekë/ditë*** *në ditë, e paindeksuar* .
Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresë nr. 1746 Prot., datë 06.03.2024, me lëndë "*Për zbatimin e VKM nr. 92, datë 21.02.2024 'Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus'"*, Protokolluar në ZVAP Kamëz me nr. 612, datë 06.03.2024, ka udhëzuar të gjitha drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat arsimore vendore se, nga data e hyrjes në fuqi të VKM nr. 92, datë 21.02.2024, në përllogaritjen e fondeve të procedurave të prokurimit apo mbulimin e shpenzimeve të transportit për nxënësit dhe mësuesit,

referuar VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, duhet të zbatohen tarifat e përcaktuara në VKM nr. 92/2024, duke qenë se shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit subvencionohet në masën 100% nga buxheti i shtetit.

Nga auditimi përcaktimit të tarifave të nxënësve **u konstatua se**:

Për shpenzimet e transportit për shpenzimet e transportit të nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km nga Bashkia Vorë mungon informacioni nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km nuk është plotësuar kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës.

Procedurat e realizimit të shpenzimeve të transportit:

- Pagesat transportit të punonjësve arsimore (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social)

Kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et e ZVAP Vorë, në të cilat shënohet distanca sipas linjave nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollës ku ata janë punonjës arsimorë.

ZVAP përpilon listë prezencë mujore firmosur nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe Titullari i ZVAP-se.

Listëprezenca mujore ZVAP-se mbështet ne listëprezencën e dërguar nga IAP-të, firmosura nga Drejtori i IAP-it, duke shënuar ditët mësimore të punonjësve arsimore për pagesë shpenzime transporti.

Liste prezencat e IAP-ve, janë dorëzuar në ZVAP-Vorë. Ato përgjithësisht mbajnë numër dhe datë Protokolli sipas shkollës përkatëse.

Për muajin dhjetor 2025 ka llogaritur shpenzime transporti për muajin nëntor për 18 dite mësimore faktike dhe dhjetor 2025 për 13 ditë mësimore faktike si për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare, në total 3,183,330 lekë nga të cilat 2,133,600 lekë për transport nxënësish.

Pagesat e punonjësve arsimore kryhen 100% në bankë.

Për auditim u përzgjodhën listëpagesat në muajin dhjetor 2025 sipas të cilave rezulton se:

Për muajin dhjetor 2025 ka llogaritur shpenzime transporti për muajin nëntor për 18 dite mësimore faktike dhe dhjetor 2025 për 13 ditë mësimore faktike si për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare, në total **3,183,330** lekë nga të cilat **1,049,730 lekë** për transport mësuesish dhe **2,133,600 lekë** për transport nxënësish.

Listat e pagesave për shpenzimet e transportit janë analizuar të grupuara sipas shkollave.

Nga shqyrtimi te dhënave dhe dokumentacionit vërtetues të listëpagesave të transportit për muajin dhjetor 2025 rezulton si më poshtë vijon:

Shkollat 9 vjeçare: Vorë; Domje; Gjokaj; Marikaj; Muçaj; Picar; Marikaj; Marqinet; Berxull; Picar.

Shkollat e mesme: Shkolla e mesme Domje; Shkolla e mesme Vorë.

Sipas listë pagesës rezulton se:

- **(28)** punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat

dhe punojnë në shkollën publike **9 Vjeçare Vorë** me vëndodhje në **qytetin e Vorës**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **130,820** lekë.
-(23) punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkollën publike **9 Vjeçare Vorë** me vëndodhje në **qytetin e Vorës**, janë paguar për muajin nëntor dhe dhjetor 2025 në shumën **115,940** lekë.
- shpenzime për kompensimin e transporti zero lekë
- të dhënat analitike u pasqyruan në Aneksin nr. 2.2.2.12 bashkëngjitur materialit.

Nga auditimi u konstatua se në listë pagesat e muajit dhjetor 2025 në ZVAP Vorë, kanë përfituar shpenzime transporti **(51) punonjës arsimore** të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, **me vendbanim** të përhershëm në qytetet ose fshat dhe punojnë në shkolla publike me vendndodhje **brenda** qytetit Vorë, janë paguar në shumën **246,760 lekë. në kundërshtim me pikën 11 germa a)** të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës punonjësit arsimorë përfitojnë shpenzime transporti në rast se punojnë në IAP-e publike **me vendndodhje jashtë qendrave urbane**.
Në listëpagesë e transportit nuk përfshihet distanca e transportit mbi të cilën llogaritet shpenzimi i transporti.
Në listëpagesat e muajit dhjetor 2025, në zbatim pikës 11 germa a) të VKM nr. 425/2024 "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*", i ndryshuar, ka llogaritur dhe paguar kompensim mujor për largësi nga vendbanimi për çdo punonjës mësimor që punon mbi 5 km deri në 50 km, larg vendbanimit dhe kthehet brenda ditës.
Me shkresë nr. 598 Prot, datë 18.09.2024, Titullari ZVAP-Vorë ka urdhëruar ndryshimin e kompensimit mujor të shpenzimeve të transportit për distancën mbi 5 km, në masën 2,700 lekë në muaj, mbi 5 km, brenda dhe jashtë qendrave urbane, referuar në pikën 11.a të VKM nr. 425/2024, e ndryshuar dhe pikës 5.a.b.c në VKM nr. 682, datë 29.07.2015 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit" , i ndryshuar.
Nga auditimi u konstatua se ZVA Vorë, në zbatim të **shkronjës "a", të pikës 11, të VKM nr. 42**5, datë 26.6.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar"*, ka llogaritur dhe paguar kompensim mujor (jo të diferencuar~~)~~ në shpenzimet e transportit, në masën 2,700 lekë/muaj, për çdo punonjës arsimor, që ka përfituar shpenzime transporti, në kundërshtim me *shkronjës pikës 6, germa a) dhe b) të* VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit , i ndryshuar***", sipas të cilës duhet të paguhet kompensim mujor i diferencuar.**
Kompensim për largësi është llogaritur dhe paguar në masën 2,700 lekë në muaj, përcaktuar në kolonë të veçantë në listëpagesën e pagave, si shume neto, që i shtohet të ardhurave nga paga pas zbritjes së sigurimeve dhe tatimeve të llogaritura.
Totali i pagesave për punonjësit e kësaj listëpagesës se muajit dhjetor për 219 mësues **në shumën 591,300 lekë** është **në kundërshtim** me *pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimore që punojnë dhe nxënësve qe mësojnë jashtë vendbanimit, i ndryshuar, e cila* **parashikon kompensim të diferencuar për distanca**t: mbi 5 km deri në 10 km në vlerën 1,000 lekë/muaj; mbi 10 km deri në 20 km 1 në vlerën 1,500

lekë/muaj dhe mbi 20 km deri në 50 km në vlerën 2,700 lekë/muaj

Në procesin e zbatimit, kuadri aktual nënligjor ka krijuar **mbivendosje dhe paqartësi ligjore**, duke sjellë një praktikë jo të unifikuar nga ZVA-të, Konkretisht:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 26.06.2024, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", i ndryshuar, në pikën 11, germa "a", përcakton një normë të unifikuar për kompensimin e transportit, **në masën fikse prej 2,700 lekë/muaj**.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 01.03.2023, "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i ndryshuar, në pikën 6, **parashikon një kompensim mujor të diferencuar**, i cili lidhet me dispozitat e shkronjës "a" të pikës 11 të vendimit nr. 425/2024.

Kuadri aktual nënligjor ka sjellë pasiguri në interpretim dhe zbatim, duke krijuar mospërputhje në praktikën administrative në institucioneve arsimore dhe ZVA-ve.

- **Pagesat e shpenzimeve të transportit.**

Pagesat transportit të punonjësve arsimore kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et e ZVAP.

Listë prezenca e mësuesve që përfitojnë shpenzime transporti janë të firmosura nga Drejtori i IAP-se dhe dërguar me shkresë përcjellëse në ZVAP.

Pagesat transportit të punonjësve nxënësve kryhen sipas ditëve mësimore të dërguara nga IAP-et ZVAP, ne te cilat shënohet emri dhe mbiemri i nxënësit përfitues distanca në kilometra mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollë, duke evidentuar emër- mbiemër ditë mësimore prezentë në mësim.

Për muajin dhjetor 2025 ka llogaritur 18 ditë pune faktike për muajin nëntor dhe 13 ditë për muajin dhjetor, për mësuesit dhe nxënësit, pasi janë zbritur ditët e pushimeve dhe festave zyrtare.

Pas verifikimit të listës së pagesave të muajit dhjetor 2025, në llogaritjen dhe pagesën e shpenzimeve të transportit nuk u konstatuan mospërputhje midis ditëve të punës të realizuara realisht nga punonjësit arsimorë, ditëve që nxënësit kanë ndjekur procesin mësimor

Për auditim u përzgjodhën listë prezencat e dërguara nga IAP-et për pagesën e shpenzimeve të transportit të mësuesve për muajin Dhjetor 2025.

Pagesat e shpenzimeve të transportit për **punonjës** arsimorë muajin dhjetor 2025 janë paguar në total ne vlere **3,183,330 lekë** nga të cilat për **nxënës** ne vlere **2,133,600** lekë dhe për mësues **1,049,730** lekë.

Pagesat e Punonjësve arsimore **kryer nëpërmjet llogarive bankare.**

Pagesat e **nxënësve** kryhen nëpërmjet 100% me **shërbimi postar**, në emër të prindërve të nxënësve, të kujdestareve ligjore apo përfituesve me prokurë të posaçme.

Nga auditimi i listë pagesave të transportit u konstatua se ZVAP Vore për muajin dhjetor 2025:

- **nuk ka paguar** shpenzimet e transportit të mësuesve (21 arsimtarë) për "Shkollën e Bashkuar-Shaban Sheshori", Prezë, me shkresë nr. 444, datë 19.01.2025, pa numër dhe datë Protokolli hyrës në ZVAP;
- **nuk ka paguar** shpenzimet e transportit të mësuesve (6 arsimtarë) për "Shkollën 9- vjeçare Fushë Prezë", Prezë, me shkresë nr. N/A, datë 25.12.2025, pa numër dhe datë Protokolli hyrës në ZVAP;
- listëpagesën e muajin dhjetor (për 11 punonjës) **nuk ka paguar** shpenzimet e transportit për 1 (një) mësuese znj. D. L.) për "Shkollën 9- vjeçare Ramazan Subashi", Marikaj, me shkresë nr. N/A, datë 19.01.2025, pa numër dhe datë Protokolli hyrës në ZVAP;

- në listëpagesën e muajin dhjetor (për 30 punonjës) **nuk ka** paguar shpenzimet e transportit për **-2 (dy)** përkatësisht mësuese znj. E. K. dhe znj.M. A.) si dhe ka përfshirë në listë pagesë +1 (një) mësuese, përkatësisht znj. E. J. për "Shkollën 9- vjeçare Vore", me shkresë nr. N/A, datë N/A, pa numër dhe datë Protokolli hyrës në ZVAP;
- në listëpagesën e muajin dhjetor (për 38 punonjës) **nuk ka** paguar shpenzimet e transportit për -2 (dy) përkatësisht mësuese znj. O. A. dhe znj.S. D.) për "Shkollën 9- vjeçare Vajdin Lamaj", Domje, me shkresë nr. 117 Prot, datë N/A, me Protokoll hyrës nr. 685/1, datë 29.12.2025.

Nga auditimi listë pagesës së transportit të punonjësve të Shkollë së mesme Vorë **u konstatua se**:
- ZVAP Vore, nuk disponon dokumentacion për justifikimin e shpenzimeve të transportit për arsimtaret, pasi pretendon se ky dokumentacion administrohet në IAP dhe të dhënat përfshihen në listë prezencë nga Drejtoret e IAP-ve, për të cilën grupi i auditimit nuk mund të shprehet mbi saktësinë e transaksioneve të kryera përsa i përket distancës së transportit sipas vëndodhjes se përhershme të punonjësit arsimor.
- Për 2 (dy) punonjës arsimore përkatësisht R.H dhe K.P, të dhënat e vendbanimit, vendit të punës dhe linjës të kryen transportin nuk përputhen.
- Për 2 (dy) punonjës arsimore përkatësisht G. K dhe R.Gj, të dhënat e vendbanimit, vendit të punës dhe linjës të kryen transportin nuk përputhen.
- Për 1 (një) punonjës arsimore përkatësisht O.A, të dhënat e vendbanimit, vendit të punës dhe linjës të kryen transportin nuk përputhen.

Nga auditimi u konstatua se nga ZVAP Vorë listë pagesat për shpenzimet e transportit paguar në disa raste kanë mospërputhje ne listat e punonjësve arsimore për pagesë, të tilla si mos pagesë në muajin dhjetor të shpenzimeve të transportit të mësuesve (21 arsimtarë) për "Shkollën e Bashkuar- Shaban Sheshori", Prezë, për (6 arsimtarë) për "Shkollën 9- vjeçare Fushë Prezë" si dhe mos përfshirje në pagese për (një) mësuese për "Shkollën 9- vjeçare Ramazan Subashi", Marikaj; për 2 (dy) përkatësisht mësuese znj. E K dhe znj.M A) për "Shkollën 9- vjeçare Vore", për 2 (dy) mësuese znj. O A dhe znj.S D) për "Shkollën 9- vjeçare V L", Domje;
- Listë pagesat për shpenzimet e transportit paguar nga ZVAP, nuk kanë distancën kilometrike për të cilën paguhen shpenzimet e transportit.
- Liste prezencat e dërguara nga IAP-et, nuk përmbajnë në çdo rast numër dhe datë Protokolli të IAP-itt;
- Listë pagesat për shpenzimet e transportit paguar nga ZVAP, nuk kanë numër dhe datë Protokolli hyrës në institucion.

❖ **Shpenzimet e transportit për nxënës**

Pagesat e transportit për nxënësit, për vitin 2025, bazohen në listat mujore të prezencës së transportit të dërguara që udhëtojnë për sipas shkollave 9-vjecare "Bërxullë"; "Marqinet"; "Prezë"; "Fushe Prezë"; "Ahmetaq" dhe "Marikaj".

Listë pagesat e ZVAP Vorë mbështeten në listë prezencës e nxënësve, të dërguara nga IAP-et, ne te cilat shënohet distanca në kilometra mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm deri në shkollë, emër, atësi, mbiemër të nxënësit, klasën e nxënësit përfitues, ditë mësimore prezentë në mësim, shkolla përkatëse, njësia administrative e shkollës.

Listë nënshkruhet nga drejtori i shkollës dhe nuk ka numër dhe datë Protokolli te IAP-it.

ZVAP përpilon liste prezence mujore për nxënësit që përfitojnë shpenzime transporti, firmosur nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe Titullari i ZVAP-se.

Pagesat e nxënësve janë kryer nëpërmjet postës shqiptare, sipas listë pagesës së shpenzimeve të transportit të nxënësve, në të cilën shënohen emër, atësi, mbiemër, dite mësimore, distanca mbi 2 km, çmimi i biletës 150 lekë, vlera e përfituar, numri ID së nxënësit përfitues dhe kolona e fundit

(nënshkrimi) e pa përcaktuar.
Lista e shpenzimeve të transportit të nxënësve dorëzohet në postë, me një dokument përmbledhës të nënshkruar nga Titullari i ZVAP-së, përgjegjësi i sektorit të shërbimeve, dhe punonjësi i postës shqiptare.
ZVAP – Vorë për vitin 2025 ka paguar shpenzimet e transportit për dhe për nxënës në total 12,896,700 lekë dhe punonjës arsimore **në total 5,746,790 lekë** nga të cilat 12,896,700 lekë për programin me kodi 9230 dhe 3,340,440 lekë për programin me kodi 9120.

Te dhënat analitikë për shpenzimet e transportit për nxënës (viti 2025)

Urdhër shpenzim nr.	Data ush	Periudha mësimore	Shpenzime transport nxënës	Transfertë me banka/posta
17	06.02.2025	Janar	1,311,000	Filiali i Postes Vore
44	05.03.2025	Shkurt	1,332,000	Filiali i Postes Vore
49	07.04.2025	Prill	1,198,800	Filiali i Postes Vore
53	05.05.2025	Maj	1,132,000	Filiali i Postes Vore
67	04.06.2025	Qershor	1,864,800	Filiali i Postes Vore
114	06.10.2025	Shtator	1,115,150	Filiali i Postes Vore
127	05.11.2025	Tetor	1,511,400	Filiali i Postes Vore
142	04.12.2025	**Nëntor – Dhjetor**	2,133,600	Filiali i Postes Vore
	TOTALI		**11,598,750**	

Shpenzime transporti për mësues analitike *(viti 2025)*

kodi programit	Urdhër Shpenzim nr.	Data USH	Periudha mësimore	Shpenzime transporti per mesues	Transfertë me Banka
9230	nr. 31	17.03.2025	janar - shkurt 2025	1,221,720	BKT
9230	nr. 32	17.03.2025	janar - shkurt 2026	71,500	Raiffeisen Bank
9230	nr. 33	17.03.2025	janar - shkurt 2025	16,000	Credins Bank
9230	nr. 34	17.03.2025	janar - shkurt 2025	6,000	Prokredit Bank
9120	nr. 58	13.05.2025	mars - prill 2025	60,750	Raiffeisen Bank
9230	nr. 57	13.05.2025	mars - prill 2025	5,700	Prokredit Bank
9230	nr. 56	13.05.2025	mars - prill 2025	14,450	Credins Bank
9120	nr. 55	13.05.2025	mars - prill 2025	1,121,750	BKT
9120	nr. 78	07.07.2025	maj- qershor 2025	858,480	BKT
9230	nr.79	07.07.2025	maj- qershor 2025	11,200	Credins Bank
9230	nr. 80	07.07.2025	maj- qershor 2025	4,200	Prokredit Bank
9120	nr. 81	07.07.2025	maj- qershor 2025	49,100	Raiffeisen Bank
9120	nr. 132	10.11.2025	shtator- tetor 2025	92,140	Raiffeisen Bank
9230	nr. 131	10.11.2025	shtator- tetor 2025	5,850	Prokredit Bank
9120	nr. 130	10.11.2025	shtator- tetor 2025	9,750	Credins Bank
9120	nr.129	10.11.2025	shtator- tetor 2025	1,148,470	Bkt
9230	nr. 148	16.12.2025	nentor - dhjetor 2025	76,260	Raiffeisen Bank
9230	nr. 147	16.12.2025	nentor - dhjetor 2025	4,650	Prokredit Bank
9230	nr.146	16.12.2025	nentor - dhjetor 2025	7,750	Credins Bank
9230	nr.145	16.12.2025	nentor - dhjetor 2025	961,070	BKT
		TOTALI		**5,746,790**	

Nga auditimi u konstatua se: Për shpenzimet e transportit për shpenzimet e transportit të nxënësve që udhëtojnë mbi 2 km nga Bashkia Vorë mungon informacioni nëse për këtë linjë transporti nxënësish në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës, veprim në kundërshtim me paragrafi 1) gërma b) të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas të cilës përballohen nga fondet publike shpenzimet për transportin e nxënësve që udhëtojnë nga adresa e vendbanimit të përhershëm mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht) dhe në këtë vendbanim nuk u ofrohet transport qytetës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar.
Pra për transportin e nxënësve mbi 2 km duhet të plotësohet edhe kriteri ligjor se në këtë vendbanim nuk ofrohet transport qytetës.
ZVAP nuk argumentuar mungesën e shërbimit bankar për kryerjen e shpenzimeve të transportit për nxënës, pasi 100% pagesave është kryer nëpërmjet shërbimit postar, veprim në kundërshtim 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", i cili përcakton se ZVAP paguajnë çdo muaj shpenzimet e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, nëpërmjet

llogarive bankare në bankat e nivelit, ose nëpërmjet shërbimit postar, vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm.
Në listat e pagesave nuk është shënuar prindi kujdestar që ka të drejtë të tërheqë shumën e transferuar ne postë, ne emër të nxënësit të identifikuar me ID, veprim në kundërshtim me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i cili përcakton se ZVAP-të, bazuar në të dhënat e dërguara nga drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitar, duhet të kryejnë pagesat çdo muaj përmes llogarive bankare të prindërve, kujdestarëve ligjorë, përfituesve me prokurë të posaçme. Përdorimi i shërbimit postar lejohet vetëm në zonat ku shërbimi bankar mungon ose është i paaksesueshëm, sipas pikës 2 të vendimit, deri në nënshkrimin e kontratës nga DRAP me operatorët ekonomikë për realizimin e transportit.
ZVAP nuk ka kryer rakordime mujore me postën shqiptare fondet tërhequra nga prindi kujdestar, sipas listëpagesës së depozituar në postë.
ZVAP ka paguar njëkohësisht dy muaj (nëntor-dhjetor 2025) shpenzimet e transportit të nxënësve, përkatësisht me urdhër-shpenzim nr. 142, dt04.12.2025, në vlerën 2,133,600 lekë.
Gjithashtu, ZVAP nuk disponon standard të miratuar nga DRAP Tiranë, i cili të përcaktojë dokumentin vërtetues për përfitimin e shpenzimeve te transportit si në IAP/ZVAP, të dhënat që duhet të përmbajë një listë pagesash për shpenzimet e transportit, veprim që bie ndesh me pikën 4 të VKM Nr. 119, datë 1.3.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", sipas së cilës pagesat duhet të kryhen çdo muaj mbi bazën e të dhënave të dërguara nga institucionet arsimore.

2.3 Mbi strukturën organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, shpenzimet e pagave, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionet publike të arsimit parauniversitar.

2.3.1 Mbi strukturën organizative

2.3.1.1 Mbi strukturën organizative të miratuara dhe krahasimi me faktin për DRAP Tiranë

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*. Në pikën 7 të këtij urdhri përcaktohet se efektet e tij fillojnë pas datës 01.10.2024.
Sipas pikës 1 të Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar"* Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka në varësi:
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë.

Përpara hyrjes në fuqi të 2 Urdhrave të mësipërm si dhe referuar Urdhrit nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ZVAP Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë dhe Vorë kanë qenë në varësi të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës.
Rezulton se Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar"* ka dalë me mbi 1 muaj vonesë nga data (01.10.2024) e caktuar nga Urdhri i Kryeministrit për fillimin e efekteve të

strukturës së re organizative të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore Rajonale.
Sipas skemës nr. 1/1 dhe nr. 2/1 të Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, është planifikuar për të funksionuar me një strukturë prej 23 punonjësish, përkatësisht:
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Drejtori i Inspektimit dhe Kurrikulës.
Sektori i Monitorimit, Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit në Arsimin Parashkollor, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.
Sektori i Statistikës, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë.
Emërimi i punonjëseve të DRAP Tiranë
Ministri i Arsimit dhe Sportit me urdhrin nr. 572, datë 19.11.2024 ka emëruar Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me urdhrat nr. 303, 304, 305, 306, 307, 308, 378, 379, 380, 381, 382, datë 23.12.2024 ka emëruar në detyrë deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit 11 punonjës në DRAP Tiranë.
Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i AKAP me urdhrat nr. 1, 2, 3 datë 07.01.2025, nr. 20 datë 10.01.2025, nr. 37, datë 20.01.2025 , nr. 88, datë 28.02.2025 dhe nr. 130, datë 20.06.2025 ka emëruar përkohësisht në detyrë deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit 7 punonjësit e tjerë të DRAP Tiranë.
Sa më sipër, konstatohet se emërimi i Drejtorit të DRAP Tiranës, nga Ministri i Arsimit dhe Sportit është **kryer me mbi 1 muaj me vonesë,** nga data e hyrjes në fuqi të strukturës të re organizative të DRAP Tiranës.
Gjithashtu emërimi i punonjësve të DRAP Tiranës është **kryer me rreth 3 muaj vonesë** nga data e hyrjes në fuqi të strukturës organizative.
Gjatë vitit 2025, referuar urdhrit të AKAP nr. 25, datë 16.10.2025, 1 punonjës është larguar nga detyra me dorëheqje, konkretisht Drejtori i Inspektimit dhe Kurrikulës. Në fund të vitit 2025, plotësimi i strukturës organizativë të DRAP Tiranë, paraqitet si në tabelën në vijim:
Tabela: Organika e DRAP Tiranë, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
I	**Drejtor**	**III-1**	**1**	**1**
II	**Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës**		**10**	**9**
	Drejtori	III-2	1	-
II.1	**Sektori i Monitorimit, Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional**		**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	III-3	1	1
2.	Specialist	IV-2	2	2
II.2	**Sektori i Inspektimit në Arsimin Parashkollor**		**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	III-3	1	1
2.	Specialist	IV-2	2	2
II.3	**Sektori i Inspektimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë**		**3**	**3**
1	Përgjegjës Sektori	III-3	1	1
2	Specialist	IV-2	2	2

III	**Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare**		**5**	**4**
1.	Përgjegjës Sektori	III-3	1	1
2.	Specialist (për burimet njerëzore)	IV-2	1	1
3.	Specialist (për buxhetin dhe investimet)	IV-2	2	2
4.	Specialist (jurist)	IV-2	1	-
IV	**Sektori i Statistikës**		**3**	**3**
1.	Përgjegjës Sektori	III-3	1	1
2.	Specialist	IV-2	2	2
V	**Sektori i Shërbimeve Mbështetëse**		**4**	**2**
1.	Specialist (arkiv/protokoll)	IV-3	1	1
2.	Sekretare		1	1
3.	Shofer		1	-
4.	Punonjës pastrimi		1	-
Punonjës gjithsej			**23**	**19**

Burimi: DRAP Tiranë, punuar nga grupi i auditimi

Sa më sipër në fund të vitit 2025, DRAP Tiranë ka pasur 4 vende vakante, nga të cilat 3 prej tyre kanë qenë vakante gjatë gjithë vitit.

2.3.1.2 Mbi strukturën organizative të DRAP Durrës

Deri më datë 01.10.2024, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës ka funksionuar sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 68, datë 05.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar"*.

DRAP Durrës, ka qenë përgjegjës për funksionimin dhe mbarëvajtjen e 12 Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tij, konkretisht:

- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Krujë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Burrel;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Mat;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Klos;
- Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër.

Në zbatim të Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar" dhe Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar" Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës pësoi riorganizim dhe në varësi të tij janë 7 Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar":

- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Durrës;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Krujë;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Bulqizë;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Burrel;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Mat;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Klos;
- Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Dibër.

Sipas skemës nr. 1/1 dhe nr. 2/1 të Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, është planifikuar për të funksionuar me një strukturë prej 23 punonjësish, përkatësisht:
Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Drejtori i Inspektimit dhe Kurrikulës.
Sektori i Monitorimit, Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit në Arsimin Parashkollor, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë.
Sektori i Statistikës, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, i përbërë nga 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë.
Për vitin 2022, 2023, 2024, 2025 nuk ka pasur vende vakante.
- Me urdhrin nr. 359, datë 06.06.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A T është emëruar në pozicionin sekretare në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 209, datë 30.09.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. B.Sh është emëruar në pozicionin përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit, është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 55, datë 19.02.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. E.V është emëruar në pozicionin specialiste e Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 268, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. F.K është emëruar në pozicionin specialiste i Sektorit të Inspektimit në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 256, datë 12.05.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. H.L është emëruar në pozicionin Drejtor në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
Me urdhrin nr. 46, datë 15.03.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. O.T është emëruar në pozicionin specialist për Investimet dhe Infrastrukturën në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 09, datë 08.09.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. R.B është emëruar në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 265, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. E.M është emëruar në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 105, datë 05.04.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. Xh.T është emëruar në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

- Me urdhrin nr. 267, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. M.M është emëruar në pozicionin specialist i Inspektimit në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 176, datë 19.06.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.O është emëruar në pozicionin përgjegjës i Sektorit të kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 317, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 182, datë 04.10.2021 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. V.K është emëruar në pozicionin specialist i Sektorit të kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në DRAP Durrës. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 317, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

2.3.1.3 Mbi strukturën organizative të ZVAP Tiranë

Për periudhën 01.01.2022 deri më 18.11.2024 struktura organizative e ZVAP Tiranë është përcaktuar në Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 25.

Ndërsa për periudhën 18.11.2024 e në vijim struktura është përcaktuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 22.

Mbi plotësimin e strukturës së burimeve njerëzore

- Me urdhrin nr. 231, datë 21.07.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. F.L është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë, për një periudhë jo më vonë së data 21.10.2020. Me urdhrin nr. 323 datë 14.10.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë", është emëruar në të njëjtin pozicion, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 317, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 307, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.N është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 321, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 72, datë 18.02.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.M është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 323, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 302, datë 22.09.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.M është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 316, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 173, datë 24.09.2025 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. K.M është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë, me kontratë provizore (zëvendësim raport mjekësor) në vend të znj. R.Xh. Në këtë emërim nuk jepet afat në lidhje me kohëzgjatjen e kontratës.

- Me urdhrin nr. 154, datë 12.09.2023 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. A.S është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 315, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 360, datë 10.11.2020 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. F.T është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 314, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 855, datë 18.12.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. R.Xh është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 320, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 240, datë 15.12.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. S.K është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 320, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 304, datë 11.10.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.S është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 318, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtin pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 273, datë 11.10.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.P është emëruar në pozicionin specialist Finance në Sektorin e Shërbimeve në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 327, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtin pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 344, datë 29.10.2020 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. G.Sh është emëruar në pozicionin specialist Finance në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 326, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin specialist Finance i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 201, datë 15.06.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.B është emëruar në pozicionin specialist Finance në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 328, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin specialist Finance i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 290, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. K.F është emëruar në pozicionin përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 309, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

- Me urdhrin nr. 288, datë 23.02.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. R.K është emëruar në pozicionin specialist Jurist në Sektorin e Shërbimeve në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 311, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar njëjtin pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 272, datë 09.09.2020 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.Sh është emëruar në pozicionin specialist Jurist në Sektorin e Shërbimeve në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 324, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar njëjtin pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 294, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. B.S është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Shërbimeve në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 310, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin specialist Jurist i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 298, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. A.Ç është emëruar në pozicionin specialist Finance në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 325, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin specialist Finance i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 295, datë 15.09.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. A.K është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 312, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në pozicionin specialist Inxhinier në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 304, datë 15.05.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. Ë.P është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 322, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

Konstatohet se 4 punonjës të ZVAP Tiranës, konkretisht znj. B.S, znj. A.C, znj. A.K dhe znj. E. P, kanë qenë në këtë institucion me status nëpunësi civil dhe me ndryshimin e bërë sipas VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”,* i ndryshuar, të gjithë punonjësve të ZVAP - ve u është hequr statusi i nëpunësit dhe trajtimi i tyre në vijimësi është sipas përcaktimeve të Kodit të Punës. Referuar kësaj VKM - je, këta punonjës kaluan nga punonjës me status nëpunësi civil në punonjës me kontratë pune provizore me afat *"Deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit"*. Megjithëse kanë kaluar mbi 7 vite nga heqja e statusit të nëpunësit civil, vazhdojnë të jenë më akt emërimi provizor deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, në një kohë që kalimi i tyre në të njëjtin institucion dhe në të njëjtin pozicion pune duhet të ishte automatikisht definitiv, ndërsa rekrutimet e reja pas daljes së këtij vendimi duhet të ishin me procedura konkurrimi.

Për vitin 2022 dhe 2023 nuk ka pasur vende vakante në ZVAP Tiranë.

Për vitin 2024 kanë rezultuar 2 vende vakante, konkretisht në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Për vitin 2025 kanë rezultuar 2 vende vakante, konkretisht 1 në pozicionin specialist Finance në Sektorin e Shërbimeve dhe 1 në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Tabela: Organika e ZVAP Tiranë, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
1	**Drejtor**	**III-2**	**1**	**1**
1.1	**Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve**		**10**	**9**
	Përgjegjës sektori	III-3	1	1
	specialist	IV-3	1	1
	Specialist jurist	IV-3	2	2
	Specialist inxhinier	IV-3	1	1
	Specialist i financës	IV-3	5	4
1.2	Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional		**11**	**10**
	Përgjegjës sektorit	III-3	1	1
	Specialist	IV-3	**10**	1
Punonjës gjithsej			**23**	**21**

Burimi: ZVAP Tiranë, punuar nga grupi i auditimi

2.3.1.4 Mbi strukturën organizative të ZVAP Kamëz

Për periudhën 01.01.2022 deri më 18.11.2024 struktura organizative e ZVAP Kamëz është përcaktuar në Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 11.

Ndërsa për periudhën 18.11.2024 e në vijim struktura është përcaktuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 10.

Mbi plotësimin e strukturës së burimeve njerëzore.

- Me urdhrin e datës 15.11.2021 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.S është emëruar në pozicionin Drejtor i ZVA Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 331, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 326, datë 02.11.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. K.V është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, e cila ka dhënë dorëheqjen më datë 21.03.2023.
- Me urdhrin nr. 296, datë 03.10.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. K.P është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 329, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 69, datë 13.10.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. S.A është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. - Me urdhrin nr. 368, datë 19.12.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z.Sh K është emëruar në pozicionin përgjegjës kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz.
- Me urdhrin nr. 381, datë 30.12.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. L.M është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 330, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 200, datë 15.01.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. D.Sh është emëruar në pozicionin specialist finance në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Për periudhën 17.01.2025 deri më 13.06.2025 është emëruar si specialiste kurrikule, emërim i përkohshëm.

Në vijim deri më datë 31.12.2025 (periudha objekt auditimi) ka rezultuar me emërim të përkohshëm si specialiste finance.

- Me urdhrin e datës 14.01.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. Xh.H është emëruar në pozicionin përgjegjës kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, pozicion nga i cili ka dhënë dorëheqjen në datë 01.11.2022.

- Me urdhrin nr. 94, datë 08.05.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. V.Gj është emëruar në pozicionin përgjegjës kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 336, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 115, datë 12.06.2023 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. K.Sh është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 337, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin e datës 21.01.2014 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.Xh është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, pozicion nga i cili ka dhënë dorëheqjen në datë 21.01.2014.
- Me urdhrin e datës 23.08.2022 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. Xh.J është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, pozicion nga i cili ka dhënë dorëheqjen në datën 14.09.2023.
- Me urdhrin e datës 03.12.2014 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. M.D është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, dal në pension në datë 21.08.2023.
- Me urdhrin e datës 05.03.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. A.A është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, dal në pension në datë 21.08.2023.
- Me urdhrin nr. 230, datë 20.12.2023 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. N.Sh është emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 338, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 95, datë 08.05.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” z. H.Dështë emëruar në pozicionin specialist kurrikule në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 335, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin e datës 01.01.2011 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. V.D është emëruar në pozicionin përgjegjëse e sektorit të shërbimeve në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 332, datë 23.12.2024 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin e datës 19.09.2019 “Për emërim të përkohshëm në detyrë” znj. E.J është emëruar në pozicionin specialiste finance në Zyrën Vendore Arsimore Kamëz, pozicion nga i cili ka dhënë dorëheqjen në datë 21.03.2025.

Për vitin 2022 nuk ka pasur vende vakante në ZVAP Kamëz.

Për vitin 2023 ka rezultuar 1 vend vakant për pozicionin e specialistit në Sektorin e Kualifikimit dhe Cilësisë.

Për vitin 2024 dhe për vitin 2025 nuk ka pasur vende vakante në strukturë.

Tabela: Organika e ZVAP Kamëz, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
1	**Drejtor**	**III-2**	**1**	**1**
1.1	**Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve**		**3**	**3**
	Përgjegjës sektori	III-3	1	1
	Specialist jurist	IV-3	1	1
	Specialist i financës	IV-3	1	1
1.2	**Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional**		**6**	**6**
	Përgjegjës sektorit	III-3	1	1

	Specialist	IV-3	5	5
Punonjës gjithsej			**11**	**11**

Burimi: ZVAP Kamëz, punuar nga grupi i auditimi

2.3.1.5 Mbi strukturën organizative të ZVAP Vorë

Për periudhën 01.01.2022 deri më 18.11.2024 struktura organizative e ZVAP Vorë është përcaktuar në Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Ndërsa për periudhën 18.11.2024 e në vijim struktura është përcaktuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Në strukturën e re është shkurtuar pozicioni i përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.

Mbi plotësimin e strukturës së burimeve njerëzore

- Me urdhrin nr. 232, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. M.L është emëruar në pozicionin Drejtor në Zyrën Vendore Arsimore Vorë. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 339, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 268, datë 08.09.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. S.B është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Sipas kontratës nr. 1637/2 prot., datë 15.07.2020 lidhur nga DRAP, neni 4 "Kohëzgjatja e kontratës" citon: Kjo kontratë pune hyn në fuqi nga data 15.07.2020, me kohëzgjatje deri në 30.09.2020 në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, duke i dhënë në këtë mënyrë efekt prapaveprues Urdhrit nr. 268, datë 08.09.2020 ose duke mos krijuar përputhshmëri midis periudhës së kontratës dhe Urdhrit të emërimit. Znj. S B ka dhënë dorëheqjen më datë 29.11.2022.
- Me urdhrin nr. 15, datë 20.01.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. O.T është emëruar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, deri në datën 30.04.2022. Në vijim me Urdhrin nr. 184, datë 27.05.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" ka vijuar në pozicionin specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 342, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 234, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. E.D është emëruar në pozicionin specialist jurist në Sektorin e Shërbimeve. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 340, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.
- Me urdhrin nr. 236, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. E.P është emëruar në pozicionin Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 343, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, dhe deri në përfundim të auditimit në terren nuk janë zhvilluar procedura konkurrimi.
- Me urdhrin nr. 233, datë 15.05.2019 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. H.H është emëruar në pozicionin Specialist Finance. Në vijim të ristrukturimit, me urdhrin nr. 341, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në të njëjtën pozicion deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

Tabela: Organika e ZVAP Vorë, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
1	**Drejtor**	**III-2**	**1**	**1**
1.1	**Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve**		**2**	**2**
	Specialist jurist	IV-3	1	1
	Specialist i financës	IV-3	1	1
1.2	**Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional**		**2**	**2**
	Specialist	IV-3	2	2
Punonjës gjithsej			**5**	**5**

Burimi: ZVAP Vorë, punuar nga grupi i auditimi

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk ka pasur vende vakante në ZVAP Vorë.

2.3.1.6 Mbi strukturën organizative të ZVAP Kavajë

Për periudhën 01.01.2022 deri më 18.11.2024 struktura organizative e ZVAP Kavajë është përcaktuar në Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Ndërsa për periudhën 18.11.2024 e në vijim struktura është përcaktuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Në strukturën e re është shkurtuar pozicioni i përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.

- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 471, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë znj. M.C, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Konstatohet se znj. M. C vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit 2006, konkretisht me Urdhrin nr. 24, datë 13.01.2006.
- Me Urdhrin nr. 144, datë 19.07.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. R.I është emëruar Specialist Finance i Sektorit të Shërbimeve dhe të Financës, pozicioni i të cilit është suprimuar nga Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 144, datë 01.08.2024.
- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 470, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë znj. L.P, në pozicionin Specialist i Sektorit të Monitorimit. Konstatohet se znj. L P vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit 2004, konkretisht me Urdhrin nr. 5, datë 16.07.2004.
- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 472, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë znj. B.M, në pozicionin Specialist i Financës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Konstatohet se znj. B.M vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit 2021, konkretisht me Urdhrin nr. 224, datë 09.11.2021.
- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 473, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë znj. K.Gj, në pozicionin Specialist Jurist i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Konstatohet se znj. K.Gj vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit 2020, konkretisht me Urdhrin nr. 364, datë 12.11.2020.
- Me Urdhrin nr. 197, datë 09.06.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. R.X është komanduar Drejtor i ZVAP, deri në janar 2024, ku me Vendimin nr. 7, datë 18.01.2024 i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkelje të rënda disiplinore.
- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 468, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë z. E B, në pozicionin Drejtor

i ZVAP. Konstatohet se z. E.B vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit mars 2024, konkretisht me Urdhrin nr. 51, datë 11.03.2024.

- Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 468, datë 23.12.2024 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka vijuar emërimin e përkohshëm në detyrë znj. E.M, në pozicionin Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional. Konstatohet se znj. E.M vijon me emërim të përkohshëm në detyrë që prej vitit 2011, konkretisht me Urdhrin nr. 163, datë 26.08.2011.

Tabela: Organika e ZVAP Kavajë, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
1	**Drejtor**	**III-2**	**1**	**1**
1.1	**Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve**		**2**	**2**
	Specialist jurist	IV-3	1	1
	Specialist i financës	IV-3	1	1
1.2	**Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional**		**2**	**2**
	Specialist	IV-3	2	2
Punonjës gjithsej			**5**	**5**

Burimi: ZVAP Kavajë, punuar nga grupi i auditimi

2.3.1.7 Mbi strukturën organizative të ZVAP Rrogozhinë

Për periudhën 01.01.2022 deri më 18.11.2024 struktura organizative e ZVAP Rrogozhinë është përcaktuar në Urdhrin nr. 234, datë 19.04.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Ndërsa për periudhën 18.11.2024 e në vijim struktura është përcaktuar në urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 571, datë 18.11.2024 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar",* ku numri total i punonjësve është përcaktuar 5. Në strukturën e re është shkurtuar pozicioni i përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.

Mbi plotësimin e strukturës së burimeve njerëzore

- Me urdhrin nr. 61, datë 23.03.2023 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. E.K është emëruar në pozicionin jurist në Sektorin e Shërbimeve. Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 346, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në pozicionin specialist jurist i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
- znj. G.B ka vijuar me emërim të përkohshëm që nga viti 2020, konkretisht emëruar me Urdhrin nr. 290, datë 17.09.2020. Në vijim të ristrukturimit, ka vijuar emërimin e përkohshëm në këtë pozicion me urdhrin nr. 347, datë 23.12.2024.
- Me urdhrin nr. 67, datë 15.04.2023 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. A.H, është emëruar Drejtor i ZVAP Rrogozhinë. Në vijim të ristrukturimit, ka vijuar emërimin e përkohshëm në këtë pozicion me Urdhrin nr. 348, datë 23.12.2024.
- Me urdhrin nr. 162, datë 10.09.2021 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. D.T është emëruar në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit dhe Zhvillimit Profesional. Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 345, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar në pozicionin specialist i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
- Me urdhrin nr. 154, datë 22.04.2022 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" z. A.S është emëruar në pozicionin specialist finance, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, i cili ka zëvendësuar z. T.D pas dhënies së dorëheqjes. Në vijim të ristrukturimit, me Urdhrin nr. 344, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar po në pozicionin specialist finance.

Tabela: Organika e ZVAP Rrogozhinë, në fund të vitit 2025

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Plan	Fakt
1	**Drejtor**	**III-2**	**1**	**1**
1.1	**Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve**		**2**	**2**
	Specialist jurist	IV-3	1	1
	Specialist i financës	IV-3	1	1
1.2	**Sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional**		**2**	**2**
	Specialist	IV-3	2	2
Punonjës gjithsej			**5**	**5**

Burimi: ZVAP Rrogozhinë, punuar nga grupi i auditimi

Në vitin 2022 ka qenë vakant pozicioni jurist. Në vitin 2023 ka qenë vakant pozicioni specialist kurrikule. Në vitin 2024 ka qenë vakant pozicioni specialist kurrikule. Në vitin 2025 nuk ka pasur vende vakante.

Nga auditimi konstatohet se pavarësisht se **të gjithë urdhrat e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar për emërimin e punonjëseve të DRAP Tiranë, Drap Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Vorë, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë kanë qenë të përkohshëm deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, deri në fund të 2025 nuk ka filluar asnjë procedurë konkurrimi.**

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 13 të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *"Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", të ndryshuar ku citohet se: *"Pranimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara me urdhër të ministrit*"; pikën 14, ku citohet: "*Drejtuesit e zyrave vendore, si dhe nëpunësit/punonjësit e drejtorive rajonale e të zyrave vendore emërohen dhe lirohen nga Drejtori i Përgjithshëm*"; nenin 4, pika 2 të Rregullores nr. 454, datë 13.09.2019 *"Për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj",* ku citohet se: "*Pranimi dhe lirimi nga detyra e punonjësve bëhet përmes konkurrimit të hapur dhe mbështete pa u kufizuar në parimet e mëposhtme: a) parimin e shanseve të barabarta, b) parimin e mosdiskriminimit, c) parimin e meritës, d) parimin e profesionalizimit, dh) parimin e paanësisë politike*" si dhe nenin 5 *"Planifikimi i nevojave",* , nenin 6 *"Shpallja e konkurrimit"*, nenin 7 *"Procedura e konkurrimit".*

Gjithashtu, konstatohet se edhe punonjësit e ZVAP-ve, të cilët kanë punuar në të njëjtin pozicion pune dhe në të njëjtin institucion me statusin e nëpunësit civil, por pas ndryshimeve të bëra me VKM nr. 99, datë 27.02.2019, *"Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar",* i ndryshuar, kanë humbur statusin e nëpunësit civil, vazhdojnë të jenë të emëruar me akte provizore deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, megjithëse kanë kaluar mbi 7 vite nga heqja e statusit të nëpunësit civil.

2.3.2 Mbi ristrukturimin e punonjësve

Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (i firmosur nga zëvendësministri) i ka dhënë të drejtën Drejtorit të DRAP, të emërojë mësues, punonjës të institucioneve në varësi të ministrisë përgjegjës për arsimin, në rastet kur këto institucione preken nga ristrukturimet. Konkretisht, pika 4, Kreu VII *"Dispozitat kalimtare dhe të fundit",* i udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i ndryshuar, citon se: "*Drejtorët e DRAP punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, të fushës arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast ristrukturimi, që kanë të paktën 3 vite pune në këto pozicione. Punësimi si mësues bëhet në një institucion arsimor parauniversitar brenda ZVAP-it ku ata kanë*

paraqitur kërkesë".
Pika 4 e udhëzimit bie në kundërshtim me nenin 60 *"Pranimi, pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit",* të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ku citohet se: "*Në institucionin arsimor publik, përfshirë edhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor sipas renditjes në portalin "Mësues për Shqipërinë", përveç mësuesit në dispozicion, i cili emërohet nga titullari i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, sipas renditjes në porta".*
Sa më sipër Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i ka dhënë kompetencë Drejtori të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të emërojë mësues, **pa procedurë konkurrimi, duke shmangur procedurat dhe portalin "Mësues për Shqipërinë".**

2.3.2.1 Mbi emërimin mësues të punonjësve të prekur nga ristrukturimi në ZVAP Tiranë

Me shkresën nr. 4106, datë 30.12.2024, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë të zbatojë pikën 4, Kreu 7 të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, duke marrë masa për sistemimin e punonjësve të cilët largohen nga puna si punonjës të ZVAP, për shkak të ristrukturimit të institucionit, konkretisht për: znj. A.K, znj. G K/K, punonjës të ZVAP Tiranë si dhe z. D.Sh, punonjës i ZVAP Kamëz.
- Nga auditimi rezulton se znj. A.K ka paraqitur kërkesën nr. 15, datë 08.01.2025 për t'u punësuar mësues në profilin histori pranë shkollës *"Koreografike".* Znj K është pajisur me licencën nr. 2...., datë 06.02.2020 për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin histori. Prej datës 17.04.2023 ka punuar specialiste, me kontratë të përkohshme deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, në Sektorin Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë.
DRAP Tiranë ka nxjerrë vendimin nr. 1, datë 08.01.2025 për emërimin definitiv të mësuesit A.K, në shkollën *"Koreografike",* Tiranë, në profilin Histori.
Konstatohet se znj. A.K nuk plotëson kriterin e punësimit prej minimumi 3 vite në të njëjtin pozicion, pasi në momentin që ka dal vendimi nr. 1, datë 08.01.2025, ka qenë e punësuar në pozicionin e specialistes për një periudhë kohore prej 1 viti e 8 muaj.
Sa më sipër punësimi i mësueses A. K., pranë shkollës *"Koreografike",* është bërë në kundërshtim me pikën 4 të udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i ndryshuar, ku citohet se: *"Drejtorët e DRAP punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, të fushës arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast ristrukturimi, që kanë të paktën 3 vite pune në këto pozicione".*
- Nga auditimi rezulton se znj. G K më datën 04.04.2025 ka paraqitur kërkesën për tu punësuar mësuese në profilin matematikë pranë shkollës *"Ali Demi".* Znj K është pajisur me licencën nr. 2. për ushtrimin e profesionit të mësuesit në profilin matematikë. Prej datës 14.04.2023 ka punuar specialiste, me kontratë të përkohshme deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, në Sektorin Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVA Tiranë, ndërsa gjatë periudhës 01.06.2024 - 06.04.2025 ka qenë me leje lindje.
DRAP Tiranë ka nxjerrë vendimin nr. 10, datë 07.04.2025, për emërimin definitiv të mësuesit G.K, në shkollën 9 vjeçare *"Ali Demi",* Tiranë, në profilin matematikë.
Konstatohet se znj. G.K nuk plotëson kriterin e punësimit prej minimumi 3 vite në të njëjtin

pozicion, pasi në momentin që ka dal vendimi nr. 10, datë 07.04.2025, përfshirë edhe periudhën e lejes së lindjes, ka qenë e punësuar në pozicionin e specialistes për një periudhë kohore prej rreth 2 vitesh.
Sa më sipër punësimi i mësueses G.K, pranë shkollës 9 vjeçare *"Ali Demi",* është bërë në kundërshtim me pikën 4 të udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i ndryshuar, ku citohet se: *"Drejtorët e DRAP punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, të fushës arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast ristrukturimi, që kanë të paktën 3 vite pune në këto pozicione".*

Nga DRAP Tiranë, konkretisht nga znj. B.S, është dërguar observacion nr. 1222 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/12 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:
Pretendimi i subjektit: Lidhur me konstatimin "Mbi emërimin e punonjësve të prekur nga ristrukturimi" sqarojmë se procedura është iniciuar mbi bazën e shkresës nr. 4106, datë 30.12.2024, të AKAP, në një periudhë tranzitore, kur institucioni i DRAP Tiranë nuk kishte filluar ende funksionimin e plotë administrativ dhe organizativ. Referuar dokumentacionit administrativ, emërimet e punonjësve në DRAP Tiranë janë kryer nga AKAP në datën 01.01.2025. Për rrjedhojë, në momentin e nxjerrjes së shkresës së sipërcituar, DRAP Tiranë, nuk kishte nisur ende funksionimin efektiv institucional si strukturë e ngritur rishtazi. Në këto kushte, gjatë trajtimit të rasteve konkrete është mbajtur në konsideratë fakti që punonjëset objekt konstatimi dispononin arsimin përkatës, licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit, si dhe plotësonin kriteret profesionale për ushtrimin e funksionit të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar. Gjithashtu, theksojmë se bëhet fjalë vetëm për 2 raste konkrete, trajtuar në kushtet e nevojës dhe situatës tranzitore të krijuar si pasojë e ristrukturimit institucional.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga analiza e argumenteve të paraqitura rezulton se observacionet kanë karakter kryesisht sqarues mbi rrethanat dhe kushtet në të cilat janë ndërmarrë veprimet administrative gjatë periudhës tranzitore të krijuar si pasojë e ristrukturimit institucional. Sqarimet e dhëna evidentojnë faktorët organizativë dhe funksionalë që kanë shoqëruar fillimin e aktivitetit të DRAP Tiranë, por nuk kundërshtojnë në thelb konstatimet dhe gjetjet e grupit të auditimit lidhur me respektimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe procedurave administrative në fuqi. Njëkohësisht, grupi i auditimit vlerëson gatishmërinë e institucionit për të adresuar problematikat e evidentuara, si dhe angazhimin e shprehur për marrjen e masave administrative dhe organizative në vijim, në përputhje me rekomandimet që do të përcaktohen në Raportin Përfundimtar të KLSH. Në këto kushte, observacioni merret në konsideratë si sqarim i rrethanave faktike të trajtuara, por nuk ndryshon përmbajtjen e gjetjes së auditimit.

2.3.2.1 Mbi emërimin mësues të punonjësve të prekur nga ristrukturimi në ZVAP Kavajë
Me Urdhrin nr. 351, datë 03.11.2020 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" znj. E.T është emëruar Specialiste në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.
Nga auditimi konstatohet se në vijim ristrukturimi i fundit i kryer në ZVAP Kavajë është bërë me Urdhrin e Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar, efektet e të cilit sipas pikës 7 të këtij urdhri fillojnë nga data 01.10.2024.
Ndërkohë për znj. E.T, vendimi për emërimin në detyrë është bërë nga DRAP Tiranë me shkresën nr. 3, datë 22.01.2025. Sipas këtij vendimi znj. E.T është emëruar Koordinator i Këshillimit të

Karrierës dhe plotësimin me orë sipas profilit, deri në përfundim të vitit shkollor 2024-2025, ku do të kalojë si mësuese definitve në shkollat "Fiqiri Keta" dhe "Rilindja" në profilin Gjuhë e Huaj "Anglisht".
Me shkresën nr. 115 prot., datë 24.01.2025 nga ZVAP Kavajë është përcjellë informacioni për zbatim shkollës 9 vjeçare "Qamil Xhani" dhe shkollës 9 vjeçare "Cete", ku znj. E.T është caktuar për të kryer 6 orët mësimore të profilit të gjuhës Angleze, ku paralelisht do të mbuloj edhe pozicionin e Koordinatorit të Karrierës.
Me shkresën nr. 646 prot., datë 04.08.2025 është lidhur kontrata pa afat me shkollën 9 vjeçare "Fiqiri Kurti".
Konstatohet se znj. E.T plotëson kriterin e punësimit prej minimumi 3 vite në të njëjtin pozicion, pasi në momentin që ka dal vendimi ka qenë e punësuar në pozicionin e specialistes për një periudhë kohore për më shumë se 3 vite, në përputhje me pikën 4 të udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* i ndryshuar, ku citohet se: *"Drejtorët e DRAP punësojnë si mësues në sistemin arsimor parauniversitar punonjësit e institucioneve në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, të fushës arsimit parauniversitar, të cilët plotësojnë kriteret për të ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit, në rast ristrukturimi, që kanë të paktën 3 vite pune në këto pozicione".*

2.3.3 Mbi vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna

2.3.3.1 Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore të kryera nga ZVAP Tiranë për punonjësit e larguar nga puna

Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nga ZVAP Tiranë, janë kryer likuidime për vendime gjyqësore të formës së prerë për **8 raste, gjithsej në vlerën 6,379,851 lekë**, duke sjellë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.
Nga këto:
- 4 raste në vlerën 5,390,144 lekë është për largim të padrejtë nga puna;
- 1 rast në vlerën 665,590 lekë për diskriminim të fëmije në kopsht;
- 1 rast në vlerën 106,800 lekë për mbrojtjen e të dhënave;
- 1 rast në vlerën 115,200 lekë për njohjen e pavërtetësisë së numrit të amzës;
- 1 rast në vlerën 102,117 lekë për detyrimin e pagesës së celularit

Nga auditimi konstatohet se për katër rastet nuk është bërë ekzekutim vullnetar i vendimeve gjyqësore, por është kontraktuar përmbarues privat. Nga vlera 6,379,851 lekë, 415,513 lekë është pagesë për përmbaruesin privat, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 60 ku citohet se: *Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.*

Gjithashtu konstatohet së ZVAP Tiranë është në disa procese gjyqësore për largime nga puna, të cilat priten të shoqërohen me efekte negative financiare në buxhetin e shtetit. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar ecurinë e proceseve gjyqësorë.

Tabela: Procese gjyqësore ZVAP Tiranë

Paditës	I paditur / Person i tretë	Objekti i çështjes	Dëmi i shkaktuar në lekë	Dëmi i parandalu ar në lekë	Informacioni i Shkurtuar
R Sh	ZVAT, AKAP, A B	Dëmshpërblim page			Në gjykim
XhK	16 Shtatori, DRAP	Vërtetim Fakti			Në gjykim
E B	Drap Tr, ZVAP Tr	Dëmshpërblim page	9 paga		Dhënë vendimi
D L	Abdulla Keta, ZVAT	Kundërshtim vendimi	15 paga + shpenzime gjyqësore		Dhënë vendimi
FS	Asim Vokshi	Konstatimin e pasaktësisë së dokumentacionit			
M Sh	Sami Frashëri	Korigjim I gjeneraliteteve			
F Sh	M. Sh, Mas	Njohje pavërtetësie			
AM	ZVAP Tiranë	Pavërtetësi akti			
LGj	Ymer Lala	Dëmshpërblim page	19.5 paga mujore		Ankimuar
K B	ZVAT, Drap Dr	Shfuqizim akti administrativ	17 paga mujore		Ankimuar
KB	ZVAP Tiranë	Pagesë vjetërsie	14 paga mujore		Ankimuar
SV	ZVAT, Sami Frashëri	Vërtetim fakti		28 paga	Ankimuar nga pala paditëse
M D	ZVAP Tiranë, O M	Shpërblim page		21 paga	Ankimuar nga pala paditëse
A P	Qemal Stafa, Drejtoria e Arkivave	Pavërtetësi dokumenti			
R K	MA, ZVAP, Pjeter Budi	Detyrim page			
L Xh	Ministria e Arsimit	Shfuqizim akti administrativ			
M N	Zva Kamëz Drap Dr. Drap Tr, Zva Tr	Dëmshpërblim page			
SM	Zva. DPA	Saktesim i gabimeve Materiale			
T N	ZVAT	Detyrim Dëmshpërblimi		20 paga	Fituar
L. K	Kongresi Lushnjes, ZVAT	Shfuqizimi i vendimit nr.36, dt 06.12.23 për pezullimin			
E.. H, 26 Nëntori	26 Nëntori	Pavlefshmëri Akti			Në gjykim
MXh	Zva Tirane, M.K	Pagesë Dëmshpërblimi			
L M	A G	Dëmshpërblim			Në gjykim

Burimi: ZVAP Tiranë

2.3.3.2 Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore të kryera nga ZVAP Kamëz për punonjësit e larguar nga puna

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga ZVAP Kamzë, është kryer 1 likuidim për vendim gjyqësore të formës së prerë për **largim të padrejtë nga puna, gjithsej në vlerën 842,226 lekë,** duke sjellë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi konstatohet se nuk është bërë ekzekutim vullnetar i vendimit gjyqësor, por është kontraktuar përmbarues privat, i cili është paguar në vlerën 52,146 lekë, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 60 ku citohet se: *Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.*

2.3.3.3 Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore të kryera nga ZVAP Rrogozhinë për punonjësit e larguar nga puna

Nga u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nga ZVAP Rrogozhinë, është kryer 1 likuidim për vendim gjyqësore të formës së prerë, për largim të padrejtë nga puna, gjithsej në vlerën 1,671,754 lekë, duke sjellë efekt financiar negativ në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi konstatohet se nuk është bërë ekzekutim vullnetar i vendimit gjyqësor, por është kontraktuar përmbarues privat, i cili është paguar në vlerën 85,321 lekë, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 60 ku citohet se: *Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullarit.*

2.3.4 Mbi nëpunësi zbatues të DRAP Tiranë

Me shkresën nr. 22, datë 09.01.2025, është njoftuar Dega e Thesarit Tiranë se për DRAP Tiranë:
- znj. B.S do të jetë Nëpunës Autorizues;
- z. K.F do të jetë Nëpunës Zbatues i përkohshëm.

Nga auditimi konstatohet se z. K.F nuk është punonjës i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, por punonjës i Zyrës Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë (institucion në varësi të DRAP Tiranë). Gjithashtu rezulton se z. K.F është njëkohësisht Nëpunës Zbatues për të dy institucionet.

Emërimi i z. K.F si Nëpunës Zbatues për DRAP Tiranën është në kundërshtim me nenin 12 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues"* të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, ku citohet se*: "Nëpunës zbatues i njësisë publike është* ***drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat të njësisë publike, në varësi direkte nga nëpunësi autorizues i njësisë*** *dhe që ka përfunduar studimet e ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion. Nëpunësi zbatues emërohet në njësi, sipas kuadrit ligjor në fuqi, duke respektuar plotësimin e kërkesave të kësaj pike".*

Referuar, nenit 12, pika 2, gërma a) dhe pika 3, gërma b), të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, nëpunësi zbatues është përgjegjës për bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit si dhe përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit. Ndërkohë në rregulloren *"Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar"* në pikën 1, neni 22 (ku përcaktohet detyrat kryesore të Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financave, në DRAP), citohet se *"Harton projektbuxhetin e DRAP dhe ZVA dhe raporton në MAS",* ndërsa në pika 1, neni 32 (ku përcaktohen detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në ZVAP), citohet se: *"Harton projektbuxhetin e ZVAP dhe ja propozon DRAP"*.

Sa më sipër rezulton se Zyra Vendore Rajonale harton projektbuxhetin dhe ja propozon atë DRAP, i cili harton më pas projektbuxhetin e DRAP dhe projektbuxhetin e ZVAP. Caktimi i të njëjtit nëpunës zbatues për të dy njësitë (DRAP Tiranë dhe ZVAP Tiranë), cënon parimin e ndarjes së detyrave dhe i jep të drejtën nëpunësit zbatues të propozojë dhe më pas të miratojë propozimin e bërë prej tij. Ky vendim ka krijuar një mbivendosje funksionesh që dobëson sistemin e kontrollit të brendshëm.

Nga DRAP Tiranë, konkretisht nga znj. B.S, është dërguar observacion nr. 1222 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/12 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:

Pretendimi i subjektit: .. Lidhur me gjetjen nr. 3, mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues, sqarojmë se ky caktim është realizuar në rrethana të veçanta organizative, gjatë fazës së krijimit dhe fillimit të funksionimit të DRAP Tiranë, në kushtet kur institucioni ishte në procesin e ngritjes dhe konsolidimit të strukturës organizative dhe administrative. DRAP Tiranë ka filluar funksionimin efektiv në datën 01.01.2025, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 144, datë 01.08.2024. Punonjësit e institucionit janë emëruar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitare, ndërkohë që në momentin e fillimit të veprimtarisë, struktura organizative nuk ishte plotësuar në të gjitha pozicionet e miratuara dhe nuk dispononte burimet njerëzore të nevojshme për ushtrimin e të gjitha funksioneve administrative dhe financiare të parashikuara.

Ky caktim është kryer me dijeni dhe miratim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe nga Ministria e Financave, në funksion të garantimit të vijimësisë së proceseve administrative dhe financiare të Institucionit.

DRAP Tiranë dhe ZVAP Tiranë janë institucione të veçanta, me personalitet juridik, buxhete të miratuara dhe përgjegjësi të pavarura në administrimin e fondeve publike. Secili institucion administron në mënyrë të pavarur fondet buxhetore që i janë akorduar, mban përgjegjësi për realizimin e buxhetit të tij dhe raporton në mënyrë të veçantë pranë Ministrisë së Arsimit për monitorimin financiar, realizimin e treguesve buxhetorë dhe hartimin e pasqyrave financiare vjetore. Në këto kushte vlerësojmë se nuk ekziston konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të përkohshëm të funksionit të Nëpunësit Zbatues nga z. K.F. Ndërkohë DRAP Tiranë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit me kërkesë për rishikimin dhe plotësimin e strukturës organizative, me qëllim përcaktimin e qartë të funksioneve administrative dhe financiare, si dhe plotësimin e pozicioneve organike të nevojshme për ushtrimin e kompetencave të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithatë DRAP Tiranë do të marrë të gjitha masat e nevojshme administrative dhe organizative, me qëllim që funksioni i Nëpunësit Zbatues të ushtrohet nga një punonjës organik i institucionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe rekomandimet përkatëse të KLSH.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga analiza e argumenteve të paraqitura rezulton se observacionet kanë karakter kryesisht sqarues mbi rrethanat dhe kushtet në të cilat janë ndërmarrë veprimet administrative gjatë periudhës tranzitore të krijuar si pasojë e ristrukturimit institucional. Emërimi i nëpunësit zbatues të ZVAP Tiranës edhe si nëpunës zbatues i DRAP Tiranës, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, pasi z. K nuk është punonjës i DRAP Tiranës si dhe nuk ka varësi direkte nga nëpunësi autorizues i DRAP Tiranës. Pavarësisht se në shkresë është cituar se ky emërim do të jetë i përkohshëm, ka kaluar mbi 1 vit dhe situata vazhdon të jetë e njëjtë.

2.3.5 Mbi drejtorët e komanduar të IPAP-ve

Në fund të vitit 2023, DRAP Durrës ka pasur nën juridiksion 383 shkolla, nga të cilat deri 192 prej tyre ose 50% janë drejtuar nga drejtues të komanduar, për të cilët nuk janë zhvilluar procedurat e konkurrimi.

Tabela: Drejtues të IPAP-ve, të komanduar, 2023

ZVAP	Numri i drejtuesve të komanduar të IPAP
Bulqize	13
Dibër	32
Durrës	17
Kamez	8
Kavajë	12
Kruje	19
Mat	11
Rrogozhinë	9
Shijak	2
Tirane	60
Vorë	1
Total	**192**

Burimi: DRAP Durrës, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2022 Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerrë 4 shpallje për fillimin e procedurave të konkurrimit për drejtues në institucionet arsimore publike, konkretisht:

- Me shkresën nr. 409 prot., datë 17.02.2022 ka hapur procedurën e konkurrimit për drejtuesin e IPAP-së nën juridiksionin e ZVAP Tiranë "Ramazan Kabashi".
- Me shkresën nr. 699 prot., datë 18.03.2022, ka hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtuesit të 38 IPAP nga të cilat: 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Kamëz; 2 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Vorë; 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Kavajë; 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Bulqizë; 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Krujë; 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Durrës; 7 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Tiranë; 1 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë; 2 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Klos; 6 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Dibër.

- Me shkresën nr. 2002 prot., datë 23.08.2022 ka hapur procedurat e konkurrimit për pozicionit të drejtuesit për 2 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Vorë.
- Me shkresën nr. 2232 prot., datë 20.09.2022, ka hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtuesit të 8 IPAP nga të cilat: 1 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Vorë; 4 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë; 2 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Durrës; 1 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Krujë.

Për vitin 2023 DRAP Durrës nuk ka hapur procedura konkurrimi për pozicionet drejtuese të IPAP-vë.

Për vitin 2024 DRAP Durrës, me shkresën nr. 46/1, datë 08.01.2024 ka hapur procedurat e konkurrimit për drejtues në 73 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat: 2 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Bulqizë; 3 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Dibër; 8 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Durrës; 5 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Kamëz; 6 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Kavajë; 1 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Klos; 6 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Krujë; 3 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Mat; 1 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Rrogozhinë; 2 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Shijak; 1 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Vorë; 1 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Dibër; 34 IPAP nën juridiksioni e ZVAP Tiranë.

Për vitin 2025 DRAP Tiranë ka filluar procedurat e konkurrimit për pozicionet e drejtuesve të institucioneve arsimore si në vijim:
- Me shkresën nr. 6, datë 28.01.2025, ka filluar procedurat e konkurrimit për drejtuesin e IPAP “Kongresi i Lushnjës”.
- Me shkresën nr. 632/1, datë 19.05.2025 ka filluar procedurat e konkurrimit për drejtuesin e IPAP “Fushë-Prezë”, nën juridiksionin e ZVAP Vorë.
- Me shkresën nr. 1172, datë 10.11.2025 ka filluar procedurat e konkurrimit për drejtuesit e 10 IPAP nën juridiksionin e ZVAP Tiranë.

ZVAP Tiranë ka në juridiksion 161 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat 120 për arsimin bazë dhe 41 për arsimin e mesëm dhe të lartë.

ZVAP Kamëz ka në juridiksion 25 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat 20 për arsimin bazë dhe 5 për arsimin e mesëm dhe të lartë.

ZVAP Vorë ka në juridiksion 14 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat 11 për arsimin bazë dhe 3 për arsimin e mesëm dhe të lartë.

ZVAP Kavajë ka në juridiksion 18 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat 15 për arsimin bazë dhe 3 për arsimin e mesëm dhe të lartë.

ZVAP Rrogozhinë ka në juridiksion 10 institucione të arsimit parauniversitar nga të cilat 8 për arsimin bazë dhe 2 për arsimin e mesëm dhe të lartë.

Nga auditimi rezulton se në fund të vitit 2025, për 51 shkolla nën juridiksionin e DRAP Tiranë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtuesit të institucioneve arsimore. Për periudhën objekt auditimi këto pozicione janë mbuluar nga drejtor të komanduar, konkretisht për:
- 27 shkolla ose 17% e shkollave nën juridiksionin e ZVAP Tiranë, drejtohen nga drejtor të komanduar;
- 9 shkolla ose 36% e shkollave nën juridiksionin e ZVAP Kamëz, drejtohen nga drejtor të komanduar;
- 8 shkolla ose 44% e shkollave nën juridiksionin e ZVAP Kavajë, drejtohen nga drejtor të komanduar;
- 7 shkolla ose 70% e shkollave, nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë, drejtohen nga drejtor të komanduar.

Tabela në vijim paraqet shkollat të cilat drejtohen nga drejtues të komanduar si dhe datat e komandimit të tyre.

Tabela: Drejtor të komanduar ZVAP Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë

Nr.	ZVAP	IPAP	Lloji i IPAP	Emër Mbiemër	Data e komandimit	Certifikuar
1	Tiranë	7 Marsi	9 - vjeçare	A.H	06.02.2024	Po
2	Tiranë	Ahmet Boja	shkollë e bashkuar	R.M	10.03.2022	Jo
3	Tiranë	Ahmet Gashi	9 - vjeçare	J.Ç	15.01.2024	Po
4	Tiranë	Bedri Llagami	shkollë e bashkuar	E.T	16.10.2019	Po
5	Tiranë	Betim Muco	9 - vjeçare	F.Xh	15.01.2024	Po
6	Tiranë	Farke e Vogel	9 - vjeçare	A.D	01.09.2022	Po
7	Tiranë	Feti Fanaj	9 - vjeçare	S.K	16.03.2023	Po
8	Tiranë	Flamur Shkoza	9 - vjeçare	K.M	16.11.2022	Jo
9	Tiranë	Haxhi Korra	9 - vjeçare	B.K	01.09.2022	Po
10	Tiranë	Kocaj	9 - vjeçare	E.A	07.09.2023	Jo
11	Tiranë	Leke Gjiknuri	9 - vjeçare	Y.K	05.07.2023	Po
12	Tiranë	Lidhja E Prizrenit	9 - vjeçare	A.Gj	01.09.2023	Po
13	Tiranë	Marie Logoreci	9 - vjeçare	R.M	09.04.2014	Po
14	Tiranë	Mihal Duri	9 - vjeçare	M.N	17.02.2022	Po
15	Tiranë	Misto Mame	9 - vjeçare	A.T	12.09.2019	Po
16	Tiranë	Musine Kokalari	9 - vjeçare	T.H	25.09.2023	Jo
17	Tiranë	Mustafa Grebllleshi	9 - vjeçare	S.L	12.10.2022	Po
18	Tiranë	Mustafa Kemal Ataturku	shkollë e bashkuar	S.N	07.09.2023	Jo
19	Tiranë	Mustafa Qemal Ataturku	9 - vjeçare	G.H	01.09.2022	Po
20	Tiranë	Naim Frasheri	9 - vjeçare	A.P	26.09.2019	Po
21	Tiranë	Nene Tereza	9 - vjeçare	M.P	01.09.2022	Jo
22	Tiranë	Nexhmi Tafaj	9 - vjeçare	J.J	17.01.2022	Jo
23	Tiranë	Petro Nini Luarasi	gjimnaz	E.Sh	01.01.2025	Po
24	Tiranë	Sander Prosi	gjimnaz	J.B	21.01.2022	Jo
25	Tiranë	Servete Maci	9 - vjeçare	L.T	01.01.2025	Jo
26	Tiranë	Skender Caci	9 - vjeçare	A.K	26.08.2025	Po
27	Tiranë	Tufine	9 - vjeçare	A.M	28.07.2023	Po
28	Kamëz	Halit Coka, Bathore	9 - vjeçare	F.F	06.09.2023	Po
29	Kamëz	100 vjetori	9 – vjeçare	M.U	08.01.2024	Po
30	Kamëz	Demokracia, Valias	9 -vjeçare	D.S	08.12.2019	Jo, në proces
31	Kamëz	Dom Nikollë Kaçorri, Laknas	9- vjeçare	M.G	14.05.2024	Po
32	Kamëz	Kamëz e Re	9- vjeçare	L.A	04.09.2025	Po
33	Kamëz	Hillary Clinton	9- vjeçare	A.B	04.09.2025	Po
34	Kamëz	Ahmet Zogu, Bathore	9- vjeçare	S.S	04.08.2025	Po
35	Kamëz	Dom Nillolë Kaçorri, Paskuqan	9- vjeçare	A.S	11.04.2014	Jo
36	Kamëz	Angel Merkel	9- vjeçare	H.K	04.08.2025	Po
37	Kavajë	3 Dëshmorët	9- vjeçare	F.Xh	05.12.2016	Jo, në proces
38	Kavajë	“Herbert”	9- vjeçare	Xh.B	17.04.2025	Po
39	Kavajë	“Bago”	9- vjeçare	S.D	17.09.2019	Jo, aplikuar
40	Kavajë	“Shtodhër”	9- vjeçare	A.Sh	03.07.2024	Jo, në proces
41	Kavajë	“Qamil Xhani”	9- vjeçare	Sh.Ç	19.11.2024	Po
42	Kavajë	“28 Nëntori”	9- vjeçare	Z.M	29.01.2015	Jo, në proces
43	Kavajë	“Golem”	9- vjeçare	S.K	22.08.2025	Po
44	Kavajë	“Fiqiri Kurti”	9- vjeçare	O.Xh	20.09.2025	Jo, në proces
45	Rrogozhinë	Xhorxh Soros	9- vjeçare	D.S	25.10.2017	Jo
46	Rrogozhinë	Qamil Gjuzi	9- vjeçare	Y.H	18.07.2025	Jo
47	Rrogozhinë	Lekaj	9- vjeçare	K.J	03.09.2024	Jo
48	Rrogozhinë	Haki Skuqi	9- vjeçare	B.Q	10.04.2020	Po
49	Rrogozhinë	Zhabjak	9- vjeçare	Z.Z	06.01.2006	Jo
50	Rrogozhinë	Stërbeg	9- vjeçare	E.S	11.02.2025	Jo
51	Rrogozhinë	Spille	9- vjeçare	E.Dh	27.06.2024	Po

Burimi: ZVAP Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë punuar nga grupi i audimit të KLSH

Sa më sipër, mos hapja e procedurave të konkurrimit dhe mos shpallja e vendeve vakante bie në kundërshtim me Kreun I “Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar”, neni 1, pika 1, shkronja “a” e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institutit arsimor publik

parauniversitar" ku citohet: *"Zyra Vendore Parauniversitar (ZVAP), menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për drejtor të IPAP-së që ka në juridiksion, njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për vendin e lirë të punës dhe vë në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme t Arsimit Parauniversitar (DRAP)".*
Pika 1, shkronja "b" ku citohet se: *"DRAP shpall vendin e lirë të punës për Drejtor menjëherë nga njoftimi i ZVAP-së".*
Rezulton se 21 nga drejtoret e komanduar nuk plotësojnë kushtet për të qenë drejtorë të përcaktuara në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, pasi nuk janë të pajisur me certifikatën për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.
Gjithashtu rezulton se 2 drejtorët e komanduar z. S.D dhe znj. Sh.Ç nuk janë të pajisur me licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në kundërshtim me nenin 57, pika 5, gërma "b" të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.

Nga DRAP Tiranë, konkretisht nga znj. B.S, është dërguar observacion nr. 1222 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/12 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:
Pretendimi i subjektit: .. Lidhur me gjetjen nr. 4, gjatë vitit 2025 DRAP Tiranë ka filluar procesin e plotësimit të pozicioneve drejtuese në institucionet arsimore nëpërmjet procedurave konkurruese, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, transparencës, meritokracisë, barazisë së mundësive dhe konkurrimit të hapur, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Duke qenë se viti 2025 përkon me fillimin e funksionimit të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe me procesin e riorganizimit institucional të administrimit të arsimit parauniversitar, plotësimi i pozicioneve drejtuese është zhvilluar në mënyrë graduale, në përputhje me nevojat e sistemit, strukturën e miratuar dhe planifikimin administrativ të Ministrisë së Arsimit. Për sa më sipër vlerësojmë se DRAP Tiranë ka ndërmarrë dhe vijon të ndërmarrë të gjitha masat administrative të nevojshme për konsolidimin e strukturave drejtuese, në përputhje me kuadrin ligjor dhe kompetencat e institucionit.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga analiza e argumenteve të paraqitura rezulton se observacionet kanë karakter kryesisht sqarues mbi rrethanat dhe kushtet në të cilat janë ndërmarrë veprimet administrative gjatë periudhës tranzitore të krijuar si pasojë e ristrukturimit institucional. Sqarimet e dhëna evidentojnë faktorët organizativë dhe funksionalë që kanë shoqëruar fillimin e aktivitetit të DRAP Tiranë, por nuk kundërshtojnë në thelb konstatimet dhe gjetjet e grupit të auditimit lidhur me respektimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe procedurave administrative në fuqi. Njëkohësisht, grupi i auditimit vlerëson gatishmërinë e institucionit për të adresuar problematikat e evidentuara, si dhe angazhimin e shprehur për marrjen e masave administrative dhe organizative në vijim, në përputhje me rekomandimet që do të përcaktohen në Raportin Përfundimtar të KLSH. Në këto kushte, observacioni merret në konsideratë si sqarim i rrethanave faktike të trajtuara, por nuk ndryshon përmbajtjen e gjetjes së auditimit.

2.3.6 Mbi nëndrejtorët e komanduar të IPAP-ve

Nga auditimi rezulton se në fund të vitit 2025, 90 nëndrejtor shkollash janë komanduar, për të cilët nga ana e drejtuesve të shkollave dhe drejtuesve të ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit, konkretisht:
- 68 nëndrejtor të komanduar në shkollat të cilat janë në juridiksionin e ZVAP Tiranë;
- 16 nëndrejtor të komanduar në shkollat të cilat janë në juridiksionin e ZVAP Kamëz;
- 4 nëndrejtor të komanduar në shkollat të cilat janë në juridiksionin e Kavajë;
- 2 nëndrejtor të komanduar në shkollat të cilat janë në juridiksionin e Rrogozhinë.

Tabela në vijim paraqet nën drejtorët e komanduar sipas shkollave dhe datat e komandimit të tyre.

Tabela: Nëndrejtor të komanduar ZVAP Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë

Nr.	IPAP	ZVAP	Lloji i IPAP	Emër Mbiemër	Data e komandimit	Certifikuar
1	1 Maji	Tiranë	9 - vjeçare	B. C	10.9.2024	Jo
2	16 Shtatori	Tiranë	9- vjeçare	M. Xh	15.01.2025	Jo
3	17 Shkurti	Tiranë	9 - vjeçare	L. R	17.07.2023	Jo
4	28 Nëntori	Tiranë	9 - vjeçare	S.V	04.09.2023	Jo
5	28 Nëntori	Tiranë	9 - vjeçare	E.Sh	02.12.2024	Jo
6	7 Marsi	Tiranë	9 - vjeçare	R .K	09.04.2024	Jo
7	Ali Demi	Tiranë	9 - vjeçare	E .Q	21.10.2020	Jo
8	Ali Demi	Tiranë	9 - vjeçare	E.Sh	01.11.2022	Po
9	Andrea Stefani	Tiranë	9 - vjeçare	V.S	16.09.2022	Jo
10	Androkli Kostallari	Tiranë	9 -vjeçare	N.M	01.12.2022	Po
11	Ardian Klosi	Tiranë	9 - vjeçare	A.C	01.11.2022	Po
12	Asim Vokshi	Tiranë	Gjimnaz	M.R	21.02.2022	Po
13	Asim Vokshi	Tiranë	Gjimnaz	R..J	06.12.2021	Po
14	At Zef Pllumi	Tiranë	9 - vjeçare	E.E	01.09.2021	Po
15	Bashkim Fino	Tiranë	9 - vjeçare	A.H	14.09.2023	Po
16	Besnik Sykja	Tiranë	Gjimnaz	V.Gj	14.10.2020	Po
17	Besnik Sykja	Tiranë	Gjimnaz	E.T	23.09.2022	Po
18	Dhora Leka	Tiranë	9 - vjeçare	D.L	08.11.2017	Po
19	Dhora Leka	Tiranë	9 - vjeçare	L.H	15.09.2023	Po
20	Dora Distria	Tiranë	9 - vjeçare	V.D	17.03.2014	Po
21	Edith Durham	Tiranë	9 - vjeçare	N.V	01.09.2019	Jo
22	Emin Duraku	Tiranë	9 - vjeçare	M.B	23.11.2020	Po
23	Eqrem Çabej	Tiranë	Gjimnaz	A.L	16.01.2023	Po
24	Fan S Noli	Tiranë	9 - vjeçare	E.B	30.12.2024	Jo
25	Gjon Buzuku	Tiranë	9 - vjeçare	Z.H.	27.11.2020	Po
26	Gjon Buzuku	Tiranë	9 - vjeçare	A.B	17.09.2019	Po
27	Hasan Tahsin	Tiranë	9 - vjeçare	L.T	14.02.2023	Po
28	Hasan Vogli	Tiranë	9 - vjeçare	F.Sh	09.09.2022	Po
29	Isa Boletini	Tiranë	9 - vjeçare	R P	02.12.2022	Po
30	Isa Boletini	Tiranë	9 - vjeçare	E.M.	27.06.2023	Jo
31	Kasem Shima	Tiranë	9 - vjeçare	L. F	03.07.2023	Po
32	Klodian Tanushi	Tiranë	9 - vjeçare	K.F	24.12.2024	Jo
33	Kole Jakova	Tiranë	9 - vjeçare	M.R	03.10.2025	Jo
34	Konferenca e Pezës	Tiranë	9 - vjeçare	F.D	06.03.2023	Po
35	Kongresi Manastirit	Tiranë	9 - vjeçare	S.A	10.10.2022	Po
36	Kongresi Manastirit	Tiranë	9 - vjeçare	E.K	05.01.2023	Po
37	Kongresi i Lushnjës	Tiranë	9 - vjeçare	L.K	23.08.2021	Po
38	Kristo Frashëri	Tiranë	Gjimnaz	M.D	12.09.2022	Po
39	Luan Hajdaraga	Tiranë	Gjimnaz	M.T	07.11.2024	Po
40	Mihal Grameno	Tiranë	9 - vjeçare	S. R	28.08.2020	Po
41	Misto Mame	Tiranë	9 - vjeçare	A.M	21.10.2022	Po
42	Myslym Keta	Tiranë	Gjimnaz	E.G	24.05.2013	Po
43	Nene Tereza	Tiranë	9 - vjeçare	B.L	04.09.2023	Po
44	Niket Dardani	Tiranë	9 - vjeçare	J. P	14.02.2022	Po
45	Petro Nini Luarasi	Tiranë	Gjimnaz	E.B	18.01.2021	Jo
46	Qemal Stafa	Tiranë	Gjimnaz	M.M	07.09.2022	Po
47	Qemal Stafa	Tiranë	Gjimnaz	R.C	30.06.2021	Po
48	Qemal Stafa	Tiranë	Gjimnaz	N.I	04.09.2023	Po
49	Sami Frasheri	Tiranë	Gjimnaz	A.N	04.01.2017	Po
50	Sami Frasheri	Tiranë	Gjimnaz	L.H	10.01.2022	Po
51	Shyqyri Peza	Tiranë	9 - vjeçare	L.L	01.12.2021	Po
52	Sinan Tafaj	Tiranë	Gjimnaz	R.K	17.11.2015	Po
53	Vaçe Zela	Tiranë	9 - vjeçare	A S.	12.09.2022	Po
54	Ahmet Gashi	Tiranë	9 - vjeçare	Xh.M	08.11.2024	Jo
55	Andrea Stefani	Tiranë	9 - vjeçare	M.Sh	18.09.2025	Po
56	Androkli Kostallari	Tiranë	9- vjeçare	K.D	11.05.2018	Jo
57	Avni Rustemi	Tiranë	9- vjeçare	E. J	02.09.2024	Po
58	Betin Muço	Tiranë	9- vjeçare	S.L	22.09.2025	Jo
59	Drita Pelinku	Tiranë	9- vjeçare	G.M	25.08.2025	Po
60	Hasan Prishtina	Tiranë	9- vjeçare	L.M	27.02.2025	Po
61	Ibrahim Brahja	Tiranë	9- vjeçare	V.T	01.09.2022	Po
62	Konferenca e Pezës	Tiranë	9- vjeçare	A.P	19.09.2025	Po
63	Kushtrimi i Lirisë	Tiranë	9- vjeçare	E.M	16.01.2025	Jo
64	Mustafa Greblleshi	Tiranë	9- vjeçare	M.L	30.09.2022	Jo
65	Petro Nini Luarasi	Tiranë	gjimnaz	A.S	01.09.2022	Po
66	Pjetër Budi	Tiranë	9- vjeçare	E.K	08.01.2025	Po
67	Servete Maçi	Tiranë	9- vjeçare	A.M	16.01.2025	Jo
68	Servete Maçi	Tiranë	9- vjeçare	H.C	17.10.2025	Po
69	Arbëria	Kamëz	9- vjeçare	A.K	15.04.2024	Jo
70	Demokracia, Valias	Kamëz	9- vjeçare	N.S	20.09.2024	Jo, në proces
71	Jashar Hoxha, Paskuqan	Kamëz	9- vjeçare	L.D	19.12.2024	Po

72	Jashar Hoxha, Paskuqan	Kamëz	9- vjeçare	M.V	16.12.2024	Po
73	Hillary Clinton	Kamëz	9- vjeçare	A.Sh	24.09.2024	Jo, në proces
74	Fatos Lami, Zall-Mner	Kamëz	9- vjeçare	Zh..S	16.09.2024	Jo, në proces
75	Niko Hoxha, Valias	Kamëz	9- vjeçare	A.Xh	07.02.2023	Po
76	Ibrahim Basha, Bulçesh	Kamëz	9- vjeçare	E.H.	06.09.2023	Jo, në proces
77	Ahmet Zogu, Bathore	Kamëz	9- vjeçare	G.H.	13.03.2023	Jo, në proces
78	Vëllazërimi, Paskuqan	Kamëz	9- vjeçare	D.S	03.02.2025	Po
79	Vëllazërimi, Paskuqan	Kamëz	9- vjeçare	V.U	15.09.2025	Po
80	Isa Boletini, Paskuqan	Kamëz	gjimnaz	A.C	07.10.2023	Po
81	Elez Isuf Ndreu, Bathore	Kamëz	gjimnaz	R.M.	28.08.2025	Po
82	Angel Merkel	Kamëz	9- vjeçare	D.H	25.08.2025	Po
83	Angel Merkel	Kamëz	9- vjeçare	S.B	25.08.2025	Po
84	Angel Merkel	Kamëz	9- vjeçare	Dh.Sh	16.09.2025	Jo, në proces
85	Aleksandër Moisiu	Kavajë	gjimnaz	I.H	15.09.2017	Po
86	Mehemet Babmusta	Kavajë	9- vjeçare	N.S	06.02.2015	Po
87	Fiqiri Kurti	Kavajë	9- vjeçare	S.P	17.09.2018	Po
88	3 dëshmorët	Kavajë	9- vjeçare	D.T	16.12.2025	Jo, në proces
89	Haxhi Qehaj	Rrogozhinë	gjimnaz	L.Sh	23.04.2024	Po
90	Gosë	Rrogozhinë	e bashkuar	F.Th	15.11.2022	Po

Burimi: ZVAP Tiranë, Kamëz, Kavajë, Rrogozhinë punuar nga grupi i audimit të KLSH

Mos hapja e procedurave të konkurrimit dhe mos shpallja e vendeve vakante bie në kundërshtim me Kreun I "Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar", neni 1, pika 2, shkronja "a" dhe "b" e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: "Për shpalljen e vendit të lirë nëndrejtor në institucionet publike të arsimit parauniversitar (IPAP), ndiqet si më poshtë:

a) Drejtor i IPAP-së, menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për nëndrejtor, njofton zyrtarisht ZVAP-në për vendin e lirë të punës.

b) ZVAP-ja shpall vendin e lirë të punës për nëndrejtor menjëherë nga njoftimi i drejtorit të IPAP-së".

Gjithashtu nga auditimi rezulton se 32 nga nëndrejtoret e komanduar nuk plotësojnë kushtet për të qenë nëndrejtorë të përcaktuar në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, pasi nuk janë të pajisur me certifikatën për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.

2.3.7 Vendet vakante për nëndrejtor në ZVAP Tiranë

Në pikën II.3 dhe III.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 10.07.2023 *"Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesë mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"*, përcaktohet numri i nëndrejtorëve që duhet të ketë një shkollë në varësi të numrit total të nxënësve, konkretisht:

- Kur numri i nxënësve është 200-480, emërohet një nëndrejtor shkolle.
- Kur numri i nxënësve është 481-800, emërohen dy nëndrejtor shkolle.
- Kur numri i nxënësve është mbi 800, emërohen tre nëndrejtor shkolle.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme, grupi i auditimit mori në shqyrtim databazën e drejtuesve të shkollave në juridiksionin e ZVAP Tiranë, si dhe databazën e nxënësve për secilën shkollë.

Bazuar në numrin e nxënësve dhe në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin e sipërcituar, grupi i auditimit analizoi numrin e nëndrejtorëve që secila shkollë duhej të kishte dhe e krahasoi atë me numrin faktik të nëndrejtorëve në detyrë, duke evidentuar diferencat përkatëse si në tabelën në vijim:

Tabela: Vende vakante për pozicionin e nëndrejtorit

Emri i shkollës	Numri i nëndrejtorëve	Numri i nëndrejtorëve sipas Udhëzimit	Numri totali i nxënësve	Diferenca[5]
17 Shkurti	1	3	876	2
Ahmet Gashi	2	3	871	1

[5] Diferenca midis numrit të nëndrejtorëve që duhet të këtë shkolla sipas Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 10.07.2023 *"Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesë mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"* dhe numrit të nëndrejtorëve faktik.

Ali Demi	2	3	808	1
Andon Zako Cajupi	1	2	588	1
Bashkim Fino	1	2	572	1
Besnik Sykja	2	3	836	1
Betim Muco	1	3	939	2
Deshmoret E Lirise	1	2	746	1
Drita Pelinku	1	2	511	1
E Kuqe	2	3	806	1
Gjon Buzuku	2	3	848	1
Gustav Mayer	1	3	1067	2
Hasan Prishtina	2	3	1081	1
Ismail Qemali	1	3	1008	2
Kongresi Manastirit	2	3	1443	1
Kongresi i Lushnjës	1	2	523	1
Kostandin Kristoforidhi	1	2	631	1
Kushtrimi i Lirisë	1	2	766	1
Lasgush Poradeci	2	3	885	1
Misto Mame	1	2	635	1
Pjeter Budi	2	3	803	1
Sabahudin Gabrani	1	3	846	2
Sami Frasheri	2	3	1131	1
Shyqyri Peza	2	3	911	1
Vace Zela	1	2	516	1
Vasil Shanto	1	3	1168	2

Burimi: ZVAP Tiranë, punuar nga grupi i auditimitRezulton se, për periudhën objekt auditimi, për 26 pozicione nëndrejtor, drejtuesit e shkollat të mësipërmve si dhe ZVAP Tiranë nuk kanë filluar procedurat për shpalljet e vendeve vakante në pozicionin e nëndrejtorit, në kundërshtim me përcaktimet e Kreun I "Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar", neni 1, pika 2, shkronja "a" dhe "b" e Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023 "*Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institutit arsimor publik parauniversitar"* si dhe me pikat II.3 dhe III.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 10.07.2023 *"Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesë mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"*.

2.3.8 Mbi kriteret për emërimin e Drejtorit të Institucionit Arsimor Publik

Referuar pikës 1 të nenit 55 të ligjit nr. 69/2012, "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, të ndryshuar, drejtori i institucionit arsimor publik emërohet nga titullari i institucionit rajonal arsimor përkatës, përgjegjës për arsimin parauniversitar, pas propozimit të dy kandidatëve që vlerësohen me konkurrim të hapur nga komisioni i vlerësimit.

Kriteret që duhet të përmbushë kandidati për drejtor, janë përcaktuar në pikën 3, të nenit 3 të ligjit më sipër, ku citohet se: "*Kandidati për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor duhet të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" dhe të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar. Certifikimi i kandidatit për drejtor dhe nëndrejtor i institucionit arsimor kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në shkollën e drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor. Në rastet kur asnjë nga kandidatët për drejtor ose nëndrejtor nuk është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, komisioni propozon dy kandidatë që vlerësohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Titullari i institucionit përkatës emëron një nga kandidatët për një periudhë 1-vjeçare, me kushtin që kandidati të jetë pranuar në shkollën e drejtorëve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesit të institucionit arsimor sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni*" dhe në pikën 55/1 ku citohet se: "*Kandidati për drejtor të institucionit arsimor parashkollor duhet të ketë, të paktën, pesë vjet përvojë pune si mësues në arsimin parashkollor, të jetë trajnuar e pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar dhe të mos bëjë pjesë, pas emërimit, në forumet drejtuese të partive politike".*

Ligji nr. 69/2012 është ndryshuar me ligjin nr. 44/2023, datë 15.06.2023, ku referuar dispozitave kalimtare, kriteri i trajnimit dhe pajisjes me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar hyn në fuqi 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ligji nr. 44/2023, ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botim në fletoren zyrtare. Ky ligj është botuar në fletoren zyrtare nr. 101, datë 07.07.2023, pra kriteri për trajnimin dhe pajisjen me certifikatë të kandidatit për drejtor ka hyrë në fuqi me datë **21.07.2025.**

Në udhëzimin nr. 22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrën, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publike arsimor parauniversitar", Kreu 1, neni 2 përcakton kushtet që duhet të plotësoj drejtori apo nëndrejtori i IPAP-së, konkretisht:

a) të zotërojë arsimimin si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar", me vlerësim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit;

c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi ndaj tij;

d) të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor, për drejtimin e institucionit parauniversitar, ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

Ndërsa në nenin 3 të po këtij udhëzimi, përcaktohet dokumentacioni që duhet të dorëzojë aplikanti, ku në pikën 1, gërma e) citohet se duhet të dorëzojë certifikatën e drejtuesit të IPAP-së ose vërtetimin nga Shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor, në rast se e disponon.

Sa më sipër, nga auditimi konstatohet se pas datës 21.07.2025, pika "d", neni 2, i Udhëzimi Nr. 22 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar (IPAP)" bie në kundërshtim me Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", konkretisht me pikën 1 të nenit 55 dhe nenin 55/1 të këtij ligji.

Në pikën "d" të nenit 2 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, parashikohet se kandidati për drejtor ose nëndrejtor të IPAP-së duhet të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit ose të jetë pranuar për ta kryer atë. Ndërkohë, në nenin 55, pika 1 dhe në nenin 55/1 të ligjit Nr. 69/2012 përcaktohen kushtet dhe kriteret për emërimin e drejtorit dhe nëndrejtorit, pa e kushtëzuar kandidimin me përfundimin paraprak ose pranimin në trajnimin e detyrueshëm përgatitor pranë Shkollës së Drejtorëve si kriter themelor për aplikim. Në hierarkinë e akteve normative, ligji ka fuqi më të lartë juridike se udhëzimi. Për rrjedhojë, një akt nënligjor nuk mund të shtojë kushte apo kritere të reja që kufizojnë të drejtën për kandidim, nëse këto nuk janë të parashikuara në ligj. Vendosja e kriterit të certifikimit ose pranimit paraprak në trajnim si kusht për kandidim përbën tejkalim të kompetencës rregullatore dhe bie në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 69/2012.

Shtojca 6 "Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor apo nëndrejtor të IPAP-së"

Nga auditimi konstatohet se në Shtojcën nr. 6, të udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrën, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publike arsimor parauniversitar", tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor apo nën-drejtor të Institutit të Provimeve të Arsimit Publik (IPAS), përcakton se kandidati vlerësohet me 10 pikë nëse kandidati ka certifikatën për drejtues të IPAP nga Shkolla e Drejtorëve.

Pas kalimit të afatit të dispozitës kalimtare (data 21.07.2025), ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 55 dhe neni 55/1 përcaktojnë qartë se certifikata për drejtues të IPAP është kriter detyrues për të qenë i kualifikuar për pozicionin e drejtorit ose nën-drejtorit, dhe jo element që duhet të llogaritet me pikë në tabelën e vlerësimit.
Sa më sipër, vlerësimi i saj me 10 pikë është i panevojshëm dhe nuk ka bazë ligjore, pasi kandidati pa këtë certifikatë nuk mund të konsiderohet i kualifikuar për vlerësim të mëtejshëm nga komisioni.
Gjithashtu, referuar Shtojcën nr. 6, të udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, rezulton se në lidhje me shkallën e kualifikimit vlerësimi me pikë duhet të bëhet brenda intervali 0.5 pikë – 3 pikë, konkretisht detajuar:
- Mësues i kualifikuar (kategoria III) - 0.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 1 pikë për vlerësimin "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm";
- Mësues specialist (kategoria II) - 1.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 2 pikë për vlerësimin "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm";
- Mësues mjeshtër (kategoria I) - 2.5 pikë për vlerësimin "Mirë"; 3 pikë për vlerësimin "Shumë mirë" ose "Shkëlqyeshëm"
Sa më sipër konstatohet se për të 3 kategoritë, vlerësimi "Mirë" dhe "Shkëlqyeshëm" vlerësohet me të njëjtin nivel pikësh. Kjo mënyrë pikëzimi paraqet hapësirë për mos diferencim real të performancës ndërmjet kandidatëve, pasi niveli më i lartë i vlerësimit "Shkëlqyeshëm" nuk reflektohet me një avantazh shtesë në pikëzim krahasuar me vlerësimin "Shumë mirë".

2.3.9 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve të IPAP

2.3.9.1 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve në IPAP nën juridiksionin e ZVAP Tiranë

Shkolla 9 vjeçare "Hasan Prishtina"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 937/2, datë 23.03.2022 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 05.04.2022.
Me anë të shkresës nr. 423/1, datë 29.03.2022, njësia bashkiake nr. 3 ka caktuar znj. E.M, personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Me shkresën nr. 889, datë 28.03.2022, shkolla 9 vjeçare "Hasan Prishtina", ka dërguar emrat e komisionit të ngritur për vlerësimin e dosjeve, më përbërje: znj. F.C, mësuese është caktuar kryetare; z. K.Xh, mësues; znj. M.R, kryetare e Bordit të Shkollës; znj. A.M, kryetare e Këshillit të Prindërve.
Në dosje nuk disponohet dokumentacion për të vërtetuar që 2 mësuesit e përzgjedhur në komision janë zgjedhur nga këshilli i mësuesve me votim të fshehtë.
Me shkresën nr. 937/24, datë 04.04.2022, ZVAP Tirana ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, DRAP Durrës, Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, se më datën 07.04.2022, ora 10, në ambientet e ZVAP do të zhvillohen procedurat për emërimin e drejtorit të shkollës "Hasan Prishtina".
Në procesverbalet e mbajtura komisioni i vlerësimit nuk shprehet nëse përfaqësues të sindikatave apo punonjës të DRAP Durrës kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 23, datë 04.04.2022, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Hasan Prishtina", përbehet si më poshtë:Znj. F.C, mësues – Kryetar
Z. K.Xh, mësues; Znj. E.M, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore; Znj. M.R, kryetar i bordit; Znj. A.M –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.

Më datë 07.04.2022, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 4 dosjeve. Anëtarët e komisionit kanë plotësuar deklaratat e konfliktit të interesit, sipas shtojcës 3/1, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 *"Për procedurat e emërimet, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publike të arsimit parauniversitar".*
Në datën 07.04.2022, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 4 kandidatë dhe për 2 kandidatët ka lënë afat deri më datë 13.04.2022 për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbalit të datës 14.04.2022, të 4 kandidatët kanë kaluar fazën paraprake.
Nga auditimi i dokumente të dosjeve të dy kandidatëve nuk rezultuan parregullsi.
Po më datë 14.04.2022 komisioni ka zhvilluar intervistat me kandidatët. Komisioni ka mbajtur procesverbal ku ka përzgjedhur 5 pyetjet që do tu zhvillohen kandidatëve.
Referuar vlerësimit të komisionit për intervistën e kandidatit rezulton se:
- Për asnjë nga kandidatët nuk janë mbajtur shënim përgjigjet e dhëna. Në procesverbal gjenden vetëm pikët e dhëna nga komisioni për çdo pyetje.
- Për përgjigjet e dhëna nga kandidati z. L.Q, rezulton se anëtarja e komisionit znj. A.M të gjitha përgjigjet janë vlerësuar me 2 pikë, ndërsa të njëjtat përgjigja nga anëtarët e tjerë të komisionit janë vlerësuar me 0.5 pikë ose 1 pikë.
Më datë 14.04.2022 komisioni ka mbajtur procesverbal për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, si në vijim:
- L.T 30.5 pikë (20.5 pikë dosja+10 pikë intervista);
- V.K 28.3 pikë (25 pikë dosja + 3.3 pikë intervista);
- I.R 20.3 pikë (16 pikë dosja + 3.9 pikë intervista);
- L.Q 15.5 pikë (11 pikë dosja+ 4.5 pikë intervista).
Drejtori i ZVA Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 30, datë 04.04.2022, sipas të cilit znj. G.H. është caktuar për të vlerësuar procedurën e ndjekur nga komisioni i vlerësimit. Me shkresën nr. 1068/20, datë 22.04.2022, juristja e ZVA ka përgatitur relacion, ku procedura e ndjekur nga komisioni i vlerësimit është konsideruar konform udhëzimit.
Me shkresën nr. 1068/2, datë 22.04.2022, ZVA Tiranë ka dërguar në DRAP Durrës dosjet e 2 kandidatëve me më shumë pikë. Më datën 26.04.2022, DRAP Durrës ka marrë dokumentacionin e dërguar nga ZVA Tiranë.
Intervista me Drejtorin e DRAP Durrës është zhvilluar më datën 02.06.2022, jashtë afatit të përcaktuar në Kreun I, pika C.3 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët".*
Drejtori i DRAP Durrës ka marrë vendimin nr. 80, datë 08.06.2022, për emërimin e znj. L.T, për pozicionin e drejtuesit të IPAP "Hasan Prishtina".

Shkolla 9 vjeçare "Gustav Mayer"

Me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.
Njësia nr. 7, me shkresën nr. 103/1, datë 18.01.2024, ka caktuar znj. M.M si personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 12.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Gustav Mayer" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 44 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. B.I me 27 vota dhe znj. S.P po me 27 vota.

Me shkresën nr. 7, datë 16.01.2024, drejtori i shkollës 9 vjeçare "Gustav Mayer" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. S. dhe znj. B., I., e cila është edhe mësuesja më me përvojë në këtë shkollë.
Me shkresën nr. 8, datë 16.01.2024 është informuar ZVAT Tiranë se Kryetar i Këshillit të prindërve është z. A. M., ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është z. D.K.
Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024, ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur. SPASH, me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 ka caktuar znj. A.L personin përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 17, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Gustav Mayer", përbehet si më poshtë: Znj. B.I, mësues – Kryetar; Znj. S.P, mësues – Anëtar; Znj; M.M, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore; Znj. A.K, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Z D.K., kryetar i bordit – Anëtar; Z. A.M. –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 8 dosjeve. Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 8 kandidatë dhe për 8 kandidatët ka lënë afat deri më datë 25.01.2024, për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbali të datës 29.01.2024, komisioni ka s' kualifikuar 2 aplikantëve për mos plotësim të kritereve ligjore.
Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati z. V.Gj rezulton se:
- Rubrika 10 "autor në tekste shkollore/për mësuesin/ për drejtorin e shkollës) është vlerësuar me 0 pikë. Sipas shkresës të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 3082/22, datë 10.06.2013, z. Gj. ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e kurrikulës së arsimit bazë, lënda "Dituri Natyre", Klasa 1-6. Sa më sipër në këtë rubrikë z. Gj. duhet të vlerësohej me 1 pikë.
- Nota mesatare është vlerësuar me notën 7, ndërsa në vlerësimin me pikë është konvertuar në 3.5 pikë. Konstatohet se komisioni i vlerësimit në notën mesatare ka përfshirë vetëm mesataren e notave të ciklit të parë të studimeve dhe nuk ka përfshirë në llogaritje e mesatares së masterit shkencor në mësuesi për arsimin fillor të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, në kundërshtim me shtojcën nr. 6 "Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor apo nëndrejtor të IPAP-së", ku citohet se: "*Llogaritet si mesatare aritmetike e të gjithë notave, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore, mesatare e notave të ciklit I dhe notave të ciklit II), ose nota mesatare në programet e integruar të studimit të ciklit të dytë ose ekuivalente me to), pjesëtuar me numrin 2(dy) e rrumbullakosur me një shifër pas presjes".* Llogaritja e notës mesatare duhet të ishte (7 + 9.8)/2=8.4, ndërsa e konvertuar në pikë 4.2 pikë. Gjithashtu rezulton se rubrika nr. 7 "Arsim shtesë në fushën e arsimit" është vlerësuar me 0 pikë.
Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga znj. M.L rezulton se:
- Znj. M.L në vitin 2016 ka përfunduar master shkencor "Biologji mjedisi dhe zhvillimi, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqerm Çabej", Gjirokastër, me notë mesatare 8.3. Konstatohet se komisioni i vlerësimit këtë master e ka klasifikuar si arsim shtesë në fushën e

arsimit dhe për rubrikën 7 "Arsim shtesë në fushën e arsimit" e ka vlerësuar me 2 pikë. Sa më sipër rezulton se komisioni i vlerësimit ka vepruar me dy standarde në lidhje me vlerësimin dhe njohjen e masterit shkencor, pasi masterin shkencor të znj. L. e ka vlerësuar me 2 pikë te rubrika e arsimit shtesë, ndërsa të njëjtën rubrikë për z. Gj. e ka vlerësuar me 0 pikë.
- Gjithashtu nën rubrika "Gjuhë e huaj e mbrojtur me testin ndërkombëtar niveli B2" të rubrikës 3 "Dëshmi të njohjes/ve të gjuhëve të huaja" është vlerësuar me 4 pikë. Nga auditimi rezulton se në dosjen e dorëzuar nga kandidati për drejtor nuk ka test ndërkombëtar të zhvilluar për mbrojtjen e gjuhëve të huaja. Rezulton se znj. L. ka dorëzuar certifikatë të lëshuar nga "Education Buisness Links Albania" për përfundimin e kursit të anglishtes në nivelin B2, gjatë periudhës 03.09.2022 - 03.12.2022. Sa më sipër vlerësimi i mbarimit të kursit të anglishtes me 4 pikë nga komisioni i vlerësimit bie në kundërshtim me shtojcën 6 "tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor apo nëndrejtor të IPAP-së", rubrika 3 "Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja" të udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: *"a) gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL publike = 2 pikë; b) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B1 = 2 pikë; c) gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar, niveli B2 = 4. Kur kandidati ka të mbrojtur, dy gjuhë të huaja të ndryshme në IAL-të publike, dy gjuhë të huaja të ndryshme në testin ndërkombëtar, niveli B1, vlerësohet me 4 pikë."*
Sa më sipër rezulton se komisioni nuk ka vlerësuar drejtë dosjet e kandidatëve pasi z. Gj. i janë ulur pikët ndërsa znj. L., e cila në kohën e zhvillimit të konkursit ka qenë edhe drejtoresha e komanduar e shkollës "Gustav Mayer", i janë shtuar 6 pikë.
Rezulton se intervistat është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *" Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"
Konstatohet se komisioni i vlerësimit më datë 31.01.2024 ka mbajtur procesverbal, ku janë zgjedhur 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor.
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- M.L 40 pikë (30 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- V.Gj 37.2 pikë (29.5 pikë dosja + 7.7 pikë intervista);
- S.A 29.5 pikë (29.5 pikë dosja + 0 pikë intervista);
- E.C 26.4 pikë (26.4 pikë dosja + 0 pikë intervista;
- E.Q 26.1 pikë (17.8 pikë dosja + 8.3 pikë intervista);
- I.M 24.9 pikë (15.9 pikë dosja + 9 pikë intervista);

Më datën 05.02.2024, z S. A. ka paraqitur ankesë ndërsa znj. E. Q. ka paraqitur ankesë më datën 06.02.2024. Komisioni më datë 06.02.2024 ka trajtuar dhe i ka kthyer përgjigje ankesave, brenda afatit kohor.
Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 935/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Tiranë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës për intervistimin e kandidatëve, pasi në relacionin e përgatitur nga ZVAP, juristja R. K., e ka vlerësuar procedurën e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit si konform udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues për pozicionin e drejtuesit të IAP "Gustav Mayer" znj. M.L.

Gjimnazi "John F. Kennedy"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.

Njësia nr. 11 me shkresën nr. 188/1, datë 15.01.2024, ka caktuar z. E. P. si personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.

Referuar procesverbalit të mbajtur më datën 15.01.2024, në gjimnazin "John F. Kennedy" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 19 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar z. N.K me 15 vota dhe znj. F.H me 10 vota.

Me shkresën nr. 18, datë 17.01.2024 është informuar ZVAP Tiranë se Kryetar i Bordit të shkollës është z. Sh. F. dhe Kryetar i Këshillit të prindërve është z. P.M.

Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.

SPASH me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 ka caktuar znj. A.L si personin përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.

Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 19, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "John F. Kennedy" , përbehet si më poshtë: Z. N.K, mësues – Kryetar; Znj. F.H, mësues – Anëtar; Z. E.P, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Znj. B.S, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Z. Sh.F, kryetar i bordit – Anëtar

Z. P.M –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.

Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 6 dosjeve. Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.

Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak, ku për 5 kandidatët ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacioni, ndërsa 1 kandidat është kualifikuar. Sipas procesverbali të datës 29.01.2024, komisioni ka s' kualifikuar 3 kandidat, ku 1 kandidat është s' kualifikuar për mungesë të kategorisë së kualifikimit, 1 kandidat është s' kualifikuar për mungesë të diplomës së ciklit të dytë "Master" me 120 kredite në fushën e mësuesisë dhe 1 kandidat është s' kualifikuar pasi nuk ka fituar titullin mësues.

Konstatohet se intervista është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: "*Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së."*

Komisioni më datë 31.01.2024 ka mbajtur procesverbal ku janë përzgjedhur 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor. Në intervistë janë paraqitur 2 kandidatë.

Referuar relacioneve të mbajtura nga komisioni i vlerësimit për kandidatin V.H rezulton:

- Anëtarët e komisionit z. N.K., znj. F.H., z. Sh.F. dhe z. P.M. nuk kanë pasqyruar në relacion përgjigjet e dhëna gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si "dobët", "saktë", "pjesërisht".
- Kandidati për pyetjen e parë ka dhënë përgjigje të saktë, por nga anëtarët e komisionit z. N.K dhe znj. F.H është vlerësuar me 1 pikë.

- Për pyetjen nr. 2, kandidati është përgjigjur pjesërisht saktë, por nga 5 anëtarët e komisionit është vlerësuar me 0 pikë. Gjithashtu rezulton se përgjigja e dhënë nga kandidati V.H është pothuajse e njëjtë me përgjigjen e dhënë nga kandidati A. P. i cili është vlerësuar nga 4 anëtar të komisionint me 2 pikë dhe anëtari i komisionit znj. B.S është vlerësuar me 1 pikë.
- Kandidati i është përgjigjur saktë pyetjes nr. 4, përgjigje të cilës 4 anëtarë të komisionit e kanë vlerësuar me 2 pikë ndërsa anëtarët e komisionit z. Sh.F dhe z. P.M e kanë konsideruat të gabuar dhe e kanë vlerësuar me 0 pikë.
- Gjithashtu pyetjes nr. 4, kandidati i është përgjigjur pjesërisht saktë, por nga 2 anëtarët e komisionit z. Sh.F. dhe z. P.M. është konsideruar e gabuar dhe është vlerësuar me 0 pikë.

Referuar relacioneve të mbajtura nga komisioni i vlerësimit për kandidatin A. P. rezulton se anëtarët e komisionit z. N.K, znj. F.H, z. Sh.F dhe z. P.M nuk kanë pasqyruar në relacion përgjigjet e dhëna gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si "dobët", "saktë", "pjesërisht".

Sa më sipër rezulton se anëtarët e komisionit nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë kandidaten znj. V.H, duke i ulur në mënyrë të konsiderueshme pikët e intervistës.

Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:

-A.P 37.8 pikë (27.8 pikë dosja + 10 pikë intervista);

-V.H 37.6 pikë (33.8 dosja + 3.8 pikë intervista);

-A.Z 20.5 pikë (20.5 pikë dosja + 0 pikë intervista).

Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 942/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë. Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Tiranë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës për intervistimin e kandidatëve pasi në relacionin e përgatitur nga ZVAP, juristja e ZVAP Tiranë, znj. R.K, ka vlerësuar se procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit është konform udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024.

Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.

Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të z. A.P për pozicionin e drejtuesit të IAP "John F. Kennedy".

Gjimnazi "Ismail Qemali"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.

Me anë të shkresës nr. 207/1, datë 11.01.2024 njësia nr. 2 ka caktuar znj. N.A si personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.

Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 09.01.2024, në gjimnazin "Ismail Qemali" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Nga 60 mësues të pranishëm, kanë votuar 60 mësues ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. A.J me 26 vota, znj. E.P me 22 vota, znj. B.K me 6 vota, znj. M.L me 5 vota dhe mësuese të tjerë me më pak se 5 vota.

Rezulton se më datë 12.01.2024, në gjimnazin "Ismail Qemali" është zhvilluar raundi i dytë për përzgjedhjen e 2 mësuesve që do të marrin pjesë në komision. Të pranishëm ishin 60 mësues dhe ndarja e votave për 4 kandidatët ka rezultuar si në vijim: znj. A.J me 33 vota, znj. E.P me 36 vota, znj. B.K me 24 vota dhe znj. M.L me 19 vota.

Me shkresën nr. 529, datë 15.01.2024, drejtori i gjimnazit "Ismail Qemali" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. E.P dhe znj. A.J e cila është edhe mësuesja më me përvojë.

Gjithashtu me shkresën nr. 530, datë 15.01.2024 , drejtori i gjimnazit "Ismail Qemali" ka njoftuar ZVAP Tiranë se Kryetar i Bordit të shkollës është znj. S.J dhe Kryetar i Këshillit të prindërve është znj. M.G.
Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.
Me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 SPASH ka caktuar znj. A.L si personin përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 37, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "Ismail Qemali", përbehet: Znj. A.J, mësues – Kryetar; Znj. E.P., mësues – Anëtar; Znj. N.A, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Znj. B.S, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Znj. S.J, kryetar i bordit – Anëtar; Znj. M.G. –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 5 dosjeve të aplikantëve. Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimi paraprak dhe për të 5 kandidatët ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 29.01.2024, komisioni ka s' kualifikuar 2 aplikantëve të shkak të mos plotësimit të kritereve.
Nga auditimi konstatohet se intervistat është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *" Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
-Sh.E 39.9 pikë;
- Dh.M 33.8 pikë;
- E.T 30.08 pikë.
Më datën 02.02.2024 znj. E.T ka paraqitur ankesë. Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të gjimnazit "Ismail Qemali" i ka kthyer përgjigje në datën 06.02.2024, brenda afatit kohor.
Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 949/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të znj. Sh.E për pozicionin e drejtuesit të IAP "Ismail Qemali".

Shkolla 9 vjeçare "Klodian Tanushi"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.
Me shkresën nr. 51/1, datë 15.01.2024, znj. D. P. është caktuar përfaqësues i njësisë nr. 14 në komisionin e vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur më datën 15.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Klodian Tanushi" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të

institucionit. Nga 32 mësues të pranishëm, kanë votuar 32 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. K.F me 26 vota dhe z. A.S me 24 vota.
Me shkresën nr. 4, datë 15.01.2024, drejtori i shkollës 9 vjeçare "Klodian Tanushi" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur z. A.S me 26 vota dhe znj. K.F me 24 vota, e cila është edhe mësuesja më me përvojë.
Gjithashtu ka informuar se Kryetar i Bordit të shkollës është znj. I.D dhe Kryetar i Këshillit të prindërve është z. E.B
Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.
Me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 SPASH ka caktuar person përfaqësues znj. A.L Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 30, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Klodian Tanushi", përbehet:Znj. K.F, mësues – Kryetar; Z. A.S, mësues; Znj. D.P, përfaqësues i njësisë vetëqeverisjes; Znj. I.V, përfaqësues i ZVAT; Znj. I. D, kryetar i bordit; Z. E.B- Anëtar
Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 7 dosjeve. Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak dhe për të 5 kandidatët ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 29.01.2024, komisioni ka kualifikuar të gjithë kandidatët.
Nga auditimi konstatohet se intervistat është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"
Rezulton se është administruar vetëm një procesverbal/relacion për kandidat në lidhje me vlerësimin e intervistë, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përmbajtje të këtij procesverbali nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si " dobët", "mirë" dhe "shumë mirë". Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me nenin 5, pika 9, gërma "dh", të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune".*
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- L.L 38.2 pikë (28.2 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- E.K 35.6 pikë (27.6 pikë dosja + 8 pikë intervista);
- B.D 24.4 pikë (17.9 pikë dosja + 6.5 pikë intervista);
- K.B 20.9 pikë (14.9 pikë dosja + 6 pikë intervista);
- M.Ll 19.4 pikë (9.9 pikë dosja + 9.5 pikë intervista).

Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 939/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.

Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të z. L.L për pozicionin e drejtuesit të IAP "Klodian Tanushi".

Shkolla 9 vjeçare "Isa Boletini"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.

Me shkresën nr. 188/1, datë 15.01.2024, znj. Z.H është caktuar përfaqësues i njësisë nr. 11 në komisionin e vlerësimit.

Referuar procesverbalit të mbajtur më datën 15.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Isa Boletini" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 41 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. D.B me 40 vota dhe znj. A.N me 34 vota.

Me shkresën nr. 9, datë 15.01.2024, drejtori i shkollës 9 vjeçare "Isa Boletini" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. A.N dhe znj. D.B, e cila është edhe mësuesja më me përvojë në këtë shkollë.

Me shkresën 9/1, datë 15.01.2024 është informuar ZVAT Tiranë se Kryetar i Bordit të shkollës është znj. Z.Xh dhe Kryetar i Këshillit të prindërve është znj. M.B..

Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.

Me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 znj. A.L është caktuar përfaqësues i SPASH.

Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.

Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 27, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Isa Boletin", përbehet: Znj. D.B, mësues – Kryetar; Znj. A.N, mësues; Znj. Z. H, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore; Znj. E.S, përfaqësues i ZVAT; Znj. Z.Xh, kryetar i bordit dhe Znj. M.B –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.

Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 5 dosjeve. Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.

Në datën 22.01.2024, komisioni ka bërë vlerësimin paraprak dhe për të 4 kandidatët ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbali të datës 29.01.2024, komisioni ka s' kualifikuar 2 kandidat për mungesë të dokumentacionit.

Konstatohet se intervistat është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"

Rezulton se komisioni i vlerësimit më datë 31.01.2024 ka mbajtur 2 procesverbale me 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor. Konstatohet se pyetjet e përzgjedhura në një procesverbal janë të ndryshme nga 5 pyetjet e përzgjedhura në procesverbalin tjetër, duke e bërë të paqartë, n.q.s. të tre kandidatëve u janë drejtuar të njëjtat pyetje. Veprimet e mësipërmve janë në kundërshtim me udhëzuesin 2 "Për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit" të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: " *Në fillim të intervistës së strukturuar, anëtarët e Komisionit hartojnë një listë prej 5 pyetjesh, të*

cilat vlerësohen me nga 2 pikë secila. Pyetjet e hartuara nga Komisioni janë të njëjta për të gjithë kandidatët që realizojnë intervistën e strukturuar".
Gjithashtu në procesverbalin/relacionin në lidhje me vlerësimin e kandidatëve, anëtaret e komisionit nuk kanë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si " dobët", "mirë" dhe "shumë mirë".
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- A.Q 36.5 pikë (25.5 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- M.N 33.9 pikë (25.6 pikë dosja + 8.3 pikë intervista);
- E.A 19.6 pikë (14.6 pikë dosja + 5 pikë intervista).

Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 934/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.
Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë të pa identifikuara nga ZVAP Tiranë, përpara përcjelljes së dosjes në DRAP Durrës, pasi në relacionin e përgatitur nga juristja e ZVAP Tiranë, znj. R. K, procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit është vlerësuar konform udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të znj. A.Q për pozicionin e drejtuesit të IAP "Isa Boletini".

Shkolla 9 vjeçare "Ali Demi"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.
Me shkresën nr. 76/1, datë 16.01.2024, znj. K.B është caktuar përfaqësues i njësisë nr. 1 në komisionin e vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 15.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Ai Demi" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve të komisionin të përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 42 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. A.H me 23 vota dhe znj. K.C me 10 vota. Në këtë procesverbal citohet se në këtë fazë fitues shpallet Znj. H. ndërsa mësueset K.C, V.B dhe A.V do kalojnë në votim në fazën e dytë.
Sipas procesverbalit të datës 15.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Ali Demi" është zhvilluar raundi i dytë për përzgjedhjen e 2 mësuesve që do të marrin pjesë në komision. Të pranishëm ishin 37 mësues, ku mësuesit më të votuar rezultojnë znj. K.C. me 22 vota dhe znj. V.B. me 13 vota.
Me shkresën nr. 9, datë 15.01.2024, drejtori i shkollës 9 vjeçare "Ali Demi" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. K.C. dhe znj. A.H, e cila është edhe mësuesja më me përvojë në këtë shkollë.
Me shkresën me nr. 13, datë 15.01.2024 është informuar ZVAT Tiranë se Kryetar i Këshillit të prindërve është znj. A.Gj. ndërsa me shkresën 14, datë 15.01.2024 është informuar se Kryetar i Bordit të shkollës është znj. E.G.
Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.
Me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024, znj. A.L është caktuar përfaqësues i SPASH. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.

Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 107, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Ali Demi", përbehet: Znj. A.H, mësues – Kryetar; Znj. K.C, mësues – Anëtar; Znj. K.B, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; Znj. R.Xh, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Znj. E.G, kryetar i bordit – Anëtar
Znj. A.Gj –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 8 dosjeve. Në këtë procesverbal nuk është shënuar data në të cilin është mbledhur. Më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit.
Në datën 22.01.2024, komisioni ka bërë vlerësimin paraprak për 8 kandidatë dhe në përfundim ka kualifikuar 2 dosje të aplikantëve ndërsa për 6 kandidatët e tjerë ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbali të datës 29.01.2024, komisioni ka s'kualifikuar 2 aplikantëve për mungesë të dokumentacionit, konkretisht për mungesë të dëshmisë së kualifikimit.
Rezulton se intervista është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *" Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"
Konstatohet se komisioni i vlerësimit më datë 31.01.2024 ka mbajtur procesverbal, ku janë zgjedhur 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor.
Nga auditimi rezulton se është administruar vetëm një procesverbal/relacion për kandidatët në lidhje me vlerësimin e intervistë, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përmbajtje të këtij procesverbali nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si " dobët", "mirë" dhe "shumë mirë". Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me nenin 5, pika 9, gërma "dh", të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune".*
Rezulton se vlerësimin i përgjigjes të pyetjes nr. 4, për kandidaten V.S është i korrigjuar.
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- V.S 41.7 pikë (31.7 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- E.C 33.1 pikë (26.1 pikë dosja + 7 pikë intervista);
- R.V 27 pikë (19 pikë dosja + 8 pikë intervista);
- E.Q 23.9 pikë (17.9 pikë dosja + 6 pikë intervista);
- F.B 12.7 pikë (12.7 pikë dosja + 0 pikë intervista);
- V.K 7.6 pikë (pikë dosja + 0 pikë intervista).

Më datën 05.02.2024, znj. E.Q dhe znj. E.C kanë paraqitur ankesë në rrugë elektronike.
Komisioni më datë 06.02.2024 ka trajtuar dhe i ka kthyer përgjigje ankesës, brenda afatit kohor.
Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 929/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues për pozicionin e drejtuesit të IAP "Ali Demi" znj. V.S.

Shkolla 9 vjeçare "Yzberish"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 11631 prot., datë 11.11.2025 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën "Yzberish", brenda datës 20.11.2025.

Me shkresën nr. 2031/1, datë 17.11.2025 z. D.D është caktuar përfaqësues i njësisë nr. 14 në komisionin e vlerësimit.
Me shkresën e datës 13.11.2025, prot., me nr. 11808, datë 14.11.2025, nga Drejtori i shkollës "Yzberish" është njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të Komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. Th.T me vjetërsi pune 34 vite dhe znj. M.I me 22 vite. Përfaqësues nga prindërit janë zgjedhur znj. E.Xh, Kryetari i Bordit të Shkollës dhe znj. K.K, Kryetare e Këshillit të prindërve.
ZVAP Tiranë i ka përcjellë FSASH dhe SPASH njoftimin mbi datat e mbledhjeve të komisioneve të vlerësimit.
Sipas procesverbalit komisioni për shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të aplikantëve kandidatë për pozicionin e drejtorit të shkollës "Yzberish", është mbajtur në datë 26.11.2025 në ambientet e ZVAP Tiranë, pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të FSASH dhe SPASH.
Me anë të Urdhrit nr. 135, datë 20.11.2025, ZVAP Tiranë ka urdhëruar ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës "Yzberish":Th.T, mësues – Kryetar; M.I, mësues – Anëtar; D.D, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; E.S, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; E.Xh, kryetar i bordit – Anëtar; K.K–kryetare e këshillit të prindërve – Anëtar.
Komisioni ka mbajtur procesverbal më datë 26.11.2025 për marrjen në dorëzim të 15 dosjeve
Më datë 26.11.2025 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Për të 15 aplikantët, Komisioni i Vlerësimit i ka lënë afat deri në datën 03.12.2025 për plotësim dokumentacioni.
Konstatohet se për 2 aplikantët nga ana e Komisionit të vlerësimit nuk janë plotësuar pikët individuale të intervistës me gojë por është vendosur vetëm mesatarja, në kundërshtim me shkronjën 7/e të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023 ku citohet: *".realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësitë për drejtimin e institucionit. Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune".*
Intervista është zhvilluar në datën 05.12.2025 për të dy kandidatët.
Me shkresën nr. 12697, datë 16.12.2025, Drejtori znj. E. M., i ka dërguar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, informacionin në lidhje me dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë, përkatësisht znj. M.R dhe znj. I.B.
Me vendimin nr. 140, datë 19.12.2025 është shpallur fitues për shkollën "Yzberish" znj. I.B.

Shkolla e bashkuar "Alush Bardhi"

Pas shpalljes nr. 1772/1, datë 10.11.2025, ZVAP Tiranë me shkresën nr. 11633, datë 11.11.2025 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit.
Me shkresën nr. 3304/1, datë 19.11.2025, znj. G.Gj është caktuar përfaqësues i njësisë administrative Farkë.
Drejtori i komanduar i shkollës së bashkuar "Alush Bardhi" ka nxjerrë urdhrin nr. 51, datë 13.11.2025 "Për ngritjen e komisionit të zgjedhjes së mësuesve që do të marrin pjesë në vlerësimin e dosjeve të aplikantëve për konkursin për drejtues të institucionit".
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 13.11.2025, në shkollën e bashkuar "Alush Bardhi" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 34 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. H.Sh me 30 vota dhe znj. M.M me 22 vota.
Me shkresën nr. 315, datë 13.11.2025, drejtori i shkollës së bashkuar "Alush Bardhi" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. M.M dhe znj. H.Sh, e cila është edhe mësuesja më me përvojë në këtë shkollë.

Me shkresën me nr. 315, datë 13.11.2025 është informuar ZVAT Tiranë se Kryetar i Këshillit të prindërve është znj. V.Q ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është znj. E.A.
Me shkresën nr. 11957, datë 19.11.2025 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë prej datës 25.11.2025 do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas njoftimit nr. 1772/1, datë 10.11.2025.
Me shkresën nr. 132, datë 21.11.2025 z. I.H është caktuar përfaqësues i SPASH. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 132, datë 20.11.2025, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës së bashkuar "Alush Bardhi", përbehet: Znj. H.Sh, mësues – Kryetar; Znj. M.M, mësues – Anëtar; Znj. G.Gj, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; Znj. B.S, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Znj. E.A, kryetar i bordit – Anëtar; Znj. V.Q –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 25.11.2025, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 11 dosjeve. Më datë 25.11.2025 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 25.11.2025, komisioni ka bërë vlerësimin paraprak për 11 kandidatë dhe për të gjithë aplikantët ka lënë afat deri në datë 02.12.2025 për plotësimin e dokumentacionit. Më datë 03.12.2025 komisioni ka s'kualifikuar 4 kandidatë për mungesë dokumentacioni. Konstatohet se komisioni i vlerësimit më datë 04.12.2025 ka mbajtur procesverbal, ku janë zgjedhur 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor.
Referuar relacioneve të mbajtur nga anëtarja e komisionit znj. G.Gj, për përgjigjet e dhëna gjatë intervistës nga kandidatja M.L, rezulton se ky relacion ka korrigjime të konsiderueshme, pasi fillimisht të 5 pyetjet janë vlerësuar me 0 pikë (totali i intervistës 0 pikë) dhe më pas mbi të gjithë numrat 0, janë vendosur numrat 2 (totali i intervistës 10 pikë), duke e kaluar vlerësimin total të intervistës nga pikët minimale, 0 pikë, në vlerësimin maksimal 10 pikë.
Referuar relacioneve të mbajtura nga anëtarja e komisionit znj. G.Gj, për përgjigjet e dhëna gjatë intervistës nga kandidati S.Sh, rezulton se për përgjigjen e pyetjes nr. 2, edhe pse kandidati ka dhënë përgjigje pjesërisht të saktë, kjo përgjigje është vlerësuar me o pikë.
Referuar relacioneve të mbajtura nga anëtarët e komisionit për kandidatin E.T rezultojnë si në vijim:
- Në lidhje me pyetjen nr. 2, edhe pse kandidati ka dhënë përgjigje pjesërisht të saktë, kjo përgjigje nga anëtarët e komisionit znj. G.Gj, znj. H.Sh, znj M.M dhe znj. B.S është vlerësuar me o pikë.
- Në relacionin e mbajtur nga znj. H.Sh rezulton se për përgjigjet e pyetjeve nr. 1, 3 dhe 5 janë bërë korrigjime në pikët e dhëna, duke ulur pikët fillestare.
- Në relacionin e mbajtur nga znj. M.M rezulton se pikët e dhëna për përgjigjen e pyetjes nr. 5, janë të korrigjuara.
Më datë 04.12.2025 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- M.L 38.9 pikë (28.9 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- S.G 35.2 pikë (28.7 pikë dosja + 6.5 pikë intervista);
- E.T 34.9 pikë (29.9 pikë + 5 pikë intervista);
- A.T 24.8 pikë (24.8 pikë dosja + 0 pikë intervista);

- L.T 20.8 pikë (18.5 pikë dosja + 2.3 pikë intervista);
- A.H 20.8 pikë (20.8 pikë dosja + 0 pikë intervista);
- Xh.Gj 18.3 pikë (13.3 pikë dosja + 5 pikë intervista).

Më datën 09.12.2025, z. E.T ka paraqitur ankesë në rrugë elektronike. Komisioni më datë 12.12.2025 ka trajtuar dhe i ka kthyer përgjigje ankesës, brenda afatit kohor.

Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 12680, datë 15.12.2025 i ka dërguar DRAP Tiranës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.

Më datën 16.12.2025 nga drejtori i DRAP Tiranës është zhvilluar intervista me 2 aplikantët.

Me vendimin nr. 140, datë 19.12.2025 është shpallur fitues për shkollën e bashkuar "Alush Bardhi" znj. M. L.

Shkolla e bashkuar "Ymer Lala"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 11630, datë 11.11.2025 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit.

Me shkresën nr. 2825/1, datë 17.11.2025 znj. F.A është caktuar përfaqësues i njësisë administrative Dajt.

Drejtori i komanduar i shkollës së bashkuar "Ymer Lala" ka marrë vendimin nr. 81, datë 13.11.2025 "Për ndjekjen e procedurës së votimit të stafit pedagogjik për përzgjedhjen e anëtareve të komisionit të vlerësimit". Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 13.11.2025, në shkollën e bashkuar "Ymer Lala" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 20 mësues, ku mësuesit më të votuar kanë rezultuar znj. A.G me 20 vota dhe znj. L.K me 11 vota.

Me shkresën nr. 1586, datë 13.11.2025, drejtori i shkollës së bashkuar "Ymer Lala" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. A.G. dhe znj. L. K, e cila është edhe mësuesja më me përvojë në këtë shkollë.

Gjithashtu, me ketë shkresë është informuar se Kryetar i Këshillit të prindërve është z. E.Gj, ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është z. S.M.

Me shkresën nr. 11957, datë 19.11.2025 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Tiranë prej datës 25.11.2025 do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas njoftimit nr. 1772/1, datë 10.11.2025.

Me shkresën nr. 132, datë 21.11.2025 z. I.H është caktuar përfaqësues i SPASH. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.

Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 137, datë 20.11.2025, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës së bashkuar "Ymer Lala", përbehet: Znj. L.K, mësues – Kryetar; Znj. A.G, mësues – Anëtar; Znj. F.A, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; Znj. A.K, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Z. S.M, kryetar i bordit – Anëtar; Z. E.Gj. –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar

Më datë 26.11.2025, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 12 dosjeve. Po më datë 26.11.2025 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.

Në datën 26.11.2025, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 12 kandidatë, ku 1 dosje e ka kaluar shqyrtimin paraprak, ndërsa për 11 aplikantët e tjera ka lënë afat deri në datë 03.12.2025 për plotësimin e dokumentacionit. Më datë 04.12.2025 komisioni ka s' kualifikuar 4 kandidatë: 2 kandidatë janë s' kualifikuar pasi kanë specifikuar se konkurrojnë për pozicionin e

drejtorit të shkollës “Kolë Jakova” dhe shkollës “Dritas”; 1 kandidat nuk disponon master shkencor; 1 kandidat nuk disponon certifikatën e shkollës së drejtorëve. Konstatohet se komisioni i vlerësimit më datë 12.12.2025 ka mbajtur procesverbal, ku janë zgjedhur 5 pyetjet që do tu drejtoheshin kandidatëve për drejtor. Kandidatë u janë përgjigjur pyetjeve me shkrim dhe më pas i kanë firmosur.
Më datë 05.12.2025 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- P.D 43.2 pikë (33.2 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- M.R 40.7 pikë (31.7 pikë dosja + 9 pikë intervista);
- E.T 37.9 pikë (29.9 pikë + 8 pikë intervista);
- D.J 30.2 pikë (30.2 pikë dosja + 0 intervista);
- A.T 27.6 pikë (21.4 pikë dosja + 6.2 pikë intervista);
- A.H 20.7 pikë (20.7 pikë dosja + 0 pikë intervista);
- L.T 19.6 pikë (18.5 pikë dosja + 0 pikë intervista);
- K.L 13.6 pikë (13.6 pikë dosja + 0 pikë intervista).

Më datën 10.12.2025, z. E.T ka paraqitur ankesë në rrugë elektronike. Komisioni më datë 12.12.2025 ka trajtuar dhe i ka kthyer përgjigje ankesës, brenda afatit kohor.
Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 12696, datë 16.12.2025 i ka dërguar DRAP Tiranës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 17.12.2025 nga drejtori i DRAP Tiranës është zhvilluar intervista me 2 aplikantët.
Me vendimin nr. 140, datë 19.12.2025 është shpallur fitues për shkollën e bashkuar “Ymer Lala” z. P. D.

Shkolla 9 vjeçare “Kushtrimi i Lirisë”

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140 prot., datë 16.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për Komisionin e vlerësimit të drejtorit për shkollën “Kushtrimi i Lirisë”, brenda datës 18.01.2024.
Me anë të shkresës nr. 76/1, datë 16.01.2024, nga Njësia Administrative nr. 1, Tiranë është caktuar znj. Lindita Muça, personi që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit të kandidatëve.
Me shkresën e datës 16.01.2024, prot., me nr. 6, nga Drejtori i shkollës “Kushtrimi i Lirisë” është njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të Komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. B.A (mësuesi më i vjetër i shkollës) dhe znj. F.K Përfaqësues nga prindërit janë zgjedhur z. Sh.A, Kryetari i Bordit të Shkollës dhe znj. Y.C, Kryetare e Këshillit të prindërve.
Me shkresën e datës 17.01.2024 prot në ZVAP Tiranë me nr. 357/1, datë 17.01.2024, është caktuar znj. A.L si përfaqësuese e Sindikatës së Pavarur të Arsimit Tiranë.
Nga DRAP Durrës, si përfaqësues në mbledhjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtor, me shkresën nr. 224 prot., datë 22.01.2024 është caktuar znj. K.B.
Me anë të Urdhrit nr. 20, datë 18.01.2024, Drejtori i ZVAP Tiranë urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtorin e shkollës “Kushtrimi i Lirisë”: B.A, mësues – Kryetar; L.M, përfaaqësues i njësisë administrative Tiranë – Anëtar; Y.Ç, kryetare e Këshillit të prindërve – Anëtar; Sh.A, kryetar i Bordit – Anëtar; F.K, mësues – Anëtar; R.Xh., përfaqësues i ZVAT – Anëtar
Për këtë procedurë, disponohet procesverbali i datës 22.01.2024 ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin pranë sekretarisë së ZVAP, për pozicionin e drejtorit të shkollës “Kushtrimi i Lirisë”.
Më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.

Nga auditimi konstatohet se sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni në datën 22.01.2024, citohet se kanë ardhur 5 dosje/aplikime nëpërmjet shërbimit postar dhe 2 në rrugë elektronike, pra 7 në total, për të cilat është bërë shqyrtimi paraprak i dokumentacionit.
Bashkëlidhur gjendet procesverbali i datës 31.01.2024 sipas të cilit komisioni ka përcaktuar 5 pyetjet për kandidatët.
Konstatohet se procesverbali i datës 31.01.2024 për vlerësimin me shkrim dhe gojë të kandidatëve pjesëmarrës, është mbajtur pranë shkollës "Sami Frashëri" dhe jo në shkollën "Kushtrimi i Lirisë", jo në përputhje me nenin 4, pika 6 e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 ku citohet se: "Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së pse të ZVAP-së…"
Kandidatët janë vlerësuar si në vijim:

Emër Mbiemër	Pikë dosje/pikë interviste	Pikë interviste	Pikë total
B.B	30.2	10	40.2
E.H	26.4	10	36.4
Dh.M	28.8	6	34.8
S.A	24.7	7	31.7
N.D	21.4	7	28.4
M.Sh	14.1	8	22.1

Nga auditimi rezulton se është administruar vetëm një procesverbal/ relacion për kandidatët në lidhje me vlerësimin e intervistës, i cili nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përmbajtje të këtij procesverbali nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si "dobët", "mirë" dhe "shumë mirë". Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me nenin 5, pika 9, gërma "dh", të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune".*
Nga auditimi konstatohet se informacioni me dokumentacionin e 2 aplikantëve me më shumë pikë është përcjellë në datën 09.02.2024 në afat me pikën 2, neni 6 i udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023 ku citohet: Drejtori i ZVAP-së, brenda dy ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit të plotë nga Komisioni, përcjell dokumentacionin e dy kandidatëve me më shumë pikë në DRAP.
Me vendimin nr. 32, datë 20.02.2024 është shpallur fitues për shkollën "Kushtrimi i Lirisë" znj. znj. B.B.

Shkolla 9-vjeçare "Mihal Grameno"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024.
Me anë të shkresës nr. 207/1, datë 11.01.2024 nga njësia nr. 2 është caktuar znj. M.Sh, personi që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 11.01.2024, në gjimnazin "Mihal Grameno" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtarëve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit, ku është zgjedhur mësuesi i parë znj. M.L ndërsa përzgjedhja e mësuesit të dytë është lënë të bëhet në një raund të dytë në datën 12.01.2024, ku u zgjodh znj. V.L.
Sa më sipër realizimi i votimit me dy raunde nuk është në përputhje me neni 4, pika 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar"* ku citohet se: "*Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash".*
Me shkresën nr. 15, datë 12.01.2024, drejtori i gjimnazit "Mihal Grameno" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. M.L dhe znj. V.L e cila është edhe mësuesja më me përvojë.

Me shkresën nr. 3 prot., datë 12.01.2024 Kryetar i Këshillit të prindërve është zgjedhur znj. M.B. ndërsa me shkresën nr. 4 prot., datë 12.01.2024 Kryetar i Bordit të shkollës është z. B.H.
Me shkresën nr. 247, datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë i ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23, prej orës 9 e deri në përfundim të orarit zyrat do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.
Me shkresën nr. 1, datë 17.01.2024 SPASH ka caktuar znj. A.L si personin përfaqësues.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 13, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "Mihal Grameno", përbëhet: Znj. V.L, mësues – Kryetar; Znj. M.L, mësues – Anëtar; Znj. M.Sh, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Znj. M.B, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Z. B.H, kryetar i bordit – Anëtar dhe Znj. M.B –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 6 dosjeve të aplikantëve, 3 prej të cilave kanë ardhur me shërbim postar dhe 3 në rrugë elektronike. Ky procesverbal nuk rezulton të jetë i dorëzuar/firmosur nga sekretari i ZVAT.
Po më datë 22.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak dhe për të 5 kandidatë ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 26.01.2024, komisioni ka s' kualifikuar 2 aplikantë për shkak të mos plotësimit të kritereve.
Nga auditimi konstatohet se intervistat është zhvilluar në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri", jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *" Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"
Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- E.N 37.9 pikë (27.9 pikë dosje+10 pikë intervista)
- E.C 30.8 pikë (25.5 pikë dosja+5.3 pikë intervista)
- E.H 30.3 pikë (26.5 pikë dosja+3.8 pikë intervista)
- A.B 30 pikë dosja (nuk është paraqitur në intervistë).

Nga auditimi rezulton se është administruar vetëm një procesverbal/ relacion për kandidatët në lidhje me vlerësimin e intervistës, i cili nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përmbajtje të këtij procesverbali nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si "dobët", "mirë" dhe "shumë mirë". Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me nenin 5, pika 9, gërma "dh", të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune".*
Më datë 07.02.2024 Kryetari i Komisioni i ka dorëzuar Drejtorit të ZVAT 2 kandidatët me më shumë pikë, konkretisht znj. E.N dhe znj. E.C.
Drejtori i ZVAP Tiranë me shkresën nr. 951/1, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 15.02.2024 në ambientet e gjimnazit "Sami Frashëri" është zhvilluar intervista me të dy kandidatët.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të znj. E.N për pozicionin e drejtuesit të IAP "Mihal Grameno".

Juristja znj. R.K me shkresën nr. 951/1 prot., datë 09.02.2024, ka përgatitur relacionin drejtuar ZVA Tiranë, sipas të cilit ka konfirmuar se procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Mihal Grameno" është konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar".

Gjimnazi "Eqerem Çabej"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 11626, datë 11.11.2025 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 20.11.2025.
Me anë të shkresës nr. 3447/1, datë 17.11.2025 nga njësia nr. 2 është caktuar z. M.D, personi që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Me shkresën nr. 182, prot., datë 12.11.2025, drejtori i gjimnazit "Eqerem Çabej" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. K.Rr me vjetërsinë punë më shumë dhe znj. D.S.
Me shkresën nr. 180 prot., datë 12.11.2025 Kryetar i Këshillit të prindërve është zgjedhur znj. A. Q ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është znj. E.F.
Me shkresën nr. 11957, prot., datë 19.11.2025 ZVAP Tiranë i ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, se në ambientet e ZVAP Tiranë prej datës 25.11.2025, prej orës 9, do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur, ku dhe kërkohet caktimi i një përfaqësuesi.
Me shkresën e datës 21.11.2025 SPASH ka caktuar znj. I.H si personin përfaqësues.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 131, datë 20.11.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "Eqerem Çabej", përbëhet: znj. K.Rr, mësues – Kryetar; znj. D.S, mësues – Anëtar; z. M.D, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; znj. B.S, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; znj. E.F, kryetar i bordit – Anëtar; znj. A.Q –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 25.11.2025, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 9 dosjeve të aplikantëve, 4 prej të cilave kanë ardhur me shërbim postar dhe 5 në rrugë elektronike. Më datë 25.11.2025 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 25.11.2025, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak dhe për të 9 kandidatët ka lënë afat deri më datë 02.12.2025 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 03.12.2025, rezulton se komisioni ka s'kualifikuar 4 aplikantë të shkak të mos plotësimit të kritereve, konkretisht: znj. F.B, z. D.J, znj. L.V, znj. E.B.
Intervistat janë zhvilluar në ambientet e ZVAP Tiranë në datën 04.12.2025.
Me procesverbalin e datës 04.12.2025 janë miratuar 5 pyetjet për kandidatët në fazën e intervistës me gojë.
Më datë 04.12.2025 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- Dh.M 34.3 pikë (29.8 pikë dosje+4.5 pikë intervista)
- L.H 43.6 pikë (33.6 pikë dosja+10 pikë intervista)
- K.L 13.6 pikë (13.6 pikë dosja+0 pikë intervista)
- E.T 36.1 pikë (29.9 pikë dosja+6.2 pikë intervista).
- E.C 35.4 pikë (33.3 pikë+2.1 pikë intervista).

Nga auditimi konstatohet se pikët e vëna nga secili anëtar komisioni kundrejt kandidatëve jo në të gjitha rastet janë njësoj ose të përafërta, veprim i paargumentuar duke marrë në konsideratë faktin që përgjigjet e pyetjeve janë standarde, si në vijim:

Kandidatët	Kryetari	Anëtari 1	Anëtari 2	Anëtari 3	Anëtari 4	Anëtari 5
Dh M	4.5	4	4.5	4.5	5.5	4
L.H	10	10	10	10	10	10
E.T	5	5.5	6	8	6.5	0
E.C	2	1.5	2	3	2	0

Më datë 09.12.2025 kandidati z. E.T ka paraqitur ankesë në lidhje me rezultatin. Komisioni ka trajtuar ankesën dhe në datë 11.12.2025 i ka kthyer përgjigje në rrugë elektronike, ku përveç rezultatit të pikëve të dosjes (29.9 pikë) dhe intervistës (6.2 pikë), ka dhënë dhe përgjigjet e sakta të pyetjeve.

Nisur nga përgjigjet e dërguara me email kandidatit E.T, grupi i auditimit vlerësoi përgjigjet dhe pikëzimin e kandidatëve të tjera, nga ku u konstatua se kandidatja L.H e cila është vlerësuar me 10 pikë nga secili anëtar, në fakt nuk rezulton të ketë dhënë përgjigje plotësisht të sakta sipas përgjigjeve standarde dhe si rrjedhojë vlerësimi i dhënë nga komisioni rezulton i mbivlerësuar dhe jo real.

Më datë 11.12.2025 komisioni ka mbajtur procesverbalin për 2 kandidatët me më shumë pikë, konkretisht: znj. L.H dhe z. E.T, të cilin ia ka dorëzuar titullarit të ZVAT.

Me shkresën nr. 12683 prot., datë 15.12.2025 ZVA Tiranë i ka dërguar DRAP Tiranë emrat e dy kandidatët të lartëpërmendur me më shumë pikë.

Intervista është zhvilluar në datën 18.12.2025 për të dy kandidatët.

Drejtori i DRAP Tiranë ka nxjerr urdhrin nr. 140, datë 19.12.2025 për shpalljen fitues të znj. L.H për pozicionin e drejtuesit të IAP "Eqerem Çabej".

Znj. E.Sh me shkresën e datës 15.12.2025, ka përgatitur relacionin drejtuar ZVA Tiranë, sipas të cilit ka konfirmuar se procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Eqerem Çabej" është konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar*".*

Shkolla 9-vjeçare "Fan S. Noli"

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 140, datë 10.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 18.01.2024. Me anë të shkresës nr. 207/1, datë 11.01.2024 nga njësia nr. 2 është caktuar znj. M.Sh, personi që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.

Me shkresën nr. 10/3, prot., datë 15.01.2024, zv. drejtori i gjimnazit "Fan S. Noli" ka njoftuar ZVAP Tiranë se anëtarë të komisionit të vlerësimit të dosjeve janë zgjedhur znj. A.Z me vjetërsinë punë më shumë dhe znj. K.K.

Me shkresën nr. 10/2 prot., datë 15.01.2024 Kryetar i Këshillit të prindërve është zgjedhur znj. E. T ndërsa me shkresën nr. 10/1 prot., datë 15.01.2024, Kryetar i Bordit të shkollës është z. G.B

Me shkresën nr. 247, prot., datë 15.01.2024 ZVAP Tiranë ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, se në ambientet e ZVAP Tiranë në datat 19, 22 dhe 23.01.2024, prej orës 9 deri në përfundim të orarit zyrtar të punës, do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur, ku dhe kërkohet caktimi i një përfaqësuesi.

Me shkresën e datës 17.01.2024 SPASH ka caktuar znj. A.L si personin përfaqësues.

Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 05, datë 18.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të

gjimnazit “Fan S. Noli”, përbëhet: znj. A.Z, mësues – Kryetar; znj. K.K, mësues – Anëtar; z. M.Sh. , përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar; znj. I.H, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; znj. G.B, kryetar i bordit – Anëtar; znj. E.T –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 22.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 7 dosjeve të aplikantëve, 4 prej të cilave kanë ardhur me shërbim postar dhe 3 në rrugë elektronike. Më datë 22.01.2025 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak dhe për 5 kandidatë ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 26.01.2024, rezulton se komisioni ka s’kualifikuar 3 aplikantë të shkak të mos plotësimit të kritereve, znj. F.Xh., znj. G.M. dhe znj. L. Sh.
Me procesverbalin e datës 31.01.2024 janë miratuar 5 pyetjet për kandidatët në fazën e intervistës me gojë.
Sipas procesverbalit të datës 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- M.N 37.4 pikë (27.4 pikë dosje+10 pikë intervista)
- A.R 33.1 pikë (25.6 pikë dosja+7.5 pikë intervista)
- E.M 25.4 pikë (16.9 pikë dosja+8.5 pikë intervista)
- A.B 30 pikë, vetëm nga dosja pasi nuk ka marrë pjesë në intervistën me gojë.

Nga auditimi rezulton se është administruar vetëm një procesverbal/ relacion për kandidatët në lidhje me vlerësimin e intervistës, i cili nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përmbajtje të këtij procesverbali nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidati gjatë intervistës, por vetëm vlerësime të përgjithshme si “dobët”, “mirë” dhe “shumë mirë”. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me nenin 5, pika 9, gërma “dh”, të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *“Çdo anëtar i Komisionit e vlerëson intervistën me pikë nga 1 në 10, brenda një dite pune”.*
Më datë 08.02.2024 komisioni ka mbajtur procesverbalin për 2 kandidatët me më shumë pikë, konkretisht: znj. M.N dhe znj. A.R, të cilin ia ka dorëzuar titullarit të ZVAT.
Me shkresën nr. 936/1 prot., datë 09.02.2024 ZVA Tiranë i ka dërguar DRAP Durrës emrat e dy kandidatët të lartëpërmendur me më shumë pikë.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr vendimi nr. 32, datë 20.02.2024 për shpalljen fitues të znj. M. N për pozicionin e drejtuesit të IAP “Fan S. Noli”.
Juristja znj. R. K me shkresën e datës 09.02.2024, ka përgatitur relacionin drejtuar ZVA Tiranë, sipas të cilit ka konfirmuar se procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të shkollës “Fan S. Noli” është konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”.

Gjimnazi “Andon Zako Çajupi”

ZVAP Tiranë me shkresën nr. 937/2, prot., datë 23.03.2022 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 05.04.2022.
Me anë të shkresës nr. 423/1, datë 29.03.2022 nga njësia nr. 3 është caktuar znj. J.Ç, personi që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Në dosje mungon shkresa dhe procedura e përzgjedhjes për përzgjedhjen e mësuesit më të vjetër, në cilësinë e Kryetarit të komisionit, mësuesit, kryetarit të këshillit të prindërve dhe Kryetarit të Bordit të shkollës.

Mungon shkresa nga ana e ZVAP Tiranë drejtuar Sindikatës së Arsimit dhe Shkencës dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, për caktimin e përfaqësuesve.
Me shkresën e datës 21.11.2025 SPASH ka caktuar znj. I.H si personin përfaqësues.
Drejtori i ZVAT Tiranë ka nxjerrë urdhrin nr. 28, datë 04.04.2022, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "Andon Zako Çajupi", përbëhet: znj. F.Gj, mësuese – Kryetar; znj. K.B, mësuese – Anëtar; znj. J.Ç, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; znj. O.M, kryetar i bordit – Anëtar; znj. E.N –kryetar kështillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 07.04.2022, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 2 dosjeve të aplikantëve. Më datë 07.04.2022 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 07.04.2022, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak dhe për të 2 kandidatët ka lënë afat deri më datë 13.04.2022 për plotësimin e dokumentacionit.
Sipas procesverbalit të datës 13.04.2022, rezulton se komisioni ka miratuar 5 pyetjet e intervistës me gojë. Nga auditimi konstatohet se pyetjet nuk kanë lidhje me njohuritë e fushës me qëllim që të jenë të matshme dhe konkrete por janë të përgjithshme duke lënë hapsirë në lidhje me vlerësimin kundrejt përgjigjeve.
Konkretisht pyetjet e intervistës paraqiten si në vijim:
- çfarë risie do të sillnit ju për këtë gjimnaz?
- cili instrument i përdorur nga ju në drejtim çon këtë gjimnaz drejt suksesit?
- si do të përdoren terrenet sportive në shërbim të komunitetit?
- bashkëpunimi me njësinë bashkiake (ide).
- si mendoni ju që bordi i shkollës të jetë sa më efikas në shërbim të procesit mësimor-edukativ dhe rankimit më lart të këtij gjimnazi?
Nga auditimi konstatohet se pikët e vëna nga secili anëtar komisioni për kandidaten znj. Arjola Vecani, jo në të gjitha rastet janë njësoj ose të përafërta, si në vijim:

Kandidati Arjola Veçani	Kryetari	Anëtari 1	Anëtari 2	Anëtari 3	Anëtari 4
Pyetja 1	2	2	2	1.5	1.5
Pyetja 2	2	2	2	1.5	1.5
Pyetja 3	2	2	1	1.5	1.5
Pyetja 4	1	2	1	2	1.5
Pyetja 5	1	2	1	1	1.5

Për kandidaten e dytë nj. T.D, të gjithë kandidatët kanë votuar për cdo pyetje në mënyrë të barabartë nga 2 pikë, me një mesatare prej 10 pikë.
Evidentohet se rezultatet e pikëve paraqiten si në vijime:
Znj. A.V 15.5 pikë (7.5 pikë dosja + 8 pikë intervista)
Znj. T.D 33.6 pikë (23.6 pikë dosja + 10 pikë intervista)
Më datë 21.04.2022 komisioni ka mbajtur procesverbalin për 2 kandidatët me më shumë pike, si më sipër, të cilin ia ka dorëzuar titullarit të ZVAT.
Në dosje mungon shkresa që ZVA Tiranë i ka dërguar DRAP Tiranë emrat e dy kandidatët të lartë përmendur me më shumë pikë.
Intervista në DRAP është zhvilluar në datën 01.06.2022.
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 79, datë 03.06.2022 për shpalljen fitues të znj. T.D për pozicionin e drejtuesit të gjimnazit "Andon Zako Çajupi".
Në dosje mungon relacioni drejtuar ZVA Tiranë, sipas të cilit të konfirmohet se procedura e ndjekur nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e drejtorit të shkollës "Andon Zako Cajupi" është konform përcaktimeve të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2024 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin,

uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar".

2.3.9.2 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve në IPAP nën juridiksionin e ZVAP Kamëz

Shkolla 9 vjeçare "Jashar Hoxha"

Bashkia Kamëz ka caktuar z. A.D, personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Në dosje nuk disponohet informacion mbi mënyrën e zgjedhjes së mësueseve që do të marrin pjesë në votim.
Me shkresën nr. 440, datë 05.04.2022, ZVAP Kamëz ka njoftuar DRAP Durrës, ZVAP Durrës dhe Sindikatat që më datën 07.04.2022, në ambientet e ZVAP Kamëz do të zhvillohen procedurat për emërimin e drejtorit.
Në procesverbalet e mbajtura, komisioni i vlerësimit nuk shprehet nëse përfaqësues të sindikatave apo anëtar të DRAP kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Kamëz ka nxjerrë urdhrin nr. 17, datë 06.04.2022, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Jashar Hoxha", përbehet: Z. A.K, mësues – Kryetar; Znj. A.K, mësues – Anëtar; Z. A.D, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Znj. V.Gj kryetar i bordit – Anëtar; Z. L.P –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar
Më datë 07.04.2022, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 5 dosjeve. Anëtarët e komisionit kanë plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës 3/1, bashkëlidhur vendimit, në përputhje me Kreun I.C.5 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimet, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publike të arsimit parauniversitar".
Në datën 07.04.2022, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 5 kandidatë dhe për të 5-të kanë rezultuar mungesë dokumentacionesh, për të cilët është lënë afat plotësimi, 3 ditë pune.
Sipas procesverbali të datës 12.04.2022, komisioni ka s' kualifikuar 3 kandidatë për mungesë dokumentacioni, konkretisht, znj. B.H, z. F.Sh dhe znj. V.H. Gjithashtu është hartuar tabela e rezultateve ku dosja e znj. I. P është vlerësuar me 16.9 pikë ndërsa znj. E.N është vlerësuar me 12.8 pikë.
Më datë 14.01.2022, komisioni ka marrë në dorëzimin dokumente plotësues për dosjen e 2 kandidatëve dhe po më datë 14.04.2022 ka mbajtur procesverbal për vazhdimin e mëtejshëm të fazës së konkurrimit, ku në përfundim 3 kandidatë janë kualifikuar dhe 2 kandidatët janë s' kualifikuar për mungesë dokumentacioni, konkretisht, znj. B.H dhe z. F.Sh. Rezulton se znj. V.H ka plotësuar dokumentacionin jashtë afatit të përcaktuar, në kundërshtim me Kreun 1,C.10,b) të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"duke caktuar afat për plotësimin e tyre në tri ditë pune"*. .
Komisioni ka hartuar tabelën e re të rezultateve, ku dosjet e kandidatëve janë vlerësuar si në vijim: znj. V.H 26.4 pikë; znj. I.P 17.9 pikë dhe znj. E.N 12.8 pikë.
Nga auditimi i dokumenteve të dosjeve rezultoi se:
- Kandidati I.P në rubrikën 3 "Dëshmia e gjuhëve të huaja" është vlerësuar me 4 pikë. Rezulton se znj. P. në provimin e TOEIC është vlerësuar në total me 505 pikë dhe nëse i referohemi tabelës së pikëve për konvertimin e nivelit nga pikët e marra, rezulton niveli B1 dhe komisioni duhet ta kishte vlerësuar me 2 pikë. Në rubrikën certifikata trajnimesh është vlerësuar me 2 pikë. Në dosje gjendet 1 certifikatë trajnimi me temë "Të drejtat e njeriut", e zhvilluar në datat 11-12.03.2021 e

barasvlershëm me 18 orë ose 1 kredit. Sa më sipër komisioni këtë rubrikë duhet ta kishte vlerësuar me 0 pikë.
- Kandidati F.Sh në rubrikën e dëshmive të gjuhëve të huaja është vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë që në datën 28.10.2026, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja ka mbrojtur gjuhën angleze me notën 8. Komisionin duhet ta kishte vlerësuar këtë rubrikë me 2 pikë.
Në rubrikën e certifikatave të trajnimit është vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë që në dosje rezulton 1 certifikatë trajnim në modulin "Planifikimi i kurrikulës dhe vlerësimi i të nxënit", për periudhën 2019-2021, i barasvlershëm me 1 kredit. Sa më sipër komisioni duhet ta kishte vlerësuar me 1 pikë.
Komisioni i ka vlerësuar kandidatët në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 5 "Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor të IPAP" të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.
Sipas procesverbalit, më datën 19.04.2022 janë zhvilluar intervistat me 2 kandidatë, konkretisht me znj. I.P dhe z. F.Sh , pasi 2 kandidatet znj. E.N dhe znj. V.H kanë njoftuar se nuk do të paraqiten në intervistë.
Nga auditimi konstatohet se komisioni i vlerësimit ka marrë në intervistë një kandidatë i cili rezulton i s' kualifikuar nga po ky komision për mungesë dokumentacioni. Në dosje nuk gjend dokumentacion për të vërtetuar se si është njoftuar 1 kandidatë i s' kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e Kreut 1.C. 10 gërma c, d dhe e të udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"Komisioni kryen këto detyra: c) pas përfundimit të afatit prej pesë ditë pune, liston aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë, të cilët do të vlerësohen nga komisioni; d) vlerëson me pikë aplikantët e pranuar, kandidatët për drejtor të IPAP, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi; e) realizon intervistën e strukturuar me secilin kandidat për fushat e njohurive dhe aftësive për drejtimin e institucionit."*
Referuar formularëve për intervistën e strukturuar për 2 kandidatët rezulton se:
- Në formularë nuk janë pasqyruar përgjigjet e dhëna nga kandidatët gjatë intervistës, por vetëm vlerësimi me pikë.
- Në këto formularë përcaktohet se vlerësimi sipas anëtarëve I, II, III, IV, duke e bërë të pa identifikueshëm se cili anëtar e ka kryer vlerësimin.
- Rezulton se anëtari III, çdo përgjigje të kandidatit F.Sh e ka vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë që për pyetjen nr. 1, kryetari i komisionit e ka vlerësuar me 2 pikë, për pyetjet nr. 3, anëtari IV e ka vlerësuar me 2 pikë, ndërsa për pyetjet nr. 4, kryetari i komisionit e ka vlerësuar me 2 pikë.
Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, pas zhvillimit të intervistës, rezulton së në vijim:
- I.P 31.9 pikë (21.9 pikë dosja+10 pikë intervista);
- F.Sh 17.8 pikë (13.2 pikë dosja+ 4.6 pikë intervista).
Konstatohet se pikët e dosjes së znj. I.P kanë ndryshimin midis tabelave të rezultateve, ku një herë dosja e saj është vlerësuar me 16.9 pikë, herën tjetër është vlerësuar me 17.9 pikë, ndërsa në vlerësimin përfundimtar rezulton 21.9 pikë.
Në dosjen për zhvillimin e procedurës nuk gjendet dokumentacion nëse sektori i shërbimeve në ZVAP ose një punonjës i autorizuar nga drejtori ka shqyrtuar dokumentacionin, si përcaktohet në Kreun 1, D.1 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2022.
Si konkluzion, pas e-maile-ve të dërguara nga dy kandidatët e kualifikuar, për mos marrje pjesë në intervistë, për shkak se në konkurrim ngel vetëm 1 kandidatë, procedura e konkursit për zgjedhjen e drejtorit duhet të ishte anuluar dhe jo të vijohej intervista me 1 kandidatë, i cili nuk është kualifikuar për mungesë të dokumentacionit.

Drejtori i ZVAP Kamëz me shkresën nr. 627, datë 04.05.2022 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datë 23.05.2022, Drejtori i DRAP Durrës ka zhvilluar intervistat me 2 kandidatët, jashtë afateve të përcaktuar në Kreun I, Pika D.3 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston 2 kandidatët".*
Drejtori i DRAP Durrës ka marrë vendimin nr. 72, datë 26.05.2022, për shpalljen fitues të znj. I.P, për pozicionin e drejtuesit të IAP "Jashar Hoxha".
Nga auditimi rezulton se znj. I.P gjatë zhvillimin e procedurës së konkurrimit nuk kanë qenë e pajisur me certifikatën e drejtorëve, por ka dorëzuar vërtetim që është pranuar në shkollën e drejtorëve. Sa më sipër vendimi i marr nga Drejtori i DRAP Durrës, z. H.L, për emërimin definitiv, pa vendosur afat, bie në kundërshtim me nenin 55, pika 3 të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ku citohet: ". *Në rastet kur asnjë nga kandidatët për drejtor ose nëndrejtor nuk është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, komisioni propozon dy kandidatë që vlerësohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Titullari i institucionit përkatës emëron një nga kandidatët për një periudhë 1-vjeçare, me kushtin që kandidati të jetë pranuar në shkollën e drejtorëve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesit të institucionit arsimor sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni".*

Shkolla 9 vjeçare "Lidhja e Prizrenit"

Bashkia Kamëz ka caktuar z. Sh.K, personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 11.01.2024, në shkollën 9 vjeçare "Lidhja e Prizrenit" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Rezulton se drejtuesja e mbledhjes ka ftuar mësuesit të paraqesin kandidaturave dhe pas diskutimeve janë propozuar emrat e 3 mësuesve që do të votohen nga mësuesit e tjerë. Këshilli i mësuesve ka bërë 3 propozime për të marr pjesë në votim. Në votim kanë marrë pjesë 35 mësues. Në udhëzim nuk përcaktohet se në votim shkojnë vetëm 3 emra mësuesish të cilët propozohen nga këshilli apo vetë ofrohen për të kandiduar, duke sjellë që kjo mënyrë votimi nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023.
Pas numërimit të votave, rezultati paraqitet si vijon: znj. B.M, 9 vota; znj. D.D, 12 vota; znj. F.Rr, 14 vota.
Drejtori i shkollës ka nxjerrë Vendimin nr. 22, datë 11.01.2024, sipas të cilit komisioni përbëhet nga: z. S.P, Kryetar i Bordit; znj. A.T- Nënkryetar i Keshillit të Prindërve; znj. D.D, mësuese dhe znj. F.Rr, mësuese.
Me shkresën nr. 142, datë 18.01.2024 ZVAP Kamëz ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Kamëz, në datë 23.01.2024, do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas njoftimit të DRAP Durrës nr. 142/1, datë 18.01.2024.
Me shkresën e datës 17.01.2024, SPASH ka caktuar z. I.B, si personi përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Kamëz ka nxjerrë urdhrin nr. 3, datë 17.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Lidhja e Prizrenit", përbehet: Znj. D.D, mësuese – Kryetar; Znj. F.Rr, mësuese – Anëtar; Znj. A.C, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Z. Sh.K, përfaqësues

i ZVAT – Anëtar; Z. S.P, kryetar i bordit – Anëtar; Znj. A.T –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar.
Më datë 23.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 5 dosjeve. Po më datë 23.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 23.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 5 kandidatët dhe u ka lënë afat deri më datë 25.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit. Më datë 25.01.2024 komisioni ka s' kualifikuar 1 kandidatë për mungesë të dëshmisë së kualifikimit.
Rezulton se anëtaret e komisionit për përgjigjen nr. 1, nuk kanë mbajtur shënim përgjigjen e kandidatëve, por kanë shënuar vetëm vlerësimin.
Më datë 29.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- L.B 43 pikë (33 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- E.N 23.2 pikë (13.2 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- Z.S 21.6 pikë (15.1 pikë + 6 pikë intervista);
- L.K – nuk u paraqit në intervistë.

Drejtori i ZVAP Kamëz, ka nxjerr Urdhrin nr. 10, datë 22.01.2024 për caktimin e juristes znj. D.G, për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të mbajtur nga komisioni.
Më datë 08.02.2024 juristja e ZVA Kamëz ka hartuar relacioni mbi procedurën e ndjekur ku ka konstatuar se kandidates znj. L.B, seksioni i gjuhëve të huaja i është llogaritur si nivel B2 me 4 pikë. Ndërkohë nëse i referohemi tabelës së pikëve për konvertimin në nivel për pikët TOEIC, rezultojnë më pak se B1 dhe kandidati duhet të vlerësohet me 0 pikë për gjuhët e huaja. Gjithashtu në këtë relacion juristja është shprehur se nëse do të bëhet rillogaritje e pikëve, nuk do të këtë ndryshim për sa i përket dy dosjeve me më shumë pikë dhe në tërësi procedura e ndjekur nga ky komision është vlerësuar e rregullt.
Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të dorëzuara rezultoi se:
- znj. E.N në rubrikën shkallët e kualifikimit është vlerësuar me 3 pikë, ndërkohë rezulton së për vitin shkollor 2018-2019 ka marrë dëshmi kualifikimi për kategorinë "mjeshtër", me rezultatin C "Mirë", çka sjellë që duhet të ishte vlerësuar me 2.5 pikë.

Për rubrikën certifikata trajnimesh është vlerësuar me 0 pikë, ndërkohë rezulton se në datat 20,21,22 tetor 2023, ka përfunduar modulin e trajnimit "si mund të përmirësohet përgatitja e mësuesve për t'iu përgjigjur objektivave për zhvillimi të qëndrueshëm", me kohëzgjatje 18 orë dhe ka fituar 1 kredit. Referuar shtojës 5 "tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor të IPAP", duhet të ishte vlerësuar me 1 pikë.
Për rubrikën vjetërsi pune në pozicionin e drejtuesit është vlerësuar me 0 pikë, ndërkohe referuar librezës së punës rezulton se për periudhën 15 shtator 2014-16 tetor 2017 ka qenë nëndrejtor i shkollës "Lidhja e Prizrenit", ndërsa pas datës 16 tetor 2017 e në vazhdim ka qenë drejtor i komanduar i shkollës "Lidhja e Prizrenit". Sa më sipër komisioni duhet ta kishte vlerësuar me 4 pikë.
- znj. L.B në rubrikën nota mesatare e studimeve të larta është vlerësuar me 4 pikë. Referuar llogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit rezulton se nota mesatare e diplomës së nivelit të dytë dhe masterit profesional është 7.8 dhe komisioni i vlerësimit këtë rubrikë duhet ta kishte vlerësuar me 3.9 pikë.

Për rubrikën gjuhë të huaja është vlerësuar më 4 pikë. Ndërkohë nëse i referohemi tabelës së pikëve për konvertimin e nivelit nga pikët e marra në provimin TOEIC rezultojnë më pak se niveli B1 dhe komisioni këtë rubrikë duhet ta kishte vlerësuar me 0 pikë.

Rezulton se znj. L.B ka përfunduar fakultetin e Shkencave të Edukimit në degën Edukatë Qytetare dhe masterin profesional Mësuesi në AMU për Edukatë Qytetare – Histori me profil minor në Gjeografi, ndërkohë që dëshminë e kualifikimit e ka marrë për lëndën arsim fillor.
Drejtori i ZVA Kamëz me shkresën nr. 424, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Më datën 19.02.2024 nga drejtori i DRAP Durrës është zhvilluar intervista me 2 aplikantët, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 6, pika 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Titullari i DRAP, brenda 5 ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston 2 kandidatët".*
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr vendimin nr. 33, datë 21.02.2024, për shpalljen fitues të znj. L.B, për pozicionin e drejtuesit të IAP "Lidhja e Prizrenit".

Gjimnazi "Elez Isuf Ndreu"

Bashkia Kamëz ka caktuar znj. F.N, personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Referuar procesverbalit të mbajtur në datën 10.01.2024, në gjimnazin "Elez Isuf Ndreu" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit, ku kanë morë pjesë 37 mësues. Rezulton se këshilli i mësuesve ka bërë 3 propozime për të marr pjesë në votim dhe mësuesit kanë votuar midis tre kandidaturave të propozuara.
Propozimi i kandidaturave nga këshilli i mësuesve bie në kundërshtim me nenin 4, pika 3 të Udhëzimit nr 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtar të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash."*
Pas votimit rezultoi se z. H.Ç morri 36 vota, znj. V.S morri 35 vota dhe z. V.N morri 30 vota.
Nëpërmjet emalit të datës 11.01.2024, drejtori i komanduar I.L, ka informuar ZVA Kamëz se përbërja e komisionit është: z. H.C, mësues; znj. V.S, mësuese; znj. A.N, Kryetare e Bordit të shkollës dhe z. S.K, Kryetar i Këshillit të prindërve.
Me shkresën nr. 142, datë 18.01.2024 ZVAP Kamëz ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e ZVAP Kamëz, në datë 23.01.2024, do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas njoftimit të DRAP Durrës nr. 142/1, datë 18.01.2024.
Me shkresën e datës 17.01.2024, SPASH ka caktuar z. I.B, personi përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.
Drejtori i ZVAT Kamëz ka nxjerrë urdhrin nr. 6, datë 17.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të gjimnazit "Elez Isuf Nderu", përbehet si më poshtë: Z. H.Ç, mësues – Kryetar; Znj. V. S, mësuese – Anëtar; Znj. F.N, përfaqësuese e njësisë të vetëqeverisjes vendore– Anëtar; Z. N.Sh, përfaqësues i ZVAT – Anëtar; Znj. A.N, kryetare e bordit – Anëtar; Z. S.K, –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar
Me urdhrin nr. 15, datë 23.01.2024 është ndryshuar përfaqësuesi i bashkisë Kamëz, duke u zëvendësuar me znj. B. B., për shkak të raportit mjekësor të marr nga anëtari i komisionit, znj. N.
Më datë 23.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 4 dosjeve. Po më datë 23.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.
Në datën 23.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 4 kandidatët dhe u ka lënë afat për plotësimin e dokumentacionit. Më datë 29.01.2024 komisioni ka s' kualifikuar 1 kandidatë për mungesë të kualifikimit.

Në dosje gjenden përgjigjet e dhëna nga çdo kandidat, këto përgjigjet janë të firmosura prej tyre.
Më datë 3.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:
- I.L 36 pikë (23 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- R.M 27.4 pikë (17.4 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- K.P 26.9 pikë.

Drejtori i ZVAP Kamëz, ka nxjerr Urdhrin nr. 10, datë 22.01.2024 për caktimin e juristes znj. D.G., për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të mbajtur nga komisioni.
Më datë 08.02.2024 juristja e ZVA Kamëz ka hartuar relacioni mbi procedurën e ndjekur ku ka konstatuar se në librezën e punës së z. R.M ka si marrëdhënie punë në ZVA Dibër ndërsa vërtetimi i masës disiplinore është marrë nga ZVA Kamzë, pra marrëdhëniet e punës nuk përputhen me vërtetimin dhe nuk pasqyrohen ne dokumentin që vërteton eksperiencën e punës.
Drejtori i ZVA Kamëz me shkresën nr. 427, datë 09.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.
Drejtori i DRAP Durrës, më datën 19.02.2024 ka zhvilluar intervistat me 2 aplikantët, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 6, pika 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Titullari i DRAP brenda 5 ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston 2 kandidatët".*
Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr vendimin nr. 33, datë 21.02.2024, për shpalljen fitues të z. I. L., për pozicionin e drejtuesit të IAP "Elez Isuf Ndreu".

2.3.9.3 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve në IPAP nën juridiksionin e ZVAP Vorë

Shkolla 9 vjeçare "Picar"

Pas shpalljes nr. 2232, datë 07.09.2022, ZVAP Vorë me shkresën nr. 983, datë 03.10.2022 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 06.10.2022.
Bashkia Vorë me shkresën nr. 5563/1, datë 06.10.2022, ka caktuar z. A.P, personin që do të jetë anëtari i komisionit të vlerësimit.
Referuar procesverbalit të datës 05.10.2022 është njoftuar ZVAP Vorë, se mësuesit e zgjedhur nga shkolla 9 vjeçare "Picar", për të marr pjesë në komisionin do të jenë znj. E.G (mësuesja më e vjetër) dhe znj. V.S. Në procesverbal nuk përcaktohen, sa mësues kanë marrë pjesë në votimi, sa vota ka marr secili mësues si dhe nuk përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së mësuesve që do të marrin pjesë në komisioni, veprime në kundërshtim me Kreun I, C, pika 3 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimet, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publike të arsimit parauniversitar" ku citohet se: *"Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash".*
Më datën 05.10.2022, drejtori i komanduar i shkollës, z. J.K, ka lëshuar një deklaratë, ku ka informuar se Kryetar i Këshillit të prindërve është z. B.P, ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është z. M.P. Rezulton se deklarata është e pa firmosur.
ZVAP Vorë me shkresën nr. 982, datë 03.10.2022 ka njoftuar DRAP Durrës, ZVAP Durrës dhe Sindikatat se më datën 06.10.2022, në shkollën 9 vjeçare "Picar" do zhvillohen procedurat për emërimin e drejtorit.
Në procesverbalet e mbajtura, komisioni i vlerësimit nuk shprehet nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë. DRAP Durrës është përfaqësuar nga z. B.G.
Drejtori i ZVAT Vorë ka nxjerrë urdhrin nr. 127, datë 05.10.2022, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Picar", përbehet si më poshtë: Znj. E.G., mësues – Kryetar; Znj. V. S, mësues

– Anëtar; Z. A.P, përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore – Anëtar; Z. M.P, kryetar i bordit – Anëtar; Z. B.P –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar

Më datë 06.10.2022, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 3 dosjeve. Anëtarët e komisionit nuk kanë plotësuar deklaratën e konfliktit të interesit (shtojca 3/1, bashkëlidhur vendimit), në kundërshtim me Kreun I.C.5 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimet, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publike të arsimit parauniversitar" ku citohet se: *"Anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin, në kuptim të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit. Në mbledhjen e parë të Komisionit, anëtarët plotësojnë deklaratën e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 3/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi".*

Në datën 06.01.2022, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 3 kandidatë dhe për 2 kandidatët ka lënë afat, për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbali të datës 11.10.2022, komisioni ka s'kualifikuar znj. D.Ll për mungesë dokumentacioni.

Nga auditimi rezulton se më datë 11.10.2022 janë mbajtur 2 procesverbale për s' kualifikimin e kandidates Ll., ku në një komision ka qenë kryetar znj. E.G, ndërsa në procesverbalin tjetër kryetare e komisionit ka qenë znj. A.Q.

Më datë 14.10.2022, shkolla 9 vjeçare "Picar", ka kërkuar zëvendësimin e kryetarit të komisionit znj. V.S. me z. A.Q., pasi znj. S. është larguar nga shkolla.

Sa më sipër, konstatohet se drejtori i ZVAP Vorë nuk ka nxjerr urdhër për ndryshimin e kryetarit të komisionit, ndërkohë që vlerësimi i dosjeve të kandidatëve dhe intervista është zhvilluar nga një kryetar komisioni, i cili është i ndryshëm nga kryetari i komisionit të caktuar me urdhrin nr. 127, datë 05.10.2022.

Nga auditimi i dokumente të dosjeve të dy kandidatëve rezultoi:

- znj. M.Ll., në rubrikën e notës mesatare është vlerësuar me 3 pikë, ndërkohë rezulton se programin e studimeve DIND në "Biologji-Kimi", sistemi me shkëputje nga puna, gjatë viteve akademike 2000-2005 e ka përfunduar me mesatare 6.6, ndërsa masterin "Mësuesi në Biologji për AML", me mesatare 8. Sa më sipër vlerësimi i znj. Ll. te rubrika e mesatares duhet të ishte 3.65. Te rubrika "Shkallët e kualifikimit", znj. L. është vlerësuar me 3 pikë. Nga auditimi rezulton se kandidatja për vitin shkollor 2019-2022 ka marrë dëshminë e kualifikimit "mësues specialist", me rezultatin B "shumë mirë" dhe vlerësimi për këtë rubrikë duhet të ishte 2 pikë.
- Znj. E. H për rubrikën "Shkalla e kualifikimit" është vlerësuar me 2 pikë. Konstatohet se për vitin shkollor 2020-2021 ka marrë dëshminë e kualifikimit "mësues specialist" me rezultatin C "mirë" dhe vlerësimi për këtë rubrikë duhet të ishte 1.5 pikë.

Në rubrikën "Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja është vlerësuar me 2 pikë, ndërkohë që në dosje nuk rezulton ndonjë dokument që vërteton mbrojtjen e gjuhës së huaj.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e Shtojcës 5 "Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor të IPAP", të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020

Më datën 18.10.2022 komisioni ka zhvilluar intervistat. Referuar procesverbaleve të intervistave rezulton se komisioni nuk ka shënuar përgjigjet e dhëna nga aplikantët por vetëm pikët e vendosura për secilën pyetje.

Referuar vlerësimit të komisionit për intervistën e kandidatit znj. E. H rezulton se:

- Kryetari i komisionit znj. A.Q përgjigjen e pyetjes nr. 4 e ka vlerësuar me 3 pikë.
- Anëtari i komisionit z. A.P, përgjigjet e pyetjes nr. 1, nr. 4 dhe nr. 5 i ka vlerësuar me 3 pikë.
- Anëtari i komisionit znj. V.S përgjigjen e pyetjes nr. 2 e ka vlerësuar me 3 pikë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me udhëzuesin 2 "Për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit nga komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit" të

Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"Në fillim të intervistës së strukturuar, anëtarët e Komisionit hartojnë një listë prej 5 pyetjesh, të cilat vlerësohen me nga 2 pikë secila, gjithsej 10 pikë. Secili anëtar i Komisionit bën vlerësim individual me 0-2 pikë për përgjigjen e dhënë nga kandidati për secilën pyetje".*

Më datë 24.10.2022 komisioni ka mbajtur procesverbal për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, së në vijim:

- E.H 25 pikë (15 pikë dosja+10 pikë intervista);
- M.K 6 pikë (11 pikë dosja+ 5 pikë intervista).

Sipas shkresës nr. 941/4, datë 25.10.2022, juristi i ZVAP Vorë, z. E.D., pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e ka vlerësuar si procedurë të rregullt dhe e ka kaluar te drejtori i ZVAP Vorë për proceduar të mëtejshme. Parregullsitë e trajtuara më sipër rezultojnë **të pa identifikuara** nga juristi i ZVAP Vorë.

Drejtori i ZVAP Vorë me shkresën nr. 941/5, datë 25.10.2022 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.

Intervista me Drejtorin e DRAP Durrës është zhvilluar më 14.11.2022, jashtë afatit të përcaktuar në Kreun I, pika C.3 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, ku citohet se: *"Drejtori i DRAP, brenda pesë ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston dy kandidatët".*

Drejtori i DRAP Durrës ka marrë vendimin nr. 281, datë 30.11.2022, për emërimin definitiv të znj. E.H, për pozicionin e drejtuesit të IAP "Picar".

Nga auditimi rezulton se znj. E.H gjatë zhvillimin e procedurës së konkurrimit nuk kanë qenë e pajisur me certifikatën e drejtorëve, por ka dorëzuar vërtetim që është pranuar në shkollën e drejtorëve. Konstatohet se znj. H. është pajisur me certifikatën për drejtimin e IAP më datë 12 prill 2023. Sa më sipër vendimi i marr nga Drejtori i DRAP Durrës, z. H.L, për emërimin definitiv të znj. E.H, bie në kundërshtim me nenin 55, pika 3 të ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar ku citohet: ". *Në rastet kur asnjë nga kandidatët për drejtor ose nëndrejtor nuk është i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor parauniversitar, komisioni propozon dy kandidatë që vlerësohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Titullari i institucionit përkatës emëron një nga kandidatët për një periudhë 1-vjeçare, me kushtin që kandidati të jetë pranuar në shkollën e drejtorëve. Pas përfundimit të kësaj periudhe, rishpallet procedura për përzgjedhjen e drejtuesit të institucionit arsimor sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni".*

Gjimnazit "Isa Boletini", Vorë

Me shkresën nr. 118/1 prot., datë 25.02.2022 nga ZVAP Vorë është dërguar në DRAP Durrës lista e shkollave që kanë të lirë pozicionin drejtor/nëndrejtor, konkretisht për gjimnazin "Isa Boletini" Vorë.

Pas shpalljes nr. 699, prot., datë 18.03.2022, nga ZVAP Vorë është kërkuar caktimi i një përfaqësuesi nga njësia e vetëqeverisjes vendore, me shkresën nr. 247/2, datë 31.03.2022. Me shkresën nr. 1639/1 datë 01.04.2022, Bashkia Vorë ka kthyer përgjigje, sipas së cilës ka caktuar përfaqësuese znj. E.P.

Me shkresën nr. 286 prot., datë 23.03.2022 gjimnazi "Isa Boletini" Vorë ka përcaktuar se komisioni i shqyrtimit të dosjeve për drejtues të IA përbëhet nga: M.S – Kryetare, mësuesi më i vjetër në gjimnaz; A.H – Anëtare; V.Th. – Anëtare; V.K – Anëtare

Nga auditimi rezulton se sipas procesverbalit të datës 23.03.2022 u zgjodhën në komision dy mësues, konkretisht znj. M. S si mësuesi më i vjetër në Institucion dhe znj. V.K mësues. Sipas këtij procesverbali të pranishëm në mbledhje kanë qenë 26 mësues nga 31 gjithsej. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur nuk evidentohet të jetë respektuar votimi i fshehtë, në kundërshtim

me Kreun I, pika C.3 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: "Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtar të komisionit 2 mësues të përzgjedhur me votim të fshehtë me shumicë të thjeshtë votash".
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP".
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote".
Me shkresën nr. 247/3, datë 31.03.2022 ZVAP Vorë ka njoftuar DRAP Durrës dhe përfaqësues të sindikatës, për pjesëmarrje të një përfaqësuesi me qëllim monitorimin dhe vëzhgimin e zbatimit të dispozitave të Udhëzimit të MASR gjatë procesit në datë 06.04.2022.
Me anë të Urdhrit nr. 52, datë 06.04.2022, Drejtori i ZVAP Vorë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtor të gjimnazit "Isa Boletini", si më poshtë: E.P – përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, anëtar
A.H – Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor, anëtar
V.Th – Kryetar i Këshillit të Prindërve, anëtar
M.S – Mësuesi më i vjetër në Institucion, kryetar komisioni
V.K – mësues (anëtar)
Më datë 06.04.2022 është mbajtur procesverbal pranë gjimnazit "Isa Boletini", për përzgjedhjen e një anëtari të ri, mësues si përfaqësues i Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve, duke qenë se znj. M.S nuk është paraqitur në punë për arsye shëndetësore. Bashkëlidhur janë emrat me firmë të mësuesve që kanë votuar por nuk ka evidencë që të vërtetojë respektimin e procedurës në drejtim të votimit të fshehtë.
Me urdhrin nr. 53, datë 06.04.2022 (dy ditë më vonë) Drejtori i ZVAP Vorë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtor të gjimnazit "Isa Boletini, si më poshtë:
E.P – përfaqësues i njësisë së vetëqeverisjes vendore, anëtar
A.H – Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor, anëtar
V.Th – Kryetar i Këshillit të Prindërve, anëtar
V.K– Mësuesi më i vjetër në Institucion, kryetar komisioni
E.Sh – mësues (anëtar)
Nga auditimi konstatohet se nuk disponohet një procesverbal i mbajtur në ambientet e ZVAP Vorë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT-it, për pozicionin e drejtorit të gjimnazit "Isa Boletini" Vorë.
Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit në datë 06.04.2022, kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në përputhje të germës c, pikës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Nga auditimi konstatohet se me shkresën nr. 296/8 prot., datë 21.04.2022 është mbajtur vendimi "Për kodet e konkurrentëve për drejtues në gjimnazin "Isa Boletini" Vorë, ku konkretisht me kodin 01 kandidati z. K.F është vlerësuar me 28 pikë, znj. S.J me 22.8 pikë dhe znj. V.K me 37.6 pikë, pikë dosje se bashku me pikët e intervistës.
Me shkresën nr. 296/9 prot., datë 21.04.2022 është bërë dhe shpallja e pikëve për secilin aplikant, duke u lënë afat 3 ditor për ankimim nga data e shpalljes.

Në datën 20.04.2022 është mbajtur procesverbali në lidhje me pikën e intervistës ku kandidatët janë vlerësuar individualisht nga secili anëtar i komisionit të intervistës, në përputhje me Kreun I, shkronjën C, pikën 10.e ku citohet se: ".çdo anëtar i komisionit e vlerëson intervistën me 10 pikë". Konstatohet se në vlerësim ka munguar anëtari i komisionit znj. A.H dhe znj. E.P, përfaqësuese e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Kryetari i Bordit të shkollës.
Konstatohet se mungon një procesverbal në lidhje me përgjigjet e dhëna nga kandidatët gjatë fazës së intervistës me gojë.
Gjithashtu nga komisioni i vlerësimit nuk është mbajtur një procesverbal miratimi i pyetjeve që do të përdoren në intervistë për kandidatët.
Nga auditimi konstatohet se ZVAP Vorë me shkresë nr. 247/8 prot., datë 04.05.2022 ka përcjellë në DRAP Durrës dokumentacionin e dy aplikantëve me më shumë pikë, konkretisht znj. V.K me 37.6 pikë dhe z. K.F me 28 pikë.
Me shkresën nr. 1658/1 prot., datë 18.07.2022 DRAP Durrës ka kthyer përgjigje ZVAP Vorë në lidhje me këtë procedurë, ku citohet se: "…Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se në procesverbalin e datës 20.04.2022, mbi organizimin e intervistës së strukturuar mungojnë Kryetari i Bordit të shkollës dhe përfaqësuesi i Bashkisë. Në pikën c "Komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin e Drejtorit të IPAP-së, pika 9 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar",* citohet: Anëtari i komisionit që mungon ose që është konflikt interesi me aplikantin, zëvendësohet. Zëvendësimi kryhet brenda një ditë pune nga titullari i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, për anëtarin e zgjedhur prej tij, bordi i IPAP; këshilli i prindërve të IPAP ose Këshilli i Prindërve të IPAP ose Këshilli i Mësuesve, për anëtarët e zgjedhur prej tyre.

Në këto kushte DRAP Durrës ka vendosur rihapjen e procedurës, me shkresën nr. 2002, datë 23.08.2022.
Nga ZVAP Vorë është zhvilluar procedura si në vijim:
Nga bashkia Vorë është përcjellë me shkresën nr. 4899/3, datë 06.09.2022, përfaqësuesi znj. A.K
Më datë 06.09.2022 është mbajtur procesverbal pranë gjimnazit "Isa Boletini", për përzgjedhjen e mësuesve si përfaqësues të Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve. Nga auditimi konstatohet se nuk ka evidencë që të vërtetojë respektimin e procedurës në drejtim të votimit të fshehtë.
Janë përzgjedhur z. E.N dhe z. E.Sh.
Kryetare e Bordit të prindërve është caktuar znj. A.H Me shkresën nr. 754/2 prot., datë 02.09.2022 ZVAP Vorë ka kërkuar caktimin e një përfaqësuesi nga sindikata.
Me urdhrin nr. 115, datë 07.09.2022 është caktuar komisioni i vlerësimit si në vijim:
- znj. A.K përfaqësues i njësisë bazë të qeverisjes vendore Anëtar
- znj. A.H Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor Anëtar
- znj. V.Th Kryetar i Këshillit të Prindërve Anëtar
- z. E.N mësuesi më i vjetër në institucion Kryetar
- z. E.Sh mësues Anëtar.

Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit në datë 08.09.2022, kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në përputhje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Në datën 08.09.2022 është mbajtur procesverbali për marrjen në dorëzim të 4 dosjeve, për dy nga të cilat kanë lënë afat plotësim dokumentacioni deri në datën 12.09.2022. Në mbledhjen e datës

13.09.2022 është mbajt procesverbali për kandidatët që kalojnë fazën e vlerësimit paraprak, konkretisht 2 kandidatët znj. S.J dhe znj. V.K.
Në datën 19.09.2022 është bërë vlerësimi përfundimtar i dosjeve dhe është zhvilluar intervista, me të njëjtat pyetje për të dy kandidatët. Konstatohet se nuk është mbajtur një procesverbal ku të dokumentohen përgjigjet e kandidateve.
Në datën 19.09.2022 është bërë shpallja e pikëve dhe ZVAP Vorë me shkresën nr. 754/3 prot., datë 26.09.2022 ka mbajtur procesverbalin për 2 kandidatët me më shumë pikë, konkretisht znj. V.K me 37.7 pikë dhe S.J me 22.9 pikë.
Nga ZVAP Vorë janë përcjellë në DRAP dosjet e dy kandidateve të mësipërme me shkresën nr. 754/4, datë 26.09.2022.
Konstatohet se intervista nga DRAP është zhvilluar në datën 21.10.2022, jashtë afatit të përcaktuar në Kreun I, pika D.3 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 ku citohet se: Drejtori i DRAP brenda 5 ditëve pune nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP interviston 2 kandidatët.
DRAP Durrës me vendimin nr. 219, datë 24.10.2022 ka shpallur fitues znj. S.J në pozicionin e drejtuesit të shkollës 9-vjeçare "Isa Boletini", Vorë, edhe pse evidentohet një diferencë e konsiderueshme në pikë krahasuar me znj. V.K.
Nga auditimi konstatohet se është përgatitur një relacion përmbledhës nga ZVAP Vorë ku konfirmohet se procedura e ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të gjimnazit "Isa Boletini", duke nisur nga publikimi i Shpalljes deri në dorëzimin e dosjeve nga Kryetari i Komisionit, Drejtorit të ZVAP Vorë është konform kuadrit ligjor në fuqi.

2.3.9.4 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve në IPAP nën juridiksionin e ZVAP Kavajë

DRAP Durrës me shkresën nr. 699, datë 18.03.2022 ka bërë shpalljen e vendeve të lira për drejtor të shkollave:
- 9 vjeçare "3 Dëshmorët";
- 9 vjeçare "Golem";
- 9 vjeçare "Herbert";
- 9 vjeçare "Bago".

ZVAP Kavajë me shkresat nr. 243, datë 24.03.2022, nr. 244, datë 24.03.2022, nr. 245, datë 24.03.2022 dhe nr. 246, datë 24.03.2022 i ka kërkuar bashkisë Kavajë të caktojë 1 përfaqësues për të marrë pjesë në Komisionet e Vlerësimit të Dosjeve për secilën shkollë. Rezulton se bashkia Kavajë nuk ka kthyer përgjigje dhe nuk ka caktuar përfaqësues, duke sjellë si pasojë mos ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve dhe anulimi të procedurave të konkurrimit për të 4 shkollat e mësipërme.

Shkolla 9 vjeçare "Sadi Tatani"

Pas shpalljes nr. 46/1, datë 08.01.2024, ZVAP Kavajë me shkresën nr. 46, datë 09.01.2024 ka kërkuar caktimin e përfaqësuesit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për komisionin e vlerësimit të drejtorit, brenda datës 15.01.2024.
Sipas shkresës nr. 160/1, datë 16.01.2024, z. A.M është caktuar përfaqësues i bashkisë Kavajë.
Referuar procesverbalit nr. 21, datë 11.01.2024, të mbajtur në shkollën 9 vjeçare "Sadi Tatani" është zhvilluar votimi për zgjedhjen e anëtareve për komisionin e përzgjedhjes së drejtorit të institucionit. Në votim morën pjesë 8 mësues nga 11 mësues, ku janë zgjedhur për të marr pjesë në komisioni B. H. dhe znj. N.K, e cila është edhe mësuesja më e vjetër. Konstatohet së në procesverbalin e mbajtur nga shkolla nuk përcaktohet se sa vota ka marrë secili mësues, gjithashtu

fletët e votimit bashkëlidhur procesverbalit rezultojnë të paplotësuara. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me neni 4, pika 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar" ku citohet se: *"Këshilli i mësuesve të IPAP-së zgjedh si anëtarë të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash".*

Me shkresën nr. 22, datë 11.01.2024 është informuar ZVAP Kavajë se Kryetar i Këshillit të prindërve është znj. H.C, ndërsa Kryetar i Bordit të shkollës është znj. L.S.

ZVAP Kavajë, me shkresën nr. 163, datë 19.01.2024 ka njoftuar Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës si dhe Sindikatën e Pavarur për Arsimit të Shqipërisë se në ambientet e shkollës 9 vjeçare "3 Dëshmorët", në datat 30 dhe 31, prej orës 8 deri në orën 14, do të zhvillohen mbledhjet e komisioneve për vlerësimin e dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor, sipas listës bashkëlidhur.

SPASH ka caktuar z. A.D si personin përfaqësues. Komisionet e vlerësimit, në procesverbalet e mbajtura nuk shprehen nëse përfaqësues të sindikatave kanë marrë pjesë.

Drejtori i ZVAT Kavajë ka nxjerrë urdhrin nr. 13, datë 16.01.2024, sipas të cilit komisioni i shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve për pozicionin drejtor të shkollës 9 vjeçare "Sadi Tatani", përbehet si më poshtë:

Znj. N.K, mësues – Kryetar

Z. B.H mësues – Anëtar

Z. A.M, përfaqësues i njësisë bazë të vetëqeverisjes – Anëtar

Znj. M.C, përfaqësues i ZVAT – Anëtar

Znj. L. S, kryetar i bordit – Anëtar

Znj. H.C, –kryetar këshillit të prindërve – Anëtar

Me urdhrin nr. 20, datë 29.01.2024 është zëvendësuar përfaqësuesi i ZVAP Kavajë, duke u caktuar përfaqësues znj. E.M.

Më datë 23.01.2024, komisioni ka mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim të 5 dosjeve. Po më datë 23.01.2024 anëtarët kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit, në përputhje me pikën 4, neni 4 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023.

Në datën 22.01.2024, komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin paraprak për 5 kandidatë dhe për të 5 kandidatët ka lënë afat deri më datë 29.01.2024 për plotësimin e dokumentacionit. Sipas procesverbali të datës 29.01.2024, komisioni ka kualifikuar të gjithë aplikantët.

Rezulton se intervistat është zhvilluar në ambientet e shkollës 9 vjeçare "3 Dëshmorët", Kavajë, jo në përputhje me neni 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22 datë 13.11.2023, ku citohet se: *" Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së ose të ZVAP-së.*"

Referuar procesverbaleve të intervistave rezulton se komisioni nuk ka shënuar përgjigjet e dhëna nga aplikantët por vetëm pikët e vendosura për secilën pyetje.

Më datë 31.01.2024 komisioni ka përpiluar tabelën e rezultateve, si në vijim:

- E.A 37.4 pikë (27.4 pikë dosja + 10 pikë intervista);
- Sh.Ç 34.4 pikë (24.4 pikë dosja + 10 pikë intervista).

Ndërsa aplikantët e tjerë janë s' kualifikuar për shkak të mos paraqitjes në intervistë.

Drejtori i ZVAP Kavajë me shkresën nr. 336/1, datë 08.02.2024 i ka dërguar DRAP Durrës informacion dhe dokumentacioni për 2 kandidatët me më shumë pikë.

Drejtori i DARP Durrës, më datën 20.02.2024 ka zhvilluar intervistat me të dy kandidatët, jashtë afatit të përcaktuar në nenin 6, pikë 3 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023, ku citohet se: *"Titullari*

i DRAP brenda 5 ditëve punë nga dorëzimi i dokumentacionit nga ZVAP, interviston 2 kandidatët".

Drejtori i DRAP Durrës ka nxjerr urdhrin nr. 33, datë 21.02.2024, për shpalljen fitues të znj. E.A, për pozicionin e drejtuesit të IPAP "Sadi Tatani".

Shkolla 9 vjeçare "Herbert"

Pas shpalljes nr. 46/1, prot., datë 08.01.2024, nga ana e Drejtorit të ZVAP-së është bërë kërkesa drejtuar Bashkisë Kavajë për caktimin e një përfaqësuesi si anëtar i vetëqeverisjes vendore, Brenda datës 15.01.2024. Nga Bashkia Kavajë është caktuar përfaqësues z. A.M me shkresën nr. 160/1 prot., datë 16.01.2024.

Me shkresën nr. 233 prot., datë 10.01.2024 shkolla e mesme 9 vjeçare ka përcaktuar se komisioni i shqyrtimit të dosjeve për drejtues të IA përbëhet nga:

A.Sh – mësuesi më i vjetër në Institucion

M.C - mësues

Nga auditimi rezulton se ka një procesverbal të mbajtur në shkollë për zhvillimin e votimit të fshehtë në lidhje përzgjedhjen e dy mësuesve, konkretisht procesverbali i datës 10.01.2024 në përputhje me Kreun I, pika C.3 ku citohet se: Këshilli i mësuesve të IPAP zgjedh si anëtar të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash dhe nuk është përcaktuar përfaqësimi i secilit anëtar.

Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP".

Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote".

Nga dosja e vënë në dispozicion, konstatohet se nga shkolla 9 vjeçare "Herbert" i është dërguar ZVAP Kavajë me shkresën nr. 234, datë 10.01.2024 miratimi i komisionit të vlerësimit të kandidatëve për drejtues shkolle si në vijim:

- Sh.V Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor (Anëtar)
- M.R Kryetar i Këshillit të Prindërve (Anëtar)
- A.Sh mësuesi më i vjetër në Institucion (Kryetar)
- M.C Mësues (Anëtar).

Me anë të Urdhrit nr. 12, datë 16.01.2024, Drejtori i ZVAP Kavajë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës 9 vjeçare "Herbert" si më poshtë:

A.Sh mësuese Kryetar

M.C Anëtar

A.M përfaqësues i njësisë bazë të vetqëverisjes Anëtar

Sh.V Kryetare Bordi

M.R Kryetar i Këshillit të Prindërve

Nga auditimi konstatohet se disponohet një procesverbal i mbajtur në ambientet e ZVAP Kavajë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT-it, për pozicionin e drejtorit të shkollës 9 vjeçare "Herbert", konkretisht procesverbali i datës 23.01.2024. Sipas këtij procesverbali janë marrë në shqyrtim 7 dosje/aplikime, nga të cilat 2 të ardhura me shërbim postar dhe 5 në rrugë elektronike.

Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në datë 23.01.2024, përputhje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për

procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Me email-in e datës 24.01.2024 janë lajmëruar kandidatët për plotësim dokumentacion brenda 3 ditë pune.
Sipas email-it të datës 30.01.2024 ZVA Kavajë ka njoftuar kandidatët për të zhvilluar intervistën me gojë, datë 31.01.2024, ora 13.30 në shkollën 9 vjeçare "3 Dëshmorët", jo në përputhje me nenin 4, pika 6 e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 ku citohet se: "Komisioni mblidhet në mjediset e IPAP-së pse të ZVAP-së…"
Në vijim nga komisioni janë shqyrtuar dosjet dhe në datë 31.01.2024 është paraqitur tabela e rezultateve totale për 3 kandidatë, pasi 4 janë s'kualifikuar për mosplotësim dokumentacioni, si në vijim:
z. Z.E 35.8 pikë (25.8 pikë nga dosja dhe 10 pikë nga intervista)
znj. B.M 26.6 pikë (17.1 pikë nga dosja dhe 9.5 pikë nga intervista
znj. Dh.Sh 24.1 pikë (20.1 pikë nga dosja dhe 4 pikë nga intervista).
Nga auditimi rezulton se komisioni nuk ka mbajtur procesverbal në lidhje me përgjigjet e dhëna nga aplikantët por vetëm pikët e vendosura nga secili anëtar komisioni.
DRAP Durrës me vendimin nr. 82, datë 19.03.2024 ka shpallur fitues z. Z.E në pozicionin e drejtuesit të shkollës 9 vjeçare "Herbert".
Nga auditimi konstatohet se nga juristi i ZVAP Kavajë është përgatitur një relacion përmbledhës me shkresën nr. 330 prot., datë 08.02.2024, sipas të cilit nuk janë vërejtur shkelje proceduriale apo teknike të procesit dhe i janë përcjellë Drejtorit të ZVAP Kavajë, dy aplikantët me më shumë pikë nga faza e parë e konkurrimit, konkretisht: z. Z.E me 35.8 pikë dhe znj. B.M me 26.6. pikë.

2.3.9.5 Mbi procedurat e konkurrimit për zgjedhjen e drejtuesve në IPAP nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë

Shkolla e mesme e bashkuar "Gosë"

Pas shpalljes nr. 4, prot., nr. 2232, datë 20.09.2022, përfaqësues i bashkisë është caktuar z. F M
Me shkresën nr. 45 prot., datë 04.10.2022 shkolla e mesme e bashkuar "Gosë" ka përcaktuar se komisioni i shqyrtimit të dosjeve për drejtues të IA përbëhet nga:
Y.I - Kryetare
M.H – Anëtare
D.S – Anëtare
V.T – Anëtare
Nga auditimi rezulton se nuk ka një procesverbal të mbajtur në shkollë për zhvillimin e votimit të fshehtë në lidhje përzgjedhjen e dy mësuesve, në kundërshtim me Kreun I, pika C.3 ku citohet se: Këshilli i mësuesve të IPAP zgjedh si anëtar të Komisionit dy mësues, të përzgjedhur me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash dhe nuk është përcaktuar përfaqësimi i secilit antëar.
Kreu I, pika C.6 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "ZVAP njofton zyrtarisht për kohën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes së Komisionit dhe për pjesëmarrjen në të, të një përfaqësuesi të DPAP/DRAP".
Kreu I, pika C.7 e Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 përcakton se: "Në mbledhjet e Komisionit ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të sindikatave të mësuesve, të cilat kanë nënshkruar kontratën kolektive me ministrinë përgjegjëse për arsimin, pa të drejtë vote".
Nga dosja e vënë në dispozicion, konstatohet se ZVAP Rrogozhinë nuk ka njoftuar DRAP dhe as përfaqësues të sindikatave, në kundërshtim me pikën C.6 dhe C.7 të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020.

Me anë të Urdhrit nr. 47, datë 04.10.202, Drejtori i ZVAP Rrogozhinë urdhëron ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve për drejtor të shkollës të mesme të bashkuar "Gosë", si më poshtë:
Y.I mësuesi më i vjetër në Institucion - Kryetar Komisioni
M.H mësues – anëtar
F.M. përfaqësues i Njësisë Bazë të Qeverisjes Vendore - Anëtar
V.T Kryetar i Bordit të Institucionit Arsimor – Anëtar
D.S Kryetari i Këshillit të Prindërve – Anëtar
Nga auditimi konstatohet se nuk disponohet një procesverbal i mbajtur në ambientet e ZVAP Rrogozhinë ndërmjet sekretares së ZVAP dhe Komisionit të Vlerësimit, mbi dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të dokumentacionit të paraqitur nga aplikatët/kandidatët që dorëzojnë dokumentacionin e tyre pranë sekretarisë së ZVAT-it, për pozicionin e drejtorit të shkollës së bashkuar "Gosë".
Anëtarët dhe Kryetari i Komisionit të Vlerësimit kanë firmosur deklaratat e konfliktit të interesit në përputhje të gërmës c, pikës 5, të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar", sipas të cilave nuk janë në konflikt.
Nga auditimi konstatohet se me shkresën **nr. 586 prot., datë 11.10.2022** është mbajtur vendimi "Për kodet e konkurrentëve për drejtues në shkollën e mesme të bashkuar Gosë", ku konkretisht me kodin 01 kandidati F.Th është vlerësuar me pikë totale 26.9 pikë dhe kandidati R.M me kodin 02 është vlerësuar me 25.3 pikë totale.
Konstatohet se ky vendim është marrë para mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së komisionit të vlerësimit të kandidatëve. Konkretisht komisioni për vlerësimin e kandidatëve për drejtues të IAP mban datën **13.10.2022, k**u kandidatët janë vlerësuar si në vijim:
Znj. F.Th 17.9 pikë dosja dhe 9 pikë intervista – Total 26.9 pikë
Znj. R.M 17.3 pikë dosja dhe 8 pikë intervista – Total 25.3 pikë
Konstatohet se procesverbali i mbajtur në lidhje me pikën e intervistës nuk ka datë dhe kandidatët nuk janë vlerësuar individualisht nga secili anëtar i komisionit të intervistës, në kundërshtim me Kreun I, shkronjën C, pikën 10.e ku citohet se: ".cdo anëtar i komisionit e vlerëson intervistën me 10 pikë".
Gjithashtu nga komisioni i vlerësimit nuk është mbajtur një procesverbali miratimi i pyetjeve që do të përdoren në intervistë për kandidatët. Nga auditimi konstatohet se pyetjet nuk kanë lidhje me njohuritë e fushës me qëllim që të jenë të matshme dhe konkrete por janë të përgjithshme duke lënë hapësirë në lidhje me vlerësimin kundrejt përgjigjeve.
Konkretisht pyetjet e intervistës paraqiten si në vijim:
- Cili është vizioni juaj për shkollën?
- Çfarë ndryshimi do të sillni në këtë shkollë?
- Cilat janë pikat tuaja më të forta?
- Strategjia që do të përdorni ju për mirë menaxhimin e procesit mësimor-edukativ?
- Si do të organizoni punën dhe cilat janë hapat që do të ndërmerrni në realizimin e projektit gjithëpërfshirës "Një ditë në jetën time si…".
Në datën 14.10.2022 nga kandidatja znj. R.M është paraqitur në ZVAP Rrogozhinë ankesë në lidhje me pikëzimin e dosjes për drejtor.
Në datën 17.10.2022 komisioni ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit, ku kandidatja znj. R.M është vlerësuar në total me 25.4 pikë, konkretisht 0.1 pikë më shumë nga vlerësimi i kaluar. Ndryshimi i vlerësimit është bërë për vjetërsinë në punë, konkretisht nga 4.9 pikë në 5 pikë.

Po në këtë datë nga ana e Komisionit i është dërguar Drejtorit të ZVAP Rrogozhinë, dokumentacioni i dy aplikantëve me më shumë pikë, konkretisht i dy kandidateve të mësipërme.
Me urdhrin nr. 52, datë 18.10.2022 nga Drejtori i ZVAP Rrogozhinë z. L.Sh është ngritur komisioni "Për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatit për konkurrimin për Drejtor për shkollën e mesme të bashkuar Gosë", pa argumentuar arsyen, apo në mungesë të një relacioni, ankesë nga komisioni i vlerësimit ose nga kandidatët. Ky veprim është në kundërshtim me Kreun I të pikës D.1 të Udhëzimit nr. 2 sipas të cilës: "Sektori i Shërbimeve në ZVAP, ose një punonjës i autorizuar nga drejtori i ZVAP, shqyrton dokumentacionin e Komisionit dhe e kthen atë, vetëm nëse konstaton parregullsi të natyrës teknike".
Komisioni i shqyrtimit:
- L.Sh Drejtor – Kryetar
- D.T P/SMKZHP – Anëtar
- G .B Spec.SMKZHP – Anëtar.

Me shkresën nr. 600 prot., datë 18.10.2022 ky komision pas shqyrtimit ka vlerësuar si në vijim:
znj. F.Th 25.9 pikë
znj. R.M 25.4 pikë.
Konstatohet se kandidates F.Th i është ulur 1 pikë pa argumentuar në cilën kategori të vlerësimit dhe arsyen përse.
Nga auditimi konstatohet se mungon shkresa e dorëzimit/përcjelljes së dokumentacionit të kandidatëve me më shumë pikë në DRAP Durrës.
Konstatohet se intervista është zhvilluar në datën 02.11.2022.
DRAP Durrës me vendimin nr. 250, datë 03.11.2022 ka shpallur fitues znj. R.M në pozicionin e drejtuesit të shkollës së mesme të bashkuar "Gosë".
Nga auditimi konstatohet se nuk është përgatitur një relacion përmbledhës në të cilën të jetë përshkrua procedura e ndjekur për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës së mesme të bashkuar "Gosë", duke nisur nga publikimi i Shpalljes deri në dorëzimin e dosjeve nga Kryetari i Komisionit, Drejtorit të ZVAP Rrogozhinë.

2.3.10 Mbi vonesat në daljen e portalit "Mësues për Shqipërinë 2024"
Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 4072 datë 25.06.2024 ka nxjerrë njoftimin për fillimin e procedurave të konkurrimit në portalin "Mësues për Shqipërinë 2024", me afat aplikimi 04.07.2024 deri më 19.07.2024.
I gjithë procesi i aplikimit dhe vlerësimit të dosjeve në drejtoritë rajonale duhet të përfundonte deri më 31.07.2024, ku pas këtij afati QSHA duhet të hartonte kalendarin e provimeve, i cili duhet të mbyllej me 25.08.2024 dhe lista përfundimtare e kandidatëve së bashku me renditjen të përfundonte brenda datës 4 Shtator.
Pavarësisht afateve të vendosura nga MAS, QSHA në kalendarin e publikuar me nr. 3354 datë 06.08.2024, ka filluar provimet me datë 12 gusht, në 2 profile Shkenca Sociale dhe Biologji dhe pas 9 ditësh kanë rifilluar provimet në profilet e tjera. Provimet kanë përfunduar më datën 19 shtator, ndërkohë që viti shkollor 2024-2025 ka filluar më datën 09 shtator.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

Nr. 3354 Prot. Tiranë, më 06.08.2024

ORGANIZIMI I TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË MËSUESIT (PORTALI I MËSUESIT 2024)

E hënë 12.08.2024	E martë 13.08.2024	E mërkurë 14.08.2024	E enjte 15.08.2024	E premte 16.08.2024	E shtunë 17.08.2024
08:30 Shkenca Sociale	08:30 Biologji				
10:30 Shkenca Sociale	10:30 Biologji				
12:30 Biologji	12:30 Biologji				
14:30 Biologji	14:30 Biologji				
E hënë 19.08.2024	**E martë 20.08.2024**	**E mërkurë 21.08.2024**	**E enjte 22.08.2024**	**E premte 23.08.2024**	**E shtunë 24.08.2024**
		Mesuesi Per Mesuesin			08:30 Gjuhë Italiane
					10:30 Gjuhë Italiane
					12:30 Arsim Fillor
					14:30 Arsim Fillor
E hënë 26.08.2024	**E martë 27.08.2024**	**E mërkurë 28.08.2024**	**E enjte 29.08.2024**	**E premte 30.08.2024**	**E shtunë 31.08.2024**
08:30 Arsim Fillor	08:30 Arsim Fillor	08:30 Arsim Fillor	08:30 Gjuhë Frënge	08:30 Gjuhë Shqipe	08:30 Gjuhë Shqipe
10:30 Arsim Fillor	10:30 Arsim Fillor	10:30 Arsim Fillor	10:30 Gjuhë Frënge	10:30 Gjuhë Shqipe	10:30 Gjuhë Shqipe
12:30 Arsim Fillor	12:30 Arsim Fillor	12:30 Arsim Fillor	12:30 Gjuhë Shqipe	12:30 Gjuhë Shqipe	12:30 Gjuhë Shqipe
14:30 Arsim Fillor	14:30 Arsim Fillor	14:30 Gjuhë Gjermane	14:30 Gjuhë Shqipe	14:30 Gjuhë Shqipe	14:30 Gjuhë Shqipe
E hënë 02.09.2024	**E martë 03.09.2024**	**E mërkurë 04.09.2024**	**E enjte 05.09.2024**	**E premte 06.09.2024**	**E shtunë 07.09.2024**
08:30 Gjuhë Shqipe	08:30 Histori	08:30 Histori		08:30 Edukim Fizik	08:30 Edukim Fizik
10:30 Gjuhë Shqipe	10:30 Histori	10:30 Histori		10:30 Edukim Fizik	10:30 Edukim Fizik
12:30 Gjuhë Shqipe	12:30 Histori	12:30 Arsim Special		12:30 Edukim Fizik	12:30 Fizike
14:30 TIK	14:30 Histori	14:30 Arsim Special		14:30 Edukim Fizik	14:30 Fizike
E hënë 09.09.2024	**E martë 10.09.2024**	**E mërkurë 11.09.2024**	**E enjte 12.09.2024**	**E premte 13.09.2024**	**E shtunë 14.09.2024**
08:30 Arsim Parashkollor	08:30 Arsim Parashkollor	08:30 Arsim Parashkollor	08:30 Gjuhë Angleze	08:30 Gjuhë Angleze	08:30 Gjuhë Angleze/ Gjuhë Greke
10:30 Arsim Parashkollor	10:30 Arsim Parashkollor	10:30 Arsim Parashkollor	10:30 Gjuhë Angleze	10:30 Gjuhë Angleze	10:30 Muzikë
12:30 Arsim Parashkollor	12:30 Arsim Parashkollor	12:30 Arsim Parashkollor	12:30 Gjuhë Angleze	12:30 Gjuhë Angleze	12:30 Muzikë Sh.a
14:30 Arsim Parashkollor	14:30 Arsim Parashkollor	14:30 Art Pamor/ Art Pamor Sh.a	14:30 Gjuhë Angleze	14:30 Gjuhë Angleze	
E hënë 16.09.2024	**E martë 17.09.2024**	**E mërkurë 18.09.2024**	**E enjte 19.09.2024**	**E premte 20.09.2024**	**E shtunë 21.09.2024**
08:30 Matematikë	08:30 Matematikë	08:30 Kimi	08:30 Gjeografi		
10:30 Matematikë	10:30 Matematikë	10:30 Kimi	10:30 Gjeografi		
12:30 Matematikë	12:30 Matematikë	12:30 Gjeografi	12:30 Gjeografi		
14:30 Matematikë	14:30 Kimi	14:30 Gjeografi			

AURORA BALLIU
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

DRAP Durrës, më datë 8 tetor ka dërguar renditja e portalit "Mësues për Shqipërinë 2024".
Kjo vonesë në daljen e Portalit penalizoi më së shumti kandidatët që ishin për herë të parë në Portalin, pasi vendet e lira u publikuan para fillimit të vitit shkollor, dhe këto vende u plotësuan me kandidatë të portalit Mësues për Shqipërinë 2023.
Konstatohet se pikërisht në këtë periudhë, u ndryshua udhëzimi nr. 8 me udhëzimin nr.19 datë 29.08.2024 ku ndër të tjera u shtua pika 5/1 në Kreu VII me këtë përmbajtje: *"Rezultatet e portalit Mësues për Shqipërinë, zbatohen sipas këtij udhëzimi deri në momentin që zëvendësohen nga rezultatet e portalit vijues"*

2.3.11 Problematika mbi bazën ligjore për praktikat profesionale

Sipas nenit 57, pika 5 "b" e ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mësuesi në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi të këtë kryer me sukses praktikën profesionale. Në këtë ligj nuk parashikohen rastet e mundshme të përjashtimit nga praktika.
Gjithashtu në nenin 8 të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, citohet se një kandidat fiton të drejtën për ushtrimin e profesionit pasi të ketë kryer praktikën profesionale. Në nenin 11, pika 6 e po këtij ligji, përcaktohen rastet kur një individ përjashtohet nga detyrimi i kryerjes së praktikës, konkretisht: nëse një individ provon se për një periudhë të caktuar dhe në përputhje me kriteret specifike të një profesioni të rregulluar, ka qenë i angazhuar në një veprimtari profesionale, brenda ose jashtë vendit, që i ka dhënë mundësi të përvetësojë një përvojë profesionale të mjaftueshme në fushën e këtij profesioni, përjashtohet nga detyrimi i kryerjes së praktikës.

Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 100, datë 25.02.2022 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, specifikohen rastet e përjashtimit nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale, konkretisht përjashtohet:
a) personi, i cili para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ka fituar diplomën e IAL-së në fushën e edukimit, ose diplomë të njëvlershme më të, si dhe e ka ushtruar profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të kohës;
b) personi që e ka kryer praktikën profesionale dhe ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar të mësuesit jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjorë në fuqi;
c) personi që ka kryer të paktën për një periudhe 3 mujore punë në një institucion arsimor dhe ka fituar diplomën sipas pikës 1 të këtij neni;
Ndërkohë në urdhrin e Ministritë të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 365, datë 28.12.2020 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimi e komisionit të provimit të shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit", i ndryshuar citohet se për tu regjistruar në provim, kandidati bën aplikimin online në Portalin Qeveritar e-Albania për regjistrimin në provimin e shtetit, pas diplomimit dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale. Në pikën 6 të po këtij neni përcaktohen kriteret që duhet të plotësojë një kandidat për t'iu nënshtruar provimit të shtetit të cilat janë:
a) përfundimi me sukses i programit të akredituar të studimeve të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë në një institucion të arsimit të lartë, duke shlyer të gjitha detyrimet për programin përkatës;
b) kryerjen me sukses të praktikës profesionale;
c) regjistrimin pranë Up-vë ose autoriteteve kompetente.
Për sa më sipër, dispozitat që rregullojnë praktikën profesionale dhe rastet e përjashtimit paraqiten të paqarta dhe jo plotësisht të harmonizuara ndërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, duke krijuar paqartësi dhe vështirësi në zbatimin praktik të tyre.

2.3.12 Mbi bazën ligjore të procesit të kualifikimit të mësuesve

Mësuesit e kualifikuar klasifikohen në tre kategori:
1. "Mësues i kualifikuar";
2. "Mësues specialist";
3. "Mësues mjeshtër".
Sipas nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe **pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit.**
Organizimi i procesit të kualifikimit, procedurat si dhe kriteret përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.
Sipas Udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2021 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", mësuesit për të kualifikuar **duhet të kalojnë me sukses provimin**, i cili organizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.
Në nenin 2 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 08.02.2023 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", citohet se: "*1. Procesi i kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë III "Mësues i kualifikuar" dhe të kategorisë II "Mësues specialist" kryhet nëpërmjet portofolit të zhvillimi profesional të mësuesve dhe provimeve me test sipas lëndëve/profileve dhe cikleve përkatëse.*

2. Procesi i kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë I "Mësues mjeshtër" kryhet nëpërmjet portofolit të zhvillimit profesional të mësuesve dhe provimit të realizuar me orë mësimore të hapur në lëndën/profilin dhe ciklin përkatës".
Pra në Udhëzimin nr. 2, datë 08.02.2023, mësuesit për të përfituar kategorinë e III "Mësues i kualifikuar" dhe kategorinë II "Mësues specialist", duhet të zhvillojnë provim me shkrim, ndërsa për të përfituar kategorinë e I "Mësues mjeshtër" **provimi do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të orës së hapur. Sipas këtij udhëzimi për kategorinë e I "Mësues mjeshtër", provim do të konsiderohet realizimi i orës së hapur dhe mësuesi nuk duhet të kalojë në procedurë testimi.**
Ndërsa në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 7, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", i ndryshuar, i cili është ende në fuqi, në nenin 2 të tij, përshkruhet organizimin i procesi i kualifikimit, konkretisht: *"1. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë "Mësues i kualifikuar" kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar, sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse.*
2. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë "Mësues specialist" kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.
3. Procesi i kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për kandidatët e kategorisë "Mësues mjeshtër" kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës".
Për të përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar" mësuesi duhet të zhvillohet edhe test i informatizuar; ndërsa për të përfituar kategorinë II "Mësues specialist" dhe kategorinë e I "Mësues mjeshtër", mësues duhet të realizojë një projekt kurrikular. Pra, sipas këtij udhëzimi për të përfituar kategorinë e II dhe I, mësuesi nuk duhet ti nënshtrohet testimit apo provimi.
Konstatohet se heqja e kriterit të realizimit të provimit për kategorinë e I "Mësues mjeshtër" në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 08.02.2023 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", për periudhën 11.03.2023 deri më 31.07.2024, bie në kundërshtim me pikën 2, neni 59 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
Gjithashtu heqja e kriterit për realizimin e provimin për kategorinë e II "Mësues specialist" dhe kategorinë e I "Mësues Mjeshtër", në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", bie në kundërshtim me nenin 59, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet se: "*Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe* ***pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit".***

2.3.12.1 Mbi procedurat e vlerësimit të dosjeve për kualifikim e mësuesve, ZVAP Tiranë
Drejtori i ZVAP Tiranë ka nxjerrë Vendimin nr. 6, datë 21.01.2025 "Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të dosjeve të mësuesve aplikantë për kualifikimin 2024-2025".
Nga auditimi me zgjedhje u konstatuan problematikat si në vijim:
- znj. S. B ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2016, duke pasur kredite vetëm në vitin 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar,

neni 6, pika 2, germa c/ii ku citohet se: *"70 kredite zhvillim profesional pas fitimit të kategorisë "Mësues specialist". Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% të krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilint që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar".*
Nga auditimi rezulton se deri në fund të vitit 2024 znj. S. B ka grumbulluar 30 kredite, duke mos plotësuar kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, gërma c/ii ku citohet se: Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës plotësojnë kushtet e mëposhtme: "…ii: 70 kredite zhvillim profesional….". Ndërsa në vitin 2025 ka marr 60 kredite.
Komisioni i vlerësimit: znj. E.P, znj. A.K dhe znj. K.Sh
- znj. A.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2016, duke patsur kredite vetëm në vitet 2019, 2024 dhe 2 kredite pa datë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. S.S, znj. E.K dhe znj. B.R
- znj. E.L ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2018, duke mos patur kredite në vitin 2020 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i
Komisioni i vlerësimit: znj. S S, znj. E K dhe znj. B.R
- znj. V.D ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, duke mos pasur kredite në vitin 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. S.S, znj. E.K. dhe znj. B.R
- znj. I.P ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke mos pasur kredite në vitin 2020 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. S.S, znj. E. K dhe znj. B.R
- znj. I.M ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", duke pasur kredite vetëm në vitin 2021, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii ku citohet se: *"30 kredite zhvillim profesional për 3 vite". Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% të krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar".*
Komisioni i vlerësimit: znj. S.S, znj. E. K dhe znj. B.R
- znj. Xh.B ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka përfituar kredite vetëm për vitin 2023 dhe 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. S.S, znj. E. K dhe znj. B.R

- znj. B.T ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka kredite vetëm në vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. A.N., znj. L.Gj, znj. R.K, znj. J.D, znj. D.K dhe znj. V.V.
- z. G.L ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka kredite vetëm në vitin 2023-2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. A.N., znj. L.Gj, znj. R.K, znj. J.D, znj. D.K dhe znj. V.V.
- znj. E.V ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", nuk ka kredite për vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii ku citohet se: *"30 kredite zhvillim profesional për 3 vite". Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite: të paktën 50% të krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar".*
Komisioni i vlerësimit: znj. A.N., znj. L.Gj, znj. R.K, znj. J.D, znj. D.K dhe znj. V.V.
- znj. M.M ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", nuk ka kredite për vitin 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. A.N., znj. L.Gj, znj. R.K, znj. J.D, znj. D.K dhe znj. V.V
- znj. G.P ka përfituar kategorinë e dytë "Mësues Specialist", pas kategorisë së tretë "Mësues i kualifikuar", të marrë në vitin 1999, duke pasur kredite vetëm në vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii, pasi rezulton me 40 kredite në 31.12.2024. Evidentohet se 10 kreditet e tjera i ka marrë në datën 31.01.2025.
Komisioni i vlerësimit: znj. A.N., znj. L.Gj, znj. R.K, znj. J.D, znj. D.K dhe znj. V.V.
- znj. V.Ll ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke mos pasur kredite në vitin 2019 dhe 2021 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. A. N., znj. L. Gj., znj. R K., znj. J D., znj. D. K dhe znj. V. V.
- znj. A.A ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, duke mos pasur kredite në vitin 2018, 2019, 2021 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii .
Komisioni i vlerësimit: znj. F.L, znj. E.T dhe znj. L.N
- znj. E.D ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, duke mos pasur kredite në vitin 2018 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. E.S, znj. M.C, znj. M.M, znj. T.D dhe znj. D. S
- z. G.T ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2016, duke mos pasur kredite në vitin 2019, 2020, 2022 dhe 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii
Komisioni i vlerësimit: znj. E.S, znj. M.C, znj. M.M, znj. T.D dhe znj. D. S

- znj. B.I ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke mos pasur kredite në vitin 2018, 2022 dhe 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. E.S, znj. M.C, znj. M.M, znj. T.D dhe znj. D. S
- znj. V.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke mos pasur kredite në vitin 2018, 2019 dhe 2021, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. F.T, znj. L.Xh., znj. E.N.
- z. S.S ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2007, duke pasur kredite vetëm në vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii ku citohet.
Komisioni i vlerësimit: znj. R.Xh, znj. A.M. dhe z. M.P
- znj. A.S ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke patur kredite vetëm në vitin 2015, 2018 dhe 2020, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: R.Xh, znj. M.B, znj. N.K., znj. J.V. dhe znj. F.M.
- znj. E.A, rezulton e punësuar prej datës 16.03.2006-31.12.2024 në Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Zyrën Vendore Tiranë. Prej datës 01.01.2025 rezulton specialiste në sektorin e Monitorimit dhe vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në DRAP Tiranë. Në vitin 2013 ka marr kategorinë e dytë "Mësues specialist" për profilin mësues biologjie. Konstatohet se në vitin 2025 ka përfituar kategorinë "Mësues Mjeshtër", pa punuar si mësuese, jo në përputhje me pikën 4 të nenit 6 të Udhëzimit nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" të ndryshuar, ku citohet se: Punonjësit e diplomuar në mësuesi që punojnë në Ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e varësisë mund të përfitojnë kategorinë përkatëse të kualifikimit nëse plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
Pika 2. c/i citon se: Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:
c) për kategorinë e kualifikimit "Mësues Mjeshtër"
i. 15 vjet pune si mësues nga të cilat 7 vjet pune pas fitimit të kategorisë si mësues specialist.
Komisioni i vlerësimit: R.Xh, znj. M.B, znj. N.K., znj. J.V. dhe znj. F.M.

2.3.12.2 Mbi procedurat e vlerësimit të dosjeve për kualifikim e mësuesve, ZVAP Kamëz

Drejtori i ZVAP Kamzë ka nxjerrë Vendimin nr. 16, datë 07.02.2025 "Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të dosjeve të mësuesve aplikantë për kualifikimin 2024-2025".
Nga auditimi me zgjedhje u konstatuan problematikat si në vijim:
- znj. V.N ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, pa përfituar kredite për vitin 2019, 2020, 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
Nga auditimi rezulton se deri në fund të vitit 2024 znj. V.N ka grumbulluar 50 kredite, duke mos plotësuar kriteret për kualifikim, në kundërshtim me nenin 6, pika 2, gërma c/ii ku citohet se:

Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit të cilët deri në 31 dhjetor të vitit paraardhës plotësojnë kushtet e mëposhtme: "…ii: 70 kredite zhvillim profesional….". Ndërsa në vitin 2025 rezulton me 70 kredite.

Komisioni i vlerësimit: znj. F.L, znj. L.Ll, znj. L.D

- znj. O.S ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2008, duke pasur kredite vetëm në vitet 2020, 2021 dhe 2024 kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Komisioni i vlerësimit: znj. E.B, znj. A.K, znj. L.A

- znj. N.D ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.

Komisioni i vlerësimit: znj. E.D, znj. A.C dhe znj. H.M.

- z. M.B ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka përfituar kredite për vitin 2019 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.

Komisioni i vlerësimit: z. I.L., znj. A.S dhe znj. L.Sh

- znj. A.H ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, ka marrë kredite për vitin 2018, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Komisioni i vlerësimit: z. I.L, znj. A.S dhe znj. L.Sh

- znj. O.C ka përfituar kategorinë e dytë "Mësues Specialist", pas kategorisë së tretë "Mësues i kualifikuar" duke pasur kredite vetëm në vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii ku citohet se: *"50 kredite zhvillim profesional pas fitimit të kategorisë "Mësues i kualifikuar".* ***Çdo vit mësuesi duhet të marrë 10 kredite:*** *të paktën 50% të krediteve të ZHVP-së duhet të jenë të lidhura me aspekte metodologjike të zbatuara në fushën/profilin që mbulon; të paktën 70% e krediteve të ZHVP-së duhet të jenë në aktivitete të drejtpërdrejta; 80% e krediteve totale të ZHVP-së duhet të jenë nga aktivitetet e akredituara në nivel kombëtar",* pasi rezulton me 40 kredite në 31.12.2024. Evidentohet se 10 kreditet e tjera i ka marrë në datën 31.01.2025.

Komisioni i vlerësimit: znj. E.C, znj. M.M dhe znj. V.K

- znj. A.Xh ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, nuk ka marr kredite për vitin 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Komisioni i vlerësimit: znj. E.B, znj. A.K dhe znj. L.A.

- znj. D.B ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka kredite vetëm në vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.

Komisioni i vlerësimit: znj. O.Gj, znj. M.M dhe znj. E.K.

- znj. E.P ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", ka kredite vetëm në vitin 2021 dhe 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.

Komisioni i vlerësimit: znj. V.S, znj. V.H dhe znj. A.Xh.

- znj. E.L ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, nuk ka pasur kredite në vitin 2019, 2020, 2022 dhe 2024 kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. D.P, z. A.Xh dhe znj. M.L.
- znj. Dh.V ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, nuk ka patur kredite në vitin 2020 dhe 2021, kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: z. I.L, znj. A.S dhe znj. L.Sh
- z. D.M ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa pasur kredite për vitin 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. Z.S, z. B.Sh dhe znj. E.Th
- znj. J.H ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, nuk ka patur kredite në vitin 2018, 2020, 2021, 2022 dhe 2023, dhe deri në 31.12.2024 në total rezulton me 50 kredite ndërkohë që 20 kredite i ka marr gjatë vitit 2025, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. E.D, znj. A.C dhe znj. H.M
- znj. F.Gj ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa pasur kredite për vitin 2023 dhe 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Komisioni i vlerësimit: znj. D.P, znj. A.Xh dhe znj. M.L.

2.3.12.3 Mbi procedurat e vlerësimit të dosjeve për kualifikim e mësuesve, ZVAP Vorë

Drejtori i ZVAP Vorë ka nxjerrë Vendimin nr. 12, datë 10.02.2025 "Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të dosjeve të mësuesve aplikantë për kualifikimin 2024-2025", me përbërje si në vijim:
- znj. E.P – Kryetare
- z. O.T – Anëtar
- z. E.D – Anëtar

Nga auditimi me zgjedhje u konstatuan problematikat si në vijim:
- znj. E.A ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, pa përfituar kredite për vitin 2017 2028, 2022, 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. E.D ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" pa përfituar kredite për vitin 2020, 2021 dhe 2022 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. M.Sh ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, pa përfituar kredite për vitin 2020, 2021 dhe 2022 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. E.N ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, pa përfituar kredite për vitin 2016, 2017, 2018, 2019, 2022, në kundërshtim

me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. D.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2012, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. D.Z ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa patur vitet e mjaftueshme eksperiencë si mësues pasi deri në 31.12.2024 rezulton me 2 vite e 4 muaj, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/i ku citohet se: *"Për kategorinë e kualifikimit mësues i kualifikuar duhen 3 vite pune si mësues".*
- znj. D.L ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", duke patur kredite vetëm për vitin 2021, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
- znj. E.B ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa patur kredite për vitin 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
- z. S.M ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa patur kredite për vitin 2021, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
- znj. M.S ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa patur kredite për vitin 2022 dhe 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
Gjithashtu nga auditimi konstatohet se znj. M.S ka përfunduar shkollën në vitin 2006 dhe është punësuar për herë të parë si mësuese më datë 22.02.2021 në shkollën "Mustafa Lleshi".
Me vendimin nr. 63 datë 23.04.2025 është emëruar si mësuese definitive në shkollën 9-vjecare "Ahmetaq", për lëndën "fizikë" nëpërmjet Portalit "Mësues për Shqipërinë". Nga auditimi rezulton se znj. **M.S nuk është e pajisur me licencën për ushtrimin e profesionit**, në kundërshtim me nenin 57, pika 5/b të ligjit nr. 69/12, datë 21.06.2012 "Për arsimin parauniversitar në RSH" i ndryshuar, ku citohet se: *"Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm, të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënës me aftësi të kufizuar dhe mësuesi me diploma të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin."*
b. të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij…".
- znj. S.K ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa patur kredite për vitin 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii. Gjithashtu rezulton se nuk ka pa patur vitet e eksperiencës si mësues, pasi në 31.12.2024 rezulton me 2 vite e 7 muaj në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/i ku citohet se: *"Për kategorinë e kualifikimit mësues i kualifikuar duhen 3 vite pune si mësues".*

2.3.12.4 Mbi procedurat e vlerësimit të dosjeve për kualifikim e mësuesve, ZVAP Kavajë

Drejtori i ZVAP Kavajë ka nxjerrë Urdhrin nr. 32, datë 10.02.2025 "Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të dosjeve të mësuesve aplikantë për kualifikimin 2024-2025", me përbërje si në vijim:
- znj. M.C – Kryetare

- znj. L.P - Anëtar
- znj. E.M – Anëtar

Nga auditimi me zgjedhje u konstatuan problematikat si në vijim:

- z. M.H ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2015, duke patur kredite vetëm në vitin 2021 dhe 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. R.C ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, pa patur kredite, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii. Nga auditimi u konstatua se ka marr 70 kredite në vitin 2025 konkretisht në datat: 04.02.2025, 05.02.2025, 06.02.2025, 07.02.2025, 08.02.2025. Për datën 05.02.2025 dhe 06.02.2025 rezulton me marrje kreditesh 2 herë, pra 40 kredite total për 2 ditë.
- znj. D.V ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, duke mos patur kredie për vitin 2023, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. E.H ka përfituar kategorinë e dytë "Mësues Specialist", pas kategorisë së tretë "Mësues i kualifikuar" të marrë në vitin 2019, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
- znj. F.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. M.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2018, 2022 dhe 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.

- znj. V.G ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2017, pa përfituar kredite për vitin 2018 dhe 2020, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. L.Sh ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2018, pa plotësuar kriterin e 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.
- znj. E.K ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2018 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.

- znj. M.A ka përfituar kategorinë e parë "Mësues Mjeshtër", pas kategorisë "Mësues specialist" të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2018 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin

nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.

2.3.12.5 Mbi procedurat e vlerësimit të dosjeve për kualifikim e mësuesve, ZVAP Rrogozhinë
Drejtori i ZVAP Rrogozhinë ka nxjerrë Vendimin nr. 9, datë 10.02.2025 “Për ngritjen e komisioneve të vlerësimit të dosjeve të mësuesve aplikantë për kualifikimin 2024-2025”, me përbërje si në vijim:
- znj. D.T – Kryetare
- z. E.K – Anëtar
- z. A.S – Anëtar
Nga auditimi me zgjedhje u konstatuan problematikat si në vijim:
- znj. E.T ka përfituar kategorinë e parë “Mësues Mjeshtër”, pas kategorisë “Mësues specialist” të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2023 dhe 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.
- znj. M.Q ka përfituar kategorinë e tretë “Mësues i kualifikuar”, pa përfituar kredite për vitin 2024 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
- znj. A.H ka përfituar kategorinë e parë “Mësues Mjeshtër”, pas kategorisë “Mësues specialist” të marrë në vitin 2016, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
- znj. B.Rr ka përfituar kategorinë e parë “Mësues Mjeshtër”, pas kategorisë “Mësues specialist” të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.
- znj. L.Ç ka përfituar kategorinë e dytë “Mësues Specialist”, pas kategorisë së tretë “Mësues i kualifikuar” të marrë në vitin 2019, pa përfituar kredite për vitin 2020, 2021 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
- znj. O.R ka përfituar kategorinë e parë “Mësues Mjeshtër”, pas kategorisë së dytë “Mësues Specialist” të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2020 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.
- z. E.Dh ka përfituar kategorinë e parë “Mësues Mjeshtër”, pas kategorisë së dytë “Mësues Specialist” të marrë në vitin 2018, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023, në
kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor” i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma c/ii.

Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me nenin 6, pika 2/c/i.
- znj. E.A ka përfituar kategorinë e tretë "Mësues i kualifikuar", pa përfituar kredite për vitin 2023 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma a/ii.
- z. D.A ka përfituar kategorinë e dytë "Mësues Specialist", pas kategorisë së tretë "Mësues i kualifikuar" të marrë në vitin 2020, pa përfituar kredite për vitin 2022 dhe 2023 në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor" i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
Nga auditimi u konstatua se nuk është plotësuar kriteri i 8 viteve punë, nga të cilat 5 vite si mësues i kualifikuar në kundërshtim me nenin 6, pika 2/b/i.

2.3.12 Mbi mësuesit e pa licencuar

Në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohen kriteret që duhen të plotësohen për tu punësuar si mësues, konkretisht:
1. Mësuesi për arsimin parashkollor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor", që formon mësues të arsimit parashkollor.
2. Mësuesi për arsimin fillor duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" dhe diplomë të ciklit të dytë "Master Profesional", që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike.
3. Mësuesi për arsimin e mesëm të ulët dhe për arsimin e mesëm të lartë duhet të ketë fituar diplomën e ciklit të parë "Bachelor" në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomën e ciklit të dytë "Master" me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë.
4. Profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuara në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar.
Diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzim të ministrit.
5. Mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi:
a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale;
b) të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
Referuar nenit 5, pika 1, gërma "g" të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 *"Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, me ligji nr. 10357, datë 16.12.2010, mësuesia është përfshirë te profesionet e rregulluar. Ky ndryshim ka hyrë në fuqi në datën 12 janar të vitit 2011 dhe sipas përcaktimit të tij, detyrohen që t'i nënshtrohen procedurës së licencimit të gjithë *personat të cilët në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë ushtruar profesionin e rregulluar të mësuesit.*

Pra të gjithë individët që punësohen si mësues pas datës 12 janar të vitit 2011 duhet të jenë të pajisur me licencë për ushtrimin e profesionit. Gjithashtu, personat të cilët kanë qenë të punësuar në arsim para datës 12 janar të vitit 2011, por që janë diplomuar në fushën e mësuesisë pas kësaj datë, kanë detyrimin ligjor për tu pajisur me licencë, për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Tiranë rezultojnë 221 mësues të pa licencuar.

Tabela: Mësues të pa licencuar, ZVAP Tiranë.

Nr.	ZVAP	Emri i Shkollës	Emër Mbiemër	Viti kur ka filluar punë	Regjistruar për provimin e licencës
1	Tiranë	26 Nëntori	R.Sh	25.01.2017	Po
2	Tiranë	28 Nëntori	Dh. P	2011	Jo
3	Tiranë	4 Deshmoret	G.Sh	13.09.2017	Po
4	Tiranë	4 Deshmoret	M. Xh	15.04.2011	Po
5	Tiranë	7 Marsi	A. B	2015	Jo
6	Tiranë	7 Marsi	E. A	2015	Po
7	Tiranë	7 Marsi	E. B	Mars 2011	Po
8	Tiranë	Abdulla Keta	L.H	25.09.2023	Po
9	Tiranë	Allgjatë	A. M.	2019	Po
10	Tiranë	Alush Bardhi	M. B	2012	Po
11	Tiranë	Alush Bardhi	V. B	2017	Po
12	Tiranë	Alush Bardhi	V. T	05 tetor 2011	Jo
13	Tiranë	Andon Zako Çajupi	K.M.	2012	Po
14	Tiranë	Andon Zako Çajupi	O.K	2015	Jo
15	Tiranë	Andrea Stefani	B. C	2014	Po
16	Tiranë	Androkli Kostallari	H. D	2012	Po
17	Tiranë	Androkli Kostallari	A.Ç	2019	Jo
18	Tiranë	Androkli Kostallari	Gj. P	2012	Jo
19	Tiranë	Arben Broci	E. B.	Janar 2015	Jo
20	Tiranë	Arben Broci	E. Zh	15.01.2015	Po
21	Tiranë	Ardian Klosi	A. K	2016	Po
22	Tiranë	Ardian Klosi	E.C	2018	Po
23	Tiranë	Asim Vokshi	E. S	2011	Po
24	Tiranë	Asim Vokshi	N. H	2011	Po
25	Tiranë	Asim Vokshi	A. V	2016	JO
26	Tiranë	Asim Vokshi	H.P	2017	JO
27	Tiranë	Asim Vokshi	E. SH	2024	JO
28	Tiranë	Asim Vokshi	D. B	2014	JO
29	Tiranë	Avni Rustemi	E. K	2015	Po
30	Tiranë	Avni Rustemi	L. M	2021	Po
31	Tiranë	Bahti Nela	B.K	2011	Po
32	Tiranë	Bajram Curri	A.C	2014	Po
33	Tiranë	Bajram Curri	A. S	2015	Po
34	Tiranë	Bajram Curri	M.J	2014	Jo
35	Tiranë	Bashkim Berisha	B. Q	2014	Po
36	Tiranë	Bashkim Fino	D. L	Shtator 2011	Po
37	Tiranë	Bashkim Fino	E. S	2015	Po
38	Tiranë	Bashkim Fino	R.K	2016	Po
39	Tiranë	Bedri Llagami	A. M	2015	Po
40	Tiranë	Bedri Llagami	E. M	2014	Po
41	Tiranë	Bedri Llagami	J. D	2018	Po
42	Tiranë	Bedri Llagami	A. B	2021	Po
43	Tiranë	Besnik Sykja	E. A	2014	Po
44	Tiranë	Besnik Sykja	Xh.S	2015	Po
45	Tiranë	Besnik Sykja	Xh. Xh	2014	Po
46	Tiranë	Besnik Sykja	A. B.	2015	Po
47	Tiranë	Betim Muço	M. H	2011	Po
48	Tiranë	Dëshmorët E Lirisë	A. D	2015	Po
49	Tiranë	Dëshmorët E Lirisë	D. S	2015	Po
50	Tiranë	Dëshmorët E Lirisë	S. Ç.	2015	Po
51	Tiranë	Dëshmorët E Lirisë	V. K.	2015	Po
52	Tiranë	Dhora Leka	F.Gj	16.10.2015	Po
53	Tiranë	Dora D'istria	G. H	2014	Po
54	Tiranë	Dora D'istria	M.Ç	2013	Po
55	Tiranë	Dora D'istria	M. J.(K)	2015	Po
56	Tiranë	Drita Pelinku	N. K	01.03.2012	Po

57	Tiranë	Drita Pelinku	R. P	01.12.2014	Jo
58	Tiranë	Dritas	E.D	2025	Po
59	Tiranë	Dritas	L. K.	2024	Po
60	Tiranë	E Kuqe	GJ. Sh	2014	Jo
61	Tiranë	E Kuqe	V. C	2014	Jo
62	Tiranë	E Kuqe	V. RR	2015	Po
63	Tiranë	Fan Noli	E.B	2014	Jo
64	Tiranë	Fan Noli	F. L	2014	Po
65	Tiranë	Fan Noli	N.S	2014	Po
66	Tiranë	Farke E Vogel	M. A	2015	Po
67	Tiranë	Farkë E Vogël	E. B	2021	Po
68	Tiranë	Farkë E Vogël	M. A.	2015	Po
69	Tiranë	Ferraj	A. K.	03.03.2013	Po
70	Tiranë	Ferraj	E. M	21. 09. 2020	Po
71	Tiranë	Feti Vogli	K. B.	03.10.2014	Po
72	Tiranë	Fushas	B. B	2020	Jo
73	Tiranë	Gjergj Fishta	E. R	2013	Jo
74	Tiranë	Hasan Prishtina	L.G	2015	Jo
75	Tiranë	Hasan Vogli	J. X.	2013	Po
76	Tiranë	Ibrahim Brahja	F. B.	2015	Po
77	Tiranë	Ibrahim Brahja	R.Rr.	2017	Po
78	Tiranë	Ibrahim Hasmema	O. S	2014	Po
79	Tiranë	Ibrahim Hima	D. M	2024	Po
80	Tiranë	Ibrahim Hima	D. H.	2015	Po
81	Tiranë	Jeronim De Rada	O. S	15.01.2015	Po
82	Tiranë	Jeronim De Rada	S. P	15.01.2015	Po
83	Tiranë	Jordan Misja	A. K.	2004	Jo
84	Tiranë	Jordan Misja	A. A	2009	Jo
85	Tiranë	Jordan Misja	A. S.	1994	Jo
86	Tiranë	Jordan Misja	A.T	2019	Jo
87	Tiranë	Jordan Misja	A. G	2021	Jo
88	Tiranë	Jordan Misja	E. M.	2019	Jo
89	Tiranë	Jordan Misja	G. Z	2014	Jo
90	Tiranë	Jordan Misja	I. M	2021	Jo
91	Tiranë	Jordan Misja	I. V	2015	Jo
92	Tiranë	Jordan Misja	K. T.	2009	Jo
93	Tiranë	Jordan Misja	S.H	2016	Jo
94	Tiranë	Jordan Misja	A. L.	2015	Jo
95	Tiranë	Kasem.Shima	E.A.	2014	Po
96	Tiranë	Katundi I Ri	I.C.	2015	Po
97	Tiranë	Klodian Tanushi	R. M.	2014	Po
98	Tiranë	Kolë Jakova	D. H	2024	Jo
99	Tiranë	Kolë Jakova	E.Xh.	2024	Po
100	Tiranë	Kolë Jakova	H. H.	2019	Po
101	Tiranë	Kolë Jakova	K.H	2025	Po
102	Tiranë	Kolë Jakova	M. B	2015	Po
103	Tiranë	Kolë Jakova	D. L	2014	Jo
104	Tiranë	Kolë Jakova	Sh.H	2014	Po
105	Tiranë	Kongresi I Lushnjes	J. S.	2017	Jo
106	Tiranë	Kongresi I Manastirit	B.M.	22.04.2014	Po
107	Tiranë	Kongresi I Manastirit	D.G	01.05.2014	Po
108	Tiranë	Kongresi I Manastirit	J.Th	23.11.2018	Po
109	Tiranë	Kongresi I Manastirit	M.M.	09.01.2026	Po
110	Tiranë	Kongresi I Manastirit	N. S.	16.09.2015	Po
111	Tiranë	Kongresi I Manastirit	S. A.	01.09.2012	Po
112	Tiranë	Koreografike	E.I.	2021	Po
113	Tiranë	Koreografike	G. Gj	01.02.2023	Po
114	Tiranë	Koreografike	G. I.	2017	Po
115	Tiranë	Koreografike	A. S	2018	Po
116	Tiranë	Koreografike	E. I	2021	Po
117	Tiranë	Koreografike	G. P.	2023	Po
118	Tiranë	Koreografike	G. I.	2017	Po
119	Tiranë	Koreografike	J. D	2022	Po
120	Tiranë	Koreografike	A. S	2016	Po
121	Tiranë	Kosova	A. Zh	2015	Po
122	Tiranë	Kushtrimi I Lirisë	A. K	01.01.2015	Po

123	Tiranë	Lasgush Poradeci	A. M.	2019	Po
124	Tiranë	Lasgush Poradeci	A. R.	2016	Jo
125	Tiranë	Lasgush Poradeci	D. Ll	2020	Po
126	Tiranë	Lasgush Poradeci	E. B	2017	Jo
127	Tiranë	Lasgush Poradeci	E. P.	2012	Po
128	Tiranë	Lasgush Poradeci	M. S	2013	Jo
129	Tiranë	Lasgush Poradeci	M. T	2015	Po
130	Tiranë	Lekë Gjiknuri	O. A.	2014	Po
131	Tiranë	Lidhja E Prizrenit	E. D	2014	Jo
132	Tiranë	Lidhja E Prizrenit	E. M	2013	Po
133	Tiranë	Loro Borici	E. V	03.10.2019	Po
134	Tiranë	Loro Borici	Ll. Gj	05.10.2020	Po
135	Tiranë	Loro Borici	T. K.	01.10.2012	Jo
136	Tiranë	Loro Borici	Y. B	21 .10.2020	Po
137	Tiranë	Luan Hajdaraga	E. C.	2015	Jo
138	Tiranë	Marie Logoreci	D. D.	1. 2012	Po
139	Tiranë	Marie Logoreci	E. M.	2016	Jo
140	Tiranë	Mersin Duqi	B. V.	2019	Po
141	Tiranë	Mersin Duqi	D. M	Maj 2011	Jo
142	Tiranë	Mersin Duqi	E. F.	2015	Jo
143	Tiranë	Mëzez-Fushë	F. H.	26.03.2015	Jo
144	Tiranë	Mihal Grameno	D. Q	Shtator 2012	Po
145	Tiranë	Mihal Grameno	E. K	2014	Jo
146	Tiranë	Mihal Grameno	E. D	2014	Po
147	Tiranë	Mihal Grameno	A. D	2015	Po
148	Tiranë	Misto Mame	A. M	04.05. 2015	Jo
149	Tiranë	Misto Mame	E. D.	15.09.2013	Jo
150	Tiranë	Murat Toptani	E. K	2013	Jo
151	Tiranë	Musine Kokalari	A. Sh	21.09.2011	Jo
152	Tiranë	Musine Kokalari	G.B	15.01.2015	Po
153	Tiranë	Musine Kokalari	N. I.	01.10.2014	Po
154	Tiranë	Musine Kokalari	V. S	01.10.2013	Po
155	Tiranë	Musine Komalari	I. I.	16.01.2017	Po
156	Tiranë	Mustafa Grebllleshi	O. D	2014	Po
157	Tiranë	Mustafa Kemal Ataturk	K.Sh	2014	Po
158	Tiranë	Myslym Keta	G. Ç	2018	Po
159	Tiranë	Naim Frasheri	E. Ll.	13.09.2016	Po
160	Tiranë	Naim Frasheri	L. Xh.	15.01.2015	Po
161	Tiranë	Naim Frasheri	R. L	15.01.2015	Po
162	Tiranë	Nene Tereza	A. B.	2026	Po
163	Tiranë	Nënë Tereza	A. N	2021	Po
164	Tiranë	Nënë Tereza	K. B	2013	Po
165	Tiranë	Nënë Teteza	E. K	2014	Po
166	Tiranë	Nexhmitafaj	E. S	09.09.2011	Po
167	Tiranë	Niket Dardani	J. T	15.10.2019	Po
168	Tiranë	Osman Myderizi	E. R.	2015	Jo
169	Tiranë	Osman Myderizi	E. Ç.	2016	Po
170	Tiranë	Pal Engjelli	P. B.	2015	Jo
171	Tiranë	Pal Engjelli	A. B	2015	Po
172	Tiranë	Pal Engjelli	A. B.	2014	Po
173	Tiranë	Pal Engjelli	L. P.	2015	Po
174	Tiranë	Pal Engjelli	L. M.	2007	Po
175	Tiranë	Petro Nini Luarasi	E. B.	4.12.2015	Po
176	Tiranë	Petro Nini Luarasi	A. L.	15.01.2015	Po
177	Tiranë	Petro Nini Luarasi	I. A.	25.09.2012	Po
178	Tiranë	Pjetër Budi	A. A.	25. 01. 2014	Po
179	Tiranë	Pjetër Budi	M. J	28.03.2023	Po
180	Tiranë	Pjetër Budi	S. T	13.10.2020	Po
181	Tiranë	Qazim Turdiu	A. N.	01.10.2011	Po
182	Tiranë	Qazim Turdiu	A. R	15.05.2012	Jo
183	Tiranë	Qazim Turdiu	B. S	15.01.2015	Po
184	Tiranë	Qemal Cena	E. C	2015	Po
185	Tiranë	Qemal Stafa	D. M	2013	Jo
186	Tiranë	Qemal Stafa	E. N.	2016	Jo
187	Tiranë	Ramazan Jarani	A. D.	2020	Po
188	Tiranë	Ramazan Jarani	K. L	2020	Po

189	Tiranë	Ramazan Jarani	K. Xh	2018	Po
190	Tiranë	Ramazan Jarani	E. M.	2015	Po
191	Tiranë	Ramazan Jarani	Xh. S	2012	Po
192	Tiranë	Sabahudin Gabrani	Gj. Ç	Prill 2009	Jo
193	Tiranë	Sami Kalasa	A. D	12.9.2011	Po
194	Tiranë	Sander Prosi	E. H	2015	Po
195	Tiranë	Servete Maçi	A.T	14. 10. 2014	Po
196	Tiranë	Servete Maçi	H. Ç	17 tetor 2011	Po
197	Tiranë	Shëngjergj	E. D	Janar 2024	Po
198	Tiranë	Shyqyri Peza	A. D.	2013	Jo
199	Tiranë	Shyqyri Peza	A. H	2012	Jo
200	Tiranë	Shyqyri Peza	D. V.	2016	Jo
201	Tiranë	Shyqyri Peza	E. H.	2013	Po
202	Tiranë	Shyqyri Peza	F. Sh.	2016	Jo
203	Tiranë	Siri Kodra	A. A.	12.09.2011	Jo
204	Tiranë	Siri Kodra	A. Gj.	17.03.2011	Jo
205	Tiranë	Siri Kodra	L. Gj.	03.04.2018	Jo
206	Tiranë	Skënder Çaçi	E. L.	11.09.2017	Jo
207	Tiranë	Skënder Çaçi	P. B	15.01.2015	Jo
208	Tiranë	Tufinë	E. B.	2015	Po
209	Tiranë	Vaçe Zela	A. Ç	2012	Jo
210	Tiranë	Vaçe Zela	I.A.	2017	Jo
211	Tiranë	Vasil Shanto	A.Gj.	2013	Jo
212	Tiranë	Vasil Shanto	N. D.	Mars 2011	Po
213	Tiranë	Vilez	F. M.	2020	Jo
214	Tiranë	Vilez	H.V.	2006	Jo
215	Tiranë	Vilez	H. Gj	2010	Jo
216	Tiranë	Xhezmi Delli	A. S.	2011	Po
217	Tiranë	Xhezmi Delli	M. R.	2011	Jo
218	Tiranë	Ymer Lala	S.K	2014	Jo
219	Tiranë	Ymer Lala	Z. T	2000	Po
220	Tiranë	Yrshek	R. Ç	2018	Jo
221	Tiranë	Yzberish	R.K	2015	Po

Burimi: ZVAP Tiranë

Në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 36 mësues të pa licencuar.

Tabela: Mësues të pa licencuar, ZVAP Kamëz

Nr	ZVA	Institucioni arsimor	Emër Mbiemër	Profili	Data e Diplomimit	Viti ne cilin ka filluar pune ne profesionin e mesuesit
1	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare 100 Vjetori	B.M.	Anglisht	29.07.2010	03.12.2012
2	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ahmet Zogu Bathore	F. B.	Arsim Fillor	27.09.2008	2017
3	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Azem Hajdari Paskuqan	A. S	Anglisht	20.07.2008	05.04.2016
4	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Demokracia Valias	Sh.Gj	Kimi	06.07.2010	2015
5	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	O.Gj	Anglisht	29.07.2010	2016
6	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	D.B	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	27.02.2007	2013
7	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	A.M	Fizikë	27.09.2006	2012
8	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	E.H	Anglisht	05.07.2008	2015
9	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	E.B	Arsim Fillor	14.07.2006	2016
10	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Basha Bulçesh	A.L	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	21.07.2009	2014
11	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Basha Bulçesh	J.H	Inxhinieri e teknologjive te informacionit	30.04.2013	2015
12	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Jashar Hoxha Paskuqan	K.D	Edukim fizik	07.07.2005	05.05.2015
13	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Jashar Hoxha Paskuqan	E.D	Edukim fizik	12.07.2010	05.05.2015
14	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	J.S	Arsim Fillor	06.03.2007	01.11.2014
15	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	P.D	Arsim Fillor	15.07.2005	01.04.2013
16	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	E.B	Arsim Fillor	10.07.2007	19.09.2019

17	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Lidhja e Prizrenit Paskuqan	B.H	Arsim Fillor	30.07.2009	06.10.2012
18	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	M.C	Arsim Fillor	30.09.2009	23.09.2019
19	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	M.O	Biologji -kimi	08.07.2009	03.03.2014
20	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	N.M	Histori	06.10.2010	05.03.2013
21	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Tahir Sinani Kodër e Kuqe	E.Th	Edukim fizik	12.07.2010	2014
22	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Tahir Sinani Kodër e Kuqe	A.H	Bio-Kimi	05.07.2008	2015
23	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Angela Merkel Kamëz	E. S	Frengjisht	17.09.2009	21.10.2011
24	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Angela Merkel Kamëz	A.M	Art Pamor	11.07.2000	15.10.2018
25	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Angela Merkel Kamëz	O. Sh	Edukim fizik	11.07.2007	01.10.2019
26	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Angela Merkel Kamëz	F.Rr	Edukim fizik	06.02.2009	22.10.2015
27	Kamëz	Gjimnazi Elez Isuf Ndreu Bathore	Gj.D	Histori	20.11.2009	10.11.2015
28	Kamëz	Gjimnazi Elez Isuf Ndreu Bathore	V.D	Gjeografi	06.10.2010	03.01.2014
29	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	E.K	Shkenca Sociale	06. 07.2006	2014
30	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	M.R	Shkenca Sociale	10. 07.2008	2014
31	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	B.B	Gjeografi	20. 07.2009	2017
32	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	I.Ç	Edukim fizik	07. 07.2008	2018
33	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	E.I	Edukim fizik	12. 07.2006	2014
34	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	E.A	Kimi	16. 07.2010	2020
35	Kamëz	Gjimnazi Isa Boletini Paskuqan	L.D	Gjermanisht	korrik 2007	Shtator 2015
36	Kamëz	Gjimnazi Isa Boletini Paskuqan	E.N	Gjuhë shqipe dhe Letërsi	korrik 2005	Mars 2011

Burimi: ZVAP Kamëz

Në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Vorë rezultojnë 11 mësues të pa licencuar.
Tabela: Mësues të pa licencuar, ZVAP Vorë

Nr.	ZVA	Institucioni arsimor	Emër Mbiemër	Profili	Data e Diplomimit	Viti ne cilin ka filluar pune ne profesionin e mesuesit
1	Vorë	Shkolla 9 vjecare Mucaj	E.M	Gjuhe Frenge	2007	2022
2	Vorë	Shkolla 9 vjecare "Vajdin Lamaj" Domje	O.G	Gjuhe-Letersi	2010	2011
3	Vorë	Gjimnazi "Isa Adem Boletini"	A.B	Matematikë	2010	2015
4	Vorë	Shkolla 9 vjecare "Vajdin Lamaj" Domje	M.Th	Gjuhe Angleze	2009	2015
5	Vorë	Shkolla 9 vjecare "Ahmetaq"	M.S	Fizike	2006	2021
6	Vorë	Gjimnazi "Vajdin Lamaj"	M.O	Gjuhe Angleze	2010	2011
7	Vorë	Shkolla 9 vjecare "Vajdin Lamaj" Domje	L.B	Arsim Fillor	2006	2015
8	Vorë	Shkolla 9 vjecare Vore	A.K	Gjeografi	2005	2014
9	Vorë	Shkolla 9 vjecare "Vajdin Lamaj" Domje	A.G	Arsim Fillor	2022	2024
10	Vorë	Shkolla 9 vjecare Berxull	D.D	Edukim Fizik	2007	2014
11	Vorë	Shkolla 9 vjecare Vorë	F.A	Arsim Fillor	2022	1994

Burimi: ZVAP Vorë

Në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kavajë rezultojnë 12 mësues të pa licencuar.
Tabela: Mësues të pa licencuar, ZVAP Kavajë

Nr	ZVAP	Institucioni arsimor	Pozicioni	Emër Mbiemër	Profili	Data e diplomimit	Data e fillimit të punës
1	Kavajë	Bago	Drejtor	S.D	Arsim Fillor	24.09.1994	01.10.2015
2	Kavajë	Qamil Xhani	Drejtor	Sh.Ç	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	10.03.2010	09.10.2015
3	Kavajë	11 Shkurti	Mësues	Z.H	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	17.07.2010	10.11.2015
4	Kavajë	28 Nentori	Kryemësuese	M.A	Gjeografi	30.10.2010	01.02.2013
5	Kavajë	Qamil Xhani	Mësuese	E.Ç	Biologji	14.07.2010	02.04.2012
6	Kavajë	3 Dëshmorët	Mësuese	G. H	Gjuhë Angleze	22.07.2010	15.09.2015
7	Kavajë	Golem	Mësuese	D.M	Gjuhë Angleze	05.08.2009	11.03.2015
8	Kavajë	Memzotaj	Mësuese	B.L	Histori-Gjeografi	11.07.2009	01.06.2013
9	Kavajë	Mehmet Babamusta	Mësuese	D.A	Kimi-Biologji	30.03.2011	01.02.2012
10	Kavajë	Aleksandër Moisiu	Mësuese	I. M	Filozofi-Sociologji	16.10.2009	03.10.2011
11	Kavajë	Aleksandër Moisiu	Mësuese	J.P	Arte	10.07.2003	11.09.2025
12	Kavajë	Aleksandër Moisiu	Nëndrejtor	M.A	Gjuhë Angleze	11.07.2008	15.02.2011

Burimi: ZVAP Kavajë

Znj. J. P. rezulton i punësuar nga portali Mësues për Shqipërinë 2025.
Sa më sipër rezultojnë pa licencë 2 Drejtor, 1 nëndrejtor, 1 kryemësues dhe 8 mësues.

Në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë rezultojnë 4 mësues të pa licencuar.
Tabela: Mësues të pa licencuar, ZVAP Rrogozhinë

Nr	ZVA	Institucioni arsimor	Emër Mbiemër	Profili	Diplomimi	Viti ne cilin ka filluar pune
1	Rrogozhinë	Shkolla 9 vjecare Spille	A.D	Gjuhe-Letersi	2008	01.10.2012
2	Rrogozhinë	Shkolla 9 vjecare Vile-Bashtove	A.A	Gjuhe-Letersi	2009	19.09.2012
3	Rrogozhinë	Shkolla 9 vjecare Luz i Madh	D.L	Histori-Gjeografi	2011	01.10.2012
4	Rrogozhinë	Shkolla 9 vjecare Lekaj	M.D	Shkenca Sociale	2014	16.09.2004

Burimi: ZVAP Rrogozhinë

Konstatohet se znj. M. D nuk rezulton as me diplomë në mësuesi.

2.3.13 Mbi mësuesit e arsimit special Në kreun IV "Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesve", pika 4 e Udhëzimit nr. 8, datë 03.07.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë", citohet se: "Në mungesë të kandidatëve të profilit arsim special për mësues ndihmës, Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve (KVD) pranë DRAP do të njoftojë të paraqiten për punësim kandidatë nga Portali Mësues për Shqipërinë, të të gjitha profileve, të cilët në aplikim kanë zgjedhur edhe opsionin arsim special, duke respektuar renditjen. Këta kandidatë punësohen me kontratë pune me afat deri në përfundim të vitit shkollor, me të drejtë rinovimi të saj, deri në emërimin e një kandidati nga portali të profilit "Arsim Special".

Nga auditimi konstatohet se dispozita që lejon emërimin e kandidatëve nga të gjitha profilet për rolin e mësuesit ndihmës në mungesë të profilit "Arsim Special" për të mbuluar nevojat në shkolla, shoqërohet me riskun e cilësisë së shërbimit arsimor, pasi mësuesit ndihmës në arsimin special kërkojnë njohuri specifike për zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për strategjitë e ndërhyrjes, për planet individuale të edukimit (PIE), etj. Kandidatët nga profile të tjera mund të mos kenë përgatitjen e duhur, çka mund të ndikojë negativisht në përparimin akademik dhe social të nxënësve.

Për vitin 2025 rezultojnë 721 mësues në shkollat e ZVAP Tiranë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 284 ose 39.4% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.

Për vitin shkollor 2022-2023, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 57 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 11 mësues janë të profilit "arsim special" ose 19% e tyre, ndërsa 81% janë mësues jashtë profilit.

Për vitin shkollor 2023-2024, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 61 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 14 mësues janë të profilit "arsim special" ose 23% e tyre, ndërsa 77% janë mësues jashtë profilit.

Për vitin shkollor 2024-2025, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 69 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 24 mësues janë të profilit "arsim special" ose 35% e tyre, ndërsa 65% janë mësues jashtë profilit.

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 78 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 28 mësues janë të profilit "arsim special" ose 36% e tyre, ndërsa 64% janë mësues jashtë profilit.

Për vitin shkollor 2022-2023 rezultojnë 18 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta vetëm 1 mësues ose 5.6% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.

Për vitin shkollor 2023-2024 rezultojnë 24 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 5 mësues ose 20.8% e mësues janë mësues të profilit

“arsimit special”, ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
Për vitin shkollor 2024-2025 rezultojnë 25 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 7 mësues ose 28% e mësues janë mësues të profilit “arsimit special”, ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
Për vitin 2025 rezultojnë 36 mësues në shkollat e ZVAP Kavajë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 14 ose 39% e mësues janë mësues të profilit “arsimit special”, ndërsa 61% janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
Për vitin shkollor 2022-2023 rezultojnë 13 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, ku të gjithë mësuesit rezultojnë jashtë profilit.
Për vitin shkollor 2023-2024 rezultojnë 14 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, ku të gjithë mësuesit rezultojnë jashtë profilit.
Për vitin shkollor 2024-2025 rezultojnë 15 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 3 mësues ose 20% e mësues janë mësues të profilit “arsimit special”, ndërsa 80% janë jashtë profilit të arsimit special.
Për vitin shkollor 2025-2026 rezultojnë 16 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 5 mësues ose 31% e mësues janë mësues të profilit “arsimit special”, ndërsa 69% janë jashtë profilit të arsimit special.

Nga ZVAP Tiranë, konkretisht nga znj. E.M është dërguar observacion nr. 56054/1 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/11 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:
Në lidhje me rekomandimin 8.1, sqarojmë se procedura e ndjekur mbi punësimin e kandidatëve të portalit “Mësues për Shqipërinë”, si mësues ndihmës por që nuk kanë formim Arsim Special, sqarojmë se kjo është një procedurë e diktuar nga përcaktimet e Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar dhe në vetvete është një procedurë për rastet përjashtimore, ku të gjithë mësuesit që nuk janë të diplomuar në profilin Arsim Special në mungesë të kandidatëve të këtij profili punësohen si mësues ndihmës gjithmonë me kontratë të përkohshme, jo më shumë se një vit mësimor. Një situatë e tillë, kalimtare, përjashtimore, ka ardhue si rezultat i kërkesave të shumta që ka sot nëpër shkolla për mësues ndihmës, nga shtimi cdo vit i fëmijëve/nxënësve që kanë nevojë për shoqërim me mësues ndihmës dhe mungesës së mësuesve që janë diplomuar për Arsim Special.
Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatohet se nuk është kundërshtuar gjetja e grupit të auditimit në lidhje me punësimet jashtë portalit, por janë sqaruar arsyet, ardhur kryesisht si rrjedhoje problematikave të shumta që janë krijuar nëpër shkolla si rezultat i mungesës së mësuesve.

2.3.13.1 Mbi numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe mësuesit e arsimit special

Nga analiza dhe kryqëzimi i të dhënave mbi numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara me numrin faktik të mësuesve ndihmës të parashikuar dhe të emëruar në strukturë, konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi nuk është respektuar në mënyrë të qëndrueshme raporti i përcaktuar për mbështetjen me mësues ndihmës.
Raporti mësues ndihmës/nxënës me aftësi të kufizuara ka rezultuar në disa vite ndjeshëm më i lartë se standardi i përcaktuar në Udhëzimin nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, pika 4, ku përcaktohet se një mësues ndihmës mund të mbështesë 2 deri në 3 nxënës me aftësi të kufizuara brenda të njëjtit institucion arsimor, në varësi të nivelit të vështirësisë dhe nevojave individuale.

Tabela: Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin në shkollat e ZVAP Tiranë, për vitin 2025

Nr.	Shkolla	Nr. i nxënsve me AK	Nr. i mësuesve	Viti	Raporti
1	1 Maji	9	5	2025	1.80
2	1 Qershori	11	5	2025	2.20
3	16 Shtatori	7	5	2025	1.40
4	17 Shkurti	16	9	2025	1.78
5	26 Nentori	8	4	2025	2.00
6	28 Nentori	27	14	2025	1.93
7	4 Deshmoret	7	5	2025	1.40
8	7 Marsi	16	8	2025	2.00
9	Abdulla Keta	3	1	2025	3.00
10	Ahmet Boja	5	3	2025	1.67
11	Ahmet Gashi	27	15	2025	1.80
12	Aleks Buda	11	5	2025	2.20
13	Ali Demi	7	5	2025	1.40
14	Alush Bardhi	7	5	2025	1.40
15	Andon Zako Cajupi	8	4	2025	2.00
16	Andrea Stefani	12	8	2025	1.50
17	Androkli Kostallari	33	16	2025	2.06
18	Arben Broci	5	2	2025	2.50
19	Ardian Klosi	10	6	2025	1.67
20	Asim Vokshi	7	4	2025	1.75
21	At Zef Pllumi	35	17	2025	2.06
22	Avni Rustemi	6	3	2025	2.00
23	Bahri Nela	2	3	2025	0.67
24	Bajram Curri	7	2	2025	3.50
25	Bashkim Berisha	3	1	2025	3.00
26	Bashkim Fino	9	5	2025	1.80
27	Bedri Llagami	5	3	2025	1.67
28	Besnik Sykja	7	6	2025	1.17
29	Betim Muco	35	21	2025	1.67
30	Deshmoret E Lirise	22	12	2025	1.83
31	Dhora Leka	17	10	2025	1.70
32	Dora Distria	7	3	2025	2.33
33	Drita Pelinku	4	3	2025	1.33
34	Dritas	5	2	2025	2.50
35	E Kuqe	12	7	2025	1.71
36	Edith Durham	19	6	2025	3.17
37	Emin Duraku	18	8	2025	2.25
38	Eqrem Cabej	7	4	2025	1.75
39	Fan S Noli	12	7	2025	1.71
40	Farke E Vogel	6	3	2025	2.00
41	Ferraj	4	3	2025	1.33
42	Feti Fanaj	2	1	2025	2.00
43	Feti Vogli	2	1	2025	2.00
44	Flamur Shkoza	6	3	2025	2.00
45	Fushas	2	1	2025	2.00
46	Gjergj Fishta	16	8	2025	2.00
47	Gjon Buzuku	22	7	2025	3.14
48	Gustav Mayer	39	22	2025	1.77
49	Hasan Prishtina	25	14	2025	1.79
50	Hasan Tahsin	13	8	2025	1.63
51	Hasan Vogli	12	6	2025	2.00
52	Haxhi Korra	10	5	2025	2.00
53	Ibrahim Brahja	19	11	2025	1.73
54	Ibrahim Hasmema	2	2	2025	1.00
55	Isa Boletini	16	9	2025	1.78
56	Ismail Qemali	4	2	2025	2.00
57	Jeronim De Rada	9	4	2025	2.25
58	John F Kennedy	2	1	2025	2.00
59	Kasem Shima	6	4	2025	1.50
60	Katund I Ri	5	3	2025	1.67
61	Kico Blushi	12	5	2025	2.40
62	Kllojke		4	2025	-
63	Klodian Tanushi	18	8	2025	2.25
64	Kole Jakova	23	14	2025	1.64
65	Konferenca E Pezes	12	6	2025	2.00
66	Kongresi Manastirit	38	20	2025	1.90
67	Kongresi I Lushnjes	7	4	2025	1.75
68	Kosova	10	6	2025	1.67
69	Kostandin Kristoforidhi	38	14	2025	2.71
70	Kristo Frasheri	4	3	2025	1.33
71	Krrabe	7	3	2025	2.33
72	Kus	2	1	2025	2.00
73	Kushtrimi I Lirise	19	15	2025	1.27

74	Lalm	3	1	2025	3.00
75	Lasgush Poradeci	19	9	2025	2.11
76	Leke Gjiknuri	5	2	2025	2.50
77	Lidhja E Prizrenit	10	5	2025	2.00
78	Luan Hajdaraga	2	1	2025	2.00
79	Lunder	6	4	2025	1.50
80	Marie Logoreci	12	7	2025	1.71
81	Mersin Duqi	2	1	2025	2.00
82	Mezez Fushe	14	7	2025	2.00
83	Mihal Duri	6	3	2025	2.00
84	Mihal Grameno	22	12	2025	1.83
85	Misto Mame	6	3	2025	2.00
86	Murat Toptani	9	4	2025	2.25
87	Musine Kokalari	16	9	2025	1.78
88	Mustafa Grebllleshi	13	3	2025	4.33
89	Mustafa Qemal Ataturku	7	3	2025	2.33
90	Mustafa Kemal Ataturku Shb	9	2	2025	4.50
91	Myrvete Peza	6	4	2025	1.50
92	Myslym Keta	8	5	2025	1.60
93	Myslym Shima	3	2	2025	1.50
94	Naim Frasheri	4	2	2025	2.00
95	Nene Tereza	8	4	2025	2.00
96	Niket Dardani	19	10	2025	1.90
97	Osman Myderizi	19	10	2025	1.90
98	Pal Engjelli	11	6	2025	1.83
99	Partizani	4	3	2025	1.33
100	Petro Nini Luarasi	3	2	2025	1.50
101	Pjeter Budi	14	6	2025	2.33
102	Qazim Turdiu	21	10	2025	2.10
103	Qemal Cena	2	1	2025	2.00
104	Qemal Stafa	3	1	2025	3.00
105	Ramazan Jarani	18	9	2025	2.00
106	Sabahudin Gabrani	26	14	2025	1.86
107	Sadik Stavileci	4	3	2025	1.33
108	Sami Kalasa	4	1	2025	4.00
109	Sander Prosi	1	1	2025	1.00
110	Seit Brahja	3	1	2025	3.00
111	Selman Meta	1	1	2025	1.00
112	Servete Maci	9	5	2025	1.80
113	Sevasti Qiriazi	4	2	2025	2.00
114	Shengjergj	1	1	2025	1.00
115	Shyqyri Peza	26	13	2025	2.00
116	Sinan Tafaj	3	2	2025	1.50
117	Siri Kodra	9	6	2025	1.50
118	Skender Caci	10	5	2025	2.00
119	Skender Luarasi	10	7	2025	1.43
120	Tufine	3	1	2025	3.00
121	Vace Zela	15	8	2025	1.88
122	Vasil Shanto	24	13	2025	1.85
123	Xhezmi Delli	14	7	2025	2.00
124	Ymer Lala	4	2	2025	2.00
125	Yrshek	1	1	2025	1.00
126	Yzberisht	9	3	2025	3.00

Burimi: ZVAP Tiranë

Tabela: Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin në shkollat e ZVAP Kamëz

Nr	ZVA	Shkolla	Nx. me AK	Mesues	Viti	Raporti
1	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare 100 Vjetori Kamëz	20	6	2022-2023	3.33
2	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Arbëria Kamëz	4	1	2022-2023	4.00
3	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ahmet Zogu Bathore	15	5	2022-2023	3.00
4	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Azem Hajdari Paskuqan	12	4	2022-2023	3.00
5	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Fatos Lami Zall-Mner	6	2	2022-2023	3.00
6	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Demokracia Valias	1	1	2022-2023	1.00
7	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Paskuqan	2	1	2022-2023	2.00
8	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Laknas	4	1	2022-2023	4.00
9	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	18	6	2022-2023	3.00
10	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Hillary Clinton Kamëz	16	5	2022-2023	3.20
11	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Basha Bulçesh	13	5	2022-2023	2.60
12	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Jashar Hoxha Paskuqan	3	1	2022-2023	3.00
13	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	10	5	2022-2023	2.00
14	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Lidhja e Prizrenit Paskuqan	6	3	2022-2023	2.00
15	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Nënë Tereza Laknas	4	1	2022-2023	4.00
16	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	3	1	2022-2023	3.00
17	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Tahir Sinani Kodër e Kuqe	9	4	2022-2023	2.25
18	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Vëllazërimi Paskuqan	7	2	2022-2023	3.50
19	Kamëz	Gjimnazi Elez Isuf Ndreu Bathore	4	1	2022-2023	4.00

20	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	3	1	2022-2023	3.00
21	Kamëz	Gjimnazi Isa Boletini Paskuqan	4	1	2022-2023	4.00
22	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare 100 Vjetori Kamëz	15	6	2023-2024	2.50
23	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Arbëria Kamëz	4	1	2023-2024	4.00
24	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ahmet Zogu Bathore	15	6	2023-2024	2.50
25	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Azem Hajdari Paskuqan	18	5	2023-2024	3.60
26	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Fatos Lami Zall-Mner	6	2	2023-2024	3.00
27	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Demokracia Valias	1	1	2023-2024	1.00
28	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Paskuqan	2	1	2023-2024	2.00
29	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Laknas	4	1	2023-2024	4.00
30	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	19	7	2023-2024	2.71
31	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Hillary Clinton Kamëz	16	5	2023-2024	3.20
32	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Basha Bulçesh	12	4	2023-2024	3.00
33	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Jashar Hoxha Paskuqan	11	3	2023-2024	3.67
34	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	15	6	2023-2024	2.50
35	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Lidhja e Prizrenit Paskuqan	6	2	2023-2024	3.00
36	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Nënë Tereza Laknas	4	1	2023-2024	4.00
37	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	3	1	2023-2024	3.00
38	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Tahir Sinani Kodër e Kuqe	10	3	2023-2024	3.33
39	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Vëllazërimi Paskuqan	7	2	2023-2024	3.50
40	Kamëz	Gjimnazi Elez Isuf Ndreu Bathore	4	1	2023-2024	4.00
41	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	4	1	2023-2024	4.00
42	Kamëz	Gjimnazi Ibrahim Rugova Kamëz	3	1	2023-2024	3.00
43	Kamëz	Gjimnazi Isa Boletini Paskuqan	4	1	2023-2024	4.00
44	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare 100 Vjetori Kamëz	17	8	2024-2025	2.13
45	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Arbëria Kamëz	6	2	2024-2025	3.00
46	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ahmet Zogu Bathore	13	5	2024-2025	2.60
47	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Azem Hajdari Paskuqan	18	5	2024-2025	3.60
48	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Fatos Lami Zall-Mner	6	2	2024-2025	3.00
49	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Demokracia Valias	2	1	2024-2025	2.00
50	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Paskuqan	2	1	2024-2025	2.00
51	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Dom Nikollë Kaçorri Laknas	5	2	2024-2025	2.50
52	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Halit Coka Bathore	15	5	2024-2025	3.00
53	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Hillary Clinton Kamëz	16	5	2024-2025	3.20
54	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Ibrahim Basha Bulçesh	12	4	2024-2025	3.00
55	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Jashar Hoxha Paskuqan	12	5	2024-2025	2.40
56	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Kamza e Re Kamëz	15	7	2024-2025	2.14
57	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Lidhja e Prizrenit Paskuqan	6	2	2024-2025	3.00
58	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Nënë Tereza Laknas	5	2	2024-2025	2.50
59	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Niko Hoxha Valias	5	2	2024-2025	2.50
60	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Tahir Sinani Kodër e Kuqe	10	4	2024-2025	2.50
61	Kamëz	Shkolla 9-vjeçare Vëllazërimi Paskuqan	7	2	2024-2025	3.50
62	Kamëz	Gjimnazi Elez Isuf Ndreu Bathore	4	1	2024-2025	4.00
63	Kamëz	Gjimnazi Gramoz Palushi Babrru	4	1	2024-2025	4.00
64	Kamëz	Gjimnazi Ibrahim Rugova Kamëz	3	2	2024-2025	1.50
65	Kamëz	Gjimnazi Isa Boletini Paskuqan	1	1	2024-2025	1.00

Burimi: ZVAP Kamëz, punuar nga grupi i auditimit

Tabela: Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin në shkollat e ZVAP Vorë

Nr.	IA	Nr i nxenesve me AK	Nr ne total i mësuesve	Viti	Raporti
1	9 vjecare Vore	5	3	2022-2023	1.67
2	Shaban Sheshori	6	2	2022-2023	3.00
3	9 vjecare "V. Lamaj"	4	2	2022-2023	2.00
4	Berxull	5	2	2022-2023	2.50
5	Picar	2	1	2022-2023	2.00
6	Gjokaj	2	1	2022-2023	2.00
7	Marikaj	2	1	2022-2023	2.00
8	Marqinet	5	3	2022-2023	1.67
9	Mucaj	2	1	2022-2023	2.00
10	Ahmetaq	2	1	2022-2023	2.00
11	"Isa Boletini"	2	1	2022-2023	2.00
12	9 vjecare Vore	9	5	2023-2024	1.80
13	Shaban Sheshori	6	2	2023-2024	3.00
14	9 vjecare "Vajdin Lamaj"	4	2	2023-2024	2.00
15	gjimnazi "Vajdin Lamaj"	1	1	2023-2024	1.00
16	Berxull	9	4	2023-2024	2.25
17	Picar	3	2	2023-2024	1.50
18	Gjokaj	3	1	2023-2024	3.00
19	Marikaj	3	1	2023-2024	3.00
20	Marqinet	6	3	2023-2024	2.00
21	Mucaj	2	1	2023-2024	2.00
22	Ahmetaq	2	1	2023-2024	2.00
23	"Isa Boletini"	2	1	2023-2024	2.00
24	9 vjecare Vore	15	7	2024-2025	2.14
25	Shaban Sheshori	7	2	2024-2025	3.50
26	9 vjecare "V. Lamaj"	4	2	2024-2025	2.00

27	gjimnazi "V.Lamaj"	1	1	2024-2025	1.00
28	Berxull	9	4	2024-2025	2.25
29	Picar	3	1	2024-2025	3.00
30	Gjokaj	2	1	2024-2025	2.00
31	Marikaj	2	1	2024-2025	2.00
32	Marqinet	7	3	2024-2025	2.33
33	Ahmetaq	2	1	2024-2025	2.00
34	"Isa Boletini"	3	2	2024-2025	1.50

Burimi: ZVAP Vorë, punuar nga grupi i auditimit

Tabela: Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin në shkollat e ZVAP Kavajë

Nr	Zvap	Shkolla	Viti	Nr. i Nxënësve me Ak që mbulon	Nr. I Mësuesve Ndihmës	Raporti
1	Kavajë	Rilindja	2022	6	3	2.00
2	Kavajë	Mehmet Babamusta	2022	5	3	1.67
3	Kavajë	Razi Leka	2022	1	1	1.00
4	Kavajë	Sadi Tatani	2022	1	1	1.00
5	Kavajë	Golem	2022	5	4	1.25
6	Kavajë	Helmas	2022	2	2	1.00
7	Kavajë	Memzotaj	2022	1	1	1.00
8	Kavajë	Herbert	2022	4	3	1.33
9	Kavajë	Gjimnazi Luz i Vogel	2022	1	1	1.00
10	Kavajë	28 Nëntori	2022	2	2	1.00
11	Kavajë	Karpen	2022	3	1	3.00
12	Kavajë	3 Dëshmorët	2022	5	2	2.50
13	Kavajë	Fiqiri Kurti	2022	2	2	1.00
14	Kavajë	11 Shkurti	2022	6	3	2.00
15	Kavajë	Bago	2022	1	1	1.00
16	Kavajë	Gjimnazi Aleksandër Moisiu	2022	3	1	3.00
17	Kavajë	Rilindja	2023	6	4	1.50
18	Kavajë	Mehmet Babamusta	2023	5	3	1.67
19	Kavajë	Razi Leka	2023	1	1	1.00
20	Kavajë	Sadi Tatani	2023	1	1	1.00
21	Kavajë	Golem	2023	5	3	1.67
22	Kavajë	Memzotaj	2023	3	3	1.00
23	Kavajë	Herbert	2023	4	4	1.00
24	Kavajë	Gjimnazi Luz I Vogel	2023	1	1	1.00
25	Kavajë	28 Nëntori	2023	3	3	1.00
26	Kavajë	Karpen	2023	3	1	3.00
27	Kavajë	3 Dëshmorët	2023	5	2	2.50
28	Kavajë	Fiqiri Kurti	2023	3	2	1.50
29	Kavajë	11 Shkurti	2023	6	2	3.00
30	Kavajë	Bago	2023	1	1	1.00
31	Kavajë	Rilindja	2024	4	3	1.33
32	Kavajë	Mehmet Babamusta	2024	3	3	1.00
33	Kavajë	Golem	2024	4	2	2.00
34	Kavajë	Memzotaj	2024	3	3	1.00
35	Kavajë	Herbert	2024	4	3	1.33
36	Kavajë	Amoisiu	2024	5	3	1.67
37	Kavajë	28 Nëntori	2024	3	3	1.00
38	Kavajë	3 Dëshmorët	2024	6	4	1.50
39	Kavajë	Fiqiri Kurti	2024	5	3	1.67
40	Kavajë	11 Shkurti	2024	6	4	1.50
41	Kavajë	Bago	2024	4	3	1.33
42	Kavajë	Rilindja	2025	3	3	1.00
43	Kavajë	Mehmet Babamusta	2025	4	3	1.33
44	Kavajë	Golem	2025	6	2	3.00
45	Kavajë	Memzotaj	2025	3	3	1.00
46	Kavajë	Herbert	2025	4	3	1.33
47	Kavajë	Amoisiu	2025	6	3	2.00
48	Kavajë	28 Nëntori	2025	3	3	1.00
49	Kavajë	3 Dëshmorët	2025	8	5	1.60
50	Kavajë	Fiqiri Kurti	2025	4	4	1.00
51	Kavajë	11 Shkurti	2025	6	3	2.00
52	Kavajë	Bago	2025	4	3	1.33
53	Kavajë	Karpen	2025	1	1	1.00

Burimi: ZVAP Kavajë

Tabela: Nr. i nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin në shkollat e ZVAP Rrogozhinë

Nr	ZVAP	SHKOLLA	Viti	NR. I NXËNËVSE	NR.I MËSUESVE NDIHMËS	RAPORTI
1	Rrogozhine	Mesme "Haxhi Qehaj"	2022	3	1	3
2	Rrogozhine	Mesme'SHMB GOSE"	2022	5	3	1.6
3	Rrogozhine	9-vjecare 'Qamil Gjuzi'	2022	5	2	2.5
4	Rrogozhine	9-Vjecare 'Xhorxh Soros'	2022	5	3	1.6
5	Rrogozhine	9-Vjecare 'Luz I madh'	2022	2	1	2
6	Rrogozhine	9 -Vjecare 'Lekaj'	2022	2	2	1
7	Rrogozhine	9-Vjecare 'Spille	2022	1	1	1
8	Rrogozhine	9-Vjecare Kalush	2022	1	1	1
9	Rrogozhine	9-Vjecare Zhabjak	2022	1	1	1
10	Rrogozhinë	Mesme "Haxhi Qehaj"	2023	3	1	3
11	Rrogozhinë	SHMB GOSE"	2023	5	3	1.6
12	Rrogozhinë	9-vjecare 'Qamil Gjuzi'	2023	5	2	2.5
13	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Xhorxh Soros'	2023	5	3	1.6

14	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Luz I Madh'	2023	2	1	2
15	Rrogozhinë	9 -Vjecare 'Lekaj'	2023	2	2	1
16	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Spille	2023	1	1	1
17	Rrogozhinë	9-Vjecare Kalush	2023	1	1	1
18	Rrogozhinë	9-Vjecare Zhabjak	2023	1	1	1
19	Rrogozhinë	9-Vjeçare Stërbeg	2023	1	1	1
20	Rrogozhinë	Mesme "Haxhi Qehaj"	2024	3	2	1.5
21	Rrogozhinë	SHMB GOSE"	2024	4	3	1.3
22	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Xhorxh Soros'	2024	4	3	1.3
23	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Luz i Madh'	2024	3	2	1.5
24	Rrogozhinë	9 -Vjecare 'Lekaj'	2024	3	2	1.5
25	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Spille	2024	1	1	1
26	Rrogozhinë	9-Vjecare Kalush	2024	1	1	1
27	Rrogozhinë	9-Vjecare Zhabjak	2024	1	1	1
28	Rrogozhinë	9-Vjeçare Stërbeg	2024	1	1	1
29	Rrogozhinë	Mesme "Haxhi Qehaj"	2025	2	1	2
30	Rrogozhinë	Mesme'SHMB GOSE"	2025	5	3	1.6
31	Rrogozhinë	9-vjecare 'Qamil Gjuzi'	2025	2	1	1.5
32	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Xhorxh Soros'	2025	4	3	1.6
33	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Luz i Madh'	2025	2	1	2
34	Rrogozhinë	9 -Vjecare 'Lekaj'	2025	3	2	1
35	Rrogozhinë	9-Vjecare 'Spille	2025	2	1	1.5
36	Rrogozhinë	9-Vjecare Zhabjak	2025	1	1	1
37	Rrogozhinë	9-Vjeçare Stërbeg	2025	1	1	1

Burimi: ZVAP Rrogozhinë

Është evidentuar se ky raport në rastet e trajtuara në tabelë (raporti mbi 3) është tejkaluar në çka tregon një mungesë të përputhjes midis nevojave reale të fëmijëve dhe burimeve njerëzore të alokuara.

Vlerësimi i risqeve

Kjo situatë krijon një sërë risqesh të rëndësishme institucionale, arsimore dhe sociale, ndër të cilat:

-Risk për cilësinë e shërbimit arsimor: Ngarkesa e tepërt mbi mësuesit ndihmës mund të ulë cilësinë e mbështetjes individuale për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjes pedagogjike dhe zhvillimin e tyre arsimor dhe social.

-Risk për mosarritjen e objektivave të përfshirjes: Mungesa e mbështetjes së mjaftueshme rrit mundësinë e përjashtimit të pjesshëm ose tërësor të nxënësve nga procesi i mësimnxënies efektive, duke cenuar parimin e arsimit gjithëpërfshirës.

-Risk institucional dhe menaxherial: Mosrespektimi i normativës sugjeron mangësi në planifikimin e burimeve njerëzore, si dhe në procesin e monitorimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse (ZVAP dhe drejtoria arsimore).

-Risk për mbingarkesë profesionale të mësuesve ndihmës: Raporti i lartë rrit ndjeshëm ngarkesën individuale të mësuesve ndihmës, duke ndikuar në uljen e motivimit profesional, rritjen e lodhjes dhe rrezikun e largimit nga profesioni etj.

2.3.14 Mbi aplikim e mësuesve për punësimi në Portalin "Mësues për Shqipërinë"

Procesi i punësimit të mësuesve bëhet nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë". Ky portal është krijuar me qëllim punësimin e mësuesve në arsimin parauniversitar, në bazë merite, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe shanse të barabarta. Individët që kanë plotësuar kriteret ligjore dhe nënligjore për ushtrimin e profesionit të mësuesit, aplikojnë për të konkurruar në Portalin "Mësues për Shqipërinë".

Rezulton se me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit nr. 4, datë 26.02.2026 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë", vendosur kufizim mbi kandidatët duke i lejuar të konkurrojnë vetëm në DARP-in që kanë vendbanimin e përhershëm. Konkretisht në pikën 1.c të këtij udhëzimi citohet se: "*Kandidati aplikon në DRAP-në ku ka vendbanimin e përhershëm. Ai ka të drejtë të përzgjedhë deri në tri ZVAP ku dëshiron të punësohet, brenda DRAP-it ku ka vendbanimin e përhershëm*".

Vendosja e këtij kufizimi mohon të drejtën e kandidatëve për aplikim jashtë DRAP-it të vendbanimit, duke cënuar parimin e ofrimit të shanse të barabarta për punësimin e të gjithë kandidateve në vendet e lira punës që shpallen.

2.3.15 Punësimet nga Portali

Gjatë auditimit të procedurave të ndjekura për punësimin e mësuesve nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë", u evidentuan mangësi në drejtim të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së procesit të përzgjedhjes nga ana e Zyrave Vendore Arsimore.
Nga verifikimet e kryera rezultoi se procesi i përzgjedhjes nuk shoqërohet me dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme që të pasqyrojnë në mënyrë të plotë, të qartë dhe të verifikueshme të gjithë rrjedhën e konkurrimit. Konkretisht, nuk evidentohet mbajtja e një procesverbali të detajuar që të përfshijë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në procedurë, ndërkohë që mungon edhe dokumentimi i rasteve të refuzimit të pozicionit apo të mosparaqitjes së kandidatëve të renditur.
Një element tjetër i konstatuar lidhet me kohën e hartimit dhe formalizimit të procesverbaleve. Rezulton se procesverbalet janë mbajtur përgjithësi në orën e përcaktuar në njoftimet e bëra në rrugë elektronike, pa lënë një interval kohor me qëllim marrjen në konsideratë edhe të kandidatëve që mund të rezultojnë me një vonesë jo të konsiderueshme.
Në përfundim, konstatohet se praktikat aktuale të ndjekura nuk sigurojnë një gjurmueshmëri të plotë të procesit të përzgjedhjes dhe nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për një vendimmarrje të dokumentuar, transparente dhe të verifikueshme.

Nga ZVAP Tiranë, konkretisht nga znj. E.M është dërguar observacion nr. 56054/1 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/11 prot., datë 20.07.2026 si në vijim**:**
Për sa i përket gjetjes 9: sqarojmë se një përfundim i tillë nuk është i saktë, pasi e gjithë procedura e ndjekur nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë në procesin e menaxhimit dhe administrimit të punësimeve të kandidatëve nga portali "Mësues për Shqipërinë", është një proces i dokumentuar në çdo detaje për çdo hap të ndjekur është transparent në çdo hap të saj, është një procedurë që pasqyron në mënyrë të plotë, të qartë dhe lehtësisht të verifikueshme të të gjithë procedurës që ndiqet.
Procedura e përzgjedhjes së vendeve të lira të punës nga kandidatët e portalit "Mësues për Shqipërinë" është procedura më transparente, e mirëdokumentuar dhe më e mirëmenaxhuar çdo procedurë e mbajtur dhe e menaxhuar nga ZVAP Tiranë.
Hapat dhe procedura që ndiqet nga ZVAP Tiranë për procesin e menaxhimit të portalit Mësues për Shqipërinë", janë :
- Raporti i vendit të lirë të punës, nga institucionet arsimore që janë nën juridiksionin e saj.
- Raportimi i vendeve të lira të punës në DRAP Tiranë,
- Publikimi i vendeve të lira të punës në faqen zyrtare të ZVAP Tiranë.
- Dërgimi i njoftimeve me emali i të gjithë kandidatëve të portalit "Mësues për Shqipërinë", nga DRAP Tiranë (sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2023, i ndryshuar). Në dërgimin e njoftimit respektohet me rigorozitet:

- Njoftimi i të gjithë kandidatëve sipas profilit të vendit të lirë të punës
- Në njoftim evidentohen vendet e lira të punës, shkollat përkatëse (gjimnaze /9 - vjeçare) vakante apo provizore dhe në rastet kur janë provizore edhe afati i aktivizimit provizor.
- Caktimi i datës, vendit dhe orës se ku do të zhvillohet procedura e përzgjedhjes së vendit të lirë të punës nga kandidatët sipas renditjes së tyre.

- Njoftimi bëhet absolutisht gjithmonë një ditë më parë (ku pavarësisht se në udhëzim nuk është e përcaktuar asnjë afat kohor se sa orë para duhet të bëhet njoftimi) me qëllim që t'u jepet mundësi të gjithë kandidatëve sado afër apo larg të jenë nga Tiranë, të kenë mundësi që të vijnë (nëse janë të interesuar për vendet e lira të punës që u janë dërguar me njoftim me email).

- Takimi i zhvilluar në datën, orën dhe mjedisin e njoftuar ne njoftim nga komisioni në prani të të gjitha kandidatëve që kanë shfaqur interes për vendet e lira të punës.
- Evidentimi në procesverbal i të gjitha përzgjedhjeve, refuzimeve (nëse ka patur) si dhe i mungesave të kandidatëve.
- Dërgimi i Memo, trasparencës dhe punësimeve të bëra, në DRAP Tiranë, çdo fillim muaji.
- Punësimet e publikuara në fazën zyrtare të ZVAP Tiranë çdo fillim muaji (për punësimet e muajit të kaluar). (bashkëngjitur po ju dërgojmë dy praktika të mbajtura, (nga dhjetra e dhjetra praktika të tilla) në lidhje me këto procedura).

Gjithashtu evidentimi se mbajtja e procesverbalit nga komisioni mbi përzgjedhjet e vendeve të lira të punës, mungesave të kandidatëve bëhet në orën e përcaktuar në njoftim, pa lënë një interval kohor me qëllim marrjen në konsideratë edhe të kandidatëve që mund të rezultojnë me një vonesë jo të konsiderueshme, gjykojmë se një evidentim i tillë është tërësisht i gabuar. Në lidhje me këtë sqarojmë se :

- Të gjithë kandidatët njoftohen absolutisht një ditë më parë (dhe pikërisht për tu dhënë mundësi të gjithëve që të kenë mundësi të vijnë edhe nga zona larg Tiranës.
- Thirrja në mënyrë të organizuar është një përcaktim i sanksionuar në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2023, i ndryshuar.
- Lënia e një intervali kohor, për të marrë në konsideratë ndonjë vonesë jo të konsiderueshme të ndonjë kandidati, kjo do të ishte shumë abuzive dhe pikërisht kjo do të sillte keq menaxhim, shteg për abuzim dhe për rrjedhojë mungesë transparence.
- Njoftimet për aktivizimin e mësuesve është një njoftim, është një procedurë që nuk pret kohëzgjatje të madhe për të përzgjedhur kandidatët, pasi çdo ditë vonesë në njoftim, përzgjedhje, etj. shoqërohet me një klasë me 30 – 40 nxënës pa mësim dhe reaksioni në shkollë dhe tek prindërit e tyre është shumë i madh. - Sqarojmë se lista e kandidatëve "Mësues për Shqipërinë", është një listë me rankimin e një numri personash të cilët kanë aplikuar për të qenë mësues, dhe këta persona duhet të jenë të gatshëm për çdo njoftim që bëhet për vendet e lira të punës. Pra në një farë mënyre këta kandidatë janë në shërbim të njoftimeve që bëhen nga ZVAP Tiranë për çdo vend të lirë pune.
- Komisioni në procesverbalet që mban dhe administron në çdo njoftim që bën evidenton që disa kandidatë kanë munguar, (referuar faktit që ata nuk janë paraqitur) dhe evidentimi i bërë nga grupi i auditimit se këtyre kandidatëve tu merret refuzimi është i pamundur për sa kohë që ata nuk paraqiten nuk mund të firmosin refuzim. Gjithashtu rrjedhimisht fakti që ata nuk paraqiten automatikisht indirekt këta kandidatë kanë refuzuar për këtë vend të lirë pune të ofruar. E gjithë procedurat e ndjekura për punësimet e kandidatëve nga portali "Mësues për Shqipërinë", janë në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2023 Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit Mësues për Shqipërinë" i ndryshuar, si dhe është një procedurë transparente dhe shumë mirë e dokumentuar në çdo hap të saj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konstatohet se observacioni eshtë i njëjtë me observacionet e dërguara mbi akt konstatimet dhe trajtuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit. Në drejtim të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së procesit të punësimeve nga portali, grupi i auditimit sqaron se: pavarësisht faktit se subjekti ka paraqitur hapat proceduralë që ndjek gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, këto argumente nuk rrëzojnë konstatimin e auditimit lidhur me

mangësitë e evidentuara në drejtim të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së plotë të procesit. Auditimi nuk ka vënë në diskutim ekzistencën e procedurës së ndjekur, por nivelin e dokumentimit të saj dhe provueshmërinë e plotë të çdo veprimi administrativ të kryer gjatë procesit. Përshkrimi narrativ i procedurës nuk përbën në vetvete evidencë të mjaftueshme auditimi për të garantuar se çdo fazë e procesit është dokumentuar në mënyrë të plotë, të njëtrajtshme dhe të verifikueshme për të gjitha rastet e shqyrtuara, veçanërisht në drejtim të kandidatëve jo pjesëmarrës ose jo të shpallur fitues.

2.3.16 Punësimet jashtë profilit

Nga auditimi është konstatuar se në ZVAP Tiranë, janë punësuar aplikantë jashtë portalit të cilët rezultojnë gjithashtu të punësuar jashtë profilit, pra profili për të cilën aplikanti ka lidhur kontratën provizore nuk është përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar, paraqitur si në vijim:

Tabela: Punësimet jashtë profilit, ZVAP Tiranë

Nr	ZVAP	Shkolla që ka përzgjedhur	Nëse është punësuar nga portali apo me aplikante jashtë portal	Profili/Lënda (e kandidatit te punësuar)	Profili ne te cilin është punësuar	Emri Mbiemri	Viti
1	Tiranë	Haxhi Korra 10 Ore + Mustafa Greblleshi	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Muzike	S. N.	2024
2	Tiranë	Osman Myderizi	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Matematikë	A. B.	2024
3	Tiranë	Ardian Klosi	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	E Gj.	2024
4	Tiranë	Emin Duraku	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	A M.	2024
5	Tiranë	Jeronim De Rada	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	A Zh.	2024
6	Tiranë	Kongresi I Lushnjes	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	P. TH.	2024
7	Tiranë	Servete Maci	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	E. L.	2024
8	Tiranë	Vace Zela	Jashtë portalit	Bio – Kimi	Arsimi Fillor	E L.	2024
9	Tiranë	Shengjergj - Vartese Ure	Jashtë portalit	Biologji	Arsimi Fillor	L.H.	2024
10	Tiranë	Hamdi Mancaku, Zall Dajt - Vartese Besh	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	M. K.	2024
11	Tiranë	Krrabe	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	P K.	2024
12	Tiranë	Shengjergj - Vartese Facesh	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	F. H.	2024
13	Tiranë	Bahri Nela - Vartese Shyqyrk, Zall Bastar	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	V. V	2024
14	Tiranë	Mezez Fushe	Jashtë portalit	Gjeografi	Arsimi Fillor	E C.	2024
15	Tiranë	Vilez - Vartese Mal Gjepalaj	Jashtë portalit	Histori	Arsimi Fillor	S. M	2024
16	Tiranë	Musine Kokalari	Jashtë portalit	Histori	Arsimi Fillor	P. K.	2024
17	Tiranë	Ymer Kurti, Lagje E Re	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	L. M	2024
18	Tiranë	Ymer Kurti, Lagje E Re - Vartese Pinet	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	A. P	2024
19	Tiranë	Hamdi Mancaku, Zall Dajt - Vartese Maricaj	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	S.K.	2024
20	Tiranë	Hamdi Mancaku, Zall Dajt - Vartese Selite E Malit	Jashtë portalit	Histori – Gjeografi	Arsimi Fillor	N. P	2024
21	Tiranë	Kico Blushi	Jashtë portalit	Histori	Arsimi Fillor	B S	2024
22	Tiranë	Bedri Llagami, Vaqarr	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	A. M.	2024
23	Tiranë	Emin Duraku	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	L. Sh.	2024
24	Tiranë	Dritas	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	N M.	2024
25	Tiranë	Ymer Lala - Vartese Murth	Jashtë portalit	Matematike – Fizike	Arsimi Fillor	B K	2024
26	Tiranë	Ymer Lala - Vartese Selbe	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	D. P	2024
27	Tiranë	Androkli Kostallari	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsimi Fillor	E. G	2024
28	Tiranë	16 Shtatori (5 Ore Ne Shkollen Qender + 3 Ore Ne Vartese Agron Hysenlliu) + Myrvete Peza 5 Ore + Shesh (3 Ore Ne Shkollen Qendedr + 2 Ore Vartese Menik) + Myslym Shima 4 Ore	Jashtë portalit	Histori	Shkenca Sociale	N.K.	2024
29	Tiranë	Vilez, Vartese Mner I Eperm	Jashtë portalit	Mesme E Pergjithshme	Gjeografi	F.M.	2024
30	Tiranë	16 Shtatori, Peze e Madhe	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	E .M.	2025
31	Tiranë	Bahri Nela - Vartese Dajt	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	M .K	2025
32	Tiranë	Bahri Nela - Vartese Selite	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	S.K.	2025
33	Tiranë	Bahri Nela - Vartese Shyqyrk	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	V.V	2025
34	Tiranë	Bahri Nela - Zall Bastar	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	E. B	2025
35	Tiranë	Lalm - vartese Allgjate	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	A.M.	2025
36	Tiranë	Vilez - Vartese Mal Gjepalaj	Jashtë portalit	Histori	Arsim Fillor	S. M.	2025
37	Tiranë	Ymer Kurti vartese Pinet	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	A. P	2025
38	Tiranë	Ymer Lala - vartese Darshen	Jashtë portalit	Parashkollor	Arsim Fillor	L. P	2025
39	Tiranë	Zenel Bastar, Bastar i Mesem	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	V .F	2025
40	Tiranë	Flamur Shkoza	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	Xh. Q	2025
41	Tiranë	Feti Vogli	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	E. L	2025
42	Tiranë	Zenel Bastar	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	A.A	2025
43	Tiranë	Jordan Misja	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	V.R.	2025
44	Tiranë	Bahri Nela	Jashtë portalit	Klarinete	Art Pamor	B .B.	2025
45	Tiranë	Edit Durham	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	I .X.	2025

46	Tiranë	Fan S. Noli	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	F .H	2025
47	Tiranë	Vasil Shanto	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	E. G	2025
48	Tiranë	Emin Duraku	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	A.K	2025
49	Tiranë	Andrea Stefani	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	P. M.	2025
50	Tiranë	Mustafa Kemal Ataturku	Jashtë portalit	Gjuhe shqipe	Arsim Fillor	E .L.	2025
51	Tiranë	Selman Meta	Jashtë portalit	Gjuhe Shqipe	Arsim Fillor	A. M	2025
52	Tiranë	16 Shtatori	Jashtë portalit	Gjeografi	Shkenca Sociale	O D.	2024
53	Tiranë	Mihal Grameno+Yzberisht	Jashtë portalit	Gjeografi	Art Pamor	D Y.	2024

Burimi: ZVAP Tiranë, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi është konstatuar se në ZVAP Vorë, janë punësuar aplikantë jashtë portalit të cilët rezultojnë gjithashtu të punësuar jashtë profilit, pra profili për të cilën aplikanti ka lidhur konratën provizore nuk është përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar, paraqitur si në vijim:

Tabela: Punësimet jashtë profilit, ZVAP Vorë

Nr	ZVAP	Shkolla që ka përzgjedhur	Nëse është punësuar nga portali apo me aplikante jashtë portal	Lloji kontrates (Me afat, pa afat)	Profili/Lënda (e kandidatit te punesuar)	Profili ne te cilin eshte punesuar	Emri Mbiemri	Viti
1	Vorë	Mb Shaban Sheshori Preze	Jashtë portalit	Me afat te caktuar	Histori	Shkenca Sociale	D.XH	2023
2	Vorë	9- Vjecare Berxull	Jashtë portalit	Me Afat	Gjuhe -Letersi	Arsimi Fillor	B.M	2024
3	Vorë	Vajdin Lamaj Domje	Jashtë portalit	Me afat	Histori	Arsim Fillor	S.D	2025

Nga auditimi është konstatuar se në ZVAP Rrogozhinë, janë punësuar aplikantë jashtë portalit të cilët rezultojnë gjithashtu të punësuar jashtë profilit, pra profili për të cilën aplikanti ka lidhur kontratën provizore nuk është përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar, paraqitur si në vijim:

Tabela: Punësimet jashtë profilit, ZVAP Rrogozhinë

Nr.	ZVAP	Shkolla që ka përzgjedhur	Nëse është punësuar nga portali apo me aplikante jashtë portali	Lloji kontratës (Me afat, pa afat)	Profili/Lënda (e kandidatit te punësuar)	Profili ne te cilin është punësuar	Emri Mbiemri	Viti
1	Rrogozhinë	IEVP Rrogozhinë	Jashtë portalit	Me afat te caktuar	Matematikë	Arsim Fillor	A.M	2023
2	Rrogozhinë	Hekuran Balliu	Jashtë portalit	Me afat te caktuar	Gjuhë Angleze	Histori	S.N	2023
3	Rrogozhinë	Ievp Rrogozhinë	Jashtë portalit	Me Afat Te Caktuar	Gjeografi	Gjuhë Shqipe Dhe Letërsi	A.Xh.	2024
4	Rrogozhinë	Kalush	Jashtë portalit	Me Afat Te Caktuar	Kimi	Arsimi Fillor	K.X	2024
5	Rrogozhinë	Haki Skuqi	Jashtë portalit	Me afat	Biologji	Matematikë	M.N	2025
6	Rrogozhinë	Xhorxh Soros	Jashtë portalit	Me afat	Histori	Art Pamor	A.K	2025
7	Rrogozhinë	Rreth Greth	Jashtë portalit	Me afat	Histori	Arsim Fillor	F.S	2025
8	Rrogozhinë	Zhabjak	Jashtë portalit	Me afat	Gjeografi	Arsim Fillor	Xh.Xh	2025

Burimi: ZVAP Rrogozhinë, përpunuar nga grupi i auditimit

Kjo situatë paraqet risk të lartë për cenimin e transparencës dhe integritetit të procesit të rekrutimit, duke krijuar mundësi për përzgjedhje jo objektive dhe trajtim jo të barabartë të kandidatëve, veçanërisht me kandidatët që rezultojnë në pritje në portalin "Mësues për Shqipërinë". Mospërputhja ndërmjet profilit të diplomimit dhe lëndës së zhvilluar në mësimdhënie rrit riskun për ulje të cilësisë së procesit arsimor dhe mosgarantim të standardeve profesionale në sistemin parauniversitar. Gjithashtu, mangësitë në verifikimin e kritereve dhe dokumentacionit të kandidatëve tregojnë dobësi në mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe në administrimin e procedurave të punësimit, duke krijuar ekspozim ndaj praktikave jo në përputhje me kriteret e përcaktuara për emërimin e personelit mësimor. Këto veprime ndikojnë negativisht në besueshmërinë e procesit të rekrutimit, në parimin e meritokracisë dhe në garantimin e një sistemi të drejtë dhe të standardizuar të përzgjedhjes së personelit arsimor.

Këto veprime bien në kundërshtim me pikën 4, neni 57 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për arsimin parauniversitar në RSH", i ndryshuar ku citohet se:

4. Profesioni i mësuesit mund të ushtrohet edhe nga individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuara në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar. Diplomat e njëvlershme, diplomat e ngjashme ose të përafërta me diplomat e sipërpërmendura të këtij neni në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar dhe kriteret për hapjen e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psikopedagogjike përcaktohen me udhëzim të ministrit;

Dhe shtojcën 1 të Udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023 *"Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimore".*

Nga ZVAP Tiranë, konkretisht nga znj. E.M është dërguar observacion nr. 56054/1 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/11 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:

Në lidhje me gjetjen 10: Në lidhje me këtë evidentim sqarojmë se:

- Aplikimi i punësimeve jashtë portalit, e sanksionuar në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2023. i ndryshuar, është një procedurë e cila ka ardhur si rrjedhoje problematikave të shumta që janë krijuar nëpër shkolla si rezultat i mungesës së mësuesve.
- Aplikimi i procedurës së punësimeve jashtë portalit është bërë absolutisht kur për një vend të lirë pune, kanë refuzuar të gjithë kandidatët e portalit "Mësues për Shqipërinë", në nivel ZVAP Tiranë por edhe të të gjithë kandidatëve të portalit "Mësues për Shqipërinë", të të gjitha ZVAP nën juridiksionin DRAP Tiranës.
- Vendet e lira të refuzuar (mos pranuara) nga kandidat e portalit (nivel ZVAP Tirane apo DRAP Tiranë) janë të shumta dhe kjo referuar zonave shumë të largëta të këtyre vendeve të lira të punës, afateve të shkurtra provizore të këtyre vendeve të lira të punës, etj.
- Aplikimet e kandidatëve për punësime nëpërmjet procedurave jashtë portalit, në vetvete përfshin kandidatë të cilët ose janë refuzuar për të qenë pjesë e portalit ose nuk plotësojnë 100 % kriteret për të qenë mësues (nuk kanë mbaruar ciklin e dytë të studimeve, nuk kanë marrë licencë, etj). Në rastet e punësimeve të këtyre kandidatëve (përkatësisht gjuhë shqipe në mësues të Arsimit fillor), një situatë e tillë është imponuar :
- Nga mungesa e kandidatëve jashtë portalit të arsimit fillor në raport me vendet e lira të punës që janë raportuar për tu plotësuar me kandidatë jashtë portalit (vendet e lira të punës që janë refuzuar / nuk janë pranuar nga kandidatët e portalit "Mësues për Shqipërinë" nivel ZVAP Tirane apo DRAP Tiranë).
- Shmangia e lënies së shkollës pa mësim.
- E vetmja zgjidhje që mund të jepet dhe të merret për të plotësuar vendin e lirë të punës, duke zgjedhur të keqen më të vogël, për të shmangur shkollën pa mësues dhe duke mos i lënë nxënësit pa mësim.
- Këta kandidatë pavarësisht se nuk kanë qenë të arsimit Fillor e kanë kryer këtë detyrë më së miri dhe ne vazhdimësi nuk është raportuar asnjëherë asnjë ankesë, përkundrazi shkollës dhe nxënësve u është siguruar arsim.

Gjithashtu sqarojmë se në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2023, i ndryshuar nuk është sanksionuar asnjë procedurë që duhet të ndiqet nga ZVAP në lidhje me menaxhimin e punësimeve jashtë portalit dhe është ZVAP Tiranë e cila, referuar procedurës që ndiqet për punësimet jashtë portalit ka përshtatur një procedurë për punësimet jashtë portalit. Sqarojmë edhe njëherë që punësimet jashtë portalit është një zgjidhje e momentit për një problem emergjent dhe absolutisht në të gjitha rastet emërimet janë provizore dhe asnjëherë definitive.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nuk është kundërshtuar gjetja e grupit të auditimit në lidhje me punësimet jashtë portalit, por janë sqaruar arsyet, ardhur kryesisht si rrjedhoje problematikave të shumta që janë krijuar nëpër shkolla si rezultat i mungesës së mësuesve.

2.4 Mbi veprimtarinë e monitorimit të kurrikulës dhe inspektime të kryera në institucionet e arsimit parauniversitar

2.4.1 Monitorimet e DRAP Tiranë viti 2025

Veprimtaria e Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës bazohet në Urdhrin 153, datë 17.04.2025 të Ministrisë së Arsimit "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" në nenin 21 të saj në të cilën parashikohen detyrat kryesore të Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar nuk është miratuar një rregullore e brendshme lidhur me veprimtarinë, procedurat dhe afatet mbi monitorimin që kryen në institucionet e arsimit parauniversitar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës.

Pika 3, neni 25 i ligjit 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar citon: *"Institucionet e varësisë të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të cilat do të kryejnë funksionet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, krijohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi në fushën e organizimit e të funksionimit të institucioneve të administratës shtetërore dhe legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".*

Pika 2, neni 69 i ligjit 69/2012, i ndryshuar citon: *"Vendimi për dënimin e kundërvajtësit, sipas pikës 1 të këtij neni, është në kompetencën e institucionit përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor dhe merret në vend me konstatimin e shkeljes nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor sipas legjislacionit për inspektimin".*

Për sa më sipër bazuar në ligjin nr. 99/2024, kreu VI, "Trajnimi dhe testimi i inspektorëve", neni 23 ku citohet: "Inspektorët qendror i nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit, në përfundim të kohës së provës, si dhe testimit periodik pas konfirmimit. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik bëhen në bazë të një provimi që organizohet nga Inspektorati i Përgjithshëm, nenit 24 ku citohet se:

1. Inspektori në kohë prove mund të kryejë veprime inspektimi vetëm nën mbikëqyrjen e një inspektori të konfirmuar në detyrë.
2. Inspektori i konfirmuar në detyrë mbikëqyr veprimet e inspektorit në kohë prove dhe nënshkruan çdo akt të tij. Nënshkrimi është kusht për vlefshmërinë e aktit të inspektimit. Punonjësit e Sektorëve të inspektimit pranë DRAP Tiranë ende nuk kanë kryer testimin dhe nuk janë në përputhje me nenin 38, pika 4 ku citohet: *"Para fillimit të procedurës së inspektimit, inspektori identifikohet me kartën e inspektorit".*

Nga auditimi konstatohet se inspektorët e DRAP nuk kanë qenë të pajisur me kartë, në kundërshtim me pikën 4, nenin 38 të ligjit nr. 99/2024.

Rezulton se inspektorët në periudhë prove janë pajisur me kartë në tetor 2025. Kjo ka sjellë që nga ana e DRAP Tiranë për këtë periudhë nuk janë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në nenin 21, pika 5 dhe 6 të Rregullores nr. 153, datë 17.04.2025 "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar", ku citohet se:

Pika 5: Detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit të Arsimit Parashkollor:

a) Inspekton dhe nxjerr përfundime mbi zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parashkollore publike dhe private si dhe merr masat administrative përkatëse në rastet e konstatimit të shkeljeve.

b) Inspekton institucionet arsimore parashkollore mbi cilësinë e ofrimit të shërbimit arsimor, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe merr masat administrative përkatëse në rast se konstaton shkelje.
c) Kontrollon zbatimin e rekomandimeve të lëna nga gjetjet e inspektimit prej institucionit arsimor përkatës.
d) Inspekton zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi për regjistrimin e nxënësve në sistemin parashkollor.
Pika 6: Detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit të Arsimit Bazë dhe të Arsimit të mesëm të Lartë:
a) Inspekton dhe nxjerr përfundime mbi zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike, si dhe merr masat administrative përkatëse në rast se konstaton shkelje.
b) Inspekton veprimtarinë e institucioneve parauniversitare publike ose private mbi zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe merr masat administrative përkatëse në rast se konstaton shkelje.
c) Inspekton zbatimin e rregulloreve të Maturës Shtetërore dhe provimeve të arsimit bazë.
d) Inspekton shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
e) Inspekton zbatueshmërinë e akteve nënligjore për regjistrimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar.
f) Inspekton veprimtarinë dhe zbatueshmërinë e akteve ligjore nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe i paraqet Drejtorit të Përgjithshëm të AKAP raportet e inspektimit dhe rekomandimet përkatëse sipas rastit…
Me shkresën nr. 1593 prot., datë 26.06.2025 Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar i ka dërguar DRAP Tiranë verifikimin e subjekteve sipas listës bashkëlidhur dhe informimin zyrtarisht të AKAP përmes një relacioni përmbledhës nëse këto subjekte ushtrojnë veprimtarinë si kopsht pa licencë. Në rast të konstatimeve të ushtrimit të veprimtarisë si kopsht pa licencë, DRAP duhet të vijojë me dhënien e dënimeve administrative sipas përcaktimeve të nenit 69, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar më RSH", i ndryshuar.
Në vijim, me shkresën nr. 921/1 prot., datë 02.07.2025 DRAP Tiranë ka nxjerr Urdhrin nr. 46, datë 02.07.2025 "Për verifikim në vend të subjekteve private pa licencë".
Me shkresën nr. 921/2 prot., datë 09.07.2025 DRAP Tiranë ka informuar Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar në lidhje me subjektet që ushtrojnë veprimtarinë si kopshte. Sipas kësaj shkrese, 4 kopshte private janë gjetur pa licencë për të ushtruar veprimtarinë si institucione arsimore parashkollore ndërsa 3 kopshte të tjerë nuk janë gjetur në adresën e deklaruar.
Për shkak të mos pajisjes me kartë inspektori, DRAP Tiranë nuk ka vijuar me vendosjen e masave administrative.
Grupi i auditimit i ka kërkuar DRAP Tiranë informacion në lidhje me vijueshmërinë e masave kundrejt këtyre subjekteve.
AKAP Tiranë i ka konfirmuar DRAP Tiranë se nga ana e AKAP janë vendosur dënime administrative kryesore "Gjobë" në vlerën 1,000,000 lekë si dhe dënim administrative plotësues "Ndërprerje e menjëhershme e veprimtarisë", sipas email-it data 04.03.2026.
Megjithatë DRAP Tiranë për vitin 2025 ka kryer monitorime*. *Për sa i përket mungesës së inspektimeve për periudhën janar-tetor 2025 përgjegjësia i takon Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar për emërimin e punonjësve të cilët nuk kanë plotësuar kriteret e përcaktuara për kryerjen e inspektimit.
Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë është vënë në dispozicion shkresa nr.16 prot., datë 08.01.2025 Plani Vjetor 2025 e miratuar nga Titullari i njësisë publike. Në këtë

plan parashikohet misioni, synimi, detyrat kryesore të sektorëve, objektivat e sektorëve, si dhe plani i veprimtarisë sipas sektorëve të Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës në DRAP Tiranë.
Referuar shkresës nr. 50 prot., datë 09.01.2026, Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës, për këtë vit ka realizuar 75 monitorime, nga të cilat: *24 në kopshte, 40 monitorime në 9-vjeçare, 8 në gjimnaze, 1 në ZVA Rrogozhinë, 1 në Qendrën Burimore "Luigj Gurakuqi", 1 në Shkollën e Bashkuar "16 Shtatori".*
Referuar këtij plani vjetor të realizimeve, nga ana e grupit të auditimit është kërkuar dokumentacion lidhur me procedurën e verifikimit dhe inspektimit mbi 8 procedura të përzgjedhura.
Nga dosjet e përzgjedhura u konstatua si në vijim:

1. Monitorimi për shkollën 9-vjeçare Marqinet – verifikim ankese

Nisur nga ankesa e znj. O.G me nr. 910120 bërë në platformën e Bashkëqeverisjes, nga kjo e fundit është përcjellë në DRAP Tiranë për ndjekje, me shkresën nr. 3930/1 prot., datë 30.06.2025. Ankesa lidhet me procedurën e emërimit të nëndrejtorit të shkollës 9-vjeçare "Marqinet". Në vijim nga ana e DRAP Tiranë është nxjerrë Urdhri nr. 48, datë 07.07.2025 "Për ngritjen e punës për verifikim", si në vijim: znj. E. N, Drejtore, Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës; znj. B.C, Përgjegjëse e Sektorit të IABAML; znj. I.H, Specialiste e Sektorit të IABAML.
Me shkresën nr. 923/3 prot., datë 04.08.2025 i është dërguar raporti i monitorimit Institucionit Arsimor "Marqinet", ZVA Vorë, MASR dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.
Sipas këtij verifikimi janë konstatuar problematika në drejtim të procedurës, konkretisht:
- Drejtori i IPAP-së nuk ka njoftuar zyrtarisht ZVAP-në menjëherë nga krijimi i vendit të lirë për nëndrejtor, në kundërshtim me shkronjën a, pikën 2, nenin 1 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar", i ndryshuar.
- ZVAP Vorë dhe IPAP "Marqinet" nuk kanë përcaktuar datën e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit, afatin e plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak, fushat e njohurive dhe aftësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar, datën e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyrën e konkurrimit të tyre, të drejtën dhe afatet e ankimit për çdo fazë të konkurrimit, në kundërshtim me shkronjat c, e, d, e, f, g, pika 3, neni 1 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023.
- Ka një mospërputhje për mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit dhe afatet e dorëzimit, nga njoftimi i ZVAP-së dhe IPAP-së.
- Urdhri për ngritjen e komisionit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të aplikimit të kandidatëve nuk është ngritur me emra konkretë, në kundërshtim me pikën 4, nenin 5 të Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023.
- Nuk është respektuar procedura për zgjedhjen e dy mësuesve me votim të fshehtë.
- Në lidhje me caktimin e drejtuesit të Komisionit, ekzistojnë dy dokumente të ndryshëm.
- Në procesverbalet e mbajtur për dy kandidatët e intervistuar nuk pasqyrojnë pyetje-përgjigjet dhe nuk është përcaktuar numri i faqeve në mbylljen e tyre. Procesverbali nuk ka datë, nunër protokolli, nuk ka nënshkrim etj., në kundërshtim me Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH".
- ZVAP Vorë nuk ka respektuar afatin e kthimit të përgjigjes brenda 3 ditëve pune, për ankesën e kandidates jo fituese.
- Nuk ka një vendim për emërimin e nëndrejtorit IPAP-së dhe komunikimit zyrtarisht të nëndrejtorit të sapoemëruar.

Rekomandimet e lëna nga grupi i punës për ZVAP-në Vorë dhe IPAP "Marqinet":
- Të anulohet procedura për emërimin e nëndrejtorit të IPAP "Marqinet".
- Të rishpallet procedura për përzgjedhjen e nëndrejtorit të IPAP "Marqinet".
Nga auditimi konstatohet se raporti monitorimit është trajtuar përgjithësisht në mënyrë të plotë dhe rekomandimet janë në koherencë me problematikat e konstatuara.

2. Verifikim ankese

Nga auditimi konstatohet se nga ana e z. A.D, është bërë ankesë me objekt punësimin me kontratë pune pa afat të znj. A.M, dërguar nga AKAP në DRAP Tiranë me shkresën nr. 411/3 prot., datë 06.02.2025 "Për ndjekje dhe kompetencë".
Në vijim të kësaj ankese, nga DRAP Tiranë është me Urdhrin nr. 21, datë 18.03.2025 është ngritur grupi i punës për verifikimin e ankesës, si në vijim: znj. B.C, Përgjegjëse e Sektorit të Inspektimit në AB dhe AML; znj. I.H, Specialiste e Sektorit të Inspektimit më AB dhe AML; znj. E.A, Specialiste e Sektorit të Kurrikulës dhe zhvillimit profesional.
Grupi i punës është caktuar të verifikojë:
- formimin dhe ndarjen e klasave në IA në varësi të ZVAP Rrogozhinë;
- shpërndarjen e ngarkesës mësimore në lëndën TIK për çdo shkollë;
- orët e lira për lëndën Tik;
- vendet vakante për këtë profil;
- procedurat e punësimit të mësuesve të profilit TIK, në vitin shkollor 2024-2025.
Me shkresën nr. 361/3 prot., datë 02.04.2025 nga DRAP Tiranë është dërguar raporti i monitorimit, me konstatimet si në vijim:
- Jo në të gjitha shkollat është zbatuar Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar", konkretisht shkollat 9-vjeçare Lekaj, Haki Skuqi, Stërbeg,
- Nga ana e drejtuesve të IA-së ngarkesa mësimore nuk është bërë në zbatim me udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023, kreu V, pika 2.
- Orët e lira të profilit TIK, IA-të i kanë raportuar pjesërisht. Disa nga këto orë u janë dhënë mësuesve jashtë profilit.
- Për vitin shkollor 2024-2025, për profilin TIK nuk ka raportime për vend vakant.
- Në njoftimet e procedurës së punësimit të mësuesve të profilit TIK, në njoftime nuk janë pasqyruar të gjitha orët e lira të këtij profili.
Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:
- marrjen e masës disiplinore për drejtorin e ZVAP Rrogozhinë për moszbatim të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara.
- zbatimi me përgjegjësi i Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2923 nga IA-të nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë.
- zbatimi i nenit 43, pika 2, shkronja dhe a dhe b të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020, nga titullari i ZVAP Rrogozhinë.
- zbatimi me përgjegjësi i Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 dhe udhëzimit nr. 19, datë 29.08.2024, nga ZVAP Rrogozhinë.
- protokollimi i të gjitha dokumenteve zyrtare hyrëse dhe dalëse nga ZVAP Rrogozhinë.
- krijimi i formateve standard për të gjitha IA-të në lidhje me raportimin e ngarkesës mësimore, statistikën e numrit të nxënësve dhe krijimin e klasave. Raportimi i orëve të lira për të gjitha profilet sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore.
- respektimin e kuadrit ligjor për kontratën e lidhur mes punëdhënësit drejtues së shkollës "George Soros", znj. D.S dhe punëmarrësit znj. A.M.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e grupit të punës nuk është realizuar objekti i plotë i verifikimit, duke qenë se shkresa nr. 411/3 prot., datë 06.02.2025 lidhet me ankesën për punësimin e znj. A.M, për të cilën në raportin e monitorimit mungon rekomandimi konkret në lidhje me këtë procedurë. Pra në thelb edhe vet rekomandimi nuk është as konkret, as i matshëm duke e bërë të vështirë ndjekjen e zbatimit të tij.

3. Verifikim ankese

Nga auditimi konstatohet se nga ana e znj. E.A, është bërë ankesë në drejtim të menaxhimit të shkollës 1 Maji nga ana e drejtueses znj. E. L, dërguar nga AKAP në DRAP Tiranë me shkresën nr. 226 prot., datë 24.02.2025 "Për ndjekje dhe kompetencë".

Në vijim të kësaj ankese nga ana e DRAP Tiranë me Urdhrin nr. 14 datë 26.02.2025 është ngritur grup pune si në vijim: znj. E.N, Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës; znj. B.C, Përgjegjës i Sektorit të Inspektimit për AB dhe AML; znj. E.E, Specialiste e Sektorit MVKZHP.

Me shkresën nr. 226/2 prot., datë 05.03.2025 nga DRAP Tiranë është dërguar raporti pas verifikimit të kryer.

Sipas këtij raporti problematikat e konstatuara paraqiten si në vijim:

- znj. E.A që ka dërguar ankesën nuk është prind i shkollës 9-vjeçare "1 maj" dhe për pasojë as përfaqësues i Këshillit të Prindërve të shkollës.

Për pretendimet e ngritura nga ana e ankueses kundrejt drejtueses së shkollës, nga kjo e fundit është e dokumentuar procedura e kryer për drejtimin e shkollës.

Grupi i punës ka lënë këto rekomandime:

- të zbatohet me përgjegjësi urdhri nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH" i ndryshuar. Në vëmendje zbatimi i nenit 59 "Koha e punës në institucionet arsimore publike", pika 4.
- të dokumentohen procedurat në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për veprimtaritë e ndryshme që realizohen në shkollë.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e grupit të verifikimit mungojnë rekomandime konkrete dhe të matshme çka e dobëson vlerën praktike të raportit dhe e bën të vështirë ndjekjen e zbatimit të tij. Gjithashtu, rekomandimi i dytë paraqitet në kundërshtim me konkluzionin e vetë grupit, sipas të cilit nga ana e drejtueses është dokumentuar procedura për veprimtarinë dhe drejtimin e shkollës. Ky mospërputhje ndërmjet konkluzioneve dhe rekomandimeve krijon paqartësi në interpretim dhe lë hapësirë për keqkuptime gjatë zbatimit.

4. Monitorim për kopshtin nr. 65 "Borëbardha", Tiranë

Me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 DRAP Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e zbatimit të kritereve për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar publik", konkretisht për kopshtin nr. 65 "Borëbardha", Tiranë, si në vijim: M.B; Xh.B.

DRAP Tiranë me shkresën nr.1395/13 prot., datë 14.10.2025, ka përcjellë raportin e monutorimit, drejtuar Kopshtit nr. 65 "Borëbardha", ZVA Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Cerdheve dhe Kopshteve dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka evidentuar këto problematika:

-Kopshti Nr. 65 dhe kopshti vartës "7 Xhuxhat", kërkojnë përmirësime në infrastrukturë për të siguruar më shumë hapësirë dhe komoditet, veçanërisht për grupet me numër të lartë fëmijësh që të garantojë cilësi më të lartë shërbimi dhe mësimdhënie.

- Organizimi i kopshtit "7 Xhuxhat" funksionon si institucion pa ushqim, me dy grupe të veçanta që kanë më pak se 25 fëmijë për grup. Pra nuk përmbush kriteret e formimit të grupeve sipas

Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Drejtoresha e Institucionit ka planifikuar ngarkesën mësimore prej 18 orësh në javë por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kjo ngarkesë nuk është plotësuar, në mospërputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023.
- Nga ana e Drejtoreshës së institucionit nuk është planifikuar dhe as realizuar ngarkesa prej 6 orësh në javë e parashikuar për procesin e vlerësimit, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023.
Nga grupi i punës janë lënë këto rekomandime:
- Të realizohet riorganizimi i strukturës së grupeve mësimore në kopshtin vartës “7 Xhuxhat”
- Drejtoria e kopshtit të garantojë përmbushjen e plotë të ngarkesës javore prej 18 orësh mësimore nga drejtuesja e institucionit…”
- Drejtoria e kopshtit të planifikojë dhe të realizojë ngarkesën javore prej 6 orësh për procesin e vlerësimit…”
- Drejtoria e kopshtit të përmirësojë menaxhimin e hapësirave fizike në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore…”
- ZVA Tiranë të kryejë monitorime të rregullta dhe të vazhdueshme për zbatimin e plotë të Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023.
Nga auditimi u konstatua se, sipas raportit të monitorimit të përgatitur nga grupi i monitorimit, nuk është kryer verifikimi i plotë nëse pagesa e Drejtorit të institucionit është realizuar në përputhje me ngarkesën faktike të punës. Konkretisht, nuk është verifikuar nëse pagesa është kryer e plotë apo është reflektuar në mënyrë të saktë ngarkesa e parealizuar e orëve mësimore si dhe ngarkesa e parealizuar për procesin e vlerësimit. Mosverifikimi i përputhshmërisë së pagesës me ngarkesën reale të punës krijon risk për kryerjen e pagesave të padrejta ose jo në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke sjellë mundësi për përdorim joefektiv të fondeve publike dhe duke dobësuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i raportit rezulton se as në rekomandimet e dhëna nga grupi i monitorimit nuk është kërkuar kryerja e këtij verifikimi nga strukturat përkatëse për realizimin e pagesës në përputhje ose jo me orët faktike të realizuara përsa i përket ngarkesës mësimore dhe procesit të vlerësimit.

5. Monitorim për kopshtin “Yjet” Tiranë

Me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 DRAP Tiranë ka ngritur grupin e punës “Për verifikimin e zbatimit të kritereve për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar publik”, konkretisht për kopshtin “Yjet”, Vorë, si në vijim: M.B; Xh.B.
DRAP Tiranë me shkresën nr.1395/4 prot., datë 08.10.2025, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar Kopshtit “Yjet”, ZVA Vorë, Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.
Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka evidentuar këto problematika:
- Drejtoresha e Institucionit nuk ka planifikuar dhe nuk ka realizuar ngarkesën mësimore prej 15 orësh në javë, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023.
- Nga ana e Drejtoreshës së institucionit nuk është planifikuar dhe as realizuar ngarkesa prej 6 orësh në javë e parashikuar për procesin e vlerësimit, jo në përputhje me Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023.
- Në disa grupe numri i fëmijëve është më pak se 15, duke mos përmbushur kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 14, datë 10.07.2023.

- Znj. A.M e cila është caktuar drejtuese e përgjithshme e kopshtit, paraqitet vetëm 1 herë në muaj dhe ushtron funksionin e saj si drejtuese jo vetëm në kopshtin "Yjet" po edhe në 13 kopshte të tjera në juridiksionin përkatës.
- Njësia e vetëqeverisjes vendore e Bashkisë Vorë, nuk ka emëruar një drejtues të posaçëm për kopshtin "Yjet", pavarësisht se institucioni ka mbi 5 grupe funksionale dhe një numër të konsiderueshëm fëmijësh. Kjo ka sjellë mangësi të dukshme në drejtimin dhe menaxhimin e institucionit.

Nga grupi i punës janë lënë këto rekomandime:
- Të realizohet riorganizimi i strukturës së grupeve mësimore në kopshtin Yjet…"
- Drejtoria e kopshtit të garantojë përmbushjen e plotë të ngarkesës javore prej 15 orësh mësimore nga drejtuesja e institucionit…"
- Drejtoria e kopshtit të planifikojë dhe të realizojë ngarkesën javore prej 6 orësh për procesin e vlerësimit…"
- ZVA Vorë të kryejë monitorime të rregullta dhe të vazhdueshme për zbatimin e plotë të Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023.
- Njësia e vetëqeverisjes vendore e Bashkisë Vorë, të emërojë një drejtues të posaçëm për kopshtin "Yjet duke qenë se ky kopsht ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh me mbi 5 grupe funksionale…"

Nga auditimi u konstatua se, sipas raportit të monitorimit të përgatitur nga grupi i monitorimit, nuk është kryer verifikimi i plotë nëse pagesa e Drejtorit të institucionit është realizuar në përputhje me ngarkesën faktike të punës. Konkretisht, nuk është verifikuar nëse pagesa është kryer e plotë apo është reflektuar në mënyrë të saktë ngarkesa e parealizuar e orëve mësimore si dhe ngarkesa e parealizuar për procesin e vlerësimit. Mosverifikimi i përputhshmërisë së pagesës me ngarkesën reale të punës krijon risk për kryerjen e pagesave të padrejta ose jo në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke sjellë mundësi për përdorim joefektiv të fondeve publike dhe duke dobësuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i raportit rezulton se as në rekomandimet e dhëna nga grupi i monitorimit nuk është kërkuar kryerja e këtij verifikimi nga strukturat përkatëse për realizimin e pagesës në përputhje ose jo me orët faktike të realizuara përsa i përket ngarkesës mësimore dhe procesit të vlerësimit.

6. Monitorim për kopshtin Nr. 41, Tiranë

Me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 DRAP Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e zbatimit të kritereve për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar publik", konkretisht për kopshtin Nr. 41, Tiranë, si në vijim: M.B; Xh.B.

DRAP Tiranë me shkresën nr.1395/10 prot., datë 08.10.2025, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar Nr. 41, ZVA Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka evidentuar këto problematika:
- Mjediset e kopshtit janë funksionale por kërkojnë përmirësime në hapësirë për grupet me numër të madh fëmijësh.
- Drejtoresha e kopshtit znj. M.Gj ka parashikuar por nuk ka realizuar ngarkesën mësimore prej 18 orëve në jave.
- Nga verifikimi i dokumentacionit nuk është parashikuar dhe nuk është realizuar ngarkesa prej 6 orë në jave për procesin e vlerësimit.

Nga grupi i punës janë lënë këto rekomandime:

- Drejtoria e kopshtit të garantojë përmbushjen e plotë të ngarkesës javore prej 18 orësh mësimore nga drejtuesja e institucionit…"
- Drejtoria e kopshtit të planifikojë dhe të realizojë ngarkesën javore prej 6 orësh për procesin e vlerësimit…"
- Drejtoria e kopshtit të përmirësojë menaxhimin e hapësirave fizike duke bashkëpunuar me njësinë vendore për të shtuar klasat ose për të zgjeruar hapësirat ekzistuese…"
- ZVA Tiranë të kryejë monitorime të rregullta dhe të vazhdueshme për zbatimin e plotë të Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023.

Nga auditimi u konstatua se, sipas raportit të monitorimit të përgatitur nga grupi i monitorimit, nuk është kryer verifikimi i plotë nëse pagesa e Drejtorit të institucionit është realizuar në përputhje me ngarkesën faktike të punës. Konkretisht, nuk është verifikuar nëse pagesa është kryer e plotë apo është reflektuar në mënyrë të saktë ngarkesa e parealizuar e orëve mësimore si dhe ngarkesa e parealizuar për procesin e vlerësimit. Mosverifikimi i përputhshmërisë së pagesës me ngarkesën reale të punës krijon risk për kryerjen e pagesave të padrejta ose jo në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke sjellë mundësi për përdorim joefektiv të fondeve publike dhe duke dobësuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i raportit rezulton se as në rekomandimet e dhëna nga grupi i monitorimit nuk është kërkuar kryerja e këtij verifikimi nga strukturat përkatëse për realizimin e pagesës në përputhje ose jo me orët faktike të realizuara përsa i përket ngarkesës mësimore dhe procesit të vlerësimit.

7. Monitorim për kopshtin Nr. 22 "Kuriozët e vegjël", Tiranë

Me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 DRAP Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e zbatimit të kritereve për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor në institucionet e arsimit parauniversitar publik", konkretisht për kopshtin Nr. 22 "Kuriozët e Vegjël", Tiranë, si në vijim: M.B, Xh.B.

DRAP Tiranë me shkresën nr.1395/8 prot., datë 08.10.2025, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar Nr. 22, ZVA Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka evidentuar këto problematika:
- Mjediset e kopshtit janë funksionale por kërkojnë përmirësime në hapësirë për grupet me numër të madh fëmijësh.
- Drejtoresha e kopshtit znj. M.Gj ka parashikuar por nuk ka realizuar ngarkesën mësimore prej 18 orëve në javë.
- Nga verifikimi i dokumentacionit nuk është parashikuar dhe nuk është realizuar ngarkesa prej 6 orë në jave për procesin e vlerësimit.

Nga grupi i punës janë lënë këto rekomandime:
- Drejtoria e kopshtit të garantojë përmbushjen e plotë të ngarkesës javore prej 18 orësh mësimore nga drejtuesja e institucionit…"
- Drejtoria e kopshtit të planifikojë dhe të realizojë ngarkesën javore prej 6 orësh për procesin e vlerësimit…"
-Drejtoria e kopshtit të përmirësojë menaxhimin e hapësirave fizike duke bashkëpunuar me njësinë vendore për të shtuar klasat ose për të zgjeruar hapësirat ekzistuese…"
- ZVA Tiranë të kryejë monitorime të rregullta dhe të vazhdueshme për zbatimin e plotë të Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023.

Nga auditimi u konstatua se, sipas raportit të monitorimit të përgatitur nga grupi i monitorimit, nuk është kryer verifikimi i plotë nëse pagesa e Drejtorit të institucionit është realizuar në përputhje me ngarkesën faktike të punës. Konkretisht, nuk është verifikuar nëse pagesa është kryer e plotë

apo është reflektuar në mënyrë të saktë ngarkesa e parealizuar e orëve mësimore si dhe ngarkesa e parealizuar për procesin e vlerësimit. Mosverifikimi i përputhshmërisë së pagesës me ngarkesën reale të punës krijon risk për kryerjen e pagesave të padrejta ose jo në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi, duke sjellë mundësi për përdorim joefektiv të fondeve publike dhe duke dobësuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar të institucionit. Gjithashtu, nga shqyrtimi i raportit rezulton se as në rekomandimet e dhëna nga grupi i monitorimit nuk është kërkuar kryerja e këtij verifikimi nga strukturat përkatëse për realizimin e pagesës në përputhje ose jo me orët faktike të realizuara përsa i përket ngarkesës mësimore dhe procesit të vlerësimit.

Nga DRAP Tiranë, konkretisht nga znj. B.S , është dërguar observacion nr. 1222 prot., datë 17.07.2026, protokolluar në KLSH me nr. 10/12 prot., datë 20.07.2026 si në vijim:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me gjetjen nr. 11, sqarojmë se procedura e pajisjes së inspektorëve me kartën e inspektorit nuk ka qenë në varësi të DRAP Tiranë, por është zhvilluar nga institucionet kompetente në zbatim të legislacionit për inspektimin shtetëror. Kjo procedurë eshtë zhvilluar në kushtet e ndryshimit të kuadrit ligjor, nga Ligji nr. 10433, dateë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i botuar në Fletoren Zyrtare më 13.11.2024 dhe që, sipas nenit 129 të tij, ka hyrë në fuqi gjashtë muaj pas botimit. Po kështu, me Vendimin nr. 100/2024 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë rrëzoi Dekretin nr. 357, datë 10.10.2024, për kthimin e këtij ligji në Kuvend, duke bërë të mundur vijimin e procedurave për zbatimin e tij.

Në zbatim të Ligjit nr. 99/2024 u miratua edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 16.07.2025, "Për përcaktimin e rasteve të testimit fillestar, intervaleve të testimit periodik, si dhe procedurës së provimit e të kritereve të vlerësimit", i cili përcaktoi procedurat konkrete përtestimin dhe pajisjen me kartën e inspektorit. Në dispozitat kalimtare të këtij vendimi, konkretisht në pikat 2 dhe 3 të Kreut VIII, parashikohet se inspektorët, të cilëve u kishte përfunduar periudha e provës përpara hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 99/2024 dhe të këtij vendimi, nuk i nënshtrohen procedurës së testimit fillestar për konfirmimin në detyrë, ndërsa ky parashikim zbatohet edhe për inspektorët, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës ose nga legjislacioni për nëpunësin civil.

Në zbatim të këtij kuadri ligjor, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Inspektorati i Përgjithshëm administruan të gjithë procesin e trajnimit, testimit dhe pajisjes me kartën e inspektorit. Nga korrespondenca në periudhë zyrtare rezulton se fillimisht u zhvilluan trajnimet për inspektorët Përgjithshëm prove, deri ndërsa testimi i planifikuar u shty me vendimmarrje të Inspektoratit të në një njoftim të dytë. Vetëm pas përfundimit të procedurave të parashikuara nga inspektorit, legjislacioni të cilën në e fuqi, tërhoqën në muajin tetor 2025, punonjësit u njoftuan për tërheqjen e kartës së menjëherë.

Ndërkohë, marrëdhënia e punës së inspektorëve ka qenë e rregullt dhe është rregulluar nga dispozitat e Kodit të Punës. Ata janë emëruar në mënyrë të ligjshme nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe gjatë gjithë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar detyrat funksionale të ngarkuara nga punëdhënësi. Punonjësit e dy sektorëve të inspektimit kanë realizuar monitorime sipas programit vjetor dhe tematikave të miratuara në institucionet arsimore publike dhe private, kanë hartuar rekomandime, kanë propozuar masa administrative sipas konstatimeve të evidentuara dhe, duke filluar nga muaji shkurt 2025, janë bërë pjesë e trupave inspektuese të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, duke ushtruar funksionet për të cilat ishin emëruar. Për rrjedhojë, mungesa e kartës së inspektorit gjatë periudhës janar-tetor 2025 nuk lidhej me mungesën e marrëdhënies së punës apo me mosushtrimin e detyrave funksionale nga inspektorët, por ishte pasojë e procedurave tranzitore të parashikuara nga legjislacioni i ri për inspektimin shtetëror, procedura të cilat ishin në kompetencë të institucioneve përgjegjëse dhe jashtë vullnetit të DRAP Tiranë.

Në lidhje me gjetjen nr. 13, lidhur me konstatimin e projekt-raportit se, gjatë monitorimeve të kryera nga grupi i monitorimit i ngritur me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 të DRAP Tiranë, nuk është verifikuar nëse pagesa e drejtorit të institucionit parashkollor publik është kryer në përputhje me ngarkesën faktike të punës, sqarojmë se ky konstatim nuk merr në konsideratë objektin e monitorimit dhe kompetencat e grupit të punës, të përcaktuara në urdhrin përkatës. Referuar Urdhrit nr. 78, datë 15.09.2025, grupi i monitorimit është ngritur për verifikimin e zbatimit të kritereve për numrin e fëmijëve në grupe/klasa, zbatimin e

ngarkesës mësimore të punonjësve arsimorë dhe respektimin e kërkesave të Udhëzimit nr. 14. datë 10.07.2023 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike të arsimit parashkollor". Në asnjë dispozitë të urdhrit nuk është përcaktuar si objekt monitorimi kontrolli i listëpagesave, verífikimi i trajtimit financiar të drejtorit apo ushtrimi i funksioneve të auditimit financiar. Në zbatim të këtij urdhri, grupi i monitorimit ka ushtruar kontrollin brenda objektit dhe kompetencave të ngarkuara, duke evidentuar rastet e mosrealizimit të ngarkesës mësimore prej 18 orësh në javë, mosrealizimit të ngarkesës prej 6 orësh për procesin e vlerësimit, si dhe mospërputhjet me kërkesat e Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023. Të gjitha problematikat e konstatuara janë pasqyruar në raportet e monitorimit dhe ijanë referuar institucioneve kompetente, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar përkatëse dhe Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, për marrjen e masave sipas kompetencës. Nga ana tjetër, referuar nenit 55/1 të Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, emërimi, administrimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor parashkollor publik janë kompetencë e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Për rrjedhojë, administrimi i marrëdhënies së punës së drejtorit, përfshirë elementët që lidhen me trajtimin financiar dhe pagesën, realizohet nga strukturat përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe nuk bën pjesë në kompetencat e grupeve monitoruese të ngritura nga DRAP Tiranë. Për rrjedhojë, grupi i monitorimit nuk kishte kompetencë ligjore të verifikonte pagesën e drejtorit të institucionit, pasi një verifikim i tillë nuk ishte pjesë e objektit të monitorimit të përcaktuar në Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 dhe as nuk parashikohet nga legjislacioni që rregullon kompetencat e DRAP Tiranë në procesin e monitorimit pedagogjik. Megjithatë, problematikat e konstatuara lidhur me mosrealizimin e ngarkesës mësimore janë evidentuar dhe u janë referuar institucioneve kompetente për ndjekje të mëtejshme, në përputhje me kompetencat e secilit institucion. Për sa më sipër, vlerësojmë se grupi i monitorimit ka ushtruar detyrat dhe kompetencat e tij në përputhje me Urdhrin nr. 78, datë 15.09.2025 dhe me kuadrin ligjor në fuqi, duke evidentuar problematikat që lidhen me objektin e monitorimit dhe duke ia referuar ato institucioneve kompetente për trajtim të mëtejshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket observacionit të gjetjes nr. 11, grupi i auditimit e ka sqaruar procesin e pajisjes me kartë dhe rolin e institucionit përkatës sipas kuadrit ligjor në fuqi. Përsa i përket gjetjes nr. 13, grupi i auditimit i qëndron konstatimit se monitorimi i kryer nuk ka qenë i plotë në raport me problematikat e evidentuara. Qëllimi i konstatimit është që si urdhrat për ngritjen e grupeve të monitorimit, ashtu edhe metodologjia e monitorimit të ndjekur nga strukturat përgjegjëse, të jenë më të plota dhe më gjithëpërfshirëse. Një monitorim më i plotë do të mundësonte identifikimin më të saktë të problematikave, analizimin e plotë të shkaqeve që i kanë sjellë ato dhe referimin e tyre në mënyrë më efektive pranë strukturave kompetente për marrjen e masave korrigjuese. Në këtë kuptim, konstatimi i auditimit synon përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe rritjen e efektivitetit të tyre në funksion të parandalimit dhe korrigjimit të problematikave të evidentuara, duke garantuar një ndjekje më të plotë institucionale në të ardhmen.

Për sa më sipër nuk ka ndryshim në gjetje dhe rekomandime në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

2.4.2 Inspektimet e kryera nga DRAP Durrës për periudhën 2022-2024

1. Inspektim, Shkolla e mesme e Bashkuar “100 Vjetori i Pavarësisë” Kashar

Inspektimi i kryer në shkollën e mesme të bashkuar “100 Vjetori i Pavarësisë” Kashar, realizuar në vitin 2022 nga inspektori/vlerësuesi z. F.K, përmban konstatimet si në vijim:

- Shkolla e mesme e bashkuar “100 Vjetori i Pavarësisë” Kashar Tiranë, ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës por këto dokumente kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime sipas kërkesave të nenit 49, 51, 52, 53 të Rregullores “Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020. Drejtori i shkollës nuk ka hartuar raportin vjetor të shkollës për bordin e IA-së mbi ecurinë e arritjes së prioriteteve dhe objektivave të planit afatmesëm parashikuar në pikën 8 të nenit 49, të kësaj Rregulloreje.

- Shkolla nuk ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2020-2021 dhe as për këtë vit shkollor nuk e ka filluar, në kundërshtim me nenin 54 të Rregullores.
- Drejtori i shkollës për këtë vit shkollor nuk ka realizuar normën për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, por nuk ka formate standarde, si dhe ky proces është formal pa tematika, nuk ka gjetje, përfundime, detyra, rekomandime, raporte dhe analiza. Drejtori i shkollës nuk e ka të dokumentuar analizën e gjendjes reale të nxënësve gjatë dhe në fund të vitit shkollor, si dhe nuk ka hartuar raporte vlerësimi, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 44 të Rregullores. Drejtori i IA-së ka kryer formalisht vlerësimin e mësuesve, pasi nuk është mbështetur në "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm/lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i IA-së disponon dosjet e plotësuara me dokumentacionin përkatës të mësuesve. Drejtori i shkollës nuk disponon një plan për zhvillimin e brendshëm profesional bazuar në nevojat reale të stafit për trajnim, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 45, të Rregullores. Drejtori nuk merr pjesë në procesin e zhvillimit profesional në nivel institucioni dhe nuk ka siguruar programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me ZVAP-në, donatorë të arsimit, universitetet ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj. Drejtori i shkollës dhe stafi mësimdhënës marrin pjesë në rrjetet profesionale. Drejtori i IA-së ka ngritur ekipet lëndore me mësues të së njëjtës lëndë/fushë por drejtuesi i ekipit lëndor (shkencat) nuk është zgjedhur sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 65 të Rregullores. Ekipet nuk e kanë të dokumentuar realizimin e detyrave të tyre, sipas planit përkatës.

Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:

Në nivel shkolle:
- Drejtori i shkollës të ngrejë grupet e punës për ndryshimet e domosdoshme në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës në përputhje me nenin 49, 50, 51, 52 dhe 53 të Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH", miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
- Drejtori i shkollës të marrin masat e nevojshme për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm në përputhje me nenin 54 të Rregullores dhe Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe Metodologjisë së Vlerësimit të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020.
- Drejtori i shkollës, ZVAP Tiranë të realizojnë orët e kontrollit duke përdorur formate standard, për vlerësimin e procesit të mësimdhënies/nxënies dhe të plotësimit të dokumentacionit shkollor.
- Për vlerësimin e mësuesve, Drejtori i shkollës të zbatoj: "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm lëndor të mësuesit në AMU", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i shkollës, ZVAP Tiranë të hartojë planin për zhvillimin e brendshëm profesional, sipas nevojave reale të stafit, dhe ta zbatojë atë në përputhje me pikën 1, të nenit 45, të Rregullores, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.

Në nivel të ZVAP-së:
- Në zbatim të nenit 49, 50, 51, 52, 53 të Rregullores, ZVAP Tiranë të miratojë ndryshimet në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës.
- ZVAP Tiranë të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna për drejtorinë e shkollës.

Në nivel DRAP-i:
- DRAP Durrës, gjatë periudhës shkurt-prill 2022, të rivlerësojë shkollën për realizimin e rekomandimeve të dhëna.

Propozim për masa disiplinore:

- Titullari i DRAP Durrës, brenda datës 10.02.2022, të shqyrtojë mospërmbushjen e detyrës funksionale për drejtorin e shkollës, z. B. P. dhe të marrë masën e duhur disiplinore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi janë trajtuar problematikat dhe rekomandimet janë në koherencë me to duke propozuar dhe masë disiplinore për Drejtorin e shkollës.

2. Inspektim, Shkolla 9-vjecare Yrshek, Tiranë

Inspektimi i kryer në shkollën 9-vjecare Yrshek, Tiranë, realizuar në vitin 2022 nga inspektori/vlerësuesi z. F.K dhe M.M përmban konstatimet si në vijim:

- Shkolla 9-vjecare Yrshek, Tiranë, ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës por këto dokumenta kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime sipas kërkesave të nenit 49, 51, 52, 53 të Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020. Drejtori i shkollës nuk ka hartuar raportin vjetor të shkollës për bordin e IA-së mbi ecurinë e arritjes së prioriteteve dhe objektivave të planit afatmesëm parashikuar në pikën 8 të nenit 49, të kësaj Rregulloreje.
- Shkolla nuk ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2020-2021 dhe as për këtë vit shkollor nuk e ka filluar, në kundërshtim me nenin 54 të Rregullores.
- Drejtori i shkollës për këtë vit shkollor nuk ka realizuar normën për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, por nuk ka formate standarde, si dhe ky proces është formal pa tematika, nuk ka gjetje, përfundime, detyra, rekomandime, raporte dhe analiza. Drejtori i shkollës nuk e ka të dokumentuar analizën e gjendjes reale të nxënësve gjatë dhe në fund të vitit shkollor, si dhe nuk ka hartuar raporte vlerësimi, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 44 të Rregullores. Drejtori i IA-së ka kryer formalisht vlerësimin e mësuesve, pasi nuk është mbështetur në "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm/lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i IA-së disponon dosjet e plotësuara me dokumentacionin përkatës të mësuesve. Drejtori i shkollës nuk disponon një plan për zhvillimin e brendshëm profesional bazuar në nevojat reale të stafit për trajnim, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 45, të Rregullores. Drejtori nuk merr pjesë në procesin e zhvillimit profesional në nivel institucioni dhe nuk ka siguruar programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me ZVAP-në, donatorë të arsimit, universitetet ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj. Drejtori i shkollës dhe stafi mësimdhënës marrin pjesë në rrjetet profesionale. Drejtori i IA-së ka ngritur ekipet lëndore me mësues të së njëjtës lëndë/fushë por drejtuesi i ekipit lëndor (shkencat) nuk është zgjedhur sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 65 të Rregullores. Ekipet nuk e kanë të dokumentuar realizimin e detyrave të tyre, sipas planit përkatës.

Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:

Në nivel shkolle:

- Drejtori i shkollës të ngrejë grupet e punës për ndryshimet e domosdoshme në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës në përputhje me nenin 49, 50, 51, 52 dhe 53 të Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH", miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
- Drejtori i shkollës të marrin masat e nevojshme për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm në përputhje me nenin 54 të Rregullores dhe Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe Metodologjisë së Vlerësimit të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020.
- Drejtori i shkollës, ZVAP Tiranë të realizojnë orët e kontrollit duke përdorur formate standard, për vlerësimin e procesit të mësimdhënies/nxënies dhe të plotësimit të dokumentacionit shkollor.

- Për vlerësimin e mësuesve, Drejtori i shkollës të zbatoj: "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm lëndor të mësuesit në AMU", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i shkollës, ZVAP Tiranë të hartojë planin për zhvillimin e brendshëm profesional, sipas nevojave reale të stafit, dhe ta zbatojë atë në përputhje me pikën 1, të nenit 45, të Rregullores, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.

Në nivel të ZVAP-së:
- Në zbatim të nenit 49, 50, 51, 52, 53 të Rregullores, ZVAP Tiranë të miratojë ndryshimet në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës.
- ZVAP Tiranë të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna për drejtorinë e shkollës.

Në nivel DRAP-i:
- DRAP Durrës, gjatë periudhës shkurt-prill 2022, të rivlerësojë shkollën për realizimin e rekomandimeve të dhëna.

Propozim për masa disiplinore:
- Titullari i DRAP Durrës, brenda datës 10.02.2022, të shqyrtojë mos përmbushjen e detyrës funksionale për drejtorin e shkollës, znj. D.H dhe të marrë masën e duhur disiplinore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi janë trajtuar problematikat dhe rekomandimet janë në koherencë me to duke propozuar dhe masë disiplinore për Drejtorin e shkollës.

3. Inspektim, Shkolla e mesme e bashkuar "Ahmet Boja", Kasallë

Inspektimi i kryer në shkollën e mesme të bashkuar "Ahmet Boja", Kasallë, realizuar në vitin 2022 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M përmban konstatimet si në vijim:
- Shkolla e mesme e bashkuar "Ahmet Boja", Kasallë, ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës por këto dokumenta kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime sipas kërkesave të nenit 49, 51, 52, 53 të Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020. Drejtori i shkollës nuk ka hartuar raportin vjetor të shkollës sipas nenit 55 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniveristare, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Shkolla nuk ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2020-2021 dhe as për këtë vit shkollor nuk e ka filluar, në kundërshtim me nenin 54 të Rregullores.
- Drejtori i shkollës për këtë vit shkollor nuk ka realizuar normën për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, por nuk ka formate standarde, si dhe ky proces është formal pa tematika, nuk ka gjetje, përfundime, detyra, rekomandime, raporte dhe analiza. Drejtori i shkollës nuk e ka të dokumentuar analizën e gjendjes reale të nxënësve gjatë dhe në fund të vitit shkollor, si dhe nuk ka hartuar raporte vlerësimi, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 44 të Rregullores. Drejtori i IA-së ka kryer formalisht vlerësimin e mësuesve, pasi nuk është mbështetur në "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm/lëndor të mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i IA-së disponon dosjet e plotësuara me dokumentacionin përkatës të mësuesve. Drejtori i shkollës nuk disponon një plan për zhvillimin e brendshëm profesional bazuar në nevojat reale të stafit për trajnim, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 45, të Rregullores. Drejtori nuk merr pjesë në procesin e zhvillimit profesional në nivel institucioni dhe nuk ka siguruar programe trajnimi për stafin, në bashkëpunim me ZVAP-në, donatorë të arsimit, universitetet ose OJF-të e akredituara, ekspertë në fushën e arsimit etj. Drejtori i shkollës dhe stafi mësimdhënës marrin pjesë në rrjetet profesionale. Drejtori i IA-së ka ngritur ekipet lëndore me mësues të së njëjtës

lëndë/fushë por drejtuesi i ekipit lëndor (shkencat) nuk është zgjedhur sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 65 të Rregullores. Ekipet nuk e kanë të dokumentuar realizimin e detyrave të tyre, sipas planit përkatës.
Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:
Në nivel shkolle:
- Drejtori i shkollës të ngrejë grupet e punës për ndryshimet e domosdoshme në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës në përputhje me nenin 49, 50, 51, 52 dhe 53 të Rregullores "Për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH", miratuar me Urdhrin nr 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
- Drejtori i shkollës të marrin masat e nevojshme për fillimin e procesit të vlerësimit të brendshëm në përputhje me nenin 54 të Rregullores dhe Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe Metodologjisë së Vlerësimit të brendshëm të shkollës, ASCAP 2020.
- Drejtori i shkollës, të ngrejë një grup të posaçëm pune, i cili të vëzhgojë zbatimin e planit afatmesëm dhe t'i raportojë me shkrim çdo 6-muaj drejtorit lidhur me ecurinë e zbatimit të planit afatmesëm.
- Për vlerësimin e mësuesve, Drejtori i shkollës të zbatoj: "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm lëndor të mësuesit në AMU", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtori i shkollës, ZVAP Tiranë të hartojë planin për zhvillimin e brendshëm profesional, sipas nevojave reale të stafit, dhe ta zbatojë atë në përputhje me pikën 1, të nenit 45, të Rregullores, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
Në nivel të ZVAP-së:
- Në zbatim të nenit 49, 50, 51, 52, 53 të Rregullores, ZVAP Tiranë të miratojë ndryshimet në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës.
- ZVAP Tiranë të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna për drejtorinë e shkollës.
Në nivel DRAP-i:
- DRAP Durrës, gjatë periudhës shkurt-prill 2022, të rivlerësojë shkollën për realizimin e rekomandimeve të dhëna.
Nga auditimi u konstatua se pavarësisht se niveli i problematikave të konstatuara në këtë shkollë është njësoj me konstatimet e 2 shkollave të lartpërmendura, në këtë rast nuk është propozuar masë disiplinore për Drejtorin e Shkollës së mesme të bashkuar "Ahmet Boja", Kasallë.

Viti 2023

1. Inspektim, shkolla 9-vjeçare "Vadabardhë", Durrës

Inspektimi i kryer në shkollën 9-vjeçare "Vadabardhë", Durrës, realizuar në vitin 2023 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M dhe z. F.K përmban konstatimet si në vijim:
- Drejtori i shkollës nuk ka bërë parashikimin e numrit të nxënësve, klasave dhe mësuesve në fund të vitit mësimor 2021-2022.
- Ndarja e ngarkesës mësimore nuk është bërë sipas Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 i ndryshuar, pasi ZVAP Durrës nuk ka bërë plotësimin e nevojave për mësues në profilin e kërkuar ose të përafërt për lëndët art pamor, muzikë.
- Procedura e ndjekur nga drejtori i shkollës dhe ZVAP Durrës për punësimin e një mësuesi të Arsimit Fillor nuk është në përputhje me Udhëzimin e MASR-së nr. 12, datë 10.06.2021 i ndryshuar pasi vendi i punës ka qenë më kontratë pa afat.
- Znj. E.M, mësuese e profilit Arsim Fillor e renditur 98, është punësuar nëpër jet Portalit "Mësues për Shqipërinë" dhe ka pranuar e nënshkruar për vendin e ofruar, me kontratë me afat.

Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:
- Drejtori i shkollës të kryejë parashikimin e numrit të nxënësve, klasave dhe mësuesve në fund të vitit mësimor.
- ZVAP-ja Durrës të plotësojë nevojat e shkollës me mësues sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 i ndryshuar.
- Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me ZVAP-në Durrës të zbatojë Udhëzimin e MASR-së nr. 12, datë 10.06.2021, i ndryshuar për shpalljen e vendeve të lira të punës.
Propozim për masë disiplinore
- I propozohet DRAP Durrës shqyrtimi i parregullsive të konstatuara dhe marrja e masave disiplinore për drejtorin e shkollës z. L.C.
Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi janë trajtuar problematikat dhe rekomandimet janë në koherencë me to duke propozuar dhe masë disiplinore për Drejtorin e shkollës.

2. Inspektim, shkolla 9-vjeçare "Karpën", Kavajë

Inspektimi i kryer në shkollën 9-vjeçare "Karpën" Kavajë, realizuar në vitin 2023 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M dhe z. F.K përmban konstatimet si në vijim:
- Plani vjetor nuk është hartuar në përputhje me nenin 51, 52 dhe 53 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH.
- Drejtori i shkollës nuk ka ngarkuar mësuesit me detyra të posaçme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shkollës.
- Drejtori i shkollës ka kryer normën zyrtare për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe dokumentacionit, duke përdorur vetëm një format standard por ky proces nuk është i plotë, nuk ka raporte me gjetje/gjykime, përfundime, detyra dhe rekomandime. Janë kryer vlerësimet e mësuesve por nuk janë specifikuar pikat e forta dhe të dobëta.
- Nuk është realizuar në mënyrë të plotë procesi i vlerësimit të brendshëm të shkollës, në nivel individual, në nivel organizmash dhe në nivel institucioni, me përfshirjen e të gjitha grupeve të interesit.
- Rregullorja e shkollës nuk është hartuar në përputhje me të gjitha kërkesat e parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 02.08.2013 "Për rregulloren tip të institucioneve arsimore", pasi nuk janë pasqyruar saktë rubrikat e parashikuara në pikën 1/b dhe 2/c, kreu II të Udhëzimit nr. 30.
- Drejtori i shkollës ka ngritur organizmat e shkollës por procedura e ndjekur për ngritjen e qeverisë së nxënësve dhe këshillit të prindërve nuk është sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nuk ka rregullore për funksionimin e komisionit të etikës dhe sjelljes, parashikuar në pikën 2, neni 36, kreu IX i Rregullores. Është hartuar rregullorja e Qeverisë së Nxënësve por rregullat dhe qasjet e vendosura në këtë dokument nuk janë konkrete dhe nuk garantojnë funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarive për qeverinë e nxënësve.
Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:
- Shkolla të ngrejë grupet e punës për reflektim të ndryshimeve të planit vjetor të shkollës dhe planit afatmesëm në përputhje me nenin 49,50, 51, 52 dhe 53 të Rregullores, miratuar me Urdhrin nr. 30, datë 28.01.2020 të MASR-së.
- Drejtori i shkollës të ngarkojë mësuesit me detyra të posaçme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së shkollës.
- Drejtori i shkollës në funksion të vlerësimit të cilësisë së procesit mësimor dhe dokumentacionit, mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të brendshëm, të hartojë raporte me gjetje/gjykime, përfundime, detyra dhe rekomandime.
- Të kryejë procesin e vlerësimit të brendshëm në përputhje me nenin 54 të Rregullores, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.

- Të hartohet rregullorja e brendshme e shkollës, në përputhje me të gjitha kërkesat e parashikuara në Udhëzimin nr. 30, datë 02.08.2013.
- Drejtoria e shkollës, për ngritjen e organizmave të shkollës të ndjek procedurën sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi janë trajtuar problematikat dhe rekomandimet janë në koherencë me to duke propozuar dhe masë disiplinore për Drejtorin e shkollës.

3. Inspektim, shkolla 9-vjeçare "Pal Zefi", Durrës

Inspektimi i kryer në shkollën 9-vjeçare "Karpën" Kavajë, realizuar në vitin 2023 nga inspektori/vlerësuesi znj. E.M dhe z. P.N përmban konstatimet si në vijim:
- Mësuesit në planet e periudhës në përgjithësi kanë hartuar drejt rubrikat por nuk përcaktojnë qartë situatën e të nxënit.
- Mësuesit në hartimin e planeve të periudhës së parë dhe të dytë nuk kanë reflektuar ndryshime të mundshme në varësi të nevojave të nxënësve të identifikuara gjatë periudhës përkatëse apo dhe në fund të saj.

Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:
- Ekipet lëndore të shqyrtojnë planet e periudhës së dytë dhe të reflektojnë ndryshimet e mundshme konform përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- Mësuesit në hartimin e planeve të periudhës të parashikojnë kur është e mundur situata për ndërtimin e njohurive.
- Drejtoria e shkollës të hartojë një plan pune për përmirësimin e situatës dhe të informojë ZVAP dhe DRAP brenda muajit mars 2023.

Nga auditimi u konstatua se në përgjithësi gjetjet mbeten përshkruese dhe nuk trajtojnë shkaqet apo ndikimin në procesin e të nxënit. Rekomandimet janë përgjithësisht të lidhura me gjetjet dhe adresojnë problematikën, por nuk janë plotësisht të strukturuara.

Viti 2024

1. Inspektim, shkolla 9-vjeçare jopublike "N", Mëzez, Tiranë

Inspektimi i kryer në shkollën 9-vjeçare jopublike "N" Mëzez, realizuar në vitin 2024 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M, z. F.K dhe z. P.N përmban konstatimet si në vijim:
- Drejtuesja e shkollës ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës por këto dokumente kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime në përputhje me kërkesat e nenit 49, pika 9, neni 51, 52 dhe 53 të Rregullores, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Drejtuesja e shkollës nuk ka hartuar raportin vjetor të institucionit.
- Nuk është kryer procesi i vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2022-2023 parashikuar në nenin 54 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
- Drejtuesja e IA-së për këtë vit shkollor nuk ka realizuar normën zyrtare për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor sipas parashikimeve të pikës 5/a, kreu II i Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 "Për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimor".
- Ish drejtoresha e shkollës nuk ka kryer vlerësimin e mësuesve për vitin shkollor 2022-2023.
- Drejtoria e shkollës nuk ka përcaktuar procedurën e shortit, periudhën, numrin e testeve që do të kryhen dhe afatin kohor të realizimit të tyre sipas parashikimeve të nenit 21, kreu VI i Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- Shkolla nuk ka drejtues didaktik, si rrjedhojë nuk ka dokumentacionin e domosdoshëm për treguesit e vlerësuar më sipër, që do të thotë se fusha "Drejtimi dhe Menaxhimi" vlerësohet "dobët".

Rekomandimet e lëna nga grupi i verifikimit paraqiten si në vijim:

- Drejtuesja e shkollës të reflektojë ndryshimet e domosdoshme në planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës në përputhje me nenet 49, 50, 51, 52, 53 të Rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Drejtuesja e shkollës të hartojë raportin vjetor të institucionit.
- Të kryhet procesi i vlerësimit të brendshëm të IA-së.
- Drejtuesja e IA-së të realizojë normën zyrtare për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor sipas parashikimeve të pikës 5/a.
- Drejtoria e shkollës për vlerësimin e mësuesve për vitin shkollor 2023-2024 të zbatojë "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU", miratuar me Urdhër të MASR-së nr. 246, datë 24.07.2020.
- Drejtoria e shkollës të përcaktojë procedurën e shortit, periudhën dhe numrin e testeve që do të kryhen dhe afatin kohor të realizimit të tyre, sipas parashikimeve të nenit 21, kreu VI i Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
- Shkolla të zbatojë procedurën për plotësimin me drejtues didaktik dhe të njoftojë DRAP Durrës për plotësimin e këtij rekomandimi brenda datës 15 gusht 2024.

Nga auditimi u konstatua se pavarësisht se niveli i problematikave të konstatuara në këtë shkollë është njësoj me konstatimet e shkollave të lartpërmendura ku është rekomanduar ndër të tjera edhe masë disiplinore, për këtë shkollë nuk është rekomanduar.

2. Inspektim shkolla së mesme të bashkuar "Feti Vogli" Baldushk, Tiranë.

Inspektimi i kryer në shkollën e mesme të bashkuar "Feti Vogli" Baldushk, Tiranë, realizuar në janar të vitit 2024 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M dhe znj. E.M, përmban konstatimet si në vijim:

1. Shkolla e mesme e bashkuar "Feti Vogli" Baldushk ZVAP Tiranë, ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës por këto dokumente të rëndësishëm për IA-në kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime në përputhje me kërkesat e nenit 49, pika 9 dhe nenit 51,52 dhe 53, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
2. Drejtuesit e shkollës kanë hartuar raportin vjetor të institucionit sipas parashikimeve të nenit 55, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
3. Shkolla e mesme e bashkuar "Feti Vogli" Baldushk ZVAP Tiranë, mbështetur në nenin 54, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe "Metodologjisë së vlerësimit të brendshëm", ASCAP 2020, ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2022-2023, por mungojnë analiza e informacionit të mbledhur si dhe konkluzionet referuar pikave të forta dhe të dobëta të treguesve/fushës së vlerësuar. Procesi i vlerësimit të brendshëm të IA-së për vitin shkollor 2023-2024 është në proces.
4. Drejtuesit e IA-së për këtë vit shkollor kanë realizuar normën zyrtare për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, por nuk përdorin formate standarde, si dhe orët e kontrollit të procesit mësimor duhet të shoqërohen me raporte dhe analiza, ku të pasqyrohen gjetje/gjykime, përfundime, rekomandime si dhe të lihen detyra dhe afate për përmirësim, me qëllim ndikim në rezultatet e nxënësve. Drejtoresha e shkollës ka kryer vlerësimin e mësuesve mbështetur në "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU, AML", miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sporti-së nr. 246, datë 24.07.2020.
5. Drejtuesit analizojnë periodikisht rezultatet e nxënësve, por ato duhet të kenë gjetje/gjykime, përfundime, rekomandime dhe afate për përmirësim si dhe të rikontrollohen.

Nga auditimi u konstatua se pavarësisht se ky raport ka problematika, nga ana e grupit inspektues nuk janë lënë rekomandime konkrete të shoqëruara dhe me afate në lidhje me zbatueshmërinë e tyre në vijim.

2. Inspektim gjimnazi "Sadi Nuri" Ndroq, Tiranë.

Inspektimi i kryer në gjimnazin "Sadi Nuri" Ndroq, Tiranë, realizuar në janar të vitit 2024 nga inspektori/vlerësuesi z. M.M dhe znj. E.M, përmban konstatimet si në vijim:

1. Gjimnazi "Sadi Nuri" Ndroq Tiranë, ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor të shkollës, por këto dokumenta të rëndësishëm për IA-në kanë nevojë për plotësime dhe ndryshime në përputhje me kërkesat e nenit 49, pika 9 dhe nenit 51,52 dhe 53, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
2. Drejtuesit e shkollës kanë hartuar raportin vjetor të institucionit sipas parashikimeve të nenit 55, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 të MASR-së.
3. Gjimnazi "Sadi Nuri" Ndroq, mbështetur në nenin 54, të "Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020 dhe "Metodologjisë së vlerësimit të brendshëm", ASCAP 2020, ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm për vitin shkollor 2022-2023, por mungojnë analiza e informacionit të mbledhur, si dhe konkluzionet, referuar pikave të forta dhe të dobëta të treguesve/fushës së vlerësuar. Procesi i vlerësimit të brendshëm të IA-së për vitin shkollor 2023-2024 është në proces.
4. Drejtoresha e IA-së për këtë vit shkollor ka realizuar normën zyrtare për vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor, por nuk përdor formate standarde. Drejtoresha e shkollës ka kryer vlerësimin e mësuesve, por nuk është mbështetur në "Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit në AMU, AML", miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sporti-së nr. 246, datë 24.07.2020.
5. Drejtuesit analizojnë periodikisht rezultatet e nxënësve, por ato duhet të pasqyrojnë gjetje/gjykime, përfundime, rekomandime dhe afate për përmirësim si dhe të rikontrollohen.

Nga auditimi u konstatua se pavarësisht se ky raport ka problematika, nga ana e grupit inspektues nuk janë lënë rekomandime konkrete të shoqëruara dhe me afate në lidhje me zbatueshmërinë e tyre në vijim.

3. Platformë inspektimi janar 2024

Me urdhrin nr. 4, datë 08. 01.2024 "Për ngritjen e grupeve të punës për vlerësimin e IAP-ve për fushën drejtimi dhe menaxhimi", nga Drejtori i DRAP Durrës, janë ngritur grupet e punës si në vijim:

- znj. E.M dhe z. M.M për gjimnazin "Sadi Nuri" Tiranë dhe shkollën e mesme të bashkuar "Feti Vogli".
- z. F.K dhe z. P.N për shkollën 9-vjeçare Pezë Helmës Tiranë dhe gjimnazin "Ibrahim Hasmema".

Grupet e inspektimit kanë vlerësuar shkollat duke realizuar:

- a) takime me drejtues të shkollës, mësues dhe nxënësit;
- b) Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit;
- c) Zhvillimi i fokus grupeve me mësues dhe ekipe lëndore;
- d) Takim përmbyllës me drejtorinë e shkollës, ekipet lëndore dhe këshillin e mësuesve

Grupet e inspektimit kanë kryer vlerësimin e IAP-ve për cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën e cilësisë "Drejtimi dhe menaxhimi" në datat 09-12.01.2024 dhe kanë hartuar raportin e vlerësimit për secilën shkollë.

2.4.3 Monitorimet e kryera nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë
Viti 2022

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Naim Frashëri"

Me Urdhrin nr. 77, datë 08.09.2022 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për monitorimin e institucioneve arsimore dhe platformës së monitorimit nr. 3425/1 prot., datë 08.09.2022, për monitorimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore", konkretisht për institucionin arsimor "Naim Frashëri", Tiranë, si në vijim: K.A; I.V.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 3425/7 prot., datë 19.09.2022, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Naim Frashëri" Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniveristar Durrës (DRAP Durrës).

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit nuk ka evidentuar problematika në drejtim të:

- përzgjedhjes së teksteve shkollore;
- procesverbaleve të komisioneve lëndore, për dy fazat e para procesit të përzgjedhjes së teksteve;
- inventarizimit të teksteve shkollore;
- njohjes me Urdhrin e përzgjedhjes së teksteve dhe katalogun e tyre;

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Drita Pelinku"

Me Urdhrin nr. 77, datë 08.09.2022 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për monitorimin e institucioneve arsimore dhe platformës së monitorimit nr. 3425/1 prot., datë 08.09.2022, për monitorimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore", konkretisht për institucionin arsimor "Drita Pelinku", Tiranë, si në vijim: K.A; I.V.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 3425/6 prot., datë 19.09.2022, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Drita Pelinku" Tiranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniveristar dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniveristar Durrës (DRAP Durrës).

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit nuk ka evidentuar problematika në drejtim të:

- përzgjedhjes së teksteve shkollore;
- procesverbaleve të komisioneve lëndore, për dy fazat e para procesit të përzgjedhjes së teksteve;
- inventarizimit të teksteve shkollore;
- njohjes me Urdhrin e përzgjedhjes së teksteve dhe katalogun e tyre;

3. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "1 Maj"

Me Urdhrin nr. 87, datë 26.09.2022 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e ankesës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me shkresën nr. 1369/1 prot., datë 15.09.2022, konkretisht ankesë për drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare "1 Maj" si në vijim: I.H; K.A; P.H.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 3938/4 prot., datë 10.10.2022, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "1 Maji" Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniveristar.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- lidhur me ankesën drejtoresha e shkollës nuk ka qenë pjesë e procesit të regjistrimit të fëmijëe të klasave përgatitore.
- z. E.D. i cili parashtron ankesën nuk është prind fëmije pranë kësaj shkolle.
- regjistrimet e kryera për klasat përgatitore janë të pa miratuara nga ZVA Tiranë.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- marrjen e masave për sistemimin e dokumentacionit të secilit fëmijë të regjistruar në klasën përgatitore;

- marrjen e masave për realizimin e një procesi edukimi të fëmijëve/nxënës në një mjedis të përshtatshëm, duke garantuar të drejtën e tyre për t'u arsimuar dhe të një jetese të shëndetshme, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijës.
- marrjen e masave për mirëfunksionimin e mjediseve të brendshme të IA, me mjetet dhe pajisjet e duhura dhe te nevojshme.

Nga auditimi konstatohet se rekomandimet e dhëna nuk janë plotësisht në koherencë me gjetjet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit. Konkretisht, rekomandimet 2 dhe 3, të cilat lidhen me marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm të IA dhe për mirëfunksionimin e mjediseve të brendshme, nuk mbështeten në mënyrë të drejtpërdrejtë nga konstatimet e vetë grupit të monitorimit. Kjo pasi, sipas raportit të monitorimit të këtij grupi, ambientet e klasave janë cilësuar si të përshtatshme.

4. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "1 Maj"

ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për verifikimin e ankesës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me shkresën nr. 1224/1 prot., datë 16.06.2022, konkretisht ankesë për drejtoreshën e shkollës 9-vjeçare "1 Maj" si në vijim: A.N; O.H; K.A; Xh.B.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 3142 prot., datë 30.08.2022, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "1 Maji" Tiranë DRAP Durrës dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniveristar.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:
- procedura e ndjekur për ngritjen e Komisionit të Disiplinës nuk është në përputhje me nenin 101, të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH".
- përsa i përket procedurës së ndjekur për ngritjen e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, mungon përfaqësimi i nxënësve në kundërshtim me nenin 36, të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- procedura e ndjekur për ngritjen e Këshillit të Prindërve nuk është në përputhje me nenin 89 të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- grumbullimi, ruajtja dhe përdorimi i të ardhurave nga kontributet e prindërve është realizuar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 29, datë 25.09.2007 "Për grumbullimin, ruajtjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dhurimet nga prindërit e nxënësve të shkollave të arsimit parauniversitar".

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:
- të merren masat dhe të kryhen të gjitha veprimet për ngritjen e Komisionit të Disiplinës në përputhje me nenin 101 të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- të merren masat dhe të kryhen të gjitha veprimet për ngritjen e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes sipas Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- të merren masat dhe të kryhen të gjitha veprimet për ngritjen e Këshillit të Prindërve në përputhje me nenin 89 të Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020.
- të merren masat dhe të kryhen të gjitha veprimet që grumbullimi, administrimi dhe shpenzimi i të ardhurave, i kontributeve të prindërve të nxënësve duhet të bëhet konform përcaktimit të Udhëzimit nr. 29, datë 25.09.2007.
- shkolla t'i ngrejë organizmat e shkollës si: komisioni i etikës dhe i sjelljes, qeverisë së nxënësve, këshilli i prindërve, bordi i institucionit arsimor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në nivel të ZVAP-së
- ZVAP Tiranë do të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport.

Në nivel DRAP-i
- DRAP Durrës në lidhje me konstatimet e sipërcituara të marrë masat e duhura në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Nga auditimi konstatohet se raporti i monitorimit evidenton mospërputhje ligjore në lidhje me sa trajtuar më sipër, por mbetet i fokusuar kryesisht në marrjen e masave për të ardhmen dhe zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, pa analizuar në mënyrë të mjaftueshme përgjegjësitë për shkeljet e konstatuara. Rekomandimet janë të orientuara drejt përmirësimit të situatës, por nuk adresojnë llogaridhënien për problematikat e krijuara.

5. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Sabahudin Gabrani"

Me Urdhrin nr. 6, datë 07.07.2022 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për vlerësimin e problematikës mbi konfliktin në vijimësi të dy nxënësve të klasë së V-të dhe shqyrtimin e veprimeve të kryera për trajtimin dhe menaxhimin e rastit nga Drejtoria e shkollës, shërbimi psiko-social, organet kolegjiale si dhe dokumentimin e procedurës nëse është ndjekur prej tyre, në shkollën 9-vjeçare "Sabahudin Gabrani" si në vijim: O.J; A.N.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 422/2 prot., datë 15.02.2022, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Sabahudin Gabrani".

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- Drejtoria e shkollës e ka menaxhuar rastin duke ndjekur të gjitha hapat për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e tij, pa mundur të realizojë një takim ballafaques midis prindërve të dy nxënësve.
- punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës kanë qenë present për menaxhimin e rastit dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me drejtorinë, prindërit dhe nxënësit.
- drejtoria e shkollës ka komunikuar me Inspektorin e Policisë së Zonës në lidhje me situatën e krijuar mes prindërve në shkollë.
- punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës kanë monitoruar në vazhdimësi gjendjen psiko-emocionale të nxënësve dhe marrëdhënien midis tyre.
- punonjësit e shërbimit psiko-social të shkollës kanë hartuar dhe zbatuar planin e ndërhyrjes në bashkëpunim me mësuesen kujdestare dhe drejtorinë e shkollës.
- mësuesja ka monitoruar në vijimësi dhe është përpjekur të shmangë përshkallëzimet e konfliktit.
- marrëdhëniet e tensionuara të prindërve janë bërë shkak për tensionimin e marrëdhënieve midis nxënësve.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Drejtoria e shkollës 9-vjeçare të marrë të gjitha masat për largimin e dy nxënësve në klasa të tjera paralele, mundësisht në klasa në kate të ndryshme.
- Drejtoria e shkollës të marrë të gjitha masat për njohjen e të gjithë prindërve me Rregulloren e brendshme të shkollës, me qëllim njohjen e detyrimeve prindërore për respektimin e marrëdhënieve me shkollën.
- Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me shërbimin psiko-social të informojë prindërit për mënyrën dhe hapat që ndjek institucioni për ndërmjetësimin e konflikteve midis nxënësve dhe monitorimin e tyre në vijimësi.
- Shërbimi psiko-social të referojë rastin pranë Punonjësit për mbrojtjen e Fëmijëve për të kërkuar ndërgjegjësimin e familjeve në menaxhimin dhe shuarjen e konfliktit midis tyre.
- Drejtoria në bashkëpunim me shërbimin psiko-social të shkollës të monitorojë dhe të vlerësojë në mënyrë të vazhduar ecurinë e rastit dhe të sigurojë në vijimësi në funksion të mirëqenies së nxënësve në interesin e tyre primar.
- Shërbimi psiko-social i shkollës të ofrojë këshillim për prindërit në përmirësim të komunikimit prind-fëmijë duke ndërgjegjësuar prindërit për të mos bërë fëmijët pjesë në komunikime që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre psiko-emocional.

Nga auditimi konstatohet se raporti i monitorimit në përgjithësi ka evidentuar në mënyrë të detajuar situatën dhe masat e marra nga strukturat e shkollës 9-vjeçare "Sabahudin Gabrani". Po

kështu rekomandimet janë të orientuara drejt parandalimit dhe menaxhimit të mëtejshëm të konfliktit. Në përgjithësi, nisur nga raporti i monitorimit rekomandimet e lëna janë masa të ezuaruar nga ana e shkollës.

Viti 2023

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Fushas"

Me Urdhrin nr. 326, datë 06.12.2023 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për trajtimin dhe vlerësimin e ankesës së paraqitur nga z. A.T, në shkollën 9-vjeçare "Fushas" si në vijim:
E.A; O.H.
ZVA Tiranë me shkresën nr. 6489/2 prot., datë 11.12.2023, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Fushas", DRAP Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
Sipas këtij raporti grupi i monitorimit nuk ka konstatuar problematika që lidhen me ankesën dhe ka dokumentuar bashkëlidhur raportit, rezultatet e pyetësorit me nxënësit, me prindërit dhe me mësuesit. Gjithashtu dhe një deklaratë noteriale nga deklaruesi z. A.T, i cili deklaron se nuk ka fëmijë të regjistruar në shkollën 9-vjeçare "Fusha" në Baldushk, nuk ka dijeni për ankesën e bërë kundrejt shkollës dhe drejtorit në emrin e tij dhe deklaron se ka mbi 15 vite që nuk jeton më në atë zonë.
Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë 2 rekomandime:
- Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me shërbimin psiko-social të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme përmes pyetësorëve klimën dhe etikën në institucionin arsimor.
- Drejtoria e shkollës në bashkëpunim me shërbimin social të zhvillojnë me stafin mësimor trajnime që kanë fokus klimën, komunikimin dhe bashkëpunimin e stafit brenda shkollës.
Nga auditimi konstatohet se është dokumentuar në mënyrë të plotë monitorimi i kryer dhe rezultatet e tij.

2. Monitorim për institucionin arsimor parashkollor privat, kopshti "S. K"

Me Urdhrin nr. 240, datë 03.05.2023 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin dhe verifikimin e ankesës së paraqitur për kopshtin privat "S. K" si në vijim:
A.K; O.M; M.B.
ZVA Tiranë me shkresën nr. 2041/3 prot., datë 11.05.2023, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar kopshtit privat "S. K" dhe DRAP Durrës.
Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:
- Kopshti privat "S.K" nuk disponon licencë si dhe nuk zbaton detyrimet përkatëse sipas VKM/Urdhrit të Ministrit/licencës së QKL-së/QKB-së.
- Kopshti nuk ka vendosur kritere pranimi për drejtuesin didaktik dhe stafin mësimdhënës si dhe nuk janë trajnuar të paktën 3 ditë në vit.
- Kopshti nuk ka konfirmuar drejtuesen didaktike nga MAS.
- Drejtoria e kopshtit nuk disponon të gjitha kontratat e lidhura mes palëve.
- Kopshti privat "S. K" ka hartuar planin afatmesëm dhe planin vjetor por jo sipas formatit zyrtara.
- Drejtuesja didaktike dhe stafi mësimdhënës i kopshtit nuk plotëson kriteret e parashikuara në nenin 57/1 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH" i ndryshuar.
- Kopshti nuk psikolog/punonjës social në stafin e tij.
Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë këto rekomandime:
- Institucioni arsimor privat kopshti "S. K" të plotësojë standardet infrastrukturore sipas Udhëzimit nr. 15, datë 12.07.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare" i ndryshuar, për të vazhduar procedurat për licencim.

- Të marr masa për miratimin e drejtueses didaktike në MAS.

Nga auditimi konstatohet se raporti i monitorimit evidenton problematika që lidhen me mungesën e licencimit, mosplotësimin e kritereve ligjore për stafin dhe mangësi në administrimin e institucionit, duke treguar një nivel të ulët përputhshmërie me kuadrin rregullator. Megjithatë, raporti mbetet kryesisht përshkrues dhe nuk analizon në mënyrë të mjaftueshme ndikimin dhe riskun që rrjedh nga këto shkelje. Në lidhje me rekomandimet, ato rezultojnë të pjesshme dhe jo gjithëpërfshirëse, pasi adresojnë vetëm një pjesë të problematikave të evidentuara. Gjithashtu, rekomandimet nuk janë të shoqëruara me masa konkrete dhe përgjegjësi të qarta për zbatim, çka kufizon efektivitetin e tyre në përmirësimin e situatës.

3. Monitorim për institucionin arsimor parauniversitar "Koreografike"

Me Urdhrin nr. 306, datë 20.10.2023 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e ankesës së mësuesve znj. M.K. dhe znj. O.N, në Institucionin Arsimor Parauniversitar "Koreografike" si në vijim: E.A; R.K; L.Z.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 5953/3 prot., datë 03.11.2023 ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar institucionit arsimor parauniversitar "Koreografike".

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- Drejtoria e shkollës "Koreografike" Tiranë në hartimin e listë prezencës mujore të mësuesve ka mospërputhje midis nivelit arsimor ku zhvillohen orët mësimore nga mësuesit dhe shkallës së nivelit të kategorizimit të pagës së pasqyruar nga ana e shkollës çdo muaj në listë prezencën mujore jo sipas nivelit arsimor ku ata zhvillojnë procesin mësimor.

Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë këto rekomandime:

- Shkolla "Koreografike" Tiranë të marrë masa që të bëjë pasqyrimin real në listëprezencat mujore të mësuesve duke i përcaktuar në listëprezencë mujore sipas nivelit arsimor ku dhe kanë ngarkesën mësimore dhe zhvillojnë procesin mësimor.

Nga auditimi konstatohet se rekomandimi nuk adreson verifikimin e periudhave të mëparshme apo forcim të kontrolleve të brendshme për të shmangur përsëritjen e problematikës.

4. Monitorim për institucionin arsimor "Marie Logoreci"

Me Urdhrin nr. 287, datë 18.09.2023 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore në institucionin arsimor "Marie Logoreci", si në vijim: I.V; R.Xh.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 5200/6 prot., datë 20.09.2023 ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar institucionit arsimor "Marie Logoreci".

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar se shkolla ka realizuar procedurat e përzgjedhjes, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të klasave 1,2,36,7,10,11,12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024 sipas katalogut të teksteve shkollore 2024-2025. Drejtoria e shkollës dhe Komisioni i Administrimit, ka administruar të gjithë dokumentacionin që rrjedh nga zbatimi i Urdhrit nr. 7, datë 07.04.2022. Janë hartuar procesverbalet e përzgjedhjes në nivel ekipi lëndor për çdo botues/distributor.

Nga auditimi konstatohet se në raport monitorimi ka firmosur znj. I.V dhe znj. A.S. Bashkëlidhur mungon shkresa që ka zëvendësuar znj. R.Xh. e përcaktuar në Urdhrin nr. 287 datë 18.09.2023.

5. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Emin Duraku

Me Urdhrin nr. 110, datë 01.02.2023 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për vlerësimin e ankesës së mësueses së IAPP-së në shkollën "Emin Duraku", si në vijim: E.A; B.S; T.S.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 744/4 prot., datë 16.03.2023 ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar institucionit arsimor "Emin Duraku".

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, për muajin shtator 2022, nuk ka menaxhuar shumë mirë shpërndarjen e mësuesve/orarin mësimor në të dyja shkollat ku u zhvendos të zhvillonte procesin mësimor kjo shkollë, (për shkak të ndërtimit të godinës së re të saj), duke sjellë për pasojë mungesën e këtyre mësuesve (të profilit TIK, Anglisht, Edukim Fizik) për zhvillimin e mësimit në klasat e arsimin fillor.
- Nga ana e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë janë kryer të gjitha pagesat për raportet mjekësore të paraqitura nga ana e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku", Tiranë të paraqitura me listëprezencat mujore.
- Prerja e ditëve të punës nga ana e drejtoreshës së shkollës për mësuesit që mungojnë në punë nuk është e shoqëruar me vendim, por vetëm pasqyrohet në listëprezencën mujore.
- Nga ana e drejtoreshës së shkollës, në shumë raste, nuk janë prerë ditët punës për mësuesit që mungojnë në punë. Nga ana e drejtorisë së shkollës për aktivitetin e zhvilluar me nxënësit e klasave të V -ta me temë "Vizitë në panairin e librit 2022", nuk janë marrë të gjitha masat për mbarëvajtjen sa më të mirë të këtij aktiviteti, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 26 të Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020.
- Mungesa/braktisja e punës nga ana e mësuese M.S, në ditën e planifikuar për aktivitetin e zhvilluar me nxënësit e klasave të V - ta me temë "Vizitë në panairin e librit 2022", nuk është shoqëruar me asnjë procedurë nga ana e shkollës për këtë mësuese, madje nga ana e drejtoreshës së shkollës nuk i është hequr kjo ditë pune, në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020.
- Nga ana e mësuese M.S, shkelej në mënyrë të përsëritur paraqitja e saj në punë me uniformën e përcaktuar dhe të miratuar edhe në Rregulloren e Brendshme të shkollës, në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020.
- Nga ana e drejtorisë së shkollës 9 - vjeçare “Emin Duraku”, Tiranë, nuk ka asnjë procedurë për mësuesit të cilët paraqiteshin me vonesë në punë, qëndronin në qendrën e punës pa uniformë, mungonin/braktisnin vendin e punës pa dokument justifikues dhe ligjor, në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020. Problematikat e hasura (ndër vite) dhe në vijimësi me mësuese M. S, nuk drejtorisë përputhen me vlerësimin vjetor “Shumë Mirë", të bërë për këtë mësuese nga ana e së shkollës.
- Drejtoresha e shkollës 9- vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, në shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin shkollor 2022– 2023 për mësuesen E.A, profili "Art Pamor" ka përfshirë në normë mësimore ngarkesën mësimore prej 2 (dy) orësh norma e SMIP, fakt i cili bien në kundërshtim me përcaktimet e pikës D, ndarja II, pikës C, ndarja II pikës C ndarja IV dhe pika 21 ndarja V. e Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- Drejtoresha e shkollës 9 – vjeçare “Emin Duraku", Tiranë, ka bërë miratimin e lejes pa të drejtë page për E.A, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 96 të Kodit të Punës dhe pikës 14dhe 15, ndarja III e VKM nr. 568, datë 06.10.2021.
- Drejtoresha e shkollës 9 – vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, ka bërë shpërndarjen e orëve mësimore të lëndës “Art pamor”, tek mësuesit e tjerë të shkollës, duke sjellë për pasojë mbingarkimin e mësuesve të tjerë të shkollës për të realizuar orët mësimore të një lënde tjetër, në një kohë që zëvendësimi i kësaj mësueseje dhe realizimi i orëve mësimore do të bëhej nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë”.

Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë këto rekomandime:

Në nivel shkolle:

- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare “Emin Duraku", Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që të bëjë pasqyrimin e saktë dhe korrekt në listëprezencat mujore që paraqitet për pagesë në Zyrën të të gjitha mungesave dhe ditëve të punës për të gjithë mësuesit, duke i trajtuar mësuesit në mënyrë të barabartë.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare “Emin Duraku”, Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që për çdo veprimtari plotësuese apo jashtëshkolloret të respektojë procedurat dhe përcaktimet e Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020, ku veprimtaritë e nxënësve të përmbushin kushtet e sigurisë, të ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të tyre.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare “Emin Duraku”, Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që nga ana e të gjithë personelit të shkollës gjatë kohës së qëndrimit në shkollë të respektohet uniforma e përcaktuar, sipas përcaktimeve të Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare “Emin Duraku”, Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që për çdo shkelje dhe problematikë të lindur në institucionin arsimor të shqyrtohet dhe trajtohet nga komisionet kolegjiale, nga Komisioni i Etikës dhe Sjelljes, dhe Komisioni i Disiplinës dhe të shmanget totalit trajtimi individual i bërë nga drejtuesi i institucionit arsimor në cilësinë e titullarit të këtij institucioni dhe që çon në marrjen e vendimeve që nuk i takojnë sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për çdo shkelje të kryer nga ana e mësuesve të trajtohen nga organet kolegjiale të institucionit arsimor, sipas përcaktimeve të Urdhrit nr.31, datë 28.01.2020.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që vlerësimet vjetore të mësuesve të mos jenë formale dhe me vlerësime të cilat nuk përputhen dhe bien ndesh me punën, sjelljet, apo konstatimet e bëra gjatë ushtrimit të detyrës së këtyre mësuesve.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku”, Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që shpërndarja e ngarkesës mësimore të të gjithë mësuese dhe nëndrejtorëve sipas përcaktimeve të Udhëzimit Nr.30, datë 12.09.2018, i ndryshuar.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku", Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që trajtimi i mësuesve me leje pa të drejtë page të bëhet vetëm sipas përcaktimeve të Kodit të Punës dhe VKM - së Nr.568, datë 06.10.2021.
- Drejtoria e shkollës 9 - vjeçare "Emin Duraku”, Tiranë, të marrë të gjitha masat dhe të kryejë të gjitha veprimet që për çdo mësues që mungon në punë dhe që nuk trajtohet financiarisht nga ZVAT (raportet mjekësore që paguhen nga Sigurimet Shoqërore, Lejet pa të drejtë page, leje lindje,) të përcillet raportimi në ZVAT duke kërkuar mësues zëvendësues.

Në nivel të ZVAP-së:

- ZVAP-ja Tiranë të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport për shkollën 9 - vjeçare "Emin Duraku", Tiranë.

Në nivel DRAP-i:

Propozim për masa disiplinore

Trajtim për dhënie mase disiplinore, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për Znj. E.M, në cilësinë e drejtoreshës së shkollës së arsimit 9 - vjeçar "Emin Duraku", Tiranë, për:

- Mos pasqyrim në mënyrë të barabartë të ditëve të punës dhe mungesave në punë, në listprezencën mujore për të gjithë mësuesit që mungojnë në punë;
- Për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në kundërshtim me përcaktimet e udhëzimit përkatës;
- Për trajtimin e mësuesve me leje pa të drejtë page në kundërshtim me procedurat dhe përcaktimet ligjore;

- Për tejkalim të kompetencave duke injoruar funksionimin e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë duke mos bërë raportim për mësuesit që mungojnë dhe duke mos bërë kërkesë për zëvendësimin e tyre më mësues zëvendësues, çka ka sjellë për rrjedhojë mbingarkimin e mësuesve të tjerë të shkollës për të realizuar orët mësimore të një lënde tjetër.

Nga auditimi konstatohet se gjetjet dhe rekomandimet e këtij raport monitorimi paraqiten të plota dhe të argumentuara.

Viti 2024

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Mustafa Qemal Ataturku"

Me Urdhrin nr. 175, datë 14.05.2024 ZVA Tiranë ka ngritur grupin e punës "Për monitorimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore, në shkollën 9-vjeçare "Mustafa Qemal Ataturku" si në vijim: M.B; E.S.

ZVA Tiranë me shkresën nr. 2914/2 prot., datë 24.05.2024, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Mustafa Qemal Ataturku" dhe DRAP Durrës.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- Përbërja e anëtarëve të Urdhrit nr. 164, datë 15.04.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Administrimit në lidhje me përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1,2,3,4,8,9 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025".
- Shkolla disponon dokumentacionin për procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore, në përputhje me detyrat e Komisionit të Administrimit por nuk disponon shkresën për datën, orën dhe vendin e mbledhjes për përzgjedhjen e teksteve.
- Shkolla nuk ka të dokumentuar detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesve të klasave dhe komisioneve lëndore të reflektuara në procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve.
- Drejtoria e shkollës nuk disponon fletën e inventarit të bibliotekës për ekzemplarët e teksteve shkollore të dërguara nga botuesit.
- Shkolla gjatë përzgjedhjes së teksteve shkollore, nuk ka lejuar asnjë veprimtari të botuesve/distributorëve, që kanë për qëllim publicitetin e teksteve të tyre.

Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë 2 rekomandime:

- Drejtoria e shkollës të ringrejë Urdhrin për "Përzgjedhjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1,2,3,4,8,9 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2024-2025", sipas përcaktimeve të pikës 2/b të Udhëzimit nr. 7 datë 07.04.2022.
- Drejtoria e shkollës të inventarizojë në bibliotekën e shkollës kopjet e teksteve shkollore të dërguara/dorëzuara nga botuesit/distributorët sipas përcaktimeve të pikës 5/c, të Udhëzimit nr. 7 datë 07.04.2022 "Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar".

Nga auditimi konstatohet raporti i monitorimit paraqet në mënyrë të qartë dhe të saktë problematikat kryesore të procesit, ndërsa gjetjet dhe rekomandimet janë përgjithësisht në përputhje me kuadrin rregullator dhe adresojnë çështjet e evidentuara. Megjithatë, konstatohet se përsa i përket rekomandimeve mungon afati i përcaktuar për zbatueshmërinë e tyre.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Gustav Mayer"

ZVA Tiranë me shkresën nr. 1345/3 prot., datë 26.02.2024, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Gustav Mayer" dhe DRAP Durrës, përgatitur nga znj. I.V, për zbatimin e nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë".

Sipas këtij raporti është konstatuar se nga shkolla 9 vjeçare "Gustav Mayer" janë marrë të gjitha masat për zbatimin e kësaj nisme, është ngritur Urdhri i brendshëm për zbatimin e nismës, është hartuar orari i zhvillimit të veprimtarive për klasat e përfshira, është ngritur grupi i punës për

vëzhgimin e orëve të projektit, është realizuar bashkëpunimi me prindërit, është analizuar mbarëvajtja e procesit, etj. Zbatimi i nismës është vlerësuar në shkallën e cilësisë "Shumë mirë".
Gjithashtu nga grupi i monitorimit janë lënë 2 rekomandime:
- Stafi drejtues i shkollës nëpërmjet takimeve me prindër, mësues, nxënës, komunitetin dhe pushtetin vendor të promovojë nismën "Bëjmë detyrat e shtëpisë", duke e shtrirë në të gjitha klasat nëpërmjet veprimtarive të larmishme brenda orarit të nismës, me qëllim përfshirjen e sa më shumë nxënësve,
- Koordinatori i shkollës të monitorojë rregullisht ecurinë e programit të nismës.
Nga auditimi konstatohet raporti i monitorimit paraqet në mënyrë të qartë çështjen e ngarkuar për monitorim. Megjithatë, konstatohet se përsa i përket rekomandimeve mungon afati i përcaktuar për zbatueshmërinë e tyre.

Viti 2025

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Lasgush Poradeci" Tiranë

ZVA Tiranë me shkresën nr. 10789/2 prot., datë 04.11.2025, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Lasgush Poradeci" dhe DRAP Tiranë, trajtim ankese, në lidhje me situatën e tensionuar midis mësues znj. D.P dhe znj. M.Sh, prind i nxënësit D.SH, në klasën e parë, përgatitur nga grupi i monitorimit znj. A.N, znj. R.K, znj. E.Z dhe znj. J.H.
Kjo ankesë konsiston në përdorimin e një gjuhe të papërshtatshme dhe fyese të znj. M.Sh kundrejt D. P.
Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:
-Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procesverbaleve të mbajtura nga drejtuesit e shkollës, rezulton se nuk është ndërmarrë asnjë veprim zyrtar pranë organeve kompetente për këtë ngjarje nga stafi drejtues i shkollës. Denoncimi i këtij incidenti në ambientet e shkollës është bërë nga vet mësuesja. Ngjarja është trajtuar brenda shkollës përmes ndërhyrjes së menjëhershme të stafit drejtues dhe psikologes së shkollës, si dhe përmes kufizimit të kontakteve të mëtejshme të prindit me mësuesen.
- Gjatë mbledhjes së zhvilluar me stafin pedagogjik, stafi drejtues nuk e ka përmendur ngjarjen e ndodhur, nuk ka ofruar asnjë informacion për stafin mësimor lidhur me situatën e krijuar me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit të rastit apo ndikimin e situatës në klimën institucionale. Fokusi i takimit është përqendruar vetëm në çështje të përgjithshme si komunikimi i mësuesve me prindërit, pa u ndalur në incidentin e ndodhur që kishte prekur drejtpërdrejtë një anëtare të stafit.
- nga ana e znj. D.P është mbajtur telefon gjatë procesit mësimor, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 23, datë 01.09.2025 "Për caktimin e rregullave dhe masave për ndalimin e përdorimit të telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhur me të në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare" si dhe rregullores së brendshme të institucionit arsimor.
- shërbimi psiko-social ka ndërhyrë sipas protokolleve të punës për menaxhimin e situatës së emergjencës.
- sipas pyetësorëve klima e mësimit dhe marrëdhëniet në përgjithësi prindër-nxënës-mësues janë të qeta dhe të sigurta.
Nga grupi i monitorimit janë lënë 5 rekomandime nga të cilat 4 për shkollën 9-vjeçare "Lasgush Poradeci" Tiranë dhe 1 për ZVAP Tiranë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.
Nga auditimi konstatohet raporti i monitorimit paraqet në mënyrë të qartë dhe të saktë problematikat kryesore të procesit, gjetjet dhe rekomandimet janë përgjithësisht në përputhje me kuadrin rregullator dhe adresojnë çështjet e evidentuara. Rekomandimet janë në koherencë me konstatimet dhe janë të shoqëruara me afati të përcaktuar për zbatueshmërinë e tyre.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Musine Kokalari" Tiranë

ZVA Tiranë me shkresën nr. 12340 prot., datë 16.12.2025, ka përcjellë raportin e monitorimit, drejtuar shkollës 9-vjeçare "Musine Kokalari" dhe DRAP Tiranë, trajtim ankese, në lidhje me konfliktin fizik midis dy nxënësve. Ky raport monitorimi është përgatitur nga znj. A.S dhe znj. E. P.

Sipas këtij raporti grupi i monitorimit ka konstatuar si në vijim:

- Reagimi institucional I drejtorisë së shkollës. Drejtoresha ka reaguar menjëherë pas njoftimit, duke paraqitur në vendngjarje jashtë territorit të shkollës dhe duke zbatuar protokollet ligjore, për identifikimin e nxënësve dhe njoftimin e prindërve. Veprimet e saj përfshijnë kontaktimin e Zyrës Vendore Arsimor, Shërbimit Psiko-social dhe SPS-së duke respektuar zinxhirin e raportimit. Kjo tregon për zbatim korrekt të detyrimeve ligjore dhe protokollare nga drejtuesja, sipas ligjit nr.69/2012 dhe urdhrit nr.31/2020 "Për funksionimin e institucione arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë".
- Mësuesit kujdestarë nuk kanë njoftuar menjëherë prindërit për mungesat e nxënësve, duke shkelur detyrimin ligjor për njoftimin e menjëhershëm të familjes.
- Mangësitë në siguri dhe menaxhim fillestar, mungesa e oficeres së sigurisë në momentin e incidentit ka krijuar boshllëk në mbulimin e zonës së rrezikut, duke vështirësuar menaxhimin fillestar.
- Shërbimi psikosocial (psikologia dhe punonjësja sociale) ka ndërhyrë në mënyrë profesionale pas incidentit, duke realizuar këshillime individuale dhe në grup, hartuar planin e masave për nxënësit dhe monitoruar situatën pas incidentit.
- Bashkëpunimi me prindërit nuk ka qenë në vijueshmëri.

Nga grupi i monitorimit janë lënë 5 rekomandime .

Nga auditimi konstatohet raporti i monitorimit paraqet në mënyrë të qartë dhe të saktë problematikat kryesore të procesit, gjetjet dhe rekomandimet janë përgjithësisht në përputhje me kuadrin rregullator dhe adresojnë çështjet e evidentuara. Rekomandimet janë në koherencë me konstatimet dhe janë të shoqëruara me afati të përcaktuar për zbatueshmërinë e tyre.

2.4.4 Monitorimet e kryera nga Zyra Vendore Arsimore Kamëz

Viti 2022

1. Monitorim për vlerësimin e nxënësve në arsimin bazë e në AML në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të kurrikulës

1.a Me shkresën nr. 307 prot., datë 18.03.2022 është kryer monitorimin për vlerësimin e nxënësve në arsimin bazë e në AML në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollën "Tahir Sinani", nga znj. M.D dhe znj. E.M, ku sipas përfundimeve nuk janë konstatuar problematika. Megjithatë janë lënë 2 rekomandime si në vijim:

- Të rishikohen raportet e vlerësimit me rekomandime dhe sugjerime, për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.
- Të rishikohen vlerësimet e detyrave dhe punimeve të nxënësve vetëm me shprehje vlerësuese nga mësuesi i klasës I-III.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet mbeten të përgjithshme dhe nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre. Gjithashtu mungon lidhja konkrete midis konstatimeve dhe rekomandimeve.

1. b Me shkresën nr. 287 prot., datë 18.03.2022 është kryer monitorimin për vlerësimin e nxënësve në arsimin bazë e në AML në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollën "100 Vjetori", nga z. A.A dhe z. S.A, ku sipas seksionit "përfundime" konstatimi është: notat nuk janë hedhur në regjistër, pasi nuk disponohet një kolonë e tillë dhe ruhen në drejtorinë e shkollës.

Rekomandimet e lëna paraqiten si në vijim:
- Rezultatet e testeve të realizuara nga Drejtoria e shkollës në fund të periudhës, të vendosen në regjistër te kolona ku mësuesi do të vendoste rezultatet e testit që zhvillon për periudhën.
- Drejtoria e shkollës të hartojë plane javore për vlerësimin e procesit të të nxënit.
- Drejtoria e shkollës të ndjekë në vijimësi angazhimin e mësuesve në rrjete profesionale, siç ndjek atë të ekipeve lëndore në shkollë.
- Në arsimin fillor klasa I-V rekomandojmë që nxënësi të ketë një portofol ku të mbajë punimet e tij.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre. Gjithashtu mungon lidhja konkrete midis konstatimeve dhe rekomandimeve.

1.c Me shkresën nr. 286 prot., datë 16.03.2022 është kryer monitorimin për vlerësimin e nxënësve në arsimin bazë e në AML në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollën "Dom N.Kacorri", nga z. Sh.K dhe z. S.A, ku sipas seksionit "përfundime" konstatimi është: notat nuk janë hedhur në regjistër, pasi nuk disponohet një kolonë e tillë dhe ruhen në drejtorinë e shkollës.

Rekomandimet e lëna paraqiten si në vijim:
- Rezultatet e testeve të realizuara nga Drejtoria e shkollës në fund të periudhës, të vendosen në regjistër te kolona ku mësuesi do të vendoste rezultatet e testit që zhvillon për periudhën.
- Mësuesit bashkë me tabelën e pikëzimit në testet përmbledhëse të bashkëlidhin dhe tabelën e rezultateve të tyre për të bërë krahasime dhe analiza pas çdo detyre.
- Drejtoria e shkollës të hartojë plane javore për vlerësimin e procesit të të nxënit.
- Drejtoria e shkollës të ndjek në vijimësi angazhimin e mësuesve në rrjete profesionale, siç ndjek atë të ekipeve lëndore në shkollë.
- Në arsimin fillor klasa I-V rekomandojmë që nxënësi të ketë një portofol ku të mbajë punimet e tij.
- Të bëhet një punë më e kujdesshme nga ana e mësuesve kujdestar klase për evidentimin dhe analizimin e mungesave të nxënësve për çdo muaj duke i pasqyruar dhe analizuar në mënyrë progresive ato, me synim uljen e numrit të mungesave për nxënës.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre. Gjithashtu mungon lidhja konkrete midis konstatimeve dhe rekomandimeve.

1.d Me shkresën nr. 262 prot., datë 10.03.2022 është kryer monitorimin për vlerësimin e nxënësve në arsimin bazë e në AML në funksion të zbatimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollën "Suljeman Elezi", nga z. A.A dhe znj. E.M, ku sipas seksionit "përfundime" nuk janë konstatuar problematika.

Rekomandimet e lëna paraqiten si në vijim:
- Drejtoria e shkollës të ketë të arkivuara dhe të dokumentuara me shkrim, edhe rubrikën "Mësuesi vlerëson nxënësin duke u bazuar te portofoli i tij".
- Drejtoria e shkollës të hartojë plane javore për vlerësimin e procesit të të nxënit.
- Rezultatet e testeve të realizuara në fund të periudhës të vendosen në regjistër, së bashku me rezultatet e testit të realizuar nga drejtoria e shkollës.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre. Gjithashtu mungon lidhja konkrete midis rekomandimeve dhe rezultateve të raportimit të monitorimit për të cilin nuk janë evidentuar problematika.

2. Monitorim për cilësinë e shërbimit të ofruar në ruajtjen, plotësimin dhe përdorimin e regjistrave të klasave dhe të amzës

Me shkresën nr. 710 prot., datë 11.05.2022 është kryer monitorim në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar në ruajtjen, plotësimin dhe përdorimin e regjistrave të klasave dhe të amzës në shkollën "Lidhja e Prizrenit", nga znj. M.D dhe znj. E.M.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre. Në rastet kur janë evidentuar problematika në lidhje me korrigjimin e të dhënave ose plotësimin e shkollës ku transferohen nxënësit nuk janë paraqitur të dhëna konkrete në sa raste dhe për cilin mësues, por përmenden në formë të përgjithshme "në disa raste".

3. Monitorim për marrjen e masave për Maturën Shtetërore 2022

Me shkresën nr. 916 prot., datë 07.06.2022 është kryer monitorim për marrjen e masave për Maturën Shtetërore 2022 në gjimnazin "Isa Boletini", nga znj. M.D dhe znj. E.M Sipas këtij raport monitorimi nga grupi i monitorimit, në këtë gjimnaz nuk janë konstatuar problematika.

Me shkresën nr. 917 prot., datë 07.06.2022 është kryer monitorim për marrjen e masave për Maturën Shtetërore 2022 në shkollën "Ibrahim Rugova", nga z. A.A dhe z. S.A.

Nga auditimi konstatohet se rekomandimet nuk plotësojnë kriterin të jenë konkrete dhe të drejtpërdrejta me qëllim zbatimin e tyre në vijim. Konkretisht rekomandimi: "Drejtoria e shkollës mund të bënte një vlerësim edhe për para testet e lëndëve me zgjedhje", në fakt është në cilësinë e konstatimit.

4. Monitorim për institucionet arsimore për llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së shkollës 2022

Nga auditimi konstatohet se janë kryer monitorime për llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës në shkollën 9 vjeçare "100 Vjetori", shkollën 9 vjeçare "Halit Coka" dhe shkollën jopublike "E".

Për shkollën "100 vjetori" është konstatuar se është përllogaritur gabim treguesi "% e nxënësve që e kanë diferencën më të madhe se 1 notë" dhe është rekomanduar korrigjimi i tij.

Për shkollën "Halit Coka" nuk janë konstatuar problematika në drejtim të llogaritjes së treguesve.

Për shkollën "E" nuk është përllogaritur saktë treguesi "% e nxënësve të arsimit të mesëm të ulët që vijojnë arsimin e mesëm të lartë" dhe "rezultatet e mësuesve të shkollës në provimet e kualifikimit gjatë 4 viteve të fundit shkollore", për të cilat është rekomanduar korrigjimi i tyre.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet nuk përcaktojnë afat për zbatueshmërinë e tyre.

Viti 2023

1. Monitorimi dhe vlerësimi i ecurisë dhe mbarëvajtjes së punës në SMIP (sistemi i menaxhimit të informacionit parauniversitar"

Me shkresën nr. 363 prot., datë 16.02.2023 është kryer monitorim në lidhje me mbarëvajtjen e punës në SMIP, në gjimnazin "Sulejman Elezi", shkollën 9 vjeçare "Azem Hajdari" dhe shkollën 9 vjeçare "100 Vjetori" nga znj. K.P.

Me shkresën nr. 366 prot., datë 17.02.2023 është kryer monitorim në lidhje me mbarëvajtjen e punës në SMIP, në gjimnazin "Ibrahim Rugova", shkollën 9 vjeçare "Ahmet Zogu" dhe shkollën 9 vjeçare "Halit Coka" nga znj. K. P.

Me shkresën nr. 412 prot., datë 23.02.2023 është kryer monitorim në lidhje me mbarëvajtjen e punës në SMIP, në shkollën 9 vjeçare "Vëllazërimi" dhe shkollën 9 vjeçare "Elez Isuf Ndreu" nga znj. K. P.

Me shkresën nr. 382 prot., datë 20.02.2023 është kryer monitorim në lidhje me mbarëvajtjen e punës në SMIP, në shkollën 9 vjeçare "Kamza e R", shkollën 9 vjeçare "Demokracia" dhe shkollën 9 vjeçare "Niko Hoxha" nga znj. K. P.

Nga auditimi konstatohet se për këto raporte monitorimi edhe përse janë konstatuar problematika në drejtim të mbarëvajtjes së punës në SMIP nuk janë lënë rekomandime përkatëse.

2. Monitorim për planifikimin e veprimtarisë për aktivitetet e planifikuara në kuadër të këshillimit të karrierës

Me shkresën nr. 581/1 prot., datë 17.03.2023 është kryer monitorim në lidhje me planifikimin e veprimtarisë për aktivitetet në kuadër të këshillimit të karrierës për gjimnazin "Sulejman Elezi", nga znj. K.P dhe znj. L.M.

Me shkresën nr. 581 prot., datë 17.03.2023 është kryer monitorim në lidhje me planifikimin e veprimtarisë për aktivitetet në kuadër të këshillimit të karrierës për shkollën 9 vjeçare "Azem Hajdari" nga znj. K.P dhe znj. L.M.

Nga auditimi konstatohet se për këto 2 raporte monitorimi janë lënë 3 rekomandime edhe përse në seksionin "përfundime" nuk janë evidentuar problematika. Pra mungon lidhja konkrete midis rekomandimeve dhe rezultateve të raportimit të monitorimit për të cilin nuk janë evidentuar problematika. Konkretisht është lënë rekomandimi "Të protokollen të gjitha fazat e procesit të këshillimit të karrierës" edhe përse në përshkrimin e situatës/konstatimeve nuk është evidentuar si fakt ose të jenë paraqitur të dhëna në lidhje me shkresat e paprotokolluara.

Viti 2024

1. Monitorim për institucionet arsimore për llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së shkollës 2025

Për vitin 2025 janë kryer monitorime në lidhje me llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së Shkollës për vitin 2025 në institucionet arsimore si në vijim:

- me shkresën nr. 2176 prot., datë 27.09.2024 në shkollën "Elez Ndreu";
- me shkresën nr. 2174 prot., datë 27.09.2024 në shkollën "Hillary Clinton";
- me shkresën nr. 2175 prot., datë 27.09.2024 në shkollën "Arbëria";
- me shkresën nr. 2176 prot., datë 27.09.2024 në shkollën "Elez Ndreu";

Këto raporte monitorimi janë kryer nga z. V.Gj dhe z. H. D. Sipas këtyre raporteve janë paraqitur rezultatet e treguesve dhe nuk janë evidentuar problematika në drejtim të llogaritjes së treguesve të Kartës së Performancës.

2. Raport monitorimi për përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor

- Me shkresën nr. 2419 prot., datë 22.10.2024 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën "Azem Hajdari". Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, por rekomandimet nuk janë shoqëruar me afat në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.

Nga auditimi konstatohet gjithashtu se janë kryer monitorime në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale në kuadër të tematikës muaji nëntor 2024, raport monitorimi në lidhje me sigurinë e nxënësve, raport për vlerësimin e riskut dhe masat që duhet marrin IAP-të për menaxhimin e tij, raport mbi edukimin për zhvillimin dhe ndryshimet klimatike, raporti i monitorimit të takimeve të rrjeteve profesionale tetor-nëntor-dhjetor.

Viti 2025

1. Monitorim për institucionet arsimore për llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së shkollës 2025

Për vitin 2025 janë kryer monitorime në lidhje me llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së Shkollës për vitin 2025 në institucionet arsimore si në vijim:

- me shkresën nr. 1881/1 prot., datë 15.09.2025 në shkollën "Halit Coka";
- me shkresën nr. 1907/1 prot., datë 19.09.2025 në shkollën "Niko Hoxha";

- me shkresën nr. 1906/1 prot., datë 30.09.2025 në shkollën “Tahir Sinani”;
- me shkresën nr. 1921/1 prot., datë 23.09.2025 në shkollën “Isa Boletini”;

Këto raporte monitorimi janë kryer nga z. V.Gj dhe z. H. D. Sipas këtyre raporteve janë paraqitur rezultatet e treguesve dhe nuk janë evidentuar problematika në drejtim të llogaritjes së treguesve të Kartës së Performancës.

2. Monitorim për zhvillimin e orës sensibilizuese mbi fenomenin e bullizimit

Për vitin 2025 janë kryer monitorime në lidhje zhvillimin e orës sensibilizuese mbi fenomenin e bullizmit në institucionet arsimore si në vijim: gjimnazi “Ibrahim Rugova”; shkolla 9 vjeçare “100 Vjetori”; shkolla 9 vjeçare “Angela Merkel”.

Këto raporte monitorimi janë kryer nga znj. K.P dhe znj. D.Xh , sipas shkresës nr. 2211/1 prot., datë 08.10.2025. Në këto raporte monitorimi është përshkruar qartë situata në shkollat e përzgjedhura dhe janë lënë rekomandime në përputhje me situatat.

Gjithashtu me shkresën nr. 2211/2 prot., datë 08.10.2025 janë kryer monitorime me të njëjtën tematikë në institucionet arsimore në vijim: gjimnazi “Elez Isuf Ndreu”; shkolla 9 vjeçare “Ahmet Zogu”; shkolla 9 vjeçare “Halit Coka”;

Këto raporte monitorimi janë kryer nga z. V.Gj dhe znj. K.Sh. Në këto raporte monitorimi është përshkruar qartë situata në shkollat e përzgjedhura dhe janë lënë rekomandime në përputhje me situatat.

3. Raport monitorimi për përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor

- Me shkresën nr. 2266/1 prot., datë 14.10.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Ibrahim Rugova”. Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj, z. H.D dhe znj. L.M. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, shoqëruar dhe me afat në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2282/1 prot., datë 20.10.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Dom Nikoll Kacorri”. Ky monitorim është kryer nga z. H.D dhe z. N.Sh. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet. Konstatohet se për rekomandimet nuk janë përcaktuar afate në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2287/1 prot., datë 24.10.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Halit Coka”. Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj dhe z. H.D. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2283/1 prot., datë 31.10.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Fatos Lami”. Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj dhe z. H.D. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2281/1 prot., datë 03.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Ahmet Zogu”. Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj dhe znj. L.M. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2305/1 prot., datë 03.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën “Azem Hajdari”. Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj dhe z. H.D. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.

- Me shkresën nr. 2304/1 prot., datë 03.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën "Arbëria". Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj dhe z. H.D. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2391/1 prot., datë 10.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në gjimnazin "Sulejman Elezi". Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj, z. H.D dhe znj. L.M. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2397/1 prot., datë 10.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën "Ibrahim Basha". Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj, z. H.D, znj. D.Xh dhe znj. K.P. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre
- Me shkresën nr. 2427/1 prot., datë 13.11.2025 është kryer monitorim në lidhje me përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsisë së procesit mësimor në shkollën "Kamza e Re". Ky monitorim është kryer nga z. V.Gj, z. H.D dhe znj. D.Xh. Raporti paraqitet me konkluzione dhe rekomandime në përputhje me konstatimet, duke lënë dhe afate për zbatueshmërinë e tyre.

4. Raport monitorimi i pretendimeve të ngritura nëpërmjet ankesës së bërë nga ana e mësuesit Besmir Matoshi, mësuesi i shkollës "100 Vjetori"

Me shkresën nr. 2324/2 prot., datë 03.11.2025 është kryer monitorim në shkollën "100 Vjetori", për verifikimin e pretendimeve të ngritura ana e mësuesit z. B.M.

Ky raport i përgatitur nga z. V.Gj, z. H.D dhe znj. D.Xh paraqitet i plotë, gjetjet dhe rekomandimet në koherencë më njëra tjetrën. Konstatohet se për rekomandimet nuk është lënë afat në lidhje me zbatueshmërinë e tyre.

5. Raport monitorimi të praktikantëve që zhvillojnë praktikën profesionale.

- Me shkresën nr. 2403/1 prot., datë 12.11.2025 është bërë monitorim i zhvillimit të praktikave profesionale në gjimnazin "Sulejman Elezi", nga z. V.Gj dhe z. H.D, për të cilën janë lënë konstatimet dhe rekomandimet në lidhje me to. Konstatohet se për rekomandimet mungon afati i lënë për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2410/1 prot., datë 12.11.2025 është bërë monitorim i zhvillimit të praktikave profesionale në gjimnazin "Ibrahim Basha", nga z. V.Gj dhe z. H, për të cilën janë lënë konstatimet dhe rekomandimet në lidhje me to. Konstatohet se për rekomandimet mungon afati i lënë për zbatueshmërinë e tyre.
- Me shkresën nr. 2438/1 prot., datë 20.11.2025 është bërë monitorim i zhvillimit të praktikave profesionale në gjimnazin "Ibrahim Basha", nga z. V.Gj dhe z. N.Sh, për të cilën janë lënë konstatimet dhe rekomandimet në lidhje me to. Konstatohet se për rekomandimet mungon afati i lënë për zbatueshmërinë e tyre.

Nga auditimi konstatohet gjithashtu se janë kryer monitorime në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale në kuadër të tematikës muaji tetor 2025, raport monitorimi në lidhje me sigurinë e nxënësve etj. Pra 2025 paraqitet me një mbulim të konsiderueshëm të monitorimeve si për numër shkollash ashtu dhe për tematikë. Gjithashtu trajtimi i tyre paraqitet i plotë dhe gjetje-rekomandime rezultojnë në koherencë me njëra tjetrën, trajtuar edhe me afat në lidhje me zbatueshmërinë e tyre**.**

2.4.5. Monitorimet e kryera nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë Viti 2022

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Muçaj"

Sipas shkresës nr. 105/3 prot., datë 18.04.2022 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P dhe z. O.T, ka kryer monitorim në shkollën 9 vjeçare "Muçaj", në lidhje me monitorimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen e teksteve shkollore, ku nuk kanë konstatuar problematika. Rekomandimi i lënë: Ekipet lëndore të reflektojnë në procesverbalet e administrimit të përzgjedhjes së teksteve shkollore, detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesve/ekipeve lëndore.

Për ZVA Vorë: ZVA Vorë të monitorojë në vijimësi realizimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport për drejtuesit e shkollës 9 vjeçare dhe të raportojnë në DRAP Durrës.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi nuk është përcaktuar si gjetje mungesa e reflektimit në procesverbalet e administrimit të përzgjedhjes së teksteve shkollore, detyrat dhe përgjegjësitë e mësuesve/ekipeve lëndore, pavarësisht se është lënë si rekomandim. Në përgjithësi raporti i monitorimit paraqitet përshkrues.

2. Monitorim për institucionet arsimore, 6 shkolla 9 vjeçare

Sipas shkresës nr. 539 prot., datë 17.06.2022 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E. P, z. A.Q dhe z. O.T, ka kryer monitorime në shkollat 9 vjeçare "Ahmetaq", "Ramazan Subashi", "Vorë", "Marqinet", "Muçaj" dhe "Vajdin Lamaj", në lidhje me monitorimin e masave të marra për zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2022.

Sipas këtij raport monitorimi, në shkollat e monitoruara janë ngritur Komisionet shkollore të PKAB, disponohen rregulloret për zhvillimin e PKAB, janë ngritur këndet e PKAB, janë zhvilluar para testet dhe janë zhvilluar konsulta sipas grafikut dhe orarit të caktuar nga shkolla.

Nga auditimi konstatohet se në përgjithësi raporti i monitorimit paraqitet përshkrues, pa detaje apo evidenca që të mbështes rezultatet e monitorimit.

3. Monitorim për institucionet arsimore, shkolla 9 vjeçare "Picar"

Sipas shkresës nr. 179/3 prot., datë 03.03.2022 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P, z. A.Q dhe z. O.T, ka kryer monitorime në shkollat 9 vjeçare "Picar", ku është konstatuar si në vijim:

- Mësuesit punojnë në vijimësi, me përjashtim të rasteve të pakta, duke respektuar rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar.
- Nuk vihen re planifikime veprimtarie për nxënës të veçantë si dhe nuk punohet me detyra sipas niveleve.
- Nuk pasqyrohen informacione për vlerësimin e nxënësve në reflektim.

Në këtë raport monitorimi janë lënë këto rekomandime:

- Plani ditor të hartohet çdo ditë për çdo temë, plani ditor të jetë me format të rregullt, estetik dhe të pasqyrohen të gjitha rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar, çdo ditë.
- Të punohet me nivele në dhënien e detyrave, çdo ditë.
- Të plotësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të gjitha rubrikat e ditarit.
- Të përcaktohet mirë në planifikimin ditor metodologjia, situata si dhe nivelet e vlerësimit, duke bërë përcaktimin si dhe ndarjen sipas përmbushjes së rezultateve të të nxënit.

Nga auditimi konstatohet se raporti paraqet mangësi në aspektin e plotësisë dhe standardizimit, pasi rekomandimet janë të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me afate konkrete zbatimi, gjë që e vështirëson ndjekjen dhe vlerësimin e progresit.

Viti 2023

1. Monitorim për institucionet arsimore, 13 shkolla

Sipas shkresës nr. 318/1 prot., datë 29.09.2023 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P dhe z. O. T, ka kryer monitorime në shkollat në varësi të ZVAP Vorë: 2 gjimnaze, 1 shkollë e mesme e bashkuar, 10 shkolla 9 vjeçare, ku është konstatuar si në vijim:

- Në disa plane afatmesëm mungojnë disa nga rubrikat e përcaktuara në Rregulloren për Funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH.
- Në disa plane analiza e gjendjes ishte formale, duke mos dhënë më shumë detaje për shkollën.
- Vizioni i shkollës në disa raste nuk përmbledh aspiratën e komunitetit dhe të punonjësve arsimor për cilësinë e shërbimit arsimor të ofruar.
- Vizioni është formuluar në mënyrë të përgjithshme duke mos evidentuar vlerat dhe aspiratat në të cilat do të zhvillohet shkolla.
- Në planin afatmesëm shkollat kanë vendosur shumë përparësi duke mos i shoqëruar ato me veprimtarirë kryesore për realizimin e tyre.
- Në lidhje me aspekte të ndryshme të ecurisë së shkollës nuk ndiqet një strukturë e qartë dhe shpeshherë mungojnë të dhëna thelbësore për secilin tregues.
- Në planet vjetore të shkollave mungon procesura e hartimit të planit, duke mos përfshirë grupet e interesit.
- Plani vjetor nuk është mbështetur në planin afatmesëm, planin e përmirësimit, analizën e gjendjes si dhe nuk dokumentohen të dhëna që janë marrë parasysh sygjerimet e nxënësve, prindërve, mësuesve dhe grupeve të interesit.
- Në disa plane mungojnë disa tregues të rëndësishëm si % e mungesave vjetore, treguesit për të cilat shkolla ka arritjet më të larta/ulëta etj. Në të gjitha planet mungonte treguesi për numrin e krediteve të marra nga punonjësit mësimor gjatë vitit të kaluar.
- Në disa plane objektivi nuk ka qenë i matshëm, duke nxitur ngritjen fiktive të rezultateve. Në disa plane mungonte plani i vëzhgimit.

Në lidhje me këtë raport monitorimi janë lënë këto rekomandime:

- Të gjitha planet e reja të PASH të rishikohen dhe të përpunohen duke iu referuar nenit 49 të Rregullores së IA.
- Të përfshihen në këto plane të gjithë treguesit duke i detajuar dhe duke dhënë të dhënat e domosdoshme.
- PASH të jetë në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.
- PASH të jenë në funksion të përmirësimit të arritjeve sipac veçorive të secilës shkollë.
- Plani vjetor të përfshijë një nga përparësitë e PASH dhe të jenë në të njëjtën linjë.
- Të ndiqen me përpikmëri rubrikat e hartimit të planit vjetor sipas nenit 51 të Rregullores.
- Objektivi i shkollës të formulohet saktë, të jetë i matshëm.
- Për çdo objektiv duhet të planifikohen veprimtaritë për realizimin e tij si dhe planin e vëzhgimit për ecurinë e realizimit.
- Të rishikohen tematikat sipas nevojave të mësuesve për zhvillimin e brendshëm profesional.

Nga auditimi u konstatua se gjetjet janë në përgjithësi relevante në raport me rekomandimet e lëna. Megjithatë, në disa raste konstatohet përdorimi i formulimeve të përgjithshme pa u mbështetur në të dhëna konkrete (p.sh. “në disa plane”, “në disa raste”), pa specifikuar numrin e rasteve apo institucionet përkatëse, çka e dobëson forcën analitike dhe verifikueshmërinë e gjetjeve. Gjithashtu rekomandimet nuk shoqërohen me afate konkrete zbatimi dhe nuk përcaktojnë qartë përgjegjësit për ndjekjen e tyre.

2. Monitorim për institucionet arsimore, 5 shkolla

Sipas shkresës nr. 274/1 prot., datë 17.04.2023 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E. P dhe z. O.T, ka kryer monitorime në shkollat 9 vjeçare "Fushë Prezë", "Ramazan Subashi", "Vorë", "Shaban Sheshori" dhe Gjimnazi "Isa Boletini", në lidhje me procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore.

Nga auditimi konstatohet se në përgjithësi raporti i monitorimit paraqitet përshkrues, nuk janë evidentuar problematika, si rrjedhojë nuk ka as rekomandime.

Viti 2024

1. Monitorim në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale

Sipas shkresës nr. 692/1 prot., datë 03.12.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P dhe z. O.T, ka kryer monitorim në lidhje me takimet e rrjeteve profesionale në kuadër të tematikës muaji nëntor 2024.

Në përgjithësi raporti i monitorimit paraqitet përshkrues, nuk janë evidentuar problematika, si rrjedhojë nuk ka as rekomandime.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Picar"

Sipas shkresës nr. 111/1 prot., datë 13.01.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P, z. A.Q dhe z. O.T, ka kryer monitorime në shkollat 9 vjeçare "Picar", në lidhje me cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, ku është konstatuar si në vijim:

- Mësuesit punojnë në vijimësi, me përjashtim të rasteve të pakta, duke respektuar rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar.
- Nuk vihen re planifikime veprimtarie për nxënës të veçantë si dhe nuk punohet me detyra sipas niveleve.
- Nuk pasqyrohen informacione për vlerësimin e nxënësve në reflektim.

Në këtë raport monitorimi janë lënë këto rekomandime:

- Plani ditor të hartohet çdo ditë për çdo temë, plani ditor të jetë me format të rregullt, estetik dhe të pasqyrohen të gjitha rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar, çdo ditë.
- Të punohet me nivele në dhënien e detyrave, çdo ditë.
- Të plotësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi të gjitha rubrikat e ditarit.
- Të përcaktohet mirë në planifikimin ditor metodologjia, situata si dhe nivelet e vlerësimit, duke bërë përcaktimin si dhe ndarjen sipas përmbushjes së rezultateve të të nxënit.

Nga auditimi konstatohet se raporti paraqet mangësi në aspektin e plotësisë dhe standardizimit, pasi rekomandimet janë të përgjithshme dhe nuk shoqërohen me afate konkrete zbatimi, gjë që e vështirëson ndjekjen dhe vlerësimin e progresit. Evidentohet gjithashtu se janë të njëjtat gjetje dhe rekomandime me raportin e monitorimit të vitit 2022, dërguar me shkresën nr. 179/3 prot., datë 03.03.2022.

Viti 2025

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Vorë

Sipas shkresës nr. 537/2 prot., datë 17.09.2025 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P dhe z. O. T, ka kryer monitorim në lidhje me llogaritjen e treguesve të Kartës së Performancës së Shkollës 2025. Në këtë raport monitorimi nuk janë evidentuar problematika, si rrjedhojë nuk ka as rekomandime.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi janë paraqitur rezultatet e treguesve por nuk ka bashkëlidhur një formular i përdorur, metodologjia ose evidencat që mbështesin konkluzionet me qëllim paraqitjen e një raporti më konkret dhe të plotë.

2. Monitorim për institucionin arsimor, gjimnazi "Isa Boletini"

Sipas shkresës nr. 555/1 prot., datë 18.04.2022 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. E.P dhe z. O.T, ka kryer monitorim në gjimnazin "Isa Boletini", në lidhje me vlerësimin e procesit të zbatimit të nismës "Shkolla Qendër Komunitare". Në këtë raport monitorimi nuk janë evidentuar problematika, si rrjedhojë nuk janë lënë as rekomandime.

Nga auditimi konstatohet se në përgjithësi raporti i monitorimit paraqitet përshkrues, pa detaje apo evidenca që të mbështetës rezultatet e monitorimit.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet një numër shumë i kufizuar raportesh monitorimi nga ZVAP Vorë, të cilat nuk kanë mbuluar në mënyrë të plotë të gjitha institucionet arsimore. Kjo situatë paraqet risk të shtuar në lidhje me efektivitetin dhe vazhdimësinë e monitorimit të këtyre institucioneve. Për më tepër, raportet e realizuara rezultojnë kryesisht përshkruese dhe nuk shoqërohen me evidenca mbështetëse të mjaftueshme, çka dobëson besueshmërinë e konkluzioneve të arritura. Në rastet kur janë lënë rekomandime, nuk është vendos afat për zbatimin e tyre.

2.4.6. Monitorimet e kryera nga Zyra Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë

Viti 2022

Nga auditimi konstatohet se ZVAP Kavajë për vitin 2022 ka kryer monitorime, konkretisht në shkollat: Golem më datë 04.03.2022, 11 Shkurti më datë 09.03.2022, Rrakull më datë 10.03.2022. Objekti i monitorimit ka qenë: Masat e marra nga IA për zhvillimin e provimeve kombëtare të Arsimit Bazë 2022. Listë-verifikimi është firmosur nga grupi monitorues si dhe drejtori i shkollës që është monitoruar.

Nga auditimi konstatohet se, megjithëse janë mbajtur listë-verifikime për monitorimet e kryera, nuk janë hartuar raporte monitorimi ku të evidentohen problematikat e konstatuara, analizat përkatëse dhe rekomandimet konkrete në funksion të përmirësimit të procesit. Mungesa e raporteve të monitorimit cenon dokumentimin e plotë të veprimtarisë monitoruese dhe ndjekjen efektive të masave për përmirësim.

Viti 2023

Për vitin 2023 janë monitoruar shkollat: SHB Synej më datë 07.02.2022, Aleksandër Moisiu më datë 08.02.2023 dhe Luz i Vogël më datë 09.02.2023. Objekti i monitorimit ka qenë: Masat e marra nga IA për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2023. Më datë 11.03.2023 është zhvilluar monitorimi i shkollës 9-vjeçare "Mehmet Babamusta" me objekt: Masat e marra nga IA për zhvillimin e provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë. Listë verifikimi është firmosur nga grupi monitorues si dhe drejtori i shkollës që është monitoruar.

Më datë 29.08.2023 është monitoruar shkolla 9-vjeçare Bago me objekt: Monitorimi i shkollës për cilësinë e administrimit të dokumentacionit shkollor në ruajtje të përhershme/të përkohshme dhe bazën materiale. Raporti i vlerësimit është firmosur nga grupi i vlerësimit dhe drejtori i ZVAP Kavajë.

Nga auditimi konstatohet se, megjithëse janë mbajtur listë-verifikime për monitorimet e kryera, nuk janë hartuar raporte monitorimi ku të evidentohen problematikat e konstatuara, analizat përkatëse dhe rekomandimet konkrete në funksion të përmirësimit të procesit. Mungesa e raporteve të monitorimit cenon dokumentimin e plotë të veprimtarisë monitoruese dhe ndjekjen efektive të masave për përmirësim. Raport monitorimi është përgatitur vetëm për shkollën 9-vjecare "Bago", sipas shkresës nr. 925 prot., datë 29.08.2023.

Viti 2024

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla e mesme e bashkuar "11 Shkurti" Synej.

Sipas shkresës nr. 1555/3 prot., datë 08.11.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C, znj. L.P dhe znj. E.M , ka kryer në shkollën e mesme të bashkuar "11 Shkurti" Synej, në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar në fushën "Drejtimi dhe menaxhimi" ku është konstatuar si në vijim:

- Vizioni i shkollës shpreh në mënyrë jo të plotë aspiratat dhe dëshirat që synon të arrijë shkolla.
- Drejtoresha harton raporte vlerësimi por mungojnë rekomandimet për përmirësimin e procesit mësimor.
- Drejtoresha disponon plan për zhvillimin e brendshëm profesional por ky plan ka nevojë për përmirësim.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Drejtuesi i shkollës të sistemojë planin vjetor në përputhje me nenet 51, 52, 53 të Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH, miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Grupet e punës të dokumentojnë veprimtarinë dhe produktet e punës në funksion të realizimit të planit vjetor dhe vlerësimit të brendshëm të shkollës.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi gjetjet e identifikuara trajtojnë çështje konkrete si pa plotësia e vizionit të shkollës, mungesa e rekomandimeve në raportet e vlerësimit dhe nevoja për përmirësim të planit të zhvillimit profesional, por këto nuk pasqyrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, formulimi i gjetjeve mbetet në disa raste i përgjithshëm dhe jo mjaftueshëm i argumentuar, çka e dobëson më tej bazën mbi të cilën ndërtohen rekomandimet. Rekomandimet rezultojnë të jenë të përgjithshme dhe më tepër të orientuara drejt aspekteve formale, si sistemimi i planit vjetor dhe dokumentimi i veprimtarive, pa adresuar specifikisht problematikat e evidentuara në gjetje.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Herbert"

Sipas shkresës nr. 1555/2 prot., datë 07.11.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C, znj. L.P dhe znj. E.M, ka kryer në shkollën 9 vjeçare, në lidhje me cilëinë e shërbimit të ofruar në fushën "Drejtimi dhe menaxhimi" ku është konstatuar si në vijim:

- Vizioni i shkollës është formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk është mbështetur në kontekstin e shkollës për të krijuar pamjen e së ardhmes. Synimi i shkollës për këtë vit shkollor është shkruar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk orientohet në arritjet e nxënësve.
- Nuk është hartuar qartë konteksti i shkollës dhe nuk është hartuar raporti i vlerësimit të brendshëm por është hartuar plani i përmirësimit nga ekipi qendror.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Drejtuesi i shkollës të vijojë procesin për vlerësimin e brendshëm.
- Drejtuesi i shkollës të hartojë planin e zhvillimit profesional, mbështetur në analizën e nevojave dhe në mbështetje të realizimit të objektivave të shkollës.
- Drejtuesi i shkollës të dokumentojë veprimtaritë për proceset e vlerësimit, pjesëmarrjes, informimit apo raportimit në shkollë.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet e dhëna janë të përgjithshme dhe nuk ofrojnë hapa konkretë për përmirësim, duke e bërë të vështirë zbatimin dhe matjen e rezultateve. Formulimi i gjetjeve mbetet i paqartë dhe pa evidencë të detajuar, ndërsa lidhja midis gjetjeve dhe rekomandimeve nuk është e fortë. Për pasojë, raporti ka nevojë për konkretizim të udhëzimeve dhe forcim të lidhjes logjike për të siguruar ndikim real në përmirësimin e shkollës.

3. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare Golem

Sipas shkresës nr. 1555/1 prot., datë 06.11.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C, znj. L.P dhe znj. E.M, ka kryer në shkollën 9 vjeçare, në lidhje me cilëinë e shërbimit të ofruar në fushën "Drejtimi dhe menaxhimi" ku është konstatuar si në vijim:

- Nuk dokumentohen të dhëna që janë marrë parasysh sygjerimet e nxënësve, prindërve, mësuesve dhe grupeve të interesit.
- Nuk është hartuar konteksti i shkollës dhe nuk është hartuar raporti i vlerësimit të brendshëm.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Drejtuesi i shkollës të vijojë procesin për vlerësimin e brendshëm.
- Drejtuesi i shkollës të orientojë formatet e vlerësimit të arritjeve të procesit mësimor në realizimin e synimeve të shkollës.
- Drejtuesi i shkollës të dokumentojë veprimtaritë për proceset e vlerësimit.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi rekomandimet mbeten të përgjithshme dhe nuk specifikojnë hapat konkretë për përfshirjen e të dhënave nga të gjitha grupet e interesit, duke e kufizuar qartësinë dhe zbatueshmërinë e tyre.

4. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Fiqiri Kurti"

Sipas shkresës nr. 145/2 prot., datë 25.03.2024 grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C, znj. L. P dhe znj. E.M, ka kryer në shkollën 9 vjeçare, në lidhje me monitorimin e shkollës për masat e marra për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, për profesionin e rregulluar të mësuesit si dhe për procedurat e vlerësimit të praktikantëve, ku është konstatuar si në vijim:

- Mësuesi mentor nuk mban plan-ditar në mënyrë sistematike sipas formatit ku përshkruan veprimtarinë e tij si mentor në orët e vëzhgimit dhe shënon konstatimet dhe këshillat kryesore në seanca këshilluese.
- Në dokumentacionin e drejtorit të shkollës nuk janë ruajtur vlerësimet e praktikantëve sipas periudhës (shtojca 3).

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Të ruhen vlerësimet e praktikantëve të periudhave të kaluara.
- Praktikanti duhet të marrë pjesë edhe në takime që organizon shkolla me prindërit.
- Praktikanti duhet të marrë pjesë edhe në takimet e rrjetit profesional sipas profilit.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi në përgjithësi, ka një lidhje midis gjetjeve dhe rekomandimeve, por nuk adreson direkt mungesën e plan-ditarit sistematik të mësuesit mentor dhe nuk ofron udhëzime konkrete për të siguruar mbajtjen e tij.

Viti 2025

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Mehmet Babamusta"

Sipas shkresës nr. 173/2, datë 07.02.2025, grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C, znj. L.P dhe znj. E.M, ka kryer monitorim në shkollën 9 vjeçare "Mehmet Babamusta", në lidhje me masat e marra për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, për profesionin e rregulluar të mësuesit si dhe për procedurat e vlerësimit të praktikantëve, ku është konstatuar si në vijim:

-Drejtori i shkollës të krijojë mundësinë që praktikanti dhe mentori të kryejnë vizita sistematike të ndërsjellta në orët mësimore të njëri-tjetrit brenda normave të përcaktuara.

- Mësuesi mentor nuk mban plan ditor në mënyrë sistematike, sipas formatit ku përshkruan veprimtarinë e tij si mentor në orët e vëzhgimit dhe shënon konstatimet dhe këshillat kryesore në seanca këshilluese.
- Në dokumentacionin e drejtorit të shkollës nuk janë ruajtur vlerësimet e praktikantëve sipas periudhës.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Të ruhen vlerësimet e praktikantëve.
- Praktikanti duhet të marrë pjesë edhe në takimet që organizon shkolla me prindërit.
- Praktikanti duhet të marrë pjesë edhe në takimet e rrjetit profesional sipas profilit.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi në përgjithësi, ka një lidhje midis gjetjeve dhe rekomandimeve, por nuk adreson direkt mungesën e plan-ditarit sistematik të mësuesit mentor dhe nuk ofron udhëzime konkrete për të siguruar mbajtjen e tij.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9 vjeçare "Herbet"

Sipas shkresës nr. 173/1, datë 07.02.2025, grupi i monitorimit i përbërë nga znj. M.C., znj. L.P dhe znj. E.M, ka kryer monitorimi në shkollën 9 vjeçare "Herebt" në lidhje me masat e marra për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale, për profesionin e rregulluar të mësuesit si dhe për procedurat e vlerësimit të praktikantëve, ku është konstatuar si në vijim:

-Drejtori i shkollës të krijojë mundësinë që praktikanti dhe mentori të kryejnë vizita sistematike të ndërsjellta në orët mësimore të njëri-tjetrit brenda normave të përcaktuara.
- Mësuesi mentor nuk ka hartuar në bashkëpunim me praktikantët planin mujor për orët e planifikuar si mësues ndihmës.
- Mësuesi mentor nuk mban plan ditor në mënyrë sistematike, sipas formatit ku përshkruan veprimtarinë e tij si mentor në orët e vëzhgimit dhe shënon konstatimet dhe këshillat kryesore në seanca këshilluese.
- Në dokumentacionin e drejtorit të shkollës nuk janë ruajtur vlerësimet e praktikantëve sipas periudhës.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:
- Të ruhen vlerësimet e praktikantëve.
- Të planifikohen orët e praktikantit si mësues ndihmës.
- Duhet të respektohet formati model i udhëzimit përkatës për vlerësimin e praktikantëve.

Në përgjithësi, raporti tregon një lidhje midis gjetjeve dhe rekomandimeve, pasi identifikon mangësitë në monitorimin dhe dokumentacionin e praktikantëve dhe propozon ruajtjen e vlerësimeve, planifikimin e orëve të praktikantit si mësues ndihmës dhe respektimin e formatit të udhëzimit për vlerësimin e praktikantëve. Megjithatë nuk adresohen në mënyrë të drejtpërdrejtë vizitat e ndërsjella sistematike midis mentorit dhe praktikantit, si dhe nuk ofrohen hapa konkretë për mbajtjen e planit ditor sistematik të mentorit.

Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi ZVAP Kavajë nuk ka mbulim të mjaftueshëm në numër dhe në tematikë përsa i përket monitorimeve të realizuara.

2.4.7 Monitorimet e realizuara nga ZVAP Rrogozhinë

Viti 2022

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla e mesme e bashkuar "Gosë"

Sipas shkresës nr. 173 prot., datë 21.04.2022, grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe znj. G.B, ka kryer në shkollën e mesme të bashkuar "Gosë". Me shkresën nr. 209 prot., datë 16.05.2022 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:

- Plani ditor hartohet duke identifikuar rezultatet e të nxënit dhe mënyrën e vlerësimit të nxënësit në të dy ciklet.
- Mësuesit punojnë në vijimësi, me përjashtim të rasteve të pakta, duke respektuar rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar.
- Në ditën e monitorimit u gjetën pa ditar 6 mësues.
- Nuk ka planifikime veprimtarie për nxënës të veçantë si dhe nuk punohet me detyra sipas niveleve.
- Nuk pasqyrohen informacione për vlerësimin e nxënësve në reflektim.

- Në regjistrat e shkollave, në shumicën e tyre, ka mungesë në hedhjen e temave përkatësisht në lëndët Frëngjisht, Anglisht, Fizikë, Biologji, Histori, Gjeografi, TIK dhe Edukim Fizik.
- Largimi i nxënësve në amëz duhet firmosur dhe vulosur nga drejtori i shkollës.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:
- Plani ditor të hartohet çdo ditë për çdo temë, plani ditor të jetë më format të rregullt, estetik dhe të pasqyrohen të gjitha rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar, çdo ditë.
- Të punohet me nivele në dhënien e detyrave, çdo ditë.
- Të përcaktohet mirë në planifikimin ditor metodologjia, situata si dhe nivelet e vlerësimit, duke bërë përcaktimin si dhe ndarjen sipas përmbushjes së rezultateve të të nxënit.
- Të hidhen temat në regjistër sipas legjislacioneve përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se në këtë raport monitorimi jo të gjitha gjetjet shoqërohen me rekomandime përkatëse dhe në disa raste mungon lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet tyre. Gjithashtu, rekomandimet e dhëna janë përgjithësisht të karakterit të përgjithshëm dhe nuk përmbajnë elementë të matshëm, afate kohore apo përcaktim të përgjegjësive, çka e vështirëson ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të tyre.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Hekuran Balliu"

Grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe znj. G.B, ka kryer në shkollën 9-vjeçare "Hekuran Balliu". Me shkresën nr. 249/1 prot., datë 24.05.2022 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:
- Mësuesit punojnë në vijimësi, me përjashtim të rasteve të pakta, duke respektuar rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar.
- Në ditën e monitorimit mësuesit ishin të gjithë me ditar.
- Në regjistrat e shkollave, në shumicën e tyre, ishte punuar pastër vetë me përjashtim të disa orëve të ditëve të fundit pa hedhur temat.
- Drejtori i shkollës, në disa faqe të amzës, nuk ka nënshkruar në vendin përkatës të faqes së amzës në përfundim të provimeve kombëtare ose kur nxënësi është larguar nga shkolla.
- Shkolla ka plotësuar pjesërisht indeksin e amzës.
- Shkolla ka plotësuar pjesërisht regjistrin e veçantë.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:
- Plani ditor të hartohet çdo ditë për çdo temë, plani ditor të jetë më format të rregullt, estetik dhe të pasqyrohen të gjitha rubrikat e parashikuara në formatin zyrtar, çdo ditë.
- Të punohet me nivele në dhënien e detyrave, çdo ditë.
- Të hidhen temat në regjistër sipas legjislacioneve përkatëse.
- Të plotësohet regjistri i veçantë dhe indeksi i amzës.
- Të vendoset vula nga drejtori i shkollës, në ato vende ku nuk është vendosur, në amëz.

Nga auditimi konstatohet se raporti shfaq mangësi në aspektin e koherencës ndërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve, pasi një pjesë e rekomandimeve (si ato për planin ditor dhe punën me nivele) nuk burojnë drejtpërdrejtë nga gjetjet e evidentuara. Nga ana tjetër, disa problematika të konstatuara, si mungesa e nënshkrimeve në amëz apo plotësimi i pjesshëm i dokumentacionit shkollor, janë adresuar në mënyrë të përshtatshme në rekomandime. Në tërësi, raporti është i pjesshëm në lidhjen logjike gjetje–rekomandim dhe rekomandimet mbeten kryesisht të përgjithshme, pa elementë të matshëm, afate konkrete dhe përcaktim përgjegjësish. Si i tillë, ai ofron një pasqyrë bazë të situatës, por kërkon përmirësim në strukturim dhe në forcimin e analizës për të përmbushur standardet e një raporti monitorimi efektiv.

Viti 2023

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Ballaj"

Grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe z. E.K, ka kryer në shkollën 9-vjeçare "Ballaj", me shkresën nr. 648 prot., datë 19.12.2023 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:

- Nuk ka planifikime veprimtarie për nxënës të veçantë si dhe nuk punohet me detyra sipas niveleve.
- Ditën e monitorimit, për një mësuese u gjetën disa data të fshira me korrektor. Ditari është punuar me shkrim në fleta të gatshme.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Mësuesi duhet të punojë sistematikisht me ditarin sipas legjislacionit përkatës.
- Të merren masa referuar Udhëzimit nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore", neni 107 "Masa disiplinore për mësuesit dhe drejtorit, pika 2 "Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për mësuesin ose nëndrejtorin në varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes të së njëjtës shkelje".

Afati i përmbushjes së rekomandimeve, jo më shumë se 5 ditë mësimore.

Nga auditimi konstatohet se, raporti i monitorimit paraqet mangësi në proporcionalitetin e rekomandimeve. Masa disiplinore e propozuar nuk justifikohet plotësisht nga niveli i gjetjeve, i kufizuar në 1 rast. Gjithashtu, vihet re mungesë konsistence krahasuar me monitorime të tjera, ku për problematika të ngjashme ose gjetje më të shumta në numër nuk janë rekomanduar masa të tilla.

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Rreth Greth"

Grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe z. E.K , ka kryer në shkollën 9-vjeçare "Rreth-Greth". Me shkresën nr. 652 prot., datë 19.12.2023 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:

- Nuk ka planifikime veprimtarie për nxënës të veçantë si dhe nuk punohet me detyra sipas niveleve.
- Ditën e monitorimit, për një mësuese rezultoi se ditari është marrë nga libri i mësuesit dhe është i papërpunuar dhe i pa sistemuar. Për një mësuese tjetër, datat e ditarit janë të fshira me korrektor dhe ditarët rezultuan të viteve të kaluara. Gjithashtu ditari rezultoi i marrë nga libri i mësuesit dhe i papërpunuar.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Mësuesi duhet të punojë sistematikisht me ditarin sipas legjislacionit përkatës.
- Të merren masa referuar Udhëzimit nr. 31, datë 28.01.2020 "Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore", neni 107 "Masa disiplinore për mësuesit dhe drejtorit, pika 2 "Masat e përshkallëzuara që komisioni i disiplinës vendos për mësuesin ose nëndrejtorin në varësi të llojit të shkeljes apo përsëritjes të së njëjtës shkelje".

Afati i përmbushjes së rekomandimeve, jo më shumë se 5 ditë mësimore.

Nga auditimi konstatohet se, raporti i monitorimit paraqet mangësi në proporcionalitetin e rekomandimeve. Masa disiplinore e propozuar nuk justifikohet plotësisht nga niveli i gjetjeve, i kufizuar në 1 rast. Gjithashtu, vihet re mungesë konsistence krahasuar me monitorime të tjera, ku për problematika të ngjashme ose gjetje më të shumta në numër nuk janë rekomanduar masa të tilla.

Viti 2024

Për vitin 2024 nuk rezulton të jetë kryer asnjë monitorim për vitin 2024.

Ngarkohen me përgjegjësi znj. D.T në cilësinë e përgjegjësit të Sektorit të Kurrikulës dhe Monitorimit, për moskryerjen e monitorimeve për vitin 2024.

Viti 2025

1. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Spille"

Grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe znj. G. B, ka kryer në shkollën 9-vjeçare "Spille". Me shkresën nr. 956 prot., datë 02.12.2025 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:

- Ditarët janë shkruar në vetën e tretë, ndërkohë që duhet të hartohen në vetën e parë, sipas formatit zyrtar.
- Në disa ditarë ka data të korrigjuara, çka nuk lejohet në dokumentacionin shkollor. Në një pjesë të ditarëve mungon viti shkollor.
- Nuk është zbatuar plotësisht struktura e ditarit në të gjitha rastet. Ka mungesa në plan-ditarë, pasi mësuesi nuk i ka hartuar plan-ditarët në përputhje me orarin mësimor, duke bërë që dokumentacioni të mos jetë i plotë.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Plan-ditarët të hartohen çdo ditë, për çdo orë mësimore, dhe në përputhje të plotë me orarin mësimor. Plan-ditarët të hartohen në vetën e parë, sipas formatit zyrtar të dokumentacionit shkollor.
- Të shmangen korrigjimet e datave në ditar; në rast gabimi, dokumenti duhet ribërë sipas rregullores. Në çdo ditar të vendoset qartë viti shkollor. Të zbatohet plotësisht struktura e detyrueshme e ditarit për të gjitha orët.
- Rubrika "Temat e kaluar" të plotësohet rregullisht dhe në mënyrë të saktë. Të merren masa për zbatimin e rregullave të dokumentacionit, referuar Udhëzimit nr. 31, datë 30.08.2018.

Afati për përmbushjen e rekomandimeve: jo më shumë se 5 ditë mësimore.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht koherencës së mirë ndërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve, konstatohet se raporti paraqet disa mangësi në aspektin e plotësisë dhe forcës analitike. Konkretisht, gjetjet janë të formuluara në mënyrë përgjithësuese ("në disa ditarë", "në një pjesë"), pa specifikuar shtrirjen reale të problemit (numër, përqindje apo raste konkrete), çka e bën të vështirë vlerësimin e nivelit të riskut dhe rëndësisë së problematikave të evidentuara.

Gjithashtu, rekomandimet, ndonëse të qarta, janë të natyrës kryesisht korrigjuese dhe nuk adresojnë shkaqet rrënjësore të problematikave (p.sh. mungesë kontrolli nga drejtuesit, nevojë për trajnim apo mbikëqyrje e pamjaftueshme).

2. Monitorim për institucionin arsimor, shkolla 9-vjeçare "Stërbeg"

Grupi i monitorimit i përbërë nga znj. D.T dhe znj. G. B., ka kryer në shkollën 9-vjeçare "Stërbeg". Me shkresën nr. 955 prot., datë 02.12.2025 ka përgatitur raportin e monitorimit, ku është konstatuar si në vijim:

- Ditarët janë shkruar në vetën e tretë, ndërkohë që duhet të hartohen në vetën e parë, sipas formatit zyrtar.
- Në disa ditarë ka data të korrigjuara, çka nuk lejohet në dokumentacionin shkollor.
- Në një pjesë të ditarëve mungon viti shkollor.
- Nuk është zbatuar plotësisht struktura e ditarit në të gjitha rastet. Ka mungesa në plan-ditarë, pasi mësuesi nuk i ka hartuar plan-ditarët në përputhje me orarin mësimor, duke bërë që dokumentacioni të mos jetë i plotë.

Për sa më sipër janë lënë këto rekomandime:

- Plan-ditarët të hartohen çdo ditë, për çdo orë mësimore, dhe në përputhje të plotë me orarin mësimor.

- Plan-ditarët të hartohen në vetën e parë, sipas formatit zyrtar të dokumentacionit shkollor.
- Të shmangen korrigjimet e datave në ditar; në rast gabimi, dokumenti duhet ribërë sipas rregullores.
- Në çdo ditar të vendoset qartë viti shkollor.
- Të zbatohet plotësisht struktura e detyrueshme e ditarit për të gjitha orët. Rubrika "Temat e kaluar" të plotësohet rregullisht dhe në mënyrë të saktë.
- Të merren masa për zbatimin e rregullave të dokumentacionit, referuar Udhëzimit nr. 31, datë 30.08.2018.

Afati për përmbushjen e rekomandimeve: jo më shumë se 5 ditë mësimore.

Nga auditimi konstatohet se, pavarësisht koherencës së mirë ndërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve, konstatohet se raporti paraqet disa mangësi në aspektin e plotësisë dhe forcës analitike. Konkretisht, gjetjet janë të formuluara në mënyrë përgjithësuese ("në disa ditarë", "në një pjesë"), pa specifikuar shtrirjen reale të problemit (numër, përqindje apo raste konkrete), çka e bën të vështirë vlerësimin e nivelit të riskut dhe rëndësisë së problematikave të evidentuara.

Gjithashtu, rekomandimet, ndonëse të qarta, janë të natyrës kryesisht korrigjuese dhe nuk adresojnë shkaqet rrënjësore të problematikave (p.sh. mungesë kontrolli nga drejtuesit, nevojë për trajnim apo mbikëqyrje e pamjaftueshme).

Ngarkohen me përgjegjësi grupet e inspektimit dhe grupet e monitorimit sipas rasteve ku janë evidentuar problematika në këtë material.

2.5 Mbi vlerësimin e funksionimin të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar.

2.5.1 Mbi vlerësimin e funksionimin të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku u konstatua se:

Raportet e monitorimit:

Nga ana e institucionit Udhëzimin nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitet objekt auditimi 2022; 2023; 2024 në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Për periudhën objekt auditimi, institucioni DRAP Durrës, në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022 - 2024; 2023 - 2025 dhe 2024 - 2026.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues:

Me shkresën nr.3347, datë 12.05.2022, urdhër nr.256, datë 12.05.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorië Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës z. H.L. Për vitin 2022, nuk u vendos në dispozicion shkresa nëpërmjet të cilës caktohet Nëpunësi Zbatues i institucionit.

Me shkresën nr.226 Prot., datë 24.01.2023 me lëndë "Për caktimin e Z.B.Sh nëpunës zbatues", drejtuar Degës së Thesarit dhe nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike është caktuar z.B.Sh. Nëpunës Zbatues në DRAP Durrës.

Koordinatori i riskut

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 1, rezulton se detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën e Titullarit të Njësisë Publike.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësisa publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.

Referuar Manualit të MFK, në nenin 19, kreu III "Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit" citohet se: "*Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin: 1. Mjedisi i kontrollit. 2. Menaxhimi i riskut. 3. Veprimtaritë e kontrollit. 4. Informacioni dhe komunikimi. 5. Monitorimi.*

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni DRAP Durrës bazohet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*" si dhe në Kodin e Etikës dhe Sjelljes, i cili është pjesë përbërëse e Rregullores së Brendshme të DRAP Durrës Nr.33 Prot, datë 29.05.2019, miratuar nga Titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Struktura organizative

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës organizohet në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.68, datë 05.04.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar".

Sipas Urdhërit nr.68, struktura dhe organika e institucionit DRAP Durrës, do të jetë 15 punonjës në total, më konkretisht:

- **1 (një)** pozicion pune Drejtor i DRAP Durrës + **1 (një)** pozicion pune sekretar i Drejtorit;
- **4 (katër)** pozicione pune në Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimi Profesional; nga këto 1(një) përgjegjës sektori + 3 (tre) specialistë;
- **4 (katër)** pozicione pune në Sektorin e Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë; nga këto 1(një) përgjegjës sektori + 3(tre) specialistë;
- **5 (pesë)** pozicione pune në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Statistikës; nga këto 1(një) përgjegjës sektori + 1 (një) specialist për burimet njerëzore + 1 (një) specialist për investimet dhe infrastrukturën + 1(një) specialist për financën dhe buxhetin + 1 (një) specialist statistike.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe të Sportit nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*". Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, me shkresën Nr.33 Prot., datë 29.05.2019 miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, ka hartuar Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e DRAP Durrës". Kjo rregullore përmban të dhëna mbi qëllimin, statusin, misionin dhe

veprimtarinë, parimet kryesore të institucionit, organizimin, rekrutimin, vlerësimin, etikën, dhe largimin nga detyra të punonjësve të DRAP dhe ZVAP, përgjegjësitë dhe detyrat e DRAP Durrës, funksionimi dhe organizimi i punës, detyrat e sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve, detyrat e sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, detyrat e sektorit të inspektimit dhe i vlerësimit të cilësisë, sekretari i drejtorit, përgjegjësit e sektorëve, detyrat e specialistit, marrëdhëniet e punës dhe shërbime të tjera, etika, rregulla për mirëmbajtjen dhe sigurinë në ambientet e institucionit si dhe raportimi në institucionet eprore dhe rregulla mbi faqen zyrtare dhe publikimin e të dhënave.

Planet vjetore dhe mujore të punës

Referuar Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a) "*Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*", miratuar nga Titullari i Njësisë Publike, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, ka miratuar disa plane vjetore dhe mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të përcaktuara sipas programeve, më konkretisht;

- Me shkresën nr.391 Prot., datë 01.02.2024 është miratuar nga Titullari i institucionit plani mujor për muajin shkurt për Sektorin e Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë;
- Me shkresën nr.393 Prot., datë 01.02.2024 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani mujor i muajit shkurt për SBNJSHS;
- Me shkresën Nr.3 Prot., datë 04.01.2023 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani mujor i muajit janar 2023 për SBNJSHS;
- Me shkresën Nr.3/1 Prot., datë 04.01.2023 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani vjetor i vitit 2023 për SBNJSHS;
- Me shkresën Nr.1 Prot., datë 04.01.2023 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani mujor i muajit janar 2023 për Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional;
- Me shkresën Nr.2 Prot., datë 04.01.2023 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani mujor i muajit janar 2023 për Sektorin e Inspektimit dhe të Cilësisë;
- Me shkresën Nr.43 Prot., datë 05.01.2024 është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani vjetor i vitit 2024 për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e DRAP Durrës nuk është vënë në dispozicion një plan veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, veprim jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, të cilat duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve, si dhe situatë që rezulton në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në anekset 5, 6 dhe 7 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore

Politikat e burimeve njerëzore lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë, ndër të tjera, një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve, kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale, një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave, vlerësimin e performancës, si dhe zhvillimin e miratimin e politikave,

rregullave dhe procedurave të zbatueshme, në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin dhe motivimin e stafit.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Procedurat e rekrutimit duhet të përfshijnë të gjitha aktivitetet e ndryshme si: publikimet në faqet zyrtare të AKAP/DRAP të vendeve vakante, ndjekjen e procedurave të parashikuara në shkresën Nr. 8488/1, datë 13.09.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Urdhër Nr. 454, datë 13.09.2019 "*Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj*"; Ligjin Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë si dhe Rregulloren "*Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" e miratuar me Urdhrin Nr. 153 datë 17.04.2025, në të cilën nuk përcaktohen kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët mbi punësimin në DRAP.

Duke qenë se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës është institucion i varur në hierarki nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të DRAP Durrës bëhet nga ky institucion (AKAP).

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 9, pika 4, gërma dh), nga auditimi rezultoi se nuk janë realizuar plane vjetore trajnimesh për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës.

<u>Komponenti "Vlerësimi i Riskut"</u>

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura.

Regjistri i riskut

Nga ana e institucionit nuk janë vendosur në dispozicion Regjistri i Riskut për vitet 2022-2024, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 21, pika 1 ku parashikohet se "*Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes",* dhe pika 2 ku parashikohet se *"*2. ….*Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit "* dhe Udhëzimi 16, datë 20.07.2016 Kreu 4, pika 2 ku parashikohet se "*Regjistri vjetor i risqeve duhet të hartohet deri në fund të muajit shkurt nga çdo njësi publike, duke marrë në konsideratë objektivat e njësisë publike dhe planet operacionale të punës së çdo strukture të miratuara me buxhetin vjetor. Gjatë vitit, në rast se ka ndryshime në objektiva duhet të rishikohet dhe regjistri i risqeve*".

Grupi i menaxhimit strategjik

Nga ana e institucionit DRAP Durrës, është vendosur në dispozicion shkresa Nr.1275/1 Prot., datë 23.05.2022 Urdhër "Për një ndryshim në Grupin e Menaxhimit Strategjik" për vitin 2022.

Për vitet 2022 – 2024, Titullari nuk ka urdhëruar ngritjen së Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe për pasojë mungojnë dhe procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje

me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27; jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; si dhe Udhëzimin Nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4.

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut

Nga ana e institucionit Me shkresën Nr.1776/1 Prot., datë 29.10.2020 është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës për vitin 2020-2022 dhe nuk është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut për vitet 2023-2024, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21, pika 2 në të cilin parashikohet se "2. *Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit*". Nga ana e institucionit është miratuar rregullorja e menaxhimit të riskut të DRAP Durrës.

<u>Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"</u>

Ndarja e detyrave:

Në Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", në nenin 7 parashikohet struktura përbërëse nga këto kategori punonjësish: DRAP Durrës ka në përbërje të saj: Drejtor; Sekretar; Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional; Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë; Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Statistikës.

Nga auditimi u konstatua se, janë firmosur përshkrimet individuale të punës të cilat përmbajnë të dhëna specifike mbi detyrat kryesore si dhe detyrat teknike, menaxhimi, përfaqësimi institucional dhe planifikimin dhe objektivat mbi pozicionin e punës. Këto dokumente janë të firmosura , sipas rastit, nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit si dhe nga eprori direkt Drejtori i Përgjithshëm i DPAP (AKAP), më konkretisht;

-Me shkresën Nr.241/1 prot., datë 17.07.2019; Me shkresën Nr.74/1 Prot., datë 10.06.2019; Me shkresën Nr.33/2 Prot., datë 29.05.2019; Me shkresën Nr.33/3 Prot., datë 29.05.2019; Me shkresën Nr.75/1 Prot., datë 10.06.2019; Me shkresën Nr.33/6 Prot., datë 29.05.2019; Me shkresën Nr.6/1 Prot., datë 08.01.2019; Me shkresën Nr.819/6 Prot., datë 29.06.2020; Me shkresën Nr.370 Prot., datë 27.02.2020; Me shkresën Nr.185/2 Prot., datë 13.01.2021.

Gjurma e auditimit

Nga ana e institucionit Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës nuk janë përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3, neni 4, pika 19 e këtij Ligji, si dhe jo në përputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për periudhën objekt auditimi DRAP Durrës, nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, në

kundërshtim me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhërit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" në të cilin përcaktohet përgjegjësia e Nëpunësit Zbatues të Njësisë Publike "*NZ është përgjegjës dhe jep llogari para NA për: g)"dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe transaksioneve të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të njësisë*".

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë.
Punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Komunikimet nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).
Nga auditimi konstatohet se, sa i përket parimit të transparencës së institucioneve publike, faqja zyrtare, jo në të gjitha rastet përditësohet me të dhënat që duhet të jenë të aksesueshme, referuar të drejtës së informimit, me informacion i cili duhet të jetë i aksesueshëm lidhur me veprimtarinë e institucionit.

Komponenti "Monitorimi"

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm

Në bazë të Ligjit Nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar në nenin 10, pika 1, gërma "b", si dhe si dhe VKM Nr.83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve ë krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 5, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jenë audituar mbi veprimtarinë që kryen nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.
Për periudhën objekt auditimi, me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar për auditim tematik nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.
Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH.

Vetëvlerësimi

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse Deklaratat dhe Raportin Vjetor, së bashku me Pyetësorin e Vetëvlerësimit, konkretisht, si më poshtë:

Për vitin 2022:

- Në përgjigje të shkresës Nr.8227/1 Prot., datë 10.01.2023 të Ministrisë e Arsimit dhe Sportit, protokolluar në DRAP Durrës me Nr.124 Prot., 13.01.2023, me shkresën Nr.124/1 Prot.,

datë 31.01.2023 drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, është dërguar Raporti për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm,

- Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm.
- Është plotësuar Pyetësori i Vetëvlerësimit datë 31.01.2023.

Për vitin 2023:

- Me shkresën Nr.269/1 prot., datë 22.01.2024 të firmosur nga Nëpunësi Autorizues i Njësisë Publike është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit, Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm për DRAP Durrës.
- Me shkresën Nr.269 Prot., datë 22.01.2024 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm të DRAP Durrës, nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues dhe Raporti për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.
- Për vitin 2023 është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit i plotësuar në datë 31.01.2024.

Për vitin 2024:

- Nëpërmjet shkresës Nr. 154/1 Prot, datë 14.01.2025 nga ana e DRAP Durrës është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit;
- Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm , Raporti për funksionimin e Kontrollit të Brendshëm, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike të DRAP Durrës.
- Pyetësori i vetëvlerësimit është plotësuar më datë 31.01.2025.

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Sa i përket inventarizimit të aktiveve të institucionit, u konstatua se ka të dhëna mbi vlerën fizike të aktiveve referuar Udhëzimit Nr.30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, është bërë inventarizimi i aseteve të institucionit, konkretisht:

Për vitin 2022: Me shkresën Urdhër i Brendshëm Nr.138 Prot., datë 27.12.2022, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike është urdhëruar "Ngritja e komisionit të inventarizimit te aktiveve afatgjata materiale në DRAP Durrës për vitin 2022". Ky komision është i përbërë me anëtarët: 1.E.B 2.O.T 3.V.K.

Për vitin 2023: Me shkresën Nr.2656 Prot., datë 26.12.2023 Urdhër Nr.146, datë 26.12.2023 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve". Ky komision ka në përbërje anëtarët:1.R.B**;**2.Xh.T 3.A.T.

Për vitin 2024: Me shkresën Nr.3246 Prot., datë 30.12.2024 Urdhër Nr.98, datë 30.12.2024 të Titullarit të Njësisë Publike "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit fizik të aktiveve" është urdhëruar inventarizimi i njësisë, për vitin 2024. Ky komision ka në përbërje anëtarët: 1.A.V 2.Xh. V 3.E. V.

Inventarët janë të hartuar dhe të nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nga Komisioni i Vlerësimit

Referuar Udhëzimit Nr.30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, pika 104 dhe 105, për vitet 2022-2024, nuk u paraqit dokumentacion mbi procesverbalet e vlerësimit nga komisioni i inventarizimit.

Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike z.H.L dhe Nëpunësi Zbatues Z.B.Sh.

2.5.2 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Përgjatë periudhës se auditimit në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, rezulton, si më poshtë:

Me shkresën Nr.6050/4 Prot., datë 19.11.2024 Urdhër Nr.572, datë 19.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, është emëruar znj.B.S., në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë është vënë në dispozicion shkresa Nr.22 Prot., datë 09.01.2025 nëpërmjet të cilës Titullari i Njësisë Publike ka caktuar Nëpunësin Zbatues të institucionit, z.K.F.

Raportet e monitorimit:

Nga ana e institucionit, bazuar në Udhëzimin.Nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit të buxhetit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitin 2025, në Ministrinë e Arsimit, konkretisht:

- Me shkresën Nr.98 Prot., datë 14.01.2026 është dërguar raporti i monitorimit 12 mujor, brenda afatit të parashikuar në Udhëzimin Nr.14;
- Me shkresën Nr.1439 Prot., datë 19.09.2025 është dërguar raport i monitorimit 8 mujor,;
- Me shkresën Nr.802 Prot., datë 18.06.2025 është dërguar raporti i monitorimit 4 mujor jashtë afatit të parashikuar.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar është krijuar në fund të vitit 2024, bazuar në Urdhërin e Kryeministrit Nr.144 Prot., datë 01.08.2024 "Për miratimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë Kombëtare dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar". Duke qenë se DRAP Tiranë është institucion i ri, i krijuar së fundmi, për vitin 2025 nuk kanë arritur të dërgojnë në afat PBA-të e vitit 2025-2027. Referuar buxhetit të vitit 2025, me shkresën Nr.8208/3 Prot, datë 24.01.2025, Ministria e Arsimit ka dërguar fondet e miratuara të buxhetit për shpenzimet korrente për këtë institucion.

Koordinatori i riskut

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 1, rezulton se detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën dhe përgjegjshmërinë e Titullarit të Njësisë Publike.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësisa publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë bazohet në Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".

Struktura organizative

Me shkresën protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar Nr.2558 Prot., datë 05.08.2024, Urdhër i Kryeministrit Nr.144 Prot., datë 01.08.2024, është miratuar struktura dhe organika e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Bazuar në këtë Urdhër, struktura dhe organika e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë do të ketë në përbërje 23 punonjës në total, konkretisht:

- Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, 1 pozicion pune;

- Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës, 10 pozicione pune, nga ku; 1 drejtor drejtorie, 3 pozicione pune në Sektorin e Monitorimit, Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga të cilët 1 përgjegjës sektori + 2 specialistë; 3 pozicione pune në Sektorin e Inspektimit në Arsimin Parashkollor, nga të cilët 1 përgjegjës sektori + 2 specialistë dhe 3 pozicione pune në Sektorin e Inspektimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë, nga të cilët 1 përgjegjës sektori + 2 specialistë.
- Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare, 5 pozicione pune, nga ku 1 përgjegjës sektori + 1 specialist për burimet njerëzore + 2 specialistë për buxhetin dhe investimet dhe 1 specialist jurist;
- Sektori i Statistikës, 3 pozicione pune, nga ku 1 përgjegjës sektori + 2 specialistë; dhe
- Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, 4 pozicione pune, nga ku 1 specialist arkivë/protokoll + 1 sekretar + 1 shofer + 1 punonjës sanitar.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë bazohet në Ligjin Nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhër i Ministrisë e Arsimit dhe Sportit Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" si dhe në Rregulloren e Brendshme Nr.603/1 Prot., datë 14.05.2025 "*Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë*", miratuar nga Titullari i Njësisë Publike.

Në Rregulloren e Brendshme të Drap Tiranë parashikohen të dhëna mbi qëllimin, përgjegjësitë funksionale të DRAP Tiranë, struktura, detyrat, përshkrimi i punës për Drejtorinë e DRAP Tiranë, detyrat kryesore të Drejtorisë të Inspektimit dhe Kurrikulës, përshkrimi i punës për drejtorin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës, detyrat kryesore të Sektorit të Monitorimit dhe Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, përshkrimi i punës së përgjegjësit të sektorit, përshkrimi i punës së specialistit të Monitorimit, Vlerësimit dhe Zhvillimit Profesional, detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit në Arsimin Parashkollor, përshkrimi i punës së përgjegjësit të Sektorit të Inspektimit të Arsimit Parashkollor, përshkrimi i punës së specialistit të Sektorit të Inspektimit të Arsimit Parashkollor, detyrat kryesore të sektori i Inspektimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë, përshkrimi i punës së përgjegjësit të këtij sektori, përshkrimi i punës së specialistit në këtë sektor, detyrat kryesore të Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare, përshkrimi i punës së përgjegjësit të sektorit, përshkrimi i punës së specialistit të burimeve njerëzore, përshkrimi i punës së specialistit të buxhetit, përshkrimi i punës së specialistit të investimeve, përshkrimi i punës së specialist jurist, detyrat kryesore të Sektorit të Statistikave, përshkrimi i punës së përgjegjësit të këtij sektori, përshkrimi i punës së specialistit të statistikave, detyrat kryesore të sektorit të shërbimeve mbështetëse, përshkrimi i punës së specialist/arkivist/protokollist, përshkrimi i punës së sekretarit, përshkrimi i punës për shoferin dhe punonjësen e pastrimit.

Planet vjetore të punës

Referuar Urdhrit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), për vitin objekt auditimi, me shkresën Nr.16 Prot., datë 08.01.2025, Titullari i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka miratuar planin vjetor të punës për vitin 2025, për sektorin e Statistikës, lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve.

Nga auditimi konstatohet se, nga ana e DRAP Tiranë nuk është vënë në dispozicion një plan veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plan për menaxhimin e risqeve të

nivelit të mesëm dhe të lartë, veprim jo në përputhje me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, të cilat duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve, si dhe situatë që rezulton në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në anekset 5, 6 dhe 7 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore

Politikat e burimeve njerëzore lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë, ndër të tjera, një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve, kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale, një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave, vlerësimin e performancës, si dhe zhvillimin e miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, dhe motivimin e stafit të punonjësve të institucionit.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Duke qenë se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë është institucion i varur në hierarki nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të DRAP Tiranë kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar. Referuar Udhëzimit Nr.454, datë 13.09.2019, neni 4, pika 2 parashikon se "*2. Pranimi dhe lirimi nga detyra e punonjësve bëhet përmes konkurrimit të hapur dhe mbështetet pa u kufizuar në parimet e mëposhtme: ç) parimin e transparencës*;…."

Lidhur me punësimet e punonjësve të institucioneve në varësi të AKAP, nuk paraqitet informacion mbi publikimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët mbi konkurrimin për pozicionin përkatës, në shpalljen e vendit vakant.

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 9, pika 4, gërma dh), nga auditimi rezultoi se nuk janë realizuar plane vjetore trajnimesh për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Komponenti "Vlerësimi i Riskut"

Vendosja e objektivave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, i përcaktuar në Ligjin Nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Regjistri i riskut

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë është plotësuar Regjistri i Riskut për vitin 2025, në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21 pika 1, si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Grupi i menaxhimit strategjik

Nga ana e Titullarit të DRAP Tiranë nuk është urdhëruar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe si pasojë mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni

8, pika 8, gërma "b", neni 27, gjithashtu jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; si dhe jo në përputhje me Udhëzimin Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*"

Strategjia e Menaxhimit të Riskut

Nga ana e institucionit nuk është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, veprime jo e përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2.

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Struktura e DRAP Tiranë ka në përbërje të saj Titullarin; punonjës të Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës, punonjës të Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare, punonjës të Sektorit të Statistikës dhe punonjës të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

Referuar Rregullores së Brendshme të DRAP Tiranë, në të parashikohen detyrat dhe përshkrimi i punës së; Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tij; detyrat kryesore të Drejtorisë së Inspektimit dhe Kurrikulës, si dhe elementët specifikë të përshkrimit individual të pozicionit të punës; detyrat kryesore të Sektorit të Monitorimit, Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional dhe elemente specifikë të përshkrimeve individuale të punës mbi pozicionin e përgjegjësit të sektorit dhe specialistit në këtë sektor; detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit në Arsimin Parashkollor, si dhe elementë specifikë të përshkrimit individual të pozicionit të punës për përgjegjësin e sektorit dhe specialistët; detyrat kryesore të Sektorit të Inspektimit për Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë si dhe elemente specifikë mbi përshkrimet individuale të punës në pozicionin e përgjegjësit dhe të specialistëve në këtë sektor; detyrat kryesore të Sektorit të Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Financiare si dhe përshkrimet individualë me element specifikë mbi pozicionet e punës për përgjegjësin e sektorit, specialistin e burimeve njerëzore, specialistin e buxhetit, specialistin e investimeve, specialistin jurist; detyrat kryesore të Sektorit të Statistikave dhe elementet specifikë mbi përshkrimin e punës për përgjegjësin e sektorit dhe specialistit; detyrat e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse si dhe përshkrimi i punës për pozicionin specialist arkivist/protokollist, sekretar, shofer, punonjës sanitar.

Këto përshkrime individuale të punës, të nënshkruara nga punonjësit respektivë, administrohen në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, si institucion epror i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Gjurma e auditimit

Nga ana e institucionit DRAP Tiranë nuk janë përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3, neni 4, pika 19 e këtij Ligji, si dhe jo në përputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për periudhën objekt auditimi DRAP Tiranë, duke qenë se është një institucion i krijuar rishtazi, nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, në kundërshtim me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhërit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" në të cilin

përcaktohet përgjegjësia e Nëpunësit Zbatues të Njësisë Publike "*NZ është përgjegjës dhe jep llogari para NA për: g)"dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe transaksioneve të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të njësisë*".

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Këto komunikime nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Sa i përket faqes zyrtare, referuar Urdhërit Nr.153, datë 17.04.2025, neni 26, institucioni ka faqen e tij zyrtare elektronike, në të cilën duhet të publikojë të dhëna mbi veprimtarinë e tij, të dhëna mbi arsimin parauniversitar, të dhëna mbi provimet kombëtare dhe ndërkombëtare, vendet vakante të institucioneve në varësi, të dhëna mbi listat e mësuesve që konkurrojnë në Portalin "Mësues për Shqipërinë" etj.

Nga auditimi konstatohet se, sa i përket parimit të transparencës së institucioneve publike, faqja zyrtare, jo në të gjitha rastet përditësohet me të dhënat që duhet të jenë të aksesueshme, referuar të drejtës së informimit, lidhur me veprimtarinë e institucionit.

Komponenti "Monitorimi"

Auditimi i brendshëm

Në bazë të Ligjit Nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar në nenin 10, pika 1, gërma "b", si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" , Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë, për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jenë audituar mbi veprimtarinë që kryen nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.

Vetëvlerësimi

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit, konkretisht, si më poshtë:

Për vitin 2025:

- Me shkresën Nr.389/1 Prot., datë 25.02.2026 nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar është dërguar dokumentacion në Ministrinë e Arsimit mbi Regjistrin e Riskut për DRAP Tiranë.
- Me shkresën Nr.389 Prot, datë 25.02.2026 nga ana e DRAP Tiranë është plotësuar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të DRAP Tiranë, për vitin 2025 e nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues i Njësisë Publike. Është dërguar Raporti për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë DRAP Tiranë, nënshkruar nga Nëpunësi Autorizues i Njësisë Publike, për vitin 2025.
- Nga ana e DRAP Tiranë, më datë 25.02.2026 është plotësuar nga Titullari i Njësisë Publike Pyetësori i Vetëvlerësimit, për vitin 2025.

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Për vitin 2025:

Sa i përket inventarizimit të aktiveve të institucionit, u konstatua se ka të dhëna mbi vlerën fizike të aktiveve në përputhje me Udhëzimin Nr.30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, nga Titullari i Njësisë Publike, me shkresën Nr.2048 Prot., datë 29.12.2025 Urdhër Nr.119, datë 29.12.2025 është ngritur Komisioni i Inventarizimit "Për inventarizimin e materialeve të magazinës në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë". Ky komision ka në përbërje anëtarët: M.K; E.F; E.E; A.S; Z.H. Referuar Udhëzimit Nr.30,

datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik*" neni 104 dhe 105 në të cilin parashikohet se "*Procesverbali i vlerësimit 104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: a) nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë…; 105. Procesverbali hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit…*" Komisioni i Inventarizimit me shkresën Nr.2048/1 Prot., datë 29.12.2025 ka mbajtur procesverbal për inventarizimin e aktiveve të njësisë i firmosur nga anëtarët e komisionit dhe nga magazinieri.

Me shkresën protokolluar në KLSH me Nr.10/12prot., datë 20.07.2026 dhe në DRAP Tiranë me Nr.1222 Prot., datë 17.07.2026 janë dërguar komente dhe shpjegime mbi projektraportin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: Lidhur me konstatimin e projekt raportit mbi publikimin e njoftimeve zyrtare sqarojmë se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka respektuar detyrimet ligjore që lidhen me transparencën institucionale dhe të drejtën e informimit të publikut.

Në përputhje me ligjin Nr,119/2014"Për të drejtën e informimit", Ligjin Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar, DRAP Tiranë ka publikuar në mënyrë të vazhdueshme njoftimet zyrtare që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë së institucionit.

Konkretisht janë bërë publike njoftimet për publikimin e vendeve vakante, procedurat e konkurrimit dhe emërimit në pozicionet drejtuese të institucioneve arsimore, procedurat e rekrutimit të personelit, shpallet për konkurrim, njoftimet me karakter administrative, si dhe cdo informacion tjeter për të cilën legjislacioni në fuqi parashikon detyrimin e publikimit.

Publikimi i këtyre njoftimeve është kryer me qëllim garantimin e parimeve të transparencës, ligjshmërisë, barazisë së mundësive, dhe aksesit të publikut n informacion, duke respektuar kërkesat e programit të transparencës së institucionit dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Nga dokumentacioni administrativ rezulton se DRAP Tiranë ka administruar dhe publikuar aktet dhe njoftimet për të cilat ekzistonte detyrimi ligjor i publikimit, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e institucionit.

Për sa më sipër, vlerësojmë se DRAP Tiranë ka përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me publikimin e njoftimeve zyrtare dhe garantimin e transparencës institucionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Megjithëse institucioni vlerëson se procedura është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të marrë në konsideratë rekomandimin për përmirësimin e praktikave administrative.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar observacionit të subjektit sqarojmë se në konstatimin e grupit të auditimit i referohemi, ndër të tjera, publikimit të vendeve vakante, raporteve të monitorimit të buxhetit, si dhe cdo dokument administrativ për të cilin ligji parashikon detyrimin për publikim, referuar të drejtës së informimit. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë

Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike znj.B.S dhe Nëpunësi Zbatues z. K.F.

2.5.3 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë

ZVAP Vorë, ka dërguar në Ministrinë e Arsmit dhe Sportit raportet e monitorimit 4 mujore, 8 mujore dhe 12 mujore, për vitet objekt auditimi. Për periudhën objekt auditimi, institucioni ZVAP Vorë, në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022-2024; 2023-2025; 2024 -2026 dhe 2025-2027.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Me shkresën Nr.288 Prot., datë 15.05.2019 me Urdhër Nr.232, datë 15.05.2019 nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPAP "Për emërim të përkohshëm në detyrë" është emëruar Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë znj.M.L.
Me shkresën Nr.289 Prot., datë 15.05.2019, protokolluar në ZVAP Vorë Nr.02, datë 20.05.2019, Urdhër Nr.233, datë 15.05.2019 për "Emërim të përkohshëm në detyrë të z. H.H në pozicionin specialist finance në ZVAP Vorë.

Koordinatori i riskut

Bazuar në Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën dhe përgjegjësinë e Titullarit të Njësisë Publike, si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" për periudhën përkatëse në fuqi.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.
Njësia publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.
Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatua se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë bazohet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*"

Struktura organizative

Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin Nr. 571, datë 18.11.2024, Nr.6717/4 Prot., datë 18.11.2024 miratoi strukturën dhe organikën e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar sipas të cilës ka në strukturë 5 punonjës:

- 1 pozicion pune Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë
- 2 pozicione pune në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, përkatësisht një specialist jurist dhe një specialist i financës; si dhe
- 2 pozicione pune specialist në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*".
Referuar Rregullores së Brendshme "*Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*", në Kreun IV të rregullores parashikohet veprimtaria e ZVAP lidhur me organizimin e punës, detyrat e drejtorit, detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, detyrat kryesore të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional si dhe raportimi që bën institucioni në institucionet eprore si DRAP, AKAP dhe Ministrinë e Arsimit mbi veprimtarinë e tij.

Planet vjetore dhe mujore të punës

Referuar Urdhrit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), nga sektorët përgjegjës janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, më konkretisht:

- Për vitin 2022, me shkresën 398/8 Prot., datë 15.02.2022 është miratuar Plani Vjetor i Punës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, miratuar nga Titullari i Njësisë Publike si dhe grupi i punës për realizimin e planit vjetor, i cili përmban të dhëna mbi detyrat dhe përgjegjësitë e ZVAP Vorë, organizimi i ZVAP dhe sektorëve përkatës, vizioni, synimet, objektivat, veprimtarinë e sektorit dhe buxheti mbi parashikimin e regjistrit të prokurimeve publike;
- Për vitin 2023 – 2024, me shkresën Nr.576 Prot., datë 01.09.2023 është miratuar Matrica e Përmbajtjes së Veprimtarive Vjetore 2023 – 2024, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike;
- Për vitin 2024 – 2025, me shkresën Nr.428 Prot., datë 28.08.2024 është miratuar Plani Vjetor i Punës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, miratuar nga Titullari i Njësisë Publike si dhe grupi i punës për realizimin e planit vjetor, i cili përmban të dhëna mbi detyrat dhe përgjegjësitë e ZVAP Vorë, organizimi i ZVAP dhe sektorëve përkatës, vizioni, synimet, objektivat, veprimtarinë e sektorit dhe buxheti mbi parashikimin e regjistrit të prokurimeve publike;
- Për vitin 2025, me shkresën Nr.526 Prot., datë 28.08.2025 është miratuar Matrica e Përmbajtjes së Veprimtarive Vjetore 2025, miratuar nga Titullari i Njësisë Publike;
- Me shkresën Nr.2/1 prot., datë 06.01.2025 është hartuar Plani Vjetor Individual i Punës nga specialisti i SMKZHP dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike;
- Me shkresën Nr.3/3 Prot., datë 05.01.2022, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike është plotësuar plani i punës për muajin janar 2022;
- Me shkresën Nr.78 Prot., datë 02.02.2022, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike është plotësuar plani i punës për muajin shkurt 2022;
- Me shkresën Nr.629 Prot., datë 25.09.2024, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike është plotësuar plani i punës për muajin shtator 2024;
- Me shkresën Nr.2 Prot., datë 06.01.2025, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike është plotësuar plani i punës për muajin janar 2025;
- Me shkresën Nr.821 Prot., datë 03.12.2025, hartuar nga përgjegjësi i sektorit të shërbimeve dhe miratuar nga Titullari i Njësisë Publike është plotësuar plani i punës mujor 2025.

Nga auditimi konstatohet se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë, nuk është miratuar një Plan Veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, në mospërputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 2, si dhe me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 4, datë 26.01.2024.

Trajnimi i punonjësve:

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 9, pika 4, gërma dh), nga ana e ZVAP Vorë janë hartuar plane vjetore trajnimesh dhe kualifikimesh lidhur me veprimtarinë trajnuese që punonjësit e institucionit kryejnë në institucionet arsimore dhe projekte të ndryshme jashtëshkollore.

Për vitet 2022-2025 nuk rezulton që të jenë kryer trajnime të punonjësve të institucionit si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Duke qenë se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë është institucion i varur në hierarki nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të ZVAP Vorë bëhet nga ky institucion (AKAP).

Komponenti "Vlerësimi i Riskut"

Vendosja e objektivave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, i përcaktuar në Ligjin Nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i administratës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë është i përcaktuar në Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" në KREU-n IV, në nenin 27 në të cilën parashikohet se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor*.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Nga ana e Titullarit të ZVAP Vorë, nuk është urdhëruar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe si pasojë mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27; si dhe jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4 dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" për vitin 2025.

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësie publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Strategjia e menaxhimit të riskut

Nga ana e institucionit nuk është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, veprime jo ë përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2.

Regjistri i riskut

Për periudhën objekt auditimi, nga ana e institucionit është hartuar Regjistri i Riskut, veprime në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21 pika 1, më konkretisht është hartuar Regjistri i Riskut për vitin 2022, 2023, 2024, 2025 miratuar nga Titullari i Njësisë Publike.

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Në Urdhrin Nr.153, datë 17.04.2025 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar neni 37 parashikon organizimin e punës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar e cila përbëhet nga këto kategori punonjësish; punonjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, detyrat e të cilëve

përcaktohen në nenin 32 të Rregullores dhe punonjës të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional detyrat e të cilëve përcaktohen në nenin 33 të Rregullores.
Me shkresën Nr.10/10 Prot., datë 23.01.2026 nga ana e Titullarit të Njësisë Publike është dërguar dokumentacion për miratim të përshkrimeve të punës në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, konkretisht për shkresat:
- Me shkresën Nr.10/8 Prot., datë 23.01.2025 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën Nr.10/9 Prot., datë 23.01.2025 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën Nr.10/7 Prot., datë 23.01.2025 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën Nr.10/6 Prot., datë 23.01.2025 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
Për vitin 2019 dhe 1 përshkrim i vitit 2022 më konkretisht:
-Me shkresën datë 10.10.2019 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës specialist në Sektorin e Shërbimeve mbështetëse, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti, përgjegjësi i sektorit dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën datë 11.10.2019 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës specialist në sektorin e kurrikulës dhe zhvillimit profesional, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti, përgjegjësi i sektorit dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën datë 11.10.2019 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës jurist, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti dhe Drejtori i ZVAP Vorë.
-Me shkresën Nr.57/1, datë 25.01.2022 e cila përmban të dhëna mbi pozicionin e punës specialist në Sektorin e Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, misionit, detyrat kryesore, planifikimi mbi objektivat, menaxhimi, detyrat teknike,, mbikëqyrja, kushtet e punës, kërkesat e posaçme. Këto përshkrime janë të firmosura nga specialisti, përgjegjësi i sektorit dhe Drejtori i ZVAP Vorë.

Gjurma e auditimit

Nga ana e institucionit Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë janë hartuar për vitin 2022, gjurma e auditit e menaxhimit të aktiveve, me shkresën Nr.12/2 Prot., datë 10.01.2022 dhe me shkresën Nr.12 Prot., datë 10.01.2022 është hartuar gjurma e auditit e zbatimit të buxhetit.
Për vitet 2023-2025 nuk u paraqit informacion mbi gjurmën e auditimit për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, referuar me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3 dhe jo në përputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe

Kontrollit. Për periudhën objekt auditimi ZVAP Vorë nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, në kundërshtim me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 "Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" në të cilin përcaktohet "*dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe transaksioneve te tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të njësisë*".

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Referuar pyetësorit të vetëvlerësimit, komunikimet nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Nga auditimi u konstatua, jo në të gjitha rastet faqja zyrtare përditësohet me të dhëna që duhet të jenë të aksesueshme, referuar parimit të transparencës së institucioneve publike.

Komponenti "Monitorimi"

Auditimi i brendshëm

Bazuar në Ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar në nenin 10, pika 1, gërma "b", Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë, për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jetë audituar mbi veprimtarinë nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.

Në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, për periudhën objekt auditimi, me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.

Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH.

Vetëvlerësimi

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vorë ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit brenda afatit kohor të përcaktuar, përkatësisht:

Për vitin 2022:

- Me shkresën Nr.32/ Prot., datë 30.01.2023 është dërguar informacion mbi Pyetësorin e Vetëvlerësimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- Nga ana e ZVAP Vorë është dërguar Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollin të brendshëm të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- Është dërguar Raporti Vjetor i Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Për vitin 2023:

- Me shkresën Nr.40 Prot., datë 12.01.2024 është dërguar informacion mbi Pyetësorin e Vetëvlerësimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
- Nga ana e ZVAP Vorë është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- Është dërguar Raporti Vjetor i Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për ZVA Vorë.

Për vitin 2024:

- Me shkresën Nr.32 Prot., datë 06.01.2025 është dërguar informacion mbi Pyetësorin e Vetëvlerësimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.
- Me shkresën Nr.32/1 Prot., datë 06.01.2025 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- Nga ana e ZVAP Vorë është dërguar Raporti vjetor i Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

Për vitin 2025:

- Me shkresën Nr.11 prot., datë 09.01.2026 është dërguar informacion mbi Pyetësorin e Vetëvlerësimit në Ministrinë e Arsimit, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.
- Me shkresën Nr.11 Prot., datë 09.01.2026 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë.
- Nga ana e ZVAP Vorë është dërguar Raporti Vjetor i Gjendjes së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për ZVAP Vorë, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Për vitin 2022: Me shkresën Nr.590 Prot., datë 25.12.2022, Urdhër Nr.65/1, datë 25.12.2022 i Titullarit "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve të magazinës së Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë" është ngritur komisioni i inventarizimit, me anëtarë 1.H.H; 2.E.P; 3.E.D. Inventari është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe drejtori i ZVAP Vorë.

Me shkresën Nr.590/1., datë 25.12.2022 Urdhër Nr.65, datë 25.12.2022 të Titullarit të institucionit, është urdhëruar të ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të magazinës së ZVAP Vorë, me anëtarë: 1.E.P 2.E.D 3.O.T 4.H.H.

Për vitin 2023: Me shkresën Nr.605 Prot., datë 25.12.2023, Urdhër Nr.72, datë 25.15.2023 i Titullarit "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve të magazinës së Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë" është ngritur komisioni i inventarizimit, me anëtarë: 1.H.H ; 2.E.P; 3.E.D.

Me shkresën Nr.605/1Prot., datë 25.12.2023 Urdhër Nr.72/1, datë 25.12.2023 miratuar nga Titullari, është urdhëruar të ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të magazinës së ZVAP Vorë, me anëtarë: 1.E.P ; 2.E.D; 3.O. T ; 4.H. H.

Inventari i institucionit është i firmosur nga firmosur nga anëtarët e komisionit dhe drejtori i ZVAP Vorë, konkretisht; 1.Titullari; 2.H.H; 3.E. P ; 4.E. D.

Për vitin 2024: Me shkresën Nr.2 Prot., datë 05.01.2024, Urdhër Nr.1, datë 05.01.2024 i Titullarit "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve të magazinës së Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Vorë" është ngritur komisioni i inventarizimit, me anëtarë: 1.H. H 2.E. P 3.E.D.

Me shkresën Nr.1 Prot., datë 05.01.2024 Urdhër Nr.2, datë 05.01.2024 miratuar nga Titullari, është urdhëruar të ngrihet komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të magazinës së ZVAP Vorë, me anëtarë: 1.E.P ; 2.E.D ; 3.O.T 4.H.H.
Inventarët janë të firmosur nga anëtarët e komisionit dhe Titullari i ZVAP Vorë.
Është mbajtur proces- verbal në datë 30.12.2024, në zbatim të Urdhrit Nr.954, datë 29.12.2023 nëpërmjet të cilit komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të magazinës së ZVAP Vorë, nxori jashtë përdorimit materialet që kanë kaluar afatin e përdorimit nga viti 2007, të ardhura në ZVAP Vorë, në maj të 2019. Ky procesverbal është i nënshkruar nga anëtarët e komisionit dhe Titullari i ZVAP Vorë.
Për vitin 2025: Me shkresën Nr.2 Prot., datë 05.01.2025, Urdhër Nr.1, datë 05.01.2025 të Titullarit të Njësisë Publike "Për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve të magazinës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar", është ngritur komisioni i inventarizimit me anëtarë:1.H.H; 2.E.P ; 3.E.D.
Me shkresën Nr.2 Prot. Datë 05.01.2025, Urdhër Nr.1, datë 05.01.2025 "Për ngritjen e komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të magazinës së ZVAP Vorë, me anëtarë: 1.E.P; 2.E. D; 3.H. H.
Inventarët e zyrave janë nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Titullari i Njësisë Publike.
Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike znj. M.L dhe Nëpunësi Zbatues z.H.H.

2.5.4. Vlerësimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë

Referuar Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku u konstatua se:

Raportet e monitorimit

Nga ana e institucionit ZVAP Tiranë, bazuar në Udhëzimin.Nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit të buxhetit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitet objekt auditimi, në Ministrinë e Arsimit. Për periudhën objekt auditimi, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, në bazë të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, rezulton se ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022 - 2024; 2023 - 2025; 2024 - 2026 dhe 2025 - 2027.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Me shkresën Nr.286 Prot., datë 24.01.2020 Urdhër Nr.13, datë 24.01.2020, është emëruar znj. E. A në detyrën e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Me shkresën Nr.2708/1 Prot., datë 06.09.2024 Urdhër Nr.162, datë 06.09.2024, është emëruar znj. B.S në detyrën e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Me shkresën Nr.4117/1 Prot., datë 08.01.2025 Urdhër Nr.05, datë 08.01.2025, është emëruar znj. E.M në detyrën e Drejtorit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.
Nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë është vënë në dispozicion shkresa Nr.346 Prot., datë 15.05.2019, Urdhër Nr.290, datë 15.05.2019 nëpërmjet të cilit emërohet z. K.F Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, në ZVAP Tiranë.
Me shkresën Nr.9768/1 Prot., datë 31.05.2019 të me lëndë "Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues te përkohshëm për disa Drejtori Arsimore dhe Zyra Vendore Arsimore" caktohet Nëpunës Zbatues i Njësisë Publike z.K.F.

Me shkresën Nr.392 Prot., datë 23.01.2025 "Njoftim mbi Nëpunësin Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues në ZVAP Tiranë" njësia publike ka njoftuar Degën e Thesarit se Nëpunës Autorizues i ZVAP Tiranë do të jetë znj. E.M dhe Nëpunës Zbatues do të jetë z.K.F.

Koordinatori i riskut

Bazuar në Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësinë publike*", deklarohet se institucioni nuk ka delegim të detyrave të koordinatorit të riskut. Bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 1, si dhe Udhëzimit Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*"detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën dhe përgjegjësinë e Titullarit të Njësisë Publike.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësia publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë bazohet në Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".

Struktura organizative

Me shkresën Nr.6717 Prot., datë 18.11.2024, Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.571, datë 18.11.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar" për ZVAP Tiranë rezultojnë 22 punonjës në total, nga ku:

-1 pozicion pune Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë;

-10 pozicione pune në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve nga ku: 1 pozicion pune përgjegjës sektori, 1 pozicion pune specialist, 2 pozicione pune specialist jurist, 1 pozicion pune specialist inxhinier dhe 5 pozicione pune specialist i financës; dhe

-11 pozicione pune në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga ku:
1 pozicion pune përgjegjës sektori dhe 10 pozicione pune specialistë.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e ZVAP Tiranë bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhërin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" si dhe Rregulloren e Brendshme, datë 27.01.2025 "Për organizimin dhe funksionimin e ZVAP Tiranë", miratuar nga Titullari i institucionit. Kjo rregullore e brendshme përmban të dhëna mbi qëllimin, misionin dhe veprimtarinë, organizimin, strukturën, emërimin dhe largimin nga detyra të punonjësve të saj, funksionet dhe detyrat kryesore të ZVAP Tiranë, plane, projekte, planifikime, raportimin në institucionet eprore, vlerësimi, funksionet dhe detyrat e Titullarit, përgjegjësve të sektorit, dhe specialistëve, elementë të përgjithshëm mbi shërbimin psiko-social në institucionet arsimore, komisionet pranë ZVAP Tiranë, elementë mbi të dhënat që duhet të përmbajnë aktet administrative sa i përket hartimit dhe qarkullimit të tyre, administrimit të dokumenteve, elementët e kartelës

shoqëruese të dokumenteve, elementë mbi administrimin e dosjeve të personelit, komunikimi i brendshëm në institucion, etika në punë, rregullat e përdorimit të rrjetit dhe pajisjeve elektronike, përditësimi i faqes zyrtare, rregulla mbi mirëmbajtjen dhe sigurinë në ambientet e institucionit. Nga Titullari i institucionit është miratuar Rregullorja datë 27.01.2025 "Për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në ZVAP Tiranë".
Referuar Rregullores "*Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" e miratuar me Urdhrin nr. 153 datë 17.04.2025, KREU IV, neni 27-36, parashikohet veprimtaria e ZVAP lidhur me organizimin e punës, detyrat e drejtorit, detyrat kryesore te Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, detyrat kryesore të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional si dhe raportimi që bën institucioni në institucionet eprore Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Ministrinë e Arsimit, mbi veprimtarinë e saj.

Auditimi i brendshëm

Sa i përket auditimit të brendshëm, për vitet objekt auditimi 2022-2025, referuar Ligjit Nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, në nenin 10, pika 1, gërma "b", ZVAP Tiranë nuk rezulton të jetë audituar për veprimtarinë nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.
Në ZVAP Tiranë, me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar për auditim tematik nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.
Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH .

Planet vjetore të punës

Referuar Urdhrit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), nga sektorët përgjegjës janë hartuar planet vjetore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve të cilat mbikëqyren dhe kontrollohen nga Nëpunësi Autorizues. Nga ana e institucionit ZVAP Tiranë është paraqitur dokumentacion lidhur me planin vjetor të punës së Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, më konkretisht:
- Me shkresën Nr.5311 Prot., datë 21.09.2023, është miratuar plani vjetor i punës i sektorit MKZHP për vitin 2023-2024, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike znj.E.A.
- Për vitin 2024-2025 është miratuar plani vjetor i punës së sektorit të MKZHP, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike znj.B.S.
- Për vitin 2025-2026 është miratuar plani vjetor i punës së sektorit të MKZHP, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike znj.E.M.

Nga auditimi konstatohet se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk është vendosur në dispozicion një Plan Veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika a) si dhe me

kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 4, datë 26.01.2024.

Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore

Politikat e burimeve njerëzore lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë, ndër të tjera, një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve, kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale, një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave, vlerësimin e performancës, si dhe zhvillimin e miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin dhe motivimin e stafit.

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 9, pika 4, gërma dh), konstatohet se nuk janë realizuar plane vjetore dhe mujore trajnimesh për punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Duke qenë se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë është institucion i varur në hierarki nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe më tej nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të ZVAP Tiranë bëhet nga ky institucion (AKAP).

<u>Komponenti "Vlerësimi i Riskut":</u>

Vendosja e objektivave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, i përcaktuar në Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i administratës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë është i përcaktuar në Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" në KREU-n IV, në nenin 27 në të cilën parashikohet se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor*.

Grupi i menaxhimit strategjik

Bazuar në Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 27, pika 2 në të cilin parashikohet se "2. *Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë.*", si dhe të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër Nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.4.2, Titullari i ZVAP Tiranë ka urdhëruar ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik përkatësisht;

-Me shkresën Nr.6706 Prot., datë 30.12.2022 , Urdhër Nr.261, datë 30.12.2022, nëpërmjet të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për Zyrën Vendore Arsimore Tiranë, për vitet 2021-2023. Ky komision ka në përbërje anëtarët: -E. A; K.F; S.K; T.S; A.Ç.

- Me shkresën Nr.3 Prot., datë 10.01.2025, Urdhër Nr.2, datë 10.01.2025 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë për vitet 2024-2026, me përbërje anëtarët: E.M; K. F; S.K; E.P; A.Ç.

Me shkresën Nr.183 Prot., datë 15.01.2025, Urdhër Nr.12, datë 15.01.2025 "Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë" nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike znj.E. M. Ky grup ka në përbërje anëtarët: E.M; K.F; S.K ; E.P; A.K.
Nga ana e institucionit Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, nuk janë vendosur në dispozicion procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime në mospërputhje me Ligjin 10 296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 8, pika b në të cilin parashikohet se " *8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji*" dhe nenin 27, pika 1 në të cilin parashikohet se "*Neni 27 Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik 1. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë e sektorit publik. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave".*
Nga auditimi rezulton se, nga ana e Titullarit të ZVAP Tiranë, Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur por nuk dokumentohet funksionimi i aktivitetit të GMS për periudhën objekt auditimi.
Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike. Mosveprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4/3 si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Regjistri i riskut

Nga auditimi u konstatua se është plotësuar Regjistri i Riskut për vitin 2025, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.
Nga ana e institucionit nuk janë vendosur në dispozicion Regjistri i Riskut për vitet 2022-2024, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 21, pika 1.

Strategjia e menaxhimit të riskut

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, nga ana e institucionit ZVAP Tiranë, sipas Ligjit 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 8, pika a) ku parashikohet se "*8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave"* rezulton se:

- Me shkresën Nr.6707 Prot., datë 30.12.2022, Urdhër Nr.262, datë 30.12.2022 i Titullarit të Njësisë Publike "Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Brendshëm për ZVAP Tiranë, për vitin 2021-2023, është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut në fund të vitit 2022, vit për të cilin kjo strategji nuk ka funksionuar pasi nuk garantohet dhe nuk dokumentohet strategjia e ndjekur për atë vit. Nga ana e institucionit nuk u vendos në dispozicion dokumenti i hartuar në zbatim të këtij urdhri duke mos paraqitur dokumentacion gjithëpërfshirës lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e strategjisë së menaxhimit të riskut.

- Me shkresën Nr.13044 Prot., datë 30.12.2025, Urdhër Nr.245, datë 30.12.2025 "Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Brendshëm për ZVAP Tiranë, për vitet 2024-2026. Kjo strategji është miratuar në fund të vitit 2025 dhe nuk dokumentohet Strategjia e ndjekur përgjatë vitit 2024 nga ana e institucionit.
- Me shkresën Nr.838 Prot., datë 03.02.2025 është nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike, Strategjia për Menaxhimin e Riskut të Brendshëm, për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, për vitin 2025.
- Me shkresën Nr.6708 Prot., datë 30.12.2022 Urdhër Nr.263, datë 30.12.2022 është miratuar manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin në ZVAP Tiranë.
- Me shkresën Nr.13043 Prot., datë 30.12.2025 Urdhër Nr.244, datë 30.12.2025 është miratuar manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin në ZVAP Tiranë.

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Në Urdhërin Nr.153, datë 17.04.2025 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, neni 37 parashikon organizimin e punës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar e cila përbëhet nga këto kategori punonjësish; punonjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, detyrat e të cilëve përcaktohen në nenin 32 të Rregullores dhe punonjës të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional detyrat e të cilëve përcaktohen në nenin 33 të Rregullores.

Nga ana e ZVAP Tiranë është vendosur në dispozicion dokumenti nëpërmjet të cilit përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të institucionit.

Nga ky dokumentacion, 10 (dhjetë) përshkrime individuale të punës për vitin 2022 dhe 9 (nëntë) përshkrime individuale për vitin 2025, në të cilat përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me pozicionin e punës, të firmosura nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt (titullari i institucionit), më konkretisht për pozicionet:

Specialist i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional;

Për vitin 2022: Shkresa Nr.5162/3 Prot., datë 10.10.2022; Shkresa Nr.5162/13 Prot., datë 10.10.2022: Shkresa Nr.5162/6 Prot., datë 10.10.2022; Shkresa Nr.5162/18 Prot., datë 10.10.2022: Shkresa Nr.5888 Prot., datë 18.10.2023; Shkresa Nr.5162/4 Prot., datë 10.10.2022; Shkresa Nr.5162/14 Prot., datë 10.10.2022; Shkresa Nr.5162/5 Prot., datë 10.10.2022; Shkresa Nr.4/1 Prot., datë 01.09.2020; Shkresa (pa numër prot.,), datë 26.04.2023

Për vitin 2025:

-Shkresa Nr.12345 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.226, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialist e sektorit të të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12345/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat dhe përgjegjësitë kryesore dhe detyra shtesë të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.

-Shkresa Nr.12346 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.227, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12346/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.

-Shkresa Nr.12350 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.231, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën

Nr.12350/1 Prot, datë 16.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt
-Shkresa Nr.12349 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.230, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12349/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.
-Shkresa Nr.12342 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.223, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12342/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.
-Shkresa Nr.12348 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.229, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialist e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12348/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.
-Shkresa Nr.12347 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.228, datë 02.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialist e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12347/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.
-Shkresa Nr.12344 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.225, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12344/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.
-Shkresa Nr.12343 Prot., datë 09.12.2025 Urdhër Nr.224, datë 09.12.2025 "Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për specialistët e sektorit të monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP Tiranë" nënshkruar nga nëpunësi autorizues. Me shkresën Nr.12343/1 Prot, datë 09.12.2025 është firmosur Formulari për përshkrimin e punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës; detyrat kryesore dhe detyra specifike të punonjësit. Ky formular është nënshkruar nga nëpunësi, përgjegjësi i sektorit dhe eprori direkt.

Gjurma e auditimit

Për periudhën objekt auditimi ZVAP Tiranë nuk ka hartuar gjurmën e auditimit dhe nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhërit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" si dhe neni 4, pika 19 e Ligjit 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij lidhur me vendimet ose aktet e miratuara nga Titullari, apo komunikimet me njësitë e tjera. Komunikimet ndërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Sa i përket faqes zyrtare, nga auditimi u konstatua, jo në të gjitha rastet faqja zyrtare përditësohet me të dhëna që duhet të jenë të aksesueshme, referuar parimit të transparencës së institucioneve publike si dhe të drejtës së informimit.

Komponenti "Monitorimi"

Vetëvlerësimi

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit brenda afatit kohor të përcaktuar, përkatësisht:

Për vitin 2022:

- Nëpërmjet shkresës përcjellëse Nr.447/2 Prot., datë 20.01.2023, nga ana e ZVAP Tiranë është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe Deklarata Vjetore për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të ZVAT, Raporti për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Tiranë për vitin 2022.
- Me shkresën Nr.447/1 Prot., datë 20.01.2023 është raportuar nga ana e Nëpunësit Autorizues, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të ZVAT, për vitin 2022, si dhe Raporti për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë ZVAT, për vitin 2022.

Për vitin 2023:

Konstatohet se, nga ana e institucionit nuk është paraqitur informacion lidhur me raportimin e institucionit mbi Deklaratën Vjetore për Cilësinë e sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Raportin për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm, Pyetësorin e Vetëvlerësimit, për vitin 2023, në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*", Udhëzimit 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit te menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe koordinatorit të riskut në njësinë publike*".

Për vitin 2024:

- Me shkresën Nr.729 Prot , datë 30.01.2025 është dërguar raportimi vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm, nënshkruar nga zyrtari autorizues.
- Me shkresën Nr.729 Prot., datë 30.01.2025 është plotësuar deklarata për cilësinë e sistemit të autorizues.
- Është dërguar shkresa e datës 30.01.2025 raport për funksionimin e kontrollit të brendshëm të njësisë Zyra Vendore Arsimore Tiranë, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- Nga ana e institucionit ZVAP Tiranë, për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është plotësuar Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit nga Nëpunësi Autorizues i njësisë publike.

Për vitin 2025:

- Me shkresën Nr.234/1 Prot., datë 13.01.2026 është dërguar në Ministrinë e Arsimit Raportimi vjetor mbi Sistemin e Kontrollit të Brendshëm për vitin 2025, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

- Me shkresën Nr.234 Prot., datë 13.01.2026 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, për vitin 2025 nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- Është dërguar Raporti "Për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë.
- Nga ana e institucionit Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë për periudhën Janar – Dhjetor, datë 13.01.2026 është plotësuar Pyetësori i Vetëvlerësimit të komponentëve të MFK.
- Me shkresën Nr.778 Prot., datë 31.01.2025 është plotësuar Programi i Zhvillimit Të sistemeve të MFK, në Zyrën vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, për vitin 2025.

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Për vitin 2022: Me shkresën Urdhër Nr.218, datë 27.12.2022, Nr.6622 Prot, datë 27.12.2022, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike, është ngritur Komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e magazinës dhe të zyrave të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë. Ky inventar është i hartuar dhe i nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nga Komisioni i Vlerësimit.

Procesverbali i vlerësimit duhet të hartohet nga Komisioni i Vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e tyre referuar nenit 104 dhe 105 të Udhëzimit 30. Ky komision ka në përbërje anëtarët: E.P; A.K; E. B; E.Sh; E.A.

Për vitin 2023: Me shkresën, Urdhër Nr.364, datë 12.12.2023, Nr.6565 Prot., datë 12.12.2023 Prot, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike, është ngritur Komisioni për inventarizimin e magazinës dhe të zyrave të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë. Ky komision shërben dhe për vlerësimin e aktiveve të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, me përbërje anëtarët: E.P; A.K; A Ç; R. K. A.M. Ky inventar është i hartuar dhe i nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nga Komisioni i Vlerësimit.

Për vitin 2024: Me shkresën Urdhër Nr.344, datë 17.12.2024, Nr.9180 Prot., nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike, është ngritur Komisioni për Inventarizimin e zyrave dhe të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Ky komision shërben edhe për vlerësimin e aktiveve të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tiranë. Ky komision ka në përbërje anëtarët: E.B; A. K; E.Sh; R. K; A.M. Ky inventar është i hartuar dhe i nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nga Komisioni i Vlerësimit.

Për vitin 2025: Me shkresën Nr.12737 Prot., datë 18.12.2025 Urdhër Nr.241, datë 18.12.2025 është ngritur Komisioni për Inventarizimin e magazinës dhe të zyrave të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë. Ky komision shërben edhe për vlerësimin e aktiveve të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tiranë. Ky komision ka në përbërje anëtarët: G.Sh; A.K; E.Sh; R.K.; A.M. Ky inventar është i hartuar dhe i nënshkruar nga përgjegjësi material dhe nga Komisioni i Vlerësimit.

Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike znj.E.A, znj.B.S, znj.E.M dhe Nëpunësi Zbatues z.K.F.

2.5.5. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, u krye vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku u konstatua se: Strukturat përgjegjëse Nëpunës Autorizues dhe Nëpunës Zbatues të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, nuk kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Raportet e monitorimit

Nga ana e institucionit, bazuar në Udhëzimin.Nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit të buxhetit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitet objekt auditimi, në Ministrinë e Arsimit.

***** Për periudhën objekt auditimi, institucioni ZVAP Rrogozhinë, në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022-2024; 2023-2025; 2024 -2026 dhe 2025-2027.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Me shkresën Nr. 283 Prot., datë 15.05.2019 Urdhër Nr.277, datë 15.05.2019 "Për emërimin e përkohshëm në detyrë" për z.L.Sh si Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë nga data 20.05.2019.

Me shkresën Nr.1213/1 Prot, datë 15.04.2024, Urdhër Nr.67 "Për emërimin e përkohshëm në detyrë" për znj.A. H. si Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë.

Me shkresën Nr.3728/495 Prot., datë 23.12.2024 të AKAP, Urdhër Nr.348, datë 23.12.2024 "Për emërim të përkohshëm në detyrë" për znj.A.H si Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë.

Nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë është vënë në dispozicion shkresa Nr.3728/487 Prot., datë 23.12.2024 Urdhër Nr.344, datë 23.12.2024 nëpërmjet të së cilës Z. A.S emërohet në pozicionin Specialist i Financës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë .

Koordinatori i riskut

Bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*", detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën dhe përgjegjësinë e Titullarit të Njësisë Publike.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësia publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

<u>Komponenti "Mjedisi i kontrollit"</u>

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë bazohet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".

Struktura organizative

Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin Nr. 571, datë 18.11.2024, Nr.6717/4 Prot., datë 18.11.2024 miratoi strukturën dhe organikën e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar, sipas të cilës: Ne strukturën e vitit 2022-2025 të vënë në dispozicion, në ZVAP Rrogozhinë rezulton se:

- <u>Për vitin 2022:</u> janë 6 punonjës në total, nga ku; 1 pozicion pune Drejtor; 1 pozicion pune përgjegjës kurrikule; 2 pozicione pune specialist kurrikule; 1 pozicion pune ekonomist; 1 pozicion pune jurist, i cili rezulton vakant për vitin 2022.
- <u>Për vitin 2023:</u> me shkresën Nr.451/3 Prot., datë 07.02.2023 është dërguar numri i miratuar i punonjësve të cilët janë 6 pozicione punë në total, nga ku: 1 pozicion pune Drejtor; 1 pozicion

pune përgjegjës kurrikule; 2 pozicione pune specialist kurrikule, ku një pozicion rezulton vakant; 1 pozicion pune ekonomist dhe 1 pozicion pune jurist.

- Për vitin 2024: me shkresën Nr.75/4 Prot., datë 22.02.2024 është dërguar numri i miratuar i punonjësve të cilët janë 6 pozicione punë në total, nga ku: 1 pozicion pune Drejtor; 1 pozicion pune përgjegjës kurrikule; 2 pozicione pune specialist kurrikule, ku një pozicion rezulton vakant; 1 pozicion pune ekonomist dhe 1 pozicion pune jurist.
- Për vitin 2025: janë 5 pozicione pune në total, nga ku: 1 pozicion pune Drejtor; 2 pozicione pune specialist kurrikule; 1 pozicion pune ekonomist; 1 pozicion pune jurist. Është mbyllur nga struktura pozicioni i përgjegjësit të kurrikulës.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e ZVAP Rrogozhinë bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*.

Referuar Rregullores së Brendshme "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" e miratuar me Urdhrin Nr. 153 datë 17.04.2025, në Kreun IV, neni 27-36, të rregullores parashikohet veprimtaria e ZVAP lidhur me organizimin e punës, detyrat e drejtorit, detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, detyrat kryesore të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional si dhe raportimi që bën institucioni në institucionet eprore si DRAP, AKAP dhe Ministrinë e Arsimit për mbi veprimtarinë e tij.

Planet vjetore të punës

Sa i përket planeve vjetore të punës, referuar Urdhrit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), nga sektorët përgjegjës nuk janë hartuar planet mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve të cilat mbikëqyren dhe kontrollohen nga Nëpunësi Autorizues.

Nga auditimi konstatohet se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, nuk është vendosur në dispozicion një Plan Veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika a në të cilin parashikohet se "*8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave".*

Nga auditimi konstatohet se, Titullari i ZVAP Rrogozhinë, nuk ka miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë të cilat duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve, për vitin 2022-2025, në mospërputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 2, gërma a) në të cilin parashikohet se "*Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut: 2. Koordinatori i riskut është përgjegjës për: a) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij*" , me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 4, datë

26.01.2024 si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 9, pika 4, gërma dh), nga auditimi rezultoi se nuk janë realizuar plane vjetore dhe mujore trajnimesh për punonjësit e ZVAP Rrogozhinë.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Duke qenë se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë është institucion i varur në hierarki nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe më tej nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të ZVAP Rrogozhinë bëhet nga ky institucion (AKAP).

Komponenti "Vlerësimi i Riskut"

Vendosja e objektivave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të ZVAP Rrogozhinë, i përcaktuar në Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i administratës së ZVAP Rrogozhinë është i përcaktuar në Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" në KREU-n IV, në nenin 27 të cilën parashikohet se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor*.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Nga ana e Titullarit të ZVAP Rrogozhinë, nuk është urdhëruar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27; jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4, dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut

Nga ana e institucionit nuk është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, veprime jo ë përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21, pika 2.

Regjistri i riskut

Për periudhën objekt auditimi, nga ana e institucionit nuk është hartuar Regjistri i Riskut konkretisht për vitet 2022-2025, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndyshuar, neni 21 pika 1 dhe Udhëzimi 16, datë 20.07.2016

Kreu 4, pika 2 si dhe Udhëzimit Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Struktura e ZVAP Rrogozhinë përbëhet nga këto kategori punonjësish: Titullari; punonjës të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional dhe punonjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Përshkrimet e punës

Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar janë dërguar në ZVAP Rrogozhinë Formularët e Përshkrimit të Punës, dokumenti nëpërmjet të cilit përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të ZVAP Rrogozhinë. Me shkresën Nr.140 Prot, datë 24.02.2025; me shkresën Nr.140/2 Prot, datë 24.02.2025; Me shkresën 140 Prot., datë 24.02.2025; janë firmosur Formularët Individual të Përshkrimit të Punës, i cili përmban të dhëna mbi pozicionin e punës, misionin, qëllimin e përgjithshëm të pozicionit të punës, detyrat, përgjegjësitë kryesore lidhur me planifikimin dhe detyrat, detyrat teknike përfaqësimin institucional dhe bashkëpunimin, mbikëqyrja për realizimin e detyrave të përcaktuara nga përgjegjësi i ZVAP Rrogozhinë, kushtet e punës si dhe kërkesat e posaçme lidhur me pozicionin e punës. Ky formular është i firmosur nga nëpunësi dhe nga Titullari i Njësisë Publike (eprori direkt).

Gjurma e auditimit

Nga ana e institucionit ZVAP Rrogozhinë nuk janë përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, veprime në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3.

Për periudhën objekt auditimi ZVAP Rrogozhinë nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" si dhe neni 4, pika 19 e Ligjit 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Komunikimet nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale si dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Sa i përket faqes zyrtare, nga auditimi u konstatua, jo në të gjitha rastet faqja zyrtare përditësohet me të dhëna që duhet të jenë të aksesueshme, referuar parimit të transparencës së institucioneve publike.

Komponenti "Monitorimi"

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm

Për vitet objekt auditimi 2022-2025, ZVAP Rrogozhinë, nuk rezulton të jetë audituar për veprimtarinë nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.

Në ZVAP Rrogozhinë, me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar për auditim tematik nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.

Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë i Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH .

Vetëvlerësimi

Ligji nr. 10296, datë 10.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, përcakton se NA i njësisë publike depoziton te titullari i njësisë raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt i vitit aktual. NA, përgatit dhe depoziton te Ministri përgjegjës raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill.

Referuar Ligjit 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 18 në të cilin parashikohet se "*Neni 18 Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm 1. Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji"* Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë nuk ka hartuar dhe dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit për vitet objekt auditimi 2022-2025.

Këto mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*", Udhëzimit 16, datë 20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit te menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe koordinatorit të riskut në njësinë publike*" si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Sa i përket inventarizimit të aktiveve të njësisë publike, referuar Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" nga ana e institucionit Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë nuk janë marrë masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin e aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Procesi i inventarizimit të njësisë është kryer si proces për efekt të pasqyrave financiare dhe jo sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr.30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 73, ku parashikohet se "*73. Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efiçiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe me urdhër/ udhëzim të miratuar nga titullari i njësisë publike"*, të pikës 74 në të cilën parashikohet se "*74. Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës"* si dhe të pikës 81 dhe 82 të Udhëzimit ku parashikohet se "*81. Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijohet me urdhër të titullarit të njësisë publike ose nëpunësit autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë. 82. Komisioni nuk duhet të jetë me më pak se 3 punonjës. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi",* si dhe pika 104 dhe 105 e Udhëzimit 30 "*Procesverbali i vlerësimit 104. Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: a) nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë; b) nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera; c) nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar. 105. Procesverbali hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike"*.
Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullarët e Njësisë Publike z.L.Sh dhe znj.A. H dhe Nëpunësi Zbatues z.A. S.

2.5.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë

Raportet e monitorimit

Nga ana e institucionit, bazuar në Udhëzimin.Nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit të buxhetit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitet objekt auditimi, në Ministrinë e Arsimit.

***** Për periudhën objekt auditimi, institucioni ZVAP Kavajë, në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022-2024; 2023-2025; 2024 -2026 dhe 2025-2027.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues

Me shkresën Nr.609/3 Prot, datë 05.04.2022 Urdhër 107, datë 05.04.2022nga ana e DPAP është caktuar Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, znj.Xh.B.

Me shkresën Nr.1214/1 Prot, datë 09.06.2022 Urdhër 197, datë 09.06.2022 nga ana e DPAP është caktuar Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, znj.R.X.

Me shkresën Nr.344 Prot, datë 25.01.2024 Urdhër Nr.15, datë 25.01.2024, nga ana e DPAP është caktuar Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, znj.M.C.

Me shkresën Nr.876/1 Prot., datë 11.03.2024 Urdhër Nr.51, datë 11.03.2024, është emëruar Drejtor i ZVAP Kavajë z. E.B.

Me shkresën Nr.3728/735 Prot, datë 23.12.2024 Urdhër Nr.468 nga ana e DPAP është emëruar Drejtor i ZVAP Kavajë z. E.B.

Me shkresën Nr.2217 Prot., datë 09.11.2021 Urdhër Nr.244, datë 09.11.2021, znj.B.M. është emëruar Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve, në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë.

Me shkresën Nr.3728 Prot., datë 23.12.2024 Urdhër. 472, datë 23.12.2024 është emëruar znj.B. M specialist i financës i sektorit të Burimeve Njerëzore.

Koordinatori i riskut

Bazuar në Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" për vitin 2025, detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën dhe përgjegjësinë e Titullarit të Njësisë Publike.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësia publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

Komponenti "Mjedisi i kontrollit"

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë bazohet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*".

Struktura organizative

Me shkresën Nr.338/2 Prot., datë 31.01.2022 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit është dërguar numri i miratuar i punonjësve për vitin 2022, të cilët janë 8 punonjës në strukturë.

Me shkresën Nr.454/2 Prot., datë 06.02.2025 është dërguar numri i miratuar i punonjësve për vitin 2025.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrin Nr. 571, datë 18.11.2024, Nr.6717/4 Prot., datë 18.11.2024 miratoi strukturën dhe organikën e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, sipas të cilës, janë 6 punonjës në strukturë, konkretisht:

- 1 Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë;
- 1 përgjegjës sektori në Sektorin i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional;
- 2 specialistë në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional;
- 1 specialist financë në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse; dhe
- 1 specialist jurist në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

Rregullore e brendshme

Veprimtaria e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Urdhërin Nr. 153, datë 17.04.2025 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar", si dhe Rregullores së Brendshme të institucionit të vitin 2024 dhe të vitit 2025 miratuar nga Titullari i Njësisë Publike në të cilën parashikohen misioni i ZVAP Kavajë, synimet kryesore, detyrat e ZVAP Kavajë dhe detyrat e Drejtorit të ZVAP Kavajë, detyrat e Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional dhe

të përgjegjësit të sektorit, detyrat e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe detyrat e përgjegjësit dhe detyra të përgjithshme të punonjësve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë. .
Referuar Rregullores "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" e miratuar me Urdhrin Nr. 153 datë 17.04.2025, në Kreun IV të rregullores, neni 27-36 , parashikohet veprimtaria e ZVAP lidhur me organizimin e punës, detyrat e drejtorit, detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, detyrat kryesore të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional si dhe raportimi që bën institucioni në institucionet eprore si DRAP, AKAP dhe Ministrinë e Arsimit mbi veprimtarinë e tij.

Planet vjetore të punës

Referuar Urdhërit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), nga sektorët përgjegjës janë hartuar planet mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve të cilat mbikëqyren dhe kontrollohen nga Nëpunësi Autorizues. Për vitet objekt auditimi, nga institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë është paraqitur dokumentacion mbi hartimin e planeve mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, konkretisht;

- Plani mujor për muajin prill 2024, për Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, hartuar nga specialisti dhe nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit; si dhe
- Plani mujor për muajin dhjetor 2025, për Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Mbështetëse, miratuar nga Titullari i institucionit.

Nga auditimi konstatohet se nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë, nuk është miratuar një plan veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e risqeve të nivelit të lartë dhe të mesëm, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika a në të cilin parashikohet se "*8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave"* si dhe në mospërputhje nenin 10, pika 2, gërma a) në të cilin parashikohet se "*Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut: 2. Koordinatori i riskut është përgjegjës për: a) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij*" si dhe me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 4, datë 26.01.2024.

Strategjia e menaxhimit të riskut

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë nuk ka miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2 si dhe Udhëzimin Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" , .

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 9, pika 4, gërma dh), nga auditimi rezultoi se në Rregulloren e Brendshme të Zyrës Vendore të Arsimit

Parauniversitar Kavajë përcaktohet detyrimi i punonjësve për të marrë pjesë në trajnime, por nuk janë hartuar plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

Duke qenë se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë është institucion i varur në hierarki nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe më tej nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të ZVAP Kavajë bëhet nga ky institucion (AKAP).

Komponenti "Vlerësimi i Riskut"

Vendosja e objektivave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, i përcaktuar në Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Grupi i menaxhimit strategjik

Nga ana e Titullarit të ZVAP Kavajë, nuk është urdhëruar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe si pasojë mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27; jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4 si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*".

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Regjistri i Riskut

Nga ana e institucionit nuk është hartuar Regjistri i Riskut për vitet 2022-2025, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 21, pika 1, pika 2, Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike"*.

Strategjia e menaxhimit të riskut

Nga ana e institucionit nuk është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, veprime jo ë përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2.

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Në Urdhërin Nr.153, datë 17.04.2025 të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar neni 37 parashikon organizimin e punës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar e cila përbëhet nga këto kategori punonjësish; punonjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, detyrat e të cilëve përcaktohen në nenin 32 të Rregullores dhe punonjës të Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional detyrat e të cilëve përcaktohen në nenin 33 të Rregullores. Në Rregulloren e brendshme

të institucionit në të cilën parashikohen, detyrat e ZVAP Kavajë dhe detyrat e Drejtorit të ZVAP Kavajë, detyrat e Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional dhe të përgjegjësit të sektorit, detyrat e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse dhe detyrat e përgjegjësit dhe detyra të përgjithshme të punonjësve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë por nuk janë nënshkruar përshkrimet individuale të punës për secilin punonjës që kanë të bëjnë me kritere të veçanta dhe të përgjithshme të pozicionit të punës.

Gjurmët e auditimit

Nga ana e institucionit Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë nuk janë përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, veprime në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3 dhe jo në përputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për periudhën objekt auditimi ZVAP Kavajë nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" si dhe neni 4, pika 19 e Ligjit 10296, datë 08.07.2010.

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Komunikimet nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale si dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Sa i përket faqes zyrtare, nga auditimi u konstatua, në disa raste, faqja zyrtare përditësohet me të dhëna që duhet të jenë të aksesueshme, referuar parimit të transparencës së institucioneve publike.

Komponenti "Monitorimi"

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Auditi i brendshëm

Për vitet objekt auditimi 2022-2025, bazuar në Ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, në nenin 10, pika 1, gërma "b", si dhe VKM Nr.83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve ë krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 5, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë, rezulton të jetë audituar për veprimtarinë nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën Nr.2118/3 Prot., datë 10.05.2024 ka dërguar nga në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë, Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt "Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime në arritjen e objektivave" i kryer nga Drejtoria e Auditit në MAS për periudhën 01.02.2019 deri më 29.02.2024.

Me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare

publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar për auditim tematik nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.

Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë i Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë "Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH.

Vetëvlerësimi

ZVAP Kavajë ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse Deklaratat dhe Raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit brenda afatit kohor të përcaktuar, përkatësisht:

Për vitin 2022:

- Me shkresën Nr.98 Prot., datë 23.01.2022 Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kavajë ka dërguar në Ministrinë përgjegjëse Raportimin Vjetor mbi Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe plotësimin e Pyetësorit të Vetëvlerësimit për komponentët e MFK, nënshkruar nga Titullari i Njësisë.
- Me shkresën Nr.(pa numër) Prot., datë 20.01.2023 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Kavajë për vitin 2022, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.
- ZVAP Kavajë ka dërguar në datë 20.01.2023 Pyetësorin e Vetëvlerësimit për periudhën Janar – Dhjetor, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Për vitin 2023:

- Me shkresën Nr.151/1 Prot., datë 19.01.2024, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë është dërguar raportimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Pyetësori i Vetëvlerësimit.
- Me shkresën Nr.151 Prot., datë 19.01.2024 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Kavajë nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- ZVAP Kavajë ka dërguar në datë 15.01.2024 Pyetësorin e Vetëvlerësimit për periudhën Janar – Dhjetor, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Për vitin 2024:

- Me shkresën Nr.64/1 Prot., datë 13.01.2025 nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë është dërguar raportimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Pyetësori i Vetëvlerësimit.
- Me shkresën Nr.64 Prot., datë 13.01.2025 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Kavajë nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.
- ZVAP Kavajë ka dërguar në datë 07.01.2026 Pyetësorin e Vetëvlerësimit për periudhën Janar – Dhjetor, nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Për vitin 2025:

- Me shkresën Nr.22 Prot., datë 07.01.2026 nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë është dërguar raportimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2025.
- Me shkresën Nr.(pa numër prot), datë 07.01.2026 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Kavajë firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.
- ZVAP Kavajë ka dërguar në datë 13.01.2026 Pyetësorin e Vetëvlerësimit për periudhën Janar – Dhjetor, firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.

Inventarizimi i aktiveve të njësisë

Për vitin 2022: Më shkresën Nr.1635 Prot., datë 30.12.2022 Urdhër Nr.119, datë 30.12.2022 "Për ngritjen e Komisionit për inventarizimin e aktiveve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë e përbërë nga 3 (tre) anëtarë dhe nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike. Nga komisioni i inventarizimin nuk është mbajtur procesverbal, referuar pikës 104 dhe 105 të Udhëzimit.

Për vitin 2023: Me shkresën Nr.1591 Prot, datë 26.12.2023, Urdhër Nr.108, datë 26.12.2023 "Për ngritjen e Komisionit për inventarizimin e aktiveve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë" është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve, i përbërë me tre anëtarë dhe i nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike. Nga komisioni i inventarizimin nuk është mbajtur procesverbal, referuar pikës 104 dhe 105 të Udhëzimit.

Për vitin 2024: Me shkresën Nr.1811 Prot., datë 26.12.2024 Urdhër Nr.215, datë 26.12.2024 "Për ngritjen e Komisionit për inventarizimin në Zyrën vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë" e përbërë nga 3 (tre) anëtarë e firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.

Është mbajtur procesverbali i datës 26.12.2024 me urdhrin e titullarit të ZVAP Kavajë "Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve" i firmosur nga tre anëtaret e komisionit te inventarizimit dhe përgjegjësi i materialit. Me shkresën Nr.1811/2 Prot., datë 26.12.2024, "Relacion mbi inventarizimin e aktiveve" në mbështetje të procesverbalit të mbajtur në datë 26.12.2024 nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.215, datë 26.12.2024, Komisioni i ka paraqitur Titullarit të Njësisë Publike një relacion në të cilin është bërë vlerësimi i aseteve funksionale dhe është bërë propozimi për marrjen e masave të nxjerrjes jashtë përdorimit të pajisjeve të amortizuara me arsyetimin se nuk i përgjigjen më kërkesave dhe programeve të punës. Relacioni është i firmosur nga tre anëtarët e komisionit dhe Titullari i Njësisë publike.

Për vitin 2025 Me shkresën Nr.1385 Prot., datë 29.12.2025 Urdhër Nr.177, datë 29.12.2025 "Për ngritjen e Komisionit për Inventarizimin dhe Vlerësimin e aktiveve të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kavajë i përbërë nga 3 (tre) anëtarë i firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.

Me shkresën Nr.195 Prot., datë 10.02.2026 "Relacion mbi inventarizimin e aktiveve" komisioni i vlerësimit i ngritur me urdhrin Nr.177, datë 29.12.2025 ka paraqitur një relacion mbi vlerësimin e aktiveve të ZVAP Kavajë dhe ka propozuar marrjen e masave për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve qe nuk janë më funksionale. Me shkresën procesverbal të ZVAP Kavajë është mbajtur në datën 30.12.2025 nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit dhe i firmosur prej tyre dhe prej përgjegjësit të materialit, i mbajtur në tre kopje.

Për problematikat dhe mangësitë ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike znj. Xh. B., znj.R.X, znj.M.C, z.E B dhe Nëpunësi Zbatues znj.B.M.

2.5.7 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz

Raportet e monitorimit

Nga ana e institucionit ZVAP Kamëz, bazuar në Udhëzimin.Nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*", janë dërguar raportet e monitorimit të buxhetit 4-mujor, 8-mujor dhe 12-mujor për vitet 2022-2025.

***** Për periudhën objekt auditimi 2022-2025, institucioni ZVAP Kamëz, në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, ka hartuar projektbuxhetin e vitit 2022 – 2024; 2023 – 2025; 2024 -2026 dhe 2025-2027.

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues:

Me shkresën Nr. 6721/1 Prot., datë 01.12.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është caktuar Nëpunës Autorizues i ZVAP Kamëz, znj. A. S.

Me shkresën Nr.9768/1 Prot., datë 31.05.2019 të me lëndë "Mbi caktimin e Nëpunësit Zbatues te përkohshëm për disa Drejtori Arsimore dhe Zyra Vendore Arsimore" caktohet Nëpunës Zbatues znj.V. D, me pozicion pune përgjegjës sektori në ZVAP Kamëz.

Koordinatori i riskut

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz, bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", si dhe i ndryshuar, Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*", detyrat e koordinatorit të riskut janë në kompetencën e Titullarit të Njësisë Publike.

Me shkresën Nr.23, datë 17.01.2022 , Urdhër i Brendshëm Nr.03, datë 17.01.2022 është caktuar Koordinatori i Riskut dhe i MFK Titullari i Njësisë Publike ZVAP Kamëz, znj.A. S.

Procedurat e prokurimit

Procedurat e prokurimit kryhen në zbatim të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* si dhe Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Njësia publike mban regjistër parashikimi dhe regjistër realizimi për çdo vit. Njësia publike njofton APP për ndryshimet në regjistrin e parashikimit, sipas ligjit të prokurimit dhe udhëzimeve të APP

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

<u>Komponenti "Mjedisi i kontrollit"</u>

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

Integriteti dhe vlerat etike

Sa i përket Kodit Etik, institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz bazohet në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" .

Struktura organizative

Nga auditimi konstatohet se, struktura e institucionit ZVAP Kamëz, për vitet 2022-2024, ka patur 11 punonjës në organikë, më konkretisht;

- <u>1 pozicion pune</u> Drejtor i Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
- <u>4 pozicione pune</u> Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, nga ku; 1 pozicion pune përgjegjës sektori + 3 pozicione pune specialist;
- <u>6 pozicione pune</u> Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga ku; 1 pozicion pune përgjegjës sektori + 5 pozicione pune specialistë.

Me shkresën Nr.6717 Prot., datë 18.11.2024, Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.571, datë 18.11.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar" për ZVAP Kamëz, sipas të cilës në strukturë rezultojnë 10 punonjës në total, nga ku:

- 1 pozicion pune Drejtor i Zyrës vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz;
- 3 pozicione pune Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, nga ku; 1 pozicion pune përgjegjës sektori + 1 pozicion pune specialist jurist + 1 pozicion pune specialist i financës;
- 6 pozicione pune Sektori i Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, nga ku; 1 pozicion pune përgjegjës sektori + 5 pozicione pune specialistë.

Rregullorja e brendshme

Veprimtaria e ZVAP Kamëz bazohet në Ligjin nr. 69/2012 "*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, UrdhËrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*" dhe Rregulloren e Brendshme Nr.56/1 Prot., datë 09.01.2025, të miratuar nga Titullari i Njësisë Publike.

Referuar Rregullores "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar", në Kreun IV, neni 27-36, të rregullores parashikohet veprimtaria e ZVAP lidhur me organizimin e punës, detyrat e drejtorit, detyrat kryesore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, detyrat kryesore te Monitorimit të Kurrikulës dhe të Zhvillimit Profesional si dhe raportimi që bën institucioni në institucionet eprore si DRAP, AKAP dhe Ministrinë e Arsimit mbi veprimtarinë e tij.

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz ka miratuar Rregulloren e Brendshme Nr.56/1 Prot., datë 09.01.2025, të miratuar nga Titullari i Njësisë Publike znj.A.S. Në këtë rregullore në KREUN I janë përcaktuar qëllimi, misioni, veprimtaria,; në KREUN II përgjegjësitë, organizimi, detyrat e ZVAP, funksionimi, kompetencat e drejtorit të ZVAP Kamëz, detyrat e sektorit të shërbimeve, detyrat e Sektorit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, raportimi ne institucionet eprore, faqja zyrtare; në KREUN III parashikohet struktura organizative dhe organike përkatëse; detyrat e përgjegjësve të sektorëve dhe të specialistëve, detyrat e sektorit të Kurrikulës dhe Cilësisë, detyrat e juristit; në KREUN IV rregullat mbi marrëdhëniet në punë, të drejtat e detyrimet e punonjësve si dhe detyrime të veçanta, detyrimet e ZVAP Kamëz mbi marrëdhëniet e punës; KREU V parashikon përgjegjësinë disiplinore, llojin dhe procedurën për dhënien e saj dhe KREU VI në të cilin parashikohet shërbimi psikosocial në institucionet arsimore si dhe rregulla mbi komisionet disiplinore pranë ZVAP Kamëz.

Auditimi i brendshëm

Për vitet objekt auditimi 2022-2025, bazuar në Ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" i ndryshuar, në nenin 10, pika 1, gërma "b", si dhe VKM Nr.83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve ë krijimit të njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik*" pika 5, ZVAP Kamëz, për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jetë audituar për veprimtarinë nga njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit.

Në ZVAP Kamëz, me shkresën Nr.220/1 Prot., datë 11.01.2024 me lëndë "Dërgohet raporti i grupit të punës" për raportin përfundimtar me Nr.6092 Prot., datë 26.12.2023 "Për verifikimin e procedurave të transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës", drejtuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, ky institucion rezulton të jenë audituar për auditim tematik nga Njësia e Auditimit në Ministrinë e Arsimit.

Me shkresën Nr.629 Prot., datë 10.12.2025 të Kontrollit të Lartë i Shtetit dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar me Nr.3141 Prot, datë 11.12.2025, me lëndë

"Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e performancës me temë "Shërbimi psiko-social në sistemin arsimor parauniversitar", rezulton të jetë audituar nga KLSH .

Planet vjetore të punës

Referuar Urdhrit Nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*" pika 2.4.1, gërma a), nga sektorët përgjegjës janë hartuar planet mujore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve të cilat mbikëqyren dhe kontrollohen nga Nëpunësi Autorizues. Për vitet objekt auditimi, nga institucioni Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz është paraqitur dokumentacion mbi hartimin e planeve mujore e vjetore të punës lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, si më poshtë:

Janë miratuar planet vjetore dhe mujore të punës sipas sektorëve, për vitet 2022-2025, më konkretisht:

- Me shkresën Nr.03/1 Prot., datë 05.01.2022 hartuar nga përgjegjësi i sektorit dhe është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani i punës janar-dhjetor i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, për vitin 2022.
- Me shkresën Nr.51/1 Prot., datë 11.01.2023 hartuar nga përgjegjësi i sektorit dhe është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani i punës janar-dhjetor i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, për vitin 2023.
- Me shkresën Nr.2767 Prot., datë 29.12.2023 hartuar nga përgjegjësi i sektorit dhe është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike plani i punës janar-dhjetor i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, për vitin 2024.
- Me shkresën Nr.2897 Prot., datë 31.12.2024 hartuar nga përgjegjësi i sektorit dhe është miratuar nga Titullari i Njësisë Publike Plani i Punës janar-dhjetor i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, për vitin 2025.

Sa i përket planeve mujore të punës, për sektorin e shërbimeve mbështetëse janë miratuar nga Titullari i Institucionit këto plane:

- Me shkresën Nr.01/1 prot., datë 05.01.2022 Plani i Punës për muajin Janar 2022.
- Me shkresën Nr.99 Prot., datë 02.02.2022 Plani i Punës për muajin Shkurt 2022.
- Me shkresën Nr.625 Prot., datë 04.05.2022 Plani i Punës për muajin Maj 2022.
- Me shkresën Nr.679 prot., datë 06.04.2023 Plani i Punës për muajin Prill 2023
- Me shkresën Nr.1206 Prot., datë 05.06.2024 Plani i Punës për muajin Qershor 2024.
- Me shkresën Nr.1052/1Prot., datë 02.05.2025 Plani i Punës për muajin Maj 2025.

Planet e punës vjetore dhe mujore për Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, hartuar nga përgjegjësi i sektorit dhe miratuar nga Titullari i Institucionit, më konkretisht:

- Me shkresën Nr.2225 Prot., datë 03.10.2025 Plani Vjetor i Punës për vitin 2025-2026.
- Me shkresën nr.1853 Prot., datë 09.09.2024 Plani Vjetor i Punës për vitin 2024-2025.
- Me shkresën Nr.03 Prot., datë 05.01.2022 Plani Vjetor i Punës për vitin 2022.
- Me shkresën Nr.1709 Prot., datë 02.09.2025 Plan Veprimi për muajin Shtator 2025.
- Me shkresën Nr.2225/1 Prot., datë 03.10.2025 Plan Veprimi për muajin Tetor 2025.
- Me shkresën Nr.2392 Prot., datë 05.10.2025 Plan Veprimi për muajin Nëntor 2025.
- Me shkresën Nr.2481 Prot., datë 04.12.2025 Plan Veprimi për muajin Dhjetor 2025.
- Me shkresën Nr.1065 Prot., datë 20.05.2024 Plan Veprimi për muajin Maj 2024.
- Me shkresën Nr.1650 Prot., datë 05.08.2024 Plani i Punës për muajin Gusht 2024.
- Me shkresën Nr.1772 Prot., datë 02.09.2024 Plani i Punës për muajin Shtator 2024.

- Me shkresën Nr.2248 Prot., datë 02.10.2024 Plani i Punës për muajin Tetor 2024.
- Me shkresën Nr.2525 Prot., datë 04.11.2024 Plani i Punës për muajin Nëntor 2024.
- Me shkresën Nr.2708 Prot., datë 03.12.2024 Plani i Punës për muajin Dhjetor 2024.
- Me shkresën Nr.01 Prot., datë 05.01.2022 Plani i Punës për muajin Janar 2022.
- Me shkresën Nr.100 Prot., datë 02.02.2022 Plani i Punës për muajin Shkurt 2022.
- Me shkresën Nr.206 Prot., datë 01.03.2022 Plani i Punës për muajin Mars 2022.
- Me shkresën Nr.393 Prot., datë 31.03.2022 Plani i Punës për muajin Prill 2022.
- Me shkresën Nr.624 Prot., datë 04.05.2022 Plani i Punës për muajin Maj 2022.
- Me shkresën Nr.1049 Prot., datë 30.06.2022 Plani i Punës për muajin Korrik 2022.
- Me shkresën Nr.51 Prot., datë 11.01.2023 Plani i Punës për muajin Janar 2023.
- Me shkresën Nr.368 Prot., datë 01.02.2023 Plani i Punës për muajin Shkurt 2023.

Nga auditimi konstatohet se nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz, nuk është miratuar një plan veprimi i posaçëm për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, veprim jo në përputhje me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika a, në të cilin parashikohet se "*8. Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan- veprimeve për arritjen e objektivave"* dhe në mospërputhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 10, pika 2, gërma a) në të cilin parashikohet se "*Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut: 2. Koordinatori i riskut është përgjegjës për: a) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij*" si dhe me kërkesat e përcaktuara në Aneksin nr. 5 të Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 4, datë 26.01.2024. Këto plane duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, trajtimin e risqeve në nivel strategjik, programi dhe aktiviteti, si dhe mekanizmat për monitorimin, vlerësimin dhe matjen e risqeve, situatë që do të rezultonte në mospërputhje me kërkesat e parashikuara në anekset 5, 6 dhe 7 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" , .

Trajnimet e punonjësve

Referuar Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 9, pika 4, gërma dh), nga auditimi rezultoi se nuk janë realizuar plane vjetore dhe mujore trajnimesh për punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz.

Në lidhje me rekrutimin dhe emërimin

ZVAP Kamëz është institucion i varur në hierarki nga Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe më tej nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe rekrutimi dhe emërimi i punonjësve të ZVAP Kamëz bëhet nga ky institucion (AKAP).

Komponenti "Vlerësimi i Riskut"

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen për arritjen e objektivave të vendosura.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Nga ana e Titullarit të ZVAP Kamëz, nuk është urdhëruar ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe si pasojë mungojnë procesverbalet e mbledhjeve të GMS-së që të dokumentojnë diskutimet, analizat dhe vendimmarrjet lidhur me realizimin e detyrave të këtij grupi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma "b", neni 27; jo në përputhje me kërkesat e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër nr. 4, datë 26.01.2024, Kapitulli II, pika 2.3 dhe pika 2.4.2.; Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*" pika 2.2.4 si dhe Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" .

Grupi i Menaxhimit Strategjik luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike. GMS duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet e saj duhet të regjistrohen nga sekretari si dhe të vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut

Nga ana e institucionit me shkresën Nr.2573 Prot., datë 30.12.2022 është miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut të Brendshëm për ZVAP Kamëz, veprime sipas Ligjit 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 21, pika 2.

Regjistri i riskut

Për periudhën objekt auditimi, nga ana e institucionit nuk është hartuar Regjistri i Riskut për vitet 2022-2025, veprime jo në përputhje me Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 21, pika 1, pika 2 dhe Udhëzimit Nr.16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në njësitë publike*" ,

Komponenti "Aktivitetet e Kontrollit"

Ndarja e detyrave

Objektivi kryesor për krijimin e institucionit të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz, i përcaktuar në Ligjin nr. 69/2012 i ndryshuar, është përcaktimi i parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Misioni i administratës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz është i përcaktuar në Urdhrin Nr. 153, datë 17.04.2025 "Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar" në KREU-n IV, në nenin 27 në të cilën parashikohet se: *Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar janë përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel vendor*.

Përshkrimet e punës

Bazuar në Urdhrin 153, datë 17.04.2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit " Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të AKAP" Nga ana e ZVAP Kamëz janë

firmosur përshkrimet e punës për punonjësit. Këto përshkrime individuale pune rezultojnë të firmosura nga Titullari i Njësisë Publike, përgjegjësi i sektorit dhe punonjësi, në të cilat parashikohen të dhëna për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore lidhur me planifikimin dhe objektivat, menaxhimin, detyrat teknike, zgjidhja e problemeve, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, kushtet e punës si dhe kërkesa të posaçme sa i përket kritereve që duhet të plotësojnë.

Gjurma e auditimit

Nga ana e institucionit Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz nuk janë përditësuar gjurmët e auditimit në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar pasqyrimin e qartë të ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban çdo proces, veprime në mospërputhje me Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3 dhe jo në përputhje me kërkesat e Aneksit nr. 3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Për periudhën objekt auditimi ZVAP Kamëz nuk ka operuar me sistem financiar të mbajtjes së të dhënave, por vetëm me paketën e microsoft /programin excel, i cili është lehtësisht i modifikueshëm dhe nuk i ruan të dhënat financiare institucionale në formë elektronike, jo në përputhje me pikën 2.4.5, pika g, të Urdhrit nr.4, datë 26.01.2024 "*Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*".

Komponenti "Informimi dhe komunikimi"

Punonjësit e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz janë pjesë e rrjetit të komunikimit dhe komunikojnë nëpërmjet tij. Komunikimet nëpërmjet punonjësve realizohen në formë shkresore, verbale dhe elektronike nëpërmjet rrjetit (arsimi.gov.al).

Sa i përket faqes zyrtare, ngaauditimi u konstatua, jo në të gjitha rastet faqja zyrtare përditësohet me të dhëna që duhet të jenë të aksesueshme, referuar parimit të transparencës së institucioneve publike.

Komponenti "Monitorimi"

Vetëvlerësimi

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kamëz ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse Deklaratat dhe Raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit brenda afatit kohor të përcaktuar, përkatësisht:

Për vitin 2022:

Me shkresën Nr.227 Prot., datë 27.01.2023 është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Me shkresën Nr.2572 Prot., datë 30.12.2022 Është dërguar Deklarata për Cilësinë e Kontrollit të Brendshëm nënshkruar nga Titullari i Njësisë Publike.

Nga ana e ZVAP Kamëz është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit për Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz.

Për vitin 2023:

Me shkresën Nr.329 Prot., datë 31.01.2024 është dërguar Pyetësori i Vetëvlerësimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.

Me shkresën Nr.329/1, datë 31.01.2024 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të ZVAP Kamëz firmosur nga Titullari i Njësisë Publike.

Me shkresën 329/2 Prot., datë 31.01.2024 është dërguar Raporti për Funksionimin e Kontrollit të Brendshëm për ZVAP Kamëz.

Për vitin 2024:

Me shkresën Nr.192 Prot., datë 27.01.2025 është dërguar dokumentacion mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Me shkresën nr.192/1 prot, datë 27.01.2025 është dërguar Deklarata për Cilësinë e Sistemit të kontrollit të brendshëm të ZVAP Kamëz.
Me shkresën Nr.192/2 Prot., datë 27.01.2025 është dërguar Raporti për Funksionimin e Kontrollit të Brendshëm për ZVAP Kamëz.

Për vitin 2025:

Me shkresën Nr.120/2 Prot., datë 28.01.2026 është dërguar pyetësori i vetëvlerësimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Me shkresën 120/1 Prot., datë 27.01.2026 është dërguar deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të ZVAP Kamëz.
Me shkresën 120 prot., datë 27.01.2025 është dërguar Raporti për Funksionimin e Kontrollit të Brendshëm për ZVAP Kamëz.

Inventarizimi i Aktiveve të Njësisë

Për vitin 2022: Me shkresën Nr.2566 Prot., datë 29.12.2022 Urdhër i Brendshëm Nr.87, datë 29.12.2022 "Mbi ngritjen e grupit të punës për inventarizimin e aktiveve në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz" është urdhëruar nga ana e Titullarit të Njësisë publike për komisioni i përbërë me një kryetar dhe dy anëtarë, referuar Udhëzimit Nr.30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nga komisioni i inventarizimit janë mbajtur procesverbale referuar nenit 104 dhe 105 të Udhëzimit 30.
Nga ana e institucionit, me shkresat e datës 30.12.2022 janë mbajtur procesverbale për verifikimin e materialeve të inventarit të aktiveve të njësisë nënshkruar nga përgjegjësi i materialit dhe nga Komisioni i inventarizimit. Këto procesverbale përmbajnë të dhëna mbi gjendjen kontabël dhe gjendjen faktike të aseteve, ndarë sipas zyrave përkatëse të institucionit.
Për vitin 2023: Me shkresën Nr.2739 Prot., datë 21.12.2023 Urdhër Nr.90, datë 21.12.2023 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të instaluara në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz" firmosur nga Titullari i Njësisë Publike, për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve të njësisë. Nga komisioni i inventarizimi janë mbajtur procesverbale referuar nenit 104 dhe 105 të Udhëzimit 30.
Nga ana e institucionit, me shkresat e datës 29.12.2023 janë mbajtur procesverbale për verifikimin e materialeve të inventarit të aktiveve të njësisë të nënshkruara nga komisioni i inventarizimit dhe nga përgjegjësi i materialit. Në procesverbale paraqiten të dhëna mbi gjendjen kontabël dhe gjendjen faktike të aseteve të ndryshme që ndodhen në institucion. Këto procesverbale janë mbajtur sipas zyrave përkatëse të institucionit.
Me shkresën e datës 22.12.2023 janë mbajtur disa procesverbale në zbatim të Urdhrit të Titullarit Nr.83/1 datë 15.12.2023 "Mbi ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e aktiveve të dhuruara", në prani të përgjegjëses së materialit dhe të komisionit. Në këto procesverbale përmbahen të dhëna mbi vitin e blerjes, sasinë, çmimin si dhe vlerën e aseteve si dhe janë të nënshkruara nga Titullari i Institucionit, përgjegjësi i materialit dhe komisioni i vlerësimit
Me shkresën Nr.2766 Prot., datë 29.12.2023 në zbatim të Urdhërit Nr.83/1, datë 15.12.2023 si dhe Urdhërit Nr.90, datë 29.12.2023 është mbajtur Relacion mbi vlerësimin e aktiveve dhe inventarizimin për vlerësimin e aktiveve të dhuruara në të cilin përmbahen kriteret e vlerësimit dhe asetet që do të vlerësohen. Ky relacion është i nënshkruar nga Titullari i institucionit.
Për vitin 2024: Me shkresën Nr.2838 Prot., datë 20.12.2024 Urdhër Nr.104, datë 20.12.2024 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të instaluara në Zyrën Vendore

të Arsimit Parauniversitar Kamëz" firmosur nga Titullari i Njësisë Publike ka urdhëruar komisioni ngarkohet të kryejë dhe vlerësimin e aktiveve të njësisë që për shkak të jetëgjatësisë (dhurimit) janë pa vlera, dhe në përfundim të mbajnë procesverbal.
Nga ana e institucionit, me shkresat e datës 20.12.2024 janë mbajtur procesverbale për verifikimin e materialeve të inventarit të aktiveve të njësisë nënshkruar nga Komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësi i materialit. Në procesverbale paraqiten të dhëna mbi gjendjen kontabël dhe gjendjen faktike të aseteve të ndryshme që ndodhen në institucion sipas zyrave.
Për vitin 2025: Me shkresën Nr.2528 Prot., datë 22.12.2025 Urdhër Nr.112, datë 22.12.2025 "Për ngritjen e komisionit për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të instaluara në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz" firmosur nga Titullari i Njësisë Publike, ka urdhëruar ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të njësisë. Nga komisioni i inventarizimit janë mbajtur procesverbale referuar nenit 104 dhe 105 të Udhëzimit 30.
Nga ana e institucionit me shkresat e datës 22.12.2025 janë mbajtur procesverbale për verifikimin e materialeve të inventarit të aktiveve të njësisë nënshkruar nga Komisioni i Inventarizimit dhe përgjegjësi i materialit. Procesverbalet përmbajnë të dhëna mbi gjendjen kontabël dhe gjendjen faktike të aseteve sipas zyrave të institucionit.
Me shkresën Nr.2526/1 Prot., datë 31.12.2025 është hartuar Raporti mbi inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve në inventar të ZVAP Kamëz me qëllim evidentimin e gjendjes faktike të aktiveve të ZVAP Kamëz, krahasimin e tyre me regjistrat kontabël si dhe vlerësimin e gjendjes fizike dhe vlerës ekonomike të tyre. Ky relacion është i nënshkruar nga komisioni dhe nga përgjegjësi i materialit. Nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kamëz është vendosur në dispozicion regjistri i aktiveve afatgjata të institucionit për vitin 2025, të dhëna mbi hyrjet dhe daljet për aktivet e vitit 2025 për institucionet arsimore, të nënshkruara nga specialisti dhe përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve.
Për problematikat dhe mangësitë e trajtuara ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Njësisë Publike znj.A.S dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit znj.V.D.

V. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të ristrukturimit të DRAP dhe ZVAP-ve rezultoi se, në zbatim të pikës 4, Kreu VII, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 03.05.2024 "*Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë",* Drejtori i DRAP ka emëruar në pozicionin e mësuesit 3 punonjës të ZVAP-ve të prekur nga ristrukturimi, pa procedurë konkurrimi dhe jashtë portalit "*Mësues për Shqipërinë",* në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, sipas të cilit emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune kryhet nga drejtori i institucionit arsimor nëpërmjet konkurrimit të hapur. Në këtë mënyrë, dispozita e parashikuar në pikën 4, Kreu VII, të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 bie në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, duke sjellë shmangien e procedurave konkurruese dhe të parimit të barazisë në punësim.

Gjithashtu nga auditimi i procedurave të emërimit të mësuesve u konstatua se udhëzimi i Ministrisë së Arsimit nr. 4, datë 26.02.2026 *"Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024"* ka vendosur një kufizim të ri në procedurën e aplikimit për pozicionin e mësuesit, sipas të cilit kandidatët lejohen të konkurrojnë vetëm brenda DRAP-it ku kanë vendbanimin e përhershëm. Ndërkohë që në ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në asnjë dispozitë të tij nuk vendosen kufizime në konkurrim në lidhje me vendbanimin e aplikantëve, por në pikën 1 të nenit 60 të tij përcaktohet se emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Të dyja dispozita e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, sipas të cilit emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune kryhet nëpërmjet konkurrimit të hapur dhe mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Për rrjedhojë, njëra dispozitë mundëson emërimin pa konkurrim, ndërsa tjetra kufizon konkurrimin vetëm brenda DRAP-it të vendbanimit të përhershëm të kandidatit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për rishikimin e Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024 *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"*, me qëllim shmangien e dispozitave që krijojnë përjashtime nga procedurat e konkurrimit nëpërmjet portalit *"Mësues për Shqipërinë"* si dhe vendosin kufizime në aplikimin e kandidatëve për një vend pune, në mënyrë që pranimi dhe emërimi i mësuesve të mbështetet në parimin e meritës, transparencës, barazisë së mundësive dhe respektimit të renditjes në portal.

Brenda vitit 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kuadrit rregullator për emërimin e drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar (IPAP), u konstatua se pas 21.07.2025, ekzistojnë mospërputhje midis dispozitave të ligjit nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"* dhe Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për*

përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP" në lidhje me certifikim e kandidatëve për drejtor. Konkretisht, pika 3 e nenit 3 të ligjit parashikon se kandidati për drejtor duhet të jetë i pajisur me certifikatën e drejtuesit të institucionit arsimor.
Ndërkohë, Udhëzimi nr. 22/2023, Kreu I, neni 2, pika "d", parashikon se kandidati duhet të jetë i certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit të trajnimit të detyrueshëm ose të jetë pranuar për ta kryer atë. Parashikimi i mundësisë për kandidimin edhe të individëve të cilët vetëm janë pranuar për të ndjekur trajnimin, pa e përfunduar ende atë dhe pa u pajisur me certifikimin përkatës, zgjeron kriteret ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 69/2012 dhe krijon hapësirë për emërime në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara nga ligji. Për rrjedhojë, kjo dispozitë përbën tejkalim të kompetencës rregullatore dhe bie në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.
Gjithashtu, në Shtojcën nr. 6 të Udhëzimit nr. 22/2023*"Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/nëndrejtor IPAP",* parashikohen që kandidati të vlerësohet me 10 pikë në rast se disponon certifikatën për drejtues nga Shkolla e Drejtorëve. Megjithatë, pas hyrjes në fuqi të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 55 dhe nenin 55/1 të Ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar, certifikata përbën kriter kualifikues detyrues dhe jo element vlerësimi me pikë, duke e bërë këtë pikëzim të panevojshëm dhe pa bazë ligjore në procesin e konkurrimit.
Po në këtë shtojcë konstatohet se për kategoritë e kualifikimit të mësuesve *("Mësues i kualifikuar", "Mësues specialist", "Mësues mjeshtër"),* vlerësimi *"Mirë", "Shumë mirë"* dhe *"Shkëlqyeshëm"* nuk shoqërohet gjithmonë me diferencim proporcional në pikëzim. Konkretisht, në disa raste, vlerësimet *"Shumë mirë"* dhe *"Shkëlqyeshëm"* trajtohen me të njëjtin interval pikësh, çka ndikon në objektivitetin e procesit të vlerësimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për rishikimin e Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"*, me qëllim rregullimin e procedurave të emërimit të drejtorëve dhe nëndrejtorëve të institucioneve publike të arsimit parauniversitar dhe garantimin e transparencës, barazisë dhe vlerësimit të drejtë e proporcional të kandidatëve.

Brenda vitit 2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kuadrit nënligjor që rregullon praktikën profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, u konstatua mungesë harmonizimi ndërmjet akteve rregullatore në fuqi, konkretisht: Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 100, datë 25.02.2022, *"Për miratimin e rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit",* i ndryshuar, përcakton rastet e përjashtimit nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale. Në këtë kuadër, parashikohen kategori të caktuara personash që nuk i nënshtrohen këtij detyrimi, përfshirë individët që kanë përfunduar studimet dhe kanë ushtruar më parë profesionin e mësuesit, personat që kanë kryer praktikën profesionale dhe kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe personat që kanë përvojë pune minimale prej tre muajsh në një institucion arsimor, të shoqëruar me diplomimin përkatës.
Ndërkohë, Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 365, datë 28.12.2020, *"Për miratimin e rregullores për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit dhe procedurat e zhvillimit të provimit të shtetit"*, i ndryshuar, përcakton si kusht për pjesëmarrjen në provimin e shtetit kryerjen me sukses të praktikës profesionale për të gjithë kandidatët.

Në këtë mënyrë, dispozitat e këtij urdhri nuk reflektojnë përjashtimet e parashikuara në Urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 100, datë 25.02.2022, duke krijuar një mospërputhje në zbatimin e kërkesave për akses në provimin e shtetit dhe pasojë të drejtpërdrejtë në interpretimin dhe aplikimin e unifikuar të kuadrit rregullator për profesionin e mësuesit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë praktikën profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit, me qëllim përcaktimin e qartë të rasteve të përjashtimore dhe garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit në fuqi.

Brenda vitit 2026

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Organizimi i procesit të kualifikimit, procedurat si dhe kriteret përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin. Sipas Udhëzimit nr. 4, datë 26.02.2021 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* mësuesit për t'u kualifikuar duhet të kalojnë me sukses provimin, i cili organizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Neni 2 i Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 08.02.2023 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* parashikonte që procesi i kualifikimit për kategorinë III "Mësues i kualifikuar" dhe kategorinë II "Mësues specialist" të realizohej nëpërmjet portofolit profesional dhe provimit me test, ndërsa për kategorinë I "Mësues mjeshtër" të realizohej nëpërmjet portofolit profesional dhe zhvillimit të një ore të hapur mësimore, pa parashikuar zhvillimin e provimit përfundimtar.
Ndërsa në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 7, datë 22.07.2024 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë"*, i ndryshuar, i cili është ende në fuqi, në nenin 2 të tij, parashikon që:
- për kategorinë "Mësues i kualifikuar" procesi të realizohet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional, orës së hapur dhe testit të informatizuar;
- për kategorinë "Mësues specialist" nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional, orës së hapur dhe projektit kurrikular;
- për kategorinë "Mësues mjeshtër" nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional dhe projektit kurrikular. Pra, sipas këtij udhëzimi për të përfituar kategorinë e II-të dhe I-rë, mësuesi nuk duhet ti nënshtrohet testimit apo provimi, por është bërë zëvendësimi i tij me forma të tjera vlerësimi, si projekti kurrikular ose ora e hapur mësimore.
Konstatohet se heqja e kriterit të realizimit të provimit për kategorinë e I "Mësues mjeshtër" në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 2, datë 08.02.2023 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* për periudhën 11.03.2023 deri më 31.07.2024, dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 17, datë 22.07.2024 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë",* bie në kundërshtim me pikën 2, neni 59 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për rishikimin dhe harmonizimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar, me

qëllim sigurimin e përputhshmërisë së plotë të tyre duke përcaktuar qartë kriteret, procedurat dhe format e provimit përfundimtar për secilën kategori kualifikimi të mësuesve.

Brenda vitit 2026

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave për tekste shkollore, u konstatua se sipas përcaktimeve të kreut II, pika 3 të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 21, datë 19.08.2020 *"Për përcaktimin e procedurave të administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas për arsimin parauniversitar",* botuesit/distributorët duhet të furnizojnë shkollat me tekste, 10 ditë kalendarike para datës së fillimit të vitit shkollor.
Sipas urdhrit të përbashkët nr. 156, datë 22.04.2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit *"Për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2025-2026 në sistemin arsimor parauniversitar"*, në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë, mësimi fillon në datë 08.09.2025. Referuar dispozitave të mësipërme furnizimi i shkollave me libra shkollor duhet të ketë përfunduar më datë 29.08.2025.
Nga ana tjetër, sipas nenit 8, të ligjit nr. 87/2019 *"Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"*, i ndryshuar, fatura duhet të lëshohet në momentin e dorëzimit të mallit. Gjithashtu në pikën 1, neni 99 të ligjit 92/2014 *"Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, përcaktohet se fatura lëshohet në momentin e furnizimit të mallit.
Gjithashtu, neni 52, i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, përcakton se nëpunësit zbatues të njësive shpenzues të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomik, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorëve ekonomik.
Ndërkohë, në Kreun III, pika 7 të udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 18, datë 01.07.2020 *"Për procedurat e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar"*, përcaktohet se ZVAP, brenda datës 10 tetor, dërgon në Ministrinë të Arsimit, kërkesën për fonde buxhetore të detajuar sipas niveleve arsimore/buxhetore, për arsimin bazë, për arsimin e mesëm të përgjithshëm, ndërsa në pikën 8 të po këtij udhëzimi citohet se ministria çel fondet për vitin përkatës buxhetor.
Sa më sipër, nga shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi konstatohet një mospërputhje ndërmjet afateve të përcaktuara për furnizimin, faturimin dhe financimin e teksteve shkollore. Konkretisht, furnizimi i librave dhe lëshimi i faturës, për vitin shkollor 2025-2026, duhet të kryhet deri më 29.08.2025, ndërsa pagesat duhet të realizohen brenda 30 ditëve nga data e faturës.
Në të njëjtën kohë, udhëzimi i përbashkët parashikon që kërkesat për fonde buxhetore të dërgohen nga ZVAP brenda datës 10 tetor, duke krijuar një mospërputhje kohore ndërmjet lindjes së detyrimit financiar dhe sigurimit të fondeve për shlyerjen e tij, me efekt mosrespektimin e afateve ligjore të pagesave dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 12-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për inicimin e procedurave për rishikimin dhe harmonizimin e kuadrit nënligjor që rregullon procedurat e furnizimit, faturimit, planifikimit dhe financimit të teksteve shkollore, duke përcaktuar afate të koordinuara që garantojnë sigurimin në kohë të fondeve buxhetore dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Brenda vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kuadri aktual nënligjor për punonjësit arsimorë, të cilët ushtrojnë detyrën në shkolla publike jashtë qendrës urbane, për largësi nga vendbanimi mbi 5 km deri në 50 km dhe kthehen brenda ditës, paraqet mbivendosje dhe paqartësi interpretimi ndërmjet VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar, i cili në pikën 6 parashikon kompensim të diferencuar sipas distancës dhe VKM nr. 425, datë 26.06.2024, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*", i ndryshuar, në pikën 11, germa "a", e ndryshuar, e cila parashikon kompensim të unifikuar në masën 2,700 lekë/muaj.
Më konkretisht në pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", përcaktohet se punonjësit arsimorë, të cilët janë punësuar në IAP-të publike të arsimit të përgjithshëm, kur punojnë jashtë qendrës urbane, në distancë nga vendbanimi i tyre mbi 50 km, dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, si dhe përfitojnë kompensim mujor, sipas shkronjës "a", të pikës 11, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*".
Ndërkohë, sipas shkronjës "a", të pikës 11, të VKM nr. 425, datë 26.6.2024, "*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar*" përcaktohet se punonjësit mësimorë, të cilët punojnë larg vendbanimit, kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, mbi 5 kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, përfitojnë një kompensim në masën 2,700 lekë në muaj, duke krijuar mospërputhje ndërmjet dy akteve nënligjore në përcaktimin e distancës dhe mënyrës së përfitimit të kompensimit për transportin e punonjësve arsimorë. Kjo situatë ka sjellë paqartësi në zbatimin praktik nga strukturat vendore të arsimit, pasi kriteret e përcaktuara në këto akte nënligjore nuk janë të harmonizuara në mënyrë të plotë.
Si rezultat, disa ZVAP kanë interpretuar në mënyrë të ndryshme kushtet e përfitimit, duke aplikuar kompensime për punonjës që punojnë brenda qendrave urbane ose në distanca më të vogla se 50 km, gjë që ka krijuar rrezik për pagesa të pajustifikuara dhe mospërputhje në trajtimin e punonjësve arsimorë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për inicimin e procedurave për rishikimin dhe harmonizimin e kuadrit nënligjor që rregullon kompensimin e transportit për punonjësit arsimorë, me qëllim eliminimin e mbivendosjeve dhe paqartësive interpretative, unifikimin e praktikave administrative dhe krijimin e një mekanizmi të qartë e të zbatueshëm për përcaktimin, dokumentimin dhe pagesën e kompensimit të shpenzimeve të transportit për punonjës arsimorë.

Brenda vitit 2026

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të emërimit të punonjësve të DRAP dhe ZVAP-ve u konstatua se punonjësit janë emëruar pa zhvilluar procedura konkurrimi, nëpërmjet kontratave të përkohshme me afat deri në përfundimin e procedurave konkurruese, ndërkohë që rezultoi se emërime të tilla të përkohshme vijojnë prej vitit 2004. Në fund të vitit 2024, në kuadër të procesit të ristrukturimit të institucioneve, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar ka nxjerrë urdhra të rinj emërimi për punonjësit e DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Vorë, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë, të cilët përsëri janë emëruar me karakter të përkohshëm, deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit. Megjithëse emërimet janë konsideruar të përkohshme dhe të kushtëzuara me zhvillimin e konkurrimit, rezultoi se deri në fund të vitit 2025 nuk janë ndërmarrë masa për hapjen e asnjë procedure konkurrimi për këto pozicione, në kundërshtim me pikën 13 dhe pikën 14 të VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *"Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar*", dhe nenin 4, 5, 6, 7 të Rregullores nr. 454, datë 13.09.2019 *"Për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj".*

Gjithashtu, u konstatua se edhe punonjësit e ZVAP-ve, të cilët kanë punuar në të njëjtin pozicion pune dhe në të njëjtin institucion me statusin e nëpunësit civil, por pas ndryshimeve të bëra me VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *"Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar",* i ndryshuar, kanë humbur statusin e nëpunësit civil, vazhdojnë të jenë të emëruar me akte provizore deri në zhvillimin e procedurave të konkurrimit, megjithëse kanë kaluar mbi 7 vite nga heqja e statusit të nëpunësit civil.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të përcjellin në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP) problematikën e konstatuar nga auditimi me qëllim marrjen e masa të menjëhershme për përfundimin e procedurave të konkurrimit dhe emërimin e punonjësve të cilët rezultojnë me akte të përkohshme emërimi.

Gjithashtu, AKAP të vlerësojë dhe të marrë masat e nevojshme administrative për sistemimin me kontrata pune pa afat (definitive), në përputhje me legjislacionin e punës në fuqi, të punonjësve të ZVAP-ve që i'u është hequr statusi i nëpunësit civil si pasojë e ndryshimeve organizative të miratuara me VKM nr. 99, datë 27.02.2019, të ndryshuar dhe vazhdojnë në të njëjtin pozicion pune.

Brenda vitit 2026

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, me shkresën nr. 4106, datë 30.12.2024, i ka kërkuar Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë zbatimin e pikës 4, Kreu VII, të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, duke marrë masa për sistemimin në punë të punonjësve që largohen nga detyra në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, në dy raste, procedura e sistemimit në punë nuk është kryer në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi:

- DRAP Tiranë ka marrë vendimin nr. 1, datë 08.01.2025 për emërimin definitiv të znj. A. K si mësuese e lëndës histori në shkollën *"Koreografike",* Tiranë. Në momentin e marrjes së këtij vendimi, znj. K. ushtronte funksionin e specialistes në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, në ZVAP Tiranë, për rreth 1 vit e 8 muaj, duke mos plotësuar kriterin e parashikuar për një eksperiencë minimale prej 3 vitesh në të njëjtin pozicion, në kundërshtim me

pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'*, i ndryshuar.
- Gjithashtu DRAP Tiranë ka marrë vendimin nr. 10, datë 07.04.2025, për emërimin definitiv të znj. G.K si mësuese e lëndës Matematikë në shkollën 9-vjeçare *"Ali Demi",* Tiranë. Në momentin e marrjes së këtij vendimi, znj. K., përfshirë edhe periudhën e lejes së lindjes ushtronte funksionin e specialistes në ZVAP Tiranë për rreth 2 vite, duke mos plotësuar kriterin e qëndrimit minimal prej 3 vitesh në të njëjtin pozicion, në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit nr. 8, datë 03.05.2024, *"Për procedurat e pranimit, pezullimit dhe largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë të marrë masat e nevojshme administrative duke vlerësuar mundësinë e ndërprerjes së emërimeve definitive dhe sistemimit të tyre me kontratë me afat të caktuar, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të punësimit nëpërmjet portalit *"Mësues për Shqipërinë",* në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Brenda vitit 2026

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se z. K.F është caktuar në funksionin e Nëpunësit Zbatues të përkohshëm për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, ndërkohë që nuk është punonjës i kësaj drejtorie, por punonjës i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, institucion në varësi të DRAP Tiranë. Gjithashtu, rezultoi se z. K.F ushtron njëkohësisht funksionin e Nëpunësit Zbatues si për DRAP Tiranë ashtu edhe për ZVAP Tiranë, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar. Referuar nenit 12, pika 2, shkronja "a" dhe pika 3, shkronja "b" të ligjit të sipërcituar, nëpunësi zbatues është përgjegjës për bashkërendimin e procesit të përgatitjes së buxhetit dhe përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit. Ndërkohë, sipas rregullores *"Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar",* Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në ZVAP harton projektbuxhetin e ZVAP-së dhe ia propozon DRAP-it, ndërsa DRAP harton projektbuxhetin e vet dhe konsolidon projektbuxhetet e njësive në varësi. Në këto kushte, caktimi i të njëjtit nëpunës zbatues në të dy institucionet krijon mbivendosje funksionesh dhe cenon parimin e ndarjes së detyrave, pasi i njëjti person përfshihet si në procesin e hartimit dhe propozimit të projektbuxhetit në ZVAP, ashtu edhe në procesin e shqyrtimit dhe konsolidimit të tij në DRAP. Kjo situatë dobëson mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar dhe rrit rrezikun e mungesës së pavarësisë në ushtrimin e funksioneve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë të marrë masa për ndërprerjen e ushtrimit të funksionit të Nëpunësit Zbatues nga z. K.F dhe emërimin e një nëpunësi zbatues nga struktura e DRAP Tiranë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në fund të vitit 2025, për 51 institucione arsimore nën juridiksionin e DRAP Tiranë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të institucionit. Për periudhën objekt auditimi, këto pozicione janë mbuluar nga drejtorë të komanduar, konkretisht për 27 shkolla në juridiksionin e ZVAP Tiranë, 9 shkolla në

juridiksionin e ZVAP Kamëz, 8 shkolla në juridiksionin e ZVAP Kavajë dhe 7 shkolla në juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë. Mos hapja e procedurave të konkurrimit dhe mos shpallja e vendeve vakante është në kundërshtim me Kreun I "Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar", neni 1, pika 1, shkronjat "a" dhe "b" të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor publik parauniversitar".*
Nga verifikimi i dokumentacionit të drejtorëve të komanduar rezultoi se 21 prej tyre nuk plotësojnë kushtet për ushtrimin e funksionit të drejtorit, të përcaktuara në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, pasi nuk janë të pajisur me certifikatën për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.
Gjithashtu, rezultoi se 2 drejtorë të komanduar në institucionet arsimore publike nën juridiksionin e ZVAP Kavajë nuk janë të pajisur me licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në kundërshtim me nenin 57, pika 5, shkronja "b" të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë të marrë masa për identifikimin dhe shpalljen e të gjitha vendeve vakante për pozicionin e drejtorit të institucioneve arsimore publike, me qëllim nisjen e procedurat e konkurrimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, deri në fund të vitit 2025, vijojnë të komanduar 90 nëndrejtorë shkollash, për të cilët nga drejtuesit e shkollave dhe drejtuesit e ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk janë hapur procedurat e konkurrimit, konkretisht:
- 68 nëndrejtorë të komanduar në shkollat që janë në juridiksionin e ZVAP Tiranë;
- 16 nëndrejtorë të komanduar në shkollat që janë në juridiksionin e ZVAP Kamëz;
- 4 nëndrejtorë të komanduar në shkollat që janë në juridiksionin e ZVAP Kavajë;
- 2 nëndrejtorë të komanduar në shkollat që janë në juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë.

Mos hapja e procedurave të konkurrimit dhe mos shpallja e vendeve vakante bie në kundërshtim me Kreun I *"Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar",* neni 1, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023 *"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit arsimor publik parauniversitar".*
Gjithashtu, nga auditimi rezulton se 32 nga nëndrejtorët e komanduar nuk plotësojnë kushtet për të ushtruar detyrën e nëndrejtorit, të përcaktuara në nenin 55, pika 3 të ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, pasi nuk janë të pajisur me certifikatën për drejtimin e institucioneve të arsimit parauniversitar.
Po ashtu, për periudhën objekt auditimi, për 26 pozicione nëndrejtorësh, drejtuesit e shkollave si dhe ZVAP Tiranë nuk kanë filluar procedurat për shpalljen e vendeve vakante për pozicionin e nëndrejtorit, në kundërshtim me përcaktimet e Kreut I *"Procedurat për emërimin e Drejtorit dhe Nëndrejtorit të Institucionit Publik Arsimor Parauniversitar*", neni 1, pika 2, shkronjat "a" dhe "b" të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 22, datë 13.11.2023, si dhe me pikat II.3 dhe III.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 10.07.2023 *"Për përcaktimin e*

numrit të nxënësve për klasë dhe ngarkesës mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1 Rekomandimi: ZVAP në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave të marrin masa të menjëhershme për hapjen e procedurave të konkurrimit për të gjitha pozicionet e nëndrejtorëve të komanduar dhe vendet vakante, duke siguruar zbatim të kërkesave ligjore për shpalljen publike, konkurrimin dhe verifikimin e kritereve të kualifikimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
5.2 Rekomandimi: DRAP në bashkëpunim me ZVAP, të analizojnë dhe të evidentojnë përgjegjësitë për krijimin e situatës së moszbatimit të procedurave ligjore në shpalljen e vendeve dhe emërimin e nëndrejtorëve.

Brenda vitit 2026

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të dosjeve për kualifikimin e mësuesve në ZVAP Tiranë, rezultoi se:
- në 13 raste për përfitimin e kategorisë *"mësues mjeshtër",* mësuesit nuk kanë përfituara kredite çdo vit dhe në 1 rast nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024 *"Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimor"* i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/i dhe c/ii.
- në 5 raste për përfitimin e kategorisë *"mësues i kualifikuar",* mësuesit nuk kanë përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
- në 1 rast për përfitimin e kategorisë *"mësues specialist"* mësuesi nuk ka përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
- në 1 rast punonjësi i ZVAP Tiranës ka përfituar kategorinë *"mësues mjeshtër"* pa pasur eksperiencë punë si mësuese, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 6 të Udhëzimit nr. 17, datë 22.07.2024, të ndryshuar.
Nga auditimi i vlerësimit të dosjeve për kualifikimin e mësuesve në ZVAP Kamëz rezultoi se:
- në 7 raste për përfitimin e kategorisë *"mësues mjeshtër",* mësuesit nuk kanë përfituara kredite çdo vit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
- në 5 raste për përfitimin e kategorisë *"mësues i kualifikuar",* mësuesit nuk kanë përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
- në 1 rast për përfitimin e kategorisë *"mësues specialist"* mësuesi nuk ka përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
Nga auditimi i vlerësimit të dosjeve për kualifikimin e mësuesve në ZVAP Vorë rezulton se:
- në 5 raste për përfitimin e kategorisë *"mësues mjeshtër",* mësuesit nuk kanë përfituara kredite çdo vit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
- në 4 raste për përfitimin e kategorisë "*mësues i kualifikuar*", mësuesit nuk kanë përfituar kredite çdo vit, ndërsa në 1 rast nuk ka pasur vitet e nevojshme të eksperiencës në punë si mësues, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
Nga auditimi i vlerësimit të dosjeve për kualifikimin e mësuesve në ZVAP Kavajë rezultoi se:
- në 7 raste për përfitimin e kategorisë "*mësues mjeshtër*", mësuesit nuk kanë përfituara kredite çdo vit dhe në 4 raste nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues

specialist në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
- në 1 rast për përfitimin e kategorisë "*mësues specialist*" mësuesi nuk ka përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
Nga auditimi i vlerësimit të dosjeve për kualifikimin e mësuesve në ZVAP Rrogozhinë rezulton se:
- në 5 raste për përfitimin e kategorisë "*mësues mjeshtër*", mësuesit nuk kanë përfituara kredite çdo vit dhe në 4 raste nuk është plotësuar kriteri i 15 viteve punë, nga të cilat 7 vite si mësues specialist në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii dhe c/i.
- në 1 rast për përfitimin e kategorisë "*mësues specialist*" mësuesi nuk ka përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, gërma b/ii.
- në 1 rast për përfitimin e kategorisë "mësues i kualifikuar", mësuesi nuk kanë përfituar kredite çdo vit në kundërshtim me Udhëzimin nr. 17, datë 22.07.2024, i ndryshuar, neni 6, pika 2, germa c/ii.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, në bashkëpunim me Komisionet e Kualifikimit të marrë masat e nevojshme për plotësimin e kushteve ligjore lidhur me kreditet e detyrueshme të zhvillimit profesional, vjetërsinë në punë dhe eksperiencën sipas kategorisë përkatëse, si dhe të forcojë kontrollet verifikuese për të garantuar zbatimin korrekt të procedurave të kualifikimit në të ardhmen.

Në vijimësi

7. Gjetje auditimi: Nga auditimi i zhvilluar në ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz, ZVAP Vorë, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë, lidhur me procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar, u konstatuan mangësi dhe parregullsi procedurale që kanë cenuar transparencën, gjurmueshmërinë, objektivitetin dhe respektimin e kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 22, datë 13.11.2023*"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"* dhe Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020*"Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të IPAP"*, si më poshtë:
- Në 20 raste procesverbalet e zhvillimit të procedurës nuk dokumentojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sindikatave dhe/ose përfaqësuesve të DRAP-it, në kundërshtim me kërkesat procedurale për garantimin e transparencës së procesit.
- Në 15 raste intervistat e kandidatëve janë zhvilluar në ambiente të tjera nga ato të parashikuara në udhëzim, konkretisht në gjimnazin "Sami Frashëri" ose shkollën "3 Dëshmorët", në kundërshtim me nenin 4, pika 6 të Udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023.
- Në 16 raste dokumentimi i intervistave rezultoi i paplotë, pasi procesverbalet dhe formularët nuk pasqyrojnë përgjigjet konkrete të kandidatëve, por vetëm pikët ose vlerësime të përgjithshme, duke mos garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri të plotë të procesit të vlerësimit.
- Në 9 raste për shkollat 9-vjeçare "Klodian Tanushi", "Ali Demi", "Yzberisht", "Mihal Grameno", "Fan S. Noli", "Kushtrimi i Lirisë", "Jashar Hoxha", "Lidhja e Prizrenit" dhe "Gosë" nuk janë administruar vlerësimet individuale i secilit anëtar të komisionit për intervistat, por vetëm një vlerësim ose rezultat i përbashkët.
- Në 10 raste për shkollat 9-vjeçare "Hasan Prishtina", "Gustav Mayer", "John F. Kennedy", "Alush Bardhi", "Eqerem Çabej", "Jashar Hoxha", "Lidhja e Prizrenit", "Picar", "Isa Boletini"

Vorë dhe "Gosë" u konstatuan vlerësime të paargumentuara, korrigjime ose zbatim jo të njëtrajtshëm të kritereve të pikëzimit, të cilat kanë ndikuar në renditjen e kandidatëve dhe kanë cenuar objektivitetin e procesit të përzgjedhjes.
- Në 8 raste u konstatuan mbivlerësime ose nënvlerësime të pajustifikuara të dokumentacionit të kandidatëve, përfshirë vlerësime të gabuara për gjuhët e huaja, trajnimet, kualifikimet, notën mesatare dhe përvojën drejtuese.
- Në 7 raste për shkollat 9-vjeçare "Ali Demi", "Mihal Grameno", "Picar", "Isa Boletini" Vorë, "Jashar Hoxha", "Lidhja e Prizrenit" dhe "Gosë" procesi i zgjedhjes së mësuesve anëtarë të komisionit nuk është dokumentuar në mënyrë të plotë, pasi mungojnë prova për zhvillimin e votimit të fshehtë, rezultatin e votimit, numrin e votuesve ose procedura është kufizuar vetëm në kandidatë të propozuar.
- Në 5 raste për shkollat 9-vjeçare "Hasan Prishtina", "Gustav Mayer", "Jashar Hoxha", "Picar" dhe "Herbert", juristët e ZVAP-së nuk kanë identifikuar parregullsitë e evidentuara gjatë auditimit dhe kanë konsideruar procedurat si të rregullta, duke i përcjellë në nivelet pasuese të shqyrtimit.
- Në 3 raste për shkollat 9-vjeçare "Jashar Hoxha", "Lidhja e Prizrenit" dhe Gjimnazi "Elez Isuf Ndreu" kandidatët janë trajtuar në mënyrë jo të njëjtë gjatë procesit të kualifikimit dhe intervistimit, duke përfshirë lejimin e kandidatëve të skualifikuar në faza të mëtejshme ose mangësi në verifikimin e dokumentacionit.
- Në 3 raste për shkollat 9-vjeçare "Jashar Hoxha", "Lidhja e Prizrenit" dhe Gjimnazi "Elez Isuf" intervistat e zhvilluara nga DRAP Durrës janë realizuar jashtë afatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 22, datë 13.11.2023.
- Në 3 raste për shkollat 9-vjeçare "Picar", "Isa Boletini" Vorë dhe "Jashar Hoxha", janë emëruar fitues kandidatë që nuk disponoin certifikatën e drejtuesit dhe emërimi i tyre në pozicionin e drejtorit, nga Drejtori i DRAP Durrës është kryer definitive dhe jo me afat 1-vjeçar, në kundërshtim me kërkesat ligjore.
Në përfundim, problematikat e konstatuara tregojnë mangësi të përsëritura në zbatimin e procedurave të përzgjedhjes së drejtuesve, veçanërisht në drejtim të dokumentimit të veprimeve procedurale, garantimit të konkurrencës së barabartë ndërmjet kandidatëve, argumentimit të pikëzimeve dhe kontrollit paraprak të ligjshmërisë nga strukturat përgjegjëse të ZVAP-ve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1 Rekomandim: ZVAP-të të marrin masa për forcimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së procedurave të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar, duke garantuar zbatimin rigoroz të kërkesave ligjore dhe nënligjore. Të sigurohet dokumentimi i plotë dhe i verifikueshëm i çdo faze të procedurës, vlerësimi objektiv dhe i argumentuar i kandidatëve, si dhe evidentimi e korrigjimi në kohë i çdo parregullsie përpara përcjelljes së dokumentacionit në DRAP.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të personelit mësimor u konstatua se 221 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Tiranë, 36 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Kamëz, 12 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Kavajë, 11 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Vorë dhe 4 mësues në institucionet arsimore nën juridiksionin e ZVAP Rrogozhinë ushtrojnë profesionin e mësuesit pa qenë të pajisur me licencën për ushtrimin e profesionit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 57, pika 5, i ligjit nr. 69/2012 *"Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në bashkëpunimin me institucionet e arsimit parauniversitar të marrin masa për verifikimin e statusit të licencimit të të gjithë mësuesve në marrëdhënie pune dhe për rastet e konstatuara pa licencë të kërkojë pajisjen me licencë, në testimin e ardhshëm për licencim. Gjithashtu, të krijohen mekanizma periodikë kontrolli dhe monitorimi për verifikimin e dokumentacionit ligjor të personelit mësimor, me qëllim garantimin që punësimi dhe ushtrimi i profesionit të mësuesit të kryhet vetëm nga individë që plotësojnë të gjitha kriteret ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në kreun IV *"Procedura e zgjedhjes së vendit të punës dhe emërimi i mësuesve"*, pika 4 e Udhëzimit nr. 8, datë 03.07.2024 *"Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë"*, parashikohet se në mungesë të kandidatëve të profilit arsim special për mësues ndihmës, mund të punësohen me kontratë me afat deri në përfundim të vitit shkollor, me të drejtë rinovimi të saj, kandidatë nga Portali "Mësues për Shqipërinë", të të gjitha profileve, duke rritur riskun e cilësisë së shërbimit arsimor të ofruar ndaj nxënësve me aftësi ndryshe.
Konkretisht nga auditimi janë konstatuar:
- për vitin 2025 rezultojnë 721 mësues në shkollat e ZVAP Tiranë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 284 ose 39.4% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
- për vitin shkollor 2022-2023, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 57 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 11 mësues janë të profilit "arsim special" ose 19% e tyre, ndërsa 81% janë mësues jashtë profilit. Për vitin shkollor 2023-2024, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 61 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 14 mësues janë të profilit "arsim special" ose 23% e tyre, ndërsa 77% janë mësues jashtë profilit. Për vitin shkollor 2024-2025, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 69 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 24 mësues janë të profilit "arsim special" ose 35% e tyre, ndërsa 65% janë mësues jashtë profilit. Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Kamëz rezultojnë 78 mësues të angazhuar në arsimin special, nga të cilët 28 mësues janë të profilit "arsim special" ose 36% e tyre, ndërsa 64% janë mësues jashtë profilit.
- Për vitin shkollor 2022-2023 rezultojnë 18 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta vetëm 1 mësues ose 5.6% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special. Për vitin shkollor 2023-2024 rezultojnë 24 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 5 mësues ose 20.8% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special. Për vitin shkollor 2024-2025 rezultojnë 25 mësues në shkollat e ZVAP Vorë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 7 mësues ose 28% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa pjesa tjetër janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
- për vitin 2025 rezultojnë 36 mësues në shkollat e ZVAP Kavajë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 14 ose 39% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa 61% janë mësues jashtë profilit të arsimit special.
- për vitin shkollor 2022-2023 rezultojnë 13 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, ku të gjithë mësuesit rezultojnë jashtë profilit. Për vitin shkollor

2023-2024 rezultojnë 14 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, ku të gjithë mësuesit rezultojnë jashtë profilit. Për vitin shkollor 2024-2025 rezultojnë 15 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 3 mësues ose 20% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa 80% janë jashtë profilit të arsimit special. Për vitin shkollor 2025-2026 rezultojnë 16 mësues në shkollat e ZVAP Rrogozhinë të cilët janë të angazhuar në arsimin special, nga këta 5 mësues ose 31% e mësues janë mësues të profilit "arsimit special", ndërsa 69% janë jashtë profilit të arsimit special.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Ministria e Arsimit në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të arsimit parauniversitar, të rishikojë mundësinë e kufizimit të emërimit të mësuesve ndihmës jashtë profilit "Arsim Special" vetëm si masë përjashtimore dhe të përkohshme.

Gjithashtu, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e masave konkrete për rritjen graduale të përqindjes së mësuesve me profil *"Arsim Special"* në institucionet arsimore, përfshirë planifikimin e nevojave për personel, nxitjen e formimit universitar në këtë profil dhe detyrimin për trajnime të specializuara e certifikim të mësuesve të emëruar jashtë profilit, me synim garantimin e cilësisë së shërbimit arsimor dhe mbështetjes efektive për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurave të ndjekura për punësimin e mësuesve nëpërmjet portalit *"Mësues për Shqipërinë",* u konstatuan mangësi në drejtim të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së procesit të përzgjedhjes nga ana e Zyrave Vendore Arsimore.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se procesi i përzgjedhjes nuk shoqërohet me dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme që të pasqyrojnë në mënyrë të plotë, të qartë dhe të verifikueshme gjithë rrjedhën e konkurrimit. Konkretisht, nuk evidentohet mbajtja e një procesverbali të detajuar që të përfshijë të gjithë kandidatët pjesëmarrës në procedurë, ndërkohë që mungon gjithashtu dokumentimi i rasteve të refuzimit të pozicionit apo të mosparaqitjes së kandidatëve të renditur.

Një tjetër element i konstatuar lidhet me kohën e hartimit dhe formalizimit të procesverbaleve. Rezultoi se procesverbalet janë mbajtur, në përgjithësi, në orën e përcaktuar në njoftimet e bëra në rrugë elektronike, pa u lënë një interval kohor i arsyeshëm për të marrë në konsideratë edhe kandidatët që mund të paraqiten me vonesë të arsyeshme.

Si përfundim, praktikat aktuale të ndjekura nuk sigurojnë gjurmueshmëri të plotë të procesit të përzgjedhjes dhe nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për një vendimmarrje të dokumentuar, transparente dhe të verifikueshme, në kundërshtim me kreun I, pikën 3 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit *"Mësues për Shqipërinë"*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Zyrat Vendore Arsimore të forcojnë procedurat e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë së procesit të përzgjedhjes së mësuesve nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë", duke siguruar hartimin e procesverbaleve të detajuara për çdo fazë të konkurrimit, ku të evidentohen të gjithë kandidatët pjesëmarrës, si dhe rastet e refuzimit të pozicionit, mosparaqitjes apo çdo ndryshimi në renditje.

Gjithashtu, të përcaktohet një interval kohor i arsyeshëm ndërmjet thirrjeve për përzgjedhje dhe formalizimit të procesverbaleve, me qëllim garantimin e pjesëmarrjes së plotë të kandidatëve dhe shmangien e situatave që mund të cenojnë transparencën e procesit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në 53 raste në ZVAP Tiranë, në 3 raste në ZVAP Vorë dhe në 8 raste në ZVAP Rrogozhinë janë punësuar mësues jashtë profilit, pra profili për të cilin aplikanti ka lidhur kontratën provizore nuk përputhet me lëndën për të cilën është diplomuar.Kjo situatë paraqet një risk të lartë për cenimin e transparencës dhe integritetit të procesit të rekrutimit, duke krijuar mundësi për përzgjedhje jo objektive dhe trajtim të pabarabartë të kandidatëve, veçanërisht ndaj kandidatëve që ndodhen në pritje në portalin "Mësues për Shqipërinë". Mospërputhja ndërmjet profilit të diplomimit dhe lëndës së zhvilluar në mësimdhënie rrit rrezikun e uljes së cilësisë së procesit arsimor dhe mosgarantimit të standardeve profesionale në sistemin parauniversitar.
Gjithashtu, mangësitë në verifikimin e kritereve dhe dokumentacionit të kandidatëve evidentojnë dobësi në mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe në administrimin e procedurave të punësimit, duke krijuar ekspozim ndaj praktikave që nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara për emërimin e personelit mësimor. Këto veprime ndikojnë negativisht në besueshmërinë e procesit të rekrutimit, në parimin e meritokracisë dhe në garantimin e një sistemi të drejtë dhe të standardizuar të përzgjedhjes së personelit arsimor.
Këto praktika bien në kundërshtim me pikën 4 të nenit 57 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "*Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar, si dhe me shtojcën 1 të Udhëzimit nr. 14, datë 10.7.2023 *"Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë".*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1 Rekomandimi: DRAP në bashkëpunim me ZVAP-të përkatëse të marrin masa për garantimin e përputhshmërisë së profilit të diplomimit me lëndën e punësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, të sigurojë verifikimin e plotë të dokumentacionit të kandidatëve para lidhjes së kontratës provizore, me qëllim parandalimin e rasteve të punësimit jashtë profili dhe sigurimin e respektimit të parimit të meritokracisë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë për vitin 2025 u konstatua sa vijon:
- Nuk është miratuar një rregullore e brendshme që të përcaktojë veprimtarinë, procedurat dhe afatet për monitorimin e institucioneve të arsimit parauniversitar nga Drejtoria e Inspektimit dhe Kurrikulës.
- Gjatë periudhës janar–tetor 2025, DRAP Tiranë nuk ka kryer inspektime duke mos përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në pikën 5 dhe 6 të nenit 21 të Rregullores nr. 153, datë 17.04.2025*"Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar".* Kjo për shkak se punonjësit e emëruar si inspektorë pranë DRAP Tiranë, deri në muajin tetor 2025, nuk kanë qenë të pajisur me kartën e inspektorit, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 38 të ligjit nr. 99/2024 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 253-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë të hartojë dhe miratojë një rregullore të brendshme për përcaktimin e procedurave, metodologjisë, përgjegjësive dhe afateve të inspektimit/monitorimit të institucioneve të arsimit parauniversitar, me qëllim garantimin e një procesi të unifikuar dhe efektiv inspektimi/monitorimi.

Brenda vitit 2026

12.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të marrin masa për nxjerrjen e përgjegjësive lidhur me emërimin e punonjësve në Drejtorinë e Inspektimit dhe Kurrikulës, DRAP Tiranë, të cilët nuk kanë plotësuar kriteret për të ushtruar funksionin e inspektimit, duke sjellë si pasojë mos përmbushjen e detyrave funksionale të kësaj drejtorie gjatë periudhës janar–tetor 2025.

Brenda vitit 2026

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi inspektimet e kryera nga DRAP Durrës për periudhën 2022–2024 u konstatuan sa vijon:
- Në 2 raste nuk është propozuar masë disiplinore ndaj Drejtorit të institucionit arsimor, megjithëse niveli i problematikave të evidentuara ka qenë i ngjashëm me rastet e tjera ku është propozuar një masë e tillë. Konkretisht, bëhet fjalë për inspektimin e kryer në vitin 2022 në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Ahmet Boja", Kasallë, si dhe për inspektimin e kryer në vitin 2024 në shkollën 9-vjeçare jopublike "N", Mëzez, Tiranë.
- Në 2 raste të tjera, konkretisht gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2024 në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Feti Vogli", Baldushk, Tiranë dhe në gjimnazin "Sadi Nuri", Ndroq, Tiranë, u konstatua se, megjithëse raportet e inspektimit kanë evidentuar problematika, grupi inspektues nuk ka përcaktuar rekomandime konkrete të shoqëruara me afate për zbatimin e tyre.
- Në inspektimin e kryer në vitin 2023 në shkollën 9-vjeçare "Pal Zefi", Durrës, u konstatua se gjetjet e grupit të inspektimit janë kryesisht përshkruese, ndërsa rekomandimet nuk rezultojnë të strukturuara plotësisht dhe të orientuara qartë drejt adresimit të problematikave të evidentuara.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 253-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1 Rekomandimi: DRAP Durrës të marrë masa për unifikimin e praktikës së vlerësimit dhe trajtimit të gjetjeve të inspektimeve, duke siguruar që masat disiplinore të propozohen në mënyrë të njëjtë për raste me problematika të ngjashme. Gjithashtu, të garantohet që raportet e inspektimit të përmbajnë gjetje të qarta, të argumentuara dhe rekomandime konkrete, të matshme dhe të shoqëruara me afate zbatimi, me qëllim rritjen e efektivitetit të procesit të inspektimit dhe monitorimin e zbatimit të masave përmirësuese.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i monitorimeve të kryera nga DRAP Tiranë gjatë vitit 2025 u konstatuan mangësi në cilësinë e procesit të monitorimit, të cilat lidhen me mosverifikimin e plotë të objektit të monitorimit, mungesën e rekomandimeve konkrete dhe të zbatueshme, si dhe mosadresimin e çështjeve me ndikim financiar. Konkretisht:
- Në një rast monitorimi të kryer për verifikimin e një ankese me objekt procedurën e punësimit me kontratë pune në shkollën 9-vjeçare "George Soros", Rrogozhinë, grupi i monitorimit nuk ka realizuar verifikimin e plotë të objektit të ankesës. Gjithashtu, raporti i monitorimit nuk përmban rekomandime konkrete lidhur me procedurën e punësimit, duke vështirësuar ndjekjen dhe verifikimin e zbatimit të tyre.
- Në një rast monitorimi të kryer për verifikimin e një ankese lidhur me menaxhimin e shkollës 9-vjeçare "1 Maji", Tiranë, grupi i monitorimit nuk ka formuluar rekomandime konkrete dhe të matshme, duke ulur efektivitetin e raportit të monitorimit dhe duke vështirësuar ndjekjen e zbatimit të tyre. Gjithashtu, një nga rekomandimet e dhëna rezultoi në kundërshtim me konkluzionet e vetë grupit të monitorimit, duke krijuar paqartësi në interpretim dhe vështirësi në zbatimin e tij.
- Në katër monitorime të kryera në kopshtet e qytetit të Tiranës, konkretisht në kopshtin nr. 65 "Borëbardha", kopshtin "Yjet", kopshtin nr. 41 dhe kopshtin nr. 22 "Kuriozët e Vegjël", grupi i

monitorimit ka konstatuar se drejtuesit e institucioneve nuk kanë realizuar ngarkesën e plotë të punës, si në drejtim të orëve mësimore ashtu edhe të procesit të vlerësimit. Megjithatë, pavarësisht këtij konstatimi, nuk është verifikuar nëse pagesa e tyre është kryer në përputhje me ngarkesën faktike të realizuar dhe nuk është rekomanduar kryerja e këtij verifikimi nga strukturat përgjegjëse. Mos verifikimi i përputhshmërisë së pagesës me ngarkesën faktike të punës krijon risk për kryerjen e pagesave të padrejta ose në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke rritur mundësinë e përdorimit joefektiv të fondeve publike dhe duke dobësuar efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 253-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1 Rekomandimi: Titullari i DRAP Tiranë të marrë masa për rritjen e cilësisë së procesit të monitorimit dhe të raporteve të monitorimit, duke siguruar kryerjen e verifikimeve të plota dhe në përputhje me objektin e monitorimit, si dhe hartimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të qarta, konkrete, të matshme dhe të harmonizuara me njëra-tjetrën, me qëllim garantimin e efektivitetit të procesit, ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe forcimin e kontrollit të brendshëm në institucionet objekt monitorimi.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimet e kryera nga ZVAP Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, për periudhën 2022-2025, u konstatua sa vijon:
- Përsa i përket monitorimeve të kryera nga ZVAP Tiranë: gjetjet paraqiten kryesisht përshkruese dhe nuk analizojnë në mënyrë të mjaftueshme ndikimin dhe risqet që rrjedhin nga problematikat e konstatuara; rekomandimet e dhëna nuk janë plotësisht në përputhje me gjetjet e evidentuara gjatë procesit të monitorimit, nuk përcaktojnë masa konkrete dhe përgjegjësi të qarta për zbatim dhe jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me afate të përcaktuara për zbatimin e tyre, duke vështirësuar në këtë mënyrë ndjekjen dhe monitorimin e zbatueshmërisë së tyre.
- Përsa i përket monitorimeve të kryera nga ZVAP Kamëz: Kryesisht, për periudhën 2022–2023, monitorimet paraqesin mangësi në cilësinë e rekomandimeve të dhëna. Ato rezultojnë të përgjithshme dhe nuk përcaktojnë afate të qarta për zbatimin e tyre, çka vështirëson ndjekjen dhe verifikimin e zbatueshmërisë.
Gjithashtu, u konstatua mungesë e lidhjes konkrete midis gjetjeve dhe rekomandimeve, gjë që ul efektivitetin e tyre në adresimin e problematikave të identifikuara. Në disa raste, rekomandimet nuk janë të plota, nuk janë të drejtpërdrejta dhe nuk sigurojnë trajtimin e plotë të çështjeve të konstatuara, ndërsa në raste të veçanta mungojnë tërësisht rekomandimet përkatëse.
Po ashtu, në disa raporte vërehet se rekomandimet nuk janë të mbështetura në gjetjet e raportuara, përfshirë edhe raste kur janë dhënë rekomandime pa u evidentuar më parë problematikat përkatëse në pjesën e konstatimeve. Në një pjesë të monitorimeve konstatohet gjithashtu mungesë e afateve për zbatueshmërinë e rekomandimeve, duke kufizuar më tej ndjekjen dhe monitorimin e tyre në vijim.
- Përsa i përket monitorimeve të kryera nga ZVAP Vorë: u konstatua një numër shumë i kufizuar raportesh monitorimi, të cilat nuk kanë mbuluar në mënyrë të plotë të gjitha institucionet arsimore. Kjo situatë paraqet risk të shtuar në lidhje me efektivitetin dhe vazhdimësinë e monitorimit të këtyre institucioneve. Për më tepër, raportet e realizuara rezultojnë kryesisht përshkruese dhe nuk shoqërohen me evidenca mbështetëse të mjaftueshme, çka dobëson besueshmërinë e konkluzioneve të arritura. Në rastet kur janë lënë rekomandime, nuk është vendos afat për zbatimin e tyre.

- Përsa i përket monitorimeve të kryera nga ZVAP Kavajë: Procesi i monitorimeve gjatë periudhës së vlerësuar paraqet mangësi të rëndësishme në dokumentim, analizë dhe ndjekje. Megjithëse janë përdorur listë-verifikime dhe janë kryer vizita monitoruese, mungon në mënyrë të vazhdueshme hartimi i raporteve të plota që të përfshijnë gjetjet, analizën dhe rekomandimet e detajuara.
Në shumë raste, rekomandimet janë të përgjithshme, jo specifike dhe pa hapa konkretë, ndërsa lidhja midis gjetjeve dhe masave të propozuara është e dobët ose e pamjaftueshme. Po ashtu, gjetjet shpesh janë të paqarta dhe të pambështetura me evidenca të mjaftueshme, duke dobësuar bazën analitike të raporteve. Gjithashtu, vërehet mungesë e trajtimit të disa aspekteve operacionale të rëndësishme dhe një cikël jo i plotë monitorim. Në tërësi, këto mangësi ulin efektivitetin e monitorimeve si instrument për përmirësimin e cilësisë së menaxhimit dhe funksionimit të institucioneve arsimore.
- Përsa i përket monitorimeve të kryera nga ZVAP Rrogozhinë, nga shqyrtimi i raporteve të monitorimit 2022–2025 evidentohet problematikë e përsëritur në menaxhimin e dokumentacionit shkollor, ku plan-ditarët dhe regjistrat shpesh nuk plotësohen në mënyrë të rregullt, të plotë dhe sipas standardeve zyrtare. Vërehen mangësi në dokumentim, si mungesa e temave mësimore, rubrikave të paplotësuara, korrigjime të palejuara dhe dokumentacion i papërditësuar.
Gjithashtu, u konstatua mungesë e planifikimit të diferencuar për nxënësit me nevoja të veçanta dhe zbatim i pamjaftueshëm i mësimdhënies së diferencuar, si dhe mangësi në kontrollin administrativ të dokumentacionit nga drejtuesit.
Në nivel metodologjik, raportet paraqesin dobësi, pasi rekomandimet shpesh nuk lidhen drejtpërdrejt me gjetjet, janë të përgjithshme dhe pa afate apo përgjegjësi të qarta. Në tërësi, situata tregon nevojë për përmirësim të dokumentacionit, forcim të kontrollit të brendshëm dhe rritje të cilësisë së procesit të monitorimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 253-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1 Rekomandimi: ZVAP Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë të marrin masa për:
- përmirësimin e qasjes së përgatitjes së raportimit nga përshkrues në analitik, duke siguruar që çdo gjetje të shoqërohet me analizë të shkaqeve, vlerësim të riskut dhe ndikimit të tyre;
- përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve me qëllim që të jenë sa më specifike, të matshme dhe të drejtpërdrejta, të lidhura qartë me gjetjet përkatëse, të shmangin formulimet e përgjithshme dhe me afate konkrete për zbatimin e tyre.
- rritjen e mbulimit dhe planifikimit të monitorimeve, me qëllim përfshirjen e të gjitha institucioneve arsimore apo tematikave në mënyrë të vijueshme.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve për pagesat e librave shkollorë rezultoi se kontratat e lidhura nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë me botuesit dhe shpërndarësit nuk janë të protokolluara. Gjithashtu, kontratat e lidhura me shpërndarës ose persona fizikë nuk kanë të bashkëlidhur autorizimet e lëshuara nga botuesit apo distributorët, të cilët janë përcaktuar në Katalogun e Teksteve Shkollore për vitin shkollor 2025–2026, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit me urdhrin nr. 128, datë 27.03.2025, *"Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore për klasat 1, 2, 3, 5, 10, 11 dhe 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2025–2026".* Për periudhën 2022–2025, në 24 raste, me vlerë totale 97,715,944 lekë, faturat tatimore janë likuiduar jashtë afatit 30-ditor, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqet nr. 253-297 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë të marrë masa për forcimin e kontrollit të procedurave administrative dhe financiare, duke garantuar administrimin e rregullt të dokumentacionit kontraktor dhe financiar, ruajtjen e autorizimeve përkatëse për shpërndarësit e teksteve shkollore, si dhe respektimin e afateve ligjore të pagesave.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DRAP Tiranë për vitin 2025 në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar 14 procedura prokurimi me fond limit 30,451,387 lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor nga njësia e prokurimit janë realizuar 5 procedura me fond limit 3,627,629 lekë ose 12% të fondit të parashikuar. DRAP Durrës për vitin 2024 në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar 22 procedura prokurimi me fond limit 24,793,701 lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor ka realizuar 11 procedura me fond limit 17,294,431 lekë ose realizuar 70% të fondit të parashikuar. Për vitin 2023 në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike ka parashikuar 22 procedura prokurimi me fond limit të parashikuar 28,280,328 lekë, nga të cilat gjatë vitit buxhetor ka realizuar 12 procedura me fond limit 13,372,808 lekë ose realizuar 47% të fondit të parashikuar.
Për vitin 2022 autoriteti kontraktor nuk paraqiti të dhëna për regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike. Për ketë vit buxhetor AK ka realizuar 2 procedura me fond limit 9,113,123 lekë. Mos realizimi i procedurave të prokurimit sipas parashikimit bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 pika 1, 2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, sipas të cilit autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për hartimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, i cili duhet të synojë planifikimin e mirë të përdorimit të fondeve publike dhe planifikimin e realizimin në kohë të procedurave të prokurimit publik.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës të marrin masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të procedurave të prokurimit publik, në mënyrë që parashikimet vjetore të bazohen në nevoja reale dhe të realizueshme, si dhe të forcohen mekanizmat e ndjekjes së realizimit të procedurave dhe përdorimit të fondeve publike, me qëllim rritjen e eficiencës, realizimin në kohë të prokurimeve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Rezulton se printimi i manualeve të lëndës "Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), për t'u përdorur nga mësuesit dhe nxënësit është bërë në muajin dhjetor 2025, ose 4 muaj pas fillimit të vitit shkollor 2025-2026 në kundërshtim me kërkesat e nenit 7.1.a të Udhëzimit të Përbashkët nr. 20, datë 13.01.2025 "*Për vitin shkollor 2025–2026 në sistemin arsimor parauniversitar"*. Vonesat në printimin e Manualeve nuk lidhen me mosparashikimin e saktë nga autoriteti kontraktor, por me procedurën e ndjekur nga Ministria e Arsimit për pajisjen me Manuale të lëndës TIK vetëm për klasat e para dhe të dyta, të cilat duhet të ishin në dispozicion të përdoruesve me fillimin e vitit shkollor 2025-2026, njësoj si tekstet e tjera shkollore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar të koordinojë me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Ministrinë e Arsimit për përcaktimin e nevojave dhe nisjen e procedurave të prokurimit në periudhën e duhur, në mënyrë që Manualet e lëndës TIK të

jenë të disponueshme në fillim të vitit shkollor për zhvillimin e orës mësimore të lëndës TIK për klasat nga e para deri në të nëntën.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit procedurës së prokurimit "Printimi i manualeve të mësuesve dhe nxënësve për klasën e parë, të dytë dhe të tretë për lëndën TIK" rezultoi se komisioni i marrjes në dorëzim nuk ka hartuar Raport Përmbledhës për Zbatimin e Kontratës në kundërshtim me nenin 2 pika 2 gërma ll) të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Gjithashtu komisioni nuk ka përgatitur formularin e raportimit për zbatimin e kontratës, i cili, pasi miratohet nga titullari dhe i përcillet APP-së, në kundërshtim me nenin 107 pika 6 germa f) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1.Rekomandimi: DRAP Tiranë të marrë masa për forcimin e procedurave të administrimit, dokumentimit dhe monitorimit të procesit të zbatimit të kontratave, duke siguruar që dokumentacioni përkatës të hartohet i plotë dhe të dokumentojë në mënyrë të qartë realizimin e detyrimeve kontraktore, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë, përgjegjshmërisë dhe plotësisë së dokumentacionit administrativ.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se relacioni për titullarin nr. 1442 prot, datë 19.09.2025 *"Argumentimi i nevojave, relacion shpjegues mbi pasurimin e bibliotekës së institucioneve arsimore parauniversitare publike, nën juridiksionin e DRAP Tiranë*", nuk përmban listën përfundimtare të gjeneruar nga SMIP për titujt e përzgjedhur nga IAP-et dhe ZVAP-et, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit të MAS nr. 200, datë 07.05.2024 "*Për miratimin e rregullores për pasurimin e bibliotekës së institucionit arsimor parauniversitar publik*", i ndryshuar si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, sipas të cilit AK, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit duhet të argumentojë dhe dokumentojë përllogaritjen e fondit limit, duke përcaktuar dokumentacionin përkatës mbi vlerën e përllogaritur të fondit limit. Gjithashtu, një kopje e tyre duhet t'i bashkëlidhet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka përcjellë në DRAP shkresën nr. 3699/1 prot., datë 24.06.2025 me objekt transferimin e fondit për shpenzime kapitale për librin artistik me të drejtë autori dhe domen publik, në vlerën totale 7,135,000 lekë. Libri artistik për pasurimin e bibliotekave është ndarë në dy kategori, përkatësisht libri artistik me të drejtë autori, ku kërkohet certifikata e së drejtës së autorit dhe libri artistik në domen publik, i cili mund ta përdoret, shpërndahet, botohet ose përshtatet pa pasur nevojë për leje apo certifikatë të së drejtës së autorit. Përzgjedhja e procedurës së prokurimit është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Procedura e prokurimit për librin artistik, me fond limit 6,722,600 lekë (pa TVSH), është zhvilluar nga OBP, ndërsa procedura për librin me domen publik, me fond limit 383,320 lekë

(pa TVSH) është zhvilluar nga DRAP Tiranë nëpërmjet procedurës së prokurimit "Blerje e Vogël". Këto 2 procedura përbëjnë grup mallrash të ngjashme dhe për rrjedhojë përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" për prokurimin e librave me domen publik, me fond limit 383,320 lekë (pa TVSH) është në kundërshtim me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar dhe me pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 5 "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", datë 25.06.2021, sipas së cilës përdorimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të shërbejë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
21.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të planifikimit dhe prokurimit, të marrë masa për identifikimin dhe grupimin e mallrave/shërbimeve të ngjashme në fazën e planifikimit dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit, me qëllim shmangien e fragmentimit të procedurave të prokurimit.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi procedurës së prokurimit me vlerë të vogël për librin artistik me domen publik, me ofertë në vlerën 344,988 lekë, zhvilluar nga DRAP Tiranë, u konstatua se ftesa për ofertë e operatorit ekonomik "P.R" mban datën 01.10.2025, ndërsa dokumentacioni përkatës lidhur me procedurën është ngarkuar në SPE më datë 02.10.2025, ndërkohë që dokumentacionit pranë AK është paraqitur më datë 06.10.2025, në kundërshtim me parashikimet e ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025 dhe pikën 16 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021 *"Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*". Nga auditimi u konstatua se nuk ka gjurmë dokumentare që provojnë dorëzimin e mostrave të kërkuara për të gjithë artikujt e listës së titujve të librave me domen publik, në kundërshtim me kërkesat e ftesës për ofertë nr. 1475, datë 24.09.2025, sipas së cilës operatori ekonomik i renditur i pari, përpara shpalljes fitues, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor mostrat për secilin artikull, si dhe në kundërshtim me pikën 10 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021, ***"****Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike****"***. Gjithashtu, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik fitues "P.R" nuk përmban numër dhe datë protokolli të DRAP Tiranë, duke mos krijuar gjurmë administrative mbi marrjen dhe administrimin e dokumentacionit, në kundërshtim me pikën 17 të Udhëzimit të APP nr. 5, datë 25.06.2021, "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"*.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
22.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë të marrë masa për përmirësimin e administrimit dhe monitorimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, duke siguruar respektimin e afateve procedurale, administrimin dhe evidentimin e plotë të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë, si dhe dokumentimin e çdo faze të procesit, përfshirë dorëzimin dhe verifikimin e mostrave. Gjithashtu, të sigurojë krijimin e gjurmës administrative të plotë për çdo dokument të paraqitur, me qëllim rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe shmangien e përsëritjes së parregullsive në zhvillimin e procedurave.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Kontraktor, DRAP Durrës, në procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje paraprake, për librat artistike me të drejtë autori, për përzgjedhjen e OE të ftuar nuk ka mbajtur Proces verbal, në kundërshtim me pikën 6 paragrafi

dytë të Udhëzimit nr. 6 datë 16.07.2021*"Mbi përdorimin e procedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*".
DRAP Durrës, në procesverbalin nr. 1847/45, datë 28.10.2024, për përcaktimin e titujve të librave, pasi ka administruar listat e titujve të përzgjedhur, të gjeneruara nga SMIP dhe të përcjella nga ZVAP-të përkatëse, ka hartuar vetëm një listë të shtëpive botuese me numrin e titujve të librave të pajisur me certifikatë të së drejtës së autorit. Në këtë dokumentacion nuk janë evidentuar titujt konkretë të librave dhe as certifikatat përkatëse të vlefshme të së drejtës së autorit për secilin titull sipas shtëpive botuese, në kundërshtim me pikën 11 të Udhëzimit të MAS nr. 200, datë 07.05.2024, "*Për miratimin e rregullores për pasurimin e bibliotekës së institucionit arsimor parauniversitar publik"* dhe nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021*"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se procesverbali nr. 1847/44, datë 28.10.2024, i mbajtur nga Sekretaria, për kthim përgjigje të email-ve të ardhura nga shtëpitë botuese mbi kërkesën për përcaktimin e titujve të bibliotekës ku kërkohet lista e çmimeve dhe certifikata e regjistrimit të kalimit të të drejtave për titujt e secilës shtëpi botuese, nuk përmban nënshkrimet përkatëse, ndërsa grupi i punës nuk rezultoi të jetë ngritur me urdhër të Titullarit për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi. Kjo situatë është në kundërshtim me pikën 1 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
23.1 Rekomandimi: DRAP Durrës të sigurojë dokumentim të plotë, të verifikueshëm dhe të nënshkruar për çdo fazë të procedurës së prokurimit, duke përfshirë listat e titujve konkretë me certifikatat përkatëse të së drejtës së autorit, ngritjen e grupit të punës me urdhër zyrtar, si dhe argumentimin e qartë të vlerës së kontratës mbi bazën e specifikimeve teknike dhe kërkesave të gjeneruara nga SMIP, në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e prokurimit publik.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit "*Negocim pa shpallje paraprake*" me objekt "*Libra artistik për pasurim të fondit të bibliotekave të arsimit të mesëm dhe 9-vjeçar*", të zhvilluar nga DRAP Durrës, u konstatua se Njësia e Prokurimit nuk ka dokumentuar, përmes një relacioni argumentues, përzgjedhjen e procedurës "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës". Rezultoi se titullari ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 21, datë 11.11.2024, pa miratimin e relacionit shpjegues mbi përdorimin e kësaj procedure, në kundërshtim me kërkesat e pikës 10.a të Udhëzimit të APP nr. 06, datë 16.07.2021*"Mbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".*
DRAP Durrës, me shkresë nr. 1847 prot., datë 22.08.2024, ka përcjellë listën e titujve artistikë rekomandues për pasurimin e bibliotekave të shkollave, bazuar në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) nr. 4721/1 prot., datë 24.07.2024, e cila përmban 764 tituj për vitin shkollor 2024–2025. Rezultoi se në përzgjedhjen e titujve nuk është respektuar shkresa e MAS, pasi janë shtuar edhe tituj jashtë saj, konkretisht tituj të librave artistik të vitit 2023, të cilit kishin ngelur parealizuar për shkak të mungesës së dokumentacionit, në kundërshtim me shkresën e MAS nr. 4721/1 prot., datë 24.07.2024.KVO nuk ka mbajtur proces verbal për të vlerësuar ofertat e paraqitura në SPE nga OE, veprim në kundërshtim me nenin 2 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. Në Raport Përmbledhës nr. 1847/73 prot, datë 26.11.2024 nuk janë trajtuar arsyet e s' kualifikimit të 6 OE, me vlerë totale të ofertuar 2,994,326 lekë, përkatësisht shtëpitë botuese "I." ,Shtëpia Botuese "B. T" , Shtëpia Botuese "B." , Shtëpia Botuese "A", Shtëpia Botuese "P" në kundërshtim me nenin 2 pika ë) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*". Në rishpallje

procedure nuk janë shprehur arsyet e s' kualifikimit të 6 OE me vlerë totale të ofertuar 863,573 lekë, përkatësisht "Loti 4: shtëpia botuese "B."; Loti 5: shtëpia botuese "A."; Loti 6: shtëpia botuese "P." në kundërshtim me nenin 2 pika ë) . të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*
Komisioni i marrjes në dorëzim të librave artistike, në 12 procesverbalet e marrjes në dorëzim të librave artistike nuk ka evidentuar të dhënat kryesore mbi titullin e librit, autorin e librit, sasinë e dorëzuar, si dhe nuk kanë shënuar të dhëna mbi gjendjen fizike të librit për të vërtetuar nëse librat plotësojnë specifikmet teknike, në kundërshtim me DST, Shtojca *7 "Formulari i specifikimeve teknike*" dhe pikën 54 të Udhëzimit nr. 30/2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".* Gjithashtu nuk ka hartuar Raport Përmbledhës mbi zbatimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 2, pika 2, gërma ll) te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar. Anëtarët e KVO nuk kanë nënshkruar deklaratën e konfliktit të interesit datë 30.10.2024, në kundërshtim me nenit 73 pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
24.1 Rekomandimi: DRAP Durrës të marrë masa për garantimin dhe administrimin e plotë, të rregullt dhe të dokumentuar të procedurave të prokurimit publik, me qëllim korrigjimin e mangësitë e konstatuara. Autoriteti Kontraktor duhet të sigurojë që çdo proces prokurimi të jetë i planifikuar, i argumentuar dhe i dokumentuar në mënyrë të plotë, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm për menaxhimin e prokurimeve.

Në vijimësi

25. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve për vitin 2024, DRAP Durrës ka zhvilluar 2 procedura prokurimi të "Blerje e Vogël", konkretisht: stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të para me REF-.-.-.-. dhe fond limit 653,437 lekë (pa TVSH), si dhe stampimi i manualeve TIK për nxënësit e klasave të dyta me REF-17854-09-03-2024 dhe fond limit 886,432 lekë (pa TVSH). Vlera totale e këtyre procedurave është 1,539,869 lekë (pa TVSH). Stampimi i manualeve TIK për klasat e para dhe të dyta përbën grup mallrash të ngjashëm dhe për efekt të përllogaritjes së kufirit monetar për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, duhej të konsideroheshin së bashku. Duke qenë se vlera e përbashkët tejkalon kufirin prej 1,000,000 lekë në vit, përdorimi i procedurës "Blerje e Vogël" rezultoi në kundërshtim me nenin 56, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*. Gjithashtu, u konstatua se procesverbali nr. 1884/2 prot., datë 06.09.2024, i mbajtur nga Komisioni i Blerjeve të Vogla, nuk përmban informacion mbi njoftimin dhe mungesën e pjesëmarrjes së operatorit ekonomik "R. G." gjatë procedurës së shortit, në kundërshtim me nenin 82, pika 6, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*.
Në dokumentacionin e dosjes së prokurimit mungon Njoftimi i Fituesit për operatorin ekonomik "F." shpk, me ofertë fituese në vlerën 326,719 lekë (pa TVSH) për procedurën e prokurimit *Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së parë*", si dhe formulari Njoftimi i Fituesit për ofertën 443,217 lekë (pa TVSH), për procedurën e prokurimit *Manuale TIK për mësues dhe nxënës të klasës së dytë*" të gjeneruara nga SPE, veprim në kundërshtim me nenin 83, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 **"***Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe pikën 22 të Udhëzimi nr. 6, datë 25.06.2021 i APP-së "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".
Komisioni i Marrjes në Dorëzim, në procesverbalin nr. 1883/3 prot., datë 16.09.2024, nuk është shprehur mbi përputhshmërinë e manualeve TIK të marra në dorëzim me specifikimet teknike të

përcaktuara, konkretisht për formatin e letrës, ngjyrat e stampimit, kopertinën dhe elementë të tjerë teknikë, duke mos garantuar verifikimin e plotë të mallrave të furnizuara në raport me kërkesat e përcaktuara nga Komisioni i Blerjeve të Vogla.
Në procedurën e prokurimit "Blerje e vogël" me objekt me objekt "*Vegla Muzikore*", REF-.-.-.-. për IAP-et në vartësi të DRAP Durrës, për programin Art dhe Zeje u konstatua se në proces verbal nr. 1524/2 prot, datë 02.07.2024, nuk është shënuar vlera e fondit limit, në kundërshtim me nenin 56 pika 4 të VKM nr. 285/2021.
Në dokumentacion mungon formulari i shpalljes së fituesit "E. L." me ofertë 492,112 lekë (pa tvsh), në kundërshtim me nenin 83 pika 1 të VKM nr. 285/2021.
Komisioni i marrjes në dorëzim nuk është shprehur mbi specifikimet teknike për "Kitarë Klasike" si pjesa e sipërme, ura, gjerësi, thellësi, ngjyra; për Metronom digjital specifikime si variacione rrahjesh për praktikim, butoni "tempo" për të rregulluar ritmin, ekran i madh LCD, funksion i zërit, etj., sipas termave teknike të përcaktuar në specifikimet teknike, etj. në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
25.1 Rekomandimi: DRAP Durrës të marrë masa për përmirësimin e proceseve të planifikimit, organizimit dhe administrimit të procedurave të prokurimit, duke siguruar koordinim më të mirë ndërmjet strukturave përgjegjëse, dokumentim të plotë të veprimeve administrative dhe procedurale, si dhe rritjen e kontrolleve në të gjitha fazat e procesit, nga planifikimi dhe zhvillimi i procedurës deri në marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, me qëllim rritjen e transparencës, gjurmueshmërisë dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike.

Në vijimësi

26. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi, DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës nuk kanë realizuar procedurat e prokurimit për sigurimin e shërbimit të transportit për nxënësit dhe mësuesit, pasi nuk janë paraqitur operatorë ekonomikë, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar. Në kushtet e mosrealizimit të procedurave të prokurimit, DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës kanë njoftuar ZVAP-të përkatëse, për vijimin e procedurës së pagesave për transportin e punonjësve arsimorë. Mosrealizimi i prokurimit pengon sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm dhe të organizuar për transportin e nxënësve dhe mësuesve, duke rritur rrezikun e cënimit të cilësisë në procesin mësimor dhe efikasitetin e institucioneve arsimore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
26.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë dhe DRAP Durrës t'i drejtohen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me propozime dhe problematika konkrete lidhur me mosrealizimin e procedurave të prokurimit për shërbimin e transportit, për rastet e mungesës së ofertave ose interesit nga operatorët ekonomikë, me qëllim analizimin e shkaqeve, vlerësimin e efektivitetit të modelit aktual të prokurimit dhe identifikimin e mekanizmave alternativë që garantojnë realizimin e shërbimit dhe zbatimin efektiv të skemës së transportit për nxënësit dhe punonjësit arsimorë.

Në vijimësi

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ZVAP Tiranë, Kavajë, Kamzë dhe Rrogozhinë, kanë zbatuar tarifa udhëtimi për punonjësit arsimorë dhe nxënësit në mënyrë të pasaktë, duke përdorur tarifa të ndryshme nga ato të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nuk rezultoi të ishte kryer dhe dokumentuar verifikimi

i ekzistencës së transportit qytetës në vendbanimet përkatëse, si dhe nuk u evidentua mbështetja ligjore dhe dokumentare për aplikimin e tarifave të indeksuara në rastet e konstatuara, në kundërshtim me pikat 1 dhe 3 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", e ndryshuar, si dhe nenin 10, germat "c" dhe "ç" të ligjit nr. 8308/1998 "Për transportet rrugore", sipas të cilit tarifat e transportit qytetës dhe rrethqytetës miratohen nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, shkresa e MAS nr. 1746 prot., datë 06.03.2024, lidhur me aplikimin e tarifave ndërqytetëse për transportin qytetës dhe rrethqytetës, duke referuar VKM nr. 92/2024, nuk përputhet me dispozitat e nenit 10, germat "c" dhe "ç", të ligjit nr. 8308/1998, pasi tarifat për transportin qytetës dhe rrethqytetës miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe jo nga Këshilli i Ministrave.

ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Vorë për punonjësit arsimorë, të cilët ushtrojnë detyrën në shkolla publike jashtë qendrës urbane, për largësi nga vendbanimi mbi 5 km deri në 50 km dhe kthehen brenda ditës, kanë përfituar kompensim transporti, në mënyrë uniforme, me tarifën fikse prej 2,700 lekë/muaj. Ky kompensim është aplikuar pa diferencim sipas distancës së transportit, në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se në ZVAP Tiranë evidentohen mangësi në administrimin, dokumentimin dhe standardizimin e procesit të kompensimit të shpenzimeve të transportit të punonjësve. Në listëpagesa nuk pasqyrohet distanca e udhëtimit, si element thelbësor për përcaktimin e të drejtës së përfitimit dhe masës së kompensimit. Në disa raste nuk evidentohet qendra administrative ose vendndodhja e institucionit arsimor. ZVAP nuk disponon dokumentacion mbështetës për verifikimin e distancës, duke argumentuar se ky dokumentacion administrohet nga drejtoritë e institucioneve arsimore parauniversitare. Listëprezencat e institucioneve arsimore, mbi të cilat mbështetet likuidimi i kompensimit të transportit, nuk administrohen me protokoll hyrës në ZVAP dhe jo në të gjitha rastet përmbajnë të dhënat mbi distancën e udhëtimit. Kompensimi i transportit trajtohet në listëpagesat e pagave si element i pagesës neto, ndërsa përllogaritja sipas distancës nuk evidentohet në mënyrë të plotë. Gjithashtu, evidentohen praktika të ndryshme në hartimin dhe administrimin e listëpagesave nga specialistë të të njëjtit sektor, duke reflektuar mungesë standardizimi dhe uniformiteti në administrimin e këtij procesi

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1 Rekomandimi: ZVAP të marrin masa për forcimin e kontrolleve administrative mbi procesin e përfitimit dhe pagesës së kompensimit të transportit, duke siguruar dokumentimin e plotë të distancës së transportit, administrimin e dokumentacionit mbështetës, dokumentimin e verifikimit të ekzistencës së transportit qytetës/rrethqytetës dhe të tarifave të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, standardizimin e modeleve të listëpagesave, si dhe përllogaritjen e kompensimit në funksion të distancës së përshkuar.

27.2 Rekomandimi: Ministria e Arsimit të rishqyrtojë shkresën nr. 1746 prot., datë 06.03.2024, duke e harmonizuar me kuadrin ligjor në fuqi, në mënyrë që të eliminohen paqartësitë në interpretimin dhe zbatimin e tarifave të transportit qytetës dhe rrethqytetës, të sigurohet përputhshmëria me kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore për miratimin e këtyre tarifave dhe të garantohet zbatim i unifikuar nga të gjitha ZVAP-të.

Në vijimësi

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në procesin e administrimit, dokumentimit dhe pagesës së shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë dhe nxënësit në ZVAP Tiranë,

Kavajë, Rrogozhinë dhe Vorë pagesat e transportit janë kryer në masën 100% përmes shërbimit postar, pa dokumentuar mungesën e shërbimit bankar dhe pa evidentuar në listëpagesa prindin, kujdestarin ligjor ose përfituesin me prokurë të posaçme, në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119, datë 01.03.2023*"Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*". Gjithashtu, rakordimet mujore me Postën Shqiptare për fondet e tërhequra nga përfituesit nuk janë kryer, duke mos garantuar gjurmueshmëri dhe kontroll të plotë mbi fondet publike të transferuara, në kundërshtim me nenin 12, pika 3, germa "a" të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010*"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".*

Në disa raste, pagesat janë realizuar me vonesë ose në mënyrë të përbashkët për periudha dy mujore, në kundërshtim me pikën 4 të VKM nr. 119/2023, sipas së cilës pagesat duhet të kryhen çdo muaj mbi bazën e të dhënave të dërguara nga institucionet arsimore parauniversitar. Po ashtu, listëprezencat dhe listëpagesat nuk mbajnë numër dhe datë protokolli hyrës, në kundërshtim me nenin 24 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e ZVAP-ve, ndërsa mungon dokumentimi i distancës kilometrike dhe verifikimi i kushtit ligjor për mungesën e transportit qytetës në vendbanimet përkatëse, sipas pikës 1/b të VKM nr. 119/2023.

Mungesa e procedurave të standardizuara dhe e rregulloreve të miratuara nga DRAP Tiranë për dokumentimin e distancës, përcaktimin e përfituesve dhe elementët e listëpagesave ka sjellë dobësi në administrimin e procesit të kompensimit të transportit, rrezik për pagesa të pajustifikuara dhe mungesë transparence në përdorimin e fondeve publike në nivel vendor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1 Rekomandim: ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Rrogozhinë, ZVAP Vorë të marrin masa për forcimin e kontrollit të brendshëm dhe standardizimin e procesit të administrimit të pagesave të transportit, përmes miratimit të procedurave të unifikuara administrative, formalizimit të dokumentacionit mbështetës, forcimit të mekanizmave të rakordimit dhe monitorimit, si dhe garantimit të gjurmueshmërisë së plotë të procesit të përfitimit dhe pagesës së fondeve publike për transportin.

28.2 Rekomandim: DRAP Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të hartojë dhe miratojë procedura të unifikuara për të gjitha ZVAP-të lidhur me administrimin e shpenzimeve të transportit, duke përcaktuar qartë dokumentacionin vërtetues të distancës, institucionin përgjegjës për administrimin dhe verifikimin e tij, si dhe elementët standard që duhet të përmbajnë listëpagesat.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për hartimin e PBA 2022–2024 rezultoi se procesi i përgatitjes së tij në institucionet ZVAP Tiranë, ZVAP Rrogozhinë, ZVAP Vorë, ZVAP Kavajë dhe DRAP Durrës është shoqëruar me mangësi në drejtim të respektimit të kërkesave ligjore dhe procedurale. U konstatua se institucionet nuk kanë nxjerrë urdhrat për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt-buxhetit. Konkretisht, ZVAP Tiranë nuk ka nxjerrë urdhër për periudhën 2022–2024 dhe 2023-2025, ZVAP Rrogozhinë nuk ka ngritur grup pune për të gjithë periudhën objekt auditimi, ZVAP Vorë dhe ZVAP Kavajë nuk kanë nxjerrë urdhër për vitin 2022, ndërsa DRAP Durrës nuk ka nxjerrë urdhër për hartimin e projekt-buxhetit për vitin 2024. Si rrjedhojë, procesi është zhvilluar pa një strukturë të formalizuar dhe pa përcaktim të qartë të roleve dhe përgjegjësive, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".*

Procesi i hartimit të PBA-së nga ZVAP-et dhe DRAP Durrës është kryer vetëm në një fazë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018, duke mos realizuar një proces të plotë rishikimi dhe vlerësimi të nevojave buxhetore.
Dokumentet e PBA-së paraqiten me mangësi në përmbajtje, pasi nuk janë përfshirë elemente thelbësore si misioni i njësisë, përshkrimi i programeve dhe objektivave të tyre, treguesit e performancës dhe aktivitetet e planifikuara për kërkesat buxhetore, në kundërshtim me Kapitullin I, pikën 8 të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018. Në mënyrë të veçantë, PBA-ja e ZVAP Tiranë nuk ka të bashkëlidhur përmbledhjen e kërkesave buxhetore sipas programeve dhe artikujve për vitin 2022. Në vijim, u konstatua se ZVAP Vorë ka dërguar shkresën për përgatitjen e projekt-buxhetit vetëm në MAS, pa e përcjellë më parë në DRAP Durrës, duke mos ndjekur zinxhirin institucional të përcaktuar në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018. Gjithashtu, në kundërshtim me Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e DRAP Durrës, rezultoi se ZVAP-të kanë përcjellë dokumentacionin njëkohësisht në DRAP dhe MAS, pa u dokumentuar procesi i shqyrtimit nga DRAP, pa kthim komentesh apo rishikim të materialit, duke munguar kështu gjurma e plotë e procesit të koordinimit institucional.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 21-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
29.1 Rekomandimi: Nga DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, Rrogozhinë, Vorë dhe Kavajë, të merren masa për zbatimin e plotë të kuadrit ligjor në procesin e hartimit të PBA-së, duke siguruar ngritjen e grupeve të punës me përgjegjësi të përcaktuara, respektimin e procesit me dy faza, përmirësimin e përmbajtjes së dokumenteve buxhetore dhe zbatimin e kërkesave metodologjike. Gjithashtu, ZVAP-et të sigurojnë komunikimin institucional për sa i përket shqyrtimit dhe dokumentimit të procedurës se PBA-së.

Në vijimësi

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e DRAP Tiranë, DRAP Durrës dhe ZVAP Tiranë, Kamëz, Vorë, Rrogozhinë nuk janë publikuar raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi 2022-2025, në kundërshtim me kërkesat e kreut IV, paragrafi i fundit, nënpika 49 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 30.05.2023*"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore"*. Gjithashtu rezultoi se nga ana e ZVAP-ve dhe DRAP Tiranë nuk janë paraqitur në relacion arsyet dhe shkaqet e mosrealizimit të projekteve që janë planifikuar por nuk janë realizuar deri në fund të vitit, duke kufizuar mundësinë e vlerësimit të performancës në administrimin e fondeve publike dhe dobësojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm për identifikimin dhe adresimin në kohë të problematikave që ndikojnë në realizimin e objektivave buxhetore.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 21-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
30.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë, DRAP Durrës dhe ZVAP-të përkatëse të marrin masa për publikimin e raporteve të monitorimit në faqet e tyre zyrtar, si dhe të sigurojnë që në relacionet shoqëruese të pasqyrohen analizat mbi realizimin e objektivave të planifikuara, duke evidentuar shkaqet e mosrealizimit të projekteve, masat e ndërmarra dhe veprimet korrigjuese për adresimin e devijimeve të konstatuara.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se kontratat e qirasë të lidhura për ZVAP Kamëz dhe ZVAP Vorë nuk përcaktojnë qartë objektin e qirasë, të dhënat mbi sipërfaqen në m² dhe përshkrimin e detajuar i ambienteve të marra me qira. Gjithashtu, kontratat nuk parashikojnë afatet dhe mënyrën e pagesës së qirasë, nuk rregullojnë në mënyrë të plotë të drejtat dhe detyrimet e

palëve kontraktuese, si dhe nuk përcaktojnë detyrimet e tjera që i lindin qiramarrësit nga lidhja e kontratës, përveç pagesës së tarifës mujore të qirasë. Mungesa e këtyre klauzolave krijon paqartësi në interpretimin dhe zbatimin e marrëdhënies kontraktore, dobëson sigurinë juridike të kontratës dhe rrit rrezikun e lindjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, duke kufizuar njëkohësisht mundësinë e institucionit për të kërkuar përgjegjësi kontraktore në rast të mosrespektimit të detyrimeve. Këto mangësi bien në kundërshtim me parashikimet e neneve 659, 663, 698 dhe 801–802 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 21-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandimi: ZVAP Kamëz dhe ZVAP Vorë të marrin masa për rishikimin dhe plotësimin e kontratave të qirasë, duke përcaktuar qartë objektin e qirasë, afatet dhe mënyrën e pagesës, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe detyrimet e tjera ekonomike që rrjedhin nga marrëdhënia kontraktore.

Brenda vitit 2026

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar rezultoi se:

- Institucionet DRAP Durrës, DRAP Tiranë, ZVAP Tiranë, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë, nuk kanë miratuar një plan të veçantë për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm dhe të lartë, në kundërshtim me nenin 10, pika 2, gërma a) të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe anekset 5, 6 dhe 7 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Nuk janë realizuar plane vjetore trajnimesh për punonjësit e DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë në kundërshtim me nenin 9, pika 4, gërma dh) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar;
- Titullarët e institucioneve DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk kanë marrë masa mbi hartimin dhe miratimin e Regjistrit të Riskut, në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 21, pika 1; pika 2 si dhe Udhëzimi 16, datë 20.07.2016 Kreu 4, pika 2;
- Titullarët e institucioneve DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk kanë urdhëruar ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik;
- Titullarët e institucioneve DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë nuk kanë miratuar një Strategji për Menaxhimin e Riskut, në kundërshtim me ligjin 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 21, pika 2.
- ZVAP Rrogozhinë nuk ka dërguar pranë Ministrisë përgjegjëse deklaratat dhe raportin vjetor, së bashku me pyetësorët e vetëvlerësimit brenda afatit kohor të përcaktuar, për vitet objekt auditimi 2022-2025, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 297-344 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.1 Rekomandimi: Titullarët e DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë të marrin masa për forcimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të planit të veprimit, regjistrit dhe strategjisë së menaxhimit të riskut, ngritjes dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, planifikimit dhe realizimit të trajnimeve për stafin, si dhe hartimit

dhe përditësimit të vazhdueshëm të gjurmëve të auditimit për proceset financiare dhe jo financiare, me qëllim rritjen e efektivitetit, transparencës, llogaridhënies dhe performancës institucionale.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faqeve zyrtare elektronike të institucioneve u konstatua se në disa raste informacioni i detyrueshëm për publikim dhe aksesim nga publiku, në lidhje me të dhënat e arsimit parauniversitar, informacionin për provimet kombëtare, raportet e veprimtarisë, raportet e monitorimit të buxhetit, etj., nuk janë përditësuar, duke kufizuar transparencën dhe të drejtën për informim të qytetarëve, në kundërshtim me urdhrin nr. 153, datë 17.04.2025 "*Për miratimin e rregullores për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 297-344 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
33.1 Rekomandimi: Institucionet DRAP Tiranë, DRAP Durrës, ZVAP Tiranë, ZVAP Vorë, ZVAP Kamëz, ZVAP Kavajë dhe ZVAP Rrogozhinë të marrin masa mbi publikimin e të dhënave mbi vendimmarrjet apo njoftimet lidhur me veprimtarinë në faqet zyrtare elektronike, me qëllim aksesueshmërinë dhe garantimin e mundësisë së njohjes me informacionin publik, në referim të së drejtës së informimit si dhe të parimit të transparencës së administratës publike.

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit rezultoi se Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë nuk ka kryer procesin e inventarizimit sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr.30, datë 27.11.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 73, si dhe të pikës 81 dhe 82, 104, 105, pasi nuk ka mbajtur procesverbale dhe relacione pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre, apo nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, mosveprime të cilat nuk paraqesin gjendjen reale të magazinës dhe stokut në mënyrë që të ketë planifikime sa më të sakta për vitin pasardhës.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5. faqet nr. 297-344 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
34.1 Rekomandimi: Nga ana e Titullarit ZVAP Rrogozhinë të merren masa mbi realizimin e procesit të inventarizimit të aktiveve të njësisë publike, ku të përfshihet ngritja e Urdhrit për Komisionin e Inventarizimit, mbajtja e procesverbaleve nga ana e komisionit për vlerësimin e aktiveve, si dhe mbajtjen e relacioneve për aktivet që duhen nxjerrë jashtë përdorimit.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ZVAP Tiranë, ZVAP Kamëz dhe ZVAP Rrogozhinë janë likuiduar detyrime që burojnë nga vendime gjyqësore të formës së prerë, kryesisht për largime të padrejta nga puna, duke sjellë efekte financiare negative në buxhetin e shtetit, si më poshtë:
- Nga ZVAP Tiranë janë likuiduar 8 vendime gjyqësore të formës së prerë, në vlerën totale 6,379,851 lekë. Konkretisht: 4 raste, në vlerën 5,390,144 lekë, për largim të padrejtë nga puna; 1

rast, në vlerën 665,590 lekë, për diskriminim të fëmijës në kopsht; 1 rast, në vlerën 106,800 lekë, për mbrojtjen e të dhënave personale; 1 rast, në vlerën 115,200 lekë, për njohjen e pavërtetësisë së numrit të amzës; 1 rast, në vlerën 102,117 lekë, për detyrimin e pagesës së shpenzimeve të telefonisë celulare. Për 4 raste, nuk është kryer ekzekutimi vullnetar i vendimeve gjyqësore, por është kontraktuar përmbarues privat. Për pasojë, nga vlera totale e likuiduar prej 6,379,851 lekë, shuma 415,513 lekë përfaqëson pagesa për shërbimin përmbarimor privat, në kundërshtim me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* i ndryshuar.

- Nga ZVAP Kamëz është likuiduar 1 vendim gjyqësor i formës së prerë për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 842,226 lekë, prej të cilës 52,146 lekë është pagesë për shërbimin përmbarimor privat, në kundërshtim me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* i ndryshuar.
- Nga ZVAP Rrogozhinë është likuiduar 1 vendim gjyqësor i formës së prerë për largim të padrejtë nga puna, në vlerën 1,671,754 lekë, prej të cilës 85,321 lekë është pagesë për shërbimin përmbarimor privat, në kundërshtim me pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, *"Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",* i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3. faqet nr. 161-253 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: DRAP Tiranë të analizojë rastet e vendimeve gjyqësore të formës së prerë që kanë sjellë efekte financiare negative në buxhetin e shtetit, me qëllim identifikimin e përgjegjësive administrative për vendimmarrjet dhe veprimet që kanë çuar në largime të padrejta nga puna dhe detyrime të tjera financiare ndaj institucionit. Gjithashtu, të marrë masat e nevojshme organizative dhe administrative për ekzekutimin vullnetar të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afateve ligjore, duke shmangur përdorimin e shërbimit përmbarimor privat dhe kostot shtesë që rëndojnë buxhetin e shtetit.

Brenda vitit 2026

2. Gjetje nga auditimi: ZVAP Tiranë, ZVAP Kavajë, ZVAP Rrogozhinë dhe ZVAP Vorë kanë kryer pagesa për shpenzimet e transportit të punonjësve arsimorë që ushtrojnë detyrën brenda qendrave urbane përkatëse në kundërshtim me kriterin ligjor që parashikon përfitimin e kompensimit të transportit vetëm për punonjësit arsimorë që punojnë jashtë qendrave urbane.

Konkretisht, nga auditimi i listëpagesave të transportit për muajin dhjetor 2025 u konstatua se:

- Në ZVAP Tiranë kanë përfituar shpenzime transporti gjithsej 122 punonjës të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytet ose fshat dhe me vendndodhje të IAP-ve publike brenda qendrave urbane dhe njësive administrative të Bashkisë Tiranë, në vlerë totale prej 1,033,110 lekë.
- Në ZVAP Kavajë kanë përfituar shpenzime transporti 7 mësues të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat të cilët punojnë në shkollat publike me vendndodhje qytetin Kavajë, në vlerën 18,356 lekë.
-Në ZVAP Rrogozhinë kanë përfituar shpenzime transporti 27 mësues të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat të cilët punojnë në shkollat publike me vendndodhje brenda qytetit Rrogozhinë, në shumën 449,050 lekë.
- Në ZVAP Vorë kanë përfituar shpenzime transporti 51 punonjës arsimore të arsimit 9-vjecar dhe arsimit të mesëm, me vendbanim të përhershëm në qytetet ose fshat të cilët punojnë në shkolla publike me vendndodhje brenda qytetit Vorë, në shumën 246,760 lekë

Përfitimi i këtyre pagesave është bërë në kundërshtim me pikën 11, germa "a", të VKM nr. 119, datë 01.03.2023 "*Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve e që mësojnë jashtë vendbanimit*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet nr. 71-161 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandimi: ZVAP-të nën juridiksion të DRAP Tiranë të marrin masa për forcimin e proceseve të verifikimit, administrimit dhe dokumentimit të përfitimit të shpenzimeve të transportit për punonjësit arsimorë, duke siguruar evidentimin e saktë të vendndodhjes së IAP-ve, dokumentimin e plotë të kritereve të përfitimit, standardizimin e dokumentacionit mbështetës dhe rritjen e kontrolleve administrative para kryerjes së pagesave, me qëllim garantimin e përdorimit të fondeve publike në përputhje me destinacionin e tyre, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të unifikuar për të gjithë punonjësit arsimorë.

Brenda vitit 2026

3. Gjetje nga auditimi: DRAP Durrës me urdhër shpenzimin nr. 111, datë 26.10.2023, ka paguar faturën e shoqërisë "O.", në vlerën 11,400 Euro, për tarifën e regjistrimit të pjesëmarrjes së 114 nxënësve dhe mësuesve të shkollës Koreografike dhe korit të Liceut Artistik Tiranë në Festivalin Ndërkombëtar të të Rinjve "Vivas Ẇorld", Itali. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se Shkolla Koreografike me shkresën nr. 494, i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit mbulimin me fonde të tarifës së regjistrimit. Sekretari i MAS, me shkresën nr. 4356/2, datë 07.07.2023, i ka kërkuar DRAP Durrës të marrë masat e nevojshme për mbështetjen financiare të tarifës së regjistrimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 1265/1, datë 18.07.2023, ka miratuar transferimin e fondeve në vlerën 1,250,000, për DRAP Durrës. Ftesa zyrtare e organizimit të aktivitetit, e cila përcakton se zhvillimi i festivalit do të jetë në datat 08-22 Korrik 2023, është dërguar po më datë 08.07.2023, pra në të njëjtën datë me datën e fillimit të aktivitetit. Për rrjedhojë kërkesa për financim, përcaktimi i pjesëmarrësve dhe korrespodenca institucionale për mbulimin e shpenzimeve janë kryer përpara administrimit të ftesës zyrtare. Gjithashtu, në dokumentacion u konstatua mosrakordim lidhur me periudhën e zhvillimit të aktivitetit, pasi në shkresat e administruara referohen data të ndryshme *(08-22 korrik 2023, 08-20 korrik 2023 dhe 10-20 korrik 2023).* Shoqëria "O. C." ka lëshuar faturën me datë 21.07.2023, në vlerën 11,400 Euro (114 persona* 100 Euro), me përshkrimin "Tarifa e regjistrimit të pjesëmarrësve në Festivalin Ndërkombëtar "Vivas Ẇorld", 08-20 korrik 2023". Po në datën 21.07.2023, Presidenti i Përkohshëm i Shoqatës, ka lëshuar deklaratë në të cilën konfirmon marrjen e shumës 11,400 Euro, si kontribut për pritjen e delegacionit të nxënësve dhe mësuesve të Liceut Artistik Tiranë. Ndërkohë, drejtori i DRAP Durrës ka nxjerrë urdhrin nr. 131, datë 24.10.2023, për pagesën e kësaj fature. Konfirmimi i marrjes së shumës nga organizatori i aktivitetit në datën 21.07.2023, pra rreth tre muaj përpara nxjerrjes së urdhrit të pagesës dhe kryerjes së likuidimit nga DRAP Durrës, krijon paqartësi mbi dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e transaksionit financiar.
Për sa më sipër , dokumentacioni i administruar nuk siguron një gjurmë auditimi të plotë, të qartë dhe të besueshme mbi ligjshmërinë e angazhimit dhe likuidimit të pagesës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet nr. 12-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1 Rekomandimi: DRAP në bashkëpunimi me ZVAP, të marrin masa për forcimin e proceseve të miratimit, financimit dhe dokumentimit të pjesëmarrjes së nxënësve dhe mësuesve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar administrimin e plotë të dokumentacionit justifikues

dhe përcaktimin e qartë të kostove të aktiviteti që do të mbulohen nga buxheti i shteti përpara pjesëmarrjes në këto aktivitete.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 germat b, c dhe ç, neni 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, i rekomandojmë Titullarit të Drejtorisë Rajonale të Arsimi Parauniversitar, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar të Auditimit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT